

Prof. Dr. Ekrem Sarëkçëogllu

Historia e feve

(prej fillimit deri sot)

Përkth. Dr. Qani Nesimi

2007

Krahasimi me origjinalin dhe redaktimi shkencor:
Doc. Dr. Metin Izeti
Mr. Nasir Rexhepi

Redaktor gjuhësor:
Pjetrit Bezhani

Botoi: **Logos – A, Shkup 2007**

Titulli origjinal:
Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi

PËRMBAJTJA:

DISA FJALË PËR AUTORIN	11
PARATHËNIE	12
SHKENCA E HISTORISË SË FEVE	13
HYRJE	15
1. Historia e feve në botën islame.....	15
2. Historia e feve në përditë	16
3. Historia e feve në Shtetin Osman dhe në Turqi	18
4. Veprat e historisë së feve në shtetin Osman dhe në Turqi	19
FETË PARAHISTORIKE NË AZINË E MESME	20
1. Ademi dhe Hava	20
2. Zbulimet historike dhe komentimet e tyre	22
FETË E MESOPOTAMISË SË VJETËR	25
1. Fetë e sumerëve.....	26
2. Fetë babilonase dhe asiriane.....	27
a. Sistemi i zotave.....	27
b. Koncepti për gjithësinë	28
c. Magjia	29
ç. Jeta pas vdekjes	29
3. Shfaqja e monoteizmit reagim ndaj politeizmit.....	30
a. Ibrahim/Abrahami.....	30
b. Junusi/Jona.....	31
c. Ezekieli	31
ç. Danieli.....	32
FEJA NË EGJIPTIN E VJETËR	33
1. Literatura fetare	34
2. Koncepti për gjithësinë	34
3. Hyjnitë dhe fuqitë mbinatyrore	34
4. Amonefisi dhe iniciativa për reforma.....	36
5. Jusufi/Josefi.....	36
6. Faraoni dhe murgjit.....	37
7. Koncepti për jetën pas vdekjes.....	37
FETË NË ANADOLLIN E VJETËR.....	39
1. Besimet parahistorike	39
a. Kafshët e shenjta	40
b. Kultet	40
c. Kulti i të vdekurve.....	41
ç. Vendet e kultit dhe tempujt.....	41
2. Feja e hititëve	42
a. Zotat e hititëve	42
b. Adhurimet	43
c. Profecia dhe magjia	43
ç. Doket për të vdekurit.....	43
d. Tempujt.....	44
FETË E VJETRA TË ARABISË.....	45

1. Fetë e vjetëra në Arabinë Veriore	45
a. Një vështrim i përgjithshëm historik	45
b. Koncepti për zotin dhe besimet e tyre.....	47
c. Kultet.....	48
ç. Paraqitja e monoteizmit dhe kundërshtimi i politeizmit.....	49
2. Fetë në Arabinë Jugore	56
3. Fetë në Arabinë e Mesme	57
a. Kultet	58
b. Ismaili/Ishmaeli	59
c. Hanifët	60
FETË E VJETRA TË EVROPËS.....	61
1. Feja e vjetër e Greqisë	62
a. Bota e zotave të Greqisë	62
b. Konceptet për jetën pas vdekjes.....	64
c. Reagimet ndaj politeizmit.....	64
2. Feja romake.....	65
a. Bota e zotave të Romës.....	66
b. Zhvillimi i fesë romake	67
3. Feja e vjetër teutone (fis i vjetër gjerman).....	68
a. Koncepti për gjithësinë	68
b. Zotat dhe kultet e tyre	68
c. Murgëria dhe kulti	69
ç. Besimi në fat	69
d. Koncepti për vdekjen	69
dh. Koncepti për eskatologjinë.....	70
4. Feja e keltëve	70
a. Koncepti për gjithësinë	70
b. Kultet	71
c. Koncepti për jetën pas vdekjes	71
5. Feja e sllavëve.....	71
a. Zoti dhe fuqitë mbinatyrore	72
b. Koncepti për vdekjen	72
FEJA E VJETËR AMERIKANE	73
1. Aztekët.....	73
2. Majatë.....	75
3. Inkatë.....	75
4. Çibçatë	75
5. Piramidat e Amerikës Jugore.....	76
6. Pasqyrimet e besimit të vjetër amerikan	76
FEJA TRADICIONALE TURKE.....	78
1. Emri i besimit tradicional turk dhe adhurimet e tyre	79
2. Koncepti për Zotin.....	79
3. Fuqitë natyrore dhe shpirtërore.....	80
a. Shpirti dhe kulti i malit.....	80
b. Shpirti dhe kulti i zjarrit.....	81
c. Kulti i stërgjyshërve.....	81
ç. Shpirtërat nëntokësorë.....	81
d. Shpirtërat e fëmijëve	82
4. Adhurimet	82
5. Klasa shpirtore (klerikët).....	83
6. Vdekja dhe besimet në lidhje me të	83
a. Mbajtja zi	84

b. Tradita e varrimit të të vdekurve	84
7. Marrëdhëniet e tyre me fetë e tjera.....	85
a. Budizmi.....	85
b. Zaratuizmi.....	85
c. Maniheizmi.....	85
ç. Krishterimi.....	86
d. Hebraizmi.....	86
ZARATUIZMI	87
1. Librat e shenjtë	87
2. Zaratuizmi	88
3. Koncepti për Zotin.....	90
4. Krijesat shpirtërore.....	90
5. Dualizmi.....	91
6. Koncepti për kohën.....	91
7. Format e adhurimit.....	91
8. Koncepti për botën e ardhshme.....	92
9. Dita e llogarisë.....	92
10. Gjendja e sotme.....	93
FETË GNOSTIKE	94
Burimet	94
Konceptet themelore.....	95
Koncepti për njeriun.....	96
Doktrina e shpëtimit.....	96
Koncepti i diturisë (gnosis).....	96
Koncepti për adhurimin.....	97
1. Sabiizmi	98
a. Studimet për sabiitët	98
b. Historiku.....	99
c. Librat e shenjtë	99
ç. Koncepti për Zotin.....	100
d. Koncepti për gjithësinë	101
dh. Koncepti për njeriun.....	102
e. Koncepti për shpëtimin	102
ë. Koncepti për eskatologjinë dhe mesianizmi	103
f. Koncepti për apokalipsin dhe botën e ardhshme	103
g. Adhurimet themelore	104
gj. Anëtarësimi në bashkësi dhe priftëria	104
h. Tempujt.....	105
2. Maniheizmi	106
a. Mani.....	106
b. Librat e shenjtë	107
c. Koncepti për Zotin.....	107
ç. Koncepti për njeriun dhe gjithësinë	108
d. Koncepti për shpëtimin	109
dh. Koncepti për eskatologjinë, mesianizmin dhe për apokalipsin	110
e. Koncepti për adhurimin.....	110
ë. Struktura shoqërore	112
FETË INDIANE	113
1. Hinduizmi.....	114
a. Shkrimet e shenjta	114
b. Mendimi për universin.....	116
c. Karma	116

ç. Sistemi i besimit.....	117
d. Kulti, adhurimi.....	119
dh. Priftëria.....	119
e. Jeta shoqërore.....	120
ë. Koncepti për botën e ardhshme.....	120
g. Zhvillimi i hinduizmit dhe rrymat e reja.....	121
Meditacioni transcendentel.....	121
Hare Krishna.....	122
gj. Qëndrimi i hinduizmit ndaj feve të tjera.....	123
2. Jogizmi.....	124
a. Ananda Marga.....	125
b. Lëvizja Neo-Sannyas Bhagawan Shree Rajneesh.....	125
3. Xhajizmi.....	126
a. Librat e shenjtë.....	126
b. Xhajna.....	126
c. Koncepti për gjithësinë.....	127
ç. Doktrina e shpëtimit dhe udhëzimit.....	127
d. Adhurimi.....	128
4. Sihizmi.....	128
a. Lindja e sihizmit.....	129
b. Zhvillimi i sihizmit.....	129
c. Besimi dhe adhurimi.....	130
5. Budizmi.....	130
a. Jeta e Budës.....	131
Buda historik.....	131
Buda si parim shpirtëror.....	131
b. Librat e shenjtë.....	132
c. Koncepti për Zotin.....	133
ç. Doktrina e udhëzimit dhe shpëtimit.....	133
d. Koncepti për jetën e pas vdekjes.....	136
dh. Murgëria (Sangha).....	136
e. Adhurimi në budizëm.....	138
ë. Rrymat kryesore të budizmit.....	138
g. Përhapja e budizmit.....	139
gj. Budizmi tibetian ose lamaizmi.....	140
h. Budizmi kinez.....	141
Fraksioni Çan-tsung (Zen).....	141
Fraksioni Tsing-to (Xhodo).....	142
i. Fraksioni Scientologjia.....	142
FETË E LINDJES SË LARGËT.....	144
1. Feja popullore kineze.....	144
2. Taoizmi.....	145
Disa këshilla të Laotsesë:.....	146
3. Konfuçionizmi.....	146
a. Librat.....	147
b. Doktrina.....	147
c. Muzika dhe ritmi.....	148
ç. Perfeksionimi.....	149
d. Doktrina e shtetit.....	149
dh. Udhëheqja e shtetit.....	150
4. Shintoizmi.....	151
a. Librat e shenjtë.....	151

b. Konceptet për gjithësinë	152
c. Forcat metafizike.....	152
ç. Kulti.....	152
d. Koncepti për botën e ardhshme	153
dh. Shinto i shtetit	153
5. Fetë e reja japoneze	154
6. Feja Cao-Dai e Vietnamit.....	155
7. Sun Myung Moon dhe Lëvizja e Unitetit	156
8. Kulti-Kargo.....	158
HEBRAIZMI	159
1. Moisiu	161
2. Jeta në Sina dhe dhjetë urdhërat.....	162
3. Aroni	163
4. Hidri (Hëzri).....	164
5. Jozueu bir i Nunit dhe periudha e njerëzve të urtë.....	164
6. Periudha e sundimtarëve	165
a. Davidi.....	165
b. Solomoni.....	166
7. Ndarja e shtetit.....	167
a. Elias.....	167
b. Elisa.....	168
c. Ishaja	168
ç. Jeremja	169
d. Dhu'l-Kifli.....	169
8. Periudha e syrgjynosjes.....	169
9. Kthimi në Palestinë	170
10. Ezra	170
11. Prej Bijve të Izraelit deri në hebraizëm	171
12. Mesjeta dhe koha e re	172
13. Themelet e besimit në hebraizëm.....	172
a. Besimi në Zotin	173
b. Besimi në botën e ardhshme	173
c. Besimi në engjëjt.....	174
ç. Besimi në profetët.....	174
d. Besimi në librat e shpallur.....	175
dh. Besimi në Mesian	176
14. Adhurimi dhe traditat.....	177
a. Lutjet.....	177
b. Agjërimi.....	178
c. Llogaritja e kohës.....	178
ç. Festat.....	178
d. Traditat	179
15. Rregullat e ushqimit	179
16. Simbolet.....	179
17. Misticizmi hebraik	180
a. Sabataj Sevi.....	181
b. Hassidizmi	181
18. Rrymat e reja në hebraizëm.....	182
a. Hebraizmi orodoks	182
b. Hebraizmi reformues	182
c. Hebraizmi konservator	183
19. Shteti osman dhe hebrenjtë.....	183

20. Qëndrimi i hebraizmit ndaj feve të tjera	184
KRISHTERIMI	185
1. Zakaria	186
2. Gjoni	186
3. Jezusi	187
a. Mesianizmi	189
b. Ç'është e ligjit	190
c. Misioni i Jezusit	190
ç. Ndarja nga bota dhe vlerësimet	191
d. Jezusi hyjnor	192
4. Pritja e Mesias	192
Jehona e shtetit hyjnor	192
5. Shkrimet e shenjta	194
Ungjijtë apokrifë	196
6. Komuniteti i parë dhe fillimi i ndarjeve	197
a. Problemet krishtere me origjinë idhujtare	198
Mosmarrëveshjet në të kuptuarit e termit apostull	198
Mosmarrëveshjet në udhëheqësinë e komunitetit	199
Dallimet në kungim	199
Dallimet në të kuptuarit e personalitetit të Jezusit	199
Mosmarrëveshjet për qëllimin e ardhjes së Jezusit	199
b. Hebreo-krishterët apo ebionitët	199
c. Disa çështje të besimit të hebreo-krishterët	201
Udhëheqësia e komunitetit	201
Çështja apostull	201
Gjendja e Jezusit	201
KRISHTERIMI SOT	203
1. Pali	203
2. Zhvillimi i besimeve krishtere	204
3. Marsioni	205
4. Dhuna ndaj krishterimit	205
5. Konstantini dhe krishterimi si fe perandorake	206
6. Zënkat doktrimore për ekzistencën e Jezusit	207
7. Parimet e besimit në krishterim	208
a. Besimi tek Zoti	209
b. Jezusi dhe trupëzimi i tij (incarnatio)	209
c. Cilësitë e Jezusit	210
ç. Shpirti i Shenjtë	211
d. Triniteti	212
dh. Maria	212
e. Shpëtimi dhe udhëzimi	212
ë. Besimet e tjera	213
Bota e ardhshme	213
Engjëjt, satanët dhe xhinnët/demonët	213
Profetët dhe librat e shenjtë	214
8. Sacramentum-Misteret e kishës	214
a. Pagëzimi	214
b. Mirojsja	215
c. Martesa	215
ç. Misteri i priftërinjve	215
d. Pendimi	215
dh. Vajimi i shenjtë	215

e. Kungimi (eucharistia)	216
9. Adhurimet	216
a. Ceremonia e kungimit (missa)	216
b. Kryqi	216
c. Lutja e Zotit (Jezusit)	216
ç. Lutjet e tjera	217
10. Ditët e festave	217
a. Koha e krishtlindjes (Noel)	217
b. Periudha e pashkëve	217
c. Festimi i ditës së diel	218
11. Kisha dhe pjesët e saj	218
12. Hierarkia e kishës	219
Papati	220
13. Ndarja e kishës në katolike dhe ortodokse (great schisma)	220
14. Sundimi botëror i papatit dhe shkatërrimi politik	221
15. Fetarësia e popullit	222
16. Lufta me herezinë	223
17. Rrymat e kundërta	223
18. Lëvizja reformiste dhe Martin Luteri	225
a. Huldrih Zwingli	226
b. Johannes Calvin	227
19. Kishat e mëdha sot	227
a. Katolicizmi	227
b. Kisha protestante	228
c. Kisha ortodokse	229
Kishat kombëtare	232
1. Kisha siriane	232
a. Marrëdhëniet me komunitetet e tjera krishtere	232
b. Shkatërrimi i sirianitëve	233
c. Besimet dhe adhurimet e sirianitëve	233
2. Kisha armene	234
a. Zhvillimi i kishës armene	234
b. Armenët dhe muslimanët	235
c. Besimi dhe adhurimi	235
3. Kisha kopte në Egjipt	236
Gjendja sot	236
4. Kisha etiopiane	236
5. Nestorianët	237
Dobësimi i nestorianizmit	237
6. Maronitët	238
Fraksionet e pavarura kishtare	239
1. Baptistët	239
2. Protestantët e lirë	240
3. Metodistët	240
4. Vëllezërit e lirë (Freier Bruderkreis)	240
5. Mennonitët	241
6. Ushtria e shpëtimit (Salvation Army)	241
7. Kuakerët (Komuniteti i shokëve)	241
8. Komuniteti Pfingst (Unioni i komuniteteve krishtere)	242
9. Apostujt katolikë (Irvingianët)	243
10. Vëllazëria e mbretërisë së Jezu Krishtit	243
11. Adventistët	243

12. Komuniteti shkencë krishtere (Christian Science).....	244
13. Kisha e shtetit hyjnor	244
14. Mormonët	244
15. Swedenborgianët (Kisha e re)	244
16. Dëshmitarët e Jehovahit	245
17. Kisha e Zotit (Kisha e Armstrongut).....	245
18. Lëvizjet e kishave monoteiste (Kishat pa trinitet).....	245
a. Unitarianët	246
b. Lorberianët.....	246
c. Apostolizmi i Jezu Krishtit	247
19. Lëvizja mesianike në Afrikë	247
a. Kisha Baptiste Nazareth	247
b. Kisha Jezu Krishti	248
Fraksionet fetare-filozofike	249
1. Fraksioni theosophie.....	249
2. Anthroposophie.....	249
3. Fraksioni Rocy Cross.....	250
4. Spiraleja e gjithësisë.....	250
5. Spiritizmi	251
6. Ufologjia, fraksioni Anijet Kozmike	252
ISLAMI	254
1. Muhamedi (a.s.).....	254
2. Kur'ani i lartësuar.....	255
3. Kushtet e besimit	255
a. Besimi në Allahun e Gjithëfuqishëm	256
b. Melekët dhe krijesat metafizike.....	257
c. Besimi në librat e shpallura	258
ç. Besimi në pejgamberët	259
d. Besimi në botën e amshueshme (ahiret)	260
dh. Kader dhe kada	261
4. Qasje besimeve të feve tjera në Mehdiun dhe Mesihun	261
5. Doktrina e udhëzimit/shpëtimit.....	262
6. Feja dhe vullneti i lirë	263
7. Filozofia e natyrës.....	263
8. Adhurimet	264
a. Namazi	264
b. Agjërimi.....	264
c. Zeqati.....	264
ç. Haxhi.....	265
9. Parimet etike dhe juridike	265
10. Fraksionet (besimet) e ndara nga islami	265
a. Durzizmi.....	265
b. Kadianizmi	266
c. Bahaizmi	267
BIBLIOGRAFIA	268

DISA FJALË PËR AUTORIN

Ekrem Sarıkçıođlu ka lindur më 1943, në İsparta të Turqisë. Pas përfundimit të gjimnazit në vendlindje, është regjistruar dhe ka diplomuar në Fakultetin Teologjik në Universitetin e Ankarasë më 1966. Doktoraturën e ka kryer në Fakultetin e Letërsisë në Universitetin Nürnberg-Erlangen të Gjermanisë më 1971, në fushën e Historisë së Fëve si bursist i Ministrisë së Arsimit të Turqisë. Në vitin 1977 ka fituar titullin docent në Fakultetin Teologjik të Universitetit “Atatürk”, ndërsa titullin profesor e ka marrë në vitin 1983 në Fakultetin Teologjik të Universitetit “19 Mayıs”. Në vitet 1985-1994 ka qenë dekan i Fakultetit Teologjik të këtij Universiteti. Profesor Sarıkçıođlu prej vitit 1998 është pedagog në Fakultetin Teologjik të Univesitetit “Süleyman Demirel” në İsparta të Turqisë.

PARATHËNIE

Në botimin e parë të këtij libri i kemi përfshirë si fetë e vdekura, që një kohë kanë dhënë një dritë shprese për njerëzit por që sot nuk kanë simpatizues, ashtu dhe fetë që jetojnë, e që kahëzojnë jetën e miliona njerëzve. Ndërkaq këtu, nuk i kemi përmendur teoritë pozitiviste dhe filozofike, si çështja e gjenezës së feve dhe paraqitja e ndjenjës fetare, me të cilat janë marrë shkrimet para viteve 1930, për shkak të humbjes së aktualitetit. Spekulumet në lidhje me këto teori janë diskutuar afër dy shekuj me rradhë dhe nuk kanë arritur ndonjë zhvillim të duhur shkencor; nuk kanë mundur të kalojnë nga ajo që të jenë vetëm se spekulime antifetare. Fusha ku diskutohen këto çështje s'ka dyshim se është filozofia e fesë. Në botimin e dytë të këtij libri, nuk i kemi përmendur edhe disa teori të ndërlidhura me këtë temë, të cilat hasen në shumë libra të shkruara për historinë e feve.

Gjatë ligjërimit të historisë së feve, nga pyetjet e nxënësve dhe diskutimet me të cilat jemi ballafaquar, pamë se nuk janë të pakët ata që nuk e njohin sa duhet kohën dhe vendin ku kanë jetuar pejgamberët, emrat e të cilëve përmenden në Kur'an, dhe vërejtjen se në rrjedhën historike ata nuk janë ndërlidhur me temat e historisë së feve. Për ta mbushur këtë boshllëk u munduam që t'i përmendim pejgamberët për të cilët flitet në Kur'an brenda hapësirës gjeografike dhe kohës kur ata kanë jetuar. Për ta shkurtimisht diskutuam nën titullin "Shfaqja e monoteizmit".

Për të ndihmuar lexuesin që të krijojë lidhje mes temave për të cilat flitet dhe fesë së tij, herë pas herë kemi përmendur edhe disa mendime dhe sqarime islame.

Në kapitullin "Islami", i kemi përmendur temat e besimit dhe adhurimit në Islam, duke patur parasysh diskutimet mes muslimanëve dhe feve të tjera dhe ndikimet e tyre në ta. U munduam, që madje pak, të ndriçojmë zgjidhjen e disa problemeve në mendjet e muslimanëve.

E kemi zgjeruar përmbajtjen e disa pjesëve të atyre temave, për të cilat ka patur kërkesa nga disa studentë dhe kolegë të mi. Po ashtu, krahas fraksioneve të rëndësishme historike të feve që jetojnë edhe sot, i kemi përmendur edhe rrymat fetare dhe fraksionet aktuale, të cilat veprojnë me misione në Evropë dhe në Turqi. Kurse edhe atyre që u interesojnë fusnotat dhe literatura u munduam që t'ua tregojmë rrugën e burimeve për të fituar edhe më tepër njohuri për çështjet e diskutuara në këtë libër.

Në çdo pjesë kemi vendosur harta që tregojnë emrat historikë dhe gjeografikë të temës në fjalë.

Për përkthimin dhe kuptimin e ajeteve kuranore kemi përdorur përkthimin e Prof. Dr. Suleyman Ateşit me titull "*Kur'an-ı Kerim ve Yüce Meal*" (Kur'ani Qerimi dhe kuptimi i lartë i Tij).¹ Kështu që kuptimet i kemi huazuar drejtpërsëdrejti dhe nuk e kemi parë të nevojshme t'i përmendim përsëri në fusnotë.

Në këtë botim të tretë që ia ofrojmë lexuesit, krahas përmirësimit të gabimeve tekstuale që na janë përvjedhur më herët, pa mos ndier nevojë për një ndryshim rrënjësor në karakterin e përgjithshëm të librit, jemi munduar që me anë të disa shtojcave t'i qartësojmë ato pjesë që na janë dukur të mbyllura.

Pasi e pamë të nevojshme që temat e librave më të rëndësishme të historisë së feve duhet të jenë të shkruara nga ekspertë, në botimin e tretë, sabiizmin dhe maniheizmin, që janë *fe gnostike* dhe *ezoterike (batini)*, ia kemi lënë Prof. Dr. Şinasi Gündüzit, fusha studimi të të cilit edhe janë. Ne e falënderojmë profesorin për mjeshtërinë që tregoi në shkrimin e tyre. Me rastin e botimit të dytë, temën "*Feja e Egjiptit*" e ka shkruar e ndjera Doc. Dr. Mürüvvet Kurhan. Për përkujtim të M. Kurhanit, e cila u nda e re nga ne, edhe në botimin e tretë temën e shkruar prej saj e lamë në të njëjtin vend. E lusim Allahun që të na mëshirojë.

İsparta, 2000

Prof. Dr. Ekrem Sarıkoçlu

¹ Në përkthimin shqip të kësaj vepre kemi përdorur këtë tekst: Sherif Ahmeti, *Kur'an-i përkthim me komentim në gjubën shqipe*, botoi Mbreti Fehd Arabia Saudite, viti 1413 h. (Shënim i përkthyesit)

SHKENCA E HISTORISË SË FEVE

Shprehja historia e feve përbëhet prej dy fjalëve kyçe, histori dhe fe (fetë). Fjala histori rrjedh prej fjalës *historia* në greqisht dhe ka kuptimin *material konkret, njoburi*. Në gjuhën arabe përdoret fjala *tarib* (histori) e cila ka kuptimin *njoburi për muajin, njoburi për kalendarin*. *Res gestae* është fjalë latine, “res” gjë, kurse “restae” lëvizje, qëndrim. Ndërsa në gjermanisht fjala që ka kuptimin e historisë është *geschichte*. Kjo fjalë në vetvete ngërthen kuptimin e një ndodhie të vërtetë dhe nuk mund të quhet *story-tregim*.² Kurse fjala e dytë është feja (fetë). Fjala fe në gjuhët e sotme perëndimore shprehet me fjalën *religion*, e cila buron prej fjalës latine *religio* dhe ka kuptimin *bashkim, lidhje*. *Relegere* është një fjalë tjetër që përdoret për fenë dhe ka kuptimin e veprimt të një pune disa herë, bashkim, lidhje. Këtë shprehje e ka përdorur Ciceroni në *De Natura Deorum*. Edhe Lactantiusi në veprën e tij *Divana Institute* përmend shprehjen *religare*. Historiani Flavius Eutrapis është i pari që fjalën religion e ka përdorur me kuptimin *feja krishtere*. Në kuptimin e lartpërmendur gjithashtu është përdorur edhe fjala *religio*.³ Në aspektin etimologjik⁴ feja është një lidhje mes subjektit dhe objektit. Ndërkaq Rolston thotë se feja është bartëse e kuptimit perenial.⁵ Kurse në aspektin islam termi fe (*din*) është njëri prej termave thelbësorë të përmbajtjes së shpalljes hyjnore dhe traditës pejgamberiane. Feja është dhunti mbinatyrrore, pasi burimi i saj është Zoti; ajo është dhunti mirëdashëse, pasi buron prej dëshirës hyjnore; ajo është dhunti e vullnetit të lirë, pasi buron prej dashamirësisë së pastër hyjnore; ajo për njeriun është dhuratë hyjnore e jo borxh që duhet kthyer, pasi buron prej mëshirës së Zotit, e cila nuk jepet e matur, nuk jepet sipas meritës e as si një detyrim që duhet kthyer. Besimi (*Imani-Sophia perennis*)⁶ është drita e shpirtit hyjnor, kurse islami (*Religio perennis*) është ngrohtësia e asaj drite, që është shprehje e dëshirës mirëdashëse hyjnore.⁷

Kështu, historia e feve përveç që njihet me këtë emër, në literaturë njihet edhe me emra të tjerë⁸ si: shkenca fetare, fenomenologjia fetare, religjionet krahasimtare, historia e religjioneve krahasimtare. Por, kjo lëmi më së shumti njihet me emrin historia e feve, meqë në vete i ngërthen të gjitha metodat dhe mënyrat e studimit të të gjithë emërtimeve të përmendura më lart.

Historia e feve nuk përjashton asnjë cilësi themelore të fesë, sepse ajo më së miri mund të kuptohet prej studimit historik krahasimtar, që d.t.th., prej fenomenologjisë së bazuar në studimin historik-konstruktiv. Historia e feve, fenomenet të cilat vlerësohen si fetare, i studion në bazë të metodave studiuese të historisë së feve, pa marrë parasysh mendimin e njerëzve për to.

Disa dijetarë bashkëkohorë, me plotë të drejtë historinë e feve e përkufizojnë si histori krahasimtare të feve, meqë ajo nuk është thjesht vetëm një studim historik, por, në të njëjtën kohë është edhe studim krahasues. Ajo i studion proceset individuale të cilave u dihet e kaluara, por ka kujdes të veçantë në të kuptuarit e vërtetësisë së zhvillimit të këtyre proceseve në rrethin ku ato zhvillohen dhe analizën e të gjitha çështjeve me ndikim historik.⁹

² Ortaylı, İlber, Tarih Nedir?, *Türkiye Günlüğü*, Nr. 73, Ankara, 2003, f. 5.

³ Demirci, Kürşat, *Dinlerin Dejenerasyonu*, İnsan Yayınları, Stamboll, 1996, f. 9.

⁴ Özcan, Hanifi, *Epistemolojik Açıdan İman*, Stamboll, 1997, f. 18.

⁵ Yaran, Cafer Sadık, *Din ve Bilim*, Sidre, Samsun, 1997, f. 36.

⁶ Termi *Sophia perennis* që ka kuptimin e filozofisë pereniale në arabishte njihet me emrin *el-bikme el-balide*, kurse në persisht *javidan birad*. Për më gjërësisht shih, Kahteran, Nevad, *Perenijana filozofija (Sophia perennis) u misljenju Renë Guënona, Frithjofa Schouna i Seyyeda Hosseina Nasra*, el-Kalem, Sarajevo, 2002 f. 71.

⁷ Hafizović, Rešid, *Teološki traktati o načelima islamske vjere*, BEMUST, Zenicë, 1996, f. 9-14.

⁸ Kjo është rezultat i mospavarësimt të shkencave si shkenca fetare, fenomenologjia fetare, religjionet krahasimtare, historia e religjioneve krahasimtare. Kohën e fundit punohet në pavarësimin e të gjitha këtyre shkencave.

⁹ Bianchi, Ugo, *Dinler Taribi Araştırma Yöntemleri*, Kajseri, 1999, f. 3.

Sipas studimeve historike historia e feve është një disiplinë e cila, duke përdorur metodat historike dhe filologjike, studion lindjen, zhvillimin, ritet, etikën etj., të feve përgjatë historisë. Ndërsa sipas studimeve krahasimtare, historia e feve është degë e shkencës e cila krahason aspektet e përbashkëta, të ngjashme dhe të ndryshme mes feve.¹⁰

Historia e feve po ashtu është përkufizuar edhe si një komentim i tërësishëm e jo i pjesshëm i feve. Ajo thirret që të nxjerrë në pah dhe të studiojë çdo lloj ballafaqimi të njeriut me të shenjtën, prej parahistorisë e deri më sot. Por, për historianët e feve është një modesti apo një turp i madh, thotë M. Eliade, që të dyshojnë në vlerësimin e aspektit dhe vlerës kulturore të rezultateve të nxjerra nga studimet e bëra në këtë fushë. Për këtë, që nga Max Müller dhe Andrew Lang e deri te Frazes dhe Marett, si dhe nga Marett dhe Levy-Bruhl e deri më sot, vërejmë rënien graduale të krijimtarisë apo të aktualitetit të historisë së feve. Megjithatë, autori në fjalë thotë se, nuk është e pamundur që historia e feve të rikthehet përsëri në pozitën e saj qendrore, mirëpo për këtë historianët e feve duhet të besojnë në mundësitë e jashtëzakonshme në këtë drejtim dhe, gjithashtu, duhet të jenë të vetëdijshëm për madhështinë dhe peshën e fushës në fjalë.¹¹

Historia e feve studimit të çështjes i afrohet duke u nisur nga ngjarjet dhe hollësitë historike. Për këtë ajo në fillim nuk merret me problemet e përgjithshme të fesë¹², por, për të përkufizuar procesin historik në lidhje me ekzistencën e njeriut, merret me studimin e mjedisit, kohës, objekteve dhe ngjarjeve individuale. Prandaj historia e feve nuk duhet të ngatërrohet me historinë e një feje të caktuar, e cila merret vetëm me disa aspekte të një feje të vetme. Historia e fesë së caktuar është shumë larg interesimit për problemet universale historike dhe fenomenologjike të feve në përgjithësi, me të cilat merret historia e feve.

Kam bindjen se libri që e keni në dorë, të nderuar lexues, do t'ju mundësojë sado pak të njiheni me fetë e ndryshme në histori dhe sot, duke nisur nga fetë e zhdukura, fetë primitive e deri te fetë e mëdha monoteiste. Mendoj se ky libër përveç se për historinë e feve, do të ndihmojë edhe në shkencën e antropologjisë dhe në avancimin dhe mbarëvajtjen e dialogut që sot është një koncept dominant në shumë qendra të mëdha botërore shkencore. Gjithashtu do të kontribuojë jo në përplasjen e qytetërimeve, por, në njohjen dhe në afrimin e tyre. Një aspekt tjetër që edhe më tepër ia rrit vlerën këtij libri është ajo se ky është rezultat i një përvoje bukur të gjatë shkencore të profesorit tim të nderuar, Ekrem Sanlıoğlu.

Dr. Qani Nesimi

¹⁰ Tümer, Günay dhe Abdurrahman Küçük, *Dinler Tarihi*, Ankara, 1993, f. 10.

¹¹ Eliade, Mircea, *Dinin Anlam ve Sosyal Fonksiyonu*, Konja, 1995, f. 69-70.

¹² Nesimi, Qani, Paraqitja dhe zhvillimi i shkencës së Historisë së feve, *Përmbledhje punimesh*, Viti 1, Nr. 1, FSHI, Shkup, 2002, f. 37-42.

HYRJJE

Në të kaluarën por, edhe sot, edhe pse mund të haset në njerëz që nuk kanë pranuar ndonjë fe, nuk mund të haset edhe në shoqëri jofetare. Ky realitet na tregon se feja për njeriun dhe për shoqërinë është një nevojë natyrore. Ajo ka ekzistuar bashkë me njeriun dhe do të vazhdojë të ekzistojë bashkë me të edhe në të ardhmen. Për pasojë, njëra prej fushave shkencore që merret me studimin e këtyre feve, që janë pjesë e pandashme e njeriut, dhe me studimin e *përmbajtjes së tyre*, është historia e feve. Kjo shkencë dallon prej kelamit (apologjetika islame) dhe prej filozofisë së fesë, të cilat kanë për obligim mbrojtjen e një feje të caktuar, por nga ana e tjetër atyre ua mundëson arritjen deri te materialet e nevojshme. Kjo shkencë, duke i përdorur metodat historike dhe filologjike, hulumton fetë dhe besimet e shoqërive të vogla apo të mëdha, në shtete dhe popuj të ndryshëm.

Disa shkencëtarë gjatë këtyre hulumtimeve janë munduar që fetë t'i klasifikojnë dhe t'i grupëzojnë. Shkencëtarë të caktuar perëndimorë fetë i ndajnë në “fe që kanë themelues” dhe “fe tradicionale”, kurse disa të tjerë në “fe kombëtare-nacionale” dhe “fe universale”.¹³ Kurse dijetarët muslimanë fetë i ndajnë në dy grupe në “fe të vërteta” dhe “fe jo të vërteta”, apo në “fe që bazohen në shpallje” dhe “fe botërore-natyrore”. Në këtë klasifikim “fe të vërteta” quhen fetë të cilat besojnë në një Zot të Vetëm dhe që janë të bazuara në vlera etike, si në moral dhe në virtyt, kurse “fe jo të vërteta” konsiderohen ato fe që nuk i zotërojnë këto cilësi. Grupin e parë e kanë quajtur “*milel*”, kurse të dytin “*nibal*”. Shembulli më i mirë për këtë janë veprat *el-Milel ve'n-Nihal* të Shehristanit dhe të Bagdadit.

Përpjekjet për klasifikimin e feve, edhe pse përbëjnë studime shkencore me vlerë, deri më tash nuk kanë mundur të gjejnë një zgjidhje e cila në vete do t'i ngërthejë të gjitha fetë. Disa fe kanë mbetur jashtë, ndërsa disa të tjera nuk i janë përshtatur klasifikimit. Si pasojë, dijetarët nuk kanë gjetur një gjuhë të përbashkët për klasifikimin e tyre. Krahas kësaj, në për lehtësim dhe thjeshtësi në studim, do të mundohemi që fetë t'i shpjegojmë në bazë të rajoneve gjeografike dhe duke patur parasysh rrjedhën historike të tyre. Në për shkak që nuk kemi mundur të gjejmë ndonjë zgjidhje tjetër, do të ndjekim metodën që është më e parapëlqyer në kohën e sotme edhe pse ky klasifikim nuk na kënaq sa duhet!

Para se të kalojmë në shqyrtimin e temës, mendoj se do të jetë e nevojshme për gjeneratën e re të studiuesve përkujtimi i punimeve në lidhje me historinë e feve në botën islame, në Perëndim dhe në shtetin tonë (Turqi).

1. Historia e feve në botën islame

Në botën islame filozofia e fesë, tasavvufi dhe historia e feve janë studiuar si një tërësi. Kështu që, pjesa filozofike e shkencës së feve është hulumtuar si marifetullah (*teozofi*), kelam (*apologjetikë*) dhe tasavvuf (*mistikë*), kurse bashkë me ta ka filluar edhe studimi i feve jashtë islamit. Në periudhën abbasite, Ibn Mukaffa (723-759) i ka përkthyer në gjuhën arabe veprat mitologjike dhe fetare të Iranit të Vjetër. Gjatë kësaj kohe janë përkthyer edhe disa vepra mitologjike të feve induse. Janë bërë studime në lidhje me keldanitët dhe janë përkthyer në gjuhën arabe veprat si “*Kitab-u Medhabib ul-Keldanijjin fi'l-Asnam*”, “*Kitab-u Esrar ul-Kevakib*” dhe “*Kitab ul-Karabin*”. Said Fejumi, në vitin 330 hixhri, pasi që ka përkthyer në gjuhën arabe disa pjesë të Dhiatës së Vjetër, për to ka bërë edhe komentime dhe sqarime.

¹³ G. Mensching, *Die Religionen, Munchen*, pa vit botimi, f. 58-64; Mehmet Taplamcioğlu, *Din Sosyolojisi*, botimi 2, Ankara 1975, f.85-91; Mehmed Şemseddin, *Tarih-i Edyan*, Dersaadet 1338, f. 26-34.

Krahas librit të njohur hebraik, Talmudit, janë përkthyer edhe disa libra të së drejtës hebreje.¹⁴

Studimet për fraksionet krishtere dhe për sabiizmin, të filluara në kohët e më hershme, u zgjeruan dhe arritën deri te fetë e vjetra indiane, kineze dhe egjiptiane. Kur'ani është libri i parë që diskuton për fetë e tjera jashtë Islamit, por, nuk futet në detaje dhe mjaftohet vetëm me të përmendurit e shkurtër dhe simbolik të tyre. Me këtë Kur'ani ka hapur dyert që muslimanët të merren dhe t'i studiojnë fetë e tjera.

Faktikisht, për herë të parë historinë e feve e hasim në veprën “*el-Fark bejne'l-Firak*” të Ebu Mensur Bagdadit (vdiq 1037) dhe në veprën “*Kitabu'l Bed'I ve't-Tarib*” të Ebu Nasr Mutahhir ibn Tahir el-Makdisit (vdiq më 340 hixhri). Në të dytën jepen njohuri të rëndësishme për fetë kineze, indiane, tibetiane, iraniane, turke, hebraike, krishtere dhe sabiute. Po ashtu, në të njëjtin shekull, vepra në lidhje me milel dhe nihal shkruhen edhe nga Ebu Mudhaffer Tahir b. Muhammed Esfarani (vdiq 1078) dhe nga Kadi Ebu Bekr el-Bakilani (vdiq 1013).

Njëra prej veprave me rëndësi në shek. IV hixhri në lidhje me këtë çështje, është vepra “*Kitabu'l-Fasl fi'l-Milel ve'l-Ahvai ve'n-Nihal*” e autorit nga Kordova, Ebu Muhammed Ali b. Hazm (944-1064). Autori në fjalë, në dy vëllimet e para, është marrë me sofistët dhe fraksionet e ndryshme filozofike, me hebraizmin dhe me krishterimin. Gjithashtu është munduar të argumentojë deformimet në Tora dhe në Ungjill. Kurse në vëllimin e tretë dhe të katërt jep njohuri për fraksionet islame. Vetëm se kjo vepër në aspektin metodik në krahasim me veprën “*el-Milel ve'n-Nihal*” të Ebu'l-Feth Muhammed Shehristanit (vdiq 548 hixhri) është më e dobët. Shehristani ka shfrytëzuar veprën e Ebu Mansur Bagdadit dhe ka dhënë njohuri për fraksionet islame, hebraike dhe krishtere, si dhe për fetë indiane dhe për sabiizmin.¹⁵ Vetëm se nuk është e drejtë që në këto vepra të kërkohen metoda shkencore moderne. Vlera e tyre është në kontekst të burimeve historike. Ato paraqesin njohuritë e muslimanëve për fetë e tjera në momentin e takimit me to.

Për fat të keq, zhvillimi dhe puna shkencore në kohët e hershme të Islamit, me ndikimin e botës islame nga skolastika e Mesjetës, janë dobësuar dhe nuk janë zhvilluar më tej. Ngjashëm si në fetë e tjera, dera e studimit dhe e shkencës, të cilën e ka hapur Kur'ani, pas një periudhe është mbyllur.

2. Historia e feve në perëndim

Në shek. V para e.s. Herodoti, me një kujdes të veçantë është përqëndruar mbi fetë e popujve, të cilët i ka studiuar. Edhe shkrimtarët antikë, si Ciceroni, Salluste, Lucian dhe Plutarch kanë lënë shkrime për hyjnitë; sidomos kanë diskutuar për fetë romake dhe greke.

Në Mesjetë, perëndimorët, duke besuar se realitet i vetëm është vetëm krishterimi, nuk e kanë parë të nevojshme të merren me fetë e tjera. Kurse me paraqitjen e kolonializmit dhe misionerizmit aktiv, filloi edhe interesimi ndaj feve të tjera. Dijetarë të ndryshëm, si Lord Herbet de Charbury dhe Anthony Collius, punuan në klasifikimin e feve të ndryshme.

Zhvillimet në shkencat natyrore në periudhën e iluminizmit, sidomos, interesimi edhe për imtësitë më të vogla të qenieve të gjalla dhe jo të gjalla dhe sukcesi i arritur për strukturën themelore të tyre, e nxitën mendimin për punime të ngjashme edhe në shkencat fetare, për të kuptuarit e themeleve kryesore të feve dhe për hulumtimin e lindjes dhe zhvillimit të këtyre feve. Këto studime forcuuan bindjen se, elementet e besimit të parë dhe të pastërt, që janë ende të papërziera me kulturat dhe me besimet e tjera, mund të gjenden në Shoqëritë Primitive. Kështu, si fushë studimi u zgjodhën “shoqëritë primitive”. Disa njohuri të përfituara në këtë drejtim u dhanë shpresë disa shkencëtarëve hulumtues dhe e përshpejtuan punën e tyre në këtë drejtim.

Filloi hulumtimi i besimeve dhe i shoqërive primitive në vende të ndryshme të botës, si në pellgjet e Kongos dhe të Amazonës. Termat si: *totem, tabu, mana, shpirt, magji, shaman (medizienman)* etj., që janë rastisur në disa rajone, janë kuptuar si atomi dhe qeliza në shkencat natyrore dhe është përqëndruar me

¹⁴ Mahmud Esad es-Sejdishehri, *Tarih-i Edyan*, Stamboll 1912-1913, f. 2; M. Şemsuddin, *Tarih-i Edyan*, Dersaadet 1338, f.17.

¹⁵ M. Şemsuddin, f.18.

entuziazëm mbi ta. Ndërkaq, të gjitha këto studime nuk kanë mundur të shkojnë më larg, përveç kuptimit dhe komentimit më mirë të disa termave.

Kurse studimet moderne dhe krahasuese të fesë kanë filluar gati një shekull më parë me Max Müllerin. Müller i ka tubuar orientalistët perëndimorë dhe ua ka shpjeguar atyre rëndësinë e shkencës së fesë. Si punë e parë pas kësaj janë përkthyer librat e shenjta dhe i janë dhënë në dispozicion botës shkencore. Vepra *“Mitologjia krabasuese”* e Müllerit, është botuar më 1856, kurse këtë e pasojnë shënimet shkollorë për *“Parimet dhe zhvillimi i feve”*, botuar më 1870. Këto studime të para e nxitën dëshirën për hulumtimin e feve e tjera dhe ngjallën interesim të madh.

Shënimet shkollorë të viteve 1896-1898 të Tiele-së të botuara në Holandë me titullin *“Elements of the Science”* (Elementë të shkencës), janë një shembull i mirë për zhvillimin e historisë së feve. Çështjet që i ka zbuluar nuk janë të rëndësishme vetëm për historinë e feve, por, edhe për etnologjinë, sociologjinë dhe për psikologjinë. Pas një periudhe shumë të shkurtër në programet universitare të Parisit, Brukselit dhe të Romës filluan të shihen lëndët për historinë e feve. Veprat e botuara, si vepra *“Primitive Culture”* (1871) e Taylor-it, *“Les formes elementaires de la vie religieuse”* (1912) e Emile Durkheim-it dhe vepra *“Völkerpsychologie”* (1906) e Wilhelm Wundt-it, janë shembull konkret për zhvillimin e shkencave për fenë.

Në fazën e dytë të studimeve të historisë së feve, bashkë me mendimet pozitiviste, veten e treguan edhe filologjia dhe historia. Metoda e vlerësimit u zëvendësua me metodën e përshkrimit. Masat dhe vlerat filluan të shpjegohen në aspektin psikologjik, sociologjik dhe historik. Zhvillime të mëdha janë realizuar edhe në studimin e feve të së kaluarës dhe të kohës së sotme. U përsos profesionalizmi, kurse objektivizmi u qëllimizua si një ligj më i lartë. Gabimi i hulumtuesve të periudhës së parë ishte neglizhimi i imtësive, kurse gabimi i të dytëve ishte vlerësimi ekstrem i imtësive. Emri më i njohur i kësaj periudhe është Ernest Renan.

Lufta e parë botërore, edhe në fushën e historisë së feve nxorri në shesh ndryshme të mëdha. Sado që të jenë bërë studime filologjike, historike dhe kritike dhe sado që metoda pozitiviste të ketë vazhduar në shumë vende, periudha e historisë ka marrë fund. Historia e feve sot, që mund ta quajmë fazë të tretë të saj, ka për qëllim të dalë mbi profesionalizmin e rritur shumë, të ndikojë në thellësinë e praktikës fetare dhe të arrijë në specifikat metafizike. Si rezultat i këtyre zhvillimeve është mundësuar studimi fenomenologjik i fesë. Fenomenologjia fetare, e cila është e zhvilluar nga ana e Max Schelerit, Rudolf Ottosë, Jean Heringit dhe të Gerardus van der Leeuwit, ka hapur rrugën e studimit të të gjitha temave fetare në mënyrë objektive dhe sistematike, duke qëndruar larg teorive filozofike, teologjike, psikologjike dhe metafizike.¹⁶ Kështu ndikimi social i saj është reflektuar në *dialogun ndërjetar* dhe ka ndihmuar në fillimin e punëve shpresëdhënëse për paqe shoqërore.

¹⁶ Joachim Wach, *Vergleichende Religionsforschung*, Stuttgart, 1961.

3. Historia e feve në Shtetin Osman dhe në Turqi

Sikur që ishte traditë në botën islame, ashtu edhe në shtetin osman (Turqi), në librat historikë fillohej prej Hz. Ademit e deri në ngjarjet e kohës tonë. Këto histori të përgjithshme nuk kanë të bëjnë me *historinë e pejgamberëve* dhe, gjithashtu me historinë e feve, në kuptimin e sotëm të fjalës. Kjo gjendje ka vazhduar deri në shek. XIX. Në fund, në programin e Fakultetit të letërsisë të *daru'l-fununit*¹⁷ më 1874, vendoset lënda “*Tarih-i Umumi ve İlm-i Esatiri'l-Evvelin*” (Historia e përgjithshme dhe dituria e brezave të hershëm).

Pas Meshrutijetit të Dytë, në vendimin e marrur në tubimin e muderrisëve të Sher'ie-së dhe Ulum-i Edebiye-së (Fakulteti i drejtësisë dhe i letërsisë) më 1911, në mesin e lëndëve Ulum-i Sher'ie (Shkencat e drejtësisë islame) janë shënuar edhe lëndët “*Tarih-i Din-i Islam dhe Tarih-i Edyan*” (Historia e fesë islame dhe Historia e feve). Kurse në vitin 1914, u pa e arsyeshme që katedra Ulum-i Sher'ie të mos gjendet në daru'l-funun, lënda “*Tarih-i Edyan*” u gjend në Medreset'l-mutehassisin (Shkollë e ekspertëve), e cila ishte e ndërtuar në emër të Abdulhamidit I.

Mësimi fetar, pas formimit të Republikës Turke, iu la në disponim fakultetit teologjik në Stamboll. Këtu mësoheshin lëndët, si “*Historia e feve dhe e medbhebeve turke*” dhe “*Historia e feve*”. Por, edhe ky institut nuk jetoi gjatë pasi më 1936 u mbyll. Në Turqi, bashkë me mësimin fetar, në një periudhë të moszhvillimit hyri edhe historia e feve. Kjo situatë vazhdoi deri më 1949, me hapjen e fakultetit teologjik pranë universitetit të Ankarasë. Këtu në programin mësimor u vëndua edhe lënda e historisë së feve. Kësaj lënde iu dha vend edhe në programet e shkollave të mesme fetare, në institutet e larta

¹⁷ Shekulli XIX është periudha kur fillon kthimi në shkencë kah Perëndimi dhe fillojnë ndryshimet në arsim. Në shtetin osman që në fillim të këtij shekulli paralel me shkollat e quajtura medrese, janë hapur edhe shkolla të quajtura daru'l-funun (shtëpia e shkencave). Në vitin 1846 Meclisi Maarif-i Umumiye fillon aktivitetin e tij. Ky mexhlis hodhi hapin e parë në themelimin e daru'l-fununit. Edhe pse ende nuk ishte e qartë se çfarë sistemi do të ketë daru'l-fununi, qëllimi kryesor i ndërtimit dhe i aktivizimit të tij ishte përgatitja e kuadrit të përshatshëm për kryerjen e shërbimeve fetare. Daru'l-fununi më 21 qershor 1846 është definuar si më poshtë: “Daru'l-fununi është një organizatë që mundëson njohuritë e nevojshme për çdonjërin që dëshiron të përkryhet në marrjen e njohurive dhe me moral për mësimin e të gjitha diturive dhe shkencave ose që dëshiron të punojë në administratën shtetërore.”

Më vonë daru'l-fununi njihet me emrin *Daru'l-funun Osmani*, që në vete ngërthen tre fakultete: Hikmet ve Edebiyat (Fakulteti i filozofisë dhe i letërsisë), Ulumi Tabiiyye ve Riyaziyyat (Fakulteti i shkencave natyrore dhe i matematikës) dhe Hukuk (Fakulteti i drejtësisë). Ky shkollim do të zgjatë 3 vjet dhe një vit do të jetë për përgatitjen e tezës së diplomës. Nxënësit që do të vijin duhet të mos i kishin kaluar 16 vjet dhe të kenë të kryer shkollën idadi apo një shkollë të të njëjtit nivel. Por, ky planprogram, duke u nisur nga mungesa e profesorëve dhe problemeve të tjera, nuk arriti të realizohet tërësisht. Në programimin e kësaj shkolle ndër të tjera, duke u bazuar në modelin francez, kishte filozofi dhe letërsi. Aty përveç arabishtes dhe persishtes mësohej edhe frëngjishtja, greqishtja dhe latinishtja. Në fakultetin e drejtësisë, krahas drejtësisë islame, mësoheshin edhe drejtësia civile franceze, drejtësia romake dhe drejtësia ndërkombëtare. Në planin e daru'l-fununit ishte edhe ndërtimi i një muzeu, i një biblioteke dhe i një laboratorit. Daru'l-fununi osmani punën e vet, gjegjësisht, regjistrimin e nxënësve e filloi në nëntor 1869 me lejen e sultanit. Për përgatitjen e literaturës për zhvillimin e mësimin u formua një grup punues i quajtur *Enxhumen-i Danış*, që do t'i shkruante librat e nevojshme, dhe një grup tjetër punues që do të përkthejë librat shkencore nga gjuhët perëndimore. Ndërkaq hapja zyrtare e daru'l-fununit osmani u bë më 20 shkurt 1870, drejtor i të cilit u zgjodh Tahsin Efendiu, kurse pas tij ishte Kazim Efendiu. Daru'l-fununi osmani aktivitetin e tij e ka vazhduar deri më 1872-1873.

Administratorët dhe udhëheqësit e popullit ishin të mendimit se populli ka nevojë për një universitet në modelin evropian, prandaj në vitin 1874-1875 u hap *Daru'l-funun Sultani*. Në këtë shkollë arsimimi zgjat 4 vjet dhe në fund përfundon me tezë, kurse ai që e përfundon me sukses do të marr titullin “doktor”. Ata që nuk do të kenë mundësi të përgatitjen tezë do të kenë provime më të lehta dhe nuk do të quhen doktor. Dy daru'l-funun të mëparshëm financoheshin prej pagesave të studentëve dhe prej ndihmave të organizatave (vakëfeve) dhe të shtetit. Kurse Daru'l-funun Sultani harxhimet i mbulonte nga të ardhurat e Galata Sarayı Mekteb-i Sultani, sa që në këtë kohë ka patur studentë që kanë studiuar me bursë, në mesin e të cilëve ka patur edhe ithtarë të librit (të krishterë dhe hebrejë).

Pas mbylljes së daru'l-fununit osmani, Sadrazam Küçük Said Pasha, më 2 shkurt 1310 (12 shkurt 1895) Sulltan Abdulhamidit II i paraqet dëshirën për formimin e një darulfununi që do të funksionojë sipas universiteteve evropiane dhe amerikane. Ai do të përbëhet prej pesë fakulteteve: letërsi dhe filozofi, natyrë dhe matematikë, shkencat fetare, kurse më vonë do të startojnë edhe drejtësia dhe mjekësia. Ky darulfunun do të quhet *Daru'l-funun-i Shabane* dhe do të përbëjë bazën elementare të universiteteve të sotme turke. Kah fillimi i shek. XX kjo shkollë e mori emrin *Istanbul Daru'l-funun* (Daru'l-fununi i Stambollit) dhe në kuadër të fakultetit të mjekësisë u shtuan edhe fakulteti i stomatologjisë dhe i farmacisë. Më 1919 Darulfununi i Stambollit u quajt *Daru'l-fununi osman*, fakultetet filluan të quhen *medrese*, kurse ligjëruesit *muderrisë*.

Udhëheqës kryesor do të jetë *emini* (rektori), kurse fakultetet do të udhëhiqen nga *reisët* (dekanët), të cilët përbënin edhe *divanin* (senatin) e daru'l-fununit. Rregulli i studimit në këto shkolla ka qenë semestral (devri dersiyë). Në vitin 1933 me vendim të Parlamentit të Madh Popullor Turk, daru'l-fununi i Stambollit shndërrohet në *Universiteti i Stambollit*. (Shih, Ekmeleddin İhsanoğlu, Darulfunun, *İslam Ansiklopedisi*, v. 8, TDV, Stamboll, 1993, f. 521-525). (Shënim i përkthyesit).

islame dhe në fakultetet teologjike, të hapura më vonë.¹⁸

4. Veprat e historisë së feve në shtetin Osman dhe në Turqi

Vepra më e vjetër në fushën e historisë së feve e shkruar në kohën e shtetit Osman është vepra “*Esatir*”¹⁹ e Şemsuddin Sami (Frashëri), e botuar më 1878. Në këtë libër bëjnë pjesë legjendat japoneze, skandinave, amerikane dhe legjendat e vjetra europiane. Vepra, edhe pse merret me mitologji, për shkak të afërsisë me historinë e feve, ia vlen që të përmendet këtu. Kurse vepra e parë e cila në mënyrë direkte do të merret me historinë e feve, është “*Tarih-i Edyan*”-i i Ahmed Mithat Efendiut, botuar më 1911. Kjo vepër përfshin fetë kineze, japoneze dhe induse. Kurse vepra “*Tarih-i Edyan*” e Mahmud Esat b. Emin Sajdishehriut, që ishte e botuar në vitet 1912-1915, ishte hyrje në historinë e feve. Ajo flet për teoritë për lindjen e feve dhe për fetë primitive. Ndërkaq, “*Tarih-i Edyan*”-i i M. Şemsuddin-it, i botuar më 1919, është e përqendruar mbi fetë primitive. Shkurtimisht bën fjalë edhe për fetë japoneze dhe kineze. Vepra “*Dinler Taribi*” e Hilmi Ömer-it (Budda), e botuar në Stamboll më 1935, është një vepër me vlerë që tregon për fetë indiane dhe kineze. Kjo vepër është e patejkalueshme në aspektin e përmbajtjes së gjerë të saj. Edhe pse është planifikuar botimi i vëllimit të dytë i veprës, kuptohet se nuk ka patur mundësi të realizohet. Vepra shkencore e cila do të përfshijë të gjitha fetë kryesore në histori është vepra “*Yer Yüzjindeki Dinler*” e autorit Ömer Rıza Doğrul, botuar më 1949. Kjo vepër ka vlerë të veçantë posaçërisht nga aspekti i kapshmërisë së saj për masën më të gjërë popullore.

Paralel me zhvillimin e jetës fetare dhe të nevojës për mësim fetar, janë bërë zhvillime dhe është vërejtur rritje edhe në studimin dhe në publikimin e arritur në fushën e historisë së feve. Punim më me rëndësi që mund të gjendet edhe sot në shitje, në mesin e punimeve dhe librave shkollorë dhe doracakëve është vepra “*Dinler Taribi*” (Ankara 1993, 472 faqe), e përgatitur nga të ndjerit Günay Tümer dhe Abdurrahman Küçük. Kjo vepër, duke u marrë me fraksionet e feve historike, me rrymat e reja fetare, si mesianët dhe sintetikët, dhe duke i prekur çështjet ndërfetare, si misionerizmi dhe dialogu ndërfeetar, ka ndihmuar në aktualizimin e historisë së feve. Gjithashtu edhe vepra “*Din Fenomeni*” (Konya 1993) e Mehmet Aydın-it, me kushtimin e kujdesit që çdokush fenë ta mësojë nga gjuha e simpatizuesve të tij, është një qasje e re për vendin tonë nga aspekti metodik.

Përveç këtyre, në vendin tonë (në Turqi), shtimi i numrit të përkthimeve dhe i shkrimeve të përgatitura për t’ia shpjeguar çdo besimtar dhe adhuruesi të fesë apo të fraksionit që i takon, për çdo ditë është në rritje dhe kështu i ndihmon punimet e bëra në shkencat fetare.

¹⁸ Shih, Hikmet Tanyu, *Türkiye’de Dinler Taribinin Tarihçesi*, İlahiyat Fakültesi Dergisi, Ankara 1961, f.109 dhe në vazhdim.

¹⁹ Vepra “*Esatir*” e Sami Frashërit është përkthyer në shqip si “*Mitologjitë*” nga ana Mehdi Polisit dhe është e botuar nga ShB Logos-A në Shkup, viti 2004. (Shënim i përkthyesit).

FETË PARAHISTORIKE NË AZINË E MESME

Literatura: Carl Klemen, *Die Religionen der Erde, V.I, München 1966, f.7-41*; Firużan Kmal, *Eski Anadolu Tarihi, Ankara 1962, f.32-52*; Sedat Veyis Örneke, *100 Soruda İlkellerde, Din, Biyyü, Sanat, Efsane, Stamboll 1971*.

Nëse dëshirojmë që të studiojmë historinë e feve prej fillimit të fesë, menjëherë në mendje na vjen pyetja se kur ka lindur feja. Nuk është shumë lehtë që kësaj pyetjeje t'i jepet një përgjigje pozitive, sepse, në skenën historike, bashkë me njeriun që mendon, ka dalur edhe feja. Vetëm se, në histori njerëzit në përgjithësi kanë qenë të shqetësuar për çështjen e asaj se ku dhe kur njeriu që mendon është paraqitur në këtë botë. Edhe shkencat e sotme të historisë natyrore, të antropologjisë dhe të arkeologjisë interesohen për së afërmi me këtë çështje dhe punojnë në vlerësimin dhe komentimin e të dhënave shkencore. Kur'ani për nxitje në kërë drejtim thotë:

“Thuaj: udhëtoni nëpër tokë e shikoni se si filloi krijimi, pastaj Allahu e fillon krijesën tjetër (ringjalljen). Është e vërtetë se Allahu ka mundësi për çdo gjë”. (Ankebut, 20)

Historianët e natyrës jetën e gjallesave të ngjashme me njeriun më të vjetër, të llogaritur sipas kaliumit (*potassium*) radioaktiv²⁰, i cili përfshin shembujt fosilë, e çojnë deri më 1,5-2 milionë vjet përpara dhe për të bëjnë komentime të ndryshme. Këta shembuj fosilë, të cilat përfaqësojnë llojet paleolitike, janë zhdukur në errësirën historike, kështu që gjeneza e tyre nuk ka mundur të vazhdojë.²¹

Shkencëtarët, paraardhësit e njeriut të sotëm i mbështesin në origjinën e quajtur „Homo Sapiens Sapiens“. Mosha e shembujve fosilë llogaritet sipas përmbajtjes së florit të tubuar në dhëmbët e mbetur nën tokë²². Këta janë paraardhësit e njeriut të sotëm në ngjyra të ndryshme, të gjetura që në periudhën e katërt të akullnajeve, gjegjësisht përpara 40 mijë vjetëve. Mendohet se këta njerëz janë themeluesit e qytetërimit, bujqësisë, blegtorisë dhe zbuluesit e mjeteve të ndryshme²³. Shkencëtarët gjenetikë, në supozimet dhe llogaritë e tyre vërtetojnë tezat e antropologëve. Deri te ky përfundim arrihet me anë të llogaritjes së ndryshimeve gjenetike në njeriun²⁴. Ata janë të mendimit se, njerëzimi i parë është përhapur prej Afrikës Lindore (Sudani-Etiopia). Edhe në transmetimet për Ademin dhe Havvanë, lidhshmëria e tyre me përafërsisht të njëjtin rajon është domethënëse.

1. Ademi dhe Hava

Në Dhaitën e Vjetër dhe Kur'an ka dallime të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Në Kur'an nuk është e qartë se urdhëri për krijim është në fillim, në mes apo në fund të krijimit. Sipas Dhaitës së Vjetër në fillim nuk ka patur asgjë, ka sunduar një zbrazëti, një kaos dhe një errësirë. Zoti në fillim krijoi dritën dhe e ndau nga errësira. Kështu u bënë dita dhe nata. Kjo ndodhi në ditën e parë të fillimit të aksionit të krijimit, vetëm se Dielli dhe Hëna ende nuk ishin të krijuara. Kështu që në këtë rast pyetja se si u formua dita dhe nata mbetet pa përgjigje. Në ditën e dytë u krijua qielli, në ditën e tretë lagështia dhe thatësira. Toka dhe deti u ndanë nga njëra tjetra. Vetëm se për t'u ndarë këto duhej që të ishin krijuar

²⁰ Ayşe Başaran, *Tıbbi Biyoloji*, Botim 4., botoi Bilim Teknik, 1996, f. 402.

²¹ Ali Demirsoy, *Kalıtım ve Evrim*, Ankara 1984, f. 750-765.

²² Başaran, f.406.

²³ Demirsoy, f.766-781.

²⁴ Robert F. Weaver-Philip W. Hedrick, *Genetics*, Iowa 1989, f.526 dhe në vazhdim; Cecie Starr-Ralph Taggar, *Biology, the Unity and Diversity of Life*, California 1989, Botim 5., f. 702 dhe në vazhdim.

më herët! Më vonë u përcaktuan edhe bimët. Ditën e katërt u krijuan Dielli, Hëna dhe yjet. Ditën e pestë u krijuan gjallesat që jetojnë në ujë dhe ajër dhe shpezët me fletë. Ditën e gjashtë Zoti e krijoi “*Ademin me fytyrë të Tij*”. Dhe ditën e shtatë Zoti pushoi (*Zanafilla*, I:1-26). Këto gjëra në Kur’an nuk janë fare. Sipas Kur’anit, Allahu nuk lodhet dhe nuk ka nevojë për pushim. Vetëm se, edhe Kur’ani thotë se krijimi është bërë në gjashtë periudha. Këtu bëhet e qartë se kur Allahu dëshiron që diçka të ndodhë, mjafton që të thotë vetëm “bëhu”. Edhe pse këto dy shprehje në fillim mund të shihen si të kundërta, fjalia “thotë bëhu dhe ajo bëhet”, tregon fuqinë e Allahut, kurse togfjalëshi “gjashtë periudha”, tregon se si në të kaluarën është krijuar bota. Fjala “*jevm*”, që ka kuptimin edhe periudhë, në Kur’an ka kuptime të ndryshme. Në disa ajete ka kuptimin 12 orë, gjegjësisht dita dhe nata, apo një ditë-natë 24 orëshe. Gjithashtu te Allahu “*jevm*” përkon me një vit botëror. Në një ajet tjetër si e kundërt e “*jevmil*” paraqiten 50 mijë vite. Nga këto kuptohet se kuptimi i fjalës “*jevm*” nuk mund të limitizohet me një botë njerëzore, vetëm se mund të kuptohet se bota është e krijuar në gjashtë periudha. Dhaita e Vjetër për krijimin e njeriut thotë: “*Zoti Ademin e krijoi në pamje të Vel*”. Në Kur’an një shprehje e tillë nuk gjendet. Kur’ani me ajetin “*Nuk ka asgjë të ngjashme me Të*” (Shura, 11), e mohon mendimin se Ademi dhe Bijtë e tij janë krijuar me pamje të Zotit. Vetëm se për shkak të transmetimit të një hadithi paralel me versetin e Dhaitës së Vjetër, kjo shprehje e Dhaitës së Vjetër nga ana e muslimanëve është e komentuar në mënyrë që është e krijuar në cilësinë e Zotit, si të pamurit, të dëgjuarit etj. Në të gjendet lajmi se “*Ademi bëngri nga pema e ndaluar*” (A’raf, 22), sipas të cilit duhet që drunjtë dhe bimët të jenë krijuar para Ademit. Gjithashtu shprehjet “*...hani nga të doni dhe mos ju afroni kësaj peme (shexhere)*” (A’raf, 19; Bakara, 36), tregojnë ekzistencën e drurit dhe dheut, ku edhe është rritur druri. Më pastaj nga shprehjet se njeriu është krijuar prej një pikë uji (*nutfeten*) (Haxhah, 5), nxirret përfundimi se Kur’ani njofton për disa faza të krijimit, e jo për historinë biologjike të njeriut. Këto sikur nuk janë pengesë për krijimin e Ademit nga ana e Allahut për një moment, ashtu nuk janë pengesë edhe për mundësinë e krijimit të tij në faza. Kurse ajetet e mëposhtme e forcojnë kuptimin se njeriu i parë ka mundësi të jetë krijuar fazë fazë. Edhe pse nuk dihen imtësitë, lidhjet mes disa ajeteve kur’anore dhe zbulimeve të shkencëtarëve dhe historianëve natyrorë janë për t’u habitur. S’ka dyshim se parimet shkencore në të ardhmen do të shndërritin edhe më tepër këtë çështje:

“...*krijimin e njeriut e filloi nga balta.*” (Sexhde, 7)

“*Dhe Allahu u shpiku juve prej tokës si bimë.*” (Nuh, 17)

“*Vërtet ka kaluar një periudhë kobore, që njeriu nuk ekzistonte fare si një diçka e përmendur.*” (Insan, 1). (Pra, në krijimin e njeriut kanë kaluar aq periudha të gjata sa që ende nuk janë përmendur. Dhe kështu ai duke u filtruar nëpër faza të ndryshme, ka kaluar një kohë e gjatë deri sa ka marrë formën e spermës).²⁵

“*Kur Ai ju krijoi në disa etapa*” (Nuh, 14; më gjërësisht shih, Süleyman Ateş, *Kur’an-i Kerim ve Yüce Meali*, Ankara, f. 570)

“*Mandej, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) dhe nga ana e vet i jep shpirt atij...*” (Sexhde, 9)

“*Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët.*” (Sexhde, 8)

“*Prej asaj (tokës) Ne u krijuam ju, e ju do t’ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t’ju nxjerrim edhe një herë.*” (Taha, 55; Shih, S. Ateş, vep. e cit., f. 314)

“*Ju patjetër do të përjetoni gjendje pas gjendjeje.*” (Inshikak, 19 ; Shih, S. Ateş, vep. e cit., f. 589)

Në komentimin e ajeteve të lartpërmendura shkrimtarët e traktateve Ihvan us-Safa, dhe dijetarët islamë, si Ibn Miskevejh, thonë se njeriu është krijuar në proces (me evoluim), por nuk e kanë bazuar në ndonjë themel shkencor.²⁶ Edhe Süleyman Ateş, njëri nga mufesirët e sotëm, nga shprehja “*kur*” (kohë, periudhë, fazë) që përmendet në Kur’an: “*E kur ta përsos atë (në formën e njeriut) dhe t’i jap atij shpirtin që është krijesë Imja, atëherë ju bini atij në sexhdë*” (Hixhr, 29), arrin përfundimin se Ademi është krijuar në një proces kohor. Për fetë, me rëndësi është pranimi nga ana e besimtarëve i krijimit si vepër e Allahut. Sot shkencat natyrore për së afërmi merren me atë se si është realizuar krijimi, me imtësitë themelore dhe me studimet dhe komentimet shkencore për të.

Sipas mendimit gjeneral të feve, si islami, krishterimi dhe hebraizmi, fe të cilat Islami i quan “*Ehl el-kekitab*” (i thhtarë të librave), njeriu i parë, gjegjësisht babai i parë i njerëzimit është Ademi. Allahu, pasi që

²⁵ Kur’ani, Insan, 1; Süleyman Ateş, *Kur’an-i Kerim ve Yüce Meali*, Ankara, f. 577.

²⁶ Muhammed Hamidullah, *Dinler Taribi Konferanslar*, 3 Prill, Erzurum 1977.

tokën e bëri të përshtatshme për jetesë, Ademën dhe bashkëshorten e tij i zbriti në të.²⁷ Është ende vështirë që, në dritën e diturive të sotme tradicionale, të caktohet historia dhe esenca e kësaj zbritjeje. Disa dijetarë muslimanë, shprehjet kur'anore në ajetin 58 të sures Merjem, “*Këta (të përmëndur) ishin që Allahu i gradoi nga pejgamberët pasardhës të Ademit, prej pasardhësve të atyre që i patëm bartur (në anije) bashkë me Nuhun, prej pasardhësve të Ibrahimit dhe të Jakubit (Israilët), dhe prej atyre që i udhëzuan dhe i bëmë të zgjedhur...*”²⁸, i komentojnë si argumente tradicionale për atë se të gjithë pejgamberët rrjedhin prej Ademit, si dhe duke pranuar se mund të ketë edhe njerëz që rrjedhin prej një burimi tjetër përveç Ademit, dhe se Allahu para Ademit ka krijuar edhe njerëz të tjerë.²⁹ Gjithashtu fjala *adem* në Kur’an, në disa ajete ka kuptimin e Ademit (a.s.), emër i përveçëm, kurse në disa raste ka kuptimin njeri, emër lloji. Edhe ky fakt ua ka tërhequr vëmendjen komentatorëve dhe mendimtarëve të ndryshëm. Pa dyshim se me zhvillimin e hulumtimeve shkencore, në të ardhmen çështja do të qartësohet edhe më tepër.

Në Dhaitën e Vjetër gruaja e parë, e cila është dhe emri i gruas së Adamit, është “Eva”. Ndërkaq në Kur’an emri i saj nuk përmendet. Transmetohet se ky çift, për shkak të nëpërkëmbjes së urdhërit të Zotit, është nxjerrur prej xhenneti: “...Zbritni (*dilni*), jeni armik i njëri tjetrit, e ju deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëjrim.” (Bakara, 36; A’raf, 24). Diskutimet për xhennetin, që do të thotë kopsht, nga i cili u nxorën si dënim, se gjendet në këtë botë apo jashta kësaj bote vazhdojnë.

Kur’ani Kerimi për jetën e kësaj bote të Ademit, gjegjësisht për jetën e tij jashtë xhennetit nuk diskuton. Vetëm se tregon se atij më herët “i janë mësuar të gjitha emrat”³⁰, nga e cila kuptohet se Ademi ka poseduar dituri për natyrën dhe për gjërat e tjera. Dhaita e Vjetër tregon se nga djemtë e Adamit, Kaini është marrë me bujqësi, kurse Abeli me blegtori, dhe gjithashtu tregon për mosmarrëveshjen mes tyre.³¹ Ndërkaq, Kur’ani duke mospërmendur emër simbolizon në xhelozinë, në zënkën dhe në ngjarjen e vrasjes mes këtyre dy vëllezërve.³² Këto transmetime ka mundësi që të vlerësohen në aspektin e simbolizimit në periudhat e mundshme të kohës kur ka jetuar pejgamberi Adem. Mund të llogariten si argumente për periudhën e marrjes së njerëzimit me bujqësi dhe blegtori. Mund të datëzohen edhe me zbulimet e njohura të arkeologjisë së sotme. Në Kur’an nuk bëhet fjalë për “Shit”-in, njëri nga bijtë e Ademit. Sqarimet e komentatorëve në lidhje me këtë çështje, bazohen plotësisht në lajmet e Dhaitës së Vjetër dhe të Talmudit.³³

Ndërkaq mendimet e feve të tjera për njeriun e parë dallojnë sipas strukturës së asaj feje. Ata mendimet e tyre i mbështesin në një krijues legjendar. Mendimi se njeriu është krijuar prej një krijuesi dhe se i tërë njerëzimi burojnë nga ai, është një besim i përhapur dhe i përbashkët mes feve. Për shembull, në Greqinë e Vjetër Zeusi ka krijuar “*Pandora-n*”, kurse te turqit e vjetër Karahani ka krijuar “*individin*”.³⁴

2. Zbulimet historike dhe komentimet e tyre

Përgjigjja e pyetjeve për besimet e shoqërive që kanë jetuar në periudhën historike pashkrim, mundohet të gjendet me zbulimet arkeologjike të mbetura prej kohëve më të hershme, dhe me komentimin dhe krahasimin e këtyre zbulimeve me traditat dhe besimin e shoqërive primitive që jetojnë sot.

Në rajone të ndryshme janë gjetur eshtra dhe skelete njerëzish, të mbetura nga periudha

²⁷ Kur’ani, Nisa, 1; A’raf, 24.

²⁸ Shih, Kur’ani, A’raf, 2.

²⁹ Amiran Kurtkan, *Sosyologjik Açıdan Tasavvuf ve Laiklik*, Kutsun Yayınları, Stamboll 1977, f. 69-77.

³⁰ Kur’ani, Bakara, 31, 33.

³¹ *Zanafilla*, IV, 2-4.

³² Kur’ani, Maide, 27-31.

³³ *Zanafilla*, IV, 1-26; *The Talmud*, H. Polano, London and New York 1978, 372 faqe, f.15-22.

³⁴ Shih Mustafa Erdem, *Hız. Adem*, Ankara 1993, f. 1-12.

parahistorike, të mbuluara me gurë. Disa nga këto mendohet të jenë varrosur në formë embrionale dhe shihet se i ngjajnë mënyrës së varrimit të popujve primitivë. Disa gropa, ku gjenden këto skelete, janë të kuqe, si varrezat në Van Tilki Tepe; mbi ata trupa është derdhur një lëng i kuq, apo bakër i kuq dioksid. Mbeturinat e këtyre materieve të kuqe mbi eshtra pas varrimit, janë argumente të qarta që tregojnë se kufoma është varrosur në mënyrë të posaçme. Shihet se, kafkat e mbetura prej periudhës mezolite dhe neolite (periudha e mesme dhe e re e gurit) janë të kthyer drejt perëndimit. Në periudhat e mëvonshme shihet se, sikur trupi shpirtit, nga i cili është ndarë, i tregon rrugën e botës së të vdekurve, për të cilën supozohet se gjendet në vendin ku perëndon dielli. Gjithashtu edhe tradita e djegies së të vdekurve që shihet në periudhën e gurit, e cila ka qenë e përhapur edhe në periudhën e bronzit, duhet të ketë lidhje me një besim se ekziston një shpirt i cili nuk është i lidhur me trupin dhe i cili jeton edhe pas vdekjes së trupit. Tradita e shtypjes me gurë të trupave të vdekur, lidhja e fortë e trupave embrionalë, futja e tyre nëpër gypa ose të thyerit apo prerja e disa organeve të tyre, në kohën e bronzit, janë argumente të qarta që tregojnë frikën prej të vdekurve. Tradita të këtij lloji të disa fise primitive shihen edhe sot. Ka mundësi që njerëzit të ishin frikësuar dhe të kishin ikur nga të vdekurit, për shkak të konceptit se ata kanë të bëjnë me sëmundje dhe fuqi mbinatyrore, por nuk posedojmë argumente të mjaftueshme për këtë. Veprimet, si lidhja dhe sakatimi i të vdekurve, janë pamje të qarta të frikës nga të vdekurit dhe të synimeve për të qenë të sigurt nga e keqja që mund të vijë prej tyre.

Sikur që shihet edhe te disa fise primitive, ngjyrosja e trupave me të kuqe mund të jetë për shkak të vullnetit për vazhdimin e shoqërimin me të vdekurit dhe për shfrytëzimin e fuqive mbinjerëzore. Ngjyra e kuqe me siguri që simbolizon gjakun. Atëherë gjaku llogaritet një lëng, që në vetvete përmban një fuqi speciale dhe besohet se kjo forcë jetike mund t'u ndihmojë të vdekurve. Disa tradita nga periudha e gurit, tregojnë se punohet për shfrytëzimin e forcës së parafytyruar speciale të të vdekurve, si për shembull, për mbrojtjen e eshtrave të nofullës së poshtme të ngjyrosur me të kuqe etj. Madje për bartjen e forcës të bartësi, ka mundësi që ta kishte bartur njeriu i periudhës parahistorike. Mundet që atë ta kishte pranuar si një amulet (nuska), e cila jep forcë. Ndërsa nuk ka të bëjë me mençurinë e pronarit të skeletit.

Në varrimin e të vdekurit, bashkë me të varrosen edhe mjetet që i ka bartur në jetë dhe disa stoli të tij. Këto mund të jenë nuska të mbushura përplot me forcë mistere, të cilat zotërisë i japin nder dhe e mbrojnë nga fatkeqësitë. Ato në fillim janë përdorur vetëm si stoli, kurse më vonë iu është mveshur fuqi mbinatyrore. Në varrezat e periudhës së gurit është rastisur në dhëmbë kafshësh dhe në gurëz të çmuar. Ndërkaq ari fillon të dalë në periudhën neolite (koha e re e gurit). Në periudhën e bronzit, minerale, bimë dhe kafshë të shenjta, të futura nëpër gypa bronzit dhe në torba lëkure, janë vendosur afër të vdekurve. Me siguri, i vdekuri deri sa ka qenë gjallë i ka bartur ato dhe i ka përdorur. Në periudhën e gurit dhe bronzit shihet se afër të vdekurit janë vendosur statuja dhe sëpata të vogla prej guri ose bronzit, të cilat nuk kanë patur asnjë vlerë në jetën e përditshme. Ka mundësi që këto të jenë prej llojeve të nuskave dhe gjëra të fuqisë magjike të cilave u besohet.

Kurse përdorimi i dheut përpara varrezave tregon mundësinë se më vonë të vdekurit janë shenjtëruar në forma të ndryshme dhe janë respektuar, ose ka mundësi që në krye të varrit të ishte bërë ceremoni fetare.

Në disa shpella, që datojnë prej fundit të Periudhës së Gurit, është hasur në relieve (skulptura), që tregojnë skenat e gjuetisë. Këto, me siguri, më tepër janë magji kafshësh, të cilat janë menduar t'i gjuajnë, se sa thjeshtë stoli. Gjithashtu ekzistenca e relieveve, të ngjashme me diellin dhe hënën, formon bindjen se dielli dhe hëna janë respektuar dhe adhuruar. Hasja e shpeshtë, që në Periudhën e Bronzitet, e formave që përfaqësojnë diellin, përforcojnë mendimin se edhe më herët ka ekzistuar adhurimi i tij. Vetëm se nuk posedohen njohuri definitive për besimin e njeriut parahistorik në hyjnitetin e pikturave të njeriut. Në realitet nga disa varreza janë nxjerrur figura të vogla njerëzish. Vetëm se është shumë vështirë që të vërtetohet se ato janë apo nuk janë adhuruar si zota. Ka mundësi që edhe vetë i vdekuri (duke qenë gjallë) ta ketë vizatuar veten e vet. Ajo që shumica e figurave të gjetura janë gra, dhe pjesa e kraharorit dhe e barkut paraqiten të stërzmadhuara në mënyrë të jashtëzakonshme, forcon mundësinë e të menduarit se ato janë krijesa të shenjtëruara. Këto figura, të quajtura idhuj, dhe statujat e thjeshta, është e mundur që të ishin përdorur edhe si magji apo si sakrificë, të cilat janë përdorur me qëllim të shpëtimit nga ndonjë sëmundje apo fatkeqësi. Figurat e grave të nxjerrura nga gërmimet e bëra në rajonin Burdur Hacilar dhe në Konya Çatal Hoyuk, janë shembuj objektivë që tregojnë për adhurimin e "Nënës së madhe", në Periudhën e vonshme paleolite dhe neolite. Një skulpturë kryesore (nënë), e cila i

jep gji fëmijës së saj, i takon Priudhës së Bronzit dhe është gjetur në Tokat Horoz Tepe. Ajo gjithashtu paraqet vazhdimësinë e kultit të Nënës së madhe (hyjneshë kryesore), e cila në periudhën kalkolite përfaqësohet me idhuj. Edhe skulpturat e drrerit dhe të kaut (mëzatis) në Çorum Alaca Hoyuk dhe në Tokat Horoz Tepe, tregojnë për besimin në disa kafshë të shenjta dhe për adhurimin e tyre. Vetëm se, ne, për shkak të njohurive të pamjaftueshme nuk mund të dimë definitivisht se si njerëzit parahistorikë i kanë përfytyruar zotat e tyre. Sendet e vendosura në varre, mundësisht mund të jenë dhurata të ndryshme për “zota nëntokësorë”. Eshtrat e qeve, qenve, dhive, të gjetura në varre, mund të jenë shenja për ekzistimin e traditës së sakrifikimit për të vdekurin pranë varrit të tij.


Është më se e vërtetë se në periudhën parahistorike ka ekzistuar besimi në Zotin e madh, në jetën pas vdekjes dhe në ekzistencat e lartësuara. Vetëm se, pasi që ende nuk është zbuluar ndonjë mjet, gjegjësisht ndonjë shkrim, që do të sillte në kohën tonë besimin dhe mendimet e tyre në mënyrë konkrete, është vështirë që për ta të bëhen komentime definitive. Edhe pretendimi se ata nuk ekzistojnë është padrejtësi ndaj tyre. Në këto periudha, që ofrojnë dokumente për mbeturina të politeizmit, me siguri që ekzistojnë gjurmë edhe për Zotin e madh dhe se në këto periudha, me siguri, që për propagandimin e besimit monoteist janë dërguar edhe profetë. Transmetimet në Librat e Shenjtë janë plot me shembuj të tillë. Si shembuj të parë janë Ademi dhe Idrisi. Emri i Idrisit në Dhaitën e Vjetër është Henoh.³⁵ Kur’ani atë e përmend me lëvdatë: „...*Ai ishte shumë i drejtë dhe peygamber. Ne e ngritëm atë në një vend të lartë (ia ngritëm lartë famën).*” (Merjem: 56-57). Nuk është e mundur që të gjendet ndonjë dokumentacion që tregon se kur dhe ku ka jetuar ai. Vetëm se, nëse merren parasysh lajmet e Dhaitën e Vjetër se Noah/Nuhi është nipi i tij, atëherë ka mundësi që ai të kishte jetuar në rajonin Irem në Arabinë Veriore (në jugperëndim të Detit të Vdekur), në fund të mijëvjetëshit 4.³⁶

³⁵ Zanafilla, V, 18-19.

³⁶ Studimet arkeologjike të kohës së sodit tregojnë se qyteti Irem gjendet në rajonin Edom të Palestinës së Vjetër. Shih John D. Davis, *The Westminster Dictionary of the Bible*, Philadelphia 1944, f. 267.

FETË E MESOPOTAMISË SË VJETËR

Bartësit e kulturave të Lindjes së Mesme në periudhat e vjetra, kanë gjuhë dhe u përkasin popujve të ndryshëm. Origjina dhe kultura e përbashkët mes tyre është ndikimi i Mesopotamisë, që zgjatet deri te sumerët. Shkrimi me kunjë³⁷ i zhvilluar nga sumerët më tepër është përdorur në kulturën e Azisë Perëndimore, kryesisht në fushën fetare. Kultet, si ai i prodhimit, i bereqetit dhe i magjisë, kanë arritur deri më sot me emra të ndryshëm. Rajoni fiton edhe më tepër rëndësi për faktin se aty kanë jetuar profetët. Emri, aktiviteti dhe prezenca e tyre në rrethe ku shpesh janë kundërshtuar janë evidente pasi ata përmenden edhe në Kur'an; gjithashtu rëndësinë e rajonit e rrit edhe ekzistenca dhe besimi i muslimanëve në to edhe sot; burimi i besimeve të devijuara, që ende jetojnë në mesin tonë etj. Këta vende që përmbajnë dokumentacionet më të vjetra të shkruara, të cilat ndriçojnë edhe origjinën e besimeve politeiste të kohës tonë, për historinë islame janë dokumentacione shumë me vlerë. Por janë me peshë edhe për ndriçimin e idhujtarisë dhe politeizmit në Arabinë e Vjetër, dhe me rëndësi të veçantë për njohjen e kulturës dhe fesë së Mesopotamisë së Vjetër.



Dituritë tona historike deri në fillim të shek. XIX bazohen në njoftimet e historianëve të periudhës së vjetër, si Herodoti, Straboni, Alexandri, Polyhistori etj., dhe në disa dituri të ngelura nga vepra e priftit Berrosos (260 para e.s.) në Babiloni. Zbërthimi i shkrimit me kunjë në botën shkencore hapi dimensione të reja dhe të gjera. Pas leximit për herë të parë të shkrimit me kunjë në persishte, nga G. Grotefend, u diskutuan edhe shkrimi me kunjë elam dhe babil. Për pasojë pjesërisht u qartësua jeta kulturore e rajonit. Në gërmimet arkeologjike doli në shesh një material shumë i pasur në lidhje me kulturën dhe fenë në Mesopotami. Sidomos, veprat letrare dhe shkrimi me kunjë që kanë arritur deri te Asurbanibali (668-626 para e.s.), fotokopjimi i tyre për në bibliotekën Pallatit të Ninovës dhe arritja e tyre deri në ditët e sotme i pasuroi edhe më tepër dituritë tona. Sot një pjesë e madhe e kësaj biblioteke ruhet në Muzeun Britanik në Londër.

Mendohet se bartësit e kulturës në rajon ishin sumerët, origjina e të cilëve akoma nuk është e qartë. Duke u nisur nga fakti se gjuha e tyre është e përafërt me strukturën e gjuhës turke, supozohet se ata kanë prejardhje nga verilindja. Në Mesopotami ata kanë themeluar një kulturë të lartë ekonomike dhe bujqësore. Në gërmimet arkeologjike, në lidhje me ta, janë gjetur përafërsisht 250 mijë tabela shkrimi me kunjë. Shkrimi ka mundësi të kishte filluar në vitet 3500 para e.s., dhe është shkrimi më i vjetër i njohur i njerëzimit. Ky shkrim fillon si shkrim me vizatim dhe duke u zhvilluar ka marrë formën e shkrimit skematik me kunjë dhe janë bërë të shprehshme rrokjet e tij.

Provat më të vjetra për burimet sumere ua kemi borxh zbulimeve të arkeologjisë. Gjithashtu sumerët janë edhe burim i legjendave semite për krijimin. Madje në tekstet sumere haset edhe në përmbajtje të pjesshme për legjendat e njohura të letërsisë semite si *Gilgameshi dhe Tufani*.

Origjina e këtij qytetërimi zbret deri në vitet 4500-4000 para e.s. Në gërmimet e bëra është hasur në numër të madh të Hyjneshave Kryesore dhe të figurave të qeve, të mbetura nga kjo periudhë. Sumerët këtu kanë ardhur në vitin 3500 para e.s. dhe kanë formuar një kulturë të lartë. Gjuhë dominante në rajon ka qenë ajo sumere. Kurse në vitin 3000 para e.s. në rajon janë formuar, më pak 12 qytet-shtete. Në mesin e tyre bëjnë pjesë: qytet-shtetet Kish, Uruk, Nippur, Lagash, Larsa etj. Çdo njëri nga këta shtete përbëhej prej qyteteve të rrethuara me mure dhe rreth e përçark me fshatra dhe ara. Në qendër të çdo qyteti gjendej një tempull. Së pari, administrimi ka qenë në duart e popullit. Kurse më vonë, luftërat mes qy-

³⁷ Më gjerësisht për llojet e shkrimeve të sumerët shih Aleksandër Stipçeviq, *Historia e librit*, Toena, Tiranë, 2000, f. 3-15. (Shënim i përkthyesit)

teteve kanë qenë shkak i lindjes së mbretërive. Sipas listës mbretërore sumere, që është gjetur në një dokument të arritur deri më sot, para Tufanit kanë jetuar 8 mbretëri. Mbreti i parë që bashkoi qytet-shtetet ishte Udhëheqësi i Kishit, Etana (2800 para e.s.). Sumerët, të dobësuar pas luftërave mes qyteteve, janë sulmuar dhe janë pushtuar, së pari nga elamët (2530-2450 para e.s.), e më vonë nga akadët (2334-2279 para e.s.). Edhe pse në disa periudha sumerët kanë fituar pavarësinë e tyre, qytetërimi sumer madhështinë e fundit të tij e ka përjetuar në kohën e fisit të Urit të tretë. Mbreti i parë Ur-Nammu, ka përgatitur kodin e njohur më të vjetër ligjor. Sumerët, me okupimin e Mesopotamisë nga amoritët, pas vitit 1900 para e.s., e kanë humbur identitetin e tyre origjinal. Por, gjuhët e tyre kanë vazhduar të jetojnë nëpër tekstet fetare.

1. Fetë e sumerëve

Literatura: Edward Meyer, *Geschichte des Altertums*, V.1-2, Stuttgart 1954, f.453-463; Helmer Ringgren, *Religions of the Ancient Near East*, Londër, 1973, f.1-46; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, Stuttgart, 1959, f.178186; H. Schmökel, “*Sümer Din?*”, përkth. Turhan Özdemir, *İlahiyat Fakültesi Dergisi*, V.19, f.197-217 dhe V.21, f.367-390.

Termi që përdoret për hyjninë në gjuhën sumere është “Dingir” dhe në të njëjtën kohë ka kuptimin “*qiell*”. Kjo përkujton fjalën “Tengiri” në gjuhën e vjetër turke. Shenja që përdoret në hieroglif shqiptohet “An, Anu”, me kuptimin “*qiell*”. Kjo ka edhe kuptimin “*i lartë, i madh*”. An është kryesori i kuvendit të zotave sumero-babil dhe ka kuptimin *Zot*. Asnjëherë nuk është bërë ndonjë statujë apo idhull për të. Vendi i tij është në katin më të lartë të kupolës qiellore. Zotat tjerë atë e respektojnë dhe e vizitojnë. Emri i tempullit në Uruk është E-an-na (*shtëpia qiellore*). Ai llogaritet si posedues i çdo gjëje, ati i të gjithë zotave të tjerë³⁸, qëndron në largësi që s’mund të arrihet dhe nuk shihet në jetën e përditshme fetare.

“Ki”, që llogaritet gruaja e tij, (në gjuhën semite Antu, Enki), pranohej si hyjneshë e tokës apo vetë toka, vendin e së cilës e zë Inanna. Anlil është i biri i Anit, zot i ajrit dhe i stuhisë, mbizotërues i atmosferës. Ai quhet edhe zoti i qytetit Nippur. Këta tre zota (An, Anlil, Enki) gjenden në krye të panteonit sumer, kurse zotat e tjerë gjenden më poshtë se ata.

Inanna është vajza e Anit dhe hyjneshë respekti e qytetit Uruk. Më vonë do të komentohet edhe si gruaja e Anit. Në artin e Azisë Perëndimore, Greqisë dhe Romës do të haset shpesh në emrat shumë të popullarizuar si Ishtar, Afrodit, Venus. Motivet Inanna (Ishtar) dhe Dumuzi do të shihen në të gjitha rajonet. Do të dalin në shesh zota të mëdhenj që do të ndikojnë në tërë Lindjen e Mesme dhe në Mesdhe. Këta kanë qenë Utu, zoti i qiellit, Nanna, zoti i hënës, Ninurta, zoti i luftës, Nergal, zoti i nëntokës dhe gruaja e tij Ereshkigal. Zotat janë llogaritur udhëheqësit e fuqisë natyrore me të cilën kanë të bëjnë, por nuk janë barazuar me natyrën. Marrëdhëniet mes zotave konceptoheshin si marrëdhënie familjare dhe komentoheshin në mënyra të ndryshme. Shtetet dhe perandoritë në shekujt e ndryshëm kanë dhënë mendime të ndryshme në komentin e zotave. Në panteonet babilonase, greke dhe romake haset shpesh në përmendjen e tyre me emra të ndryshëm. Për shembull, Ninursak është kryesori i kupolës së hyjneshës kryesore, kulti i së cilës është përhapur prej Anadollit e deri në Romë.

Qytet-shteti në të njëjtën kohë llogaritej edhe si “Shtet i Zotit”. Administrimi i çështjeve shtetërore, organizimi i punëve bujqësore bëhej në tempull. Tempulli megjithatë ishte qendër e fronit dhe e administrimit shtetëror. Krahas tempujve shiheshin edhe zikkuratët, që ishin ndërtesa të shenjta dhe speciale për sumerët. Këto janë kulla piramidale të ngritura në formë të shkallëve dhe përbëjnë shembullin e parë të kullës së njohur babilonase.

Detyra më kryesore në ceremoni i takonte mbretit murg, të cilin gjatë ceremonisë i ndihmonin murgjit e tjerë. Në ceremoninë Inanna-Dumuzi merrnin pjesë edhe murgesha, të cilat kryenin detyrën e kurvërimit të shenjtë. Këto sjellje ishin pjesë e ceremonisë dhe shërbenin për përhapjen e bereqetit në shtet. Ceremonitë, ku flijoheshin bimë dhe kafshë dhe ku përdorej uji dhe tymi i shenjtëruar, i realizonin të zhveshur, sikur që shiheshin arabët e para islamit në rrotullimin e tyre që bënin rreth Qa-

³⁸ Eliade, *Die Religionen und das Heilige*, Salzburg, 1954, f. 92-94.

besë.

Besimi në botën e ardhshme: prej gjërave të vendosura nëpër varre kuptohet se sumerët besonin në të jetuarit e shpirtit pas vdekjes. Shpirti, duke kaluar lumin Habur, për të cilin besohet se gjendet në nëntokë, shkon në botën nëntokësore. Ndërkaq edhe disa shpirtëra janë të obliguar që ta shoqërojnë atë. Por, kjo botë e të vdekurve llogaritet si një vend ku s'ka gëzim, dhe është vend pakthim. Për këtë sumerët në lutjet e tyre lypnin jetë të gjatë dhe të shëndetshme.

2. Fetë babilonase dhe asiriane

Literatura: Helmer Ringgren, *Religions of the Ancient Near East*, Londër, 1973, f.49-121; Carl Clemen, *Die Religionen der Erde*, V.1, f.42-61; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f.178-197; Mehmet Taplamcıoğlu, *Karşılaştırmalı Dinler Tarihi*, Ankara, 1996, f. 82-90.

Është bërë e ditur se, që nga vitet 2600 para e.s., disa popuj me gjenezë semite janë shpërngulur në toka të Mesopotamisë dhe atje kanë formuar shumë qytet-shtete. Sundimi i parë semit ka filluar me themelimin e shtetit *Akad* nga Sargoni i (2350 para e.s.). Sumeri, gjegjësisht dinastia e 3. e qytetit Ur, është shkatërruar me kryengritjen e dytë semite. Me hovin e shpërnguljes së kenanëve në vitet 2000 para e.s. u formuan shteti *Larsa* dhe *Isin*. Së pari, një dinasti lindore kenane, Babiloninë e ka bërë kryeqytet dhe udhëheqësi më i mirë i tij ka qenë Hamurabi. Kjo dinasti e fundit babilonase, mori fund në vitin 1530 para e.s. Në këtë kohë ky vend ishte nën sundimin e një populli anadollian indo-xhermen. *Kassitët*, të zbritur nga malet Zagros në jug, duke shfrytëzuar gjendjen pështjelluese të Mesopotamisë, themeluan shtetet e tyre. Vetëm se, kanë mbetur nën ndikimin e qytetërimit të zhvilluar babilonas. Në veri të rajonit është forcuar Perandoria Asiriane dhe ka vazhduar ndikimi i pasuesve të tij, Hurrit dhe Mitannit. *Shteti i Asirisë* u zhvillua dhe për një kohë të shkurtër sundoi mbi tërë rajonin. Për një kohë sundoi edhe Egjiptin (681-612 para e.s.). Në vitin 625-538 para e.s. u paraqit edhe *dinastia kalde e aramitëve*. Këto shtete shekuj me radhë luajtën rolin e shtetit dominues në botë. Me përzierjen e besimeve dhe kulturave të popujve semitë me kulturën sumere, që është josesmitë, dolën në shesh krijime të reja, kështu që në fund mund të flasim për fetë babilonase edhe asiriane.

a. Sistemi i zotave

Fetë babilonase dhe asiriane kanë një pamje politeiste. Babilonia në fillim përbëhej prej shumë qytet-shteteve. Edhe feja e këtyre qytet-shteteve është zhvilluar prej kulteve të shumë zotave natyrorë lokalë. Kulti për çdo vend mëtonte se është pamje e botës dhe pozita më e lartë e hyjnisë së tij. Në fillim kishte mbi 600 hyjni që adhuroheshin. Më vonë këto hyjni duke u përzier njëri me tjetrin u pranuan si zota mbrojtës të qytetit kryesor. Kështu mbreti Hamurabi (1728-1686), Babiloninë e bëri kryeqytet dhe qendër fetare të Perandorisë së tij. Marduki, zot i Babilonisë, kaloi në krye të kuvendit të zotave. Dominimi i zotave të tjerë u shkatërrua përpara Mardukit. Sistemi astrologjik, me përpjekjet e murgjërve i përshkruhet Mardukit. Sipas lajmërimit në Dhaitën e Vjetër (*Zanafilla, 11*), edhe kulla e bërë në Babiloni, për të cilën thuhet se ka arritur deri në qiell, është ndërtuar për nderë të Mardukit. Nga gërmimet arkeologjike është kuptuar se kjo kullë kishte lartësinë 90 m. Më vonë, edhe asirianët të gjithë zotat e tyre i bashkuan te Marduku.

Adhurimi dhe respektimi i zotit Asir, është përhapur në kohën e mbretit Sanharib (705-681 para e.s.). Zoti Asir, në shpjegimet mitologjike të asirianëve për krijimin, ka qenë personi kryesor në festën e vitit të ri, që fillon në pranverë, dhe në *ekuinoks* (koha në të cilën dita dhe nata janë të barabarta). Sipas asaj që bën të ditur Tevrati, në qytetin Ur të Kaldesë, të cilin e ka braktisur Ibrahim (a.s.), hyjnesha e hënës e mbetur prej sumerëve, ka qenë Nannari. Kjo hyjneshë në Harran është njohur me emrin Sin. Zoti i diellit Shamashi, mbrojtësi i drejtësisë dhe i rregullit të akadëve, është adhuruar në veri në qytetin Nippur dhe në jug në qytetin Larsa. Shamashi quhej se ishte i biri i Nannar-Sinit dhe kjo ishte një shenjë që tregon se sa i vjetër ishte adhurimi i hënës. Anu, zoti i qiellit, adhurohej dhe respektohej në

qytetin e vjetër Uruk. Përveç kësaj Ea (sipas sumerëve: *Enki*) mendohej zot i oqeanit me ujë të ëmbël, kurse Nergal zot i botës nëntokësore dhe i botës së të vdekurve.

Një prej çështjeve që tërhek vëmendjen është dalja në shesh e trinitetit të zotave të mëdhenj. Vetëm se në këta zota nuk ekziston dukuria e veçantë e shpëtimit të përhershëm. Në krye të panteonit qëndronin tre hyjni kozmike. Zoti i qiellit ishte Anu (sipas sumerëve: An), që në periudhën helene është identifikuar me Zeusin. Ky ishte kryesori i zotave dhe ishte babai dhe dominuesi mbi të gjithë zotat. Zotat e tjerë buronin nga ai. Ai në një farë mënyrë shprehte termin Zot në fetë monoteiste. Zoti i tokës dhe i maleve ishte Ellili, prototipi i tij ishte Enlili, zoti i ajrit te sumerët. Kurse zot dhe hyjni i ujit ishte Ea (sipas sumerëve: Enki), i cili sikur te sumerët, llogaritej mbrojtësi i premtimit dhe i urtësisë dhe mik i njerëzimit. Po ashtu llogaritej edhe zot i botës dhe i ujërave nëntokësore. Dhe më vonë doli në shesh njëshmëria e trinitetit qiellor e lëvizjes dhe e kthimit, dielli (Shamash), hëna (Sin) dhe yjet (Ishtar). Shamashi, zoti i diellit, llogaritej i biri i Sinit, i cili është një zot që adhurohet shumë nga semitët perëndimorë dhe është mbrojtësi i drejtësisë. Ligjet e Hamurabit, që gjenden në *rrënimet Susa*, janë përgatitur në emër të Shamashit. Ata përbëhen përafërsisht prej 300 paragrafëve. Edhe ai vetë, si Sargoni I. që është edhe njëri nga paraardhësit e tij, ka besuar se është një shpëtimtar dhe se me këto ligje do të realizojë drejtësinë në këtë botë. Gjithashtu edhe Ishtari (sipas sumerëve: Inanna), e cila llogaritet vajzë e Sinit dhe vajza e vëllait të Shamashit, ishte përfaqësuese e yllit (planetit Venus) të mëngjesit dhe mbrëmjes. Ajo ishte hyjnesha kryesore e dashurisë emocionale dhe e plleshmërisë. Shumë zota të plleshmërisë ajo i ka bashkuar në veten e saj. Ishtar ishte hyjnesha e qytetit Arbela, në emër të saj është bërë një tempull i njohur. Më vonë është bërë hyjneshe edhe e Ninovës. Është bërë shkak që nga asirianët të konsiderohet si hyjneshe e gjuetisë dhe e luftës. Gjithashtu është bërë shkak për përhapjen e influencës që ajo në të njëjtën kohë të llogaritet edhe hyjneshe e dashurisë dhe hyjneshe kryesore. Në adhurimin që i bëhet asaj gjendet edhe kurvërimi i shenjtë.

Kundërshtimin e Ibrahimit ndaj këtij triniteti qiellor dhe pretendimet e tij logjike kundër tij, i vërteton edhe Kur'ani (*En'am, 76-78*). Ai gjithashtu potencon se gjërat që lindin, perëndojnë dhe që janë kalimtare nuk mund të jenë zota.

Temmuzi (te sumerët Dumuzi, te fenikët dhe grekët Adonis) është i biri dhe i dashuri i Ishtarit. Gjatë kohës është forcuar dhe ka marrë karakterin zot i bimëve. Ai vetveten e paraqet në ringjalljen e përhershme të botës, e cila në vjeshtë vdes, kurse në pranverë ngjallet. Temmuzi çdo vit shkatërrohet dhe vdes në temperaturën djegëse të diellit pranveror. Po ashtu edhe bimët bashkë me të zverdhen dhe vyshken. Nëna Ishtar, e cila dëshiron që ta shpëtojë djalin e saj, nëpër një rrugë ferri ka shkuar në shtetin Ereshkigal, prej ku nuk ka kthim, dhe ka dashur që ta prishë fatin e vdekjes. Kjo gjendje është imituar edhe në mitologjinë egjiptiane të Ozirisit. Vjershat e Temmuzit që i posedojmë përbëhen prej elegjive të thënura në ligjërimet reciproke, mes komunitetit dhe klerikëve për ndarjen e zotit të bimëve nga bota, dhe prej elegjive të thënura nga gratë me britma dhimbjeje. Në këto adhurime ka marrë pjesë edhe profeti hebraik Hezekijel.³⁹ Më vonë Temmuzi me mbështetjen e murgjve është llogaritur djali i Ea-së dhe është bashkuar me Mardukin.

Prej zotave të tjerë të njohur të Babilonisë mund të përmenden Adad-zoti i stuhisë, që jep shi dhe pasuri; Ninurta-zoti i asirinëve, për luftë dhe gjueti; Dagon-mbrojtësi i prodhimit të amoritët, i cili përmendet në Dhaitën e Vjetër. Edhe Nabu, djali i Mardukit, është një sekretar hyjnor që regjistron fatin e njerëzve në pllaka.

Të gjithë këta zota në kohën e parë kanë qenë trima legjendë apo në fillim kanë qenë fuqi natyrore të personifikuara. Është e mundur që edhe besimi në melekët në fetë monoteiste, të komentohet si hyjnizim. Por më vonë u përshkruan dhe u konceptuan në formë të njeriut apo simbolikisht u trupëzuan. Kultet e të gjitha këtyre hyjnive janë bashkuar me ceremonitë, në të cilat besohet se ka forca mistere. Këto adhurime udhëhiqeshin nga priftërinj specialë të përbetuar.

b. Koncepti për gjithësinë

Gjithësia e njohur ndahet në qiell, tokë dhe nëntokë. Edhe triniteti i përmendur i hyjnive i është përshtatur këtij

³⁹ *Ezekiel, 8:14.*

rregulli të universit. Por, njëri nga konceptet themelore të Mesopotamisë së Vjetër është mendimi i ngjashmërisë së bëmave qiellore dhe botërore me njëra tjetrën. Sidomos, yjet përfitohen si një shkrim misterioz i hyjnive dhe leximi dhe kuptimi i saj për njerëzit është i mundshëm. Për këtë babilonasit, që në kohën më të hershme, kanë zhvilluar disa njohuri për lëvizjen e yjeve dhe po këtë lëvizje e kanë llogaritur me një precizitet të madh. Gjithashtu edhe të llogariturit e javës si shtatë ditë dhe të vitit si 365 ditë-netë, bazohet në ato. Shtatë ditët e javës u përsëriten zotave. Marduki është llogaritur Jupiter (e enjte); Nabui, Merkur (e mërkurë); Nergali, Mars (e martë); Ninurta, Saturn (e shtunë); Ishtari, Venus (e premte). Përveç këtyre pesë planeteve e diela i përsëritet Shamashit (diellit), kurse e hëna, Sinit (hënës). Mitologjitë pasqyrojnë marrëdhëniet e hyjnive me planetet dhe karakterin e tyre. Kjo kulturë e Mesopotamisë më vonë është përveçuar nga grekët dhe romakët. Edhe pse botërat e zotave që moti janë bërë pjesë e historisë, madje edhe sot profecia e astrologëve bazohet në mitologjinë e Mesopotamisë së Vjetër.

c. Magjia

Arti i kontaktit me metafizikën dhe me qeniet shpirtërore llogaritet njëra prej detyrave të klerikëve, të cilët me metoda të ndryshme magjike i shfrytëzonin ata dhe i drejtonin drejt realizimit të aspiratave botërore. Sikur që, për ndikime negative të dikush apo në diçka, është magjia e zezë, për shpëtim nga ajo dhe shërim nga sëmundjet është magjia e bardhë. Aktivitetet mistere, rrënjët e të cilave zëbrasin deri te tekstet sumere-akade, kanë ndikuar në rrethet politeiste në tërë Lindjen e Mesme dhe në bregdetin e Detit Mesdhe, por kanë ndikuar edhe te hebrenjtë, te të krishterët dhe te muslimanët. Për këtë janë shkruar shumë libra dhe, krabas ndalimit fetar, interesimi i njeriut për ta nuk ka mundur të pengohet. Edhe pse prej atëherë ka kaluar një kohë bukur e gjatë, përsëri origjina dhe ndikimi i Mesopotamisë ende e paraqet vetveten. Në Kur'an shpjegohet se melekët Haruti dhe Maruti popullit në Babiloni ua kanë mësuar magjinë.⁴⁰ Një numër i madh i literaturës arkeologjike vërteton këtë shprehje kur'anore.⁴¹

ç. Jeta pas vdekjes

Në tekstet që i zotërojmë thuhet se, shpërblimi për punët e mira do të bëhet në këtë botë, kurse edhe punët e këqija do të dënohen po në këtë botë. Ndërkaq për shpërblimin apo dënimin në botën tjetër shumë rrallë bëhet fjalë. Vendi ku do të arrijë njeriu pas vdekjes, gjendet në pjesën perëndimore të botës dhe është i rrethuar me shtatë mure dhe shtatë dyer. Këtu sundon hyjnesha Allatu. Ai është një vend pa kthim dhe pa gëzim. Të vdekurit, të mbuluar në pluhur, qëndrojnë në një vend të errët. Derisa pas vdekjes së tyre për ta nuk flijohet alkool dhe ushqim, ata do të pinë ujë të turbulluar dhe do të hanë pjesë dheu. Sidomos situata e atyre që nuk janë varrosur dhe që nuk kanë lënë pasues, është shumë e keqe. Kurse gjendja e atyre që kanë vdekur në luftë është pak më e mirë dhe pinë ujë të pastër. Në anën tjetër në disa tekste, tregohet edhe për atë se të vdekurit në hyrje gjykohen nga Anunakisi.

Të vdekurit, që shkojnë në botën e të vdekurve, atje, sikur lakuriqët, bartin një mbulesë prej flete. Kurse bota në të cilën gjenden, është e mbuluar me errësirë dhe me një pluhur shkatërrues. Ky pluhur, sikur që thotë Ishtari “në rrugën e tij për në ferr”, është ushqim për banorët e atjeshëm.⁴² Në një përshkrim tjetër, të një bote tjetër nëntokësore, bota e të vdekurve paraqitet si pjesa natë e botës. Udhëheqësi këtu është vdekja. Vdekja rri në një saraj shtetëror, përplot me xhinnë dhe errësirë dhe i urdhëron demonët që i ka nën kontroll. Ata natën shpërndahen në tërë botën dhe njerëzve u shpërndajnë të keq dhe fatkeqësi.

⁴⁰ Kur'ani, Bakara, 102.

⁴¹ Ernst Zbinden, *Eski Ortadoğu ve İslam Ülkelerinde Cin İnanç*, Stamboll, 1996, f. 225.

⁴² Schoeps, *Die Religionen*, f. 73.

3. Shfaqja e monoteizmit: reagim ndaj politeizmit

Atë që në Mesopotami, e shohim në modelin më të vjetër të sistemit politeist në “An”-in, zoti i lartë, e hasim edhe në konceptin “zoti i qiellit” te sumerët. Vetëm se me mendimin se a ka grua dhe fëmi dhe me spekulacionet e murgjve, filloi një politeizëm sistematik. Më herët nuk bëheshin skulptura të familjeve të hyjnive, të cilat përfytyroheshin si familje njerëzish. Me kalimin e kohës filluan të bëhen edhe skulptura edhe idhuj. Nuk ekzistojnë dokumentacione historike dhe konkrete që tregojnë për reagimet ndaj këtyre zhvillimeve. Njohuritë më të vjetëra për këtë bazohen në transmetimet tradicionale. Këto janë njohuri të Biblës dhe të Kur’anit. Sipas librit “Zanafilla” të Dhaitën e Vjetër, rajoni gjeografik ku është vendosur Noah pas Tufanit quhet Ur. Me siguri familja e shpëtuar nga tufani bashkë me anëtarët e tjerë të saj është vendosur në këtë rajon. Nuk ka dyshim se më vonë ata kanë vazhduar me misionin propagandistik të tyre. Sepse Abrahami, njëri nga pasardhësit e tyre, ka vazhduar ta bartë flamurin e monoteizmit, të cilin e kanë bartur gjyshërit e tij.

a. Ibrahim/Abrahami

Është djali i Azerit, njërit nga nipërit e Nuhit. Babai i tij është Azeri (sipas Tarab), kurse nëna e tij është Emseta e bija e Karnebos.⁴³ Ka edhe transmetime tjera. Për shkak të frikës nga ndonjë e keqe prej Nemrudit, e cila është rezultat i një falli në lidhje me lindjen e tij, ai fëmijërinë nuk e ka kaluar pranë babait, por, pranë gjyshit të tij të madh, Nuhit, i cili ka jetuar larg qytetit. Sipas transmetimeve në Talmud, kur ka vdekur Noah, Abrahami ka qenë ende në moshën 15 vjeçare. Kështu pra, është rritur pranë Noahit dhe edukimin e parë e ka marrë prej tij. Më vonë, kur Abrahami kthehet te babai i tij Azeri, gjegjësisht në qytetin ku ka jetuar, për të cilin supozohet të jetë qyteti Ur, Nemrudi ka qenë mbi 40 vjeç. Transmetohet se gjatë shpërnguljes ai kishte qenë në moshën 50 vjeçare. Në Ur ai ka propaganduar qenien dhe njësinë e Zotit dhe ka kundërshtuar politeizmin dhe idhujt. Vetëm se pak më herët, kur ka ardhur në qytetin Ur, ka parë se babai i tij dhe njerëzit përreth kanë adhuruar yjet, hënën dhe diellin. Në fillim nuk ka mundur ta marrë veten, duke menduar se a thua vallë ka ndonjë të vërtetë në besimin e popullit të tij. Fillimisht ka menduar se zot është së pari ylli, pastaj hëna e më vonë dielli. Por kur ka parë se këta njëri pas tjetrit perëndojnë dhe zhduken para syve të njerëzve ka thënë:

“...O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni! Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përsbkruejnë shok!”⁴⁴.

Edhe studimet historike i vërtetojnë këto shprehje të profetit Ibrahim. Ai tregon se fjalët që shprehin termin Zot janë An, En; dhe se ata janë vajza e Ishtarit dhe djali i Sinit (hënës) dhe Shamashit (diellit). Librat e Shenjtë tregojnë se Nemrudi ka dashur që atë ta hedhë në zjarr dhe ta dënojë, vetëm se zjarri atë nuk e ka djegur, dhe se ai me mrekulli ka shpëtuar prej zjarrit. Se vendi i zjarrit nuk ka qenë shesh por, një pallat, kuptohet nga këto shprehje: “Ata thanë: Ndërtonja atij një vend dhe hudhne atë në zjarr!” (Saffat, 97). Talmudi tregon, se bashkë me Abrahamin në zjarr është hudhur edhe vëllai i tij Harani dhe për shkak të dyshimit për një moment në Zotin është djegur.⁴⁵ Dalja gjallë e Abrahamit nga ai zjarr ia mundëson që ai të jetë i lirë. Vetëm se, nga torturat e mëdha sa që nuk mund t’i durojë njeriu, ai ka qenë i detyruar që bashkë me familjen ta lërë Mesopotaminë dhe të shpërngulet në një vend tjetër. Abrahami me gruan e tij Saranë dhe me Lutin, djalin e Haranit, së pari shpërngulet për në Harran, që është një vend për pushim dhe qytet qendër i asaj kobe. Kurse prej andej u shpërngul në rajonin e Palestinës dhe drejt anës perëndimore të Lumit të Vdekur.

Për sundimtarin e qytetit Ur, i cili e hodhi Ibrahimin në zjarr, nuk kemi njohuri të mjaftueshme dhe definitive. Fjala Nemrud nuk është emër i përveçëm por ka kuptimin, “sulltan, mbret, udhëheqës, prijës”. Huluntuesit perëndimorë, duke u bazuar në transmetimet e Dhaitën e Vjetër, janë të mendimit se ai është Hamurabi apo ndonjë nga fisi i tij. Për këtë shkak, për kohën e lindjes së Abrahamit jepen data të ndryshme mes shekujve 20-17 para e.s.⁴⁶ Kurse sipas mendimit tonë, Nemruti mund të jetë Sargoni I, që është themeluesi i shtetit Akad. Nëse nisemi nga shenjat kur’anore, më tepër ka mundësi

⁴³ The Talmud, 31.

⁴⁴ Kur’ani, En’am, 76-79.

⁴⁵ Talmud, 39-41.

⁴⁶ de Vaux, f. 257-263.

që Sargoni I. të jetë vetë Nemrudi. Ai është sundimtari i parë i madh që mundësoi bashkimin e semitëve. Kurse pas shpërnguljes së Abrahamit në rajonin e Palestinës, e shohim se ai misionin e ka vazhduar brenda familjes së tij dhe është munduar të qëndrojë larg sundimtarëve.⁴⁷

b. Junusi/Jona

Ai është prej fisit të Ibrahimit. Edhe familja e tij ka qenë në mesin e familjeve hebraike të syrgjynosura në Babiloni. Ai, popullin asirian të Ninovës e ka obliguar me propagandë. Ai ka jetuar në kohën e mbretit të Jahudas, Osijas dhe mbretit izraelit, Jerobeamit II. (785 para e.s.). Emri i tij përmendet në sure të ndryshme të Kur'anit.⁴⁸ Kurse sureja e dhjetë mban emrin e tij "Junus". Përmendet edhe si Dhunnun edhe si Sahib ul-Hud. Në literaturën islame emri i tij është Junus i biri i Mattasë, kurse në Dhaitën e Vjetër është djali i Ammittajit që do të hidhej nga fisi Zablon. Pasi që populli i qytetit nuk e ndëgjonte atë, ai u hidhërua dhe dëshironte që pa lejen e Zotit të braktisë qytetin dhe kështu ka hipur në një anije. Pasiqë anija rrezikonte të mbytej, për përcaktim të mëkatarit që do të hidhej në ujë, shorti i ka ra atij dhe ai vetë hidhet në lumin Tigër. Sipas rrëfimeve ai, në barkun e peshkut ka qëndruar një kohë të gjatë (transmetimet tregojnë periudha të ndryshme prej 4 minuta deri 40 ditë) dhe më vonë peshku atë e ka hedhur në breg. Junusi/Jona, i cili e kuptoi gabimin e tij dhe u pendua, u kthye përsëri në Ninova, ku vazhdoi detyrën të tij si misionar.⁴⁹

Libri i cili i përkushktohet atij, kinse vjen prej vitit 600 para e.s., në Dhaitën e Vjetër, ende nuk është përcaktuar me shkrim ose gojarisht. Burimi i materialit komentues të librit nuk është i qartë. Është e mundur që transmetimet e tilla gojore t'i kishte përmbledhur dhe të kishte punuar me to një autor i panjohur. Ato libra, të cilat janë të përhapura në rajone të ndryshme të botës mitologjike dhe janë shndërruar në forma lokale, i kanë bartur hebrejtë. Për këtë edhe në tregimet e Greqisë së Vjetër dhe të Indisë haset në legjenda paralele.⁵⁰

c. Ezekieli

Ka jetuar në fillim të shek. VI para e.s. Ai, me shkatërrimin e shtetit Jahuda, ka marrë pjesë në syrgjynosjen e parë të popullit hebraik në Babiloni (597 para e.s.). Ai nëpërmjet kanalit Kebar, në afërsi të Nippurit, është vendosur në Tel-Abib. Ka qenë i martuar, por gruaja i ka vdekur më 587, gjatë rrethimit të Jerusalemit. Ai u mundua që, Bijtë e Izrealit dhe njerëzit rreth e përçark tij, t'i mbrojnë prej politeizmit. Profecia e tij fillon në vitin 592 para e.s. Edhe në vitin 571 ishte ende gjallë. Duke mbajtur ligjëratat për shpresën, u mundua që të mbajë të fortë anën spirituale të besimtarëve. Në "Libri i Ezekielit" në Bibël, jepen njohuri të gjëra për personalitetin dhe veprimtarinë e tij. Tregohet se, pas shpëtimit të hebrejve nga syrgjynosja në Babiloni, bashkë me popullin është kthyer në Palestinë dhe atje e ka vazhduar misionin e tij. Kurse për daljen e librit, dominon bindja se libri është shkruar në shek. III para e.s.⁵¹

Komentatorët muslimanë janë të mendimit se, njeriu i urtë, i cili në ngjarjen që shpjegohet në suren Bakara, ajeti 259, që përpara ndërtesave të shkatërruara thotë, "Si do ta ringjallë Allahu këtë pasiqë të vdes kështu?", vdes vetë dhe duke u ringjallë pas njëqind vjetëve, e ka përjetuar edhe vdekjen edhe ringjalljen, është vetë Ezekieli.⁵²

⁴⁷ Për jetën e mëvonshme të Hz. Ibrahimit shih kapitullin *Fetë në Arabinë Veriore!*

⁴⁸ Kur'an, VI, 86; XXI, 84; XXXVII, 139-148; LXIII, 48.

⁴⁹ Dhiata e Vjetër, Libri i Profetit Jona; Libri 2 i Mbr., 14, 25; Kur'an, Enbija, 87-88; Kur'an, Saffat, 139-148; Kur'an, Kalem, 48-50 dhe sureja Junus.

⁵⁰ Ernst Sellin dhe Georg Fohrer, *Einleitung in das Alte Testament*, Botimi 10, Heidelberg, 1965, f. 485 dhe në vazhdim.

⁵¹ Sellin-Fohrer, f. 442-458.

⁵² Süleyman Ateş, *Kur'an-ı Kerim ve Yüce Meali*, 42; Kitab-i Mükaddes, *Kapitulli Ezekielit*, 37, 1-14.

ç. Danieli

Ka jetuar në sarajin babilonas në shek. VI para e.s. dhe ishte prej fisit Jahuda.⁵³ Si rezultat i rrethimit të Jerusalemit nga Nabuketnazari (606 para e.s.)⁵⁴, kapet rob në moshë të re dhe dërgohet në Babiloni. Me talentin dhe aftësitë e tij tërhoqi vëmendjen e sarajit. Ai posedonte aftësinë e të kuptuarit të ëndërrave dhe të urtësisë. Edhe pas çlirimit të shtetit nga Medleri, Dariusi atë e respektoi shumë, dhe e zgjodhi edhe ministër. Danieli u mundua ta shndrritë rrethin e tij. Tregohet se ka qenë dëshmitar i vitit të tretë të udhëheqësisë së mbretit persian Kurus (536 para e.s.). Nuk dihet se ku dhe kur ka vdekur.⁵⁵ Edhe pse nuk përmendet emri i tij në Kur'an, në mesin e muslimanëve ai ka gëzuar një autoritet dhe ka qenë një profet i respektuar. Në Tarsus ka një vend që e mban emrin e tij.

Në librin, që bën pjesë në Dhiatën e Vjetër, për jetën e Danielit tregohen tre tregime. Nga këto, pjesa e dytë e librit me metodën „unë“, është shkruar nga Danieli, i cili që para vitit 605 para e.s. është dërguar në Babiloni. Për shkak të disa ëndërrave dhe vizioneve që gjenden në të, hebrenjtë dhe të krishterët ato i kuptojnë si profeci për kohën e fundit. Mendimi i studiuesve për analizimin e tekstit është se libri është shkruar në shek. II-III para e.s.⁵⁶

⁵³ Daniel, I,3-7.

⁵⁴ Ömer Faruk Harman, *İslam Ansiklopedisi*, VIII, 480-481.

⁵⁵ Vep. e cit.

⁵⁶ Sellin-Fohrer, f. 518-527.

FEJA NË EGJIPTIN E VJETËR

Doc. Dr. Müriüvet Kurban (e ndjerë)
Hacettepe Üniversitesi, Turqi

Literatura: Bargiut P., *Les textes des Sarcophages égyptiens du Moyen Empire*, Paris, 1986 ; Bugde Wallis E.A., *The Gods of the Egyptians*, V. 2, New York, 1969; Daumas François, *La Civilisation de l'Égypte pharaonique*, Paris, 1967; Dunand française-Zivie-Coche Christiane, *Dieux et Hommes en Égypte*, Paris, 1991; Erman Adolphe, *des Pharaons*, Paris, 1939; Faulkner N., *The Ancient Egyptian Pyramid texts*, V. 2, Oxford, 1969; Harnung Herik, *les Dieux de l'Égypte*, Paris, 1986; Kolpaktchy Gregoire, *le livre des Mort des anciens égyptiens*, Paris, 1991; Jacq Christian, *Nefertiti et Akhenaton*, Paris, 1990; Lalouette Claire, *Textes sacrés et textes profanes de l'ancienne Égypte*, Paris, 1987; Leveque J., *Sagesse de l'Égypte ancienne*, Paris, 1983; Montet Pierre, *l'Égypte éternelle*, Paris, 1970; Moret Alexandre, *le Nil et la civilisation égyptienne*, Paris, 1929; Racht M. F. et Guy, *Dictionnaire de la civilisation égyptienne*, Paris, 1970; H. J. Schoeps, *Religionen*, Gutersloch, 1964, f.78-93; Traunecker Claude, *les Dieux de l'Égypte*, Paris, 1991; Helmuth von Glasenapp, *Die nichtchristlichen Religionen*, Frankfurt, 1957, f.25-37; Talat S. Halman, *Eski Mısır Şiiri*, Stamboll, 1972; E. A. Wallis Budge, *The Book of the Dead*, New York.

Shteti i faraonëve, Egjipti, ka rëndësi të veçantë për arsye se është vendi ku janë zbuluar dokumentacionet dhe tekstet e shkruara më të vjetra në historinë botërore. Sidomos në këtë shtet, pas Mesopotamisë, janë gjetur tekstet më të vjetra për historinë e fesë. Rëndësi të veçantë për muslimanët kanë marrëdhëniet e faraonëve me rrethet ku kanë jetuar pejgamberët si Jusufi (XIV para e.s.) dhe Musai, emrat e të cilëve përmenden në Kur'an. Egjipti, për shkak të piramidave, zotave në formë të kafshëve dhe të piktografive nga ana e Greqisë se Vjetër është pranuar si shtet i mistereve. Vetëm se shkrimtarët si Herodoti, Josephusi, Porphirusi, Piodori, në të shumtën e rasteve, kur kanë bërë krabasimin e zotave të tyre me të Egjiptit, kanë bërë konstatime të gabuara. Egjipti shekuj me radhë ka qenë vend i panjohur dhe vend i mrekullive. Napoleoni, gjatë udhëtimit për në Egjipt më 1799, në Rosette ka hasur në një mbishkrim me tre lloje shkrimesh. Kuptimi i vërtetë i këtij mbishkrimi u dha nga ana e francezët J.F. Champollion, në vitin 1822 dhe me të u zëbërthe shkrimi hieroglif. Pas kësaj, dituria jonë për egjiptasit e vjetër u rrit përnjëherë dhe lindi shkencë për Egjiptin e Vjetër. Sot në shumë universitete perëndimore ekzistojnë drejtime që merren me hulumtimin dhe studimin e kësaj fushe.



Fiset nomade që kanë jetuar përgjatë Nilit, në Egjiptin e Vjetër, që nga periudha e Neolitit (5000-4000 vjetë para e.s.) kanë jetuar si të vendosur. Si rezultat i zhvillimit të shoqërisë fiset themeluan qytet-shtetet dhe prefekturat e tyre. Në periudha të ndryshme historike në krahinën e Egjiptit të Epërm dhe të Poshtëm (rajoni Delta) u krijuan mbretëri dhe prefekturat u bashkuan me mbretëritë. Mbretërit Nehen, me dominimin mbi shtetet e tjera mundësuan bashkimin kulturor dhe politik të Egjiptit. Ky zhvillim e lehtësoi kalimin në historinë e shkruar. Kah vitet 3100 para e.s. mbreti Menes bashkoi Egjiptin e Epërm dhe të Poshtëm. Për pasojë u themelua një kryeqytet i ri me emrin Menfis.

Ndërtimi i grupit të parë të piramidave të gurit, është realizuar në kohën e faraonit të dytë Coser, të brezit 3. (2686-1613 para e.s.). Kurse ndërtimi i piramidave madhështore të Keopsit, Kefrenit dhe Mikerinosit i takon periudhës të brezit 4. (2613-1494 para e.s.). Egjipti, njëri nga 2-3 shtetet më të zhvilluara të botës së vjetër, së pari u shkatërrua nga sulmi i asirianëve e më vonë, në shek. VI para e.s., nga sulmi i persianëve. Në vitin 332 para e.s. Leka (Aleksandri) i Madh, hyn në Egjipt dhe e fillon periudhën e sundimit të Maqedonisë. Egjipti, i shpëtuar nga sundimet e jashtme kohë pas kohe, deri në ardhjen e muslimanëve ka mbetur nën sundimin e romakëve.

1. Literatura fetare

Rrënjët e shkrimit hieroglif fillojnë me zhvillimin e piktografisë, duke filluar që para viteve 3100 para e.s. Supozohet se ky shkrim është zhvilluar dhe frymëzuar nga piktografia e sumerëve. Vetëm se është zhvilluar në forma të ndryshme: në Mesopotami ka marrë formën e një stili të shkrimit me kunjë, kurse në Egjipt janë bërë simbole figurative. Më dukshëm është zhvilluar në vitet 1686-2613 dhe është përdorur deri në përhapjen e krishterimit në shek II dhe III të erës sonë. Mbishkrimi hieroglif i fundit i njohur daton prej vitit 394 të e.s.

Prej zbërthimit të hieroglifëve e deri më sot janë bërë gërmime të shumta. Tekste me peshë janë gjetur në piramida, në gurët e varrezave, në muret e tempujve, në senduqe dhe në papiruse. Me rëndësi është që të përmendet emri i Librit të urtësive, i cili krahas tregimeve, vjershave dhe përrallave, përmban edhe parime etike. Gjithashtu janë gjetur tekste që përshkruajnë jetën e të vdekurve në varre, dhe tekste të vendosura apo të shkruara nëpër varre, me qëllim që të vdekurve t'u japin njohuri për botën tjetër. Në këto tekste mësohet se si i vdekuri mund të fitojë mirëqenien në jetën e re dhe se si zoti Oziris do të ringjallet përsëri. Tekstet piramidale, të shkruara në muret e piramidave, dhe "Tekstet e arkivoleve", të shkruara në skajet e arkivolit, i paraprijnë dhe janë shkallët e para të librit të njohur me emrin "Libri i të vdekurve". Në këto libra të vdekurit mësohen se si ta mbrojnë veten prej gjarpërinjve dhe prej viganëve (kuçedrave). Për këtë, në ato libra vend të rëndësishëm zënë fjalët dhe formulat magjike. Sidomos gjykimi i njerëzve është paraqitur me vizatime. Ky libër është më i vjetër në botë.

2. Koncepti për gjithësinë

Egjiptasit e vjetër, për dallim nga shumë popuj të tjerë, botën e konceptojnë mashkull, kurse qiellin femër. Për krijimin e botës në tekstet piramidale thuhet: *"Kur nuk ekzistonin njerëzit dhe zotat, kur nuk ekzistonte vdekja, në oqeanin e përhershëm kaotik u krijuan toka dhe uji"*. Ndërkaq për daljen në shesh të zotit Diell dhe të krijesave tjera, ka mitologji të panumërta. Megjithatë, egjiptasit qiellin e shohin si oqean. Kurse dielli, hëna dhe yjet me anije shëtisin nëpër këtë oqean. Dielli në mbrëmje kalon nëpër një lumë të errësirës nëntokësore dhe në çdo mëngjes përsëri paraqitet nga lindja.

Ata kanë punime edhe në lidhje me kalendarin. Një kalendar që është gjetur përafërsisht është rreth vitit 3000 para e.s. Ky kalendar ka filluar me paraqitjen e yllit Sirius. Viti në të është llogaritur si 365 ditësh.

3. Hyjnitë dhe fuqitë mbinatyrore

Yjet dhe fuqitë natyrore, bota e gjallesave dhe e të vdekurve, që në kohët më të hershme shiheshin si sundues të fatit. Konservatorizmi ishte një specifikë e egjiptianëve. Format më të vjetëra të kultit, si animizmi dhe spiritualizmi kanë jetuar një kohë të gjatë në këto troje. Kultet e vjetra të kafshëve nuk janë zhdukur, por, ato u janë bashkangjitur zotave të personifikuar. Zotat i kanë vizatuar me trup njeriu dhe me kokë kafshe. Isis është vizatuar me brirë lope, Horus me kokë skifteri, kurse zoti i të vdekurve Anubis me kokë çakalli. Kjo një kohë të gjatë i ka habitur të huajt. Sfenku (Sfinks) Giza, njëzet metra i lartë, është gdhendur në një gur të madh me trup kafshe dhe me fytyrë njeriu.

Në klasifikimin e llojeve të kafshëve që llogariten të shenjta, ndikim më të madh kanë kultet lokale. Për shembull, përreth Nilit menjëherë shihen zotat krokodilë, përreth shkretëtirës shihen zotat luanë. Megjithatë, te egjiptasit nuk haset në totemizëm, gjegjësisht besimi në konsiderimin e njeriut ose të klanit identik me një lloj të posaçëm të kafshëve. Kau, lopa, macja, gjarpëri dhe krokodili, të cilat adhurohen, konceptohen si zota të trupëzuar. Bota e zotave të Egjiptit nuk dallon shumë nga ajo e babilonasve. Krahas rëndësisë që kishin lumi Nil, hëna dhe yjet nuk janë llogaritur për zota.

Rëndësia e hyjnisë Diell ka qenë e madhe. Shpesh haset në emrin dhe format e tij. Ai ka qenë në

qendër të fesë egjiptiane. Emri më i vjetër dhe më i përhapur për hyjninë diell është Ra. Në kohën e fisit 5. (2500 para e.s.) është adhuruar si zoti më i lartë. Kurse me vonë në teologjinë Helyopolis „Ra“, është pranuar si gjyshi i hyjnive dhe „sundimtar hyjnor“ i ritrupëzuar në çdo faraon. Mitologji të ndryshme tregojnë se Ra, zoti i Diellit, me anijen e ditës udhëton nëpër oqeanin qiellor dhe në mbrëmje duke hypur në anijen e natës, shkon nëpër oqeanin e madh nëntokësor drejt lindjes, gjegjësisht drejt vendit ku lind dielli. Gjatë kësaj kohe, të vdekurit e përshëndesin Atë me këngë fetare dhe me lëvdata. Qyteti Helyopolis, që gjendet afër Kairos, ishte vendi më i madh i kultit Ra. Lutjet atij i bëheshin në një kodrinë, në nënqiell. Insekti i ngordhur i vizatuar në shumë gurëz të vulosur dhe në shumë nuska, nuk ishte vetëm simboli i vdekjes dhe i rilindjes, por në të njëjtën kohë ishte edhe simboli i Ra-së, zotit të Diellit, por në këtë trajtë hasej më rrallë. Shumë zota, që në fillim ishin zota lokale, gjatë kohës janë bashkuar në zotin Ra. Mbreti zot Horus ishte njëri nga këta. Ishte bërë zot i mrekullueshëm i shtetit të ri. Gjithashtu edhe Amoni, zoti lokal i qytetit Teben, pasi që Tebeni u bë kryeqytet, u bashkua me „Ra“-në dhe kështu me emrin „Amon-Re“ një mijë vjet me radhë, u bë një zot i njohur i Perandorisë së Re.

Kryemurgu i kultit Amon-Re ishte personaliteti më i lartë i shtetit, menjëherë pas faraonit. Kurse tempulli, ishte i pasur dhe plotë me pre lufte. Murgjit Amon-Re ishin ndikuesit më të mëdhenj politikë. Mbeturinat e këtij kulti të vjetër të diellit, që ka rëndësi të veçantë në aspektin e historisë së artit, sot gjenden në fshatin Karnak.

Krahas zotave të diellit vend të rëndësishëm zë edhe zoti krijues Ptah, i cili ekziston që në periudhën më të vjetër. Ptahu adhurohej dhe respektohej në kryeqytetin e vjetër, Menfis. Ai ishte zoti i vetëm i vizatuar gjithmonë në formë të njeriut. Sidomos ishte mbrojtësi i artistëve. Më vonë u bashkua me Ozirisin dhe Sokarin, zot i varrit dhe i të vdekurve, përplot me mistere. Gruaja e tij ishte Zehmet, hyjneshë e luftës me kokë luani. Ajo njerëzve u çonte sëmundje ngjitëse. Disa herë është llogaritur e njëjtë me Ptahin. Ndërkaq vendi kryesor i mëzatit të shenjtë Apis ishte Memfisi. Kult i tij, deri vonë është përhapur me forcë dhe ka vazhduar të ekzistojë. Kurse në disa raste adhurohej me emrin Serapis. Deri më sot janë gjetur shumë kufoma të balsamosura mëzeterish të zinj.

Në mesin e hyjneshave vend të rëndësishëm zë edhe Izisi. Ajo, duke e rritur autoritetin e saj në periudhën e fundit të fesë së Egjiptit, zuri pozitën më të lartë në botën e zotave. Sidomos kulti e saj, në kohën e perandorit Kaligula, u përhap në tërë Perandorinë Romake, sa që në Pompei është gjetur një tempull i Izisit. Izisi, sikur që është parë në formën e Marisë, ajo është vizatuar edhe me një fëmi në kraharor, si mbikqyrëse e Horusit, djalë i saj. Ajo, si nënë e mëshirshme është pëlqyer shumë. Në shikim të parë bie në sy lidhja e afërt e saj me kultin e Marias në Krishterim. Gjithashtu edhe burri i saj Ozirisi ka një vend të rëndësishëm. Sipas mitologjisë për të, Ozirisi mashtrohet nga vëllai i tij Set-hi dhe mbyllet në një sënduk dhe mbytet. Trupi i tij, i hedhur bashkë me sëndukun në lumin Nil, lundron Biblosit në Siri. Sipas një lajmi tjetër, trupi i tij është copëtuar dhe është shpërndarë në të gjitha shtetet. Vetëm se gruaja e tij Izisi, atë e kërkon me një britmë vdekjeje. Si përfundim, syri i djalit të tij, Horusit, të cilin Horusi e ka humbur në luftë me Sethin, i jepet si ilaç Ozirisit dhe ai ngjallet. Pas kësaj Ozirisi bëhet sundimtar i botës nëntokësore. Ndërkaq Horusi, llogaritet sundimtar i botës dhe paraardhës i të gjithë faraonëve, gjegjësisht faraonët llogariten inkarnim i tij ose forma trupore e tij.

Vdekja e Ozirisit, në periudhën e vjetër ka patur kuptimin e vdekjes dhe ringjalljes së natyrës, ripërtëritjes së natyrës, që në Mesopotami i ngjan Temmuzit, në Siri Attisit dhe Adonisit. Ozirisi shihet në karakterin e zotit të bimëve. Edhe në fetë mistere greke ka luajtur rol të rëndësishëm. Në Egjiptin e vjetër është lartësuar në mesin e shumë kulteve dhe zotave dhe kështu është bërë zot kombëtar i Egjiptit. Sa që kulti i tij, nëpërmjet tregtarëve dhe grupacioneve egjiptiane është përhapur në tërë Mesdheun, ka arritur deri në vendet e Danubit.

Në mesin e zotave të Egjiptit të Vjetër, vend të rëndësishëm zë edhe Hatori, hyjnesha e lopës. Pikturat e saj i simbolizon pamja e diellit mes dy brirëve të lopës. Llogaritet hyjneshë e grave dhe e dashurisë së lirë. Hyjnesha Basted vizatohet me kokë të maces dhe me trup gruaje. Ajo ishte hyjneshë e dëfrimit. Adhurohej me muzikë dhe vallëzim. Macja, për shkak se Bastedi paraqitej në formë të saj, për egjiptianët llogaritej kafshë e shenjtë dhe ishte varrosur e balsamosur. Kurse Mut, me kokë luani, në Teben në fillim ishte hyjneshë e diellit dhe e qiellit, pastaj u bë hyjneshë e luftës.

4. Amonefisi dhe iniciativa për reforma

Një shekull e gjysëm para profetit Musa, përafërsisht në kohën kur profeti Jusuf ka qenë në Egjipt, nga fisi 18, mbreti i ri Amonefisi IV (1377-1358) doli në shesh si reformator fetar. I ndaloi të gjithë zotat e Egjiptit dhe në vend të tyre vendosi pamjen e diellit të quajtur Aton, që është një dhe i gjallë në qiell. Puna e tij ishte një lloj monoteizmi, gjegjësisht ishte besim në një zot. Edhe veten e mbiquajti me titullin Eknaton (Atonit i pëlqeu). Por, pas reagimit të murgjëve Amon kryesinë e shtetit e barti prej Tebeni në qytetin Tell el-Amarna, në Egjiptin e Mesëm. Gradualisht figurat njerëzore me koka kafshësh dhe emrat e tjerë të zotave u zhdukën. Edhe emri Oziris ishte fshirë në tempuj të ndryshëm. Në ceremoni lexoheshin këngë fetare për diellin, të shkruara nga Eknatoni si poet. Kurse për vdekjen dhe drejtësinë e zotit, Eknatoni nuk ka bërë ndonjë shpjegim. Vetëm se, murgjit lëvizjen reformatore të Eknatonit, e shihnin si herezi dhe humbjen e disa tokave në Azi e komentonin si dënim i zotave të nervozuar me të.

Djali i tij Tutanhamuni, i cili vjen në pushtet pas vdekjes së Eknatonit, nuk e vazhdoi rrugën e babait të tij, por, u kthye në kryeqytetin e vjetër, në Teben. Zotin Amon-Ra përsëri e vendosi në vendin e mëparshëm. Pas kësaj Amon-Ra ishte më i madh, kurse zotat e tjerë ishin ndihmës hyjnorë. Trupi i Tutanhamunit, i cili ka vdekur në moshë të re, nga murgjit falënderues është vendosur në një sënduk prej ari dhe është varrosur plotë me perla.

5. Jusufi/Josefi

Jusufi (shek. 14 para e.s.) ka lindur në Harran dhe është biri i Jakubit/Jakobit dhe gruas së tij Rahelit. Nëna e tij ka vdekur në rrugë për në Palestinë, gjatë lindjes së Benjamin. Babai i Jusufit më tepër interesohet për të se sa për djemtë e tjerë, pasi që Jusufi ishte djali më i vogël i familjes dhe jetim. Ka mundësi që edhe Is'haku të ishte interesuar pak më tepër për të. Këtu ka ndikim edhe simpatia ndaj tij. Vetëm se kjo u bë shkak për armiqësinë dhe xhelozinë e vëllezërve të tij. Vëllezërit filluan të bëjnë plane për të shpëtuar prej tij. Edhe pse në fillim mendonin ta mbytnin, më vonë zgjodhën rrugën e shpëtimit duke e hedhur në pus. Kurse babait të tyre i thanë se e ka ngrënë ujku.⁵⁷ Atë e gjetën karvanierët e Medjenit dhe e dërguan në Egjipt. Atje ia shitën si skllav Potifarit, njërit nga punëtorët e faraonit. Edhe pse Jusufi zotërisë të tij i shërbente me drejtësi, ai përsëri u spiunua dhe u fajësua me tradhëti. U burgos. Por, me të komentuarit e drejtë të ëndrrës së faraonit doli nga burgu. Kështu e fitoi besimin e faraonit dhe u bë mbrojtësi i depos së ushqimit.

Ai me vëllezërit e tij u takua atëherë kur ata, për shkak të krizës për ushqim, kanë shkuar në Egjipt për të marrë grurë. Dhe kështu, nëpërmjet kësaj Jusufit iu mundësua që babain dhe tërë familjen e tij ta marrë në Egjipt dhe të vendosen atje. Në këtë mënyrë filloi jeta e Bijve të Izraelit në Egjipt.⁵⁸ Jusufi vdiq në moshën 110 vjeçare. Ai u varros i balsamosur sipas traditës egjiptiane.⁵⁹ Ka mundësi që ardhja e Jusufit në Egjipt të rastis në kohën e Amonefisit IV. Në tyrbenë e një njeriu me emrin Tutu, e zbuluar në Tell el-Amarna, shkruan se ai është kryeshërbyesi i mbretit, ndjekës i punëve të zotuar, kontrollues i depove dhe se rrjedh nga fisi semit.⁶⁰ Këto njohuri i pasqyrojnë të gjitha specifikat dhe detyrat e Jusufit. Dallimi në emër dhe ndryshimi i emrit mund të jetë nga gjuha egjiptiane. Për pasojë Tutu është emri i Jusufit në Egjipt.

Mbrojtjen e monoteizmit, luftën kundër politeizmit, ndalimin e adhurimit të idhujve, fillimin e reformave dhe tendenca në këtë drejtim nga Amonefisi IV, sikur duket e ka bërë Jusufi. Është e

⁵⁷ Dhiata e Vjetër, *Zanafilla*, XXXVIII.

⁵⁸ *Zanafilla*, XXXIX-IIIIL.

⁵⁹ *Zanafilla*, L, (Kapitulli 50).

⁶⁰ R. de Vaux, *İsrail Oğullarının Mısır'a Yerleşmesi ve Yusuf Kıssası*, 19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, V. 3, Samsun 1989, f. 176-177.

pamundur që të shpjegohet në një mënyrë tjetër. Ndërkaq Kur'ani tregon se Jusufi në Egjipt nuk ka hequr dorë prej misionit të tij dhe se atje ka patur edhe prej atyre që i kanë besuar atij.⁶¹ Shpresojmë se, dituritë dhe dokumentacionet që do të zbulohen në të ardhmen do ta qartësojnë edhe më mirë këtë temë.

6. Faraoni dhe murgjit

Mbretëria teokratike e Egjiptit, e themeluar në bazë të sistemit shtetëror, është organizata më e vjetër e botës. Faraoni, si bir i zotit diell, në jetë llogaritej si një zot. Vetëm se adhurimi zyrtar që bëhej ndaj faraonëve, fillon pas vdekjes së tyre. Ai emërohej si dielli që jeton ose si pasqyrim i diellit në tokë. Për të mbrojtur natyrën e tyre hyjnore, ishte kusht që të martohen me motrat e tyre. Kurse sipas teologjisë së Helyopolisit, zoti Amon-Re merr pamjen e çdo faraoni, i cili ka autoritet. Në tempull faraoni përballë zotit është ekzistenca e vetme hyjnore. Ishte i obliguar që të udhëheqë rite dhe ceremoni të ndryshme flijimi. Për këtë gjë murgjit llogariten zëvendës të tij.

Murgjit, si nëpunës shtetërorë, janë shpërndarë në tërë territorin e shtetit. Në mëngjes hapin derën e tempullit dhe i zgjojnë zotat, i mbulojnë me mbulesa madhështore, u japin gjëra ushqimore dhe për nder të tyre e aromatizonin hapësirën me erëra të mira. Në ceremonitë, me vete mbanin edhe pikturat e zotave.

7. Koncepti për jetën pas vdekjes

Konceptin e egjiptianëve për jetën pas vdekjes, e kuptojmë nga tekstet papiruse dhe mbishkrimet në piramida. Egjiptianët besojnë se njeriu i vdekur vazhdon të jetojë në varr. Për këtë arsye në varre lënë ushqime dhe pije. Në kohë të caktuara të vdekurve u therin edhe kurban. Veprimet, si vajimi i të vdekurit dhe balsamosja e tij, që shihen që në periudhën e perandorive të vjetra, kanë të bëjnë me jetën pas vdekjes. Njeriu, sipas egjiptianëve, përbëhet prej pesë pjesëve: Një trup, një emër, një ah (hije), një ba dhe një ka. Është shumë vështirë që, tre termat e përmendur më në fund, të shpjegohen apo të përkufizohen. Kurse shpjegimet e bëra deri më tash janë të diskutueshme. Ka mundësi që të kishin pësuar ndryshime mijëra vjet me rradhë. Ah është fuqi hyjnore. Pas ceremonisë së shndrritjes kalon në njeriun. Ba është një lloj shpirti i përfytyruar në formë të zogut. Ai shkon në qiell dhe i viziton të balsamosurit në varre. Ai mund të marrë forma të ndryshme. Ka është personifikim i fuqisë së jetës dhe përfytyrohet si zanë mbrojtëse. Ka, lind bashkë me njeriun, por ai vazhdon të jetojë edhe pas vdekjes dhe ushqehet me ushqimet që u ofrohen të vdekurve.

Kujdesi që tregohet ndaj të vdekurve është një traditë balsamosjeje me zanafillë që në kohën e vjetër, kurse përsosshmërinë e ka arritur në periudhën e perandorisë së re. Kjo traditë, tregon qartë besimin në jetën e vazhdueshme të të vdekurve në varr. Vetëm se nga kjo është shumë vështirë të konkludohet në mënyrë decide se ekziston besimi se të vdekurit vazhdojnë të jetojnë në një botë tjetër.

Edhe në përfytyrimin e botës tjetër, ballafaqohemi me mendime të ndryshme. Në fillim egjiptianët supozonin se të vdekurit jetojnë në një vend të largët. Kurse më vonë, shohim se besojnë se ata që janë larguar nga bota jetojnë në qiell, ku kanë hipur me shkallë. Këtu shpirtërat, bashkë me zotin e diellit, me anijen e tij (zotit të diellit) e shëtisin botën.

Ndërkaq sipas një mësimi tjetër, shkojnë në botën nëntokësore të Ozirisit. Atje, sipas asaj që përshkruhet në „*Librin e të vdekurve*“, bëhet gjykimi i të vdekurve. Ozirisi ulet në fronin e tij, hyjnesha e të vërtetës Maat e sjell brenda të vdekurin, zemrën e të vdekurit e matin Horusi, me kokë skifteri, dhe Anubisi, me kokë çakalli. Sekretari zot me emrin Thot' e shkruan përfundimin dhe e lajmëron Ozirisin. I vdekuri përpara 42 gjykatësve, të cilët gjenden rreth e përqark Ozirisit, tregon se s'ka bërë asnjë të keqe. Nëse, ajo që e thotë përputhet me realitetin mëshirohet. Këtu nuk ka monoteizëm, por shihet një

⁶¹ Kur'ani, Jusuf, 40; Këto lajme tradicionale i plotëson edhe arkeologjia.

koncept për një zot mbinatyror. Ndërkaq disa piktura që përshkruajnë dënimin e ferrit për të dënuarit, kanë mbetur nga periudhat e mëvonshme. Ka mundësi që të jenë edhe mbeturina nga misioni i pejgamberëve të Allahut të dërguar te ata.

FETË NË ANADOLLIN E VJETËR

Literatura: Hikmet Tanyu, *Dinler Tarihi Araştırmaları*, Ankara 1973, f.98-120; U. Bahadır Alkım, *Anatolien I*, Gef 1968; James Mellaart, *Excavation at Hacilar*, Edinbur 1970, V. I-II; K. Kınal, *Eski Anadolu Tarihi*, Ankara 1962; Tahsin Özgüç, *On tarihte Anadolu İdollerinin Anlamı*, Dil ve Tarih Coğrafya Fak. Der., V. II, n. I, Ankara 1943; Tahsin Özgüç, *Die Bestattungsbräuche im vorgeschichtlichen Anatolien*, Ankara 1948.

Periudha parahistorike e Anadollit fillon prej errësirës historike e deri te hititët (2100-1800 para e.s.). Në këtë kohë, me fillimin e përdorimit të shkrimit hieroglif dhe kunjor nga hititët, të cilin e kanë mësuar prej të afërmeve të tyre, Anadollit fillon të hyjë në periudhën historike. Ndërkaq njohuria jonë për periudhat parahistorike kryekëput bazohet në arritjet shkencore të gjeologjisë dhe arkeologjisë. Nga gjurmimet e bëra në rajone të ndryshme shihet se në Anadoll njeriu ka jetuar që në Periudhën e Gurit. Këtë çështje e ndriçojnë zbulimet e bëra gjatë gjurmimeve në rrethin e Ankarasë, në Antalia, në Burdur si dhe në afërsi të Ispartasë, përreth Karsit, në rajonin e Gaziantepit dhe Adijamanit, në rrethinën e Antakisë si dhe në İkiztepe të Bafras.



1. Besimet parahistorike

Momentalisht është e pamundur që me anë të zbulimeve për periudhën parahistorike dhe periudhën paleolite të fitohet dituri lidhur me besimet e asaj kohe. Zbulimet, të cilat u japin mundësi komenteve fetare, fillojnë në Periudhën Neolitike (Koha e Re e Gurit). Sinjalin e parë në këtë fushë na e kanë dhënë gjurmimet në Çatalhöyük. Sipas datave të përgatitura në bazë të metodës radio-karbonike, shtresa XII. zbrit deri në vitet 6800 para e.s. Shtresa I. zbrit deri në vitet 5700 para e.s. Në dhomat e kultit, që hasen në masë të madhe mes shtresave III.-X., gjenden statuja të hyjneshës kryesore të bëra prej argjili, koka dhe brirë mëzetësh, reliefe kraharorësh të grave. Hyjnesha kryesore është përfytyruar si grua e re, grua që lind dhe grua plakë. Në njërin nga statujat, hyjnesha kryesore është përfytyruar në qëndrim ulur mbi fronin e mbrojtur prej dy luanëve dhe në atë mënyrë që kokën e njeriut e ka marrë nën këmbë. Statujat e hyjneshave, në përgjithësi, janë bërë me pamje të njeriut (*pamje antropomorfe*). Numër i madh i statujave të hyjneshave të zbuluara në Çatalhöyük dhe bile edhe në shembuj më të zhvilluar nga ata, është hasur në gjurmimet e bëra në qytezën Hacilar të Burdurit. Vetëm Hacilar daton nga vitet 5700-5600 para e.s. dhe më vonë. Gjatë kësaj kohe në Hacilar, sikur në Çatalhöyük, është hasur edhe në statuja meshkujsh, të cilat, si bashkëshortë të hyjneshës kryesore, janë përfytyruar në formë të re dhe të plakur. Simbolet e hyjneshës kryesore të zbuluara në rrethin e qytetit Isparta, i cili gjendet në një krahinë afër Hacilarit, arrijnë deri në periudhën e bronzit. Me përparimin e gjurmimeve ka mundësi që të shkohet në periudhat edhe më të largëta. Edhe në gjurmimet në İkiztepe të Bafrasë, haset në numër të shumtë të figurave të hyjneshës kryesore, të cilat datojnë që në periudhën e bronzit, të bëra nga dheu i pjekur. Këto janë të ekspozuara në muzeun arkeologjik të Samsunit (Turqi). Ngjarja e tufanit të Nuhit në rajonin e Palestinës, është shenjë që tregon nivelin e përhapjes së politeizmit dhe të idhujtarisë në Anadoll.

S'ka dyshim se statujat e grave të zhveshura, me organe gjentile të theksuara, që gjenden në dhomat e kultit nëpër vendet e vjetra të banuara, janë bërë për adhurim, gje gjegjësisht janë bërë për qëllime fetare. Shembuj të qartë të këtyre gjërave në masë të madhe, hasen në periudhat historike. Në zbulimet e periudhës së gurit-bakërit statujat e hyjneshës kryesore fitojnë edhe më tepër rëndësi. Vetëm se, në këtë kohë gradualisht braktisen skulpturat hyjnore të meshkujve, statujat shkojnë drejt asaj që të jenë simbolike dhe të stilizohen. Besimi në Hyjneshën Kryesore shihet në fusha të ndryshme të jetës. Edhe mbi vazo dhe mbi qeramika, haset në kraharorë grash që simbolizojnë hyjneshën kryesore. Këtë mendim tonin e vërteton edhe skulptura e kraharorit të hyjneshës kryesore, e gjetur në Kültepe Karum

të Kayserit, e cila i takon shek. 18 para e.s. Simbolet e Hyjneshës Kryesore mbi vazo dhe enë, mund të jenë edhe nuska të bëra për mbrojtjen dhe shtimin e ushqimeve dhe pijeve. Gjithashtu edhe format gjeometrike të rrumbullakta mbi rrethet e futura njëra në tjetrën dhe në drugë, të cilat janë të ngjyrosura mbi disa enë prej dheu, mund të jenë simbole kraharorësh të stilizuara që reflektojnë kultin e prodhimit, kultin e hyjneshës kryesore.

Këto besime ndaj hyjneshës kryesore që i shohim në periudhat neolitike dhe kalkolitike, në Anadoll janë zhvilluar më tepër se në shtetet fqinje dhe në periudha të ndryshme historike kanë përgatitur kultin e njohur Kubele. Vetëm se nuk mund të dimë, përveç asaj që e pamë në besime primitive jashtë këtij besimi, a ekziston një koncept për zotin, i cili për dallim nga zotat e tjerë mendohet si abstrakt, krijues dhe si një zot që posedon dëshirë të lirë dhe fuqi të pakufizuar. Kurse në periudhat e mëvonshme, në periudhën e kolonive para hititëve, shohim se edhe në Anadoll, paralel me besimet fetare në shtetet fqinje, filluan të shihen koncepte për zotin. Dolën në shesh familje zotash të përbëra prej djemve dhe etërve si në Egjipt dhe në Mesopotami. Kështu që shihet se çdo zotit i është dhënë një forcë dhe detyrë e caktuar.

a. Kafshët e shenjta

Në historinë e feve hasim në shembuj të ndryshëm në lidhje me shenjtërimin e disa llojeve të kafshëve. Edhe prej gërmimeve të bëra në Anadoll, kuptohet se disa kafshëve u është dhënë më tepër rëndësi. Në muret e dhomave të kultit në qytezën Çatalhoyuk të Çumrasë, Konya, është hasur në brirë dhe koka mëzetësh dhe në vizatime leopardash. Në disa reliefe hyjneshë kryesore përfytyrohet si një që lind kryemëzatin dhe kryedashin. Gjithashtu në Ikiztepe të Bafrasë dhe në Beycesultan të Çivrilit, Denizli, janë gjetur reliefe dhe brirë të stilizuar mëzetësh, të cilat i takojnë periudhës së hershme të Bronzit. Nga këto, sikur që ishte në Siri dhe Egjipt, mëzati kuptohet si simbol i zotit të prodhimit, ose kafsha e shenjtë e zotit të prodhimit. Po ashtu supozohet se mëzati simbolizon hyjnitë mashkullore, kurse dreri hyjnitë femërore. Varrimi në masë të madhe dhe në mënyrë të rregullt të kokave të mëzetëve në Demircihoyuk⁶², mes Eskişehirit dhe Bozoyukit, që datojnë nga periudha e hershme kalkolitike, më vonë dalja në shesh e një numri të madh të tyre në krahinën Frig'ja⁶³, nuk lë dyshim se mëzati i është dhënë një domethënie fetare.

Në Çatalhoyuk, në murin e dhomës së një kultit në shtresën VII. është hasur në shëmbëlltyrën e skifterit, i cili i vërsulet një trupi. Kjo simbolizon se ky skifter ka mundësi që të ketë lidhje me vdekjen ose me zotin e të vdekurve. Vetëm se, mbetja e saj vetëm si shëmbëlltyrë nuk jep mundësi që ky kuptim fetar të gjeneralizohet.

b. Kultet

Në bazë të disa zbulimeve në disa vende gërmimi, si në Çatalhoyuk të Çumrasë, në Alishar të Jozgatit, në Ahlatlibel të Haymanas. në Demircihoyuk të Eskişehirit, në Ikiztepe të Bafrasë etj., njeriu anadollian i Periudhës Kalkolitike, si përfaqësues të zotit dhe kafshëve të shenjta, ka bërë idhuj prej guri dhe argjili. Në fillim këto ishin me trup të rrumbullakët ose katror, por me kohë kanë marrë formën e njeriut. Mendohet se këta idhuj janë përdorur për t'u mbrojtur prej çdo fatkeqësie dhe sëmundjeje dhe me qëllim kurbanit, premtimi ose magjie. Arkeologu ekspert Tahsin Özgüç, supozon se figura e gruas bashkë me kultin e hyjneshës kryesore, ka mundësi që të përfaqësojnë zotat e shtëpisë dhe të familjes, se ata luajnë rolin e një lloji nuske e cila përmban fuqi për mbrojtjen e shëndetit, bereqetit dhe sigurisë dhe se, ato janë gjëra që njeriun e mbrojnë prej mësyshit dhe prej fuqive ugurzez.

Gjurmët e dorës dhe këmbës në muret e dhomës së kultit, të gjetura në Çatalhoyuk, vizatime të gjurmëve të gishtërinjve, kokat e stilizuara të mëzetëve, vizatimet e sëpatave me dy fytyra, mund të jenë simbole që posedojnë fuqi magjike mbrojtëse. Gjithashtu edhe paraqitja e rrëmujës në vallëzim e mbështjellur me lëkurën e leopardit, në njërin nga pikturat e murit në dhomën e kultit, përdorimi i një instrumenti, paraqitja e lëvizjeve akrobatike prej pjesëve të tyre,

⁶² Manfred Korfmann, *Demircihoyuk*, Türk Arkeoloji Der., XXV-1, Ankara 1981, f. 145.

⁶³ Vep. e cit., XXIV-2, f. 47.

pasja në duart e disave shtizë dhe bark, sikur që i përkujtojnë vallëzimet e gjuetisë dhe të kultit në Shamanizëm. Paraqitja e pikturave të kaut, drerit, derrit, ariut, ujkut dhe qenit, tregon mundësinë se shëmbëlltyra mund të jetë një magji gjuetie.

c. Kulti i të vdekurve

Zbulimi i varreve dhe i varrezave të periudhës parahistorike, na jep disa shenja për besimin e njerëzve të asaj kohe. Fëmijët që kanë vdekur gjatë kësaj periudhe janë varrosur kryesisht në shtëpitë e tyre, nën themel ose nën oxhak. Shkaku i varrimit të fëmijëve brenda në shtëpi është bindja se ata nuk janë ngopur me shtëpinë e tyre dhe besimi se ata shpirtërisht e ndjekin jetën e familjes së tyre. Përveç kësaj, në Tekkekoj të Samsunit dhe në Sandıklı Kusura është parë se fëmijët janë varrosur jashtë shtëpive.

Trupi i të vdekurve lihej në vendin ku ishte varrosur deri në prishje, kurse pastaj dërgohej në shtëpinë e të vdekurve. Vepronin kështu pasi ata besonin se shpirti, deri në prishjen e trupit, qëndron bashkë me të. Varret prej dheu, qypi dhe sandëku përdorshin edhe për të vdekurin e dytë apo të tretë. Në këto raste, eshtrat e të vdekurit të parë shmangeshin në një anë. Kjo çështje thua se është e njëjtë në të gjitha kulturat e rajonit. Ndoshta këto janë varreza familjare, që janë formuar nga shkaku i vendit të ngushtë. Por, mund të kenë lidhje edhe me besimin në botën tjetër, i cili varet prej vendit ose kohës. Në Anadollin perëndimor në mënyrë permanente deri në vitin 1200 para e.s. haset në dhoma varrezash.

Në varret në Anadoll shihet edhe pasuria personale e të vdekurve. Këto janë thika, bylyzikë, vathë, sëpata, fortësa si dhe mjete kulturore të cilat i vdekuri i ka përdorur në jetën e tij. Bylyzikët dhe vathët janë varrosur bashkë me të vdekurin pa mos u hequr nga ai. Në Alacahoyuk të Çorumit është hasur në mbeturina eshtrash dhe qypash të varur në një çengel mishi. Kjo tregon se disa pjesë të kurbanëve që janë prerë për të vdekurit, u janë dhuruar atyre.

Banori parahistorik i Anadollit ka besuar se njeriu pas vdekjes jeton, ushqehet, pi dhe se vazhdon t'i përdorë mjetet e tij. Në mesin e gjërave që janë gjetur nëpër varreza, në Horoztepe të Tokatit, janë gjetur edhe instrumente muzikore, si sistrumi dhe çapare. Pasi që besohej se ata i shfrytëzonin edhe dhuratat për ushqim dhe pije, gjërat e nevojshme i varrosnin bashkë me të vdekurin. Eshtrat e lopëve, dhive, qenve dhe dhenve përreth varreve tregojnë praktikimin e sakrifikimit tek varri i të vdekurit.

ç. Vendet e kultit dhe tempujt

Në Anadoll, deri në vitet 2000 para e.s., populli si vend për adhurim zgjidhte o një hapësirë të shenjtë në natyrë, o e ndante një dhomë nga shtëpia ku banonte. Nga kjo praktikë e fundit, kanë dalur në shesh dhomat e kultit. Shembull i qartë për këtë janë 40 dhomat e kultit që gjenden mes shtresave 3-10 në Çatalhöyük. Nga kjo kuptohet se në periudhën neolitike, gati se në çdo shtëpi ka patur një dhomë që është përdorur për kult. Vazhdimin e kësaj tradite e shohim edhe në periudhën kalkolitike në nënprefekturën Hacılar (Haxhëllar).

Lokali i kultit Bejxhesulltan nuk është në formë të një dhome, por ai është i gjerë dhe përbëhet prej dy dhomave. Të këtij lloji janë gjetur tre çifte tempujsh. Këto ndërtesa të quajtura „*dhomat bineq të kultit*“, krahas disa ndryshimeve të vogla, nuk e kanë humbur rëndësinë që e kanë patur në fund të periudhës së bronzit. Dhomat bineq të kultit Bejxhesulltan, përbëhen prej tre pjesëve: hyrja, altari dhe dhoma për shërbyesit fetarë. Në Anadollin e periudhës së bronzit, në gjermimet që janë bërë në vende të ndryshme, shihet se janë ndërtuar edhe tempuj të ngjashëm. Për këtë edhe rëndësia e monumenteve fetare të Bejxhesulltanit është e madhe. Ajo ka qenë edhe një model i mirë për ndërtimin e tempujve të mëvonshëm.

2. Feja e hititëve

Literatura: Firuzen Kinal, *Eski Anadolu Tarihi*, Ankara 1962. f.204-226; Eduart Meyer, *Geschichte des Altertums*, v.1-2, Stuttgart 1954, f.713-719; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f.193-197.

Hititët, në krahinën e Anadollit, janë të parët që e kanë përdorur shkrimin dhe të parët kanë lënë dokumente të shkruara në lidhje me besimin dhe adhurimin e tyre. Tre të katërtat e dokumentacioneve të arkivit shtetëror, të zbuluara në Boğazkoy (Hatuşas) të Çorumit, janë tekste fetare. Këta janë shkrime që tregojnë për rregulloret e tempullit, për fjalët magjike kundër disa sëmundjeve dhe për metodën e flijimit të kurbanit për shpëtimin e mëkateve të kryera. Po ashtu edhe tekstet që i përshkruajnë hyjnitë, luajnë rol në njohjen e statuve dhe skulpturave të hyjnive. Ato gjithashtu kanë luajtur edhe rolin e urës, për bartjen e politeizmit të Mesopotamisë në Perëndim.



Përveç këtyre dokumentacioneve fetare që i jep arkivi Boğazkoy, edhe materialet arkeologjike i plotësojnë dhe i vërtetojnë njohuritë e këtyre dokumenteve fetare. Pas këtyre vijnë materialet e Shkëmbit të shkruar, që është një tempull në hapësirë, në muret e të cilit gjenden vizatimet e zotave. Këtu gati se çdo zot është paraqitur me simbolin e tij dhe mbi duart e secilit me hieroglifet hitite janë shkruar emrat e tyre. Vetëm se, hieroglifet hitite ende nuk mund të lexohen, prandaj disa pika ende kanë mbetur të panjohura.

a. Zotat e hititëve

Siç kuptohet nga hulumtimet e bëra deri më sot, besimi i hititëve (përafërsisht në vitet 1850-700 para e.s.), si populli i parë historik në Anadoll, ishte besim politeist. Gjithashtu edhe në tekste të tjera bëhet fjalë për “mijëra zota”. Shkaku është se, hititët, përveç zotave të tyre, një kohë i kanë adhuruar edhe zotat e popujve të mëparshëm të Anadollit. Për këtë, në panteonin hitit pranë zotave të tyre si *Proto-Hatti*, *Luvi*, *Hurri*, *Mitanni*, kanë marrë pjesë edhe zotat e *sumerëve*, *akadëve* dhe *asurëve* dhe kështu panteoni hitit ka patur një karakter kozmopolit.

Te hititët respekt të veçant ka patur triniteti Anu, Enlil dhe Ea, të cilët janë përfaqësues të zotave të qiellit, tokës dhe oqeanit. Gjithashtu në panteonin hitit ka bërë pjesë edhe triniteti Sin, Shamash dhe Ishtar, zota të hënës, diellit dhe yjeve. Përveç këtyre, që në kohën e Proto-Hattitëve, është adhuruar zoti Asur dhe kryezoti i qytetit Kish të Mesopotamisë, Zababa.

Prej përmendjes së emrave të zotave dhe lutjeve të vendasve të Anadollit shihet se janë adhuruar edhe zotat e proto-hattitëve. Nga këta zota më të njohur janë zotat Vurushemu, që njihet me titullin “hyjnesha e diellit në qytetin Arinna”, i biri i saj Telipunu, vajza Mazullash dhe nipi Zintuhu.

Kurse sa u përket zotave Luvi, disa prej tyre ende janë të diskutueshëm. Zoti më i rëndësishëm Luvi të cilin e adhurojnë hititët, llogaritet Dattashi, sunduesi i furtunës.

Ndërkaq zotat Mitanni më tepër hasen në dokumentacionet e “shtetit të ri”. Sidomos pas dominimit të hititëve pjesa veriore e Sirisë, e cila ka mbetur nën ndikimin e kulturës Hurri-Mitanni, është lëshuar në rrjedhat e kulturës së re. Zotat Mitanni, si Indra, Mitra dhe Varuna janë zota me origjinë nga India.

Hititët kanë patur interesim të madh, sidomos, ndaj fesë së popullit hurri. Kështu që, në tekstet hitite përmenden qindra emra të zotave hurri. Madje kryezoti hurri, Teshup dhe gruaja e tij, Hepat, janë bërë kryezota të panteonit hitit.

Ndërsa në mesin e zotave kombëtarë hititë, më të njohurit kanë qenë Teshup, zoti i furtunës, gruaja e tij hyjnesha Hepat, zoti i detit Aruna, zoti i vatrës Hashshash, zoti i diellit Utu, zoti i zjarrit Pahhur, zoti i burimit Shuppilulia, zoti i dashurisë dhe i luftës Lelvani, zoti i stërgjyshërve Shuinash.

Nga këta zota kuptojmë se edhe hititët, sikur romakët kanë besuar kultin e vatrës dhe të stërgjyshërve, kurse ngjashëm me babilonasit kanë besuar në kultin e zjarrit dhe të diellit. Në një tekst

thuhet “Mbreti trim Shamash, mbreti i tokës dhe i qiellit, sunduesi i asaj që është lart dhe i asaj që është poshtë, ligjdhënës”. Ky tekst tregon se në mesin e hititëve rol të rëndësishëm ka luajtur edhe kulti i diellit që ka ardhur nga Mesopotamia.

Qoftë tekstet e shkruara qoftë ato të gdhendura, nuk lënë dyshim se hititët zotat e tyre i kanë përfytyruar në formë të njeriut. Zoti është në rolin e zotërisë, kurse njeriu në rolin e robit. Pra, ashtu sikur që robi, për realizimin e një dëshire të tij i lutet zotërisë të tij, ashtu edhe njeriu i lutet zotit të tij, dhe kështu zoti apo zotëria atij i përgjigjet. Në anën tjetër, hititët mbretin e tyre që vdes e konsideronin se “u bë zot”, dhe kjo tregon besimin e tyre në shenjtërimin e mbretërve. Gjithashtu, me përfytyrimin e zotave të tyre si njerëz, tregojnë besimin e tyre në atë se zoti ka nevojë materiale dhe shpirtërore dhe se posedon shtëpi, fëmijë, ndjen dashuri dhe se hakmerret.

b. Adhurimet

Burimet ekzistuese nuk tregojnë për adhurimet kolektive të hititëve. Kurse në to adhurimet e mbretit dhe të mbretëreshës, të cilat i realizojnë gjatë ceremonive të festave dhe të kurbanëve, zënë një vend të rëndësishëm. Kushti i parë i adhurimit tek ata është pastërtia. Pastërtia është kusht i parë për hyrjen në shtëpinë e zotave, gjegjësisht për hyrje në tempuj, për lutje, për therje të kurbanit. Zotat, pasi që shpirti i tyre nuk dallohet prej atyre të njerëzve, kanë nevojë sikur njerëzit për ushqim dhe pije të përditshme. Fetarisht është rreptësisht e ndaluar që ushqimit dhe pijes së zotave t’u afrohen kafshët e fëlliqura, si derri dhe qeni. Hantili, njëri prej mbretërve të vjetër, për shkak të moskujdesit të posaçëm ndaj pastërtisë, është shkarkuar nga pozita nga ana e zotave. Metoda e përcaktimit të fajtorit, me anë të zhytjes në ujë e popujve të Mesopotamisë, nga ana e hititëve është përdorur me kuptim fetar. Kështu që të kuptohet një njeri se është apo jo fajtor hidhet në ujë, nëse fundoset quhet fajtor dhe mëkatar e nëse nuk fundoset, quhet i pafajshëm dhe i pastër.

Pas ofrimit të pijeve dhe të ushqimeve zotave, për të cilat ata kanë nevojë, bëhen kërkesa njerëzore, si psh., kërkohet jetë e gjatë, shëndet, paqe dhe fitore në luftë. Për shembull, një mbretëreshë sheh në ëndërr zotin, i cili thotë, „burrit që e mban në zemër i jap një mijë vjet jetë“, kurse mbretëresha ia kthen duke i premtuar „se nëse burri im jeton aq gjatë, unë ty do të të jap tlyen, mjaltë dhe fruta“. Hititët përveç sakrifikimit të premtuar, flijonin edhe kurban për faljen e mëkateve të tyre. Sakrifica kishte mundësi të jetë prej çdo lloji të ushqimit. Prej teksteve të shkruara dhe relieveve kuptojmë se prej kafshëve janë sakrifikuar lopë, dhi dhe dhen. Në mesin e hititëve ekzistonte edhe tradita e sakrifikimit të njeriut, ashtu sikur e shohim të përhapur në Siri. Vetëm se, nuk ishte aq i përhapur sa te komshinjtë e tyre.

c. Profecia dhe magjia

Hititët, përdornin metoda të ndryshme për të mësuar dëshirën e zotave. Dukuritë natyrore, si vetëtimja, bubullima, fluturimi i shpezëve, konsideroheshin si manifestim i dëshirës së zotit. Pasi termat e përdorura në falle janë në gjuhën akade kuptohet se falli në Anadoll ka ardhur nga Babilonia. Magjistarët në fallin e shpezëve, komentimet i bënin sipas drejtimit të fluturimit të shpezëve apo lëvizjeve të tjera të tyre. Në disa raste murgu, ëndërrat e mbretit i komentonte duke fjetur i pastër në tempull.

Hititët besonin në ekzistimin e shpirtërave të këqinj dhe të zanave dhe frikësoheshin prej dëmit të tyre. Kurse magjia ishte e ndaluar dhe dënimi për atë që merrej me të ishte me vdekje. Lejohej vetëm magjia për prishjen e magjive të bëra më parë.

ç. Doket për të vdekurit

Në periudhën para hititëve ka patur tre mënyra të varrimit. Nga zbulimet në Alishar dhe Bogazkoj mësojmë se, në kohën e shtetit të vjetër hitit të vdekurit janë varrosur, pa u djegur. Gjatë kësaj kohe haset edhe në traditën e varrimit nëpër qypa dhe nëpër sënduqe prej guri. Por nëpër qypa dhe sënduqe

futeshin pasi të digjej trupi i tyre. Nga dhuratat e pakta që gjendeshin nëpër varreza kuptohet se ato janë varreza të popullit të rëndomtë. Moszbulimi deri tash i gjurmëve të varrezave të mbretërve të kohës së Shtetit të Ri, përforcon mendimin se, trupat e mbretërve hititë të asaj kohe janë djegur.

Studimet e bëra në shkëmbinj të Bağlarbaşı dhe të Mankayasit, afër Yazılıkayës, tregojnë për ekzistimin edhe të varrezave me skelete edhe të varrezave nëpër qype, të cilat paraqesin traditën e djegies së të vdekurve. Ndërkaq zbulimet arkeologjike në kohën e hititëve të vjetër tregojnë se trupat e pajetë të familjeve të mbretërve dhe të familjeve të ngritura janë djegur, kurse të vdekurit nga populli i rëndomtë janë varrosur. Tradita e djegies së të vdekurit dhe dhuratat nëpër varreza e përforcojnë besimin e tyre në jetën pas vdekjes. Sikur që këta mund të kenë një besim të dobët në jetën e përhershme, si në Mesopotaminë e vjetër, ashtu kjo mund të jetë edhe një lloj shpërnguljeje speciale e shpirtërave, apo një ritrupëzim (reinkarnim), ngjashëm sikur në hinduizëm.

d. Tempujt

Ndërtesat të cilat pasqyrojnë në formën më të bukur artin hitit, janë tempujt e zbuluar në Bogazkoj. Nga gërmimet e bëra në tempujt në Yazılıkaya dhe në Alacahoyuk, kuptohet se ata tempuj nuk kanë qenë të ndërtuara drejt një drejtimi të caktuar. Në përgjithësi është praktikuar plani sipas nevojës dhe sipas vendit. E veçantë e tempujve hitit është ajo se në këta tempuj përreth salonit të gjatë, i cili ishte në mesin e tempullit, gjendej një dhomë e vogël. Kështu që kjo dhomë llogaritej vendi më i shentjës i këtij tempulli. Dritaret e tempullit ishin të thella, kurse çatitë e tyre ishin të rrafshta.

FETË E VJETRA TË ARABISË

Literatura: Harmut Gese, *Die Religionen Altsyriens, Altarabiens und der Mandaer*, Stuttgart, 1970, f. 7-232; Helmer Ringgren, *Religions of the Ancient Near East*, London 1973, f. 124-175; Eduart Meyer, *Deschicte des Altertums*, v.1-2, 1954, f. 399-414.

Është mjaft vështirë të përcaktohen fetë e vjetra në rajonin e gjerë të rrethuar në jug me Gadishullin e Arabisë së sotme, në lindje me lumin Euftrat, në veri me Anadollin dhe në perëndim me Mesdheun. Për këtë arsye këtë rajon të gjerë do ta shqyrtojmë në tre pjesë: Arabia Veriore, Arabia Jugore dhe Arabia e Mesme.



1. Fetë e vjetëra në Arabinë Veriore

Me shprehjen fetë e vjetra në Arabinë Veriore, kemi për qëllim rajonin e rrethuar me Mesdheun në perëndim, me lumin Euftrat në lindje, me Gjirin Akabe dhe shkretëtirën arabe në jug, si dhe me malet Toros në veri.

Burimet e pashkruara që qartësojnë temën tonë janë materiale të kufizuara, si tempujt e ndryshëm që na i ofron arkeologjia, vendet kulte dhe mjete të ndryshme kulti. Gjithashtu edhe vizatimet dhe statujat e zotave, vultat dhe paratë e stolisura me motive fetare, janë një burim i pasur.

Ndërkaq *burimet e shkruara*, filluan të shihen nga mesi i *Periudhës së Bronzës*. Më i vjetri nga këto është në *gjuhën egjiptiane* dhe daton nga mesi i shek. XIX para e.s. Po ashtu edhe letrat diplomatike në *gjuhën akade*, shkrimet në *gjuhën hitite*, që përmbajnë marrëveshjen e bërë mes fqinjëve veriorë me hititët, dhe tekstet në *gjuhën ugare*, që është një gjuhë veriperëndimore semite, përmbajnë shumë njohuri. Këto janë këngë fetare, lutje, legjenda, betime, lista të zotave, që janë rregullore që i takojnë udhëheqësisë së tempullit. Në *Periudhën e Hekurit* hasen shkrime në *gjuhën kenane* dhe *arameje*. Këto përmbajnë, sidomos, shkrime në lidhje me shenjtërimin e ndërtesave, mbishkrime të varrezave dhe marrëveshje, vizatime zotash dhe lutje. Kurse në mbishkrimet fenike haset pas viteve 1000 para e.s. Këta tekste në gjuhën siriane vazhdojnë të shihen deri në shek. I. para e.s. Ato më vonë vendin ua lënë teksteve në gjuhën latine dhe greke.

a. Një vështrim i përgjithshëm historik

Për shkak që ky rajon është vendi ku kanë jetuar kulturat dhe profetët, të cilët i përmend Kur'ani dhe Dhiata e Vjetër, është me rëndësi që të përqëndrohemi në historinë e tij. Në zbulimet nëpër shpellat e Sirisë dhe të Palestinës, haset në gjurmë dhe prova të shumta nga periudha paleolite dhe mezolite, në lidhje me jetën e njeriut. Nga fundi i Periudhës Paleolite në Palestinën Veriore dhe në rajonin Karmel haset në të afërmit e Neandertalit dhe në Galileusisin. Sidomos në kultin e krabinës Natuf (në veriperëndim të Jerusalemit), dëshkohet për mezolitikumin, e ruajtur mirë prej mijëvetëshit 9.

Njeriu i Natufit ishte me fytyrë të hollë dhe të gjatë, me lartësi një metër e gjysëm. Më vonë ky tip haset në Sami-Hani, përfaqësuesit më të vjetër të njeriut, si në Egjipt, Gezer dhe në Biblos. Këta njerëz, të cilët në fillim merreshin me grumbullimin e ushqimeve që i gjenin në natyrë, më vonë u morën me bujqësi. Shpesh haset edhe në gjurmë (mbeturina) jashtë shpellave. Në dokumentet neolite të rajonit Siri-Palestinë, haset që në mijëvetëshin e 8. Vendet e banuara, të përbëra prej shtëpive me gurë dhe mureve rrethues, reflektojnë specifikën e kohës. Krahas gjuetisë së kafshëve bëhet edhe ruajtja e tyre. Në fillim shtohet dhia, pastaj delja dhe derri, kurse më vonë shtohen edhe qetë. Burimi kryesor për ekzistimin e njerëzve që banojnë nëpër fshatra, është bujqësia. Kjo kulturë ka qenë prezente edhe në fushën Amig të Ugaritit (sidomos në Tell el-Xhude). Është gjetur edhe në Biblos dhe në Eriha. Pas zbulimit të qeramikës, në gjysmën e dytë të mijëvetëshit të 6., shihen të përhapura enë prej dheu dhe shibet Neolitika Qeramike. Gjithashtu në këto zbulime përcaktohen edhe marrëdhëniet e Sirisë Veriore me Anadollin Jugor.

Në Jordani bashkë me Neolitit shfaqet edhe kultura Megalite dhe përhapet prej lindjes drejt

perëndimit. Disa obeliskë (menhir), dhoma varresh (dohmen), apartamente prej guri (cromlechs) i takonin popullit vendës, i cili merrej me bujqësi. Kulturat si këto i takojnë Periudhës Megalite, kurse në rajonin Siri-Palestinë, rajon i lënë pas dore, ishte e përhapur kultura Neolite e fermerëve.

Nga mesi i mijëvjetëshit të 5., shihet përdorimi i bakrit, që rritej me intenzitet të madh. Po ashtu vazhdon përdorimi i gurëve të ashpër dhe të mprehtë. Kjo periudhë e gurit-bakrit, vazhdon deri nga fundi i mijëvjetëshit të 4. Në fillim me siguri ka patur edhe ndryshime shoqërore. Këtu shihet edhe një varfërim i theksuar, si psh., në Biblos, një kohë ndërpritet vendbanimi në peiudhën e gurit-bakrit. Më vonë fillon një rrymë qeramike e fortë në Mesopotami; në kulturën e zhvilluar fermere shihet ngjyrimi i rastisur më herët; në shtresën që përfshin shtresën el-Ubed, zbulohet përdorimi i rrotës nga poçari, i cili më vonë ngeç; në anën tjetër të Lumit Jordan është paraqitur kultura e ujitjes, kultivimi i grurit, elbit, ullirit dhe e fikut. Në mesin e mijëvjetëshit të 4., në kulturën Uruk të Mesopotamisë, bëhen zhvillime të ngjashme. Kultura e qytetit dhe e ujitjes është që në kohën e mbretërve të vegjël. Përafërsisht, më herët se periudha e gurit-bakrit, si kalim në periudhën e bronzit, mund të llogaritet edhe roli i popujve semitë në Sirinë Jugore dhe të Mesme.

Periudha e Bronzit, fillon në fund të mijëvjetëshit të 4. Bronzi është një përzierje e bakrit dhe e kallajit. Në krahasim me bakrin është më i ashpër. Ai në këtë periudhë ka pasur përdorim të gjerë. Arkeologjia dhe shkencat e tjera historike këtë e ndajnë edhe në nëngrupe. Periudha e hershme e bronzit, përfshinë mijëvjetëshin e 3-të. Në kohën e Fisit 1., filloi edhe eksportimi i drurit prej Libani për në Egjipt. Limani kryesor eksportues i Egjiptit është Biblosi. Ekzistenca e egjiptianëve në Biblos bazohet në dokumentacionet e kohës së fiseve 2. dhe 3. Hyjnesha e qytetit Biblos është identifikuar me Hatorin. Në mijëvjetëshin e 4. shihet ndikimi i Mesopotamisë në Egjipt, nëpërmjet Sirisë. Sargoni, themeluesi i dinastisë akade, arrin deri në bregdetin e Detit Mesdhe. Ai për këto suksese e falënderon zotin Dagon.⁶⁴

Në periudhën e hershme të bronzit, në Sirinë Jugore dhe të Mesme, formohet dialekti kenan i semitëve perëndimorë. Gati të gjithë emrat e vendeve janë në gjuhën semite. Për shembull, Eriha është pagëzuar sipas zotit të Hënës, që është zot i semitëve perëndimorë. Ky zot është argument i ekzistimit të një populli para semitëve. Qytetet e mëdha të Fenikesë bartin emra semitë, si Tirus, Sidon, Bejrut, Biblos (Geba) etj.

Në fillim të periudhës së mesme të bronzit (2100-1600 para e.s.) shihet se në shumë vende janë shkatërruar vendet e banuara. Kjo vazhdon edhe në Sirinë Veriore (për shembull: fusha Amik). Kjo mund të shpjegohet vetëm me valët e reja të shpërnguljes. Këtë popull në Mesopotami i thubet populli amurru. Fiset e Mesopotamisë së vjetër, mund të lidhen vetëm me këto shpërngulje të amurrujve. Egjipti në kohën e fisit 12. e zgjeron ndikimin e tij deri në Sirinë Veriore. Në shek. XVIII, prej emrit Varrezat e Mbretërve të Biblosit kuptohen edhe fiset vendëse. Në periudhën e mesme të bronzit, Egjipti dobësohet. Në shek. XVII dhe XVI para e.s. hisosët një kohë mbisundojnë mbi Sirinë, Palesinën dhe Egjiptin. Gjatë kësaj kohe hurrët, të ardhur prej Kaukazit Jugor, fillojnë të ndikojnë në Sirinë Veriore. Pas këtyre vijnë hititët. Siria, në Periudhën e Mesme dhe të Vonshme të Bronzit (1600-1200 para e.s.), një kohë mbetet mes rivalitetit të egjiptianëve dhe hititëve. Tutmosisi III, prej vitit 1480 para e.s., ka përgatitur udhëtime për në Siri dhe me ndikimin e Mitannit ka arritur ta shtypë kryengritjen. Edhe pasuesi i tij, Amonefisi II., me ekspeditat e tij forcon sundimin mbi Egjiptin. Nga mesi i shek. XV para e.s., në Sirinë Veriore fillon të shihet dhuna e Perandorisë Hitite. Sidomos, Egjipti, në kohën e Amonefisit III. dhe të IV. e ka humbur plotësisht sundimin mbi Sirinë. Njohuritë në lidhje me këtë temë dokumentohen në Arkivin e Ugarit.⁶⁵

Me fillimin e periudhës së hekurit, në vitin 1200 para e.s., në Sirinë Veriore shihen ndryshime të mëdha. Shpërngulësit që vijnë nëpërmjet detit ndikojnë edhe në Anadoll edhe në Siri, okupohen qytetet e Palestinës dhe të Fenikesë. Edhe valët e shpërnguljes tokësore arameje, vendosen nëpër vende të zbrazëta mes Kenanit dhe të Palestinës. Në Jordanin Lindor vendosen ammonitët, në jug të Detit të Vdekur moabitët, kurse në jugperëndim të Detit të Vdekur edomitët. Formohen qytet-shtete të vogla. Më vonë rajonet e mesme u bënë anëtare të mbretërisë së Sirisë, kurse veriorët u lidhën me mbretërinë Hama. Por, qytet-shtetet e fuqishme e vazhduan pavarësinë e tyre. Bijtë e Israelit hyjnë në rajonin e ndikuar nga palestinezët, të cilët nga kjo gjendje do të shpëtohen në kohën e Davidit. Në këto periudha në zonat mesdhetare formohen kolonitë e Fenikesë. Themelimi i Kartagenës, sipas dëshmimeve, daton në vitin 814 para e.s. Këto koloni llogariteshin rajone të Melkartit, zotit të qytetit Tirus. Kulturat fetare të Sirisë dhe të Mesopotamisë, përmes kolonive të themeluara në Qipro, bregdetit jugor të Anadollit,

⁶⁴ Gesse, f. 12.

⁶⁵ Gesse, f. 15.

Rodosit dhe përmes Menfisit të Egjiptit, kanë arritur deri në Perëndim. Më vonë rajoni kryesisht ka hyrë nën sundimin grek dhe romak.⁶⁶

b. Koncepti për zotin dhe besimet e tyre

Në gërmime të ndryshme, të cilat i ndriçojnë periudhat parahistorike, bashkë me varrezat kolektive të varrosura me perla të shumta, janë zbuluar edhe varre individuale të varrosura në mënyrë embrionale. Këta tregojnë se ata kanë poseduar koncepte në lidhje me jetën pas vdekjes. Gjithashtu në Jeriho është gjetur një ndërtesë e shenjtë që kthehet deri në vitin 7000 para e.s., dhe në të është rastisur në një statujë kafshe e bërë prej dheu; në një statujë gruaje që gjoksin e saj e ka mbështjellur me krah. Hyjnesha këto që përkujtojnë hyjneshat e prodhimit, të rastisura në periudhën e bronzit. Idhuj të këtij lloji, të mbetura nga periudha Neolite, hasen edhe në vende të tjera. Disa idhuj janë në formë të babës, disa në formë të nënës, e disa në formë të pjesëtarëve të familjeve. Nga këto del përfundimi se ata kanë besuar në ekzistencën e familjeve të zotave të prodhimtarisë. Edhe statujat e gjetura të kafshëve, ka mundësi që të jenë kafshë të shenjta të këtyre zotave.

Në mijëvjetëshin 3. para e.s. e shohim hyjneshën Ba'lat. Sipas asaj që kuptohet prej teksteve ugare në krye të panteonit, të mbetur prej viteve 1400 para e.s., gjendet zoti El. Ky emër, gjithashtu është një emër që përdoret për zotat në përgjithësi. Ai ekziston në të gjitha gjubët semite. Ekzistenca e një hyjneshe me emrin El në Mesopotami, është argumentuar në tekstet e mbetura nga shek. XXVI para e.s. Kjo shihet në tekstet e periudhës së para Sargonit, në mesin e mijëvjetëshit të 3. Edhe te semitët më të vjetër të Mesopotamisë, El është zoti më i madh. Në tekstet ugare El është mbi zotat dhe në krye të kuvendit të zotave. Në mbledhjet e kuvendit të zotave, të dërguarit flasin me El-in. Zotat e tjerë vijnë te Ai. Përpara Tij përulën dhe e respektojnë. El, sikurse që e ka shkatërruar Astarin dhe e ka mbytur Baalën, ashtu edhe zotave të tjerë mund t'iu bëjë çfarë të dëshirojë.⁶⁷ Një zot ai mund ta bëjë mbret. Baal, për të formuar mbretërinë e tij, ka nevojë për lejen e El-it. Ai, lejen për ngritjen nga dheu, ia ka dhënë Anatit. Gjithashtu El-i Anatit i ka dhënë leje edhe për mbytjen e Akhatit. Kenetin dhe Danelin i ka shenjtëruar vetë. Kur sëmuret Keneti, të gjithë zotat janë të pafuqishëm që ta shërojnë, por El-i mund ta shërojë atë.

Vetëm se, El nuk e pëlqen luftën aktive, e cila pëlqehet prej zotave të tjerë. Ai e preferon qetësinë pasive. Por bartësi dhe udhëheqësi i çdo gjëje është Ai. Edhe ekzistenca e zotave varet prej tij. Ai është bota e shenjtë pas botës së ndryshueshme. Në mesin e zotave titulli sundimtar përdoret vetëm për Elin. Ai cilësohet si një sundimtar i përbershëm. Ai sundimin nuk e ka fituar më vonë, sikurse Baali. Ai gjithmonë është dominant. Ky sundim i tij përfshinë edhe zotat. Krijimtaria e tij simbolizohet me kaun. El është krijuesi i të gjithë njerëzve të lindur. Për këtë i thuhet edhe babai i njerëzimit dhe krijuesi i krijesave. Në kuvendin e zotave llogaritet babai i të gjitha zotave.

Gruaja e zotit El, sipas teksteve ugare, është Asirati. Kjo hyjneshë në transmetimet hitite është Ashertu, gruaja e Elkunirbasit. Në Mesopotami njihet si gruaja e Amurrut. Përgjithësisht adbuohet sikur të jetë nëna e të gjitha zotave. Për zotat e tjerë thuhet se janë bijtë e Asiratit. Gruaja e Elit përmendet edhe me emrin Elat (El-Lat). Adbuohet edhe si hyjneshë e prodhimtarisë. Vendet kulte të njohura të tij gjenden në Sidon dhe Tirus.

Dagon, është njëri prej anëtarëve të Kuvendit të zotave nën udhëheqjen e zotit El. Për herë të parë shihet në tekstet e vjetra akade, të mbetura prej periudhës para amiritëve. Prej sundimtarëve akadë Sargoni dhe Naramsi, për çlirimin e Sirisë Veriore, e kanë falenderuar Dagonin. Adhurimi i Dagonit kulminacionin e ka arritur në periudhën e Hamurabit. Ai është llogaritur i njëjtë me zotin Enlil, njërin prej zotave të mëdhenj të panteonit sumer. Sipas Dhiatës së Vjetër, në rajonin e Palestinës ai ka qenë zot kryesor. Sipas legjendës Dagon është zbuluesi i drithit dhe i parmendës. Ai simbolizon fuqinë krijuese në tokë.

Baal, në gjubët semite ka kuptimin zot, pronar i pasurisë, zotëri. Sipas një dokumenti të marrëveshjes hitite, i mbetur nga mesi i mijëvjetëshit të 2., ai përmendet si sundimtar i "Maleve të Sirisë dhe të Libanit". Ka fituar autoritet si zoti i ajrit. Më parë është përdorur si Baal Hadad, kurse më vonë nuk është përdorur emri "Hadad". Hadad, zot i ajrit, në Mesopotami njihet me emrat: Adad, Addu, Haddu dhe Dada. Kultu Baal, sikurse që është i përhapur në tërë rajonin e Sirisë, edhe në Egjipt në kohën e Amenofisit 2., në gjysmën e dytë të shek XV para e.s., si dhe në kohën e Menfisit, është adhuruar si padron mbrojtës i marinarëve. Në Kur'an pejgamberi Ilyas popullit të tij i tërheq vërjetjen: "A

⁶⁶ Gesse, f. 18-19.

⁶⁷ Gesse, f. 95.

e adburoni “Baal-in” (emër i një statuje) e braktisni adburimin ndaj më të mirit që është Krijues?”⁶⁸ Një pjesë të madhe të teksteve ugarë i përbëjnë legjendat e ndryshme në lidhje me zotin Baal. Kulti i tij ishte shumë i përhapur. Baal ishte shfaqje e Sin-it, zot i hënës të harranët. Pra, përdoret si mbiemër. Krabas kësaj shpesh përdoret edhe si një emër i një zoti të caktuar. Në shek. XIX para e.s., cilësitë që i janë përsëkruar Dagonit, i janë përsëkruar edhe atij. Kulti i tij ka qenë shumë i përhapur në Sirinë Veriore dhe në Mesopotaminë Veriore. Edhe në papiruset e Fenikesë emri i tij përmendet shpesh. Edhe legjenda e Temmuz-Ishtar-it është përfshirë në të. Ai për shkak të kundërshtimit ndaj El-it, u kap dhe u dërgua te El-i. Por, me ndërmjetësimin e motrave të tij, Anat dhe Astarte, shpëtoi.⁶⁹

Në tekstet ugarë, përveç hyjneshës me emrin Astarte, e cila llogaritet e njëjtë sidomos me Ishtarin, si vajza të tjera të Baalit, haset edhe në hyjneshat me emrin Pidraj, Talaj dhe Arsaj. Dielli, në mesin e hyjneshave të mëdha, njihet si Shamash. Aty haset edhe në zota me emra qiell dhe tokë. Yjet konsiderohen zotërinj të diellit. Astarte njihet si Ylli i Mbrëmjes. Kulti i saj është Jarib, zoti i hënës, i cili një kohë ka qenë i përhapur në Ur dhe në Harran.

c. Kultet

Në mijëvjetëshin e 2. para e.s., sikur që shohim rregullimin e kulteve nëpër vende të larta, ndërtime të tilla hasen edhe nëpër qendra të banuara. Vendet e larta të kultit janë altarë të ndërtuar për fljimin e kurbanëve. Ndërkaq tempujt përbëhen prej altarit, ku digjet kurbanit dhe prej oborrit që e rrethon atë. Brenda saj gjendet një dhomë ku qëndrojnë zotat. Kjo dhomë më vonë ka marrë formën e një saloni të ndarë në tre pjesë. Në të gjenden parasaloni, saloni kryesor dhe në fund gjendet saloni më i shenjtë. Tempulli rreth e qark është i rrethuar me një mur të lartë. Në salonin e mesëm si kurban thërren dhia, kau, pëllumbi dhe kafshë të tjera. Gjithashtu këtu fljohen edhe drithëra si kurbanë. Sidomos, kurbanët e premtuar kanë rëndësi të veçantë. Si që kuptohet nga Dhiata e Vjetër⁷⁰, shibej edhe prania e kurbanëve njerëz. Maobët në kohën e fatkeqësive kurban i bënin fëmijët e lindur të parët.⁷¹ Edhe asurët, te vendosur në Samarija, dhe aramitët, për idhujt Adrammelek dhe Anammelek, kurban i bënin fëmijët. Ata nuk ndrubeshin që fsheburazi, në kohën e fatkeqësive të fljorin fëmijët më të dashur të tyre.⁷²

Në punët e kultit, gjegjësisht, në adhurime dhe ceremoni rol të rëndësishëm luante sundimtari. Shumica e ceremonive bëhej në saraje. Pranë mbretit gjendej kryemurgu dhe sipas nevojës mbreti e linte atë zëvendës të tij. Murgjit vishnin një teshë të bardhë liu dhe në kokat e tyre të gërvishtura lidhnin një mbulesë. Gjatë periudhës së shërbimit qëndronin larg çdo lloji të marrëdhënieve seksuale. Gjithashtu, shërbenin edhe si fallxhorë dhe merreshin me profeci. Në punët e kultit shërbenin dhe respektobeshin nga të tjerët edhe këngëtarët e tempullit.

Fenikasit për zotin e bimëve, i cili vdes dhe lind çdo vit, organizonin ceremoni. Në tempullin Baalat (Afrodit) në Biblos, bëheshin ceremonitë e Adonisit. Me gëzimet adonise lidhej kurvëria e shenjtë. Me ndikimin e Egjiptit kjo komentohet si gëzim i Ozirisit. Në burimin e lumit Adonis, i cili sot qubet lumi Ibrahim, ka një tempull të Afroditës. Ky vend llogaritet vend i vdekjes së Adonisit. Aresi me fytyrë derri e ka plagosur Adonisin dhe e ka mbytur. Në tempull gjendet një pëllg i shenjtë dhe në të hidhen kurbanët. Shëndërimi i lumit në të kuqe në çdo vit në ceremoni të caktuara, llogaritet shpallje e plagosjes vdekjeprurëse të Adonisit.

⁶⁸ Kur'ani, Saffat, 125.

⁶⁹ Gese, f. 51-59.

⁷⁰ Dhiata e Vjetër, Zanafilla, 22; Gjyqtarët, 11, 30.

⁷¹ Libri 2 i Mbr., 3, 27.

⁷² Libri 2 i Mbr., 17, 31.

ç. Paraqitja e monoteizmit dhe kundërshtimi i politeizmit

Një numër i madh i trimave të historisë së monoteizmit, të përmendur në Bibël dhe në Kur'an, kanë jetuar në këto rajone. Shumica e profetëve, të cilët dokumentacionet historike dhe arkeologjike i lënë pas dore, që kanë luftuar kundër idhujtarisë dhe besimit në shumë zotëra dhe që kanë mbrojtur njësinë e Zotit, kanë jetuar në këto rajone. Ata gjithashtu janë munduar që në mesin e tyre të paraqesin rrugën e shpëtimit dhe të qytetërimit. Nuk është e mundur që fetë dhe zhvillimet universale të kuptohen pa mos u marrë në konsideratë kjo luftë e tyre.

Idrisi/Enoh

Lajmet për Idrisin janë shumë të kufizuara. Në Kur'an dhe në Dhiatën e Vjetër lajmërohet se ai ka jetuar dhe është ngritur "në një vend të lartë".⁷³ Emri i tij në Dhiatën e Vjetër është "Henoh" ose "Enoh". Për vendin dhe kohën kur ka jetuar ai, nuk posedojmë asnjë njohuri. Vetëm se, nëse merret parasysh transmetimi i Dhiatës së Vjetër se ai është gjyshi i Noahit/Nuhit, atëherë mund të thuhet se ai ka jetuar në një rajon me Nuhin, gjegjësisht në Palestinë. Në Talmud ka transmetime për asketizmin dhe për devotshmërinë e tij.⁷⁴ Shpjegohet se popullit të tij i ka folur fjalë me urtësi dhe në vendin ku ka jetuar ka sjellë paqe dhe drejtësi.⁷⁵ Mendohet se ka jetuar nga mesi ose në gjysmën e dytë të mijëvjetëshit të 4. para e.s.

Nuhi/Noah

Për Nuhin i cili në Kur'an dhe në Dhiatën e Vjetër numërohet në mesin e profetëve të mëdhenj, njohuritë janë shumë të kufizuara. Emri i babait dhe i nënës së tij në Kur'an nuk përmenden. Babai i tij, sipas Talmudit-librit të shenjtë të kategorisë 2. të hebraizmit-është Lemeh, kurse nëna e tij Ashmua, vajza e Elishusë, djalit të Idrisit (a.s.)⁷⁶

Nuhi, sipas Kur'anit dhe Dhiatën e Vjetër, popullit të vet ia ka mësuar urdhërat hyjnorë për njësinë dhe ekzistencën e Zotit. Populli i tij politeist dhe udhëheqësit e tyre atë e kanë fajësuar me çmenduri dhe i janë kërcënuar me vrasje. Vetëm se, pasi që nuk ka shenja për realizimin e kërcënimit nga ana e ndonjë sundimtari apo nga ndonjë autoritet tjetër të ngjashëm, bëhet e qartë se në rajonin ku ka jetuar ai ende nuk ka ekzistuar ndonjë autoritet shtetëror apo ndonjë sundimtar. Gjithashtu, në mënyrë indirekte kuptojmë se ai ka jetuar në një vend jashtë Mesopotamisë dhe Egjiptit.

Në librat e shenjtë nuk haset në ndonjë lajm të qartë për atë se në cilin rajon të botës ka jetuar Nuhi dhe për atë se ku është realizuar ngjarja e *Tufanit*. Në Dhiatën e Vjetër dhe në Talmud transmetohet se Abrahami ka lindur pas Tufanit në qytetin Ur të Mesopotamisë në çiflikun e Naohit. Gjithashtu transmetohet se është nip i Noahit dhe se është rritur pranë tij.⁷⁷ Ithtarët e Dhiatës së Vjetër, duke u bazuar në këtë të dhënë, ngjarjen e Tufanit e kanë kërkuar në Mesopotami; e kanë menduar edhe mundësinë se Noah ka jetuar në të njëjtin vend edhe para Tufanit. Sidomos, edhe lindja këtu e Epopesë së Gilgameshit dhe gjurma e ujit e hasur në gërmimet arkeologjike të bëra në qytetin Ur, janë llogaritur si shenjë dhe gjurmë të Tufanit.⁷⁸ Vetëm se, mosgjetja e gjurmëve të njëjta në pjesën veriore të Mesopotamisë, i ka dobësuar pretendimet e studiuesve, por, bindjet e tyre nuk ka mund t'i ndryshojë. Edhe komentatorët tradicionalë të Kur'anit i kanë pranuar mendimet e ithtarëve të Dhiatës së Vjetër, në përgjithësi. Edhe në botimet e sotme të bëra për çështjet që janë të hapura për spekulim, përsëriten mendime të ngjashme.

Sipas mendimit tonë, me përmendjen e emrave të idhujve të popullit të Nuhit në Kur'an, si *Vedd*,

⁷³ Kur'ani, Ankebut, 58; Dhiata e Vjetër, *Zanafilla*, V, 24.

⁷⁴ *The Talmud*, trans. H. Polano, London, New York 1978, f. 17-18.

⁷⁵ *The Talmud*, f. 19.

⁷⁶ *The Talmud*, f. 22.

⁷⁷ *Zanafilla*, XI, 26; *Talmud*, 31.

⁷⁸ V. Gordon Childe, *Doğu'nun Prehistoryası*, përkth. Şevket A. Kansu, Botimi 2, Ankara 1971, f. 113, 131.

Suva, Jaguth, Jenk dhe *Nesr*⁷⁹, dhe përhapja e këtyre idhujve në një vend që shtrihet deri në Arabinë e Jugut dhe të Mesme, edhe sikur të kuptohet se Nuhi ka jetuar në Gadishullin Arabik, zbulimi se këta janë emra të zotave lokalë të Mesopotamisë, të cilët simbolizojnë diellin, hënën dhe yjet⁸⁰, e përjashtojnë mundësinë se Nuhi ka jetuar në Gadishullin e Arabisë.

E dhëna më e vlefshme për njoftim vendi në Kur'an është lajmi se trashëgimtari i tokave të popullit të Nuhit, që nuk ekziston më, është populli *Ad*⁸¹, dhe se qendra e Adit është qyteti *Irem*.⁸² Për Iremin flitet edhe në Dhiatën e Vjetër.⁸³ Kështu që kuptohet se Irem është vendi ku ka jetuar Nuhi dhe populli i tij. Dijetarët e Mesjetës, duke u bazuar në transmetimet gojore, truallin e Iremit e kanë kërkuar në bregdet të Detit Umman në Jemen, në mbeturinat historike të qytetit. Kurse studiuesit e arkeologjisë të kohës së sotme kanë bindjen se ky vendbanim është qendra e Edomit, në jugperëndim të Detit të Vdekur, në Sherian Lindore.⁸⁴ Gruaja Naamah dhe njëri djalë i saj, për shkak se nuk kanë besuar dhe nuk kanë hipur në anije, kanë vdekur nga Tufani. Nuhi bashkë me djemtë, nuset dhe besimtarët e tjerë, pas Tufanit, e ka braktisur rajonin dhe është vendosur në qytetin Ur të Mesopotamisë. Edhe nipi i tij Abrahami ka lindur atje dhe, sipas lajmeve të Dhiatës së Vjetër, ka vdekur në afërsi të Urit.

Në lidhje me periudhën se kur ka jetuar Nuhi, nuk ka ndonjë provë të qartë. Sipas Dhiatës së Vjetër Abrahami, i biri i Azerit dhe nipi i Noahit, ka lindur 292 vjet pas Tufanit dhe është rritur pranë gjyshit të tij, Noah.⁸⁵ Noah ka vdekur kur Abrahami ka qenë në moshën 15 vjeçare. Duke u nisur nga ky lajm është marrë iniciativa për përcaktimin e një date për Tufanin dhe kështu murgu i Kishës Siriane, Shën Guneli, e ka llogaritur se anija e Noahit në vitin 2347 para e.s. është ndaluar në kodrën Kardo (Xhudi).⁸⁶ Edhe teologët perëndimorë, duke u mbështetur në Dhiatën e Vjetër, kanë menduar se ngjarja e Tufanit ka mundësi të ketë ndodhur në shek. XX dhe XXI para e.s.⁸⁷

Vetëm se Kur'ani shpreh se në ndërtimin e anijes janë përdorur edhe “dërrasa dhe gozhda” (*Kamer, 13*), dhe nga kjo kuptohet se Nuhi ka jetuar në periudhën e xeheve, gjegjësisht në periudhën e hershme të bronzit. Sipas mendimit tonë kjo datë duhet të jetë rreth viteve 2650 para e.s.⁸⁸ Ajo që lajmëron Kur'ani se rajoni Irem përnjëherë mbetet pa njerëz, se banorët më të hershëm kanë qenë me strukturë më të vogël trupore kurse më vonë me trup më të zhvilluar, e shton edhe më tepër këtë mundësi

Edhe fjala “xhudi”, që simbolizon vendin ku është ndaluar anija, nuk është emër i përveçëm. Nëse kjo fjalë pranohet si mbiemër, atëherë ka kuptimin “vend me bërëqet, vend prodhues”⁸⁹, e cila simbolizon pranimin e lutjes së Nuhit, e cila është si vijon: “*Dhe thuaj: O Zoti im, më zbarko në një vend të bekuar! Ti je më i miri zbarkues!*”. (*Mu'minun, 29*)

Gjithashtu nga ajetet kuranore kuptohet qartë se Tufani ka qenë lokal dhe i kufizuar me atë të popullit të Nuhit. Kështu që nga botimet që bëhen kohën e fundit në lidhje me temën në fjalë merret vesh se ajetet në lidhje me këtë temë kanë filluar të kuptohen më drejt.

Po ashtu sipas lajmeve të Dhiatës së Vjetër Noah është profeti, të cilit për herë të parë i është dhënë ligji. Sipas këtij ligji atij i është ndaluar martesë me të afërmit, ngrënia e të ngordhurve dhe ngrënia dhe derdhja e gjakut. Kurse ngrënia e të gjitha bimëve dhe kafshëve i është e lejuar.⁹⁰

⁷⁹ Kur'ani, Nuh, 23.

⁸⁰ Maria Hofner, Die vorislamische Religionen Arabiens, *Die Religionen Altsuriens, Altarabiens und der Mandaer*, von Harmut Gese, Maria Hofner, Kurt Rudolph, Stuttgart 1970.

⁸¹ Kur'ani, A'raf, 69.

⁸² Kur'ani, Fexhr, 7.

⁸³ *Zanafilla*, 36, 43; *Libri 1. i Kro.*, I, 54.

⁸⁴ John D. Davis, *The Westminster Dictionary of the Bible*, Philadelphia 1944, f. 267.

⁸⁵ *Zanafilla*, XI, 10-32.

⁸⁶ Aziz Günel, *Türkiye Süryaniler Tarihi*, 29; Bekir Aksoy, 91.

⁸⁷ Maurice Bucaille, *Dhiata e Vjetër, Înciller ve Kur'an*, përkth. M. Ali Sönmez, Konja 1979, f. 61.

⁸⁸ Ekrem Sarıkcıoğlu, Kur'an ve Arkeoloji Isığında Hz. Nuh ve Tufan Olayına Yeni Bir Yaklaşım, *İslami Araştırmalar Dergisi*, v. 9, numri 1-4, 1996, f. 201 dhe në vazhdim.

⁸⁹ Sarıkcıoğlu, f. 202.

⁹⁰ *Zanafilla*, IX, 2-6.

Hudi/Eber

Ajeti 69 i sures A'raf, njofton në vendosjen e popullit "Ad" në vendin e zbrazur pas zhdukjes së popullit të Nuhit. Po ashtu Kur'ani thotë se, qyteti Irem, që është qendra e popullit Ad, është i zbukuruar me shtylla të larta.⁹¹ Komentatorët e Kur'anit duke u nisur nga fjala "*Ahkaf*" (kodrat e rërës), që është një përcaktim tjetër i popullit Ad, Iremin e kanë kërkuar në rajone të ndryshme ku gjenden shumë kodra me rërë, sidomos një hulumtim të tillë e kanë bërë në Jemen.⁹² Ata kanë ngulmuar në atë se ai është i njëjti person me Eberin, që ka mundësi të jetë paraardhësi i ibranitëve.⁹³ Ndërkaq arkeologjia e sotme Iremin e ka gjetur në jugperëndim të Detit të Vdekur, në rajonin Edon. Sipas mendimit tonë, ky përcaktim është në përputhshmëri me fjalët e Shuajbit, të cilat përmenden në ajetin 89 të sures *Hud*. Atje është e mundur që kodrat e përmendura të rërës të gjenden me shumicë.

Edhe populli i Hudit, sikur populli i Nuhit, adhuronte idhujt. Ishte një popull politeist. Nuk i pranonte mësimet për njësinë e Allahut. Në shoqëri sundonte jo drejtësia, por, dhuna. Si shenjë për idhujt në udhëkryqe dhe në vendet e larta (shtyllat hermes ose të quajtura Phallus) vendoseshin shtylla prej guri ose druri. Kur'ani në suren Shuara 128-129, lajmëron se Hudi i ka kritikuar ata me këto fjalë, "*A në çdo bregore ngritni ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë? Dhe a i ndërtoni pallatet e fortifikuara që të jeni përgjithmonë?*". Për këtë Allahu tërë popullin Ad, përveç Hudit dhe atyre që i kanë besuar, në një stinë dimri i ka dënuar me një javë të ftohtë dhe stuhi të fortë.⁹⁴

Sipas hulumtimeve arkeologjike të bëra në rajonin Beershebe, ku gjendet Iremi, njerëzit me trup të gjatë dhe të shëndoshë këtu kanë ardhur përafërsisht në vitet 2600 para e.s. Supozohet se kanë ardhur prej veriut.⁹⁵ Dijetarët e kanë shpjeguar ajetin kur'anor: "...Përkujtoni kur Ai ju bëri sundues pas popullit të Nubit dhe ju shtoi fuqinë fizike..."⁹⁶, dhe e kanë argmuntuar këtë zbulim arkeologjik. Gjithashtu arkeologjia thotë se këta njerëz pas një kohe të shkurtër, përafërsisht, në vitin 2200 para e.s., janë zhdukur dhe pas tyre në rajon kanë arritur valë të reja të të shpërngulurve.⁹⁷ Kjo dituri mund të jetë shenjë për periudhën e fatkeqësisë të popullit të Hudit.

Salihu/Saleh

Te populli Themud⁹⁸, i cili quhet edhe "*ashab-i bixhër*" (populli i Hixhres)⁹⁹, si profet ka qenë i dërguar Salihu. Ka mundësi që të jetë i njëjti person me "Saleh", të birin e Arpahasadit, dhe sipas asaj që thuhet në Dhiata e Vjetër¹⁰⁰ ai është njëri prej nipave të Nuhit. Në disa ajete¹⁰¹ vendi ku ka qëndruar populli Themud përshkruhet si një vend i këndshëm: "*Në kopshte e në burime. Edhe në të mbjella, e me hurma me frutat e tyre të freskët*". Ndërkaq në anën tjetër përshkruhet si një rajon që ka mangësi të ujit dhe një thatësi, e cila do të bëhet shkak për diskutimin e ujit që e ka pirë një deve. Përcaktimi i ujit të bunarit të lartpërmendur, një ditë për deven dhe një ditë për kafshët e të afërmve, pirja e ujit me program,¹⁰² therja e devesë nga ana e beduinëve, për të cilën mendojnë se ka pirë shumë ujë¹⁰³, na jep të kuptojmë se Salihu ka jetuar në një rajon gjysëmshkretëtor ose gjithëshkretëtor. Ajeti përkujton një oaz të vogël dhe rrethinën e saj. Shpjegohet se një pjesë e hapësirës ku ka jetuar populli i cili është përhapur në një rajon të gjërë, është vreshtëri dhe kopshtajë.

Për atë se ku mund të gjendet, janë thënë mendime të ndryshme. Siç janë ata që mendojnë se Salihu

⁹¹ Kur'ani, Fexhr, 7-8.

⁹² "Ahkaf", *Islam Ansiklopedisi*, Türkiye Diyanet Vakfı, v.1, f. 549.

⁹³ Muhammed Esad, *Kur'an Mesajı*, Meal Tefsir, İşaret Yayınları, 1998, f. 244.

⁹⁴ Kur'ani, Hakka, 7.

⁹⁵ Roland de Vaux, *The Early History of Israel*, London 1971, f. 53.

⁹⁶ Kur'ani, A'raf, 69.

⁹⁷ Vaux, f. 55.

⁹⁸ Kur'ani, A'raf, 73; Tevbe, 61.

⁹⁹ Kur'ani, Hixhr, 80-82.

¹⁰⁰ *Zanafilla*, X, 24; XI, 13-15.

¹⁰¹ Kur'ani, Shuara, 147-149.

¹⁰² Kur'ani, Kamer, 28; Shems, 13.

¹⁰³ Kur'ani, Shems, 14.

ka jetuar në Palestinë, në rajonin Petra, ka edhe prej atyre që mendojnë se ai ka jetuar në jug, në rajonin e Jemenit. Mendimi gjeneral i mbështetur në transmetime tradicionale, është në atë se ai ka jetuar në qytetin Medain Salih, në veriperëndim të Arabisë Saudite. Ky vend është 110 km në jugperëndim të qytetit Tajma. Banorët e tij janë beduinë, kurse nevojën e tyre për ujë e plotësojnë prej puseve.¹⁰⁴ Sado që vendi të jetë një vendbanim i vjetër dhe të jetë hasur në dokumentacione të mbetura prej shek. V. para e.s., ende nuk është hasur në ndonjë dokument që simbolizon popullin Themud, apo ende arkeologjia nuk ka mundur të zbresë deri në mijëvjetëshin 3. para e.s.

Sipas njohurive që janë, në rajon adhurohej treshja: hëna, dielli dhe ylli Venus dhe idhujt e tjerë që adhurohen në vendet e tjera të Arabisë.¹⁰⁵ Në ajetet 30-31 të sures Mu'min (Gafir), përmendja një pas një e Nuhit, popullit Ad dhe Themud, tërheqja e kujdesit popullit të Shuajbit me atë se çfarë u ka ndodhur popujve të më parshëm¹⁰⁶, sidomos lajmi për "ata që kanë qenë pas popullit Ad në rajon, janë bërë sundimtarë", që përmendet në ajet¹⁰⁷, e përforcojnë mendimin se tokat e popullit Ad i ka trashëguar populli i Salihut. Edhe në suren Shuara', 147-149 të përshkruarit dhe të shpjeguarit e rajonit me shprehjen "*Në kopshte e në burime. Edhe në të mbjella, e me hurma me frutat e tyre të freskët*", formon bindjen se vendi kryesor për banim i shoqërisë është një vend me gjelbërim dhe prodhues. Këto përshkrime nuk i ngjajnë shumë përshkrimet të rajonit të Madait të Salihut. Ky vend mund të jetë Hixhri, gjegjësisht rajoni në jug dhe jugperëndim të Detit të Vdekur, me qendër në Irem. Ndërkaq shpjegimet që bëhen për popullin e Salihut në Kur'an, si, se ata i ka bërë sundimtar pas Adit, ata në fushat e tyre kanë bërë vila, nëpër male shtëpi¹⁰⁸, jo e vendosur në tokat prodhuese dhe me ajër, tregon se të paktën ata kanë mundësi të jenë dominues deri të tokat e popullit Ad, apo deri afër tyre. Sidomos në suren A'raf, përmendja një pas një e popujve dhe e pejgamberëve, Nuh, Hud, Salih dhe Lut, e përforcon mundësinë se këta janë pejgamberë të dërguar në një rajon.¹⁰⁹

Sipas mendimit tonë, shkakut i përmendjes së Salihut bashkë me devenë femër, është roli kryesor që i është dhënë Salihut për zbutjen e devesë, e cila deri në atë kohë ka jetuar si e egër. Sepse sipas arkeologjisë së sotme zbutja e devesë ka filluar pas shek. XII para e.s.¹¹⁰ Kurse përdorimi i saj në karavane është bërë në shek. VIII para e.s.¹¹¹ Këto njohuri na ndihmojnë të kuptojmë se pse e kanë kundërshtuar Salihun dhe pse e kanë gjykuar vullnetin e tij për të zbutur dhe për të mbrojtur me kujdes devenë femër që e gjeti të ngatërruar në një shkëmb.

Populli i Salihut, sikurse edhe popujt e tjerë të rajonit, adhuronte idhujt. Ai popull ishte politesit. Thirrjen monoteiste të Salihut nuk e pranoi.¹¹² Salihut i besoi një numër shumë i vogël i tyre. Jobsimtarët dëshironin që një natë ta mbysin dhe iu kërcënuan me vdekje.¹¹³ Së pari ia therën devenë, pastaj ky popull meritoi hidhërimin e Allahut u zhduk me një tërmet të frikshëm¹¹⁴, me një zhurmë¹¹⁵ dhe me një vetëtimë.¹¹⁶

Me siguri Salihu ka jetuar në rajonin e Palestinës pas Hudit e para Ibrahimit. Vetëm se, në bazë të njohurive që i posedojmë nuk mund të tregohet një datë dhe një vend i saktë.

¹⁰⁴ Vidal, Al-Hixhr, E.I.IV, f. 365.

¹⁰⁵ Për më gjërësisht shih, Hofner, Gese dhe Rudolph, *Die Religionen de alten Arabiens*, f. 373-382.

¹⁰⁶ Kur'ani, Hud, 89.

¹⁰⁷ Kur'ani, A'raf, 74.

¹⁰⁸ Kur'ani, A'raf, 74.

¹⁰⁹ Kur'ani, A'raf, 59-84.

¹¹⁰ W.F. Albright, *The Archaeology of Palestine*, London 1949, f. 206.

¹¹¹ Vaux, f. 223.

¹¹² Kur'ani, Hud, 62.

¹¹³ Kur'ani, Neml, 48-49.

¹¹⁴ Kur'ani, A'raf, 78.

¹¹⁵ Kur'ani, Hud, 67; Hixhr, 83; Kamer, 31.

¹¹⁶ Kur'ani, Fussilet, 13, 17.

Ibrahimi/Abrahami

Ibrahimi, bashkë me gruan e tij, djalin e vëllait Lutin dhe me çobanët e tij, ka kaluar nëpër Harran drejt tokave të Palestinës. Në çdo vend që ka pushuar gjatë udhëtimit ka ndërtuar tempuj. Ne fillim vendoset në Palestinën Perëndimore, më pastaj edhe pse shkon në vendin e Sinasë që është nën sundimin e Egjiptit, për shkak se nuk i pëlqejnë sjelljet e zotërinjëve të Egjiptit ai kthehet prapë. Sipas Dhiatës së Vjetër ai vendoset në perëndim të Detit të Vdekur. Vetëm se për shkak të zënkave për vendkullotje mes barinjve të Lutit dhe barinjëve të tij, i jep leje Lutit që të shkojë në Sodom. Kur ai kishte 86 vjet i lindi djali Ismail me robëreshën Haxher, kurse kur i mbushi 100 me gruan e tij Saranë, i lindi djali Is'hak. Transmetohet se për shkak të mosmarrëveshjes mes Sarasë dhe Haxheresë ai Ismailin dhe Haxherenë i ka dërguar në Mekkë. Sipas mendimit tim, dërgimi i tyre në Mekkë, është mision për përhapjen e monoteizmit. Në këtë kohë Is'haku ishte 4 vjeç, kurse Ismaili 18 vjeç. Ibrahimi e mori djalin e tij të ri dhe gruan e tij dhe shkoi në Mekkë, dhe bashkë me djalin e tij Ismailin e ndërtoi Qabenë, dhe iu lut Allahut që këtë vend ta bëjë vend të sigurisë.¹¹⁷ Këto të dhëna të Kur'anit i afrojnë njohuritë që i jep Dhiata e Vjetër, se Ishmaeli ka qenë në moshën 18-20 vjeçare, në një moshë kur ka mundur t'i ndihmojë babait të tij. Legjendat e hiperbolizuara që tregohen për Ismailin si foshnje dhe për Haxherenë, kanë të bëjnë, me siguri, me rrethin e ngushtë të Ibrahimit në rajonin e Palestinës, para se ai të shpërngulet për në Mekkë.

Pas vdekjes së Sarasë, në moshën 127 vjeçare, në afërsi të Hebronit (Zanafilla XXIII, 1), Abrahami martohet edhe me një grua të quajtur Keturë dhe me të i linden edhe gjashtë fëmijë.¹¹⁸ Kur rriten dhe arrijnë në moshën e pjekurisë, ata i dërgon në rajonet përreth për të përhapur monoteizmin.¹¹⁹ Ndërkaq pranë tij mbetet vetëm Is'haku.

Kur Ibrahimi vdes në moshën 175 vjeçare, varrosët në shpellën Makpella, afër gruas së tij Sarasë.¹²⁰

Feja e Ibrahimit: në Kur'an bëhet fjalë për "fenë e Ibrahimit" dhe theksobet se Ibrahimi nuk ka qenë as i krishterë e as hebre.¹²¹ Kur Ibrahimin e shikojmë në dritën e Kur'ani dhe të Dhiatës së Vjetër shohim se:

1. Ai nuk pranon zot tjetër përveç Allahut. Ai refuzon hyjninë e krijesave si dielli, hëna dhe yjet. Refuzon që Zotit t'i përsëkrubet fëmijë dhe përfaqësimin e tij me idhujt.¹²²

2. Sipas Kur'anit ai beson në abiret dhe në ringjallje.¹²³ Në Dhiatën e Vjetër nuk baset në ndonjë shprehje decide për besimin e tij në abiret/botën e ardhshme, vetëm se varrimi i tij dhe i Sarasë me ceremoni dhe mendimi i tij për drejtësinë hyjnore mund të llogariten si shenja për besimin e tij në abiret.

3. Ai sikur që besonte në pejgamberllëk, ishte i vetëdijshëm edhe për atë se edhe vetë është një pejgamber. Kur'ani dhe Dhiata e Vjetër për këtë janë të një mendimi.¹²⁴

4. Kur'ani dhe Dhiata e Vjetër dëshmojnë se ai ishte i vetëdijshëm për ekzistimin e engujve dhe, për atë, disa nga këta të dërguar ua kanë sjellur mesazhin e Zotit.¹²⁵

Nëse për adhurimin e Ibrahimit do të shikonim në shenjat e Kur'anit dhe të Dhiatës së Vjetër mund të përcaktojmë sa vijon:

1. Ai është një njeri që dëshiron të ndërtojë tempuj. Në Kur'an shpjgohet se, ai e ka ndërtuar Qabenë dhe i ka thirrur njerëzit në haxh.¹²⁶ Kurse në Dhiatën e Vjetër shpjgohet se ai ka ndrequr thertore për sakrifikim¹²⁷ dhe aty ka bërë therjen e tyre.¹²⁸

2. Ai ka falë namaz (Ibrahim, 14/40). Dhiata e Vjetër këtë e shpreh se ai është përlur (Zanafilla, 22/5; 24.52).

¹¹⁷ Kur'ani, Bakara, 127; Nur, 35.

¹¹⁸ Zanafilla, XXV, 1.

¹¹⁹ Zanafilla, XXV, 6.

¹²⁰ Zanafilla, XXV, 7-10.

¹²¹ Kur'ani, Bakara, 132; Ali-Imran, 67.

¹²² Kur'ani, Bakara, 126, 128; En'am, 74-78, 81; Ibrahim, 35; Shuara, 81; Merjem, 44-46; Ankebut, 17; Saffat, 86; Mumtehine, 4; Dhiata e Vjetër, Zanafilla, XII, 7, XV, 1-21, XVII, 1, XVIII, 1-22; Talmud, f. 36-42.

¹²³ Kur'ani, Shuara, 81, 85, 87; Ankebut, 25.

¹²⁴ Kur'ani, Bakara, 126; Hadid, 26; Zanafilla, XII, 7, XV, 1-21, XVII, 1, XVIII, 1-22.

¹²⁵ Kur'ani, Hixhr, 51-58; Dharijat, 24-34; Zanafilla, XVI, 7-13, XIX, 1.

¹²⁶ Kur'ani, Bakara, 127.

¹²⁷ Zanafilla, XII, 7-8, XIII, 18.

¹²⁸ Zanafilla, XXII, 5.

3. Ai ushqente të varfërit dhe u bënte mirë njerëzve.¹²⁹ Dhiata e Vjetër këtë e shpreh se ai njerëzit i ka porositur që të mbajnë rrugën e Zotit dhe të veprojnë me drejtësi dhe me paqe.¹³⁰

4. Si nevojë e marrëveshjes që bën me Zotin, familjes së tij dhe besimtarëve ua bën farz sunetimin.¹³¹

5. Ai i zbatonte ligjet e Nubit. Prej ngjarjeve që janë përjetuar në kohën e tij, kuptohet se reptësisht e ndaluar është homoseksualizmi¹³², pirja e gjakut¹³³, mbytja¹³⁴, martesja e vëllait me motrën.¹³⁵ Kurse përsa i takon trashëgimisë për të ende nuk kishte ndonjë ligj, sepse të gjithë pasurinë e tij prej Sarasë, ia dha Is'hakut, kurse fëmijët e Keturasë, ose të skelleverve të tij, janë mjaftuar me dhuratat që ua kanë dhënë.¹³⁶

Luti

Luti është djali i Haranit, vëllait të Ibrahimit. Ai bashkë me Ibrahimin është shpërngulur për në Palestinë. Një kohë ka jetuar bashkë me Ibrahimin, vetëm se për shkak të mosmarrëveshjes mes barinjve të tij me të Ibrahimit për një kullotë, ndahet, dhe shkon në Sodom në jugperëndim të Detit të Vdekur,¹³⁷ në një rast, në luftë me qytet-shtetet fqinje, zihet rob dhe më vonë shpëtohet nga ana e Ibrahimit¹³⁸

Edhe Luti politeistët pranë tij i thërriste të besojnë në njësinë e Allahut dhe të largohen prej veprave të ndaluara. Populli i tij tallej me të dhe e kërcënonte.¹³⁹ Për këtë, i gjithë qyteti dhe njerëzit që kishin fituar hidhërimin e Zotit vdiqën prej një zëri të trishtueshëm dhe rënies prej qielli të zjarrit të sqfufrosur. Përveç Lutit dhe dy vajzave të tij nuk mbeti askush tjetër i gjallë.¹⁴⁰ Kur'ani thotë se në mesin e atyre që u ballafaquan me fatkeqësinë ishte edhe gruaja jobesimtare e Lutit.¹⁴¹

Is'haku

Is'haku është djali i Ibrahimit dhe Sarasë. Kur'ani thotë se Is'hakut i është dhënë bollëk dhe është përgatitur që të jetë prej dijetarëve dhe prej të sinqertëve.¹⁴² Në këtë kohë Sara ishte 90 vjeçe, Ibrahim 100 vjeç, kurse Ismaili 14 vjeç.¹⁴³ Në ditën e 8 pas lindjes është bërë synnet nga ana e babait të tij. Ibrahim, në këtë kohë, ka jetuar në afërsi të Hebronit. Sipas Dhiatës së Vjetër, djali i cili do të sakrifikohej ishte Is'haku.¹⁴⁴ Edhe sureja Saffat (ajeti 101-102) jep shenjë se djali që duhej të therej për kurban ishte djali i sihariquar. Megjithatë shumica e dijetarëve muslimanë mbrojnë mendimin se fëmija i bërë kurban është Ismaili, i lindur prej Haxheresë.¹⁴⁵ Is'haku martohet me Rebekka-në, mbesën e xhaxhait Nahor, i cili jetonte në bregun e lumit Eufrat në Siri.¹⁴⁶ Në këtë kohë Is'haku kishte 40 vjet, kurse në moshën 60 vjeçare i lindin dy fëmijë binjakë, i pari quhet Esav (Isav), kurse i dyti Jakobi.¹⁴⁷

¹²⁹ Kur'ani, Nisa, 125; Enbija, 73.

¹³⁰ Zanafilla, XVIII, 19.

¹³¹ Zanafilla, XVII, 10-14.

¹³² Zanafilla, XVIII, 8.

¹³³ Zanafilla, XIX, 1.

¹³⁴ Zanafilla, ?, 4-6.

¹³⁵ Zanafilla, XX, 12.

¹³⁶ Zanafilla, XXV, 2-6.

¹³⁷ The Talmud, 46.

¹³⁸ Zanafilla, XIII-XIV.

¹³⁹ Kur'ani, Kamer, 36.

¹⁴⁰ Zanafilla, XIX; The Talmud, 48-51.

¹⁴¹ Kur'ani, Tahrim, 10.

¹⁴² Kur'ani, Saffat, 112.

¹⁴³ The Talmud, 57; Zanafilla, XXI, 5.

¹⁴⁴ Zanafilla, XXII.

¹⁴⁵ Kuzgun, Kur'an'a Göre Hz. Ibrahim, f. 73-78.

¹⁴⁶ Zanafilla, XXIV.

¹⁴⁷ Zanafilla, XXV, 20, XXV, 25.

Me kalimin e kohës, për shkak të paraqitjes së krizës ekonomike, një kohë shpërngulet për në Gerar, rajon i Palestinës, ku ishte i vendosur edhe babai i tij. Ai merrej edhe me bujqësi edhe me blegtori, dhe kështu është pasuruar. Për shkak të mosmarrëveshjes së barinjve të tij me popullin vendës për ujin, ai kthehet në Beerseba, prej nga u largua në fillim. Atje ndërtoi një faltore dhe punoi në përhapjen e besimit në një Zot, në rrethin ku jetonte. Ai bëri marrëveshje me vasalët përreth dhe u mundua që të jetojë në paqe. Për shkak të mosmarrëveshjes mes djemve të tij, Jakobit dhe Esavit, Jakobi iku te daja i tij dhe atje edhe u martua. Pas një kohe Jakobi bashkë me fëmijët e tij kthehet në Hebron, te vatra e babait të vet. Is'haku, që jetën e ka kaluar bashkë me fëmijët dhe nipat e tij, vdes në moshën 80 vjeçare. Kurse varrimi i bëhet nga ana e fëmijëve të tij.¹⁴⁸

Jakubi/Jakobi

Është i dyti i binjakëve të Is'hakut. Ai përafërsisht ka jetuar në mesin e periudhës së mijëvjetëshit 2., në kohën e bronzit. Ai ishte me natyrë të urtë dhe i pëlqente shumë që të meditojë. Dhiata e Vjetër atë e cilëson si dinak. Me dinakërinë e tij ai, nga Esavi ka blerë të drejtën e lindjes i pari dhe më pas për trashëgimtar; e mashtron babain e tij që ta shenjtërojë atë (për profet).¹⁴⁹ Vëllait të tij, Esavit, i shkante për qejfi gjuajtja nëpër fushë, kurse Jakobi preferonte të qëndrojë në shtëpi pranë gjyshit të tij, Abrahamit, që të mësojë dhe të dëgjojë prej tij. Kur vdes Abrahami ai ende ishte në moshën 15 vjeçare. Ai dinte që marrëveshjen që kishte bërë me vëllain e tij, Esavin, ta kthejë në dobi të tij edhe atë, duke i dhënë atij dhurata dhe duke i thënë atij fjalë atraktive.¹⁵⁰ Me propozim të familjes së tij ai shkoi në Harran pranë dajës së tij, Labanit, ku u martua me vajzat e dajës, Lea dhe Rahel. Pas një periudhe qëndrimi atje, i morri gratë dhe fëmijët e tij dhe u kthye në Hebron, pranë babait të tij. Gjatë udhëtimit, edhe ky sikur gjyshi i tij ka ndërtuar nëpër vendqëndrime të ndryshme tempuj dhe ka punuar që familjen dhe njerëzit pranë tij, t'i mbrojë prej politeizmit. Kur ka arritur afër Betlehemit, gjatë lindjes së Bunjaminit i vdes gruaja, Rahela.¹⁵¹

Nofka e Jakobit ishte Izrael. Ai ka patur 12 djem që më vonë janë bërë paraardhës të 12 fiseve të Bijve të Izraelit.

Në fund Jakobi arrin në Hebron, te babai i tij, Is'haku, dhe aty jetojnë bashkë. Në vdekjen e babait kanë qenë prezentë bashkë me vëllain dhe të dy bashkë e kanë varrosur babain në shpellën Makpella. Jakobi qëndroi në Hebron deri në paraqitjen e një krize tjetër ekonomike. Më vonë, me ftesë të djalit të tij, Josef, shpërngulet për në Egjipt. 17 vjetët e fundit të jetës së tij i ka kaluar në Egjipt dhe ka vdekur në moshën 147 vjeçare.¹⁵² Ai, sipas porosisë që kishte lënë, është balsamosur dhe është dërguar në Palestinë, ku është varrosur në shpellën Makpella, pranë paraardhësve të tij.¹⁵³

Ejubi/Jobi

Për personalitetin legjendar të Ejubit të nuk ka njohuri të mjaftueshme. Ai është i njohur me fjalët e tij të urta dhe me vargjet "*Libri i Egjiptit*" në Dhiatën e Vjetër. Ejubi është simboli i durimit dhe i mirënjohjes. Sipas mendimit të përgjithshëm thuhet se ai ka jetuar në qytetin Uz, që gjendet në verilindje të Galilesë, në rajonin Basan. Shumica e dijetarëve muslimanë pjtohen me këtë mendim, pasi që edhe e kanë pranuar se Ejubi ka jetuar në rajonin e Sirisë. Në Siri është edhe një tyrbe e bërë në emër të tij.¹⁵⁴ Përmendja e një princi me emrin A-ja-ab (Ejub), në një tekst në gjuhën akade në Basan, i mbe-tur nga shek. 14 para e.s., e përforcon mundësinë që ai të jetë vetë Ejubi.¹⁵⁵ Përkundër kësaj bindja gjenerale e studiuesve hebraikë është se qyteti Uz është Kirbet el-Its, që gjendet në jurperëndim të Detit të Vdekur, në rajonin e Edomit.

¹⁴⁸ Zanafilla, XXV, 28.

¹⁴⁹ Zanafilla, XXVII.

¹⁵⁰ Zanafilla, XXXIII.

¹⁵¹ Zanafilla, XXX, 24, XXXV, 18.

¹⁵² Zanafilla, III, 28.

¹⁵³ Zanafilla, XXXIX.

¹⁵⁴ Abdullah Aydemir, *İslami Kaynaklara Göre Peygamberler*, Ankara 1992, f. 98.

¹⁵⁵ Job Samuel Terrin, *The Encyclopedia of Religion*, VIII, 97.

Dijetarët muslimanë, Ejubin e renditin pas Jusufit. Emri i tij përmendet në katër sure të Kur'anit dhe theksohet se ai është person shembull për durimin dhe mirënjohjen.¹⁵⁶ Vetëm se, për personalitetin historik të tij nuk jepen njohuri. Sipas burimeve hebraike ai rrjedh prej fisit të Is'hakut, kurse nëna dhe gruaja e tij janë prej vajzave të Lutit. Por për këto nuk posedojmë ndonjë dituri të sigurt. Ka mundësi që të jetë prej fëmijëve të Ibrahimit, që i ka patur me gratë e tjera, pas vdekjes së Sarasë. Thuhet se djali i tij me emrin Sheref, në Kur'an përmendet dhe lavdërohet si Dhu'l-kifl. Ai në rrethinën e Sirisë është përpjekur për përhapjen e besimit monoteist.¹⁵⁷ Kurse emri Dhu'l-kifl nuk përmendet në Dhiatën e Vjetër.

Shuajbi

Ai është përmendur si pejgamber i popullit të Medjenit, që gjendet në Gadishullin Sina, mes gjirit Akabe dhe luginës Humus, dhe te populli i Ejkesë, i cili jeton mes Medjenit dhe Detit të Kuq. Ishte një person me gjuhë të ëmbël. Popullin e tij e këshillonte, që krabas besimit në Allahun, të mos mashtrojë në tregti dhe në matje, të frikësohet prej Ditës së Gjykimit.¹⁵⁸ Luftoi kundër kërcënimit, tiranisë dhe detyrimit në politeizëm, që u bëheshin besimtarëve të tij, mbronte lirinë fetare dhe të besimit, popullin e tij e këshillonte duke u treguar atë se çfarë u ka ngjarë popujve të Nubit, Hudit, Salibut dhe të Lutit.¹⁵⁹ Popullin e Medjenit, për shkajdesjen ndaj këshillave të Shuajbit, e zbuloi një tërmet i fortë (A'raf, 91), kurse popullin e Ejkesë një shi i nxehtë me zjarr.¹⁶⁰

Dijetarët muslimanë, Shuajbin, i cili ka jetuar në Medjen, e identifikojnë me vjehrrin e Musait, murgun Jesrum (Eksodi, III, 1), që ka jetuar në Medjen dhe ka qenë njeri i mirë. Për shpjegimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje ne nuk kemi dokumentacione të mjaftueshme.

2. Fetë në Arabinë Jugore

Literatura: Maria Hofner, "Die Vorislamischen Religionen Arabiens", in: *Religionen Altsyriens, Altarabiens und er Mondaer*, Stuttgart 1970, f.234-402.

Shembullin më tipik të feve të Arabisë Jugore e gjejmë në Saba. Saba është shteti më i vjetër në Arabinë Jugore dhe është, gjithashtu, edhe një vend ku më tepër gjenden dokumentacione burimore. Deri në vitet 400 para e.s., këtë shtet e sundonin sundimtarët e quajtur Mukarrib. Nëse merret parasysh tregimi i Sulejmanit, i cili ka vdekur në vitin 935 para e.s., me Belkisën¹⁶¹, mbretëreshën e Sabasë, emri i së cilës përmendet në Kur'an dhe në Dhiatën e Vjetër, kuptohet se Belkisa është bashkëkohanike e Solomonit, dhe se ka jetuar në shek. 10 para e.s. Dokumentacionet e zbuluara historike ende nuk kanë arritur deri në shek. 10 para e.s. Ka edhe prej atyre që mendojnë se, ka mundësi që Belkisa të jetë mbretëreshë arabe, anëtare e një populli të quajtur "Saba", i cili ka jetuar në Arabinë Veriore. Edhe pse tregohet se ka qenë adhurues i diellit, ky besim ka qenë në tërë Lindjen e Mesme, dhe aspak nuk është reale që për të të ketë një shtrirje lokale. Sundimtar i parë i Sabasë ka qenë Jisa Amar (720 para e.s.), historia e të cilit është e njohur. Njoftimet na vënë në dijeni se ai sundimtarit asur, Sargonit II., i ka dërguar dhurata. Kurse sundimtar i dytë ka qenë Karib ul-Vatar I. (165 para e.s.). Të dy këta përmenden edhe nga historianë asurë. Titulli *Mukarrib* ka kuptimin "Mbreti i murgjve". Pas Karib ul-Vatarit II., vendin e kësaj fjale e merr emri "mbret". Shumë dokumentacione tregojnë se shteti i vjetër ka qenë një shtet teokratik dhe perandori. Kurse zoti i tyre ka qenë sunduesi i vetëm i shtetit, pasi që sundimtari është llogaritur zëvendës i zotit në tokë. Ky besim është dobësuar në kohën e Karib ul-Vatarit II., dhe më vonë ka mbetur vetëm si teori.

¹⁵⁶ Kur'ani, Nisa, 163; En'am, 84; Enbija, 83-84; Sad, 41-44.

¹⁵⁷ Yazır, *Hak Dini Kur'an Dili*, v. 6, f. 474.

¹⁵⁸ Kur'ani, A'raf, 85; Tevbe, 84.

¹⁵⁹ Kur'ani, Tevbe, 89.

¹⁶⁰ Kur'ani, Sad, 12-13; Kaf, 14.

¹⁶¹ Bibla, Libri 1 i Mbr., X, 1-13; *Libri 2. i Kro.*, IX, 1-12; Kur'ani, Neml, 22-24; Sebe', 15-18.

Emrat e zotërave më të përmendur në mbishkrime janë: Astar, Almakah, Zat-Himjan, Zat-Badan, Havbas dhe Sama. Rrallë herë haset edhe në emra si Vedd dhe Basham.

Almakah është zoti i shtetit Saba. Në fillim ka qenë zoti i shtetit Saba, pasi që Saba u bë perandori, është e mundshme që edhe ai të ishte bërë zot i perandorisë. Shihet afërsia e tij me hënën. Ndërsa në protokolin e zotave zë vendin e tretë. Në vendin e parë është Astarte, i cili ka marrëdhënie me ujitjen dhe me bujqësinë. Mund të kujtohet se është i njëjtë me Ishtarin, në Mesopotami dhe me Astarte, te kenanët. Vetëm se Astarte, përkundër tyre, përfytyrohet si mashkull. Në periudhat e mëvonshme atij i janë dhënë titujt Dhu-Farat dhe Dhu-Ziban. Shihet se ka lidhje edhe me yllin Venus. Ky planet në disa raste përfytyrohet si Yll i mëngjesit, e në disa raste si Yll i Mbrëmjes.

Kurse Zat-Himjan dhe Zat-Badan janë emra të zotave të *diellit*. Astar, Almakah dhe Zat-Himjan janë zota të *Venusit*, *hënës* dhe të *Diellit*. Ky grup i tre zotave mund të llogaritet si triniteti zyrtar i Sabasë. Ky trinitet në literaturë shihet si *Hëna-baba*, *Dielli-nëna* dhe *Ylli-biri*. Sidomos, lajmi i Kur'anit se ata adhurojnë diellin mund të jetë simbolizim për atë se besimi dhe kulti i hyjneshës kryesore, që shihet në periudhën e vjetër, është shumë i përhapur edhe në Saba.

Përveç këtyre mund të përmenden edhe emrat e zotave si Havbas, Sama, Basham dhe Vedd. Emri Havbas haset në mbishkrimet prej shek. 7 para e.s. e deri në shek. 3 të e.s. Vedd, i cili mendohet si zot i hënës, ka kuptimin "*miqësi dhe dashuri*", dhe ishte zot i shtetit Main. Në periudhat e mëvonshme rastiset në Basham-in me formë dhie, e cila ka lidhje me hënën. Hyjneshat kanë filluar të duken që prej shek. 4 para e.s., si Zat-Gadran (ajo që jep shumë ujë) dhe Zu-Samavi. Hyjneshat e qiellit Zu-Samavi përkujton Baalshamin e rajonit të Sirisë.

Edhe në rajonet e Arabisë Jugore, si në Kataban dhe në Hadramaut, me emra të njëjtë apo të ndryshëm nga ato në Saba, adhurohen: Zoti i Hënës, Zoti i Diellit dhe Zoti i Yllit. Besimi kryesor i rajonit nuk dallon nga ai i Sabasë. Këtu nuk haset në paraqitjen e zotave në skulptura e në forma të njeriut si në periudhat e vjetra. Idhujt, në përgjithësi, përfytyroheshin në formë të kafshëve. Në këtë rajon nuk shihen fort kurbanët njerëz. Falli dhe magjia kanë qenë shumë të përhapura.

Në Jemenin Jugor të vdekurit varroseshin në dhomëzat e gdhendura në shkëmbinj. Si dhuratë në varret e të vdekurve vëndoheshin perla të ndryshme, vula, nuska dhe mjete të ndryshme kuzhine. Haset edhe në figura dhe në reliefe. Nga të gjitha këto kuptohet se edhe ata kanë besuar në një jetë pas vdekjes.

3. Fetë në Arabinë e Mesme

Literatura: Kur'an-ı Kerim; İbn Kalbi, Putlar Kitabı, përkth. në turq. Beyza Düşüngen (Bilgin), Ankara 1969; Neşet Çağatay, İslam Öncesi Arap Tarihi ve Cabiliye Çağı, Ankara 1971, f.102-112.

Materiali për Arabinë e Mesme është shumë më i pakët dhe më i pamjaftueshëm prej asaj të Arabisë Jugore. Nuk është rastisur në ndonjë dokument më tepër për jetën dhe besimin e popullit të atij vendi. Burime më të rëndësishme janë Kur'ani dhe libri "*Kitabu'l-asmam*" (Libri për idhujt). Nëpërmjet këtyre mund të fitojmë dituri për besimin dhe zakonet e arabëve të periudhës paraislame.

Siç shihet në shumicën e popujve idhujtarë dhe politeistë, të cilët kanë jetuar në vende të ndryshme të botës dhe në kohëra të ndryshme, që jetojnë edhe sot, edhe në rajonin e Hixhazit krahas besimit në shumë zota, besohej edhe në një zot që posedon një fuqi dhe një forcë absolute. Kësaj ekzistence të lartë i thonin "Allah". Mirëpo ata Allahun e përfytyronin si një zot pasiv, që qëndron në largësi, në punët e tyre ditore i shikonin idhujt dhe besonin se ata janë ndrëmjetësues mes tyre dhe Allahut. Po ashtu adhuronin zota të nivelit të ulët, kurse Allahun e lartësuar e përmendnin në rreziqe të mëdha dhe kur e humbisnin shpresën në zotat, për të cilët mendonin se kanë fuqi të kufizuar. Kur'ani, në suren Ankebut, ajeti 65, këtë gjendje e shpjegon kështu:

"(Idhujtarët e dinë për Allahun pse) Kur hipin ata në anije (u këputet lidhja me tokë dhe frikësoben) i luten singerisht Allahut, e kur i shpëton ata (dhe dalin) në tokë, qe, po ata të njëjtit lusin idhujt!"

Sidomos edhe politeistët, kur pyeten se të kujt janë toka dhe krijesat mbi dhe në të, qiellërat dhe Arshi, pasuria dhe depot, thonin se janë "të Allahut". Ata nuk e refuzonin ekzistimin e Allahut. Ata

përveç Allahut besonin edhe në ekzistimin e shumë krijesave të tjera hyjnore. Për shkak të personifikimit të idhujve, si Lat, Menat, Uzza, Hubel etj., me shkëmbinj, drunj dhe statuja, atyre u është thënë “idhujtarë”. Nga këto Latin, Menatin dhe Uzzanë i mendonin si femra dhe u thonin vajza të Allahut; këto respektoheshin në tërë Arabinë. Kurse Hubeli llogaritej mashkull. Më i vjetri në mesin e këtyre zotave ishte Menati. Idhulli i tij ishte një pus i madh dhe gjendej në vendin e quajtur Kudajd, mes Mekkes dhe Medines. Sidomos këtë e adhuronin fiset Evs dhe Hazrexh. Por kultu i tij ishte i përhapur në mesin e të gjithë arabëve.

Kulti i Latit ishte i përhapur në Arabinë e Mesme dhe Veriore. Qendra e vendit të kultit ishte në Taif. Idhulli i tij ishte një gurë i bardhë graniti dhe gjendej në vendin ku sot gjendet Xhamia e Taifit. Vendi ku ai gjendej llogaritej si pronë e tij. Lati kishte një xhabxhab (një gropë ku vëndoheshin gjërat e dhuruara për idhullin), i cili ishte plot me gurë të çmuar, me ar, argjend dhe me stofra të ndryshme.

Uzza, që është më e reja prej tre hyjneshave, ka kuptimin e fortë, e fuqishme. Kulti i saj ishte i përhapur në tërë Arabinë. Vend kultu ishin tre drunj të samurasë në lumin Nahle në Mekke. Këtij vendi i thuhej edhe Qabeja Gatafan. Besohej se idhulli është i ulur në këta drunj. Këta drunj, pas shpalljes së Islamit me urdhërin e Muhamedit (a.s.), u prenë, kurse shtëpia u prish.¹⁶² Në rajonet e Arabisë Veriore, krijoheshin lidhje mes Planetit *Uzza* dhe *Venus*. Përveç këtyre tre hyjneshave, në Kur'an përmenden edhe zotërat me emra Vedd (Hëna), Suva, Jaguth, Jeuk dhe Nesr (Dielli), për të cilët populli i Nuhit thotë:

*“Dhe u thanë: mos braktisni zotat tuaj kurrsesi, mos braktisni Veddën, as Suva-në, e as Jeguth-in, Jeukë-n e Nesre-n.”*¹⁶³

Këta më herët kanë qenë zota klanesh. Këta zota hasen edhe në Arabinë Jugore.¹⁶⁴

Njëri nga zotat e njohur të Arabisë së Mesme është edhe Hubeli, idhulli i tij është në formë të njeriut dhe gjendej në Qabe. Ai është sjellur prej Veriut, prej rajonit Muadh. Idhulli i tij luan rolin e fallxhiut përpara të cilit gjenden pusi pa ujë dhe në të hidhen shigjeta fati.

Idhujt Isaf dhe Naile, që gjenden në Qabe, adhurohen prej fiseve Kurejsh dhe Huza. Menat, njëri nga zotat që adhurohej prej kurejshitëve llogaritet i njëjtë me Zeusin në Arabinë Veriore. Gjithashtu janë adhuruar edhe zota të tjerë si Ruda, Shems, Kuzah etj.

a. Kultet

Politeistët, idhujt e tyre i adhurojnë sikurse adhurohet Zoti. I duan ata dhe për ta sakrifikojnë. Sakrifica më i rëndësishëm ka qenë deveja. Edhe delja dhe kau ishin të pranishëm. Çdo kush kishte mundësi të flijojë. Mishi i kafshëve të sakrifikuara ose harxhohet në një ceremoni gjenerale ose u libej kafshëve të egra. Kurse gjaku i kafshës së sakrifikuar derdhet i tëri. Ai llogaritej pjesë që i takon Zotit. Në kope, kafsha që lind e para sakrifikohet. Ndërkaq thyerja e eshtrave të sakrificës ishte e ndaluar. Gjithashtu disa kafshë seleksionoheshin nga kopeja dhe për shtimin e saj i dhuroheshin zotit dhe libeshin të lira. Dhe këto kafshë as mund të prekeshin, as mund të punohet me to e as mund të thereshin. Kurse qumështi i kafshës femër që i dhurohet zotit plotësisht u shpërndabte mysafirëve dhe të vobektëve. Ky lloj i kafshëve libej në kope ose preferohet t'i dhurohet një vendi të kultit.

Ndërkaq vendet e kultit i takonin popullit vendës. Në këto vende për vizitë gjendeshin gurëzjt e kultit ose një shtëpi kultu. Këto ishin nga një ndërtesë sikur Qabeja e nuk ishin tempuj. Çdo idhull kishte rajonin e tij të shenjtë dhe këtij rajoni i thuhej Hima. Në Hima ishte e ndaluar të gjuhej dhe të priteshin drunjtë. Këtu lejohet të kullotnin vetëm kafshët e dhuruara zotit. Nëse një kafshë prej kopesë rastësisht apo gabimisht hynte në atë rajon nuk merrej prapë, ajo llogaritej si pjesë e zotit.

Kurse idhujt ishin me forma të çuditshme. Sipas thënieve vetëm idhujt e dy zotave, Vedd dhe Hubel, ishin në formë të njeriut. Këta idhuj arabëve u kanë ardhur prej jashtë. Arabët më herët nuk dinin për këto forma të zotave. Ata gurëve kulte u thonin ansab ose asnam. Në një vend kultu, në të shumtën e rasteve, gjendeshin shumë asnam. Përpara idhujve thërehet sakrifica dhe idhulli o lybej, o stërpikoj me gjak. Si adhurim, rreth idhullit ose gurit njerëzit shëtiteshin, rrotulloheshin, e ledhatonin dhe puthnin, mbi të varnin tesha, armë etj. Dhuratat që i jepeshin idhullit vendobeshin në një gropë ose në një shpellë të quajtur xhabxhab.

¹⁶² Ibn al-Kalbi, *Putlar Kitabı*, përkth. Beyza Düşüngen, Ankara 1969, f. 32-36.

¹⁶³ Kur'ani, Nuh, 23.

¹⁶⁴ Shih temën e larpërmendur për rajonin ku ka jetuar profeti Nuh.

Ka nga ata që këtë gjendje e lidhin me mangësinë kulturore dhe njohuritë e arabëve para islamit dhe të popujve të tjerë semitë. Është me rëndësi të përkujtohet se edhe sot, në kohën tonë, në shtetet e përparuara dhe të qytetëruara janë të përhapura besimet e këtij lloji. Çështja nuk është ndonjë problem kulturor. Edhe një njeri primitiv me nguljen e një guri, me krijimin e një grumbulli gurëzish ose me gdhendjen e një statujë, nuk mendon dhe nuk pretendon se ka krijuar një zot të ri. Në botë askush nuk e adburon gurin vetëm si gur. Por, nëse ka një gurë përpara të cilit ndjehet një frikërespekt (përrulje) ajo bëhet shkak që të besohet se në atë gur ka ardhur zoti, se në të është vendosur zoti ose zoti atij i ka dhënë shpirt. Vetëm se besohet se në atë gur zoti më është trupëzuar. Një njeri që lidh marrëdhënie me të beson se lidh marrëdhënie me zotin, me të bisedon dhe përpara tij përulet. Guri i shenjtë dhe vendi ku gjendet ai bëhet një vend ku njeriu dhe zoti lidhin marrëdhënie dhe vend ku Zoti u jep përgjigje zotimeve (biat).

Përgjithësisht kur përmendet besimi në idhujt përfytyrohet një zot i vizatuar ose një statujë. Në fetë e popujve të zhvilluar në artin plastik, ose te grekët, te romakët, idhujt mendohen në formë të skulpturave. Shenjtëria e idhujve nuk ijen prej pamjes fizike të tyre. Ata i shenjtëron besimi se në ta ka një fuqi, një shpirt hyjnor dhe se ai është i vendosur në brendinë e tyre. Sidomos arabët, edhe pse përreth tyre ishte i zhvilluar arti plastik, nuk e ndjenin nevojën për formësimin e zotave të tyre. Gati të gjithë zotat, përveç idhujve Hubel dhe Vedd, të sjellur prej Sirie, ishin në formë të një shtylle prej një guri të trashë ose në formë të një shkëmbi. Idhulli Uzra përbëhej prej tre drunjve. Ata pas çlirimit të Mekkes janë prerë dhe kështu i është dhënë fund kultit të tij. Idhulli Sad në bregdetin e Xhiddesë, ishte një pjesë e gjatë guri. Idhulli Fals ishte një skep i kuq në mes të maleve të errëta. Kur shikohet nga larg të përkujtohet pamjen e njeriut. Idhujt nuk adburoheshin si gurë, por besonin në qenien e zotit në brendi të tij dhe i adburonin duke dashur që të shfytëzonin fuqinë hyjnore në të. Nga ai pritnin ndihmë. Madje, sikur që shpjegon Kur'ani se disa thoshin "ne ata nuk i adbuojmë për diçka tjetër, por që të na afrojnë më tepër te Allahu". Ata besonin se idhujt ishin ndërmjetësues te Allahu; prisnin prej tyre fitim botëror, pasuri, shëndet, jetë të gjatë.¹⁶⁵

b. Ismaili/Ishmaeli

Është djali i Ibrahimit i lindur prej Haxheresë, me origjinë nga Egjipti, që ishte robëreshë e Sarasë, gruas së Ibrahimit. Sipas Dhiatës së Vjetër, kur ka lindur Ishmaeli, Abrahami ka qenë në moshën 86 vjeçare, kurse kur ka lindur Is'haku ka qenë në moshën 100 vjeçare. Kur Abrahamit, për shkak të xhelozisë së Sarasë iu kërkua që Haxherenë dhe Ishmaelin t'i nxjerrë prej shtëpisë, Ishmaeli ishte në moshën 18-20 vjeç.¹⁶⁶ Transmetimi se kur Ismaili me nënën e tij kanë dalur nga shtëpia, Ismaili ka qenë ende foshnje, baset vetëm në Dhiatën e Vjetër.¹⁶⁷ Dhiata e Vjetër shpjegon se, Ismaili me nënën e tij janë vendosur në jug të Sinasë, në shkretëtirën Paran, pak më larg nga Abrahami.¹⁶⁸ Kurse lajmi i Kur'anit, se Ibrahim i gruan dhe djalin e tij i ka dërguar shumë larg, në Mekken e sotme, është realizuar kur ai ka qenë 15-20 vjeç. Ndërtimi i Qabesë bashkërisht nga të dy tregon se Ismaili ka qenë në moshë që mund t'i ndihmonte babait të vet. Pas një kohe Ibrahimit me një dëshëprim të madh ndabet prej djalit të tij me këtë lutje:

"Zoti im! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Tënde të Shenjtë..."¹⁶⁹

Ismaili martohet me një vajzë të familjes Xhurhum, që janë prej endacakëve të rrethit. Nëna e tij Haxhereja vdes këtu. Thuhet se Ibrahimit ka ardhur disa herë për të vizituar djalin e tij.¹⁷⁰ Nga shprehja "Përkujto kur Ne e udhëzuan Ibrahimin për në vendin e shtëpisë (Qabesë)..." (Haxh, 26), kuptohet se Ibrahimit, Haxherenë dhe Ismailin për një detyrë e ka sjellur prej Palestine me urdhërin e Allahut dhe atij i është treguar vendi për ndërtimin e Qabesë. Ismaili, karvaneve që kanë ardhur prej Mekkes dhe rrethit si dhe endacakëve ua ka mësuar besimin në njëshmërinë e Allahut. Përhapja e ngjarjes si një mosmarrëveshje xhelozie mes dy grave, është në kundërshtim me pejgamberllëkun e Ibrahimit dhe tepër e thjeshtë. Ndërkaq, edhe fëmijët e lindur prej martesës pas Sarasë, me të ardhur në moshën e pjekurisë i ka dërguar të vendosen në zona të ndryshme të rajonit. Me siguri qëllimi ka qenë përhapja e

¹⁶⁵ Sarıkcıoğlu, "Kur'an'a Göre Müşrikler", *İslami Araştırmalar Dergisi*, Korrik 1986.

¹⁶⁶ Zanafilla, XVI, 16, XXI, 5-11; *Talmud*, 52.

¹⁶⁷ Zanafilla, XXI, 14-20.

¹⁶⁸ Zanafilla, XXI, 21.

¹⁶⁹ Kur'ani, *Ibrahim*, 37.

¹⁷⁰ *Talmud*, 53 dhe në vazhdim.

besimit monoteist. Këtu kuptohet se Haxhereja me ndjenjën e nënës ka zgjedhur anën e Isamilit dhe nuk është ndarë prej tij.

Ismaili vdes në moshën 137 vjeçare¹⁷¹ dhe varroset pranë varrit të nënës së tij, Haxheresë.

c. Hanifët

Në Gadishullin Arabik, sidomos në mesin e politeistëve të Hixhazit kishte edhe disa që quheshin “*hanif*”. Këta nuk ishin as hebrej, as të krishterë. Ata besonin në njëshmërinë dhe në ekzistencën e Allahut dhe në lutjet e tyre i drejtoheshin vetëm Allahut. Ata besonin se e jetojnë fenë e Ibrahimit. Vetën e tyre nuk e ndjenin të obliguar me propagandë të fesë, por vazhdonin me besimin e tyre në monoteizëm. Në Kur’an ka shenja për këtë.¹⁷² Këta ka mundësi të jenë besimtarë që janë përpjekur ta jetojnë fenë e Ismailit.¹⁷³


¹⁷¹ *Zanafilla*, XXV, 17.

¹⁷² Kur’ani, Ali Imran, 60; Rum, 30; En’am, 79; Junus, 105.

¹⁷³ Şaban Kuzgun, *Hız İbrahim ve Hanifilik*, Ankara 1985, f. 148.

FETË E VJETRA TË EVROPËS

Kur themi fetë e vjetra evropiane menjëherë na kujtohen fetë, si besimet dhe mbeturinat deri më sot të popujve romakë, teutonë (fis i vjetër gjerman), keltë dhe sllavë, në krye me fenë e vjetër greke.¹⁷⁴ Këto janë besime të vjetra të kontinentit evropian, simpatizues të të cilave thua se sot nuk ka fare. Sidomos fetë romake dhe greke, me idhujt dhe tempujt e tyre madhështorë e të lënë pas, kanë stolitur artin botëror.



¹⁷⁴ Edhe feja e vjetër e shqiptarëve është me rëndësi të përmendet këtu. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe janë autokton në këto troje, kurse gjuha e tyre llogaritet gjuhë indo-evropiane. Shqiptarët, të cilët sot njihen si popull me shumicë muslimane dhe pjesa tjetër krishtere, kanë edhe besimet e tyre pagane të bazuara në kulte të ndryshme. Në disa raste kultet e tilla janë përvetësuar nga besimet e mëdha të shpallura që ekzistojnë në mesin e shqiptarëve. Kryezoti i panteonit ilir është *perëndia* (parjana, perun), i cili llogaritet qenie supreme. Emri i njëres prej ditëve të javës, që është e *bëna*, mendohet të ketë lidhshmëri me emrin e zotit Hen ose En të Babilonisë dhe të Mesopotamisë. Rol të madh luan kulti i *tokës mëmë*, që ka të bëjë me pjellorinë e saj dhe me zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi. Tek ilirët gjithashtu është i përhapur edhe *beliolatria* (adhurimi i diellit). Gjurmët e shumta të këtij kulti shprehen përmes motiveve të ndryshme që zbulonin objekte të veçanta dhe që në mënyrë grafike simbolizojnë diellin. Për shembull, rrathët bashkëqendrorë, svastikat, spirallja etj. Ky kult diellor tek ilirët shprehej edhe përmes varësive të ndryshme në formë kali, kaprolli, zogu etj. Tek ilirët e krahinave jugore shumë i përhapur ishte edhe *kulti i gjarpërit* si simbol i pjellorisë, si totem, si qenie mbrojtëse nga syri i keq (apotropeike). Ky kult ndryshe quhet gjarpëri (bolla ose vitore) i shtëpisë. Fjala vitore në popull përdoret për të treguar rojen e shtëpisë që besohet se është një gjarpër i shkurtër dhe i trashë; një grua që ka lindur shumë fëmijë; fatitë për të cilat besohet se i vijnë foshnjës te djepi, natën e tretë, për t'i caktuar fatin etj. Përveç që është konsideruar fatsjellës e me cilësi shqetësuese, gjarpëri është konsideruar edhe si zotërues i tokës dhe i nëntokës, mbrojtës i shtëpisë dhe i familjes etj. Prej kulteve autoktone ilire është edhe *kulti i të parëve*, i cili ka të bëjë me konceptin e zanafillës së gjenealogjisë së hyjnëzuar, të personave udhëheqës të heroizuar. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet besimi në *jetën e përtej varrit* dhe *ekzistimin e fuqive mistike*, të cilat jetonin në mesin e njerëzve dhe u shkaktonin sëmundje e fatkeqësi. Kurse ilirët, për t'i larguar ato fuqi mistike, sajuan forma të ndryshme varësesh (amuleta) me karakter apotropeik etj. Thuhet se në rrethinën e Tiranës (në krahinën e Bendës), një herë, një grua po endte në vegjë. Pasi ajo kishte ndërprerë punën, e bija ia kishte ngatërruar fjetet e penjve. E ëma, pas shumë përpjekjesh, e lodhur dhe e rrsakapitur, e mallkoi duke i thënë: “Ti moj bijë, gjithmonë endsh dhe kurrë gjë mos bëfsh!”. Nga ky mallkim vajza u shndërrua në merimangë që gjithmonë përpiqet, por nuk arrin të endë një pëlhurë. Në disa krahina flitet për *plakën e vatrës* apo *hyjninë e vatrës*. Sipas një legjende vatra e shtëpisë ruhet nga një grua e moshuar, e cila tjerë ose end vazhdimisht. Ndaj ishte zakon që natën pranë vatrës gjithmonë të lihej një copë bukë e pak ujë për kërë grua. Gjithashtu, legjenda tregon se, kur mbarohej së enduri, nuk duhej lënë vegja bosh (pa fije maje ose pa një copë pëlhurë të endur), sepse lënia bosh e vegjës apo e drugëzave besohej se ndillte shkretim të shtëpisë dhe fatkeqësi për atë që end. Sipas legjendës vegja nuk duhet mallkuar, pasi në të endet për njeriun dhe me fije leshe të deles, e cila konsiderohej e bekuar. Gjithashtu me rëndësi është të përmendet *kulti i pemës në ceremoninë e dasmës*. Në Mallakastër pasi e përcillte vajzën e bërë nuse për në shtëpi të burrit, në të kthyer, e ëma mblidhte karthi dhe i hidhte në zjarr, me qëllim që të digjeshin gojë e liga. Po ashtu, ia vlen të theksohet edhe *kulti i zjarrit, i erërave, i redonit, i medanrit, i diellit, i hënës* etj. Sa i takon besimit pagan dhe kulteve tek ilirët është me rëndësi të përmenden edhe kultet që vijnë si pasojë e sinkretizmit mes besimit ilir me atë grek dhe latin. Kështu, këtu mund të përmendim kultin e *bukura e dbent, nusja e malit, zana, fati, shtriga, vampiri, xbindi, syri i keq* etj. (Shih, *Historia e popullit shqiptar*, v. I, ASHSH-III, Toena, Tiranë, 2002, f. 55-56; Poghirç, Cicerone, *Albanian Religion, Encyclopedia of Religion*, (ed. Mircea Eliade), v. I, New York, Macmillan, 1987, f. 178-180; Zeqo, Moikom, *Panteoni ilir*, Globus R, Tiranë, 1995, f. 77-101 dhe 119-130; Tirta, Mark, *Gjarpëri në mitologjinë shqiptare, Kultura popullore*, Nr. 1-2, ASHRSH-IKP, Tiranë, 1997, f. 17-30; Onuzi, Afërdita, *Besime e rite rreth mjeshtrësisë së endjes, Kultura popullore*, Nr. 1-2, ASHRSH-IKP, Tiranë, 1997, f. 47-50; Jacques, Edwin E., *Shqiptarët*, v. I, Kartë e Pendë, Stamboll, 1996, f. 16-40.) (Shënim i përkthyesit).

1. Feja e vjetër e Greqisë

Literatura: Hans-Joachim Schoeps, *Religionen*, Gutersloh 1964, f. 137-153; H. von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, f. 131-143; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f. 452-484.

Feja e vjetër greke, sikur fetë e vjetëra babilonase dhe egjiptiane, është një besim politeist. Kështu që Zeusi adhurohet sikur Apolloni romak, Amon-Ra-i egjiptian dhe Eli i Arabisë Veriore. Në të gjitha këto fe besohet në luftën mes zotave dhe shpjegohet mitologjia e tyre. Kjo fe i reflekton periudhat parahistorike të ngritura në botën e mitologjive.

Në kohën kur *Bijtë e Izraelit* dolën nga Egjipti dhe nën komandën e Musait u nisën drejt qytetit Kenan të Palestinës, dorët (shek. XII. para e.s.), pasues të *ijonëve* dhe *akejve*, vërshuan drejt Greqisë, ku gjetën një kulturë të zhvilluar. Por nuk dimë se çfarë i kanë shtuar ata konceptit të tyre fetar nga popujt e mëhershëm. Krahas asaj që shiheshin më tepër ndikimet e forta të kulturës së ishullit të Kretës dhe të Anadollit, ende nuk është e shpjeguar sa duhet dalja e kulturës dhe e botëkuptimit të këtij ishulli. Por, nuk ka dyshim se marrëdhëniet mes Sirisë dhe Anadollit kanë qenë të forta.

Njohuria jonë për fenë dhe adhurimin grek, kryesisht, bazohet në burime arkeologjike. Këta janë kryesisht tempuj të gjetur si rezultat i gërmimeve arkeologjike, vizatime që paraqesin zota, dhurata sakrificash, mbishkrime, statuja prej guri dhe prej tullave, enë dhe mbishkrime fetare. Gjithashtu, këto shpjegime i marrim edhe prej lajmeve të panumërta të shkrimtarëve të vjetër, prej tregimeve dhe legjendave mitologjike, prej shkrimeve që i shpjegojnë autorët e krishterë, me qëllim që të kritikojmë besimin e adhurimeve të idhujtarëve.

a. Bota e zotave të Greqisë

Grekët e vjetër zotat e tyre i shihnin si paraqitje mbinatyrore të qenies njerëzore. Zotat qëndrojnë në një vend lartë në qiell dhe e udhëheqin botën. Sidomos, përfytyrohet se ata qëndrojnë në majë të malit Olimp, dhe shumica e tyre janë të mbuluar me mjegull në një lartësi prej 3000 metrash në Tesalja. Këtu sundon Zoti i qiellit, Zeusi, që është ati i zotave dhe i njerëzve. Ai është mbrojtësi i drejtësisë dhe i të vërtetës, i caktimit dhe i rregullimit botëror. Sipas Homerit, ai është zoti i vetëm që me njerëzit nuk lidhte marrëdhënie direkte, por kontaktonte nëpërmjet të të dërguarve. Ky lartësim i Zeusit, sikur në shumicën e feve politeiste, paraqet prirjen e grekëve kundër henoteizmit.¹⁷⁵ Në këtë lartësim, një pjesë e zotave janë zhdukur në trupin e Zeusit, kurse disa të tjerë vazhdojnë të jetojnë si emra të ndryshëm të Zeusit.

Zeusi, si Zot i Qiellit, në duar të tij e ka rregullin botëror. Ai di të tashmen dhe të ardhmen. Ai mbron shenjtërinë e betimit, të drejtën e misafirit dhe të refugjatit. Ai, gjithashtu është edhe mbrojtës i shtëpisë, familjes, dhe i shtetit. Festa më e njohur për të, që bëhet një herë në katër vjet, është ceremonia e Olimpiadës, ku marrin pjesë të gjitha qytetet dhe familjet greke. Gjatë ceremonive rreptësisht është e ndaluar gjakderdhja. Në këtë kohë, ngjashëm me “muajt e ndaluar” të arabëve, në tërë Greqinë sundon paqa. Sipas Homerit, *lojrat e para Olimpike në Greqi kanë filluar në vitin 776 para e.s.* Vetëm se, këto lojra, të cilat pandërprerë kanë zgjatur mbi një mijë vjet, janë ndërprerë me sundimin e krishterimit, në kohën e mbretit Theodosius, në vitin 393 të e.s. Është shumë i njohur tempulli i Zeusit, i lartë 22 metra, i ndërtuar në malin Olimp, në vitin 460 para e.s. Brenda tij gjendet idhulli i zotit i ndërtuar prej ari dhe fildishi. Gruaja e Zeusit është Hera. Për nder të saj organizoheshin lojëra dhe gara

¹⁷⁵ Henoteizmi (*Henotheism*) është doktrinë teologjike sipas së cilës besohet në shumë zota, kurse vetëm njëri prej tyre pranohet si zoti më i lartësuar i familjes apo klanit. Ky term është përdorur që në shekullin XIX nga ana Max Mullerit dhe F. W. J. Schellingut dhe dallon nga monoteizmi. Në henoteizëm edhe pse besohen shumë zota, përveç zotit kryesor të tjerët lihen mbas dore. Për shembull, në fenë e vjetër hinduse pranohej ekzistenca edhe e zotave të tjerë por vetëm Indra adhurohej si zot më i madh. Gjithashtu në hebraizëm në disa raste haset në henoteizëm. Qasja që i bëhet zotit Jahve në Tora është më afër henoteizmit se sa monoteizmit. (Shih, Gündüz, Şinasi, *Din ve İnanç Sözlüğü*, Vadi Yayınları, Ankara, 1998, f. 165). (Shënim i përkthyesit).

të veçanta, në të cilat merrnin pjesë vajzat e reja. Në tempullin më të vjetër të Olimpiadës gjendet edhe idhulli i Heras.

Zeusi ka lidhje edhe me vendin e kultit të Dodonës, që është zot i natyrës dhe i fallit. Ai adhurohet në veri të Greqisë në një Zabel Dushku. Në disa raste përfaqësohej me vizatimin e një kau, i cili llogaritej zot i prodhimit. Sipas mitologjisë, ai, duke u shndërruar në ka, e rrëmben vajzën e mbretit Finike, Evropën, dhe e dërgon në ishullin e Kretës. Në të njëjtën mënyrë e rrëmben edhe Ganymedin, një djalë i mirë dhe i bukur i një mbreti, dhe e çon në malin Olimp. Ganymedi, me urdhërin e Zeusit është bërë verëbartës i zotave në malin Olimp. Këto mendime për Zeusin, tregojnë se ai ka patur lidhje të ngushta edhe me zotat e bimëve që vdesin dhe ringjallen.

Kurse një zot tjetër që në vlerë mund të krahasohet me Zeusin, është Apolloni, zoti i mëshirës. Ky në fillim ka dalë në shesh në Anadoll, si një zot tiran që përhap tmerr, kurse më vonë plotësisht i është përshtatur shpirtit grek. Vendi kryesor i kultit të tij, më herët ishte Delphi, ku gjendej edhe kulti i një zoti të gjarpërit. Siç kuptohet prej mbi 200 emrave të kulteve, edhe Apolloni në trupin e tij përfshin shumë zota. Ai në veten e tij ka trupëzuar bukurinë, muzikën dhe ahengun dhe kulti i tij është përhapur në tërë Greqinë dhe në Anadoll. Shenja të madhështisë së tij janë *barku*, *organo* dhe *dafina* (*defne-bay*). Në çdo katër vjet në Delphi, në emër të Apollonit, organizoheshin lojëra. Në tempull, ku llogaritej se është mesi i botës, gjendej një gurë i madh. Mbi këtë gur kishte një podium me tre këmbë ku qëndronte një fallxhore, që lajmëronte për ardhmërinë. Për këtë, në tempullin e Apollonit shkohej për punët e shtetit, për formimin e kolonive dhe për këshillim për çështjet që kishin të bëjnë me punët ditore. Në gjendje lufte, sëmundje ngjitëse ose në gjendje prodhimi të keq, atje caktoheshin lëmoshat për zhdukjen e hidhërimit të zotit.

Hyjnesha e tokës dhe gruaja e Zeusit, Gaja, që është njëra prej anëtareve gra në kuvendin e zotave në malin e Olimp, llogaritej njëra prej hyjneshave me rëndësi. Gruaja tjetër e Zeusit, Hera, ishte hyjnesha që mbronte në të njëjtën kohë edhe gratë edhe martesën. Kurse Athena, hyjnesha mbrojtëse e qytetit të Athinës, në fillim e lidhur me një fetish ka hyrë në Akropolis. Edhe pse ishte një hyjneshë e qytetit, në shumë vende në Greqi, ajo është konsideruar e shenjtë. Vajza e Zeusit, Pallas Athena, ishte një hyjneshë e luftës, e cila gjithashtu llogaritej zbuluese e makinës luftarake, e fyellit, e parmendës dhe e tryezës për endje. Për nder të saj çdo vit organizoheshin veprimtari muzikore, netë gazmore, bëheshin gara sportive.

Poseidon, është vëllai i Zeusit dhe zot i detit. Është një zot që ka ekzistuar edhe para formimit të shtetit grek. Llogaritet edhe burri i hyjneshës së tokës. Saraji i tij gjendet në thellësi të detit. Vendi më i madh i kultit të tij është në Isthmos të Korintit. Për nder të tij çdo vit organizoheshin gara me karroca. Ai në të shumtën e rasteve adhurohet dhe përfytyrohet në formë të pelës. Pegasos, që është pela me fletë e qiellit, mendohet të ketë prejardhje prej Poseidonit.

Vëllai tjetër i Zeusit është Hadesi, i cili konsiderohet zot i botës nëntokësore. Besohet se ai gëzon sovranitetin mbi hijet. Këtij zoti të pamëshirë dhe fitimtar për kurban i theret një dele e zezë dhe në të njëjtin moment duart përplasen për tokë. Njëri prej zotave të rëndësishëm, kulti i të cilit ishte i përhapur në tërë Greqinë, është edhe Hermes. Ai përfytyrohet si djalë i Zeusit dhe i dërguari i zotave. Ai konsiderohej përfaqësues i shpejtësisë dhe udhëheqës i shpirtërave. Besohej se ai i çon shpirtërat te Hadesi, se është dhënës i ëndërrave dhe është ai që njerëzit i zgjon apo i vë në gjumë duke i prekur në sy me shkopin e tij. Hermes llogaritet edhe zbuluesi i fyellit dhe i rebabit (lloj violine në Azi të Mesme). Ai udhëheq korin muzikor të hyjneshave dhe të zanave të bukurisë. Ai kishte një ekzistencë mistere. Në Azinë e Mesme haset në përfytyrimet për Hidrin (Hëzrin), i cili u ndihmon njerëzve dhe paraqitet përpara tyre papritmas dhe në format dhe kohërat që nuk shpresohet të paraqitet. Ai ishte padroni mbrojtës i udhëtarëve, i rrugëve dhe i tregëtarëve, por, në të njëjtën kohë ishte edhe i vjedhësve dhe i mashtruesve. Hermes, i cili posedon veçanësi të ndryshme, respektohej edhe si zot i barinjve dhe i bollëkut. Shtyllat Phallus të vendosura nëpër udhëkryqe për nder të tij, llogariteshin të shenjtë. Këto shtylla guri me emrin "hermenë", të vendosura nëpër rrugët dhe nëpër sheshet e Greqisë, janë simbole të gjinisë mashkullore dhe të fuqisë së jetës. Simbolet Hermes, gjenden edhe në hyrje të shkollave për mundje dhe në hyrje të ndërtesave që janë të hapura për shërbim popullit.

Përveç zotave të lartpërmendur, në fenë e vjetër greke kishte edhe zota të tjerë që kanë luajtur rol të rëndësishëm. Prej tyre është edhe Ares, zoti i fuqisë, i cili është edhe përfaqësuesi i egërsisë dhe i çmendurisë në luftë. Artemis, ishte hyjnesha e gjuetisë, të cilën e shoqëronin zanat. Afrodita ishte

hyjnesha e dashurisë dhe e bukurisë. Sipas mitologjisë, ajo është krijuar prej shkumës së detit në Qipro. Kulti i saj në Korint është bashkuar me kurvërinë e shenjtë, që të bën me dije se është ndikuar nga kulti babilonas, *Ishtari*. Burri i saj ishte Hefaistos, kurse djali i saj ishte Erosi, zoti i dashurisë. Zjarri i kurbanit dhe zoti i vatrës ishte Hestija. Prej zotave të rëndësishëm janë edhe Pan, zot i bariut; Ajdos, zot i erës; gruaja e tij dhe hyjnesha e muzgut (agut të mëngjesit) ishte Eos dhe zoti i hënës ishte Helana.

Zotat e Greqisë së vjetër, të cilët i shpjegon Homeri, sipas Aristotelit janë *njerëz të pavdekshëm*. Në aspektin etik nuk janë shumë mbi njerëzit, kurse në aspektin e fuqisë janë mbi ta. Edhe zotat, sikur njerëzit, dashurohen, gëzohen, zemërohen, hidhërohen dhe përjetojnë dhimbje. Në çdo punë të tyre kanë qëllime mistere. Për këtë edhe nuk u besohej tepër. Ata qëndronin në botë dhe nuk kishin fuqi kur të dëshironin.

Besohej se mbretërit janë prej fisit të Zeusit dhe ata besonin se mbretin e zgjedh Zeusi. Mbretërit, si përfaqësues të Zeusit në tokë, ishin të obliguar t'i udhëhiqnin ceremonitë fetare. Ata në të njëjtën kohë llogariteshin edhe si kryemurgjër. Vetëm se ata nuk synonin qartë në hyjni sikurse ishte rasti me faraonët. Ata punonin në emër të Zeusit dhe betoheshin se do ta sendërtojnë të vërtetën dhe të drejtën në emër të tij.

b. Konceptet për jetën pas vdekjes

Sipas koncepteve shumë të vjetra, besohej se të vdekurit vazhdonin të jetonin në varreza në afërsi dhe pas një kohe të caktuar ktheheshin përsëri në botë. Krahas këtij koncepti ata besonin se të vdekurit dhe hijet e tyre jetonin në nëntokë, ku gjendej *bota e të vdekurve*. Ata, për shkak që nuk mund të dilnin në sipërfaqe të tokës, jetonin të mërzhitur. Megjithatë, të zgjedhurit dhe shenjtorët shkonin në *isbullin e shenjtorëve*, që quhet "Elysium" dhe sipas parafytyrimeve ai gjendet në skajin perëndimor të botës. Nuk mungojnë edhe ata të cilët besojnë në botën e ardhshme dhe jetën pas vdekjes. Akili në veprën "*Odisea*" ka thënë: "*Kundër vdekjes, ku jetë nuk ka aspak, me plot dëshirë preferoj një jetë ditore të punëtorit, punën e një bujku që punon për ngopjen e barkut*". Me këtë jepet shenjë se ka edhe nga ata të cilët nuk e pranojnë edhe atë besim të dobët në botën e ardhshme.

Nevojën për besim në botën e ardhshme të grekëve të vjetër janë munduar ta plotësojnë *fetë mistere* me përshkrime konkrete. Sipas kësaj: mëkatarët do të dënohen në një ferr nëntokësor, kurse të mirët do të shpërblehen në një botë hyjnore, gjegjësisht në *Isbullin e mbretërve*. Sipas konceptit shpirtëror të përgatitur nga Orfikët (Orphik) periudhat e më vonshme, shpirti pas zhdukjes së trupit vazhdon të jetojë i lirë. Trupi është varri i shpirtit, shpirti pasi të shpëtojë prej trupit, takohet me jetën e vërtetë. Sipas tyre, njerëzit gjenden në një shpërngulje të shpirtit të rimishëruar (reinkarnacion). Shpëtimi realizohet vetëm me anë të shpëtimit nga rrethi i rimishërimit. Disa filozofë të njohur, si Pitagora, Empedokle, Platoni ishin në këtë besim të orfikëve.

c. Reagimet ndaj politeizmit

Dihet se shkolla orfike është kundër politeizmit. Sidomos, Ksenofoni ka luftuar kundër besimeve në shumë zota dhe kundër koncepteve mitologjike për zotin. Ai kritikon Homerin dhe Hesiodin. Ai thotë se këta, zotit ia kanë veshur të gjitha punët e këqija që kanë të bëjnë me njerëzimin; zotat i kanë konceptuar në formë të njeriut dhe kanë menduar se ata mund t'i bëjnë të gjitha punët e këqija si vjedhjen, amoralitetin, rrenën etj., dhe vazhdon duke thënë: "Sikur kau dhe luani të kishin mundësi të vizatojnë, zotat e tyre do t'i vizatonin në formë të kaut dhe të luanit. Kështu edhe çdo popull zotit të vet do t'i jepte cilësitë e tij. Kështu që të zinjte zotin e tyre do ta mendonin me hundë të rrafshë dhe me flokë të zeza kaçurrela. Kurse, përkundër kësaj, njerëzit e Trakisë veriore do ta mendonin një zot me sy të kaltërt dhe flokë të verdha".¹⁷⁶

Sipas Ksenofonit, në fakt Zoti është shumë larg të gjitha këtyre cilësive. Asnjëra nga këto nuk mund t'i përshkruhet zotit. Zoti është një, i pafund dhe i palëvizshëm. As lind, as vdes e as ndryshon. Megjithatë, zoti i udhëheq të gjitha ndryshimet dhe të gjitha lëvizjet në botë. Ky Zot, i cili asnjëherë nuk lëviz dhe nuk ndryshon, sheh dhe dëgjon çdo gjë. Ksenofoni e pranon edhe ekzistencën e zotave të tjerë. Por, mbi të gjitha ata zota, vëndon këtë Zot të fortë dhe një, i cili

¹⁷⁶ Birand, *Ilk Çağ Felsefesi Tarihi*, f. 17.

*udhëheq botën. Ai gjithashtu pranon ekzistimin edhe të zotave që varen prej Zotit një.*¹⁷⁷

Sipas Heraklitit, parimi *logos*, i cili udhëheq botën, dhe *zoti* janë të njëjtë. Zoti është i njëjtë me logosin, i cili rregullon dhe udhëheq botën dhe vetë gjendet brenda në botë. Logos ndikon në çdo pikë të botës, ai ka punuar në brendësi të çdo pjese të botës. Kështu që shpirtërat individualë janë pjesë të logosit, shpirtit të botës. Pasi njeriu vdes shpirti kthehet te tërësia. Zoti që i rregullon ngjarjet në botë, gjithashtu është brenda në botë. Herakliti me këtë mendim të tij mbron një *mendim panteist dhe monoteist*.¹⁷⁸ Ndërkaq, sipas Parmenidit, kjo botë dhe zoti janë një, janë të njëjtë. Ai është vetë ekzistenca.

Njëri prej kundërshtarëve të fesë tradicionale greke është Anaksagora. Ai thotë se zotat që adhurohen nuk janë gjë tjetër në thelb, veçse janë grumbuj gurëzish. Për këtë dhe është fajësuar si mosrespektues i zotave dhe është syrgjynosur prej shtetit të tij.¹⁷⁹

2. Feja romake

Literatura: H. J. Schoeps, *Religionen*, f. 156-164; H. von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, f. 158-168; F. Heiler, *Die Religionen Menschheit*, f. 484-500.

Feja e romakëve është zhvilluar prej një përzierje të elementeve të kultit të shteteve të ndryshme, të cilat i kanë patur nën sundim. Parimet themelore të tyre, në ceremonitë fetare dhe në kult, i kanë mbrojtur duke filluar prej periudhës perandorake. Në gadishullin italian, që në periudhat e vjetra kanë banuar popuj indu-xhermenë dhe latinë dhe janë marrë me bujqësi. Po ashtu në këtë gadishull kanë banuar edhe etruskët, për të cilët mendohet se kanë ardhur prej Anadollit në Italinë e Mesme dhe gjuha e tyre sot është një gjë e pazbërthyer.

Feja e etruskëve ka ndihmuar shumë në zhvillimin e fesë romake. Sidomos kjo kuptohet prej besimit në botën e ardhshme dhe kultit shumë të zhvilluar dhe është prej metropolëve (qytete të vdekurish) të stolisura me vizatime nëpër mure dhe me varreza momentalisht të mbrojtura. Gjithashtu, sipas etruskëve besohet se, prej vëzhgimit të fluturimit të shpezëve, prej studimit të mushkërive të zeza dhe zorrëve të kafshëve kurban, mund të kuptohet dëshira e zotit dhe ardhmëria.

Kurse popujt, si *latinët* dhe *sabinët*, në përgjithësi banonin në qytete. Qyteti më i njohur nga këta ishte Roma. Çdo popull kishte kultin e vet special dhe kulti më i rëndësishëm ishte ai i Jupiterit Latiarisit. Pasi që qyteti i Romës e mori autoritetin politik prej latinëve (deri në shek. IV para e.s.), kulti i Jupiterit është zhvilluar dhe është festuar me ceremoni madhështore. Njëri prej zotave të rëndësishëm është edhe zoti i hënës, Diana. Ai adhurohet nga ana e të gjithë latinëve. Vendi më i njohur i kultit të tij është një zabel në një skaj të detit (liqenit) Nemi në Arixhia. Kulti i tij ka vazhduar edhe në periudhën e perandorisë.

Feja e vjetër e Romës është një model i fesë popullore, i ndërtuar mbi kultin familjar dhe shtetëror. Për këtë arsye romakët nuk llogariten krijues të fesë së tyre speciale. Nevojat fetare i plotësojnë nga besimet e tjera. Nëse këtu haset në elemente të huaja fetare, nga kjo shihet se feja romake ka tre rryma kryesore, të cilat janë: në shek. VIII para e.s. etruskët, në shek. VI para e.s. grekët dhe në shek. III para e.s. valët helenistike-lindore. Vetëm se, përzierja e këtyre feve, që në fillim të fesë romake, ka filluar me bashkimin e elementeve *etruskë* dhe *latinë* dhe kështu është krijuar feja, e cila quhet “*Feja e vjetër e Romës*”.

¹⁷⁷ Birand, f. 17-18.

¹⁷⁸ Birand, f. 19.

¹⁷⁹ Birand, f. 24.

a. Bota e zotave të Romës

Sipas njoftimeve të vitit 753 para e.s. të arritura deri në kohën tonë, triniteti më i lartë dhe më i vjetër i qytetit të vjetër të Romës, qytet ky i themeluar nga ana e dy vëllezërve binjakë, *Romulus* dhe *Romus*, përbëhej prej Jupiterit, Marsit dhe Quirinusit. Çdo njëri nga këto zota posedonte një murg special kulti. Vendin më të lartë pas mbretit në shkallën e kultit të murgjive, e zinin ata. Jupiteri ishte një zot tipik indo-xhermen. Në periudhën e mëvonshme ai konsiderohej i njëjtë me Zeusin. Ai besohej si zot i dritës dhe ditët e hënës së plotë i përshkruheshin atij, sepse atë ditë me perëndimin e diellit nuk shuhej drita e tokës dhe e qiellit. Gjithashtu në të njëjtën ditë murgjit e Jupiterit, në kalanë e Romës, për vete thernin një dele të bardhë për kurban. Këtu kishte një shesh të lirë vetëm për fallxhorët. Fallxhorët nga aty vëzhgonin gjendjen e qiellit, fluturimin e shpezëve, gjithashtu prej aty mundoheshin të mësonin mendimet dhe dëshirat e Jupiterit për ardhmërinë. Në vitin 509 para e.s., në skajin jugor të kalasë u ndërtua një tempull i madh i Jupiterit, kurse më herët këtu gjendej tempulli i Jupiter Feretriusit. Ai mëkatet e tij i ka mbytur me një vetëtimë. Murgjit e Jupiterit llogariteshin mbrojtësit e marrëveshjes. Gjithashtu këtu kishte një *fetish* (një gur të shenjtë). Marrëveshjet bëheshin pranë këtij guri dhe gjatë kësaj kohe bëhej kurban një derr, cili vritej me shtizë. Kuptimi i kësaj është: “*Kështu sikur shtizë që e vrau derrin, edhe Jupiteri do ta vrasë popullin romak, nëse ai nuk e mbron marrëveshjen dhe nuk i kryen obligimet*”. Sikur që Hera është gruaja e Zeusit, edhe Juno u bë gruaja e Jupiterit. Derisa romakët i braktisën plotësisht zotat e paraardhësve të tyre, besnik i qëndruan zotit më të lartë, Jupiter Optimus, Maximus (më i madh, më i mirë). Populli dridhej para tij. Madje një i huaj, si Antichuse Epiphanes, në kryeqytetin e tij ndërtoi një tempull dhe u mundua me mish e me shpirt të përhapë kultin e tij. Vetëm hebrenjtë ishin ata të cilët përpara Jupiterit kanë patur mundësi të mbronin besimet e tyre dhe superioritetin e zotit. Por, ky kundërshtim nuk pati sukses, kështu që në kohën e Hadrianit, mbi mbeturinat e Tempullit të Solomonit në Jerusalem u ndërtua *Tempulli i Jupiterit*, i cili ishte zot kryesor romak. Ky tempull qëndroi deri në kohën e dominimit të Krishterimit.

Një zot tjetër si Jupiteri ishte Marsi. Ai ishte zot i popullit dhe mbrojtësi i popullit, i qytetit dhe i prodhimit. Jashtë murit të qytetit në sheshin e Marsit, në emër të tij është ndërtuar një *altar*. Populli njëherë në pesë vjet, për pastrim shpirtëror, merr pjesë në adhurim dhe në ceremonitë fetare për të. Punët e pastrimit hyjnor në arat e mbjellura, po ashtu bëhen me emrin e tij. Në festat e Marsit pastroheshin kuajt, armët dhe brirët për luftë. Gjatë adhurimit, zotin e përfaqësonte një shtizë në altar. Murgjit duke u ngjeshur me armë, bënin vallëzime magjike. Këta simbolizonin fitoren e Romës dhe zdukjen e armikut. Gjithashtu për nder të tij shumë herë brenda çdo viti organizoheshin gara me kuaj.

Kurse zot i tretë është Quirinsi, i cili nuk ishte shumë i njohur. Ka mundësi që në fillim të kishte luajtur një rol sikurse Marsi e më vonë të ishte shkrirë në të.

Zotat e tjerë të vjetër të Romës janë mbrojtësit e shtëpive dhe të arave, kurse ceremonitë reflektojnë kultin e bujqësisë. Hyjnesha Tellus është mbrojtëse e tokës së mbjellur, hyjnesha Ceres mbrojtëse e farës dhe e prodhimit. Për Tellusin në pranverë (15 Prill), gjatë mbjelljes bëhet kurban një lopë e bukur. Kurse pas disa ditëve (19 Prill), bëhen gëzime për Ceres. Edhe Flora dhe Ops janë mbrojtësit e prodhimit. Në realitet çdonjë rajon i bujqësisë kishte zotin e vetë mbrojtës. Emrat e këtyre zotave i mësojmë prej listës së lutjeve e mbetur që moti.

Faunus ishte zoti i kopeve dhe mbrojtësi i drerëve. Për nder të tij, murgjit, për mbrojtjen e kopeve nga ujçit, shëtisnin rreth tij me ceremoni dhe atyre që kishin marrë pjesë në ceremoni u binin me pjesë të lëkurës së kurbanëve dhe i shenjtëronin ata. Besonin se në kopenë dhe në arën ku ata janë prekur me të do të shtohet prodhimi. Në këtë listë të zotave natyrorë mund të futim edhe shumë zota të tjerë. Për shembull, zoti i prodhimit i etruskëve është Saturni (Chronos), në emër të të cilit me 17 Dhjetor bëhet ceremoni dhe për atë ditë zgjidhet mbreti i të çmendurve dhe përgatitet një lloj karnavali. Zoti i ujit Neptoni (Poseidon) dhe zoti i zjarrit Vulkanusi (Hephaistos), veten e paraqesin me karakter grek.

Njëra prej specifikave të fesë romake është ekzistimi i zotave të shtëpisë dhe të familjes. Janus është zoti i derës së shtëpisë. Siç shihet në besimet primitive, sipas romakëve edhe dera e shtëpisë është bartëse e një fuqie mistere. Më vonë Janus u bë zot i fillimit të gjithçkaje. Tempulli i tij hapej në kohën e luftës, kurse në kohë të paqes mbyllej. Vesta ishte zot i vatrës. Të gjitha festat që bëheshin për të, në shtëpi, bëheshin rreth vatrës. Betimet dhe premtimet bëheshin në momentet kur flakët ishin të pastërta

fetarisht. Pasi edhe shteti përfytyrohej si një familje e madhe, zotat si Janus dhe Vesta, u futën në mesin e zotave shtetërorë. Murgjit e Janusit përbënin shtresën më të lartë të murgjive. Kurse murgjit e Vestasë ishin gjashtë vajza beqare. Këto kishin për detyrë që gjithmonë të ndeznin zjarrin e vatrës shtetërore dhe posedonin një shkallë të lartë shpirtërore. Edhe Penates dhe Lares ishin prej zotave të shtëpisë. Gjithashtu edhe respektimi i shpirtërave të paraardhësve të vdekur ishte detyrë e kulteve të shtëpisë. Në kohë të ndryshme sakrifikohej dhe punohej për të fituar simpatinë e tyre.

Së fundi, Geniusi llogaritej forcë prodhuese dhe shpirt mbrojtës. Në fillim ai ishte fuqi e personifikuar për riprodhim. Çdo mashkull posedon Genius, kurse çdo femër posedon Juno. Më vonë Geniusi u pranua si shpirt mbrojtës. Kurse një pjesë e zotave të Romës së vjetër (si për drejtësi dhe për prosperitetin e shtetit) përbëheshin prej trupëzimit të përfytyrimeve konkrete, pa gjak. Ndërkaq në disa raste binin në sy koncepte të ndryshme sipas specifikave të vendeve lokale. Për shembull, rreth kënetave shenjtërohej një hyjneshë e zjarrit me emrin Febris. Zotat e kohës së parë, si të drejtësisë dhe të virtytit, më vonë u shpallën si cilësi të perandorit dhe u shkrirë në personalitetin e tij.

b. Zhvillimi i fesë romake

Me përparimin shpirtëror dhe gjeografik të romakëve, pas shek. VI para e.s., edhe hapësira e interesimit për zotat doli jashtë, bujqësisë, çobanisë dhe jashtë luftërave dhe u zhvillua edhe mëtej. Shumë zota të huaj gradualisht hynë në Romë. Zotat e vendeve të okupuara merreshin me formën e tyre dhe me tolerancën e gjerë të romakëve zinin vend të vazhdueshëm në Tempull. Por, kjo ishte vetëm një tolerancë fetare, por kishte karakter edhe fetar edhe politik, që ndiqej me vetëdije të plotë. Këta zota të huaj, duke i shoqëruar zotat vendës në tempull, pas një kohe filluan të llogariten si zota vendas. Në shek. VI vendin e trinitetit të përbërë prej Jupiterit, Marsit dhe Quirinusit, e morri triniteti i ri të cilin e përbëjnë Jupiter, Juno Regina dhe Minerva. Librat magjikë në lidhje me kultin e Apollos në Delfi, u sollën në Romë dhe u vendosën në bodrumin e tempullit Jupiter. Për Apollon u formua një organizatë e murgjive prej 15 personave.

Me këtë zotat grekë filluan të hynin në Romë. Zotat e parë grekë që u futën në shoqëri janë gjysëmzotat ose trimat mitologjikë, si Caster dhe Pollox, që janë prej fëmijëve të Herkulit dhe të Zeusit. Për këta në qendër të qytetit u ndërtua një tempull. Në emër të Apollonit, në vitin 431 në Romë u ndërtua një vend kulti special dhe aty ai adbuohej si padron mbrojtës i popullit. Artemisi u bashkua me Dianan, njërin nga zotat e vjetër të Italisë. Kafsha e shenjtë e Asclepiosit, zotit të shëndetit, ishte gjarpëri. Shenja e gjarpërit, të cilën e bartin mjekët buron prej këtu. Kurse në vitin 217 sistemi i dymbëdhjetë zotave olimpikë i grekëve u pranua zyrtarisht në kultin shtetëror të Romës. U bashkua me zotat vendës. Më vonë zyrtarisht të njëjtë llogariteshin zotat e poshtëpërmendur:

Zeus-Jupiter, Hera-Juno, Poseidon-Nepton, Athena-Minerva, Ares-Mars, Afroditi-Venus, Apollon-Apollo, Artemis-Diana, Hephaistos-Vulcanus, Hestia-Vesta, Hermes-Mercurius, Demeter-Ceres.

Kështu, sikur që në sheshin e hapur me emrin Agora në Athinë ishin zotat grekë, në Romë në sheshin Forum ishin statujat e mbështjellura me flori. Poashtu edhe mitologjia e zotave Doma u zhvillua dhe ata morën formë dhe ngjyrë të posaçme. Ndërkaq prej shek. III. para e.s., edhe zotat lindorë filluan të ndikojnë në Romë. Kultet e tyre luanin rol të rëndësishëm në vitet e lindjes së Jezusit. Për përzierjen e feve, datë më e rëndësishme është viti 204 para e.s. Sepse pas Luftës së Ponit të dytë, me shtimin e rrezikut përreth Romës, kulti i Magna Materit u soll në Romë. Dhe në vitin 191 në emër të tij u bë një tempull. Kubele adbuohej me emrin Magna Mater. Sidomos, në lidhje me kultin e tij rol të rëndësishëm luante pagëzimi me gjak në fetë mistere, të cilat respektoheshin nga ana e grave.

Nga fundi i periudhës së Republikës, në fe shihet një rënie e përgjithshme. Shkakun e kësaj ka qenë ndikimi i kritikave të fesë greke në ato romake. Për shembull, disa shkrimtarë, si Ciceroni, janë munduar që të lubatin besimin e popullit në zotat e tyre. Gradualisht tempujt filluan ta humbnin atë madhësi që e kishin më herët, ritet fetare filluan të neglizhoheshin, nëpër kalendaret fetare filluan të paraqiteshin përzierje. Perandori Augustos, për të ndaluar këtë zhdukje (shek. XII para e.s.), mori mbi vete edhe detyrën më të rëndësishme të murgjive dhe ndërtoi tempuj të rinj. Dhe kështu është shpallur shenjtëria e Cezarit dhe e Augustinit dhe janë bërë përpjekje për zhvillimin e kultit të perandorit. Pas kësaj sakrifikat janë thënë për Geniusin, kurse thejja është bërë përpara pikturave të perandorit. Jupiteri u shpall kryezoti i perandorisë, kurse kryezotat e tjerë janë llogaritur të njëjtë me të. Po ashtu në këtë kohë në Romë kanë hyrë edhe zotat lindorë, si Izisi, Serapisi, Adonisi etj.

Në vitin 160 para e.s. Izisi, i cili ishte i marrur nga Egjipti në kohën e Caligulas, është pranuar si kult shtetëror, kurse në vitin 38 të e.s. për të është ndërtuar një tempull i veçantë.

Kombinimi i fesë së vjetër romake me fetë e huaja mistere, te romakët ka ringjallur përmallimin e të kuptuarit dhe të shprehurit të problemeve të thella jetike.

3. Feja e vjetër teutone (fis i vjetër gjerman)

Literatura: H. von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, Frankfurt am Main 1963, f. 122-130; H.J. Schoeps, *Religionen*, Gutersloh 1961, f. 118-130.

Teutonët janë një grup i një populli indoeuropian, të cilët në aspektin gjuhësor më afër janë me keltët dhe italikët. Ende nuk është e qartë se emri i tyre rrjedh prej keltëve apo prej teutonëve (gjermanëve). Kjo fjalë shihet në Posejdonjos, në vitin 80 para e.s. Teutonët janë përhapur prej Skandinavisë Jugore dhe prej Gjermanisë Veriore. Ata kishin koncepte të ndryshme dhe nuk kanë patur një fe të caktuar dhe të përbashkët. Ne këtu do të flasim për parimet e tyre të përbashkëta dhe të përgjithshme.

Njoftimet më të vjetra për fenë teutone hasen te Cezari, Straboni, Tacitus, Ammianus, Merellinus, Jordanes dhe Prokop, të cilët janë shkrimtarë të periudhës së vjetër. Më vonë këta i pasojnë aktivitetet e misionarëve krishterë, gjegjësisht lajmet për ligjet kundër traditave të idhujtarisë. Në lidhje me këtë çështje, shumica e teksteve *runen* (tekste të shkruara me shkrim të vjetër teuton) dhe fjalët magjike zënë një vend të rëndësishëm.

Provat më të vjetra të besimit teuton janë ato të mbetura prej Periudhës së Gurit dhe Bronzit në Suedi dhe në Norvegji, të cilat paraqiten nëpër vizatime të ndryshme nëpër shkëmbij. Traditat e tyre për të vdekurit dhe për besimin në shpirtin mund të përcaktohen në bazë të disa mundësive. Edhe pse burimet për madhësinë e teutonëve janë të pakta, në veprat me titull “Edda” dhe “Sagas” gjenden dokumentacione me vlerë për teutonët e vjetër. Vetëm se, pyetja se sa mitologjitë për zotin që shpjegohet nëpër disa tema, mund të jenë të vazhdueshme për të gjitha hapësirat teutone, mbetet pa përgjigje. Megjithatë, përsëri burim kryesor për fenë teutone është Edda.

a. Koncepti për gjithësinë

Gjithësia përbëhet prej nëntë botërave që janë: tre në nëntokë, tre në sipërfaqe dhe tre në qiell. Në nëntokë janë: 1. *Niflheim* (vendi i mjegullës), ku zotëron të ftohtit dhe errësira e vdekjes; 2. *Niflhel* (vendi i zotit Hel), këtu banon zoti i nëntokës Heli. Ata që vdesin prej pleqërisë dhe sëmundjes vijnë këtu; 3. *Alfenheim i Zi*, është vendbanimi i shkurtabiqëve zeshkanë. Në sipërfaqe janë: 1. *Midgard*, bota e njerëzve të mesit; 2. *Jotunheim*, vendi i viganëve të pyllit; 3. *Vanenheim*, vendi i caktuar i krijesave hyjnore. Kurse në qiell: 1. *Muspelheim*, është vend i “Viganëve të Zjarrit” kryetari i të cilëve është Surturi dhe të cilët lëshojnë flakë; 2. *Alfenheimi Dritë*, është vendi i shpirtërave, që janë miq të dritës; 3. *Asgard*, është vendi i zotave. Zotat këtu banojnë nëpër kështjellat e tyre. Kurse toka dhe qielli njëra me tjetrën lidhen me anë të urës të quajtur Bifrost.

b. Zotat dhe kultet e tyre

Zotat më të rëndësishëm të teutonëve janë Frej, Ziu, Donar dhe Wodan. Tacitus këta i konsideron të njëjtë me Marsin, Jupiterin dhe Mërkurin. Më i vjetri nga këta është Ziu (Tyr), Zoti i Qiellit. Te saksonët e vjetër përmendet me emrin *Saxnot*. Ai është përfaqësuesi i jetës së shenjtë dhe i jetës ligjore. Kurse te teutonët perëndimorë dhe ata veriorë është zot i luftës.

Donar, është zot i furtunës dhe i prodhimit, zoti më i dashur i fshatrave të Islandës. Po ashtu, edhe *normanët* dhe *vikingët* e kanë zhvilluar kultin e tij. Kulti i tij edhe në periudhën e Krishetritizmit ka jetuar një kohë të gjatë. Ky zot që cilësohet si mbrojtës i mitologjisë, i adhuruesve të alkoolit dhe i gjarpërinjve Midgard, ka luajtur rolin edhe të mbrojtësit. Arma e Donarit ishte çekani, kurse kali i tij ishte Sleipnir, me tetë këmbë dhe magjik, i cili atë e bartte në ajër. Edhe dy korba që i bartte në shpinë, të cilët çdo gjë që shihnin gjatë fluturimit ia përshtatnin atij dhe e lajmëronin atë.

Frej, ishte prej zotave gra dhe ishte hyjneshë e prodhimit dhe e dashurisë. Sidomos Nerthusi me dy

gjini dhe Frigg, që është nëna e zotave për ardhmërinë dhe gruaja e Odinit, luajnë rol të rëndësishëm.

Feja teutone është besim në shumë zota. Vetëm se edhe besimi në një zot nuk është harruar në asnjë rajon.

c. Murgëria dhe kultu

Popujt teutonë nuk e njihnin klasën e murgjve dhe organizatën e tyre. Flijimin e sakrificave e bënte çdo njeri vetë. Vetëm se, ritualet e rëndësishme i realizonin administratorët botërorë të rajonit. Adhurimi më tepër bëhej nëpër pyje (zabele) dhe vende të shenjta. Më vonë filloi të bëhet nëpër shtëpi, salone për sakrificë. Krallëherë shibej edhe sakrificë njeri, i cili flijohet, sidomos, për zotin Odin. Sipas shpjegimeve të Strabos, në Kimberuler, murgeshat me flokë të bardha dhe të veshura me të bardha, në kokat e robërve të luftës vendosin lule, i afrojnë afër një kazanit dhe, duke e mbajtur kokën mbi një skaj të kazanit, ia presin qafën dhe gjaku i tyre rrjedh brenda në kazan. Kështu që duke shikuar në gjakun e derdhur në kazan, japin lajme edhe për ardhmërinë. Adam von Bremen, shpjegon se në Uspala në kohën ekuinoks (dita kur nata dhe dita janë të barabarta) të (pran)verës, ditën dhe natën theren nga nëntë njerëz sakrificë dhe pastaj trupat e tyre i varin në një zabel.¹⁸⁰

Sipas besimeve popullore teutone, burime uji të panumërta, male, pyje, shtëpi janë vende ku gjenden viganët, zanat dhe shkurtabiqët që kanë të bëjnë me shpirtin. Këto krijesa, në të shumtën e rasteve veprojnë pozitivisht ndaj njeriut. Ata njeriut i mësojnë fuqinë magjike të kullës, gurëve, shkrimit dhe fjalëve. Sipas asaj që kuptohet prej vendeve të kultit në Upsala, teutonët në periudhat e mëvonshme kanë edhe vizatimet e tempujve dhe të zotit.

ç. Besimi në fat

Zotat teutonë jetojnë në majën e botës, të quajtur Asgard, që është si një familje zotash nën udhëheqjen e Odinit, kurse vendi i tyre i ngjante vendit të njeriut. Sipas teutonëve, zotat janë qenie që zotërojnë fuqi magjike dhe të nxjerra prej formës së njeriut dhe gjenden nën administrimin e fatit për jetesë dhe për zhdukje. Për këtë ata nuk janë të përhershëm. Zoti Odin (Wodan), për të mësuar kohën e fatkeqësisë, Mimirit Vigan i ka dhënë syrin, kurse për të lidhur ujkun e Ziu Fenrisit, zotit të luftës, e ka sakrifikuar dorën e djathtë të tij. Zotat e dinë fatin e tyre se janë duke shkuar drejt hiçit, por nuk u mjafton forca që kanë për të ndryshuar atë. Planifikues të fatit, që është i dënuari i gjithësisë, dhe realizues të atij plani ishin tre hytnesha. Këto ishin tre zota të quajtur Urd (i bërë), Werdandi (bëhet) dhe Skuld (do të bëhet), të cilat qëndrojnë në një dru frashëri. Ato tjerrin dhe endin fijet e jetës së njerëzve dhe të zotave.

d. Koncepti për vdekjen

Sipas teutonëve, vdekja është një mjet, i cili njerëzit i bart pranë familjes që jetuar më parë. Njeriu i vdekur, në kodrinat e varreve takohet me anëtarët e familjes që kanë vdekur më herët dhe kështu vazhdojnë bashkërisht të jetojnë jetën e kësaj bote.

I pari në botën e të vdekurve është zoti Hel. Atje arrihej me anë të një ure prej ari, e ndërtuar prej dy vajzave mbi një lumë të quajtur Gjöll. Të pafajshmit do të jetojnë në vendin e Helit të padënuar, por jo edhe të gëzuar. Ndërkaq mëkatarët, aty afër të tjerëve do të torturohen nga Garm, qeni i ferrit. Ata pastaj do të bien në gropa me baltë, të mbushura me shpata, do të lëndohen dhe do të ndiejnë dhimbje. Kurse fati i atyre që vdesin në luftë, çdo njëri sipas plagës që ka, do të bëhet përsëri i ri dhe do të shërohet. Kurse qumështi i Dhisë së Heidrun-it, atyre do t'u dhurojë një jetë të përhershme. Edhe një derr mashkull, i quajtur *Shebrimnir*, çdo herë pasi që të hahet do të ringjallet përsëri, dhe ata do t'i ushqejë me mishin e tij. Atje edhe këngëtarët dhe instrumentalistët do t'i kënaqin dhe do t'ua mundësojnë që ditët që nuk kanë fund t'i kalojnë me gëzim.

¹⁸⁰ Glasenapp, f. 128.

dh. Koncepti për eskatologjinë

Bota pas vdekjes së zotit Baldurs, gjithmonë do të shkojë drejt të keqes, morali dita-ditës do të shkatërrohet, vëllezërit do të vrasin njëri tjetrin. Fëmijët vëlla-motër do t'i prishin lidhjet gjenetike; prostitucioni dhe luftërat do të përhapen; asnjë mashkull me tjetrin nuk do të jetë i pajtuar. Veç se, para ditës së kiametit, Krimbi Fenris dhe Gjarpëri Midgard, do t'i prishin lidhjet dhe do të zhduken në det, yjet do të bien nga qielli, tokën do ta përfshijë një tym dhe një zjarr, kurse një temperaturë e madhe do të ngritet në qiell. Megjithatë, pas zhdukjes së gjithçkaje, bota përsëri do të dalë prej detit dhe do të fillojë një jetë e re. Ndërkaq zotat, do të grumbullohen në një shesh të gjerë të quajtur sheshi Ida dhe do t'i gjejnë mbishkrimet e mbetura prej periudhave më të hershme dhe do t'i mësojnë të vërtetat e humbura. Të gjitha fatkeqësitë do të shndërrohen në mëshirë dhe duke ndenjur në saraje prej ari, do të vazhdojnë të shijojnë jetën e tyre.

4. Feja e keltëve

Literatura: H. von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, Frankfurt am Main 1963, f.231-235; H. J. Schoeps, *Religionen*, Gutersloh 1961, f. 131-133; F. Heiler, *Die Religionen Menschheit*, Stuttgart 1959, f. 542-551.

Keltët janë prej popujve indo-europianë, kurse në aspektin e fondit të fjalëve dhe të kultit u ngjajnë teutonëve. Për keltët njohuri të mjaftueshme japin shkrimtarët grekë dhe romakë, mbishkrimet në përmendore, monedhat, literatura në Irlandën e vjetër dhe në Uells. Keltët, në vitin 600 para e.s., kanë sunduar në Evropën Perëndimore dhe të Mesme. Me shpërnguljet e mëdha në shek. V, një numër i madh i tyre shtrihet deri në Azi të Vogël, një pjesë tjetër deri në Perëndim, në Spanjë dhe në Portugali. Por, deri më sot keltët veten e tyre e kanë mbrojtur vetëm në Gali dhe në ishullin britanik, e sidomos në Irlandë, në Uells dhe në Skoci. Irlanda dhe Uellsi kanë qenë qendrat kryesore të gjuhës dhe të kulturës kelte. Kurse keltët e kontinentit, me anë të ekspeditave dhe të luftërave që ka bërë Cezari në Galja, janë latinizuar shpejt.

Edhe pse transmetohet se, në mbishkrimet e gjetura në rajonin ku ata kanë jetuar janë gjetur shumë emra të zotave keltë, ata nuk janë përcaktuar. Shkrimet më të vjetëra për fenë e keltëve janë në veprat e *Aristotelit*, *Cezarit*, *Lucanit*, *Lukianit*, *Cacius Dios* dhe në *shkrimet e periudhës së vjetër*. Gjithashtu ato gjenden edhe në përkujtimet e shkrimtarëve të kishës të periudhës së krishterimit, si Gregor von Tours, dhe në legjendat e shenjtoreve. Ai që me vjershat dhe me përkthimet e tij zgjoi interesim për legjendat kelte, në vitin 1760, është skocezi James Macpherson. Ai, legjendat irlandeze që datojnë prej shek. III, i ka bartur në Skoci.

Burimet për fenë kelte, bashkë me ato që u përmendën më lartë, i përbëjnë mbishkrimet e ndryshme, përkujtimoret, skulpturat dhe monedhat me pamje zotash. Këtyre mund t'ua shtojmë edhe Librin Leinsler, që gjendet në Irlandë, i tubuar në shek. XII., dhe dorëshkrimin Mabinogion në *gjuhën wellsb*, e mbetur prej shek. XIV. Këto tekste llogariten gjysëmmitologjike, sepse zotat e përmendur në to janë në pozitë të mbretit, trimit apo magjistarit. Po ashtu edhe disa vjersha kelte japin njohuri për këtë çështje. Megjithatë, këto nuk mjaftojnë për shkrimin e historisë së fesë kelte. Por, pranohet që prej burimeve të ndryshme të nxirret një koncept fetar i përgjithshëm.

a. Koncepti për gjithësinë

Prej keltëve nuk ka asnjë lajm për krijimin e botës. Murgjëve keltë u thuhet druid. Sipas pretendimeve të *druidëve*, ata vetë e kanë krijuar *diellin*, *hënë*, *botën dhe qiellin*. Edhe *brabmanët*, sikur murgjit keltë, pretendojnë se nëse nuk e çojnë në vend sakrificën e shenjtë, dielli nuk do të lindë. Sipas legjendës popullore, shumë pjesë të botës (lumenjtë, detrat, burimet, kodrat, malet etj.) janë të krijuara prej një vigani të madh, i cili zë vendin e hyjnive. Sipas druidëve, shpirti dhe qielli janë krijesa që nuk do të zhduken. Kurse, do të vijë një kohë kur në tokë do të zotërojë uji dhe zjarri. Por, qielli nuk do të

shkatërrohet asnjëherë. Kurse sipas konceptit për botën nëntokësore, atje nuk ka diç të frikshme, ai është një vendbanim gëzimi. Në brendi të disa kodrave gjenden sarajet e zonave dhe atje mund të hyjnë vetëm të zgjedhurit. Nga këta numërohet ishulli i shenjtorëve Avalonis dhe shteti i zonave Emain. Në mbishkrimet e Galisë shihet triniteti i zotave luftarak i keltëve. Ky trinitet përbëhet prej Mbretit të Popullit Teutatesi, Esusi dhe zotit të Vetëtimës Taranisi. Përveç këtyre, zota të njohur në tërë shtetin e keltëve janë edhe zoti i prodhimtarisë Dagda dhe zoti i artit Lug. Lug, Lyon dhe Leiden ende e vazhdojnë jetën e tyre si emra qytetesh. Brigit, vajza e Dagdasë, përcaktohej si hyjnesha e vjershës dhe e gjykimit. Hyjnesha e kalit Epona, është njëra nga hyjneshat e njohura. Kulti i saj është përhapur deri në thellësi të Perandorisë Romake.

b. Kultet

Ndërkaq punët e kultit ishin në dorën e klasës së organizuar të fallxhorëve. Murgjit e lartë, të quajtur druidë, që janë paraqitur në Britani, përbëjnë një klasë speciale. Madje kanë formuar edhe fraksionet e tyre. Druidët, kurbanët më tepër i flijonin për çështje të shenjta, flijimin e bënin nën drunj të shenjtë ose në burime të ujërave të shenjtë. Në periudhat e mëvonshme të keltëve janë bërë tempuj duke marrë si model tempujt romakë. Kurse tempujt keltë në Irlandë hasen pas shek. V. Sipas të dhënave romake, te keltët ka qenë i përhapur edhe sakrifikimi i njeriut. Sipas shpjegimeve të historianit Caesar, njeriu flijohet me rastin e sëmundjeve ngjitëse dhe në kohën e luftës. Kështu që “Mbreti i zotave” për njeriun nuk jepte qetësi deri sa të flijohet ai. Ndërkaq Pliniusi tregon se, në mesin e keltëve ka patur edhe kanibalistë. Kështu që, edhe krahas mirëkuptimit të madh të romakëve, kjo mund të jetë arsyeja e përndjekjes së druidëve nga ana e romakëve.

Për besimin në zot të keltëve nuk jepen shumë njohuri. Megjithatë dëshmohet se ata kanë besuar në shumë zota mbrojtës dhe lokalë, që kanë qenë një përzierje e magjisë dhe e panteizmit (një sinkretizëm). Besohet se, ata kanë ditur se vendi i tyre ka qenë i rrethuar me shpirta natyrorë, kanë patur njohuri për fuqitë mistere, shiun, sipas tyre e çojnë druidët. Gjithashtu kanë patur njohuri edhe për fjalët magjike dhe për formulën e betimit.

c. Koncepti për jetën pas vdekjes

Keltët kanë besuar në pavdekshmërinë e shpirtit dhe në rimishërimin (reinkarnacion). Por, nuk është e qartë se ky reinkarnacion është apo nuk është si përgjigje për punën e mirë dhe të keqe. Keltët jetën e shikojnë më me shpresë se sa teutonët, pasi për teutonët nuk ka shpëtim prej fatit, kurse fundi edhe i zotave edhe i njerëzve është errësirë. Por te keltët vdekja është qendra e të jetuarit gjatë. Për këtë ata nuk frikësohen prej vdekjes dhe e kanë shumë të lehtë të bëjnë vetëvrasje. Ata pranojnë se një vend special i të vdekurve gjendet në një ishull në Perëndim. Kurse disa besojnë se kjo metabotë është një vend nën ujë. Kurse besimi në ferr te keltët nuk ekziston.

5. Feja e sllavëve

Literatura: F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f. 552-561; H. J. Schoeps, *Religionen*, f. 133-136; H. von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, f. 283-286; Ibn Fadlan *Sayabatnamesi*, çev. R. Resen, Stamboll 1975, f. 68-75.

Edhe sllavët, sikur keltët, janë prej popujve europianë. Banojnë mes lumit Vollga dhe Dniepër. Sllavë lindorë llogariten: rusët, ukrainasit, rutenët. Kurse sllavë jugorë janë: kroatët, serbët dhe bullgarët.¹⁸¹ Ndërkaq sllavë perëndimorë quhen çekët, sllovenët, vlllehët (polakët), sorbenët dhe keshubenët.

¹⁸¹ Për bullgarët ka mendime se kanë gjenezë turke, të ardhur prej Azisë Qendrore. (Shënim i përkthyesit).

Lajmi më i vjetër për sllavët haset në *luftën Gote*, gjegjësisht në shpjegimin e fesë së sllavëve, të cilat i tregon në veprën e tij historiani bizantin, Prokebuni, i cili që ka jetuar në shek. VI. Edhe Ibën Fadlan, i cili në shek. X ka vizituar Rusinë, në *Seyabatnamen* (udhëpërshkrim) e tij jep njohuri për fenë e sllavëve. Sidomos, për fenë sllave njohuri mund të fitohet edhe prej epopeve dhe tregimeve për trimëri, si dhe prej traditave të vjetra.

a. Zoti dhe fuqitë mbinatyrore

Sipas të dhënave, sllavët besonin në një qenie të quajtur Anten, që llogaritet si krijuesi i çdo gjëje. Kjo karshi zotit të së mirës dhe të së bukurës, sikur në fetë e tjera, ishte edhe një qenie e së keqes dhe të ligës. Megjithatë, kjo nuk është parim i dualizmit. Në henoteizmin e sllavëve të jugut zot krijues ishte Perun. Perun llogaritej zot i qiellit, i vetëtimës dhe i furtunës. Në Novgrad kishte një zjarr që ndizej rregullisht për hir të tij. Idhulli i kultit ishte prej druri, përpara të cilit edhe sakrifikohej. Idhulli në Kiev ishte i ndërtuar prej ari dhe argjendi. Tempulli i tij ishte shkatërruar në vitin 988, në kohën kur mbreti Vladimir e pranon krishterimin si fe të veten. Te sllavët e jugut gjendej edhe zoti Pazbog, që ishte zot i diellit dhe i sakrificës dhe që ishte bir i Svaro-së, zot i zjarrit. Ndërkaq nuk haset shumë në hyjnesha. Po ashtu përmenden edhe zotat si Stribo, zot i erës dhe i luftës, Horse, zot i gjuetisë dhe i sëmundjeve, Mkos, zot i bujqësisë dhe i tregtisë. Gjithashtu thuhet se ata kanë besuar edhe në ekzistimin edhe të zotave të hënës, të fatit dhe të të vdekurve. Përveç kësaj, ata kanë besuar edhe në shpirtëra, vampirë dhe zana.

b. Koncepti për vdekjen

Sipas lajmeve të vjetra dhe njohurive që japin udhëpërshkruesit arabë, sllavët, krahas traditës së adhurimit të idhujve dhe kulteve të bujqësisë, rëndësi të veçantë u kanë dhënë edhe ceremonive për të vdekurit. Tradita e djegies së të vdekurit ishte shumë e përhapur. Gjatë kësaj ceremonie për të vdekurin bëheshin shumë dhurata. Ibën Fadlan tregon se, gjatë djegies së trupit të të vdekurit, me qëllim shoqërimi, sakrifikohej edhe gruaja ose robi i tij. Gjithashtu atë e kanë djegur bashkë me teshat, duke menduar se ato do t'i duhen atij në botën e ardhshme.

Respekti ndaj shpirtërave të vdekur ka vazhduar një kohë të gjatë. Shpirtërat janë përfytyruar shumë të thjeshtë, të rrezikshëm dhe në forma të çuditshme. Sikur që ka shpirta në formë *ujku* dhe *vampiri* (lugati), ka edhe shpirta shtëpiakë, të cilët sjellin fatkeqësi apo fshehurazi sjellin mëshirë. Shumica e shpirtërave shtëpiakë përfytyrohen si shkurtabiqë. Besohej se, prej shpirtave të fëmijëve të mbytur në ujë, bëhen demonët dhe zanat.

FEJA E VJETËR AMERIKANE

Literatura: H. von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, f. 37-45; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f. 97-107; Walter Kickeberg, *Die Religionen des alten Amerika*, Stuttgart 1961.

Edhe në historinë e kontinentit amerikan haset në kultura të zhvilluara. Disa nga këto kultura shkojnë deri në periudhat më të lashta, kurse disa janë paralel me historinë e Periudhës së Mesme të Evropës. Në Meksikë shihet kultura e lartë e toltekëve dhe e aztekëve, në Guatemala dhe në Jukatan shihet shteti i majave, në Kolumbi çibçat, kurse në Peru dhe në Bolivi inkat. Vetëm se, okupimi i Amerikës së Mesme dhe të Jugut nga ana e spanjollëve, për të gjithë ata përgatit një fund të dhimbshëm dhe kështu të gjithë u zhdukën nga skena historike.

Ata të cilët të parët kanë diskutuar për fetë e vjetra amerikane janë shpirtërorët spanjollë, shumicën e të cilëve e përbëjnë priftërinjtë, që kanë ardhur bashkë me fuqitë pushtuese. Gjithashtu, gjenden fetare të popullit e ndriçojnë edhe shkrimet historike të administratorëve dhe të indianëve.


Sidomos, lajmet e vëzhguesve i vërtetojnë hulumtimet e bëra me anë të gërmimeve arkeologjike në kohën e fundit. Gjithashtu dokumentohen edhe njoftimet nga astekët dhe nga të vjetërit.

Libri i shenjtë i popullit keçe, i quajtur "Popul Vuh" (Libri i këshillave), i cili ka vlera të rëndësishme në fushën e historisë së feve, nga ana e një indiani që e ka pranuar krishterimin më 1530, është përkthyer në gjuhën amtare, por me alfabet latin. Këtë libër, nga origjinali apo nga një kopje Francisko Ximenez, nga fraksioni i dominikajve, e ka përkthyer në spanjisht më 1700. Ky libër përfshin legendat për krijimin e botës dhe të njerëzve, historinë e zotave, trimat e periudhës së parë dhe në fund historinë e sunduesve të popullit keçe. Vepra është një prej dokumenteve më me vlerë për kulturën e Amerikës së Vjetër.

Ndërkaq popujt e kulturës të rajonit të Andeve të Amerikës Jugore, për të shprehur qëllimet e tyre, në vend të shkrimit kanë përdorur sistemin e perit me nyje. Forma e nyjes në pe tregonte ngjyrën, gjatësinë, kuptimin dhe numrin e gjësë në fjalë.

1. Aztekët

Me pushtimin e Meksikës nga ana e spanjollëve më 1521, edhe shteti i aztekëve u shkatërrua dhe u zhduk. Emri i aztekëve rrjedh prej fjalës Aztlan, që është emri i shteteve mitologjike. Gjuha e tyre i takon grupit të gjuhëve të popullit nahua. Këta në shek. XIV, në platotë meksikane, kanë themeluar monarkitë ushtarake, kurse në aspektin shpirtëror ishin të lidhur me trotekët, të cilët shtetin e tyre e kanë formuar më herët. Ata gjithashtu kishin një histori me shkencë të matematikës të zhvilluar. Sipas koncepteve për universin, bota ka dalë prej një deti të amshueshëm. Nën sipërfaqen e tokës gjenden nëntë bota nëntokësore, kurse mbi të gjenden nëntë apo dymbëdhjetë shtresa qiellore. Bota, me përjetimin e katër fatkeqësive të mëdha, u shkatërrua katër herë dhe më në fund u shkatërrua krejtësisht. Këto fatkeqësi emërtohen me periudha të quajtura "diell". E para është "Delli i ujit", e cila ka përfunduar me kapllimin e tërë botës nga uji me rastin e tufanit; e dyta, "Dielli i tigrin", e cila ka përfunduar me ngrënien e diellit dhe të gjallesave nga ana e tigrin; e treta, "Dielli i zjarrit", e cila ka përfunduar me ndarjen e tokës nga zjarri i ardhur nga qielli dhe i dalë prej vullkaneve; e katërta, "Dielli i erës", e cila ka përfunduar me zhdukjen e tërë gjallesave nga furtuna dhe nga shekullina. Kurse periudha e tashme botërore është më e fundit, e cila do të përfundojë me tërmete.



Vetëm se, zotat, në fatkeqësinë e mëparshme, kanë shprehur dëshirë të shohin një botë të re dhe e kanë riparuar botën. Ndërsa këtë rradhë, nuk do të ndihmojnë në riparimin e botës dhe ajo nuk do të mund të ringjallet edhe një herë.

Sipas aztekëve, në katin më të lartë të qiellit qëndron zoti Tonacatecutli bashkë me gruan e tij. Ata fëmijës në barkun e nënës i dërgojnë shpirtin. Nën administrimin e tyre kanë zota të panumërt, gjysëm zota, trima të periudhës së vjetër, demonë të mirë dhe të këqinj, shpirtëra natyrorë dhe të paraardhësve. Në tempujt e tyre adhurohen vetëm zotat. Murgjit janë të detyruar që t'i mësojnë ceremonitë praktike dhe të menduara me bindje. Në shtetet e aztekëve dhe të toltekëve, tempujt më të mëdhenj të rajonit i përkushtohen, së pari Ketsalkovatli (gjarperi me fletë) e pastaj Tezcatlipace dhe Huitzilopochtli. Sipas legendës, Ketsalkovatli ka lindur pas gëlltimit të gurit të çmueshëm hyjnor nga ana e vejushës Kimalman. Ai gjithashtu ishte mbreti murg i shtetit legjendar Tollan dhe mësuesi i shumë arteve dhe kulturave për tollanët dhe toltekët. Për shkak të shumë intrigave të zotave rivalë, ai e braktisi shtetin dhe u zhduk në largësi. Kohën e fundit, Ketsalkovatli përfytyrohej si zot i furtunës dhe gjykues i qiellit natën. Besohej se në një ardhmëri të largët do të kthehet përsëri në botë. Duke menduar se ardhja e komandantit Cortez është kthimi i Ketsalkovatli-it, ata i pritën vëllazërisht spanjollët. Kur e kuptuan se janë mashtruar, çdo gjë kishte përfunduar. Rivali i Ketsalkovatli-it ishte Tezcatlipoce, zoti i natës dhe i luftës. Ai përfytyrohej me fytyrë të frikshme dhe person që bën intriga dhe si magjistar i madh. Një zot tjetër është zoti i luftës, Huitzilopochtli. Hyjnesha e tokës, që ishte Tlazolteotl, nëpërmjet një topi, i cili përplot me qime ka rënë nga qielli, ka mbetur me barrë prej Huitzilopochtli dhe atë e ka lindur bashkë me armët. Zota të tjerë me rëndësi janë: Tonatiuh, zoti i diellit, Tlaloci, zoti i shiut dhe Tlazolteote, zoti i tokës. Përveç këyre, kishte edhe shumë zota të tjerë që përfaqësonin krijesa natyrore, si prodhimtarinë, zjarrin, yjet etj. Sundimtari i botës së të vdekurve dhe i shtatë botëve nëntokësore ishte Mictlantecutli. Kultu i tij përcaktohej sipas kalendarëve të përgatitur me një vrojtim të kujdesshëm të qiellit. Përveç disa festave për nder të tij, ai adhurohej edhe në disa ceremoni, të cilat realizoheshin me rastin e disa rasteve në jetën e njeriut, si lindja, vdekja etj. Adhurimi në tempull dhe në vende të posaçme bëhej me fljirim dhe me lëmshë. Fëmija i sapolindur, për t'u mbrojtur nga fëlliqësitë materiale dhe nga forcat e liga shpirtërore, lahej me ujë. Për pastrim shpirtëror agjërohej, qëndrohej larg marrëdhënieve seksuale dhe bëhej pendimi me askezë. Te aztekët ishte shumë e përhapur tradita e fljimit të njeriut. Për hyjninë e zjarrit periodikisht fljohesh njeriu. Besohej se, në sajë të këtyre sakrificave dielli dhe hëna vazhdonin lëvizjet e tyre. Në altarët, që quhen "Tlacatecco", ku njeriu sakrifikohej, ndërtohej një idhull i përbërë prej mjalti, mielli dhe prej gjakut të fëmijës, më vonë mishi i sakrificës hahej nga prezentuesit në ceremoni. Sakrificat më tepër zgjidheshin të jenë prej robërve të luftës dhe prej fëmijëve. Njeriun që do ta sakrifikonin e kapin katër vetë, kurse murgjit me thikë prej guri ia çajnë kraharorin dhe ia nxjerrin zemrën jashtë. Sipas dëshmimeve, nuk mungonin edhe gostitë kanibaliste. Për sakrificë i piqnin dhe i hanin të rinjtë e ushqyer enkas për këtë qëllim.

Murgjit ishin të organizuar në mënyrë hierarkike dhe jetonin nëpër manastire të pamartuar. Prej kushteve të murgërisë llogariteshin, të bërit e vetes unuk (steril), të marrurit gjak prej veshëve dhe gjuhës.

Kurse fati i njerëzve pas vdekjes varej prej formës së vdekjes. Burrat dhe gratë që vdesin në pleqëri dhe të sëmurë, shkojnë në botën nëntokësore. Ata që mbyten apo vdesin nga ndonjë sëmundje me temperaturë dhe ata që vdesin prej vetëtimës shkojnë në parajsën e Tlaloc-it, zoti i shiut, për të cilin mendohet se gjendet në një mal në lindje. Për këtë, të vdekurit para se të varrosen lyhen me ngjyrë të kaltërt, që llogaritet ngjyra e zotit të shiut. Ata që vdesin në luftë dhe që fljohen dhe ato gra që vdesin gjatë lindjes, shkojnë në parajsën qiellore, te zoti i diellit. Kështu që, në jetën pas vdekjes nuk ka dënim dhe shpërblim, kundërvlerë për punët e kësaj bote.

Njëri prej lajmeve me rëndësi që është në burimet e tyre është ajo se, njëri prej princave të popullit Tezcoco, i quajtur Nezahualcoyotl (Kozotl që agjëron), ka shkruar një legendë të ngjashme me *Fjalët e Urta* (të Solomonit) të Dhiatës së Vjetër. Ai ka ndërtuar një tempull nëntë katësh, ka mbrojtur mendimin se zoti është krijuesi i gjithësisë, të besohet dhe të adhurohet një zot i dukshëm dhe e ka ndaluar sakrificën me gjak.

2. Majatë

Feja e majave ka ngjashmëri në shumë aspekte me fenë e aztekëve. Shkrimet hieroglifike dhe lojrat e shenjta me top janë disa prej ngjashmërive. Vetëm se majatë nuk kanë qenë tiranë dhe gjakderdhës, sikur aztekët. Te ata shumë rallë shihet flijimi i njeriut. Kryesisht ata flijonin bimë dhe kafshë. Në krye të panteonit gjendej Hunabku, zoti më i lartë dhe pasiv. Kurse zoti aktiv, Itzamna, llogaritej zoti i diellit dhe trim i kultit. Zoti që i ngjan Ketsalkovatl-it të aztekëve ishte Kukulkan. Ai ishte zbuluesi i kalendarit dhe i diturive dhe mbrojtësi i prodhimit. Ata kishin edhe zota të shiut, të tërmetit dhe të yjeve. Kurse sunduesi i botës nëntokësore ishte Hunahpu. Sipas legjendës së majave, ai ishte zoti që e nxorri shtetin prej deti dhe pasi iu përgjigj çdo nevoje, e krijoi njeriun prej bimës së misrit.

Këta edhe në aspektin e kultit u ngjajnë aztekëve, të cilët flijonin pemë, lule, qen dhe gjel deti. Ndërkaq flijimi i njeriut ishte i rallë. Vetëm në kohë të caktuara, në një gropë të thellë që e llogaritnin të shenjtë, i hidhnin vajzat beqare, duke i sakrifikuar. Ata e dinin edhe lojën e topit, sikur te aztekët. Oborri i gjërë i tempullit llogaritej edhe fushë futbollit.

3. Inkatë

Inkatë kanë jetuar në Perun e sotëm. Shteti i tyre ka ekzistuar deri më 1432, kur komandanti spanjoll *Pizarro* e pushtoi atë. Një pjesë e tokave të tyre ishte pasuri e shtetit, gjegjësisht e inkave. Çdo nënshtetas mashkull, deri në një moshë të caktuar, ishte i obliguar të punojë në këto toka dhe të shërbejë në ushtri. Nevojtarët kërkesat e domosdoshme të tyre për drith, pambuk etj., i përmbushnin prej depos shtetërore. Ndërsa kur plakeshin nevojat e tyre në tërësi i plotësonte shteti. Inka, si kryetar shteti, llogaritej nip i diellit. Sipas legjendës, pasuesi i tij Manko Kapak, i cili është parë nga motra dhe gruaja e tij në një shpellë në liqenin *Titicaca*, është tërhequr në veriperëndim dhe njerëzve u ka mësuar ndreqjen dhe përdorimin e mjeteve të ndryshme. Kurse në *Cuzco* ka formuar një shtet. Nga të gjithë këta sundimtarë, gjashtë të fundit janë të njohur.

Sipas inkave, zoti Vriakoça, llogaritej krijuesi i botës. Këngët e bukura fetare për të tregojnë fetarësinë e njerëzve. Në tempullin e diellit në Cuzco, gjenden bashkë zoti i diellit, Inti, dhe zoti i vetëtimës, Kokeilla. Ata përfaqësohen me tre idhuj prej ari. Poashtu, edhe deti, hëna dhe yjet e rëndësishëm kanë zotat e tyre të posaçëm. Ceremonitë fetare bëhen në tempull. Për kurban flijohen lule, ushqime, pije dhe veshje, të cilat pastaj hidhen në zjarr dhe digjen. Në disa raste në zjarr si kurban digjej edhe kafsha Lama. Me rastin e kalimit në fron apo me rastin e vdekjes së inkas, ose në raste me rëndësi, si paraqitja e sëmundjeve ngjitëse dhe e urisë, flijohen fëmijë dhe të rritur. Shërbimet fetare i kryejnë murgjit dhe murgeshat. Inka, gratë tjera, përveç gruas kryesore të tij, që është edhe motra e tij, i zgjedh prej murgeshave.

Të vdekurit i varrosin të balsamosur. Ata besojnë se, shpirtat, nëpër një urë prej qimje, shkojnë në “Shtëpinë e memecëve”, e cila gjendet mbi një det të thellë, kurse për ata që jetojnë në bregdet, besohej se shpirtërat e tyre me anë të peshkaqenëve dërgohen në ishullin Guano.

4. Çibçatë

Ata jetonin në mes të liqenit Nacaragua dhe të Ekuatorit, dhe kishin prejardhje prej popullit të Andeve me një kulturë të zhvilluar. Qyteti i shenjtë Suamoj qeverisej nga një mbret murg i zgjedhur. Ata kishin një sistem të ngjashëm me sistemin kast të indusëve. Murgjit pozitat e tyre i linin trashëgimi me një metodë *matriarkale*. Klasat përbëheshin duke filluar prej luftëtarëve, tregtarëve, artistëve dhe bujqve. Kurse klasa më e ulët ishin *parjatë*. Realizuesi i këtij ligji, në të njëjtën kohë ishte edhe sundimtari, hyjnia e të cilit është e pranuar.

Sipas një dëshmie të çibçajve, njerëzit burojnë nga Bachue, që është nëna e çdo gjëje, e cila ka mbetur me barrë nga një mashkull që është parë në liqenin Iquaqua. Pastaj Bachue, atë mashkull, që është babai i njerëzimit, e shndërron në formën e gjarpërit dhe e lëshon në liqen. Kurse sipas një dëshmie tjetër, i ati i parë i njerëzimit është Kazikeni, që meshkujt i ka krijuar prej dheut të verdhë, kurse femrat prej bishtit të bimëve. Ndërsa vetë ai, sikur dielli dhe hëna, ka hipur në qiell. Bachue është ajo që njerëzimit ia ka mësuar qytetërimin. Ajo, së pari është fshehur dhe pastaj ka humbur.

5. Piramidat e Amerikës Jugore

Piramidat janë të ndërtuara nga vendësit e vjetër amerikanë. Gjithashtu janë mbeturina të qytetërimin (200 para e.s.-700 pas e.s.) të quajtur “Teotihuacan”. Përbëhet prej pesë katëve taracë. Më e larta është 60 metra. Por, ka edhe më të vogla. Në shtetin e majave (Rajoni Chiapas) ka edhe piramidë me emrin “Tempulli i mbishkrimeve”, e cila ka një dhomë për të vdekurit, që nuk është te piramidat e tjera, dhe një varr prej guri dhe, gjithashtu, është e zbukuruar me gurëz të gdhendur. Në maje të piramidave të Meksikës gjendet një bazament dhe një pullaz tempulli. Ndërkaq piramida *El-Castillo* është nëntëkatëshe dhe mjaft madhështore.

6. Pasqyrimet e besimit të vjetër amerikan

Vendasit e Amerikës së Vjetër, të shpëtuar prej gjenocidit të ushtruar mbi ta, nga ana e kolonizuesve janë syrgjynosur në male dhe shkretëtirë, vende të cilat nuk vlejnë për bujqësi. Një pjesë e popullit, nga të cilët ishin marrë burimet për jetë, u zhdukën nga uria dhe sëmundjet. Ata që kanë mbijetuar deri tani nga kultura e tyre e përbashkët, janë vallëzimet e kultit për turistët, modelet e teshave të veshura në danse dhe punimet mbi ato teshat. Ata, përveç që janë dërguar përreth lumit *Missisippi* dhe *Misuri*, janë munduar që jetën e tyre ta vazhdojnë edhe në shkretëtirën e Teksasit dhe të Meksikës së Re dhe në kufijtë e Kanadasë. Krahas krishterimit të përgjithshëm të tyre, në mesin e tyre, nga mesi i shek. XX, u paraqit një lëvizje e quajtur “Vallëzimi i shpirtërave”, e cila sot vazhdon ende me emrin “Kulti Peyote”.

Peyote është manifestim i ndjenjës së zhvilluar fetare në situata të ndryshme të racës së kuqe. Në vallëzimin e shpirtërorëve është shpresa për ardhjen e shpëtimtarit-mesias. Sipas kësaj, ata besojnë se do të vijë një lider i mbushur me frymëzim hyjnor dhe do t’u mundësojë atyre një jetë parajsë. Që këtë lider dhe udhëheqës Zoti sa ta dërgojë më shpejt, ata mundohen që të lidhin marrëdhënie me shpirtërat e stërgjyshërve dhe botën hyjnore. Brenda kohës janë paraqitur edhe liderë, të cilët kanë besuar se kanë lidhje me qiellin dhe me shpirtërat e stërgjyshërve. Këta, në përgjithësi, janë liderë të edukuar dhe që shpejt mund të kalojnë në trans (gjendje shpirtërore të hipnozës së thellë). Disa nga këta njerëz, që nëpërmjet ëndërrës dhe transit bëjnë udhëtime shpirtërore në qiell, jetojnë jetë asketike në male. Në manifestimin e fuqisë së shenjtoreve në rolin e shpëtimtarit, rol të rëndësishëm luajnë kultit i vjetër mjekësor dhe veprimet për shpërndarjen e shërimit. Në disa raste luftëtarëve u kanë thënë se nuk i vret plumbi i të bardhëve.¹⁸² Sidomos, ata besojnë se, dëshmorët e luftës me fuqinë misterioze të Shpëtimtarit të ardhshëm do të rikthehen përsëri në jetë, gjegjësisht në familjet e tyre.

Kulti Peyote është shfaqur pas shtypjes së kryengritjes aktive të shpëtimtarit nga ana e të bardhëve. Peyote është një bimë kaktusi me rrënjë të deponuar, si karrotë, rrepë etj. Ka specifikë narkotike. Njerëzit që ushqehen nga këto kalojnë në gjendje transi dhe në ekstazë (dehje shpirtërore) dëgjojnë zëra të jashtëzakonshëm, shohin fotografi të ngjashme. Për ta kjo është një bimë e shenjtë. Anëtarët e kultit Peyote kishën e tyre në fillim e kanë quajtur “Church of the Born”, kurse sot e përdorin emrin “Native American Church”. Bima Peyote është bërë një mjet që i bashkon njerëzit me hyjninë. Sa që thonë se, Bibla është vetëm për anëtarët e botës së vjetër, kurse ata vetë me anë të Peyotes arrijnë direkt te shpallja hyjnore, dhe thonë se Bibla nuk është për ta. Ceremonitë kishtarë janë unifikuar me ceremonitë Peyote.

¹⁸² Ernst Benz, *Neue Religionen*, Stuttgart 1971, f. 68-72.

Kjo është një rrymë e re fetare e lindur si sintezë e krishterimit, e traditave dhe e besimeve parakrishtere amerikane.¹⁸³

¹⁸³ Benz, f.71-81.

FEJA TRADICIONALE TURKE

Literatura: Ünver Günay-Harun Güngör, *Başlangıçtan Günümüze Türklerin Dini Tarihi*, İstanbul Ocak Yayınları, 1997, 406 f.; Hikmet Tanyu, *Türklerin Dini Tarihi*, İstanbul, 1978; Abdulkadir İnan, *Şamanizm*, Ankara 1954; Abdulkadir İnan, *Eski Türk Dini Tarihi*, İstanbul 1976; İbrahim Kafesoğlu, *Eski Türk Dini*, Ankara 1980. S. Buluç, Şamanizm, *İslam Ansiklopedisi* (maddesi). W. Radlof, *Sibiryanadan*, V. 1, Kitap 2, İstanbul, 1956; Bahaeddin Ögel, *Türk Kültür Tarihi*, Ankara 1962; Bahaeddin Ögel, *Türk Mitolojisi*, Ankara, 1971; Hans Findeisen, *Schamanentum*, Stuttgart, 1957; Mircea Eliade, *Schamanismus*, Stuttgart.

Turqit, para se të pranohet islamin, kanë qenë pjesëtarë edhe të budizmit, hinduizmit, maniheizmit, zaratustrizmit, hebraizmit dhe të krishterimit. Vetëm se, kjo nuk është bërë me përqaftimin tërësor të tyre por duke i pranuar ato pjesërisht, krabas besimeve tradicionale të veta. Përvetësimi komplet shihet vetëm në kalimin e tyre në islam. Përveç feve që i numëruam më lart është edhe feja e hershme turke, të cilën e ka besuar populli turk që në kohët më të vjetëra dhe që mund ta quajmë edhe fe tradicionale turke. Është e vështirë që të diskutohet për ekzistimin e njohurive dhe studimeve të mjaftueshme për të. Tema në fjalë komentohet në bazë të njohurive ekzistuese. Për këtë temë në krye të punimeve të bëra deri më tash qëndron vepra "Historia e fesë turke prej fillimit e deri sot" (Başlangıçtan Günümüze Türklerin Dini Tarihi), e përgatitur nga Ü. Günay dhe H. Güngör.



Në shek. II para e.s. te popujt turq dhe te hunët tradicionalisht ka qenë besimi në Zotin e qiellit. Teoritë e bazuara në Dhiatën e Vjetër, edhe pse historinë gjenealogjike turke e mbështetin në Jafesin (2500 para e.s.), gjegjësisht në djalin e Nuhit, komentatorët arkeologjikë shkojnë edhe më larg, rrënjët e tyre derisa humbasin në burimet historike. Dëshmitë se Oğuz Kani ka qenë armik i adhurimit të idhujve, se babain e tij e shkatërroi për shkak të favorizimit të idhujtarisë dhe se shtetin e mori në duart e tij, janë në thelb shkëndijat e dëshirës së tij që të arrijë në monoteizëm. Nuk është lehtë që në një kohë dhe në një periudhë të pashënur të hasësh në dokumente për një temë abstrakte.

Edhe sot me njohuritë e arritura etnologjike dhe me dokumentacionet historike nuk shihet se është e mundshme të arrihet në përgjithësimë përfundimtare. Dokumentacionet arkeologjike dhe etnologjike, në përgjithësi tregojnë se turqit kanë qenë politeistë. Në burimet e shkruara të periudhës më të vonshme, si *monumentet Orhun*, është rastisur edhe në gjurmë monoteiste. Në historinë fetare tradicionale turke është e mundur që besimi të ndahet: në atë të klasës së ngritur dhe besimi i shtresës popullore dhe, kështu, ka mundësi të arrihen dy përfundime. Shumica e studimeve të bëra deri sot, janë studime folklorike në lidhje me besimet popullore turke. Kurse studime për besimet e shtresës së ngritur gati se nuk ka fare. Natyrisht, shkaku i vërtetë i kësaj nuk duhet të harrohet se janë mangësia e burimeve dhe e mjeteve.

Edhe njohuritë që do t'i paraqesim më poshtë, në përgjithësi, kanë të bëjnë me besimin popullor tradicional turk. Vetëm se, për shkak që fiset e ndryshme turke e kanë pranuar budizmin, hinduizmin, zaratustrizmin, maniheizmin, krishterimin, hebraizmin dhe islamin, nuk është e drejtë që të diskutohet vetëm për një fe të caktuar. Është e mundur që sot në besimet popullore turke, të gjenden gjurmët dhe ndikimet e feve të lartpërmendura. Këtu shkurtimisht do të përqendrohemi në aspektin "Feja tradicionale turke". Gjithashtu shkurtimisht do të diskutojmë edhe për marrëdhëniet e saj me fetë e saj të përgjithshme.

Njohuritë për traditën e varrimit të të vdekurit tek iskitët, që i jep Herodoti, i cili ka jetuar në shek. V para e.s., kohët e fundit vërtetohen edhe nga gërmimet arkeologjike të bëra në Azinë e Mesme dhe në Malet Alltaj. Historia e varrezave dhe e teshave në ta, të nxjerrura në shesh nga këto zbulime, shkon deri në vitin 3000 para e.s. Edhe burimet kineze, të mbetura prej shek. IV të e.s., dhe sqarimet e Radlofit, që në shek. XVIII ka shëtitur Azinë e Mesme dhe Veriore, gati sa tregojnë një paralelizëm me të dhënat historike dhe arkeologjike.

1. Emri i besimit tradicional turk dhe adhurimet e tyre

Për besimin dhe adhurimet tradicionale turke, me ndikimin e etnologëve perëndimorë, përdorej termi shamanizëm. Në literaturë fjala “shaman” ka kuptimin “magjistar primitiv”. Origjina e fjalës është nga *gjuha tunguziane*, kurse në *gjuhën jakute* janë fjalët: “*oyun*” ose “*udayan*”. Ndërkaq te turqit alltaj është fjala “*kam*” ose “*gam*”. Në fakt termi shamanizëm, i cili rrjedh prej emrit Shaman, emër ky i cili i jepet atij që udhëheq në rituale dhe në adhurim, nuk është shprehja e vërtetë e fesë tradicionale turke. Madje, në kohën e Mbretërisë Ruse, një grup turqish shkuan te mbreti rus dhe i thanë se feja e tyre nuk është shamanizmi, dhe se ata nuk dëshironin që ky emër të përdorej për ta. Por, misionarët dhe etnologët perëndimorë kanë ngulmuar mbi këtë term të gabuar dhe të padëshiruar dhe kështu në literaturën botërore, fjalën “shamanizëm” e kanë vendosur si një term kryesor.

Në botimin e parë të këtij libri kam përdorur termin “Feja e vjetër turke”. Vetëm se, përdorimi i shprehjes “Fe tradicionale turke” në punimet e reja të Ü. Günay dhe të H. Güngör-it, më shtyu që të mendoj edhe njëherë për këtë çështje. Edhe pse gjatë historisë turqit kanë pranuar fe të ndryshme, duke përfshirë edhe fetë universale, mendimi i Günay-it dhe i Güngör-it se kjo fe (feja tradicionale) duhet të dallohet më qartë nga fetë tjera, më pëlqeu dhe vendosa t’i përshtatem këtij mendimi të tyre.

2. Koncepti për Zotin

Besimi hyjnor te turqit e vjetër ishte henoteizmi. Gjegjësisht besohet në një zot të madh që ka krijuar gjithësinë dhe çdo gjë, por të njëjtit i përshkruhen grua dhe fëmijë. Me fjalë të tjera, bashkë me pranimin e shumë qenieve hyjnore, besoj se në mesin e tyre ka një Zot të fuqishëm. Fjala “zot” në të kaluarën te turqit përdorej edhe me kuptimin “zot”, por edhe me kuptimin “qiell”. Sikur që shihet te fqinjët e tyre kinezë, ata një kohë kanë besuar edhe në “Zotin e qiellit”. Besojnë se Zoti i Qiellit qëndron në katin më të lartë, bashkë me bashkëshorten e tij. Më vonë, për të mos u përzier termat qiell dhe zot, të cilat shprehen me fjalën “tengri”, hyjnia duhej të shprehej më fjalë tjetër. Kështu që, turqit alltaj këtë qenie të lartë e kanë quajtur Ülgen, Ülgön (i madh) ose Bay Ülgen (i pasuri i madh). Tatarët kanë përdorur emrin “Kuday”, jakutët “Tanara”, çuvashët “Tura” ose “Tora”. Përveç këtyre është edhe përmendja e termave të popujve turq si Idi, Ugan, Çalab, Bayat etj.¹⁸⁴

Në përgjithësi, Zoti konceptohej në trajta njerëzore, gjegjësisht si person i cili bashkë me gruan e tij Umay-in, qëndron në katin më të lartë qiellor. Turqit abakan diskutonin edhe për tendën e Zotit të Qiellit. Sipas turqve alltaj, Bay Ülgen qëndron ulur mbi një fron prej ari, në një saraj të mbështjellur me ar. Ai është krijuesi i njerëzve, fushave, maleve, zjarrit, diellit, hënës, yjeve dhe kupolës qiellore; ai është edhe udhëheqës i fatit. Ai, gjithashtu, është edhe dhurues i fëmijëve. Edhe pse fuqia e tij mjafton për çdo gjë, ai kënaqej vetëm me veprimin e së mirës.

Sipas *mbishkrimeve Orbun*, edhe sundimtarët dhe zotërinjtë turq e falënderonin Zotin e Qiellit. Ata kur flisnin për punët me sukses nuk nguronin të përdornin edhe termin “dëshira e Zotit”. Gjithashtu emrin e Zotit e përmendnin në veçanti, pa mos e përzier me zotërat dhe shpirtrat e tjerë. Dhe kjo ne na tregon se sa ka qenë i zhvilluar tek ata besimi në Zotin e Madh.

Sipas turqve alltaj, Zoti i madh Ülgen, ka shtatë ose nëntë djem, nëntë vajza dhe një shpirt ndihmës. Djemtë e Ülgenit kanë qenë: Karshët, Pura-Kan, Jajëk-Kan, Burça-Kan, Karakush, Paktë-Kan, Er-Kan. Çdo fis, njërin nga këta e llogariste për themelues të fisit të vet. Vajzat e Ülgenit në përgjithësi quheshin “Vajzat e bardha”, gjegjësisht “Vajzat e ndershme”. Këto vajza, që kanë hyrë në shtresën e shpirtërave të mirë gjatë ritualeve i inspirojnë dhe i inkurajojnë kamët (shamanët). Foshnjat, në formë të lodrës për fëmijë, të cilat i përfaqësojnë ato, qëndrojnë varur në mantelin e kamit, Kurse shpirtërat ndihmës të Ülgenit, kryejnë detyrën e të dërguarit dhe qëndrojnë në qiellin më të afërt të

¹⁸⁴ Ünver Günay-Harun Güngör, *Başlangıçtan Günümüze Türklerin Dini Tarihi*, Stamboll 1997, f. 35.

botës. Këta, si Jajëk, Sujla, Karllëk dhe Utkuçu, përbëjnë shpirtërat më të avancuara të panteonit të zotave. Sipas *turqve lebed*, Bay Ulgeni ka katër djem: Përçak-Kan, Toz-Kan, Kara-Kan dhe Sujlap. Djali i këtij të fundit është Sari-Kan. Djali i Përçak-Kanit është Kërgëz-Kan. Ky llogaritet shpirti themelues i turqve lebed, të cilët kanë jetuar për rreth lumit Kargasan. Përveç Kara-Kanit, të gjithë zotat e tjerë njerëzimit i bënin mirë, ndërsa Kara-Kani, largohet prej botës së zotave dhe tërhiqet në botën e errësirës. Erlik, sundimtari i të vdekurve, është i biri Kara-Kanit. Edhe Erliku ka dy djem: Ulap dhe Kolok. Të gjitha këto krijesa hyjnore jetonin në një botë të errët nëntokësore dhe quheshin Aza. Nën urdhërin e Azave gjendeshin djajtë dhe nëpërmjet tyre i mundonin njerëzit dhe kërkonin prej tyre flijim.

3. Fuqitë natyrore dhe shpirtërore

Turqit e vjetër besonin se, toka dhe bota nëntokësore janë përplot të mbushura me disa shoqëri shpirttrash dhe me fuqi shpirtërore dhe se çdo vend ka pronarin shpirtëror të saj. Zoti i Qiellit me njerëzit fliste me anë të të dërguarve shpirtërorë. Shamanin në udhëtimin e tij qiellor e shoqëronin shpirtrat. Sidomos, në natyrë çdo krijesë ka një shpirt, të cilët detyrat e tyre i kryejnë në mënyrë hierarkike. Çdo gjë që jeton në ose mbi detra, lumenj, liqenj, male dhe mbi ose në kodrina ka një shpirt mbrojtës.

Fuqitë natyrore si dielli, hëna, yjet, bubullima, vetëtima konceptoheshin në formë të shpirtërave qiellorë. Në burimet kineze përmendet se, *hunët* e kanë madhëruar diellin dhe hënën. Sipas njohurive etnologjike moderne, ky kult ka vazhduar edhe te jakutët. Dielli dhe hëna llogariten si dy vëllezër (motra) dhe atyre u përshkruhet fuqi hyjnore. Besohej se disa trima rrjedhin prej bamirërsisë së diellit dhe të hënës. Po ashtu edhe yjet dhe planetet llogariten të shenjta. Më i rëndësishmi nga ato është Venusi, gjegjësisht ylli i mëngjesat.¹⁸⁵

a. Shpirti dhe kulti i malit

Te turqit, kulti i malit ka të bëjë me kultin Zoti i Qiellit. Në malin Han-Joan, që është prej vargmaleve Jen-si-jan dhe Shan-din-shan, atdheu i vjetër i hunëve, është mali ku çdo vit sakrifikohet për Zotin e Qiellit. Perandorët Hanë, marrëveshjet me Kinën i kanë aprovuar duke sakrifikuar dhe duke u betuar në vendin e quajtur mali Hun. Turqit malet i llogaritin si vende të zotave. Ka mundësi që ky besim të jetë për shkak se, malet e larta duken sikur janë më afër qiellit. Për këtë, shumica e maleve në Azinë e Mesme, njihen me emrat si zoti Han, Buztağ Ata Kayrakan etj., të cilët në turqishte dhe në mongolishte kanë kuptimet: *i shenjtë, ati i madh, perandor i madh*.

Sikur që çdo familje kishte një mal të shenjtë të vetin special, edhe shoqëritë e formuara nga këto fise kishin malet e shenjta të përbashkëta. Nga mbishkrimet e gokturqve dhe ngjyrave të tyre kuptojmë se, në shek. VII për të gjitha fiset turke dhe fiset e huaja, që janë bashkuar me perënditë qiellore të turqëve, kulte kanë qenë malet dhe pyjet Ötüken. Në këto lokale të shenjta adhurohej Zoti i Qiellit, Jersua (hyjni e tokës dhe e ujit) dhe shpirtrat e stërgjyshërve. Edhe malet përreth dhe burimet e lumit Orhun, që prej kohës së hunëve, nga ana e fiseve të ndryshme turke janë llogaritur të shenjta. Po ashtu dihet se janë përdorur edhe si vend kulti.

Edhe fiset e sotme alltaj, kanë male të shenjta. Ata në këngët fetare të tyre, përmendin vargmalet Alltaj. Për turqit malet, liqenet, lumenjtë janë përplotë me shpirtëra dhe janë krijesa të gjalla. Kështu që kur flitet për ta, është vështirë të kuptohet se flitet për malet, për ujërat, apo për njeriun, i cili mban emër gjeografik. Të gjitha këto objekte janë krijesa që dëgjojnë, që martohen, që kanë fëmijë. Shpirti është vetë mali, mali është vetë shpirti.

¹⁸⁵ Günay-Güngör, f. 45.

b. Shpirti dhe kulti i zjarrit

Turqit, që në kohët e hershme e kanë respektuar zjarrin dhe kanë besuar se në zjarr ka një shpirt të shenjtë. Alltajasit këtij shpirti i thonë “ot ezi” (pronar i zjarrit); jakutët, me kuptim të njëjtë, i thonë “ot iççite”. Besimi se zjarri vjen prej qielli, është një besim i përhapur shumë në mesin e turqve. Historikisht është vërtetuar se ai posedon një fuqi pastrimi. Nga ceremoni të shumta që bëhen për raste të ndryshme, kuptohet se ekziston besimi se zjarri ka një specifike që njeriun e pastron prej të këqijave, prej shpirtërave të ligj dhe e mbron prej sëmundjeve. Zjarrin e përdornin edhe si mjet që lajmëron për të ardhmen. Atë e llogarisnin si një krijesë të gjallë dhe mundoheshin, që në respektimin ndaj tij të mos mbeten të mangut. Te turqit alltaj dhe te të Sibirisë, ka qenë traditë që për zjarrin të sakrifikohej, të sapomartuarit të derdhnin vaj në zjarr gjatë ceremonisë, prej pijeve dhe prej ushqimit të tyre t'i ndajnë një pjesë edhe shpirtit të zjarrit.

Besohej se zjarri është dërguar prej qielli, nga ana e Ülgenit. Kundër zjarrit nuk thuhet asnjë fjalë e keqe. Rreptësisht ishte e ndaluar sharja e zjarrit, fikja e tij me ujë, pështyrja në të dhe loja me zjarrin. Një traditë e vjetër ishte edhe hedhja e fallit duke shikuar zjarrin. Në ditë të caktuara të vitit ndizej një zjarr i madh, flijohej, bëheshin lutje dhe më pastaj shikohej fall në flakën e këtij zjarri. Nëse flaka bëhej e gjelbërt sinjalizonte se do të ketë shi, bereqet dhe prodhim të mirë; nëse merrte ngjyrë të kuqe atëherë simbolizonte sëmundjet ngjithëse, nëse shndërrohej në të zezë simbolizonte vdekjen e perandorit.

Sipas karagasve, nëse zjarri fishkëllon kjo ishte simbol se do të vijë një mik nga larg. Vetëm nëse zjarri fishkëllon natën nuk është mirë, sepse ajo është shenjë e afrimit të djallit. Atëherë për largimin e djallit, në zjarr hidhet një dru dëllinje, që llogaritej si dru i shenjtë.

Jakutët, nëse shohin se hiri lëviz në oxhak, thonë “*og kuta oynyur*” (luan shpirti i fëmijës) dhe besojnë se zjarri tregon se familja do të lind një fëmijë. Nëse duke menduar diçka fishkëllon zjarri, ata gjykonin se ajo nuk mund të realizohet.

Për të shfrytëzuar fuqinë pastruese të zjarrit dhe për t'i përzënë shpirtërat e ligj, gokturqit perëndimorë, në shek. VI delegacionet e huaja që vinin në shtetin e tyre, i kalonin nëpër zjarr, me anë të të cilit mundoheshin t'i pengonin shpirtërat e ligj që të hynin bashkë me të deleguarit dhe t'i prishnin magjitë e tyre.

c. Kulti i stërgjyshërve

Tradita e respektimit të stërgjyshërve të vdekur dhe sakrifikimi për ta, përbëjnë pjesën e rëndësishme të besimit turk. Hunët çdo vit, nga mesi i muajit Maj sakrifikonin për paraardhësit e tyre. Edhe gokturqit dhe ujugurët, sikur hunët, mbledheshin në malet e shenjta dhe sakrifikonin për zotin dhe paraardhësit e tyre. Madje të vdekurit i varrosnin bashkë me teshat me vlerë të tyre. Vizatimet, të cilat alltajtë i quanin “toz”, dihej se kishin të bënin me kultin e paraardhësve. Po ashtu jemi dëshmitarë edhe të ekzistimit të kultit të kafshëve. Këto janë shpendët si: skifteri, shqiponja, Pjetriti, shkaba dhe fajkoi. Te gokturqit është ujku. Në flamujt e perandorive të gokturqve dhe të ujugurëve gjendej “koka e ujkut”. Te kërgëzët është “lopa”, kurse në mitologjinë alltaje dhe sibiriane vendin e tyre e zë “shqiponja”.¹⁸⁶

ç. Shpirtërat nëntokësorë

Bota nëntokësore si zakonisht është vendi ku kanë jetuar shpirtërat e frikshëm dhe të ligj. Alltajtë këta i quajnë “*substancë e errët, shpirti i keq, rritje e errët*”. Ka edhe shpirta, si ajna, ada, yor etj., për të cilët besohet se jetojnë në botën nëntokësore dhe përfytyrohen si të trishtueshëm. Në krye të shpirtërave të këqinj është Erlik Kani, që llogaritet perandor i botës nëntokësore. Irle Kani ose Il Kani, si dhe Erlin Kani, nuk janë tjetër veçse emra të tjerë të Erlik Kanit. Sipas alltajve, Erlik Kani, karrierën e tij e vazhdon në katin më të ulët të nëntokës, në një fron në sarajin e rregulluar prej dheut të zi ose prej hekuri të zi. Në skaje të nëntokës gjendet një lumë ku jetojnë egërsirat më të trishtueshme. Ai që i çon fatkeqësitë e mëdha dhe ai që i çon sëmundjet ngjithëse, po ashtu është Erlik Kani. Ai me këto

¹⁸⁶ Vep. e cit. f. 52-54.

kërcënime kërkon që të bëhen kurbanë për të. Në lutjet shamane Erlik Kani përmendet edhe si Kayra-Kan (hani therës). Alltajtë besojnë se shpirti i cili përfytyrohet si zanë, është prerë nga vetë ai. Erliku shpirtërat e marrur të njerëzve i çon në botën nëntokësore. Kurse pas gjykimit të tyre atje i përdor si skllëvër. Ata nuk bëjnë idhuj ose ikona që e përfaqësojnë Erlikun.

Thuhet se Erliku ka patur ose shtatë ose nëntë djem. Ata janë: Bay Bahadır, Karash, të cilët janë gurëz me kyç dore; kurse bakër me kyç dore janë: Uçar Kan, Jabsh Kan, Kerey Kan, Şedey Kan. Të gjithë shpirtërat e ligj në nëntokë dhe në mbitokë udhëhiqeshin nga ata. Ata ia tregojnë rrugën shamanit që zbret në nëntokë. Ata ndërmjetësojnë mes etërve dhe shamanit. Në disa raste Erliku adhurohet edhe si shpirt mbrojtës.

Fiset *alltaje*, për Erlikun dhe për djemtë e tij, për sakrificë i merrnin kafshët e dobëta, bile edhe të sëmurat. Shumica, në emër të tyre therin një ka të zi, ose një lopë, kurse asnjëherë nuk kanë sakrifikuar kuaj.

Erliku ka tetë ose nëntë vajza. Ato nuk kanë detyra të caktuara. Luajnë lojëra, vallëzojnë, i mashtrojnë shamanët, të cilët çojnë kurban në nëntokë. Ata që arrijnë te paraardhësit e tyre dërgojnë sakrifica në nëntokë dhe mundohen që prej tyre të marrin sakrifica. Në lutjet e tyre i pëshkruejnë si krijesa me fytyrë të zezë, me flokë të zeza dhe me sensualitet.

Besohet edhe në qenien e të vdekurve nëntokësorë. *Lebedët*, për të shpëtuar atë që gjendet nën presionin e shpirtit të keq të quajtur “*azul*”, flirtojnë një kafshë me ngjyrë të zezë. *Talentët* besojnë se shpirti i të vdekurit deri në të katërdhjetat jeton në varr, kurse në disa raste ai dëshiron të vijë në shtëpinë e tij, të cilët quhen “*uzul*”. Besohet se edhe aza edhe uzuti shëtisin nëpër furtunë. Këto shpirtra të ligj, nën udhëheqjen e Erlik Kanit, mundohen t'i kapin shpirtrat e të gjallëve dhe t'u lëshojnë sëmundje.

d. Shpirtërat e fëmijëve

Sipas turqve alltaj, shpirti i njeriut (kut) para se të lindë njeriu gjendet në qiell. Teletët thonë se Enem Jajuçë, i cili i jep shpirt fëmijës, jeton në katin e katërt të qiellit. Sipas asaj që thuhet, shpirti i fëmijës në trupin e nënës hynë në formë të një krimbi të kuq. Kurse se sa do të jetojë fëmija i lindur e përcakton hyjnesha e lindjes. Sipas tyre ka edhe një hyjneshtë tjetër me emrin Enem Kan, e cila qëndron në katin e tretë në qiell dhe ajo kafshëve të vogla u jep shpirt. Sipas alltajasve, për lindjen e fëmijës Ulgeni e urdhëron djalin e tij, Yayıkin. Edhe Jajëki shpirtin e merr prej “sut ak kol”-it (det i bardhë si qumështi) në qiell, që gjendet në katin e pestë dhe përfytyrohet si femër, dhe e vendos në mitrën e nënës dhe bëhet ndihmës i tij tërë jetën. Sipas jakutëve, shpirti i fëmijës zbret si zog nga qielli dhe futet në barkun e nënës.

4. Adhurimet

Burimet historike tregojnë për ceremonitë fetare zyrtare, të bëra rregullisht në çdo vit. Hunët, në muajin e pestë të vitit, për zotin e Qiellit dhe për Tokën-Ujin, sakrifikojnë. Gjithashtu në fillim të çdo viti krerët e fiseve turke tubohen në tempullin perandorak dhe e adhurojnë Zotin. Epiqendër e adhurimit është ceremonia e sakrifikimit. Sakrifica më e pëlqyer është kali. Kurse kau ose lopa dhe bagëtia tjetër janë në kategori të dytë. Madhërohet dielli i lindur, kurse gjatë natës adhurohej hëna. Për sakrificë pa gjak flirtohen materiet ushqimore si pijet alkoolike, orizi, gruri, mielli, qumështi.¹⁸⁷

¹⁸⁷ Vep. e cit., f. 62-64.

5. Klasa shpirtrore (klerikët)

Te turqit e vjetër ka patur njerëz të cilët i kanë udhëhequr ritualet fetare dhe ceremonitë e sakrifikimit, dhe që kanë qenë edhe ndërmjetësues mes njerëzve dhe shpirtërave. Këta njerëz janë quajtur “kam”. Këta janë një lloj i veçantë shërbyesish fetarë.

Tunguzët këtyre u thonë “shaman”. Kamët janë njerëz që dinë të lidhen me shpirtat në forma të ndryshme. Njerëzit normalë nuk mund të dinë se shpirtërat në cilën gjendje janë dhe prej cilave gjëra ata ndiejnë kënaqësi. Ata nuk mund të përcaktohen se prej cilit lloj të sakrificave mund të jenë të kënaqur. Vetëm se, kami dhe shamani me fuqinë dhe frymëzimin që marrin prej shpirtërave të paraardhësve i dinë të gjitha këto. Ata punojnë që në njërin anë të mundësojnë vazhdimin e të mirës dhe të dobishmes në aspektin shpirtëror për njerëzit, kurse në anën tjetër, të pengojnë aktivitetet e dëmshme të shpirtërave të këqinj. Kami, në ritualet që i përgatit me këtë qëllim, bën takime me shpirtërat dhe i kënaq ato, dhe kështu mundohet të arrijnë rezultatin e nevojshëm.

Besohet se kamët lajmërojnë edhe për të ardhmen. Mevrizi, kur flet për kërgëzët, thotë:

“Çdo vit në ditë të caktuar sillet një njeri dhe pranë tij grumbullohen këngëtarët, muzikantët dhe njerëz të ngjashëm me ta. Këta fillojnë të argëtohen. Kur tubimi merr një gjendje të pëlqyeshme, njeriu, për të cilin bëhet fjalë alivanoset. Ai bie në tokë si një njeri epileptik. Gjatë kësaj gjendjeje ai pyetet për ngjarjet e vitit të ardhshëm. Dhe pastaj ai tregon se çfarë do të ndodhë në vitin e ri, a do të ketë bollëk, apo mungesë ushqimi, apo shi ose thatësi”¹⁸⁸

Kamllëku, sipas alltajve, llogaritet si një sëmundje, e cila trashëgohet familjarisht dhe që, sidomos në moshën fëmijërore, vjen me anë të rojeve epileptikë. Çdokush me anë të një edukimi të caktuar nuk mund të bëhet kam. Kamllëku është një çështje natyrore dhe një caktim i pashmangshëm. Shembuj të panumërt tregojnë se aftësia për kam është patologjike. Sipas Radlofit, mbrojtësit e kamllëkut vijnë në një kohë të papritur. Kandidati për kam së pari ndjen një lodhje të madhe, trupi i tij tkurret dhe dridhet dhe pas kësaj pason gjendja e të gogësiturit. Gjoksi i ngushtohet, qanë duke nxjerrë zëra të çuditshëm, sytë i rrotullohen. Pas një kohe kërcen dhe çohet në këmbë, fillon të rrotullohet si i çmendur dhe në fund duke i shkumuar goja bie në tokë, trupi i tij bëhet i pandijshëm. Këto gjendje brengosëse vazhdojnë një kohë. Si përfundim një ditë e merr daullen dhe fillon t'i bjerë, qetësohet dhe vjen në vetë. Besohet se ai që ikën që të mos bëhet kam, çmendet apo vdes në moshë të re.

Kamët, në përgjithësi janë njerëz të mençur, me shpirt poeti dhe fantazist. Ata gjatë ritualit, me një ekstazë (nga zëllim) të lartë, kalojnë prej vetes dhe shkojnë në qiell ose zbresin në botën nëntokësore. Krijesat dhe ngjarjet e çuditshme që i shoh atje i shpjegon në imtësi. Vetëm se, pas vetëdijësimit nuk mund të përkuqtojnë asgjë. Transmetohet se kamët ndahen në dy grupe, në të bardhë dhe në të zinj. Të parët mundësojnë kontaktin me qiellin, me Ulgenin, perandorin e botës së dritës dhe me shpirtat e mirë. Kurse të dytët organizojnë ceremoni vetëm për Erlikin, përfaqësuesin e shpirtit trishtues të nëntokës, dhe për shpirtat e varur prej tij. Këto dy lloje të kamëve ose të shamanëve, nga njëri-tjetri dallojnë edhe për nga veshja. Kamët e bardhë, në krabasim me kamët e zinj, janë më modestë dhe pa madhështi. Kurse gratë mund të bëhen vetëm shamanë/kamë të zinj.

6. Vdekja dhe besimet në lidhje me të

Turqit e vjetër sëmundjen dhe vdekjen e llogarisnin si një vepër të shpirtërorve të ligj. Sipas turqve alltajas, Erliku, perandori i botës nëntokësore, me anë të alldaçëve që i dërgon në tokë, i burgos shpirtat e njerëzve dhe i jep fund jetës së tyre. Edhe jakutët vdekjen e shpjegojnë me kapjen e shpirtit të njeriut, nga ana e shpirtave të ligj. Sipas përfytyrimeve të tyre, shpirtat që e krijojnë vdekjen janë shpirta, o të anëtarëve të vdekur të familjeve të tyre, ose janë të të vdekurve të huaj. Në përfytyrimet e tyre është edhe ajo se shpirti, në gjendjen e vdekjes, fluturon dhe shkon në formë të një zogu. Reflektimin e tyre e shohim edhe në mbishkrimet Orhun. Besohet se, shpirtat shohin dhe dëgjojnë çdo gjë që lëviz rreth tyre.

Sipas turqve alltaj, me kalimin e kohës njerëzit do të pakësohen dhe nuk do të largohen prej

¹⁸⁸ Ramazan Şeşen, *İbn Fadlan Sayahatnamesi*, Stamboll 1975, f. 99.

mëkateve. Zoti i mirë, Ülgeni, do të largohet nga kjo shoqëri mëkatore. Në tokë do të dalë zoti Erlik dhe do të nxitë të keqen. I shqetësuar nga kjo zoti Ülgen, për t'i shpëtuar njerëzit në tokë, do të luftojë me djalin e tij, Erlikun, i cili ka një karakter të keq. Në fund Ülgeni do të dominojë dhe në tokë do të mbetet sunduesi i vetëm. Dhe më vonë do t'i ringjallë të gjithë të vdekurit dhe do ta fillojë ditën e ringjalljes.

a. Mbajtja zi

Në fenë e turqve të vjetër, dhembja që ndjehet me rastin e vdekjes së ndonjërit, shprehet në forma të ndryshme dhe me disa ceremoni. Hunët si traditë i shkurtojnë flokët. Për trimat nuk derdhin lotë, por duke e lënduar fytyrën derdhin gjak. Sipas burimeve kineze, te turqit, anëtarët e familjes duke bërtitur dhe duke qarë përpara tendës ku gjendet i vdekuri, fytyrën e tyre e lëndojnë me thikë dhe derdhin lotë gjaku. Në Mbishkrimet Orhun shpjegohet se, me rastin e vdekjes së Bumi Kaganit dhe vëllait të tij Kul Tikinit, në mesin e të afërmeve që kanë ardhur ka patur edhe prej atyre që kanë mbajtur zi. Ata që do të marrin pjesë në ceremonitë e zisë, si shenjë zie, ka qenë traditë t'i presin flokët dhe veshët. Te kërgëzët ditën kur varroset i vdekuri, gruaja e tij e mbetur vejushë dhe vajzat e tij i shkurtojnë flokët. Prej gërmimeve të bëra kuptohet se, hunët, flokët e prera bashkë me teshat e tjera me vlerë, i kanë futur në varr. Megjithatë, në një varr hunësh, në Noyin Ula afër Urgasë, janë gjetur 17 gërsheta flokësh të mbështjellura me mëndafsh. Kërgëzët, si shenjë zie, kalit të të vdekurit ia presin bishtin dhe kreshtën.

b. Tradita e varrimit të të vdekurve

Sipas burimeve kineze, hunët, të cilët në shek. I të e.s. kanë jetuar në pjesën veriore të Mongolisë, prijësit e tyre familjarë i kanë varrosur me teshat të argjendëta. Gjithashtu në burimet kineze është e regjistruar se turqit, të cilët në shek. V-VIII kanë jetuar në rrethin Kara Irtish, në veri të shkretëtirës Gobi, të vdekurit i kanë djegur bashkë me kalin dhe teshat e tyre. Po ashtu prej burimeve të njëjta mësohet se, edhe dubotë, të cilët jetonin në pjesën e epërme të Jenisejit, pasi të vdekurin e fusnin në arkivol, e vendosnin mbi një shkëmb ose mbi drunj. Te gokturqit është traditë që te varri i perandorit ose i udhëheqësit të vdekur të ngulen aq statuja sa armiq ka mbytur ai deri sa ka qenë gjallë. Këto statuja quhen balbal. Qëllimi i kësaj është që njeriu që përfaqëson balbalin në botën e të vdekurve, të mundësojë që të shërbebet i vdekuri. Sipas asaj që shpjegon Ibën Fadlani, te hazarët dhe te oguzët ka qenë traditë që i vdekuri të varroset në shtratin e lumenjve. Për këtë, në shtratin e lumit që ka ndryshuar kahje përgatitet një varr me material të fortë dhe pasi që i vdekuri të varroset aty, ujërat rrikthehen në shtratin e vjetër të tyre.

Mervizi lajmëron se, kërgëzët, të vdekurit e tyre i kanë djegur: "Ata mendonin se zjarri të vdekurin e pastron dhe e lanë prej mëkateve. Kjo traditë e djegies tek ata është e hershme. Por, pasi u bënë fqinj me muslimanët, filluan që të vdekurit t'i varrosnin". Sipas njohurive që i jep Plano Carpini, i cili ka shëtitur nëpër Azinë e Mesme, mësohet se në shek. VIII, një zotëri që vdiste te turqit, varroset fshehurazi. Përpara të vdekurit vendosej një masë e mbushur me ushqime si mish, qumësht etj., po ashtu varroset bashkë me të edhe kali i tij me të gjitha stolitë. Gjithashtu te varri thërrë një kalë dhe habej, kurse shtëpia dhe qerija e të vdekurit shkatërroheshin. Ka qenë traditë që te varri të ngulet një kalë që ka kaluar nëpër shtagë. Qëllimi i të gjitha këtyre ceremonive është furnizimi i të vdekurit me gjëra të gjalla dhe jo të gjalla, të cilat do t'i përdorë në botën e re, dhe që do t'i shërbejnë për t'ia lehtësuar jetën atij atje.

Në vitet 1924-25, në gërmimet e bëra nga arkeologë rusë në fortesat e maleve Noyan-Ula në pellgun e lumit Selanga, janë zbuluar varreza të princave hunë. Princat hunë, në përgjithësi janë varrosur nëpër male të larta. Bora që depërton nëpër varret e tyre ngrin shpejtë dhe mbetet e pashkrirë shekuj me rradhë. Për këtë stofat, drunjat dhe trupat që janë varrosur bashkë me të vdekurin, janë ruajtur të paprishura dhe kanë arritur deri në kohën tonë. Pjesa e jashtme e varreve është e ngritur me gurëz dhe me tokë, dhe kështu ka marrë formën e piramidës. Pjesa e brendshme e varrit përbëhet prej dy pjesëve. Gropat e varreve gradualisht thellohen dhe kështu dalin në shesh korridorët. Pas korridorit arrihet në vendin ku është vendosur arkivoli. Arkivoli ishte varrosur në një gropë të hapur për këtë qeli të brendshme. Kjo qeli mbyllet me dërrasa të prera bukur dhe me trung. Në kapakët e disa arkivoleve haset në mbeturinat e stofit të mëndafsh. Nga kjo kuptohet se, arkivolet kanë qenë të mbështjellur me stof mëndafshi. Në korridorët e varreve, si shenjë zie, është hasur në stofë me yndyrë. Gjithashtu në varreza janë gjetur stoli kuajsh, teshat të mëndafsh, teshat shtëpishë, kurse në një vazo janë parë edhe mbeturina çaji. Në këto varreza kuajtë janë varrosur jashtë dhomave që kanë qenë të posaçme për njerëzit.

Nëpër tregje janë gjetur shumë trupa të ngrirë kuajsh.

7. Marrëdhëniet e tyre me fetë e tjera

Marrëdhëniet e turqve me fetë e tjera shkojnë shumë larg në histori. Misionarët budistë, në shtetet turke kanë filluar të paraqiten qysh në shek. II. të e.s. Jemi dëshmitarë të asaj se më vonë në mesin e turqve janë përhapur edhe zaratustrizmi (“fe” e adhuruesve të zjarrit), hebraizmi, krishterimi, maniheizmi. Nuk ka dyshim se te turqit kanë ndikim edhe fetë kineze si konfuçianizmi dhe taoizmi.

a. Budizmi

Budizmi ka lindur në Indi në shek. VI para e.s. Ky besim në shek. III ka arritur në Baktrija dhe në Gandhara, kurse më vonë në Azinë e Mesme. Në shek. III dhe IV në Tashkent dhe në Merv gjendeshin tempuj budistë. Sidomos manastiret e ndërtuara gjatë rrugës së karvanëve, që shtrihet deri në Kinë, veprimtaritë e tyre i kanë vazhduar shekuj me radhë. Në manastiret e quajtura Vihara, të cilat janë të ndërtuara në Hotan dhe në Miran, në Tumshuk dhe në Kuça, misionin e tyre e kanë vazhduar murgjit e quajtur “tayin”. Sipas Gunay-it dhe Gungor-it, “qyteti Buhara, në fakt emrin e merr prej manastireve...në formimin e medreseve në botën islame dhe në përhapjen e tyre në tërë botën islame në kohën e selxhukëve kanë patur ndikim stili i këtyre viharave budistë”.¹⁸⁹ Në mesin e turqve më tepër janë përhapur fraksionet budiste si mahajana dhe lamaizmi. Periudha madhështore e tyre ka vazhduar me ardhjen e islamit, ndërkaq më vonë vendin ia kanë lënë islamit. Kurse lamaizmi ende e vazhdon ndikimin e tij në Mongoli dhe në mesin e disa fiseve turke.

b. Zaratustrizmi

Edhe pse është i vështirë përcaktimi i fillimit historik të zaratustrizmit në mesin e turqve, po qe se e marrim parasysh se Zaratustra (630-553 para e.s.) është rritur në pellgun e lumit Amuderja, dhe se ai ka pranuar shpalljen e parë të tij, atëherë nuk është shumë imagjinuese që të flitet për marrëdhëniet e turqve me zaratustrizmin. Edhe pse më vonë ai është shpërngulur në rajonin persian, vdekja e tij ka ndodhur në dorën e perandorit të shtetit Turan, Arcataspa, i cili ka qenë i brengosur për përhapjen e zaratustrizmit në shtetin e tij. Të gjitha këto tregojnë mundësinë e fillimit të marrëdhënieve me zaratustrizmit dhe turqve që në kohën kur ka jetuar Zaratustra. Para islamit tempuj të zaratustrizmit ka patur në Buhara, në Samarkant, kurse në Transoksani, zaratustrizmi ka dominuar.¹⁹⁰ Prej burimeve kuptohet se ka patur ndikim edhe në Azi të Mesme dhe ka rivalizuar edhe budizmin.

c. Maniheizmi

Ky besim në tekstet turke përmendet me emrat “Üç Odki Nom” dhe “İki Yıldız” (dy yje). Themeluesi i saj, Mani (216-277) duke qenë ende gjallë, në të katër anët e botës ka dërguar misionarë dhe është kujdesur për përhapjen e fesë së tij. Kështu që është shumë normale që misionarët e tij të shkojnë edhe në qytetet e turqve, që janë fqinjë me Iranin. Më kryesorët nga ata misionarë janë tregëtarët sogdianë. Bogu Kagan (759-779), njëri nga ujgurët, maniheizmin e ka pranuar fe shtetërore dhe rreth e përqark ka dërguar misionarë. Fraksioni “Dinaverije”, pranohej nga ujgurët dhe ata për qendër shtetërore të maniheizmit nuk e pranonin Babiloninë, por, Samarkandin. Kurse atyre që Babiloninë e njihnin si qendër shtetërore u thuhej “Dinderan”. Turqit tempujt e quajtur “Bia”, i quanin

¹⁸⁹ Günay-Güngör, f. 111.

¹⁹⁰ Vep. e cit. f. 128.

“Tengirlik” ose “Çaydan”. Prej shek. X simpatizuesve dhe anëtarëve të kësaj feje u thuhej “Acari”.¹⁹¹

ç. Krishterimi

Njohuritë për prezencën e krishterimit në Azinë e Mesme nuk shkojnë më largë se deri në shek. IV të e.s. Kontaktet përgjithësisht janë bërë me kishën lindore. Më kryesore në këtë rast është nestorianizmi. Sidomos më tepër shihet në vendbanimet e formuara rreth rrugëve tregtare si në Bajkent, Buhara. Që në vitin 332 në Merv haset në një peshkopatë krishtere. Gjurmët krishtere të shek. VII. dhe VIII. në Azinë të Mesme dhe në Ural, u takojnë karlukëve. Në shekullin e njëjtë edhe nestorianizmi është përhapur në mesin e kërgëzëve, ujugurëve, najmanëve, kereikëve dhe hunëve. Me çlirimin e qytetit Talas nga ana e muslimanëve, atje kisha e madhe u shndërrua në xhami. Në periudhën e mëvonshme shihet se të krishterët me shumicë kalojnë në islam. Pas shek. XV. është shumë vështirë që të gjenden njohuri për ta.¹⁹²

Edhe aktivitetet misionerike të kishës Melkite Bizantine mbeten pas të tjerave. Në rrugën e mëndafshit dhe në Transoksani themelohen qendra misionerike dhe dërgohen misionarë në Kinë. Por nuk kanë dalë të suksesshëm sa nestorianët. Në fakt më tepër sukses kanë treguar në Evropën Lindore dhe në Ballkan. Saqë fiset turke që kanë pranuar krishterimin e kanë humbur unin e tyre kombëtar, janë sllavizuar ose janë shkrirë në popuj të tjerë përreth tyre. Si shembull mund të numërohen bullgarët, kumanët, këpçakët, uzët etj. Ata që nuk e kanë humbur unin e tyre kombëtar dhe që e kanë mbrojtur veten e tyre deri më sot janë gagauzët (Gök Oğuzları). Këta janë të krishterë ortodoksë. Këta kanë qenë të suksesshëm në mbrojtjen e gjuhës së tyre. Kështu që në shek. XVI. në Dobruçha, nën udhëheqjen e princit Ballëk, kanë formuar edhe një shtet të tyre. Momentalisht jetojnë në Republikën e Moldavisë.¹⁹³

d. Hebraizmi

Hazarët janë fis turk i cili e ka pranuar hebraizmin. Mesudi këtë e çon deri në kohën e Harun Reshidit (768-809). Kurse burimet hebraike thonë se kjo ngjarje ka filluar që në shek. VII. Në këtë rol të madh kanë luajtur, sipas hebrenjve, hebrenjtë të cilët nga dhuna e Bizantit janë strehuar te hazarët. Në aspektin fraksional ky hebraizëm është i fraksionit hebraik, karai. Ata përveç Dhiatës së Vjetër nuk pranojnë libër tjetër të shenjtë. Ata nga rajoni dhe skena historike janë zhdukur me dominimin e selxhukëve në këtë rajon. Shumica e popullit e kishte pranuar islamin. Ata që kanë mbetur, me invadimin e mongolëve janë tubuar në Krime. Pas Revolucionit Rus, si çdo besimtar, u janë nënshtruar torturave të ndryshme. Në terminologjinë fetare, në vend të fjalës *sinagogë* kanë përdorur fjalën *kenasa*, në vend të fjalës *kryerabin* kanë përdorur “*gaban*”, “*gazan*”, kurse në vend të fjalës *Jehova*, kanë përdorur fjalën “*Tenkr*”. Historia e kolonive hebraike në Azerbejxhan kthehet deri në shek. VII-X. Atje e marrin emrin “hebrenjtë e malit”. Në Baku dhe në Guba numri i tyre është në shtim e sipër.¹⁹⁴

¹⁹¹ Vep. e cit. f. 129-136.

¹⁹² Vep. cit. f. 142-147.


¹⁹³ Vep. e cit. f. 148-153.

¹⁹⁴ Vep. e cit. f. 161-167.

ZARATUSTRIZMI

Literatura: W. Hinz, *Zarathustra*, Stuttgart 1961; Avesta, *Die Heiligen Bücher der Parsen*, Übersetzt von Fritz Wolf, Strassburg 1910, Tipki Basim: Berlin 1960; H. von Glasenapp, *Die nichtchristlichen Religionen*, f. 288-300; F. Heiler, *Die Religionen Menschheit*, f. 419-438.

Themeluesi i zaratustrizmit është Zaratustra.¹⁹⁵ Origjinali i fjalës është “Zarat-Ustra”. Forma e latinizuar e saj është “Zarathustra”, kurse forma e greqizuar është “Zoroaster”. Ndërsa fesë që ai themeloi i thuhet “zoroastrizëm”, ose sipas emrit që përdoret për zotin në këtë fe, Ahura Mazda, kësaj feje i thuhet “mazdaizëm”. Kurse në bazë të shtetit ku kjo fe vepron i thuhet edhe “persizëm”. Kur’ani për këtë besim përdor termin “mexhusi”.¹⁹⁶ Për shkak të traditës së ndezjes së zjarrit që e përdorin në adhurimet e tyre ata janë quajtur edhe si “adhurues të zjarrit”.



Emri i themeluesit përbëhet prej kompozimit të fjalëve zarath (*i bukur, i drejtë*) dhe ustra (*deve*), që ka kuptimin “ai që ka deve të bukur”. Etimologjia popullore fjalës Zaratustra i jep kuptimin “Ylli që jeton”. Sipas legjendës, ai është ndeshur me një yll që ka qenë në shpërndarje e sipër dhe ai yll atë e ka bartur në qiell. Për këtë shkak ai e ka marrë emrin Zaratustra, që do të thotë “ylli që jeton”.

Ne, njohuritë për zaratustrizmin i marrim prej burimeve të ndryshme. Bota perëndimore një kohë të gjatë ka shfrytëzuar shkrimtarët latinë dhe grekë, që janë burime të dorës së dytë. Dijetari nga Oxfordi, Thomas Hyde, më 1700 ka shkruar një vepër me emrin “*Historia religionis veterum Perserum, eorumque Magarum*”, dhe kjo vepër për shkrimtarët e mëvonshëm është bërë burim kryesor. Sipas Hyde, Zaratustra është një profet për të cilin është folur shumë edhe nga ana e Jezusit/Isait. Ezra (Uzejri) dhe profetët e tjerë hebraikë, kanë shrytëzuar të dhëna nga ai. Kjo vepër e Hydeit, ka qenë burim edhe për Volterin, edhe për Lessingun. Por, deri në shek. XVIII. Avesta, libri hyjnor i kësaj feje, ende nuk njihej definitivisht. Si përfundim, më 7 nëntor të vitit 1754 Anquetli Duperron, një i ri ushtar francez dashurohet në persishten. Në Indi pati sukses, futet në mesin e persianëve dhe prej tyre mori mësimet e duhura. Më në fund, duke i mbushur dy këmisha dhe dy shami xhepi me disa libra dhe me Avestën, me anë të një organizate franceze arrinë të iki, për në Indinë Lindore. Më vonë, Avestën e përkthen në frengjisht dhe kështu më 1771 arrinë të botohet në Paris. Njëpërmjet kësaj bota shkencore njohu librin kryesor, gjegjësisht burimin kryesor të Zaratustrizmit.

1. Librat e shenjtë

Emri i librit të shenjtë, i cili del në shesh pas vdekjes së Zaratustrës, është Avesta. Ajo rrjedh prej fjalës *apastak*. Në përgjithësi përkthehet si “*tekst origjinal*”. Në fillim Apastak është kuptuar vetëm si transmetim gojor. Ka që pretendojnë se kjo rrjedh prej fjalës ermene *avandem* (të shpjegosh, të transmetosh). Pjesa *Gatatët*, e librit të shenjtë, ka mundësi që të shkojë deri në kohën e Zaratustrës. Pjesa tjetër është e shkruar më vonë. Avesta është shkruar në dialektin e vjetër iranian. Këtij dialekti i

¹⁹⁵ Në gjuhën shqipe përdoret shprehja Zoroastrizëm, themluesi i të cilit është Zoroastri. (shënim i përkthyesit).

¹⁹⁶ Kur’ani, Haxhah, 17.

thuhet *dialetki aveste*. Ka një afërsi me gjuhën e vjetër indiane. Sot nga dialektet persiane më afër saj është dialekti afgan.

Sipas të dhënave iraniane, ekziston një tekst i Avestës i llogaritur i vërtetë në kohën e *ahamenidëve*. Kurse në tekstin e Avestës që e posedojmë sot është bërë një numër shtesash. Teksti i periudhës ahamenide ka humbur gjatë luftës së zhvilluar mes persianëve dhe Lekës së Madh. Edhe pse në periudhën e sasanidëve është mundur që shkrimet e shenjta të grumbullohen edhe një herë, me çlirimin e Iranit nga ana e muslimanëve përsëri stagnoi një aktivitet i tillë. Teksti ekzistues përbëhet prej pjesëve që shpëtuan nga shumë vështirësi, që kanë pësuar përmirësime të mëdha dhe që kanë mundur të mbijetojnë deri më sot. Kontrolli i saktësisë dhe i përcaktimit të marrëdhënieve me Zaratustrën, është shumë i vështirë.

Avesta është njëra prej librave, që në aspektin e shprehjes dhe përmbajtjes është shumë e vështirë për t'u kuptuar. Që në fillim kanë lindur problemet për të kuptuarit e Avestës dhe kjo ka qenë shkak i daljes së shumë komentimeve në shesh. Këto komentime quhen "*zend*" (shkencë). Me kalimin e kohës, prej bashkimit të Zendit dhe Avestës është formuar "*Zend-Avesta*".

Në transmetimet islame lajmërohet se Avesta është parë në shek. X në Bagdad. Libri Videvdat (libri për mbrojtjen nga demonët), që është pjesë e Avestës, nuk është i plotë. Dorëshkrimi më i vjetër që njihet sot, është i mbetur prej shek. XIII dhe ruhet në Indi. Kurse ata që janë në persisht nuk shkojnë më larg shek. XVII. Ndërkaq libri i botuar që është sot, ka afërsisht 500 faqe dhe është i keqpërdorur. Libri i adhurimit, pjesa kryesore e të cilit përbëhet prej 72 pjesëve, është jasna. Pjesës 16., që përbëhet prej 28-34 dhe 43-51 pjesëve të Jasnasë, i thuhet gata, për të cilën ekspertët kanë arritur në konsensus se arrin deri te Zaratustra. Në aspektin e shprehjes dhe formës ajo paraqet paralelizëm me Atharva-Veda, e cila reflekton periudhën indo-xhermene.

2. Zaratustra

Sipas të dhënave vendëse, Zaratustra ka jetuar në një rajon të quajtur vendi i Arjas. Ky vend, sikur që është i njohur, është pjesa lindore e Iranit. Kushtet gjeografike dhe ekonomike të cilat lajmërojnë *gatatët*, tregojnë se ky rajon është një vend malor ku jetohet me blegtori. Nga ajo që është zbuluar kuptohet se populli *jashtë*, i cili ka jetuar në këtë vend para Zaratustrës, ka besuar në shumë zota dhe për lumenjtë, malet dhe për liqenet ka flijuar kurban si lopë dhe dhen. Ata nuk kanë patur tempuj. Ka patur murgj që merreshin me magji dhe me sakrificë, të cilët jetonin me dhuratat e të pasurve. Aty Mitra e indusve kishte shumë respekt. Në vend të pijes *soma*, përdornin *haoma*. Kjo ishte një bimë e shenjtë të cilën besohet se e pinin edhe zotat. Prandaj murgjit e kanë pirë me shumicë, se ajo ishte një bimë e lëngët dehëse. Zaratustra ka lindur dhe është rritur në një ambient të tillë. Vetëm se, ku dhe kur ka lindur, ka qenë temë diskutimi një kohë të gjatë. Sipas disave, Zaratustra ka jetuar 1000 vjet para e.s., ose ka jetuar në periudhën e ahamenidëve. Kurse shkrimtarët grekë, atë e çojnë në periudha shumë më të vjetra dhe pretendojnë se ka jetuar 6000 vjet para Platonit. Kurse një pjesë janë të mendimit se ai ka jetuar nga vitet 2000 para e.s. Ndërkaq burimet iraniane tregojnë se Zaratustra ka jetuar 258 vjet para Lekës së Madh. Shumica e historianëve këtë datë e pranojnë si të vërtetë. Për pasojë, ata janë të mendimit se Zaratustra ka jetuar në kohën e ahamenidëve, në shek. VI para e.s. Ajo që mësohet prej hieroglifëve persiane dhe prej transmetimeve greke, vërteton mendimin se Vishtaspa (621-581 para e.s.), që është i ati i Dariusit të Madh, dhe Vishtaspa, perandori që i beson Zaratustrës dhe që përmendet në Jasna 51, 16, janë i njëjti person. Sipas kësaj Vishtaspa ka pranuar fenë e Zaratustrës dhe në të ka parë energjinë e nevojshme për të formuar një perandori. Në bazë të kësaj llogarie kuptohet se Zaratustra ka lindur më 630 para e.s. në rajonin e quajtur Horasan.

Nëna e Zaratustrës është Dugdova, kurse babai Pojrushaspa. Thuhet se i takojnë fisit Spitama. Zaratustra është i treti mes pesë vllëzërve. Në moshën 7 vjeçare, babai e dërgon te një mësues, në bazë të traditës së kohës. Kurse në moshën 15 vjeçare, thuhet se ai, në bazë të moshës që ka patur është zhvilluar më tepër. Ndërkaq në moshën 20 vjeçare ai ka filluar udhëtimin e tij në vendet përreth. Babai i tij pëlqen një vajzë për të, mirëpo ai, edhe pse ishte në kundërshtim me traditën vendëse ngul këmbë që ta shohë vajzën me të cilën do të martohet. Pasi e sheh atë në fund martohet. Emrin e kësaj zonje nuk e dimë, vetëm se, transmetohet se Zaratustra me të ka patur një djalë me emrin Ishatjastra dhe tre vajza.

Pas moshës 20 vjeçare, te Zaratsustra bëhen ndryshime të mëdha shpirtërore. Shpesh shkonte në male dhe vende të pashkela dhe atje mendohej të jetojë një jetë asketike.

Përafërsisht mes moshës 30-40 vjeçare në një festë vere, pranë lumit Daitja (Amaderja?) atij i paraqitet një engjell me emrin Vohu-Mana dhe e shtetë për shpalljen që i ka dërguar zoti i madh Ahura-Mazda. Është e mundshme që kjo ngjarje të rastis në muajin mars të viti 600 para e.s. dhe në kohën e lindjes së mbretit Husrev. Sipas transmetimit thirrja për profet e Zaratustrës është bërë pas jetës asketike të tij. Pas kësaj kohe ai ka qenë i preokupuar me adhurim dhe meditim në një shpellë pranë një mali të afërt. Kriza e tij mori fund me krijimin e marrëdhënieve me botën hyjnore. Kurse engjëlli që iu paraqit, atij ia sollti detyrën e profetësisë. Ai sipas një fjale të tij, nuk ka mbetur vetëm me të pamurit e engjëllit, por, në të njëjtën kohë me veshin e brendshëm të tij i ka përvetësuar mësimet e tij. Kështu që, marrëdhëniet me engjëllin do të vazhdojnë deri në fund të jetës së tij.

Emri i engjëllit, sipas asaj që e ka emërtuar Zaratustra, Vohu-Mana, ka kuptimin “*shpirti i mirë, ndjenjë e mirë, mendim i mirë*”. Zaratustra ngjarjen e kontaktit me engjëllin e shpjegon kështu: “*Kur humba veten në shpirtin e mirë ai më pyet, kush je ti, kujt i takon ti, pyetjes së parë iu përgjigja se unë jam Zaratustra, jam armik i vërtetë i gënjeshtreve, por, dëshiroj të bëhem përkerabës i fortë i njerëzve të drejtë*” (Jasua, 43, 37).

Pas kësaj nuk dimë më për misionin profetik të Zaratustrës dhe si ai e ka filluar këtë detyrë. Sipas transmetimeve persiane, ai, dhjetë vjet me radhë, në vendlindjen e tij, është marrë me të mësuarit dhe të shpjeguarit e asaj që i është shpallur. Mes viteve 600-590 para e.s., këto aktivitete nuk arritën ndonjë përfundim. Në vendin e tij, në Bakterija nuk mundi të arrijë sukses, sepse prej fisit të vet mundi të bind vetëm Madjomanbanë. Në fund, e kuptoi se, kundër armiqësisë së popullit të tij, e vetmja rrugë ishte braktisja e vendit dhe shpërngulja. Përafërsisht, më 590 para e.s, në stinën e dimrit mori rrugë drejt lindjes. Zaratustra gjendjen shpirtërore të këtij rasti e shpjegon kështu:

“Cili rreth mua më fsheh?

Mua do më fsheh, ku duhet të ikë?

Largohem prej fisnikërisë dhe priftërisë,

Bashkëatdhetarët, të cilëve u kam shërbyer, nuk më lenë rahat.

Si edhe gjyqtarët e huaj në vendin tim!

O, Zoti im që di çdo gjë, më trego

Si mund të të bëj të kënaqur?” (Jasua, 46,1)

Këtu i shohim brengat dhe ankesat e Zaratustrës. Përafërsisht ai udhëtimin e tij e filloi në muajin Janar të vitit 590 para e.s. Në dimrin e ftohtë ai vazhdoi të udhëtojë drejt maleve Horasan. Nëse kalimthi trokiste tek ndonjë nga parësia e vendit, nuk pranohej brenda. Viti i shpërnguljes së Zaratustrës nuk është i qartë. Vetëm se ka qenë i detyruar të shkojë drejt lindjes dhe bashkë me ata që kanë qenë me të, strehohet në shtetin e Kavi Vishtasë, por, gjithashtu i jepet edhe e drejta e propagandimit të fesë së tij.

Vetëm se, pas një kohe i ikën edhe qetësia. Ballafaqohet me kundërshtime të forta nga klerikët vendës. Sipas transmetimeve, murgjit atij i drejtohen me 33 pyetje, diskutimi i të cilave vazhdoi vite me radhë. Në këto tubime ka marrë pjesë edhe perandori Kavi Vishtaspa dhe është ndikuar prej diskutimeve të tij. Kundërshtarët e tij e akuzojnë se ai është magjistër. Zaratustra burgoset, lihet i uritur. Ai nga kjo gjendje shpëton me shërimin e kalit të perandorit, të cilin perandori e donte shumë.

Siç kuptohet nga transmetimet, Zaratustra ka ardhur në Horasan dhe këtu dy vjet ka predikuar dhe e ka rrënjësuar fenë e vet. Fenë e tij e kanë përqaftuar disa nga vendësit. Më kryesori nga ata është Frasha-Oshtra. Atë dhe vëllain e tij, Camaspa, Zaratustra i lavdëron si mbrojtës të besimit të vërtetë. Po ashtu sipas transmetimeve edhe mbretëresha Hutavsa ndikohet nga predikimet e tij dhe bëhet shkak për pranimin e këtij besimi nga ana e burrit të saj, Vishaspa. Vëllai i perandorit Zajravaraj dhe princi Spentodata, janë prej besimtarëve të njohur. Ai në këtë kohë martohet me një vajzë prej familjeve të parësisë.

Vishtaspa, pasi e pranon fenë e re, 30 vjet radhazi vazhdon të paraqesë ligjëratat e Zaratustrës. Vetëm se, autoriteti i tij i tejkaloi kufijtë mbretëror, kështu që edhe në shtetet përreth filloi të përhapet me të shpejtë. Kjo përhapje u bë shkak edhe për ndarjen e familjeve, disa e braktisën shtetin e tyre dhe u shpërngulën në shtetin e Vishtaspasë. Perandori i shtetit Turan, Arcataspa, i cili dëshironte t'i jap fund kësaj gjendjeje, e sulmoi shtetin e Vishtaspasë. Me këtë rast Zaratustra kapet nga ana forcave të Arxhataspasë dhe në vitin 553 para e.s. vritet në moshën 77 vjeçare.

3. Koncepti për Zotin

Zaratustra, zotin, për të cilin propagandonte e kishte quajtur *Ahura-Mazda*. Emri i tij mund të përkthehet si “*Zoti që di gjithçka*”. Te gatatë, të dy pjesët e emrit të zotit, fjalët Ahura dhe Mazda, përbëjnë një tërësi të pandarë. Etimologjikisht fjala Ahura do të thotë “*zot*”, kurse fjala Mazda “*Ai që di gjithçka*”. Kurse fjala zot në mënyrë direkte, te gatatë nuk përmendet fare. Zaratustra, në Jasna 44/3-6, duke e përshkruar Ahura Mazda-në, shprehet kështu:

“Kush i vendoi në orbitë diellin dhe yjet?

Kush është ai që hënën e merr në vete dhe e humb?

Kush është ai që botën e mban nën vete?

Kush është ai që nuk e lë qiellin të rrëzohet?

Kush është ai që i mban ujërat dhe bimët?

Kush është ai që erën dhe mjegullat i çon të vrapojnë?

Cili është ai krijues që krijoi gjumin dhe zgjimin?

Kush është ai që ringjallë vetëdijën e përgjegjesisë, në obligimin e mëngjesit, drekës dhe të mbrëmjes?

O, gjykatës suprem,

Ty, edhe si etern edhe si të amshueshëm, të gjeta me shpirtin tim?”.

Zaratustra Zotin, të cilin e quan Ahura-Mazda, e cilëson si “*zoti dhe krijuesi i vërtetë i rregullit dhe i veprimeve*”. Ai është që di çdo gjë, dhe ai është zoti që të mirës i përgjigjet me mirësi, kurse të keqes me të keqe. Vetëm se, të mirën dhe të keqen nuk i tregon si parapërcaktime. Për këtë arsye fati i njeriut mund të ndryshojë. Në luftën mes forcave të së mirës dhe të keqes, liria e njeriut është e padeterminuar. Që nga dita kur Zoti krijoi çdo gjallesë, edhe të drejtat edhe gënjeshttrat janë të lira në veprimin e tyre. Kurse në shkrimet e periudhës së mëvonshme të Avestës, shprehet se Ahura-Mazda i ka krijuar vetëm krijesat e mira dhe të pastra, kurse krijesat e këqija dhe të papastëra, i ka krijuar Ehrimeni, që është fuqi e djallit. Ahura-Mazda nuk ka ndonjë trup special. Ai konceptohet si zjarr, si dritë, si flakë.

4. Krijesat shpirtërore

Përveç engjëllit Vohu Manah, te gatatë ka edhe engjëj tjerë që kanë shërbyer si të dërguar të Ahura-Mazdasë. Njëri nga ata është engjëlli me emrin Sraoshah (respekt). Përveç këtyre, kujdes kërkojnë edhe krijesat e tjera shpirtërore, esenca e të cilave nuk është e qartë dhe e kuptueshme. Disa studiues thonë se, shtatë të shenjtat me emrin Amesha Spentas, janë pa trup; në realitet pretendojnë se këto janë cilësi të Ahura-Mazdasë. Ndërkaq në shkrimet e mëvonshme të Avestës, Amesha Spentas paraqitet si kryeengjëll, si një shpirt i shenjtë. Spenta Mainju, cilësohet si diç tjetër nga Ahura-Mazda, kurse në disa raste shihet si njëri prej emrave të Zotit. Prej krijesave shpirtërore janë edhe jazatatë, të cilat llogariten në mesin e krijesave të mirësisë. Në mesin e këtyre gjenden edhe zotat e vjetër popullorë iranianë para Zaratustrës, si Mitra dhe Verasragna.

Në fund mund të përmenden edhe fravashitët, të cilët llogariten si vizatime qiellore të të gjitha gjallesave. Ka mundësi që këto të krahasohen me idetë e Platonit. Ata po ashtu pranohen edhe si engjëj mbrojtës. Përveç këtyre gjenden edhe fuqitë e këqija, krijesat satanike. Në mesin e tyre numërohen Aka Mainju (shpirti i keq) dhe Ashme (dehja e vdekjes). Krijesa kryesore e të këqiave është Angra-Mainju, emri tjetër i së cilës është Ehrimeni. Fuqitë e këqija, nën urdhërin e tij, e kanë kapluar tërë botën. Numri i tyre me kalimin e kohës shtohet. Këto fuqi të së keqes, në përgjithësi janë zota të Iranit politeist, të periudhës para Zaratustrës. Zaratustra, kuptimin e këtyre e kthen mbrapsht dhe ato i cilëson si shpirtëra të këqinj. Kurse në shkrimet e periudhës së mëvonshme të Avestës, iranianët, armiqtë e tyre i kanë konsideruar për fuqi të këqija, të cilat i shërbejnë Ehrimenit. Për shembull, grekët, romakët, turqit dhe arabët janë cilësuar si ushtarë të djallit.

5. Dualizmi

Zaratustra, burimin e ngjarjeve të ndryshme në këtë botë e ka parë në aktivitetin e fuqisë së të mirës dhe të së keqes, gjegjësisht në aktivitetin e engjëjve dhe të djallit. Sipas tij, zoti Ahura-Mazda dhe engjujt nën urdhrin e tij, të gjitha gjallesat i orientojnë në mirësi drejt të bukurës, kurse Angra-Mainja dhe djajtë nën urdhërin e tij, gjallesat i orientojnë në të keqen dhe në rrugë të gabuar. Në botë, këto dy fuqi, për të realizuar dominimin absolut, janë gjithnjë në luftë me njëra tjetrën. Këto fuqi nuk kuptohen vetëm në aspektin etik, por edhe në atë metafizik. Fuqia pozitive me atë negative dhe fuqia krijuese me atë shkatërruese që në amshueshmëri kanë qenë në kundërshtim me njëra tjetrën. Këto shumë më herët paraqiten si "binjakë" të lindur prej Zotit të Kohës (Zervan, Debr): Ahura-Mazda, Angra Mainju. Në disa raste, njëra pranë tjetrës janë si drita me errësirën. Zoti i dritës llogaritet Ahura-Mazda, kurse i errësisës Djalli Angra-Mainju. Në luftën e këtyre fuqive të kundërta fitimi i fundit do të jetë i Ahura-Mazdasë. Sundimi absolut i tij do të jetë dritë, sikur dielli. Mazdaistët (adburuesit e zjarrit), janë si simbol i pastërtisë ideale. Ndeznin zjarr. Atyre u thuhej Asravan, që d.t.th. ndezës të zjarrit. Kjo traditë e tyre i ka shtyrë muslimanët që ata t'i quajnë adburues të zjarrit.

6. Koncepti për kohën

Sipas zaratustrianizmit, periudha prej krijimit e deri në kijamet do të zgjatë 12000 vjetë që përbëhen prej katër periudhave nga tre mijë vjet. Është e mundshme që numri 12 ka të bëjë me horoskopin dhe me numrin e muajve. Në fillim Angra-Mainju, që është njëri nga binjakët e krijuar nga Zervani edhe pse në amshueshmëri për shkak të xhelozisë, e ka sulmuar Ahura-Mazdanë, nuk ka qenë i suksesshëm. Armiqësia mes tyre vazhdon të ekzistojë. Pas kësaj, lufta që ka filluar mes zotit Ahura-Mazda dhe Angra-Mainju do të zgjatë 9000 vjet:

1. Në këtë periudhë (vitet 1-2999) Ahura-Mazda krijon engjëjt, shpirtërat e mirë dhe fravashitët, gjegjësisht, pamjet e përhershme shpirtërore të gjallesave. Të gjitha jetojnë për një të ardhme të pafundme.

2. Në këtë periudhë (vitet 3000-5999) krijesa e pafund shndërrohet në materie. Njeriu i parë i shndërruar në materie quhet gajomart, kurse në botën e kafshëve i pari është shpirti i kaut. Kështu këto fillojnë të jetojnë një jetë të përsosur pa gabime. Angra Mainju kur e sheh se sulmi në periudhën e parë i shkon kot dhe se fitorja e fundit i takon Ahura-Mazdasë, dëshiron që të bëjë një sulm të ri. Por, edhe këtë herë fiton Ahura-Mazda.

3. Në këtë periudhë (vitet 6000-8999) Angra-Mainju futet në botë, e mbyt njeriun e parë dhe kaun e parë. Por, njeriu dhe kau i parë e kanë parandjerë fatin e tyre dhe para se ata të vdisnin kanë lënë pasardhës. Gjatë kësaj kohe bota mbushet edhe me viganë dhe demonë, të cilët i ka krijuar Ahura-Mazda. Kështu që në botë përçizhet e mira me të keqen.

4. Në këtë periudhë (vitet 9000-12000) Ahura-Mazda për t'u ndihmuar njerëzve dërgon Zaratustrën. Zoti, shpirtin e tij e ka krijuar që në fillim të periudhës së dytë dhe kështu, ai (Zaratustra) që në atë kohë jetonte në botën e pafund. Ndikimi i misionit të Zaratustrës në botën ka jeton do të zgjatë dhjetë shekuj. Pastaj, me kalimin e kohës do të keqësohet gjendja gjenerale etike e botës. Në fund, në mijëvjetëshin e dytë pas Zaratustrës, do të vijë një profet, po ashtu prej fisit të Zaratustrës, dhe kjo gjendje do të përsëritet në mijëvjetëshin e tretë përsëri. Vetëm se emri i misionarit që do të vijë në mijëvjetëshin e tretë dhe i cili do të jetë një farë lloj mehdii, do të jetë Soashjant. Ai do të sundojë botën dhe do ta pastrojë atë nga fuqitë e këqija, do ta ripërtërijë misionin e Zaratustrës dhe bota do të mbushet me besimtarë të Zaratustrës. Në fund të mijëvjetëshit, sundimin e tij do t'ia dorëzojë Ahura-Mazdës dhe kështu do të marrë fund edhe ekzistimi i botës.

7. Format e adhurimit

Nuk kemi njohuri të mjaftueshme për format e adhurimit, të vendosura nga ana e Zaratustrës. Sot, format e

adburimit të parsijve nuk ka mundësi që të mbështeten te Zaratustra. Për mënyrën e pranimit të anëtarëve të rinj në këtë fe, nuk dimë asgjë. Besimtarët e sotëm, si shenjë e një lidhshmërie shpirtërore me zotin, lidhin një brez. Simboli kryesor i reformës fetare të Zaratustrës është mobimi i çdo lloji të sakrifikimit me derdhje gjak. Në vend të adburimit që i bëhet Mitres nëpër shpella të errëta, bëhen adburime të pastra gjatë ditës. Përpara altarit të vendosur në një shesh të gjerë ndizet një zjarr dhe duke i ngritur duart lart bëhet lutje. Zaratustra e hoqi institucionin e sakrifikimit të kafshëve dhe në vend të tyre vendosi traditën e ndezjes së zjarrit.

Altarët e zjarrit, të rregulluara në sheshe publike, duke u zhvilluar u bënë shkak i daljes në shesh të tempujve të mëdhenj të quajtur “Ateshgede”. Ateshgedetë, përbëhen prej një oborri të hapur në formë katrori, pranë të cilit gjendej edhe një dhomë e zbrazët e mbuluar me kupolë. Në këtë dhomë rri ndezur një zjarr i shenjtë. Kurse populli tubohet në oborrin e hapur dhe aty kryejnë adhurimin e tij. Më herët tempujt kanë qenë të izoluar nga drita dhe kanë qenë ndërtesa ku ka qenë ndezur zjarri i shenjtë. Zjarrin nuk e prekte asnjë dorë njeriu. Murgjit që e ruanin zjarrin, për të mos e përlyer zjarrin me frymëmarrjen e tyre, gojën dhe hundën e tyre i mbulonin sikur kirurgët modernë. Zjarrin e tollovitnin me mashë dhe me lopatë dhe mbi të vëndosnin drunjt të shenjtëruar.

8. Koncepti për botën e ardhshme

Zaratustra në predikimet e tij, shpesh lajmëronte për një ditë të llogarisë, që do të vijë së shpejti. Vetëm se kjo ditë është për ata që nuk janë mazdaistë, sepse në mëngjesin e ditës së katërt pas vdekjes, shpirti shkon në botën tjetër. Nëse është një shpirt besimtar, ai nga ana e Sraoshit do të dërgohet në parajsën qiellore. Kurse nëse është shpirt mosbesimtar bie në ferrin e përgatitur nën mbikalimin e quajtur Ura Simvant (ura e ndarjes), e cila e bashkon këtë botë me botën tjetër. Mesi i urës është si maja e shpatës. Kur do të kalojë ndonjë besimtar, do të zgjerohet dhe do të bëhet një rrugë e rehatshme me gjërësi prej 15 shtizash dhe kështu, besimtarit ia mundëson të arrijë në parajsën e përbershme të dritës. Kurse kur kalon shpirti jobesimtar, ajo bëhet më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata dhe kështu, shpirtin e jobesimtarit e rrëzon në thellësitë e pafund të ferrit. Madje engjëjt që qëndrojnë në fillim të urës, shpirtin besimtar e udhëzojnë dhe e çojnë në parajsë, kurse shpirtin jobesimtar e futin në ferr.

Vendin të cilin e quajmë ferr, Zaratustra e quan “Vendi i rrenës” ose “Shtëpia e rrenës”. Ky vend përfytyrohet si një vend në nëntokë i mbuluar me kupolë. Ky është vendi i njerëzve të këqinj dhe i krijesave të këqija. Ushqimi që iu ofrohet atyre është papastërtia. Ai është një vend i mbushur me errësirë, brengë dhe zhurmë.

Kurse vendi ku do të hyjnë besimtarët, është parajsja. Zaratustra këtë vend e quan “Shtëpia e lavdërimit”. Këtu në fillim hyn Zoti. Zaratustra këtu do të shpërblehet bashkë me ithtarët e tij. Kurse ata të cilët mirësitë dhe mëkatet i kanë të barabarta, deri ditën e fundit do të qëndrojnë në një vend në mes të parajsës dhe ferrit.

9. Dita e llogarisë

Përveç që shpirti, pas vdekjes, ballafaqohet me gjykimin individual, ai po ashtu paramendohet të ballafaqohet edhe me gjykimin gjeneral ditën e ringjalljes. Sipas kësaj, me kalimin e kohës, me plotësimin e jetës në këtë botë, në mijëvetëshin e tretë pas Zaratustrës, do të vijë mehdiu Soashjant dhe ai, pas punës së tij njëmijëvjeçare, sundimin e tij do t'ia dorëzojë zotit Ahura-Mazda. Pas kësaj do të fillojë edhe ringjallja, të vdekurit do të kthehen në trupat e tyre të mëparshëm dhe do të tubohen në sheshin e gjykimit. Aty çdo njeri do t'i paraqiten bëmat dhe punët e veta, të vërtetët do të ndahen nga të pavërtetët. Zoti, në praninë e shpirtit të Shenjtë dhe mehdiut Soashjant, do ta formojë gjykatën hyjnore dhe në bazë të drejtësisë hyjnore të mirën dhe të keqen do ta ndajë me zjarr. Ata që do të shkojnë në ferr do të dënohen tri ditë radhazi, kurse ata që do të shkojnë në parajsë do të shijojnë dënimin e atyre. Pas kësaj do të vijë një zjarr i madh që i përfsbin të gjithë, i cili besimtarëve do t'iu japë qumësht të ngrohtë, ndërsa jobesimtarëve xebe të shkrirë. Zjarri njeriut do t'ia djegë të gjitha mbeturinat e papastra. Më në fund të gjithë njerëzit do të hyjnë në parajsën e zotit Ahura-Mazda.

10. Gjendja e sotme


Në Iran dhe në Indi ka disa grupe fetare që mundohen të mbajnë gjallë zaratustrizmin. Ata që janë në Iran janë të paorganizuar dhe me numër shumë të vogël. Atyre atje u thuhet "gabritët". Kurse ata që janë në Indi janë më të organizuar dhe quhen "parsitët". Ata gjenden në Bombaj dhe në rajonet e tjera përreth tij, në qytetet Karnataka dhe Karaçi. Pas çlirimit të Iranit nga ana e muslimanëve, supozohet se ata që nuk kanë dashur të jetojnë nën udhëheqjen e islamit, janë shpërngulur atje. Ata merren me tepër me tregti dhe me zanate të ndryshme. Të vdekurit i vendosin në vendet e quajtura dahma ose "Kulla e qetësisë". Këto janë ndërtesa në formë cilindri me lartësi 12 këmbë. Në pullazet e tyre rradhiten trupa të njerëzve të zhveshur. Gjatë kohës trupat e tyre haben nga skifteri ose thaben. Eshtrat e zhveshur prej mishit, vendosen në katin përdhësë të kullës. Të huajve nuk u lejohet të hyjnë në varreza. Mosdjegia dhe i mosvarrimi i të vdekurve, sikur te komshinjtë e tyre, ishte me qëllim që të mos përlyhet dheu dhe zjarri. Vetëm se, ata të Iranit me ndikimin e komshinjtë të tyre, të vdekurit i varrosin. Mendohet se numri i tyre është 300.000.

FETË GNOSTIKE

Prof. Dr. Şinasi Gündüz
İstanbul Üniversitesi - İlahiyat Fakültesi
Stamboll, Turqi

Literatura: K. Rudolph, *Gnosis the Nature and History of an Antient Religion*, Edinburgh 1983; G. Quispel, *Gnostik Studies*, v. I-II, Stamboll 1974; G. Filoramo, *A History of Gnosticism*, Oxford 1990, f. 20-141; W. Foerster, *Gnosis*, I. Patristic Evidence, Oxford 1972; H. Jonas, *The Gnosis Religion*, Beacon Hill 1958.

Edhe pse është vështirë që gnosticizmi të definohet, përsëri mund të thuhet se është një rrymë fetare-filozofike e cila jep sqarime në lidhje me temat kryesore si Zoti, bota, njeriu, shpëtimi dhe dituria. Ai që nga shek. V dhe IV para e. s. shihet së është prezent në popuj të ndryshëm të Azisë së Mesme. Sado që disa shkencëtarë bashkëkohorë kanë botuar vepra me titull “fe gnostike”, gnosticizmi ende nuk është fe apo fraksion në vete. Ai është një rrymë, apo një tendencë, që është formuar si rezultat i ndikimit kulturor ose zhvillimit natyror brenda shumë traditave fetare. Ashtu sikurse ka shkolla, të cilat paraqesin mësimet dhe besimin gnostik që gjenden në hebraizëm dhe krishterim, ashtu ekzistojnë edhe tradita fetare si sabiizmi dhe maniheizmi, të cilat plotësisht posedojnë një karakter gnostik. Kështu që në mesin e mësimëve dhe besimit gnostik me gjenezë në Azinë e Mesme dhe traditës hinduse ka ngjashmëri dhe paralelizëm në tema të ndryshme me vlerë. Pa dyshim temat e burimeve dhe përfaqësuesve gnostikë përbëjnë nga një fushë të posaçme të studimit të gnosticizmin.



Kur të hulumtohet struktura e mendimit dhe besimit e popujve para islamit, të Sirisë, Mesopotamisë, Egjiptit, Palestinës, Jordanit dhe Anadollit, do të kuptohet se në të gjitha këto vende ka rryma të ndryshme gnostike. Nëse ka nevojë të jepen disa shembuj, maniheizmi, që është një fe që përfaqëson plotësisht mësimet dhe besimin gnostik, nga fundi i shek. III të erës sonë ka qenë mjaft i përhapur në Iranin jugor, Mesopotami, Siri, Anadoll dhe në Afrikën Veriore; në shek. e IV vjen në pozitë të kundërshtarit më të fortë të krishterimit dhe në shek VIII bëhet fe zyrtare e ujgurëve. Përsëri mund të përmendim sabiizmin, i cili që nga shekulli i II të e.s., si rrymë përfaqësuese fund e krye i gnosticizmit, ekzistencën e tij e ka vazhduar në Mesopotaminë Jugore dhe për rëndësinë që ka emri i tij është përmendur tri herë në Kur'an. Përveç kësaj në periudhën para islamit, shumë rryma të vogla, si elkesaitët, valentinianët, setianët, magaritët, kukitët, essenitët, bardaisanët dhe simonët, të cilat si fraksione heretike të krishterimit dhe hebraizmit, janë rryma, që u japin rëndësi mësimëve dhe besimit gnostik, që kanë qenë të përhapura në vende të ndryshme të Azisë së Mesme. Përveç kësaj, hermetistët, ihtarët e feve mistere, lëvizjet e ndryshme mistike të hebraizmit dhe krishterimit manifestojnë mënyrën e jetesës, mësimet dhe besimin gnostik. Thënë shkurt, besimi, mësimet dhe format e jetesës gnostike në histori zënë vend me emra dhe organizata të ndryshme, janë përbërë prej specifikave të përbashkëta të njerëzve të Azisë së Mesme. Gnosticizmi, para islamit, ka qenë në pozitën e një nënkulture në atë vend dhe formësonte ibadetet, besimet dhe tregimet e njerëzve që ishin pjesëtarë të një gube, feje ose bashkësie të ndryshme prej shumicës.

Burimet

Burimet e gnosticizmit ndahen në burime të dorës së parë dhe burime të dorës së dytë. Burimet e dorës së parë përbëhen prej shkrimeve apo përmbledhjeve të grupeve të ndryshme gnostike. Këto

burime përfshijnë dokumente të ndryshme të shkruara në gjuhën siriane, kopte, greke, ibrante, sabiute (mandene), ujgure dhe gjuhë të tjera. Në mesin e këtyre mund të numërojmë librat, shumica e të cilëve janë greqisht, *Corpus Hermeticum* nga burimet e Gnosticizmit Hermetik; veprat me gjuhën kopte me titull *Pistis Siphia* dhe *Codex Bruccianus*; në sirianishte mund të numërohen *Literatura Nag Hammadi* që përbëhet prej 52 librave, tekstet *Od-ët* e Solomonit dhe *Kënga fetare për margaritarin*. Sidomos, tekstet e ndryshme të kulturës hebraike si Tekstet e detit të Vdekur, Sfer Jesira dhe Mamer Merqa, literatura e shenjtë e sabiutëve dhe maniheistëve bëjnë pjesë në burimet e dorës së parë në lidhje me mësimet dhe besimin gnostik. Përveç kësaj mendimet gnostike i manifestojnë edhe Ungjilli i Gjonit dhe burime të ndryshme të tjera të cilat bëjnë pjesë në literaturën krishtere. Këto burime të dorës së parë datojnë që nga dy shekujt e parë para erës sonë e deri në shek. e VI dhe VII të erës sonë.

Konceptet themelore

Në bazë të mësimave dhe besimit gnostik janë tre elemente me rëndësi:

1-Besimi në një qenie të lartë që bazohet në konceptin e jetës dhe dritës.

2-Koncepti i dualizmit, që shpreh parime të kundërta.

3-Koncepti i demiurgut, i cili shpreh konceptin e Zotit krijues dhe gjendet jashta ekzistencës së lartë të cilës i besohet.

Kulti i jetës dhe dritës është një specifikë me rëndësi që bën pjesë në strukturën fetare të të gjitha rrymave gnostike. Në mesin e emrave të ekzistencës së lartë, prezenca e së cilës në fetë gnostike pranohet, gjenden emra me rëndësi si "Jeta", "Jeta e lartë", "Jeta e parë", "Shkëlqimi", "Drita", "Mbreti i dritës", "Drita e lartë". Sipas gnostikëve "Jeta" është rregull, burim i prodhimit dhe i qetësisë dhe mister i ekzistencës. Në të shumtën e rasteve bota hyjnore pëshkrubet me një tip të "Drurit të jetës". Në esencën e Drurit të Jetës gjendet Zoti i lartësuar, ekzistenca e të cilit nuk dihet dhe nuk mund të definohet plotësisht; ndërsa botërat dhe ekzistencat hyjnore, të cilat gjenden përreth Zotit të lartësuar dhe të cilat në një aspekt mendohen si gjethe dhe degë të Drurit të Jetës, janë manifestim dhe prezantim të kësaj ekzistence të lartë. Kështu që, Jeta, që përdoret si një emër i Zotit, sipas gnostikëve në të shumtën e rasteve vlerësohet si diçka që "nuk mund të njihet", "nuk mund të kuptohet" dhe "nuk mund të shprehet".

Në anën tjetër të mësimave gnostike gjendet një dualizëm i qartë, i cili besohet se ekziston mes vlerave si materie-mana, dritë-errësirë, shpirt-trup dhe botë-bota tjetër. Gnostikët në përgjithësi botën e ndajnë në botën e dritës dhe në botën e errësirës. Bota e dritës përfaqëson të mirën, të vërtetën dhe realitetin, ndërsa bota e errësirës dhe e dhunës përfaqëson të keqen, gënjeshtrën dhe jo të vërtetën. Në mesin e botës së dritës dhe botës së errësirës ka një luftë dhe një zënkë që nuk ka të përfunduar. Materia dhe çdo gjë materiale, bota në të cilën jetojmë, trupi ynë dhe çdo gjë që i takon kësaj bote i takon botës së të keqes, ajo vetvetiu është e keqe. Ndërsa shpirti dhe qeniet shpirtërore i takojnë botës së dritës dhe në esencë janë të mira. Në këtë luftë në mes botës të së mirës dhe botës të së keqes, apo në mes dritës dhe errësirës fitues do të jetë e mira, drita apo nuri. Në fund të jetës në përgjithësi errësira do të sundohet do të frenohet nga ana e dritës dhe materia apo çdo gjë materiale që është nën emrin e saj do të zhduket. Për njeriun, që është përfaqësuesi i jetës në përgjithësi, esenciale është që t'i japë rëndësi ekzistencës shpirtërore që i takon botës së të mirës dhe të mos i përulet trupit, dëshirave dhe aspiratave trupore dhe materies të cilat i takojnë të së keqes. Duhet që të braktisen bota dhe gjërat botërore të cilat janë të këqia në esencë dhe të këmbet kujdes për shpirtin dhe qartësimin e shpirtit të cila përfaqësojnë dritën dhe të mirën. Me këtë dualizëm gnosticizmi dallohet nga traditat e tjera dualiste. Për shembull, në zaratustrizëm dualizmi më tepër ka karakter etik. Ndërsa në dualizmin e gnostikëve që ne e quajmë dualizëm gnostik, përveç asaj që ka karakter etik, ka të bëjë me qëndrimin kundër botës materiale. Në dualizmin gnostik materia dhe çdo gjë që buron nga materia identifikohet me të keqen. Ky mendim, plan jetik i dualizmit gnostik nuk gjendet për shembull, në idhujtari.

Një specifikë tjetër me rëndësi që zë vend në bazën e mësimave dhe besimit gnostik është mendimi për demiurgun. Gnostikët, të cilët e identifikojnë materien dhe elementet materiale me të keqen dhe me errësirën, besojnë se ekzistenca e materies nuk buron nga zoti i lartësuar dhe se krijuesi i saj është një ekzistencë tjetër. Kësaj fuqie tjetër krijuese, që është diç tjetër nga zoti i lartësuar i thuhet demiurg. Demiurgu, emri i të cilit buron nga termi demiourgos (ai që punon për popull) në greqishte, është fuqia e cila ka krijuar gjithësinë dhe ekzistencën materiale të njeriut. Krabas mendimeve të ngjashme në lidhje me specifikat karakteristike themelore të demiurgut, mes traditave gnostike ka dallime në lidhje me aktivitetin, esencën dhe burimet e demiurgut.

Koncepti për njeriun

Koncepti për njeriun në sistemin gnostik është shumë interesant. Në mendimin gnostik, në lidhje me përbërjen e njeriut zë vend një triologji (trinitet). Sipas kësaj, njeriu përbëhet prej tre elementeve: shpirtit, trupit dhe unit-epshit. Shpirti, njëri prej elementeve përbërës të njeriut, rrënjësisht i takon botës së dritës. Ai, është një ekzistencë, një substancë e cila sipas caktimit hyjnor është bedhur apo ka rënë në tokë, e cila i takon botës së të keqes, dhe në trupin e njeriut, i cili është pjesë e të keqes. Ndërsa në anën tjetër, trupi dhe nefsi sipas përbërjes kanë natyrën e së keqes, prandaj janë edhe inferiore. Shpirti, në një fazë të luftës që vazhdon që në parakohë mes botës së dritës dhe botës së errësirës, nga ana e zotit të dritës, me qëllim që të mundë të keqen dhe errësirën dhe t'i marrë ata nën sundimin e vet, dërgohet nga bota e dritës në botën e errësirës, që d.t.th. se është zbritur në botën materiale dhe është vendosur në trupin e njeriut. Sipas gnostikëve, shpirti në trup është si një i burgosur. Kështu që, trupi i cili e rrethon njeriun rreth e përqark e ka burgosur atë që të mos i ikë nga dora dhe mundohet të bëjë çdo gjë me qëllim që drita e tij të mos reflektohet jashtë. Ndërsa shpirti nuk është aspak i kënaqur nga bedhja e tij në botën materiale dhe në trup. Ai është shumë i mërzhitur dhe me mish e me shpirt dëshiron që të ketë, të ngrihet në botën hyjnore, që është edhe vendi i tij i vërtetë. E keqja, e cila në luftën 'përbershmem-ambushme' me dritën dhe të mirën e ka burgosur shpirtin, që është një element i dritës, për të penguar ikjen e shpirtit e përdor trupin dhe nefsin, që është përfaqësues i çdo lloji dëshire dhe aspirate botërore. Shkurtimisht thënë, ikja e shpirtit nga kjo botë pengohet me anë të trupit dhe nefsit.

Doktrina e shpëtimit

Shpëtimi apo udhëzimi sipas konceptit gnostik realizohet me anë të ngritjes së shpirtit nga bota inferiore materiale, në të cilën ka rënë, në botën hyjnore. Sipas gnostikëve shpirti, i cili është një pjesë e botës hyjnore, është i pandekshëm. Vdekja vlen vetëm për ekzistencat materiale inferiore-ku është fjala për njeriun-dhe për trupin. Megjithatë, ndërsa për shpirtin si shprehje e dëshirave dhe aspiratave të trupit, ka mendime të ndryshme. Për shembull, sabiutët besojnë se me vdekjen, që për njeriun d.t.th. fundi i jetës së kësaj bote, dhe me shpirtin e njerëzve të mirë (gnostikëve), i cili është përmirësuar që në botë, ka fituar të drejtën që të ngrihet bashkë me shpirtin në botën hyjnore. Në anën tjetër besojnë se, shpirti i njerëzve të këqinj (jognostikëve) me vdekjen e trupit do të zhduket dhe për shkak se shpirtat e këtyre njerëzve nuk do të shpëtohen, do të jenë të dënuar që të kalojnë një jetë me mendime dhe me dhimbje.

Sipas gnosticizmit, shpëtimi dhe udhëzimi i shpirtit vetvetiu është i pamundshëm. Fazat e nevojshme për shpëtimin e trupit mund të renditen kështu:

1. Së pari të kuptohet struktura e vetë shpirtit në botën inferiore dhe të ndjehet dëshira dhe aspirata për shpëtimin e tij nga kjo jetë e keqe, me fjalë të tjera të njihet vetvetja dhe duhet që të ndjehet një përmallim ndaj botës hyjnore, që është vendi i vërtetë i tij.

2. Pas kësaj shpirti duhet që me baptizëm, agjërim, me lutje ditore dhe adhurimet e tjera të përgatit infrastrukturën e nevojshme për shpëtim.

3. Duhet të ketë një murshid, udhërefyes apo një shpëtimtar, që do t'ia sjellë dhe do t'ia mësojë atij urtësinë dhe diturinë e shenjtë, që është një lloj çelësi i shpëtimit.

4. Së fundi, duhet që dituria e shenjtë e fshehtë që njihet si një eliksir i shpëtimit dhe emërohet me emrat gnosis, *manda* dhe *sophia* atij i jepet me anë të udhëzuesit.

Koncepti i diturisë (gnosis)

Një çështje tjetër me rëndësi është edhe doktrina e urtësisë misterioze dhe dituria shpëtimtare e gnosticizmit, të cilat janë doktrina përbërëse të esencës së mësimin dhe besimit gnostik. Termi gnostik rrjedh prej termit gnosis në greqishte që ka kuptimin "dituri". Kjo dituri, të cilën shpirti, për të shpëtuar nga kjo botë inferiore, duhet ta posedojë, është një dituri e shenjtë dhe buron nga bota hyjnore, nga zoti i lartësuar i cili qëndron në mes të botës hyjnore. Burimi dhe gjeneza është bota e dritës hyjnore.

Kjo nuk është një dituri që fitohet, merret apo arrihet por, është një dituri e cila jepet, dhurohet dhe fallet nga Zoti. Kjo dituri as nuk mund të kuptohet, as nuk mund të shpjegohet e as nuk mund të shprehet me dhuntitë e botës sonë praktike të bazuara në organet shqisore dhe perceptimet tona. Vetëm se shpirti, kur të fitojë të drejtën me anë të plotësisimit të kushteve të nevojshme për të marrë këtë dituri apo për të fituar këtë shpëtim, atëherë kjo dituri i jepet dhuratë atij nga shpëtimtari i lartësuar. Për gnostikët, të cilëve iu është dhënë kjo dituri, është gabim i madh zbulimi dhe manifestimi jashtë i këtyre dukurive. Për shembull, sabiutët e vlerësojnë si pabesueshmëri zbulimin e themeleve të besimit dhe literaturës së shenjtë të tyre, atyre që nuk janë sabiutë. Së fundi edhe pse është vështirë që të gjendet një përgjigje e saktë në lidhje me të, se çfarë diturie është dhe e kujt është kjo dituri, por, aq sa kuptohet nga literatura gnostike kjo dituri është dituri e së vërtetës, e ekzistencës së lartësuar dhe e botës së dritës. Kjo dituri, e cila në burimet e ndryshme gnostike emërtohet me emrin *keusha*, d.t.th. “e vërteta”, është një dituri që mundëson të kuptuarit e të vërtetës dhe të njohurit e Zotit të lartësuar.

Sipas mendimit gnostik, shpirti nuk ka mundësi që këtë dituri ta njohë direkt, ose ta arrijë vetvetiu. Në këtë rast shpirti ndien nevojë për një ndriçues dhe shpëtimtar të obliguar me dërgimin e ditorisë mistere dhe të shenjtë, e cila ka lidhje me vërtetësinë e Zotit të lartësuar. Ky shpëtimtar është i obliguar që t’ua dërgojë ditorinë hyjnore shpëtimtarëve që janë të gatshëm të pranojnë dituri nga Zoti i lartësuar. Një cilësi ndikuese e shpëtimtarit është se ky para se të obligohet me shpëtim-mision në botën inferiore, me caktimin e Zotit e ka përjetuar të jetuarit në botën e të keqes ku ka kërkuar rrugën e shpëtimit dhe së fundi e ka përjetuar edhe të shpëtuarit nga bota inferiore duke e njohur ditorinë e shpëtimit. Ai, me një shprehje me vend, është shpëtimtar që e ka shpëtuar vetveten dhe udhëzues që e ka udhëzuar vetveten.

Koncepti për adhurimin

Sipas traditës gnostike, shpirti, për të kuptuar shpëtimtarin dhe udhëzuesin dhe për të marrë ditorinë hyjnore, që do ta udhëzojë atë, e ka të domosdoshme që në lidhje me këtë të përgatit themelet e nevojshme. Këto kushte janë që, shpirti të kuptojë pozicionin e tij, që d.t.th. ta njohë vetveten e tij, ta dëshirojë shpëtimin dhe t’i kryejë ritet dhe ibadetet të cilat tregojnë zgjedhjen e rrugës së shpëtimit. Krahas disa dallimeve që janë në mes grupeve gnostike në lidhje me ritet fetare që duhet të bëhen, qëllimi i përbashkët i të gjithë adhurimeve gnostike, është të mundësohet e pastrimit shpirtëror nga elementet e errësirës dhe të së keqes dhe të qëndruarit larg nga elementet botërore inferiore. Për këtë qëllim të gjitha grupet gnostike, qoftë pak apo shumë, butë apo ashpër, i lënë vend një asketizmi. Për shembull, në maniheizëm, në mesin e grupeve maniheiste më afër shpëtimit shihet grupi i të zgjedhurve, specifike karakteristike e të cilëve është të hanë pak, të flasin pak, të flejnë pak, të qëndrojnë larg çdo preokupimi dhe pune botërore, të mos martohen, përpiqen që tërë kohën ta kalojnë me dua, adhurim dhe me mësim fetare. Shprehja “*ti dalësh zot dorës, mjedisit dhe gjubës*”, është një shprehje e njohur që përbën themelin e të kuptuarit të etikës maniheiste. Në anën tjetër prej specifikave të përbashkëta të të gjitha grupeve gnostike, janë që të mos përzihen me popullin, të jenë të durueshëm ndaj dëshirave dhe aspiratave të ndryshme botërore dhe të qëndrojnë larg çdo të keqeje morale. Sipas traditës gnostike një jetë ideale kërkon largim të plotë nga bota inferiore. Për këtë edhe shumë shkolla gnostike i japin përparësi një jete që ka për bazë braktisjen e martesës dhe jetës familjare. Në anën tjetër, gati se në çdo grup gnostik larja e tërësishme e trupit, larja e pjesshme e trupit dhe pagëzimi (baptizimi) janë adhurime me rëndësi. Megjithatë gnostikët besojnë se lumenjtë Jordan, Tigër, Eufrat dhe Karun burojnë nga bota e dritës dhe përsëri atje derdhen; kështu që larjen në këto ujëra e pranojnë si zhdukje të papastërtive të botës së ulët materiale (inferiore). Përveç kësaj, vend me rëndësi zënë edhe të bërit lutje në orët e caktuara të ditës duke u kthyer nga veriu, që pranohet kahje ku gjendet bota hyjnore, të agjëruarit, të bërit ceremoni të ndryshme për përkujtimin e të vdekurve dhe shpirtëtarëve të baballarëve dhe forma të tjera të rregullta të adhurimit. Së fundi në shumë shoqëri gnostike shpesh haset në tradita siç janë: profecia e mbështetur në magji, falli, hajmalitë, llogaritë astrologjike.

1. Sabiizmi

Literatura: Şinasi Gündüz, *Son Gnostikler Sabiiler İnanç Esasları ve İbadetleri*, Ankara 1995; Şinasi Gündüz, 'Kur'an'daki Sabiilerin Kimliği üzerine Bir Tahlil ve Değerlendirme', *Türkiye 1. Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu*, Samsun 1992; Şinasi Gündüz, *The Knowledge of Life*, Oxford 1994; E.S. Drower, *The Mandaean of Iraq adn Iran*, Oxford 1937; K. Rudolph, *Die Mandaer*, v.2 Göttingen 1960-1961; K. Rudolph, *Thegonie, Kosmogonie und Antropogonie in den mandaischen Schriften*, Göttingen 1965; E.M. Yamauchi, *Mandaic Incantation Text*, New Haven 1967.

Sabiütët, që sot janë 20.000 mijë banorë, në përgjithësi jetojnë në Irakun Verior, në qendër të një vendbanimi të vogël, në vendin ku bashkohen Eufrati dhe Tigri. Në qytetet e mëdha si Basra dhe Bagdad mund të haset në sabiütë që merren me përpunimin e arit dhe argjendit. Përveç kësaj, një numër i vogël i sabiütëve jetojnë në qendrat e vendbanimeve përgjatë lumit Karun në Iran.

Sabiütët, të cilët edhe pse nga komshinjtë e tyre arabë, janë quajtur me emrin *sabii* (subbi ose subba), ata, qoftë në librat e tyre të shenjtë, qoftë mes tyre vetveten nuk e kanë emërtuar me atë emër. Ata vetveten e tyre e quajnë me emrin mandenë (të diturit, të mençurit) ose nasurajë (ata të cilët e mbrojnë doktrinën e shenjtë). Emri manden, përdoret për të gjithë anëtarët e grupit mes sabiütëve, kurse emri nasura më tepër përdoret për priftërinjtë dhe për prijësit e tjerë të komunitetit. Sidomos ata emrin Nasura e përdorin edhe për baballarët e tyre. Në anën tjetër termi "*sabii*", që rrjedh prej gjuhës mandene që është gjuhë e sabiütëve, ka kuptimin "ai që baptizohet". Atyre ky emër iu është dhënë nga komshinjtë e tyre për shkak të baptizimit të shpeshtë të tyre e që është një adhurim i sabiütëve që bie në sy më shumë.

a. Studimet për sabiütët

Temat se kush janë sabiütët, emri i të cilëve në Kur'an përmendet tri herë (Bakara, 62; Maide, 69; Haxh, 17), dhe se ku jetojnë ata, janë tema të cilat që në periudhat e mëhershme kanë ngjallur interesimin e dijetarëve muslimanë. Dijetarët muslimanë që kanë jetuar deri në gjysmën e parë të shekullit të IX të e.s., kanë bërë disa vlerësime për atë se sabiütët jetojnë në jug të Irakut dhe se kanë fe të tyre të caktuar. Edhe pse këto vlerësime të dijetarëve muslimanë, të periudhës së parë ishin shumë sipërfaqësore dhe të bazuara në pamje, në përgjithësi ishin të vërteta. Periudha e kalifit Me'mun, në aspektin e spekulacioneve dhe vlerësimeve që janë bërë deri tani në lidhje me atë se kush janë sabiütët, ishte një rikthim. Në këtë periudhë harranitët, të cilët deri në atë kohë nuk kishin asnjë farë lidhje me sabiütët, në rrethinën e tyre njiheshin me emrat si "adhurues të zjarrit" dhe "harranitë" dhe si vazhdues të politeizmit tradicional Asur-Babil (adhurimi i trupave qiellorë dhe i idhujve që i simbolizojnë ata), e morën emrin sabii. Shkaku i marrjes së këtij emri ishte shpëtimi prej kërcënimit me vdekje nga kalifi Me'mun. Kështu që Me'muni, strukturën e tyre idhujtareske e ka pranuar si pengesë që ata në shtetin islam të jetojnë me statutin *dhimmi* (me marrëveshje) dhe iu është kërcënuar atyre, që ata, o të pranojnë islam, o të hyjnë në njërin prej grupeve emri i të cilave përmendet në Kur'an. Idhujtarët e zjarrit të ngushtuar, në lidhje me besimin e tyre u mbështetën në emrin "sabii". Kështu që pas marrjes së emrit sabii nga ana e adhuruesve të Harranit, shumë dijetarë nga Harrani (i njohuri Sabit ibn Kura dhe Ibrahim ibn Hilal) nën emrin sabii u bënë të njohur në qendra si Bagdadi, kurse disa prej tyre besimin e tyre (nën emrin sabiütë) e mbrojtën me vështirësi. Ndërkaq sabiütët e vërtetë në këtë periudhë u harruan për shkak se si nevojë e fesë, besimin e tyre nuk e tregonin jashtë dhe në fushën e shkencës dhe letërsisë, nuk paraqitnin ndonjë gjurmë të ekzistencës së tyre. Kështu që nga kjo kohë dijetarët muslimanë në veprat e tyre përmendnin gjerë e gjerë politeizmin harranitë në emër të sabiizmit. Në anën tjetër, disa dijetarë muslimanë si el-Bagdadi, Biruni dhe Ibn Nedim, duke i ndarë sabiütët në "*sabiütët harranitë*" dhe "*sabiütët e mesëm*", tregojnë për sabiütët e mesëm si "*sabiütë të vërtetë*" ata që jetojnë në Irakun jugor. Sidomos këta shprehen qartë se, në fakt, harranitët nuk janë sabiütë, ndërsa emrin sabii e kanë marrë më vonë. Megjithatë ky konfuzion në lidhje me sabiütët, duke vazhduar edhe në periudhat e më vonshme, erdhi deri në kohën tonë. Në lidhje me këtë fe dhe komunitet, të cilat në aspektin e kulturës islame kanë një rëndësi të veçantë, nga muslimanët deri në kohën më të vonshme, për fat të

keq, nuk është bërë ndonjë punim i bazuar në burimet e dorës së parë.

Në anën tjetër perëndimorët, që në periudhat shumë më të hershme (shek. XVI) kanë patur lidhje me sabiitët. Studiues dhe misionarë të ndryshëm perëndimorë, me misionarët jezuitë në krye, që kanë treguar aktivitet në Iran dhe Irak, duke krijuar marrëdhënie me sabiitët të cilët i kanë quajtur me emrin “Të krishterët e Gjon Pagëzorit”, filluan që librat e tyre të shenjtja, t’i dërgojnë në shtetet e tyre dhe të japin njohuri për këtë fe. Më herët njohuritë të cilat nuk i tejkalonin vëzhgimet dhe shënimet e udhëtimeve, në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, u zëvendësuan me punime tejet serioze në lidhje me sabiitët. Gjersa e gjithë literatura sabiite u përkthye në gjuhë të ndryshme perëndimore dhe u shkruan vepra të shumta në lidhje me të. Prej studiuesve kryesorë modernë që kanë bërë punime me rëndësi në lidhje me sabiitët janë M. Lidzbarski, E.S. Drower, K. Rudolph dhe J.J. Buckley.

b. Historiku

Sado që sabiitët të pretendojnë se feja e tyre është “fe e parë” e cila fillon me Ademin, historia e sabiitëve fillon diku para dy mijë vjetëve. Sabiizmi, këta dy shekujt e fundit filloi të zhvillohet, të dalë në shesh, brenda rrymës heterodokse hebraike në vendin Palestinë-Jordan. Në këtë kohë kishte shumë grupe që ishin kundër konceptit zyrtar hebraik, i cili në Jerusalem përfaqësohej nga grupi kryesor i tyre. Essenitët, baptistët dhe nasurajtë që njiheshin si “*Grupe Kumran*”, ishin më kryesorët në mesin e tyre. Në aspektin e sabiitëve me rëndësi janë sidomos nasurajtë. Sepse sabiitët në librat e shenjtë të tyre nasurajtë i tregojnë si stërgjyshër të tyre në Palestinë dhe shpjegojnë luftën e tyre (nasuritëve) me hebrenjtë. Shkolla e nasuritëve, ishte njëri prej grupeve më me rëndësi që ishte kundër konceptit zyrtar hebraik. Për këtë shkak hebrenjtë, çdo lëvizje të re që dilte nga brendësia e tyre në atë kohë e fajësonin se janë prej nasuritëve. Ndërkaq edhe Isai/Jezusi me komunitetin e vet në fillim nga ana e tyre emëroheshin me emrin nasura.

Ka mundësi që edhe Jahja/Gjon Pagëzori, që nga sabiitët emërtohej me thënien “prijësi i madh” dhe “një profet i dritës”, të ishte në marrëdhënie me grupin e nasurajve. Jahja, bashkëkohanik i Isait, ka lindur si anëtar i shoqërisë hebraike. Por më vonë, si peygamber, ka dalë kundër hebraizmit dhe jashtë Jerusalemit e formon xhematin e vet. Isai para peygamberllëkut të tij kohë mbas kohe, vinte të dëgjojë ligjëratat e Jahjasë, që ishte më i vjetër se ai (Isai) me moshë; bile me dorën e Jahjasë është pagëzuar. Veprimtaria e Jahjasë e kishte brengosur organizatën zyrtare hebraike. Kështu që ata e nxitën prefektin e Romës Herodos Antipasin kundër Jahjasë dhe në fund Jahjai u burgos. Pas mundimeve dhe torturave Jahjai ekzekutohet duke iu prerë koka, ndërsa ithtarët e tij u ndoqën dhe u masakruan. Sabiitët këtij masakrimi i japin vend të posaçëm në librat e tyre. Hebrenjtë, sipas shprehjes së Ginzasë, kanë vrarë mijëra nasurajë (paraardhësit e sabiitëve), me në krye 365 njerëz të parësisë. Ata që shpëtuan nga masakra, kanë ikur drejt Mesopotamisë veriore nën mbrojtjen e mbretit të atëhershëm Arsakid. Në librat e shenjtë të sabiitëve theksohet se numri i tyre ka qenë rreth 60.000. Pas një kohe nasurajtë shpërngulen prej andej dhe vendosen në jug të Mesopotamisë. Sabiitët deri në gjysmën e parë të shek. III pas e.s., kur adhurimi i zjarrit në Iran pranohet si fe zyrtare, në këto vende e jetuan periudhën e tyre më të artë. Në shek. VII me çlirimin e Irakut nga ana e muslimanëve, edhe sabiitët si çdo popull tjetër u futën nën mbrojtjen islame me statusin *dhimmi*.

Sabiitët gjatë këtij procesi historik jetuan në mirëkuptim me popuj të ndryshëm që ishin anëtarë të besimeve dhe kulturave të ndryshme. Natyrisht brenda kohës nga këto tradita janë ndikuar në fusha të ndryshme. Krahas kulturës së tyre origjinale hebraike ata adoptuan elemente edhe nga fetë e Iranit (disa ceremoni me të vdekurit, rite në të ngrënurit dhe koncepcione të ndryshme në lidhje me yjet), nga feja babilonase-asiriane (formulat e magjisë dhe fallit etj.) dhe nga krishterimi (si shenjtërimi i ditës së diel). Gjatë kësaj kohe, për shkak të masakrimit dhe përndjekjes zhvilluan shumë polemika kundër hebrenjve dhe u larguan shumë nga hebraizmi.

c. Librat e shenjtë

Librat e shenjtë të sabiitëve, të cilët posedojnë një literaturë fetare tejet të pasur, ndahen në dy grupe: tekste të shkruara dhe tekste mistere.

Tekstet e shkruara ndahen në grupe të ndryshme si librat themelorë, tekste me specifike ezoterike (të fshehtë), letërsi, sqarime dhe komentime, tekste astrologjike dhe shkrime për magji dhe fall. Në mesin e librave të shenjtë të sabiutëve vend më të rëndësishëm zënë librat *Ginza*, *Drashia d Jahja* dhe *Kolasta*. *Ginza* që ndahet në dy grupe (*Ginza e Djathtë* dhe *Ginza e Majtë*) ka kuptimin “depo”, përafërsisht përmban 600 faqe. Ky libër i shenjtë, që quhet edhe “Libri i Adamit”, përmban dua të ndryshme, teologji, mitologji, tema për vdekjen dhe për jetën pas vdekjes dhe të ngjashme. *Drashia d Jahja* (Mësimet e Jahjasë) është një libër, siç kuptohet edhe nga vetë emri, që përmban jetën dhe mësimet e Jahjasë. Ndërsa *Kolasta* (koleksion ose falenderim) është një libër i adhurimeve ditore që përmban pagëzimin, ritet e ushqimit, lutje dhe praktika në lidhje me adhurime të ngjashme. Vetëm se nga librat ezoterikë, të cilat priftërinjëve dhe kandidatëve për priftërinj iu lejohet t’i përdorin, sa për ilustrim mund të përmendim *Alt Trisar Shualia* (Një mijë e dymbëdhjetë pyetje), *Alma Rishaia Rba* (Bota e Madhe e Parë) dhe *Alma Rishaia Zuta* (Bota e vogël e parë). Këto vepra në të shumtën e rasteve diskutojnë tema teologjike dhe koncepte të ndryshme mitologjike. Letërsia, sqarimet dhe komentimet janë libra të cilat merren në mënyrë të pavarur me tema të ndryshme. Tekstet astrologjike janë tekste të cilët japin njohuri për profecinë, për eksorsizëm (përzënie e xhinnëve dhe shpirtërave të këqinj) gjithashtu japin edhe njohuri për komentimin e ngjarjeve duke bërë llogari të ndryshme astrologjike në lidhje me emrin e njeriut, ditën, orën dhe kohën e lindjes, vdekjes, vitit të ri dhe martesës. Nga këta më i rëndësishëm është libri *Sfar Malvashia* (Libri i horoskopit).

Ndërsa tekstet mistere të sabiutëve janë tekste magjike dhe nuska të shkurtëra të shkruara në papiruse, metale apo në gjëra si enë të baltës së pjekur, të shkruara këto kundër sëmundjeve të ndryshme, fallit të zi, magjisë, belave, fatkeqësive dhe të këqiave të ngjashme.

Sabiutët besojnë se librat e shenjtë-sidomos librat themelorë dhe tekstet të cilat lejohen t’i lexojnë vetëm priftërinjtë, tekstet e vështira për t’u kuptuar janë shpallur njeriut të parë, Adamit, nga ana e Zotit të lartësuar gjatë krijimit. Studimet që janë bërë në lidhje me literaturën sabiute tregojnë se një pjesë e tyre është përmbledhje e përgatitur në shek. II dhe III të e.s.

Gjuha në të cilën janë të shkruara tekstet e shenjta sabiute është gjuha mandene, që është dialekt lindor i gjuhës arameje. Sabiutët të cilët në jetën e përditshme flasin arabisht, këtë gjuhë (mandene) duke mos e kuptuar e përdorin vetëm si gjuhë adhurimi. Shkrimi dhe leximi i këtyre teksteve u takon vetëm klerikëve.

ç. Koncepti për Zotin

Në themelin e konceptit për zotin te sabiutët ekziston një dualizëm gnostik. Sipas këtij dualizmi në njërin anë gjendet bota e dritës dhe e shkëlqimit, ndërsa në anën tjetër bota e errësirës. Në krye të botës së dritës gjendet *Malka d Nhura* (Mbreti i Dritës), të cilit i jepen edhe emra të tjerë si “Jeta e lartë”, “Shpirti i fuqishëm”, “Zotëri i lartësisë”. *Malka d Nhura* është një ekzistencë e lartësuar, e furnizuar me cilësitë më të larta dhe e pastër nga të gjithë të metat. Atë shumë bukur e definon kjo shprehje në *Ginza*:

“Falenderimi të takon ty! ... (ti je) Zoti i të Vërtetës i pa fund dhe me fuqi të manifestuar, Dritë e Lartë dhe Nur i pastër që nuk ka të mbaruar; i mëshirshëm, falës, mëshirëbërës dhe dashamirës (ekzistencë e lartësuar); shpëtimtar i besimtarëve, pronar i gjithë të mirës, i fuqishëm, i mençur, njohës (i çdo gjëje), ai që sheh, posedues i urtësisë dhe i fuqishëm për çdo gjë; pronar i të gjitha botërave, botës së epërme dhe të mesme të dritës, fytira e lartë e dinjitetit, ekzistencë e pafund dhe e pavdekshme pa ortak në sundim dhe pa shok që mund ndajë fronin me të.”

Në botën e dritës rreth e përçark zotit të lartësuar Malka d Nhura gjenden ekzistenca të panumërta prej drite. Detyra e këtyre ekzistencave që quben Uthria (të pasurit) dhe Malkia (mbretër), është që ta shenjtërojnë dhe ta lartësojnë Malka d Nhura-në. Bota e dritës dhe ekzistencat e kësaj bote janë plotësisht të pastërta nga e keqja. Kjo botë gjithashtu është edhe larg cilësive si skamja, e meta, zhdukja dhe gabimi. Në librat e shenjtë sabiute thuhet se bota e Dritës, për të cilën besohet se gjendet në veri, përbëhet prej parimeve të Jetës (Hüa) që simbolizojnë rregullsinë, ekzistencën dhe prodhimtarinë. Kështu që e tërë teologjia sabiute, prej fillimit e deri në fund, gjendet nën parimin i Jetës.

Në anën tjetër, edhe krabu tjetër përbërës i dualizmit, bota e errësirës, si bota e dritës, posedon të njëjtën përbërje. Bota e errësirës, për kundër përbërjes së botës së dritës nga parimi i Jetës, përbëhet prej një kaosi apo Uji të zj që simbolizon skamjen, të metën, parregullsinë. Në krye të kësaj bote, që gjendet në jug, qëndron Ur ose Malka d Hshuka (Mbreti i Errësirës) i cili quhet edhe “bishë e madhe”. Malka d Hshuka vlerësohet edhe si përhapës dhe krijues i krijesave të këqia të panumërta në botën e errësirës. Kjo ekzistencë, e cila posedon fuqi dhe cilësi të shumta mbinatyrore, i

posedon të gjitha cilësitë e të keqes dhe të errësirës. Në *Ginza* është e shënuar se *kejo ka një pamje të frikshme me kokë luani, trup kuçedre, krabë shqijonje, shpinë breshke, trashësia e buzëve të saj janë afërsisht 800.000 km. Gjithashtu theksobet se fryma e saj e shkrinë hekurin dhe me një shikim të saj dridhen malet. Krabas kësaj, për shkak se ajo zë vend karshi Mbretit të Dritës, theksobet se ajo është një e marrë dhe u butuar.*

Përreth *Malka d Hshuka*-së gjenden krijesa të këqija, të egra, djaj, shpirtëra të këqinj, bisha dhe krijesa të tjera të ngjashme. Përveç këtyre ekzistencave në botën e errësirës ka ekzistenca të dritës që kanë rënë poshtë (nga bota e dritës). Këto janë ekzistenca, që në bashkëpunim me ekzistencat e këqija apo si manifestim i caktimit hyjnor, janë hedhur në botën e errësirës. Në krye të këtyre qëndron një figurë femërore me emrin *Ruha*. *Ruha* është një ekzistencë që vlerësohet si nxitëse e *Malka d Hshuka*-së që t'i lëvizë ekzistencat e këqija në mitologjinë e krijimit, sidomos në mitologjinë e krijimit të njeriut dhe botës. Po ashtu në mesin e ekzistencave që janë hedhur në botën e errësirës janë edhe figurat si *Jushamin*, *Abatur* dhe *Ptahil* (bota materiale dhe krijuesi i njeriut), të cilat janë ekzistenca ndërmjetësuese mes botës së dritës dhe botës së errësirës.

Sipas teologjisë sabiute *Malka d Nhura* edhe *Malka d Hshuka* janë të përhershme pa fillim. Në fund të botës çdo ekzistencë do të zhduket, vetëm se zoti i errësirës me parimin e errësirës dhe kaosit *Malka d Hshuka* do të mbetet e përhershme. Megjithatë këto nga *Malka d Nhura* do të mbyllën në botën e tyre.

d. Koncepti për gjithësinë

Konceptet sabiute për krijimin e gjithësisë dhe tokës janë krejtësisht mitologjike. Qoftë krijimi i gjithësisë dhe tokës, qoftë krijimi i njeriut, shihen si manifestim i caktimit hyjnor në lidhje me luftën e pashmangshme mes të mirës dhe të keqes apo mes dritës dhe errësirës. Në periudhën para krijimit të universit bota e errësirës dhe bota e dritës kanë qenë plotësisht të ndara. Bota e errësirës, si nevojë strukturale në gjendje kaosi dhe parregullsie, është krijuar nga Uji i zi; për shkak të mosbartjes të asnjë elementi të jetës dhe të prodhimit nuk mund të krijojë asgjë të rregullt. Kështu që mbreti i errësirës thur plane për zënien dhe burgosjen e ekzistencave të botës së dritës. Ndërsa mbreti i dritës, duke e ditur situatën, bën përgatitje të ndryshme kundër saj. Ndërkaq, të dërguarin e dritës *Manda d Hiia*-në e çon në botën e errësirës me një detyrë speciale dhe në mënyrë të fshehtë. *Manda d Hiia* me armët e tij të shenjta e robëron Mbretin e Errësirës dhe e lidhë me zinxhir. Vetëm se më vonë, disa ekzistenca të dritës që jetojnë në botën e dritës, duke dashur që të shohin ekzistencat dhe botërat jashtë tyre, i hapin perdet mes botës së dritës dhe botës së errësirës dhe shikojnë në Ujin e zi (botën e errësirës). Pra, kjo dëshirë e tyre është edhe fillimi i rënies apo i largimit nga bota e dritës. Dhe nëse çdo njëra nga ekzistencat e hedhura nga bota e dritës më vonë e kupton gabimin e bërë dhe dëshiron që përsëri të kthehet në botën e dritës, kjo dëshirë e tyre sipas caktimit hyjnor nuk pranohet. Vetëm se kur do t'i jepet fund jetës materiale, këto do të pastrohen nga gabimet dhe do të pranohen përsëri në botën e dritës.

Në aspektin e krijimit të universit me shumë rëndësi është sidomos rënia e *Jushamin*, *Abaturit* dhe *Ptahilit*. Këto tre ekzistenca që njihen edhe me emrat *Jeta e Dytë*, *Jeta e Tretë* dhe *Jeta e Katërt*, kanë për detyrë nga një aspekt ndërmjetësimin dhe kontaktin mes botës së dritës dhe botës së errësirës. Këto tre ekzistenca, në një aspekt tjetër, në lidhje me krijimin përbëjnë tre fazat e rënies në botën e errësirës. Me fjalë të tjera, për *Jushaminin* dhe *Abaturin* rënia në botën e errësirës nuk realizohet plotësisht; por rënia e *Ptahilit* është plotësuar. Edhe pse *Jushamin* dhe *Abatur* dëshirojnë që të formojnë një botë të tyre brenda kufijve të botës së errësirës në të cilën ata kanë rënë, nuk mund të jenë të suksesshëm. Kështu që *Abatur*, duke e hapur perden e botës së tij shikon në Ujin e zi dhe në atë moment në Ujin e zi i reflektohet fotografia e vet. Nga ky reflektim krijohet *Ptahili*, që njihet me emrin *Jeta e Katërt*. *Ptahili* me grimcat e dritës që gjenden në të, mundohet të krijojë një botë për vete në Ujin e Zi; vetëm se në këtë nuk mund të korrë sukses. *Ruha*, i cili më herët është hedhur në botën e errësirës dhe është vëzhgues i punimeve të *Ptahilit*, bashkëpunon me bishën e madhe mbretin e errësirës *Urin*, ia zgjidh zinxhirët e tij dhe të dy së bashku, duke u paraqitur si të *Ptahilit*, e nxisin atë në krijimin e botës materiale. Qëllimi i tij, në fakt, është që më vonë të sundojë botën që do të krijojë *Ptahili*. *Ptahili*, që në synimin e parë të tij ishte i pasuksesshëm, iu lut Mbretit të Dritës që t'i ndihmojë. Në këto raste për realizimin e planeve në të ardhmen bashkohen figura femërore *Ruha* dhe mbreti i errësirës dhe nga kjo krijohen 7 planete dhe 12 yje si krijesa të këqija. Nga lutjet e *Ptahilit* mbreti i dritës ia jep atij dritën e jetës dhe *Ptahili* me atë krijon botën në ujërat e zinj. Anët materiale të kësaj bote krijohen nga Uji i zi, ndërsa anët që kanë jetë dhe fryte krijohen nga Dritat e jetës. Me plotësimin e këtij krijimi, forcat e kë-

qija, për të mos ikur drita e jetës (krijesa e dritës) e bashkuar me ujin e zi, përreth kësaj bote i vendosin fëmijët e tyre, 7 planetet dhe 12 yjet. Kështu që bota e Ptahilit merret plotësisht nën kontroll. Fuqitë e këqija nuk mjaftojnë me kaq, por Ptahilin e mashtrojnë dhe ia marrin botën dhe e mbushin atë me demonë, egërsira dhe djaj të shumtë.

Sikurse shihet fuqi krijuese në krijimin e botës nuk është Zoti i lartësuar i Dritës, por është Ptahili, demiurgu një qenie e dritës së rënë. Në literaturën sabiute në lidhje me krijimin e botës rallë herë rastiset edhe në pikëpamje moniste (në atë formë që krijuesi i botës është Zoti i lartësuar). Vetëm se është më se e mundshme që këto sabiizmit i janë adaptuar më vonë.

dh. Koncepti për njeriun

Koncepti i sabiutëve për krijimin dhe strukturën e njeriut është i njëjtë me mitologjinë e krijimit të botës dhe të universit. Ptahili demiurg, i cili e ka vëzhguar marrjen e botës, që ka krijuar vetë nga forcat e këqija, dhe për mbushjen e saj dëshiron që në botë të krijohet një qenie që do ta zëvendësojë atë dhe kështu planifikon që të krijohet njeriun. Vetëm se, përsëri fuqitë e këqija e mashtrojnë dhe për këtë çështje bashkëpunojnë me të. Kështu trupi, i cili përbën pjesën materiale të njeriut, krijohet nga ana e Ptahilit. Por ky krijim përfundon pa sukses; sepse krijesës së sajuar i mungon elementi për jetë, gjegjësisht është pa shpirt. Për t'i dbënë jetë asaj, fuqitë e këqija provojnë rrugë të ndryshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të jenë të suksesshme. Në fund Ptahili i lutet Zotit të lartësuar të Dritës dhe kërkon që ai t'i ndihmojë. Si përgjigje ndaj këtij zëri, Mbreti i Dritës, shpirtin e njeriut e zhbret prej botës së dritës në tokë dhe nëpërmjet të deleguarit të dritës (Manda d Hiia) atë e vendos në trupin e pashpirt. Pas kësaj njeriu (Adami) çohet në këmbë dhe fillon të flasë.

Adami, sipas besimit sabiut, ishte një njeri besimtar. Sepse Zoti i lartësuar njeriun nuk e ka lënë në duart e krijesave të këqija; nga momenti i vënies së shpirtit në trup, për edukimin e tij ka dërguar Manda d Hiianë, ndërsa bashkë me Manda d Hiianë për të mbrojtur atë ka dërguar edhe tre mbojtës hyjnorë (Hibil, Shitil dhe Anush). Kështu që njeriu i parë, njohës i rrugës hyjnore, u bë një krijesë që e respekton mbretin e lartësuar të Dritës. Që Adami të mos mbetet i vetëm në këtë botë është krijuar edhe Eva. Gjithashtu, në literaturën sabiute, në lidhje me krijimin dhe strukturën e Evasë kohë mbas kobe rastiset në pikëpamje të ndryshme. Për shkak të strukturës inferiore të botës, ka mendime edhe për ndarjen e Adamit dhe Evasë. Nga martesja e Adamit dhe Evasë kanë lindur tre djem dhe tri vajza dhe nëpërmjet tyre bota është shtuar.

Siç shihet, sipas sabiutëve njeriu përbëhet prej dy elementeve të ndryshme, materies dhe shpirtit. Trupi, për shkak të përbërjes materiale përfaqëson të keqen dhe errësirën, ndërsa shpirti, përfaqëson të mirën dhe dritën. Trupi si krijesë i takon kësaj bote inferiore; ndërsa shpirti i determinuar që nga drita hyjnore të zhbret në botën inferiore dhe të vendoset në trup.

e. Koncepti për shpëtimin

Sipas mendimit sabiut, shpirti që është vendosur në trupin inferior (e ulët), nuk është i kënaqur aspak nga kjo gjendje e tij. Ai është duke u përpjekur për të shpëtuar nga kjo botë inferiore dhe për t'u ngritur përsëri në botën e dritës, që është vendi i tij. Ndërsa në anën tjetër forcat e këqija dhe të errësirës, për të mos e humbur këtë ekzistencë të dritës kanë bërë përgatitje dhe i kanë rrethuar ata rreth e për qark. Ato mundohen që shpirtin, në një anë me pasuri dhe dhunti të ndryshme botërore, e në anën tjetër me ambicie, epsh, urrejtje dhe me shumë dëshira dhe aspirata tjera epshore, ta lidhin me këtë botë. Në këtë mënyrë shpirti në trup jeton i burgosur.

Shpëtimi, sipas sabiutëve vlen vetëm për shpirtin; sepse trupi i takon kësaj bote inferiore. Ndërsa shpëtimi i shpirtit varet prej shpëtimit nga bota dhe burgu trupor. Shpirti për shpëtimin e tij duhet t'i kryejë gjërat e nevojshme, pra, duhet të lidhet me besimin e vërtetë dhe me adhurimin. Madje kjo nuk është e mjaftueshme për shpëtim. Sepse sipas mendimit sabiut rruga e vetme e shpëtimit është posedimi i diturisë shpëtimtare (kësaj i thuhet manda ose "urtësi" ose "dituri e shenjtë"). Ndërsa kjo dituri nuk është dituri që fitohet, arrihet, por ajo jepet, dhurohet. Për të poseduar këtë dituri shpëtimtare njeriu duhet që të përgatisë kushtet e përshtatshme për të. E kjo është e mundur me besim të vërtetë dhe me adhurim. Një shpirti, që ndjek besimin e vërtetë dhe adhurimin, dituria shpëtimtare atij i dërgohet nga shpëtimtari hyjnor (*redeemer*). Shpirti që e posedon këtë dituri duke u pastruar plotësisht nga kjo botë inferiore lartësohet në botën e dritës hyjnore, te Mbreti i lartësuar i Dritës. Në këtë mënyrë realizohet shpëtimi.

Sabiütët besojnë se shembulli i parë i shpëtimit është realizuar në personalitetin e njeriut të parë, Ademit. Ademi pas krijimit, ka qëndruar larg ekzistencave të këqia dhe duke iu drejtuar Mbretit të lartësuar të Dritës i është lutur për shpëtim. Si përgjigje, për këtë, atij nëpërmjet Manda d Hiia-së i është dërguar dituria shpëtimtare, kështu që shpirti i Ademit është ngritur në botën e dritës. Ky model i shpëtimit që është realizuar në personalitetin e Ademit, është një shembull për të gjithë sabiütët.

ë. Koncepti për eskatologjinë dhe mesianizmi

Sabiütët jetën e kësaj bote, nga krijimi i njeriut të parë e deri në kijamet, e llogaritin të jetë 480.000 vjet. Kjo kohë ndahet në 4 periudha. Periudha e parë fillon nga krijimi i Ademit dhe zgjat 216.000 vjet. Në fund të kësaj periudhe njerëzimi është zhdukur, përveç një çifti që ka shpëtuar, me shpatë dhe me sëmundje. Në fund të periudhës së dytë që zgjat 156.000 vjet, njerëzit janë zhdukur me zjarr, dhe përsëri ka shpëtuar vetëm një çift. Ndërsa në periudhën e tretë, e cila ka zgjatur plotë 100.000 vjet, njerëzit janë zhdukur me ujë (tufan) dhe nga kjo situatë me anije kanë shpëtuar vetëm Nuhi me familjen e tij. Ndërsa periudha në të cilën jemi duke jetuar, që ka filluar me tufanin e fundit dhe do të vazhdojë deri në shkatërrim, do të zgjat 8000 vjetë.

Sipas sabiütëve 2000 vjetët e fundit të periudhës së katërt, që d.t.th. se koha që fillon me themelimin e Jerusalemit 6000 vjet pas Nubit dhe që do të vazhdojë deri në fund të kësaj bote përfaqëson kohën e fundit. Koha e fundit është një periudhë ku më tepër do të shtohet e keqja, dhuna, fitneja dhe luftërat. Në këtë kohë shtohet edhe përndjekja dhe tirania ndaj sabiütëve. Sidomos, në këtë periudhë, do të prishet dhe shaktërrohet barazpesha natyrore; do të përhapet varfëria, thatësia, fatkeqësitë natyrore dhe toka do të shndërrohet në shkretëtirë. Në këtë periudhë shumë gjëra do të bëhen në formë të kundërt (do të bëhen zotërinjtë shërbëtorë e shërbëtorët zotërinj). Përveç kësaj njerëzit do të torturohen nga sëmundje ngjitëse dhe belatë e ndryshme. Në fund të kësaj periudhe, do të shihen shenja të shumta që do të tregojnë për afrimin e fundit të botës. Më kryesoret nga këto janë rënia e një ylli në oqean, derdhja e ujit të kuq në shtatë detëra dhe shterpësia e atyre që do të pinë nga ai ujë dhe së fundi dalja e një furtune të madhe. Pas këtyre shenjave në shesh del trimi i kohës së fundit ose Mesia Prashai Siva ("luftëtari i fundit" ose "mbreti i fundit") dhe e sundon botën. Në periudhën e Mesias çdo të keqeje morale i jepet fund; zhduken luftërat, fjetet dhe dhuna. Po ashtu edhe rregulli natyror ndikohet pozitivisht nga kjo periudhë e lumturisë. Ashtu që dimër nuk bëhet aspak. Periudha e Mesias Prasha Siva bëhet një periudhë e artë. Sundimi i Mesias do të vazhdojë deri në fund të botës.

f. Koncepti për apokalipsin dhe botën e ardhshme

Sabiütët besojnë se në fund të jetës së kësaj bote do të bëhet një shkatërrim i përgjithshëm. Sipas kësaj, në fund të jetës së kësaj bote, së pari me helmimin e ajrit të gjitha gjallesat do të zhduken; pastaj do të zhduken vetë toka dhe të gjitha planetet dhe yjet që e rrethojnë tokën. Pas kijametit për shpirtërat do të bëhet një llogari e përgjithshme, vetëm se kjo llogari do të bëhet vetëm për shpirtërat mëkatarë. Ndërkaq me vdekjen e njerëzve shpirti, duke i kaluar me rradhë 7 planetet, të cilat e rrethojnë botën dhe në një mënyrë kryejnë detyrën e shtëpive vëzhguese, arrin në peshoren e Abaturit dhe prej atje lartësohet drejt botës së dritës. Nëse njeriu që vdes është ndonjë besimtar, shpirti i tij shtëpitë vëzhguese i kalon me shpejtësi rrufeje dhe arrin në parajs (Mshunai Kushta), në botën e dritës. Vetëm se nëse njeriu që vdes është ndonjë mëkatar ose jobesimtar, shpirti i tij mbetet në këto shtëpi dhe i nënshtrohet torturës. Kështu që në llogarinë gjenerale shpirtërat mëkatarë të shpëtuar nga toka me kijametin dhe shpirtërat, të cilët edhe pse janë ndarë nga bota më herët për shkak të mëkateve, që dënohen dhe torturohen në shtëpitë e vëzhgimit, do të maten në peshoren e Abaturit dhe do të gjykoohen dhe për t'u pastruar nga mëkatet do të flaken në detin Suf, që është një lloj ferri. Me larjen e mëkateve këto shpirtëra përsëri do të merren në botën e dritës. Sipas besimit sabiüt shpirtërat e atyre të cilët nuk janë sabiüt, për shkak të mëkateve të shumta do të mbeten përgjithmonë në detin Suf.

Gjithashtu sabiütët besojnë se, gjatë kijametit zoti i të keqes Malka d Hshuka do të zibet dhe përgjithmonë do të burgoset në guackën e tij. Kështu që ekzistencat e rëna të dritës si Jushamini, Abaturit dhe Ptabili përsëri do të pranohen në botën e dritës.

g. Adhurimet themelore

Jeta e sabiutëve është komplet nën disiplinën e rregullave fetare. Ata besojnë se adhurimet njeriun e çojnë drejt një atmosfere të nevojshme për shpëtim dhe për këtë arsye praktikimit të ibadeteve i kushtojnë shumë rëndësi. Në mesin e adhurimeve të sabiutëve më i rëndësishëm është baptizimi (pagëzimi). Ekzistojnë tre lloje baptizimi: masbuta, tamasha dhe rishama. Masbuta, që është baptizim i plotë, është një lloj abdesti i madh që bëhet me zhytje në një ujë të rrjedhshëm nën kontrollin e priftit. Çdo sabi i ka të domosdoshme që këtë baptizim ta kryejë të paktën një herë në javë, ditën e Diel. Ndërsa tamasha është një larje trupore që pas mëkatit sabi i pa prezencën e murgut, duke mos ndier nevojë për të, e kryen atë vetë duke u zhytur dhe dalë tri herë nga lumi. Ndërsa lloji i tretë i baptizimit, rishama, është një larje që i ngjan abdestit normal në islam. Është e patjetërsueshme që baptizimi të bëhet në një ujë që rrjedh ose në kanalet e formuara nga ujërat rrjedhës. Sabiutët ujërat rrjedhës i shohin si diçka që i takon botës së dritës dhe ata i quajnë “uji i jetës”. Në anën tjetër, ujërat që nuk rrjedhin, nuk ju shkojnë fort për qejfi. Ata që nuk baptizohen të paktën një herë në javë, baptizohen në raste të tjera si në ditët dhe festat fetare, në martesë, në lindje, me rastin e prekjes së të vdekurit, në një sëmundje serioze dhe me rastin e kthimit nga ndonjë udhëtim, si dhe pas veprave që llogariten mëkate si zënka, gënjimi, sharja etj.

Në mes të adhurimeve sabiute vend me rëndësi zënë edhe ushqimet ceremoniale. Nga këto ceremoni më e rëndësishmeja është ceremonia masiqta. Kjo ceremoni bëhet me qëllim që shpirti i të vdekurit shtëpitë kontrolluese t'i kalojë me shpejtësi dhe të arrijë në botën e dritës. Në kontrollin e murgut përgatiten ushqime speciale të ndryshme që hahen me shoqërimin e baptizimit, lutjeve dhe ceremonive të tjera të ngjashme. Përveç se më raste të vdekjes ushqime ceremoniale përgatiten edhe për përkujtimin e shpirtërave të paraardhësve, për ceremoninë e shpalljes së ndonjërit prift dhe për pastrimin e tempullit.

Sabiutët nuk kanë ndonjë ibadet-namaz me ruku dhe sexhde. Vetëm se kanë ceremoninë e lutjes ditore, e cila bëhet duke u kthyer drejt veriut. Sabiutët në orë të caktuara të ditës (Sipas Ginzasë tre herë gjatë ditës e dy herë gjatë natës) i luten mbretit të lartësuar të Dritës.

Sabiutët në fazën përgatitore për përgatitjen e ushqimeve ceremoniale, therin dash dhe pëllumb për kurban. Këta kurbanë edhe pse janë forma të tjera të ibadetit, janë pjesë e ceremonisë (së riteve) ushqimore. Kafsha kurban mund të theret vetëm nga ndonjë murg. Murgu gjatë therjes së kurbanit kthehet drejt veriut dhe në dorë mban një shkop të vogël. Pas therjes këtë shkop murgu e hedh në lumin që e quajnë uji i jetës.

Në sabiuzëm nuk ka agjërim në formë që të mos hanë dhe të mos pinë. Në vend të kësaj sabiutët thirren që të agjërojnë duke i mbajtur larg të keqes organet si dorën, gjuhën, zemrën, veshin dhe organet e tjera.

Sabiutët ditë dhe orë të ndryshme të vitit i quajnë si të pafat (mbattal) dhe në atë kohë mundohen që të mos punojnë dhe të mos dalin jashtë. Ndërsa në ditë të caktuara bëjnë festë. Në mesin e festave më e rëndësishmja është festa pesë ditëshe Panzha ose Parvania, të cilën e festojnë si një lloj feste të verës. Kjo festë kremtohet brenda pesë ditëve, duke filluar në muajin e fundit të kalendarit sabiut, i llogaritur sipas lëvizjes së hënës, dhe duke vazhduar në fillim të vitit të ri. Besohet se brenda kësaj kohe ka edhe festa tjera të ndryshme të cilat i quajnë Dihba Rabba, Dihba Hnina dhe Dihba Daimana.

Përkundër disa traditave fetare gnostike, në sabiuzëm nuk zë vend një jetë asketike në formë që të mos i jepet aspak rëndësi botës, apo që të braktiset çdo gjë botërore. Sado që sabiutët të besojnë se bota është një vend që është krijuar nga forcat e këqia, ata rëndësi të veçantë i japin çështjes së martesës, lindjes së fëmijve dhe të hapjes së ndonjë pune.

gj. Anëtarësimi në bashkësi dhe priftëria

Në shoqërinë sabiute nuk ka kasta ose klasa të ndara njëra prej tjetrës me linja kategorike. Megjithatë ekzistojnë murgj të cilët në shoqëri i udhëheqin ritet dhe ceremonitë fetare. Në sabiuzëm, në aspektin teorik, murg mund të bëhet çdokush që është i shëndoshë dhe pa të meta trupore dhe që në paraardhësit e tij nuk ka ndonjë heretizëm apo ndonjë rast të shmangies nga feja. Vetëm se në praktikë murgëria perceptohet si profesion që trashëgohet, pra që kalon nga babai te i biri. Ai që do të zgjedhet

për prift, po të jetë i martuar është një rast ideal. Murgjit në periudhën para se të pranojnë detyrën e tyre, një periudhë jetojnë si nxënës apo si kandidat nën kontrollin e një priftit (si ndihmës të tij). Më vonë me anën e organizimit të një ceremonie për priftëri, bëhet prift. Shkallës më të lartë në priftëri i thuhet *rish ama*. Kjo detyrë në një aspekt do të thotë edhe liderizëm i shoqërisë sabiite. Sabiitët e sotëm nuk e posedojnë një rish ama. Ndërsa ganzibra është i njëjtë me detyrën e një kryepriifti lokal. Priftërinjve normal ju thuhet tarmida, ndërsa ndihmës priftërve ashganda.

Priftërinjtë sabiitë, krahas asaj që çdo sabiitë në ritet dhe ceremonitë fetare e ka të domosdoshme që të veshë rasta (tesha të bardha ceremoniale), teshat e tyre i pajisin me disa gjëra që janë shenja të priftërisë. Në mesin e tyre më të rëndësishme janë: unaza e arit e vendosur në gishtin e vogël të dorës së djathtë; një shkop i gjatë, që gjatë ceremonisë, mbahet në dorën e djathtë dhe është i bërë nga dega e ullirit; sarëku i mbështjellur rreth kokës, me qëllim që të mbyllë gojën dhe hundën dhe një kordele e mbajtur në kokë për të lidhur flokët. Bartja apo veshja në mënyrë më të përshtatshme e këtyre gjërave për priftërinjtë është një gjë me shumë rëndësi. Nga këto gjëra, me vdekjen dhe varrosjen e priftit varrosen edhe unaza dhe shkopit i tij.

Në shoqërinë sabiite nuk ka një ceremoni për praninë në fe, siç është rasti me Krishterimin. Çdo i lindur normal në familjen sabiite pranohet anëtar natyror i shoqërisë. Edhe krahas mos rastisjes së një shprehjeje flagrante në librat e shenjtë sabiit, një njeri nga jashtë (një njeri që nuk ka lindur nga një nënë dhe baba sabiit) është e pamundur që të bëhet sabii.

Çdo sabii ka dy emra, një emër botëror dhe një emër të fshehur fetar. Emrat fetarë me lindjen e fëmijës e cakton prifti duke bërë llogaritë të ndryshme astrologjike. Sabiitët emrat botërorë i përdorin jashtë; ndërsa mes tyre dhe gjatë adhurimeve përdorin emrat e tyre fetarë. Për shoqërinë sabiite është shumë me rëndësi përshtatja ndaj parimeve misterioze (të fshehtësisë). Të treguarit jashtë (atyre që nuk janë sabii) të çdo doktrine apo të çdo parimi fetar pranohet si gabim i madh, bile edhe blasfemi. Çdo sabii është i obliguar që të vishet me teshat e bardha të shenjta rasta. Kështu që të vdesësh pa rasta, d.t.th. që pas vdekjes t'iu nënshtrohesh dënimeve të mëdha. Megjithatë, sidomos sabiitët, rastat i veshin edhe nën teshat e jashtme. Ky qëndrim ekstrem dhe jotolerant i sabiitëve në mes komunitetit të tyre është edhe shkak i shtimit të ngjarjeve si mosinteresimit për fenë apo të ndërrimit të fesë nga ana e sabiitëve.

h. Tempujt

Tempujt sabiitë quhen *mandi*. Manti në përgjithësi është një shtëpizë e thjeshtë dhe e vogël, e rregulluar pranë lumit dhe me kahje drejt veriut, është pa dritare dhe në anën jugore ka një derë. Në jug të kësaj ndërtese gjendet një pishinë e vogël për baptizim që lidhet me lumin me anë të një kanali dhe me një kanal tjetër përsëri uji derdhet në të njëjtin lumë. Brenda në mandi nuk ka dysheme e as ndonjë zbukurim tjetër; këtu nuk bëhet as ndonjë adhurim. Manti perceptohet si simbol i botës së dritës në tokë. Përveç priftërinjëve, për anëtarët e tjerë është e ndaluar hyrja në të; edhe priftërinjtë mund të hyjnë në të vetëm në kohë të caktuar. Kështu që, në fakt, është shumë vështirë të thuhet se mandit është një tempull. Sepse ajo godinë, jo që s'është tempull por më shumë është me cilësinë e një klubi kulturi.

2. Maniheizmi

Literatura: S.N.C. Lieu, *Manichaeism*, Manchester University Press 1985; J.P. Asmussen, *Manichaean Literature*, New York 1975; L. Cinillo, A. Roselli (ed.), *Codex Manichaicus Coloniensis*, Merra Editare Cosenna 1986; The Cologne *Mani Codex*, tr. By R. Cameron, *A.J.Dewey*, Scholars Press 1979; K.Rudolph, *Gnosis*, Edinburgh 1983, f.326-342.

Maniheizmi është një traditë fetare gnostike, e themeluar nga Mani, në shek. III. pas e.s. Maniheizmi, për shkak të posedimit të një organizmi misionerik të zhvilluar, për një kohë të shkurtër, duke i kaluar kufijtë lokal të vendit ku ka lindur si Iranin Jugor dhe Mesopotaminë, u shtri deri në brendësi të Egjiptit, Anadollit, Evropës dhe Azisë. Kështu që në shek. IV. arriti në pozitën e një rivali më të madh të krishterimit në shumë vende. Në shek. VIII. (762/763) me një qarkore të Bögü Kan-it bëhet fe zyrtare e ujqurëve në Turkistanin Lindor. Vetëm se maniheizmi, pas shek. VI. fillon të dobësohet në Evropë, ndërsa pas shek. XII. edhe në Azi, kurse në vendet ku edhe lindi si në Mesopotami dhe Iran, me çlirimin e këtyre vendeve nga muslimanët, gradualisht u zhduk. Edhe pse sot nuk ka asnjë simpatizues, në periudhën para islamit, ajo ishte një fe shumë ndikuese dhe shumë interesante në aspektin e parimeve të besimit dhe në aspektin e të kuptuarit të jetës gnostike.

Burimet në lidhje me maniheizmin mund të përmbledhen në dy grupe. Grupi i parë përbëhet nga shkrimet manibeiste, që janë burime të dorës së parë të maniheizmit. Ndërsa në grupin e dytë, bëjnë pjesë burime të ndryshme të dorës së dytë, të cilat japin njohuri për maniheizmin. Në mesin e tyre mund të numërohen edhe disa etër të kishës si Shën Augustini, që fillimisht ka qenë manibeist, dhe disa dijetarë islamë si Ibn Nedim dhe el-Biruni.

a. Mani

Mani, ka lindur në vitin 216 pas e.s. në Iranin Jugor dhe është prej një familjeje të medhhebit Elkesai, të cilët nga ana e të krishterëve janë llogaritur si të devijuar. Emri i babait të tij ka qenë Patik, ndërsa emri i nënës së tij ka qenë Maria . Burimet nuk janë të një mendimi në lidhje me vendin e lindjes së Manit. Vetëm se Biruni tregon se vendi i lindjes së Manit është fshati Mardinu. Në rajonin ku është rritur Mani, përveç fraksionit krishter Elkesai kanë qenë të përhapura edhe sistemet e besimit si sabiizmi dhe zaratustrizmi, të cilat në forma të ndryshme kanë ndikuar në formimin e sistemit të të menduarit të Manit. Sipas teksteve manibeiste, Mani qysh në moshën 5-6 vjeçare ka përjetuar përluljen e drunjve dhe dëshmimin e tyre të lartësisë para tij. Në moshën 12 vjeçare Mani, nëpërmjet një të deleguari hyjnor, të cilin e quan “ikizim”, dhe komentohet si “Shpirti i Shenjtë”, pranoi shpallje të ndryshme. Përafërsisht në moshën 20 vjeçare kjo përvojë e marrjes së inspirimit filloi përsëri, dhe pas kësaj Mani filloi të formojë sistemin e besimit dhe ta përhapë atë rreth e qark. Hapin e parë për përhapjen e besimit ua bëri babait dhe anëtarëve tjerë më të mëdhenj të familjes që e përkrahën atë. Në kohën e mbretit Shapur I. lëvizjes së Manit iu bë një lëshim i madh dhe në sajë të kësaj ai (Mani), duke u nisur nga Irani, gjeti rastin për përhapjen e fesë së tij në vende të ndryshme. Mani me shkrimin e veprës Shapuragan u mundua që në një mënyrë të shlyej borxhin falenderues që ia kishte Shapurit I. Rivaliteti që ishte në mes ithtarëve të Zaratustrës dhe të Manit, nuk krijoi ndonjë situatë faktike gjatë periudhës së sundimit 30 vjeçar të Shapurit I. Mani për përhapjen e doktrinës së tij shëtitu brenda kufijve të Perandorisë dhe formoi komunitetin e tij. Me dërgimin e nxënësve në Lindje dhe Perëndim e zhvilloi veprimtarinë misionerike. Horasani u bë qendër e maniheizmit. Pas Shapurit I. toleranca që i bëhej maniheizmit vazhdoi edhe për disa kohë. Vetëm se në kohën e Behram I. (274-277) kësaj iu dha fund. Me botimin e një qarkoreje nga ana e krye priftit zaratustrist të perandorisë së Kartir-it, e cila porosit që çdo fe tjetër të ndiqet, duke përfshirë edhe maniheizmin, fillon fushata e asimilimit të fuqishëm të manibeistëve. Në fund Mani kapet, futet në burg dhe pas 26 ditë burgimi në vitin 276 vritet duke iu prerë koka. Trupi nga pjesëtarët e tij varroset në Ktesifon. Nxënësit e Manit, në vendet ku kanë shkuar për të përhapur fenë, misionin e tyre e kanë kryer me sukses. Fenë e tyre, zaratustristëve ua shpjeguan si “i biri shpirtëror i Zaratustrës” (Saoshjant), budistëve si “Buddha i ardhmërisë” (Maitraja), ndërsa të krishterëve si

“Paraklit”.

b. Librat e shenjtë

"Mani" është njëri prej liderëve themelues të fesë, që edhe ka shkruar doktrinën dhe besimin fetar. Ai, në disa raste veprat e tij i ka zbukuruar me vizatime dhe figura, kështu që për sqarimin e mendimeve të tij ka zgjedhur metodën e shpjegimit me këto forma. Mani, i cili pjesën më të madhe të veprave të tij i ka shkruar në dialektin lindor të gjuhës arameje, doktrinën e tij e ka përmbledhur në 7 libra. Ato janë:

- 1 - "Ungjilli" i jetës
- 2 - Depoja e jetës
- 3 - Pragmateia
- 4 - Libri i fshehtësive
- 5 - Libri për kafshët e egra (e frikshme)
- 6 - Letrat
- 7 - Këngët fetare dhe lutjet

Përveç këtyre ai, në librin me emër Shapuragan, të shkruar në gjuhën Pahlave për Shapurin I. i cili atë e mbronte, ka reziguar doktrinën dhe besimin e shprehur në shtatë librat e lartpërmendur. Vetëm se asnjëri nga këto libra, të shkruara nga Mani, nuk ka arritur deri në kohën tonë. Deri në kohën më të hershme njohuritë në lidhje me këto libra, i mësonim nga veprat e etërve të Kishës dhe nga shkrimtarët arabë dhe sirianë. Por që nga fillimi i shek. 20., si rezultat i hulumtimeve dhe i gjurmimeve të bëra, u gjetën me mijëra faqe dokumente të shkruara nga nxënësit e Manit dhe shkrimtarët maniheistë. Këto (shkrime) gjenden në qendra të ndryshme vendbanimesh në një hapësirë shumë të gjerë, prej Algerit e deri në rajonin Turfan të Turkistanit Lindor, dhe janë të shkruara në gjuhë të ndryshme, si: kopte, siriane, kineze, persiane dhe latine.

Kjo literaturë, e cila është dërguar në qendrat si Dublin, Berlin dhe Këln, sot shërben si burim shumë i rëndësishëm qoftë në lidhje me Manin, qoftë në lidhje me përmbajtjen e librave të shkruara nga Mani.

c. Koncepti për Zotin

Si në çdo fe gnostike edhe në maniheizëm gjendet mendimi i një dualizmi gnostik. Ky dualizëm bazohet në dy parime origjinale të kundërt njëri me tjetrin dhe në konceptin tre kohë, që ka të bëjë me marrëdhëniet me njëri tjetrin të këtyre parimeve. Këto dy parime origjinale janë drita dhe errësira apo e mira dhe e keqja. Të dy këto parime, që në aspektin cilësor janë plotësisht të ndarë njëri prej tjetrit, janë të pafillim dhe të pambarim. Zoti i dritës, që është sundimtar i botës së dritës, quhet me emrat si “Babai i lartësisë”, “Mbreti i botës së dritës” ose shkurtimisht “Zoti”. Në disa tekste, në një përshtashmëri me traditën iraniane, ai quhet edhe me emrin Zarvan. Mani këtë qenie të lartësuar e përkufizon kështu: “Ai është zotëria i jetës dhe është i gjallë (do të mbetet) deri në pafundësi, ka qenë para çdo gjëje dhe do të jetë pas çdo gjëje. Çdo gjë varet prej ekzistencës së tij dhe do të jetoj me fuqinë e tij”. Zoti i lartësuar posedon katër fuqi të përbëra nga e shenjta, drita, forca dhe dituria. Ai ka edhe botëra të tjera të dritës (12 aeon, bota e dritës). Bota e dritës, e cila përbëhet nga pesë elementet e përbëra prej ajrit, erës, dritës, ujit dhe zjarrit, sidomos posedon edhe pesë cilësi hyjnore. Këto janë mendja, mendimi, perceptimi, ditura dhe dinjiteti, të cilat në fakt janë zbulesë e cilësive të zotit të lartësuar. Sidomos kjo botë zotëron edhe cilësitë si dashuri, besim, lojalitet, mirësi dhe urtësi. E gjithë bota e dritës, bashkë me Zotin e lartësuar, përshkruhet si “druri i jetës”.

Edhe bota e errësirës është si bota e dritës, vetëm se bota e errësirës ka një konstruksion krejt tjetër. Edhe në krye të kësaj bote ka një ekzistencë të lartësuar, mbretin ose zotin e errësirës. Zoti i errësirës definohet si një egërsirë me kokë gjarpëri, me trup kuçedre, me krahë shpeze, me bisht peshku dhe me këmbë të kafshës së egër. Rreth e përqark tij ka qenie të këqia të panumërta dhe bota e pesë errësirave. Këto janë tymi, zjarri, era, uji dhe errësira. Në çdo njëri nga këto botëra, që janë edhe cilësi të zotit të errësirës, banojnë qenie të këqia dhe një udhëheqës i keq (arkon). Botën e errësirës, e cila për kundër botës së dritës është e mbushur me cilësi negative, fund e krye e ka kapluar një tym që është “helmi i vdekjes”. Gjithashtu në këtë botë gjendet edhe “druri i vdekjes”, i cili simbolizon materien dhe nga degët e panumërta të tij fluskon luftë, ashpërsi, urrejtje dhe çdo gjë e keqe. Nga këto dy botëra

originale, bota e dritës si vend gjeografik përfshinë veriun, lindjen dhe perëndimin, ndërsa bota e errësirës përfshinë jugun. Në mesin e tyre është një kundërshtim dhe një zënk e pafund.

Nga ana e Manit koha, në aspektin e marrëdhënieve me njëra tjetrën të këtyre botërave, ndahet në tri pjesë. Këto janë koha e kaluar dhe koha e ardhshme, të cilat në një aspekt kanë të bëjnë me luftën pasive në zënkat në mes dy botërave, dhe koha e tashme, në të cilën jetohej një luftë aktive.

Koha e kaluar është periudha e ndarjes definitive në mes botës së dritës dhe errësirës. Me fjalë tjera, ajo është një kohë, në të cilën të dy botrat qëndrojnë në vendet e tyre duke mos dhunuar kufijtë e njëra tjetrës dhe duke përfshirë gjendjen origjinale të ndjekjes së luftës pasive kundër njëra-tjetrës. Ndërsa koha e tashme, e cila përfshinë edhe kohën në të cilën jetojmë, është një periudhë në të cilën këto dy parime të kundërta me njëra-tjetrën ose bota e dritës dhe bota e errësirës në disa vende janë përzier dhe në disa vende ndjekin një luftë aktive mes veti. Koha e ardhshme, e cila është koha e tretë, është një periudhë në të cilën, ku me përfundimin e kësaj lufte aktive të dy botërat do të tërhiqen në vendet e tyre dhe do ta mundësojnë përsëri pozitën origjinale të së kaluarës.

ç. Koncepti për njeriun dhe gjithësinë

Sipas maniheizmit lufta në mes dritës dhe errësirës fillon me sulmin e errësirës (*bushuk*), që zotëron cilësi të përshtjellimit dhe cilësi jo të frytshme, të cilat ia mundësojnë botës së errësirës që të kap qeniet dhe botën e dritës, që posedon cilësi të jetës dhe të rregullsisë. Kështu që, për këtë qëllim forcat e errësirës vijnë në kufijtë e botës së dritës. Ndërsa zoti i lartësuar i dritës, për të zhdukur këtë sulm të botës së errësirës, për ta burgosur përsëri atë në vendin e vetë dhe për të kthyer atë në pozitën e saj pasive të pafund, nxjerr një plan me tre faza. Sipas këtij plani, i cili përfshinë edhe kohën e tashme që po jetojmë, Zoti i Lartësuar i Dritës, për të vazhduar luftën në të tre fazat kundër errësirës, krijon tre krijesa hyjnore, të cilat nuk janë asgjë tjetër vetëm se manifestim i tij.

Në fazën e parë, Zoti i lartësuar i Dritës krijon “Shpirtin e Lartësuar” ose “Urtësinë”; ndërsa nga ajo krijohet “Nëna e jetës”. Nëna e Jetës, për të luftuar kundër forcave sulmuese të errësirës, krijon Njeriun e Parë (Anash Kadmi, Hurmuz) dhe e pajis atë me pesë elemente. Këto pesë elemente, të cilat në të njëjtën kohë janë edhe teshat dhe armët e Njeriut të Parë, janë: zjarri, era, uji, drita dhe ajri. Kjo krijesë mitologjike, të cilën maniheistët e quajnë Njeriu i Parë, nuk është Adami babai i njerëzimit, por është një krijesë hyjnore. Njeriu i Parë bashkë me armët e tij zbret në botën e errësirës për të luftuar me të; vetëm se e humbet luftën dhe kapet ndërsa armët e tij gëlltiten nga forcat e errësirës (arkonët). Kështu që faza e parë e luftës aktive përfundon me fitoren e errësirës. Vetëm se maniheistët thonë se, kjo humbje e Njeriut të Parë në fakt nuk është humbje, por, është një ushqim i dhënë errësirës si përcaktim hyjnor. Në një tekst maniheist thuhet se, kjo i ngjan situatës së çobanit, i cili për të kapur luanin e egër dhe për të siguruar kopenë e tij, luanit i përgatit një kurth duke i dhënë për ushqim një qengj. Kështu që çobani, kur luani të vij për të ngrënë qengjin ai do ta kapë atë, ndërsa qengjin duke ia lidhur plagët do ta shërojë.

Në fazën e dytë, çështje parësore e Botës së Dritës është që në fund të kësaj lufte të nxehtë të shpëtojë Njeriu e Parë mitologjik dhe pesë armët e tij, të cilat janë zënë rob nga bota e errësirës. Për këtë edhe zoti i lartësuar i dritës krijon shpëtimtarin me emër “Arkitetkti i lartësuar” ose “Shpirti i Jetës”. Në traditën iraniane emri i këtij shpëtimtari është Mitra. Edhe pranë këtij ka pesë djem ose armë me emrin “Adamët e dritës”. Kështu që Shpirti i Jetës e thërret atë dhe për të shpëtuar Njeriun e Parë fillon aksionit. Njeriu i Parë i përgjigjet kësaj thirrje dhe duke shpëtuar prej botës së errësirës kthehet në botën e dritës. Ky motiv i shpëtimit më vonë do të luajë rolin e një modeli prototip për ata që dëshirojnë të shpëtojnë. Motivi “t’i bësh zë ose t’i përgjigjesh” në këtë shpëtim zë një vend të rëndësishëm në doktrinën e shpëtimit të çdo tradite gnostike. Kështu që, në këtë formë, shpëtimi i Njeriut të Parë është një sukses për forcat e dritës; vetëm se puna e shpëtimit nuk është plotësuar ende. Pesë armët e Njeriut të Parë, të cilat janë të gëlltitura nga arkonët, ende mbahen të burgosura në botën e errësirës. Me qëllim që t’i shpëtojë këto Shpirti i Jetës (Shpirti i Shenjtë) brenda botës së errësirës fillon të krijojë kozmosin. Kështu që ai nëpërmjet pjesëzave të gëlltitura nga arkonët e këqinj krijon yjet, tokën dhe qiellin. Pra kozmosi krijohet nga elemente të botës së errësirës dhe botës së dritës; kështu që ana e palëvizshme materiale e saj përbëhet prej elementeve të errësirës, ndërsa ana shpirtërore, bartë jetë prej elementeve të dritës. Krijesat që shndritin më tepër si Dielli dhe Hëna, në vete mbajnë më

tepër pjesëza të dritës. Zoti i Lartësuar i Dritës për të shpëtuar elementet e dritës nga bota kozmike ia fillon fazës së tretë ose fazës së fundit të luftës aktive kundër errësirës dhe të keqes.

Në fazën e tretë krijohet “*i dërguari i tretë*”. Nëpërmjet asaj një rrotë qiellore, duke lëvizur si një rrotë e madhe uji, pjesët e dritës në këtë botë i çon në hënë dhe diell. Pjesët e dritës të cilat nxirren deri në gjysmën e parë të çdo muaji, ngjitet në qiell në formë të një kolone drite dhe me këtë krijohet hëna e plotë. Ndërsa në pjesën e dytë të çdo muaji, këto pjesë të dritës dërgohen në diell dhe prej atje në “*parajsën e dritës*”. Rruga e qumështit paramendohet si kolonë drite.

“*I dërguari i tretë*” në mekanizmën e shpëtimit, me qëllim që të shpëtoj elementet e dritës që janë gëlltitur nga arkonët e këqinj, shëtit mes arkonëve dhe në mesin e tyre vetveten e paraqet si një grua dhe një burrë magjepsës. Nga kjo pamje e tij ndikohen edhe meshkujt edhe femrat arkonë. Kështu që nga sperma e derdhur në tokë nga arkonët meshkuj bëhet bota e bimëve, ndërsa nga sperma e arkonëve femra në det bëhet një egërsirë deti. Nga ajo që bie nga arkonët femra në tokë krijohen xhinnët. Këto xhinnë hanë bimët e tokës dhe mbeten me barë dhe kështu krijohet bota e gjallesave. Në çdo krijesë që bie prej arkonëve në këtë formë krahas elementëve të errësirës gjenden edhe pjesëza drite. Pjesëzat e dritës më tepër gjenden në bimë. Ndërsa në masë më të vogël elementet e dritës gjenden edhe në gjallesa dhe në demonë.

Zoti i Errësirës, i cili e ka kuptuar se ngjarjet i kanë dalë prej kontrollit dhe zhvillohen në dobi të botës së dritës, bën sulmin e fundit për të mbrojtur dhe për të mos i humbur elementet që i ka rob në botën e vet dhe kështu sajton një krijesë kundër “*Të dërguarit të Tretë*” i cili do të punojë me urdhërin e tij. Për këtë detyrohen dy demonët e zgjedhur: Ashkalun (Saklas “*i marrë*”) dhe Namrael (ose Nebroel). Këta elemente të fundit të dritës që kanë mbetur në ekzistencat e tjera të errësirës i grumbullojnë në veten e tyre dhe pastaj bashkohen. Nga ata lind çifti i parë njerëzor (Gehmurd), të ngjashëm me mashkullin dhe femrën e “*Të dërguarit të Tretë*”, d.t.th. lind Adami dhe Eva. Siç shihet, si në çdo sistem gnostik edhe në maniheizëm, krijuesi i njeriut nuk është zoti i lartësuar, por është e keqja. Trupi i njeriut është pamje trupore e demonëve. Epshi dhe trupi janë trashëgimi që u ka mbetur njerëzve nga demonët.

d. Koncepti për shpëtimin

Me krijimin e çiftit të parë, Adamit dhe Evasë, nga forcat e këqija Zoti i Lartësuar i Dritës për t’ia shpjeguar të vërtetën Adamit dhe për t’ia mësuar rrugën e shpëtimit i dërgon të deleguarin hyjnor “*Jezusin madhështor*”. Jezusi madhështor te Adami vjen me këtë thirrje dhe Adami kësaj thirrjeje i është përgjigjur pozitivisht. Më vonë Jezusi madhështor, Adamit ia sjell diturinë hyjnore të shpëtimit. Dhe me këtë Adami kupton vetëveten dhe të vërtetën në lidhje me botën hyjnore dhe e meriton shpëtimin. Për këtë shkak plani inferior i errësirës edhe njëherë është mundur. Në anën tjetër elementet e dritës së Adamit dhe Havvasë nuk janë të një mase. Eva posedon më pak pjesëza drite. Ademit i është tërhequr vërejtja nga ana e Isait, që të mos ketë marrëdhënie intime me Havvanë, për shkak se ajo do ta lidhë me këtë botë materiale, dhe në fillim ai i nënshtrohet këtij urdhëri. Vetëm se Eva, e cila në vete posedon më pak elemente drite, nuk është e interesuar për Adamin por, ajo interesohet për babain e tij arkonin dhe bashkohet me të. Nga ky bashkim lind Kaini. Pastaj Kaini bashkohet me nënën e tij dhe kështu lind Abeli. Këto bashkime të parregullta ndjekin njëra tjetrën dhe më pastaj një arkon (Sindid) Evanë e mëson se si ajo me magji ta mashtrorë Adamin që ai të bashkohet me të. Kështu Adami i mashtruar nga Eva, bashkohet me të dhe nga ky bashkim lind Shiti. Vetë Adami e rrit Shitin dhe ia mëson atij realitetin. Shiti, djali i Ademit, në të gjithë shoqëritë gnostike pranohet si djali i vërtetë i Ademit dhe si babai i gnostikëve. Sindid, arkoni i keq, duke e mashtruar Ademin, përsëri e nxit Evanë që të bashkohen. Ademi përsëri mashtrohet me Havvanë; vetëm se këtë rradhë Shiti e këshillon Adamin dhe e thërret që ai të shkojë me të në lindje, në botën e dritës. Kështu që pas vdekjes Adami dhe pasardhësit e tij lartësohen në botën e dritës. Ndërsa në anën tjetër Eva dhe pasardhësit e saj shkojnë në ferr.

Njerëzimi në të cilin shpirti - që i takon botës së dritës në trupin e keq - jeton i burgosur vazhdon të shtohet. Vetëm se shpëtimi i Adamit përbën për pasardhësit një model, një shembull për tërë njerëzimin në përgjithësi. Jezusi madhështor për shpëtimin e njerëzimit që rrjedh prej Adamit, e obligon “*Mendjen e Dritës*” (Manuhmed), i cili njihet si babai i të gjithë të dërguarve të dritës. Mendja e Dritës,

çdo njeriu që do të shpëtojë i vjen shpirtërisht me pesë cilësitë. Shpirti e njeh atë për këto pesë cilësi dhe i përgjigjet ftesës së tij. Në anën tjetër shpirti, që nuk e meriton shpëtimin dhe nuk i është tërhequr vërejtja nga Mendja e Dritës, deri sa ta meritojë shpëtimin apo deri në ditën e fundit të llogarisë, do të lindë përsëri (disa herë) në botë. Prandaj në maniheizëm ka një mendim të reinkarnacionit (rimishërimi-shpërngulja e shpirtit) të kufizuar. Sipas kësaj nënshtrimi i shpirtit rimishërimit, në një aspekt është proces për pastrimin nga errësira dhe e keqja e tij; ndërsa nga ana tjetër, shpirti i cili nuk e meriton që t'i tërhiqet vërejtja nga ky i deleguar hyjnor, dënohet me qëndrim të kohëpaskohshëm në burgun e trupit.

Shpirti për shpëtimin e tij para së gjithash duhet të bëjë parapërgatitjet e nevojshme, duhet të qëndrojë larg botës inferiore materiale dhe dëshirave dhe aspiratave trupore. Në këtë rast është kusht të njohë strukturën e vet dhe të ndjejë një përmallim për shpëtim. Më vonë duhet që t'i përgjigjet thirrjes së të dërguarit hyjnor dhe të hyjë në rrugën të cilën ia ka treguar ai. Ai vetëm në sajë të njohjes së mirë të diturisë, të cilën ia dërgon i dërguari hyjnor, mund që të shpëtojë nga trupi i keq dhe bota materiale.

Mani beson se, në kohëra të ndryshme të dërguarit hyjnorë (*Paraklit*), për t'ua mësuar njerëzve rrugën e shpëtimit, kanë jetuar në tokë dhe se vetë ai është i fundit nga të dërguarit e Dritës. Të gjithë të dërguarit që kanë ardhur para tij si Zaratustra, Buda dhe Jezusi, kanë ardhur me qëllim që njerëzve t'ua mësojnë rrugën e shpëtimit. Ndërsa vetë ai është i dërguari i fundit. Pas tij nuk do të ketë më të dërguar; vetëm do të dalin në shesh të dërguar të rrejshëm. Maniheizët besojnë se, Mani, si i dërguar i fundit, pas ndarjes nga kjo botë nuk ka shkuar në botën e dritës, por është ndalur në hënë dhe aty do të presë derisa të shpëtojë edhe bërthama e fundit e kësaj bote dhe se prej atje vazhdon që shpirtërave t'ua tregojë rrugën (e shpëtimit).

dh. Koncepti për eskatologjinë, mesianizmin dhe për apokalipsin

Sipas Manit, paralel me shpëtimin e shpirtërave nga burgu i botës dhe trupit do të shtohet tirania, terrori dhe e keqja. Sepse me largimin prej këtu, një nga një apo dy nga dy, të elementeve të dritës të zënë rob në botë, në të do të mbeten më pak elemente të dritës, kështu që do të pakësohet edhe e mira dhe paqa që buron nga ata. Gjithnjë sipas Manit në kohën e fundit do të dalin të dërguar të rrejshëm, sikurse "Mithra i rrejshëm" që do të mundohet t'i devijojë njerëzit.

Në kohën e fundit në periudhën kur do të jetë afër shpëtimi edhe i pjesës së fundit të dritës, do të ndodhë një luftë e madhe që do të jetë lajmtare për afrimin e fundit të botës. Që nga këto momente në botë do të dominojnë vetëm mëkati dhe zënkat. Më vonë në botë për së dyti herë do të vijë i dërguari i dritës Jezu Krishti dhe do të fillojë gjykimi i njerëzve. Për këtë dhe ai do të ulet në mes të botës dhe do ta ndajë të mirën nga e keqja. Sipas kësaj ndarjeje, maniheizët, të cilët deri në atë moment ende nuk janë ndarë nga kjo botë, duke u mbështetur në të do të ulen në anën e djathtë të tij dhe do të jenë nga fitimtarët. Ndërsa mëkatarët, të cilët do të jenë në anën e majtë të tij, do të flaken në ferr. Ata besimtarë të cilët do t'i nënshtrohen atij, do të shndërrohen në melekë. Më vonë Jezu Krishti, do t'i njoftojë qeniet hyjnore, që është në formë të rrugë së qumshtit, dhe shpirtit të pesë dritave, që ata të largohen nga vendi i tyre. Ata me t'ua ndarë bota menjëherë do të shkatërrohet dhe do të dalë një zjarr i madh që do të zgjatë 1468 vjet. Edhe elementet e fundit të dritës që kanë mbetur mbrapa bashkë me të dërguarin e dritës, do të lartësohen në botën e dritës, forcat e këqija, që e kanë humbur luftën dhe ithtarët e tyre, për të mos jetuar edhe një herë atë tirani, do të hidhen në një humnerë të madhe që është përgatitur për ata, ndërsa vrima e saj do të mbyllet me një rrasë të madhe. Kështu, plotësohet periudha e luftës aktive mes të mirës dhe të keqes dhe përsëri bëhet rikthimi në pozitën e parë origjinale, ku e mira dhe e keqja vazhdojnë të ndara nga njëra-tjetra.

e. Koncepti për adhurimin

Sipas mësimave të Manit, shpirti, për të shpëtuar nga burgu i tokës dhe i trupit, duhet që të qëndrojë larg disa veprave të cilat do t'i bëjnë dëm shpirtëdëlirësisë së tij dhe do të vazhdojnë ta mbajnë atë në burg. Për këtë arsye maniheizët janë të obliguar që t'i nënshtrohen rregullës "pesë urdhëra" dhe

“tre vula”. Në mesin e pesë urdhërave, të cilëve duhet t’iu nënshtrohen, zënë vend edhe: agjërimi, bërja e lutjeve dhe dhënia e lëmoshës, mosgënjimi, mosvraska e asnjë lloj gjallese dhe mosngrënia e mishit, kujdesi për pastërtinë dhe shpirtdëlirësinë, mosdhënia rëndësi pasurisë, të respektohet i varfëri dhe të qenurit modest. Në anën tjetër parimi i tre vulave është parim i të dalurit zot dorës, gjuhës dhe ndjenjave. Vula e gojës bën të nevojshme të mosfolurit keq, mosngrënien e mishit dhe mospirjen e pijeve dehëse. Sipas Manit, mishi posedon më pak bërthamë drite se bimët. Sado që gjallesat ushqehen me bimë, një pjesë e thërmijave të dritës që gjenden tek bimët, me të cilat ato ushqehen, ikin nga trupi i gjallesave. Ndërsa pjesa tjetër që mbetet në trupin e tyre për shkak të marrëdhënieve seksuale shndërohen në mish.

Mani, ithtarët e tij i porositi që të hanë ushqime bimore. Edhe sasia e dritës e bimëve ndryshon nga lloji në lloj. Në mesin e bimëve më tepër element drite kanë pemët dhe perimet si sallatat, pjepëri dhe shalqini. Në anën tjetër është e ndaluar pija alkoolike që e deh njeriun dhe e largon nga mendimi për Zotin e Lartësuar të Dritës. Ndërsa vula e dorës, njeriun që beson e mbron nga çfarëdo qëndrimi që do t’i dëmtojë elementet e dritës të zëna rob brenda në materie. Për këtë arsye, mënyra e sjelljes që është ideal dhe ka pëparësi për maniheistët është mosvraska e asnjë gjallese, mosdëmtimi i asnjë bime, bile edhe moslëvrimi i tokës dhe moskorrrja. Sidomos një maniheist fetar nuk duhet të shkelë kullosën, nuk duhet të nëpërkëmbë farën. Bile edhe larja nuk është e preferuar për shkak se kanë frikë se mos ndoten elementet e dritës në ujë. Së fundi vula e ndjenjës apo mjedisit kërkon që të largohen nga martesat dhe seksualiteti. Sepse sipas maniheizmit, martesat, e cila mundëson vazhdimin e ekzistencës materiale dhe formimin e trupave të rinj, është imitim i traditës së arkonëve të këqinj.

Shoqëria maniheiste në aspektin e nënshtimit ndaj parimeve kategorike të maniheizmit ndahet në dy grupe: të zgjedhurit dhe dëgjuesit. Të zgjedhurit janë elita që këto parime i respekton plotësisht. Ndërsa dëgjuesit, që e përbëjnë shumicën e shoqërisë, nuk i respektojnë të gjitha (sidomos parimin e martesës, të korrijshirjes) këto parime. Në këtë rast sipas mësimave të Manit, elita, e cila i respekton plotësisht këto parime, kur vdes ngjitet në botën e dritës si e pastër. Ndërsa në anën tjetër ata të cilët nuk i respektojnë këta parime, deri sa të lindin si pjesëtarë të elitës i nënshtrohen sistemit të rimishërimit dhe lindin përsëri në tokë. Shërbimet që do t’ia bëjnë elitës në jetën e tyre dhe qëndrimet për mbështetjen e mësimave fetare do t’iu mundësojnë që ata në lindjen e dytë të lindin më të mirë. Në anën tjetër që këta të vazhdojnë si anëtarë të maniheizmit u mjafton vetëm respektimi i këtyre 10 parimeve: monogamia (martesa me një grua), largimi nga adulteri (tradhëtia bashkëshortore), rrena, vjedhja, hipokrizia, idhujtaria, magjia, vrasja e kafshëve dhe nga çdo lloj dyshimi në lidhje me fenë dhe së fundi respektimi i elitës.

Maniheistët kanë edhe lutje ditore (namaz) dhe agjërim. Sipas kësaj, të zgjedhurit e kanë kusht që duke u kthyer nga veriu, të luten shtatë herë në ditë. Ndërsa dëgjuesit luten vetëm katër herë në ditë. Gjatë lutjes falenderohet Zoti i Lartësuar i Dritës dhe lexohen ilahi dhe tekste të ndryshme me përmbajtje falenderimi. Gjithashtu është kusht edhe praktikimi i agjëritimit në disa ditë të ndryshme të vitit. Të zgjedhurit agjërojnë krejtësisht 100 ditë një mbas një në muajin e fundit të vitit, i cili përkon me kohën para festës Bema të ditës së 30-të. Në këtë bën pjesë edhe agjërimi javor që mbahet të dielën. Ndërsa përveç këtyre, ceremoni tjetër me rëndësi është përgatitja e ushqimit të të zgjedhurve, që është përgatitje ditore. Dëgjuesit, të cilët janë të obliguar në përgatitjen e këtij ushqimi, sigurojnë gjithashtu edhe sallatë, shalqin, pjepër, lëngje të ndryshme pemësh dhe bukë gruri. Ata për këtë shërbim shpërblehen me faljen e mëkateve ditore. Gjithashtu ka edhe ceremoni javore për pendim dhe praninë gabimesh. Andaj një herë në vit me grupe bëhen ceremoni pendimi. Së fundi, për dëgjuesit është obligim që një të 7-tën apo një të 10-tën nga të ardhurat e tyre ta japin për shoqërinë.

Maniheistët kanë edhe festa dhe ditë të shenjta që i festojnë. Në mesin e tyre më e rëndësishmeja është festa Bema. Bema përveç që është festë, është edhe ceremoni përkujtimi për një vit. Kjo ceremoni, që festohet në fundin e muajit 12 të vitit, që është edhe muaji i agjëritimit dhe pendimit vjetor, festohet për përkujtimin e mbytjes dhe keqtrajtimit të Manit, në shkurt dhe mars. Për këtë ceremoni përgatitet një fron me pesë shkallë, që në një aspekt përfaqëson Manin, të dërguarin e dritës, dhe mbi të varet fotografia e Manit. Më vonë për Manin lexohen këngë hyjnore, lutje dhe lëvdata të ndryshme. Përveç këtyre bëhet edhe ceremonia e shenjtërimit të tyre. Maniheistët përgatisin edhe ceremoni për përkujtimin e të vdekurve.

ë. Struktura shoqërore

Manibeizmi konsiderohet si një strukturë shoqërore hierarkike e zhvilluar mirë. Sipas kësaj shoqëria në përgjithësi ndahet në dy grupe, të zgjedhurit, të cilët janë të lidhur ngushtë me parimet asketike ekzakto fetare dhe dëgjuesit, të cilët qëllim të tyre kanë, krabas mosrespektimit të këtyre parimeve, t'u shërbejnë zgjedhurve. Të zgjedhurit pranohen si të dërguar botërorë të cilët mundohen për shpëtimin e elementeve të burgosur të dritës; ata i pastrojnë elementet e dritës në ushqimet që i hanë dhe pas ushqimit duke gromësirë ju ndihmojnë atyre që ata të jenë të lirë. Të zgjedhurit para se të fillojnë ushqimin, kur e marrin atë në dorë dhe kur e përgatisin bëjnë një lutje fillestare, e cila thekson se ata nuk kanë ndonjë përgjegjësi dhe me këtë kanë për qëllim që dëgjuesit, të cilët nuk jetojnë jetë asketike, t'i llogarisin përgjegjës për mëkatet dhe gabimet. Në manibeizëm sado që dëgjuesit të jetojnë një jetë botërore, e cila në fe nuk është e pranuar, dhe sado që nuk i respektojnë plotësisht mësimet fetare, roli, që ata luajnë në shoqëri është i rëndësishëm dhe me vlerë. Kështu që, është e pranuar se edhe ata (dëgjuesit) me ndihmën që iu bëjnë të zgjedhurve, të cilët merren me shpëtimin e elementeve të dritës, për të vazhduar jetën dhe me përgatitjen e terrenit të përshtatshëm për të, luajnë rol aktiv në shpëtimin e dritës.

Në shoqërinë manibeiste punët si ligjërimi, mësimi i doktrinës fetare, përfaqësimi i shoqërisë, udhëheqja e ceremonive natyrisht që udhëhiqen nga ata që i takojnë grupit të zgjedhurve. Në anën tjetër, brenda në grupin e të zgjedhurve ekzistojnë një sërë konstruksionesh hierarkike. Kjo mund të renditet si vijon:

- 1 - Një lider, i cili si zëvendës i Manit e udhëheq komunitetin.
- 2 - 12 mësuesit, të cilët përfaqësojnë apostujt.
- 3 - 72 peshkopë
- 4 - Grupi i 360 njerëzve të moshuar.

Këto katër grupe të renditura më lartë janë vetëm nga masa e të zgjedhurve dhe nga masa e dëgjuesve të cilët i ndjekin të zgjedhurit.

FETË INDIANE

Literatura: Carl Clemen, *Die Religionen der Erde*, Munchen 1966, v.1, f.108-166; Helmuth von Glasenapp, *Die nichtchristlichen Religionen*, f.147-173; F. Heiler, *Die Religionen Menschheit*, f.368-418; Shankara, *Tefrik Etme Hazinesi*, Stamboll 1976; *Upaniṣadlar*, derleyen M. Ali Işın, Stamboll 1976; O.R. Doğrul, *Yeryüzündeki Dinler Taribi*, f.73-78, 97-105; *Ramayana*, përkth. O.R. Doğrul, Stamboll 1975; H.J. Schoeps, *Religionen*, f.169-186; H. Glasenapp, *Die Religionen Indiens*, Tübingen 1943; Ömer Hilmi (Budda), *Hind Dinleri*, Stamboll 1953; Reller, 627-648; F.W. Haack, 82-91.

Fetë që kanë lindur dhe janë zhvilluar në gadishullin indian qubën fe indiane. Krahas ngjashmërisë së karaktereve gjenerale të tyre, këto, me ndikimin e themeluesve dhe me zhvillimin historik të tyre, kanë specifika dhe zhvillim të posaçëm. Në krye të tyre qëndron feja tradicionale e gadishullit indian, hinduizmi. Këtë e ndjekin budizmi, jogizmi, xhajnizmi, si dhe rrymat dhe fraksionet e tjera të tyre.

1. Hinduizmi

Është përfaqësuesi më shumëgjyresh i besimeve politeiste (në shumë zotra) në kohën e sotme. Tërheq vëmendje me idhujt, të cilët në disa raste janë me qindra, të vendosur në tempujt e fshatrave. Ata jetojnë bashkë me muslimanët dhe numri i tyre është deri 200 milionë. Hindu është emër persisht me të cilin muslimanët i emërtojnë popujt që jetojnë rreth e përqark lumit Indus. Ky emërtim është një shprehje gjeografike. Termi “hinduizëm” përdoret për të shprehur sistemin e mendimit dhe besimin e këtij populli. Ndërsa termi brahmanizëm, nuk rrjedh nga Zoti Brahman, por nga klasa brahmane e priftërinjve indianë. Në nga shprehjet hinduizëm dhe brahmanizëm kuptojmë mënyrën e përshtypjeve (ndijimit), mendimit, besimit dhe jetesës së indianëve, duke filluar nga periudha më e lashtë e Vedave e deri më sot. Ndërsa indianët për të shpjeguar fenë e tyre përdorin shprehjen “Sanatana Dharma” (rregull i përhershëm).



Rol të rëndësishëm në formimin e gjendjes së sotme të hinduizmit, në këtë apo në atë formë, kanë luajtur shërbimet e popujve të ndryshëm të racës së bardhë, të verdhë dhe të zezë. Banorët më të vjetër të Indisë, duke u përzjer me popujt e ardhur nga veriu janë zhdukur, ka mundësi që ata të jenë të zinjë (negrit) me gjenezë afrikanë dhe malenezë. Racën e verdhë e përfaqësojnë popujt Mon-Khmer të Indisë Veriore. Ndërsa raca e bardhë mendohet të jenë dravidët e sotëm, të cilët mijëra vjet përpara janë shpërngulur nga veriu. Ndoshta kanë dhe një afërsi me popujt e vjetër të Pellgut të Mesdheut. Arianët me përkatësi të grupit gjubësor Indo-European, të afërt me persianët, janë shpërngulur për në Indi në vitin 1500 para erës sonë. Edhe pse në fillim të shek. XX u hodhën disa hipoteza se arianët janë themeluesit e kulturës indiane, gjurmimet në rajonin Harappa (në jug të Penxhabit) dhe Mahenco-Daro (në Sind) në vitin 1921-1922 tregojnë se, para shpërnguljes së arianëve, në vitin 2500 para erës sonë, në Indi ka ekzistuar një kulturë shumë e zhvilluar qytetare në rajonin indus dhe se dikur kur kanë ardhur aty janë ballafaquar me një kulturë shumë të zhvilluar. Vetëm se për fat të keq, për shkak të mosgjydhjes së mjaftueshme të burimeve arkeologjike, nuk mund të dimë se cili popull e ka themeluar kulturën induse dhe çfarë gjuhe ka folur ai popull. Por, s'ka dyshim se ajo ka patur lidhje me kulturën e Anadollit. Kjo cilësohet si një kulturë botërore internacionale e zhvilluar në atë kohë. Veprat artistike që gjenden atje, vulat dhe nuskat tregojnë se populli indus ka poseduar edhe kulturën e vizatimit (një përshkrim i zotit përkujton Shivanë të ulur si Joga), e cila u ngjan indianëve të sotëm; gjithashtu tregojnë se u kanë besuar kafshëve të shenjta si krokodilit, gjarpërit dhe kaut dhe materieve si drurit të fikut dhe gurit allus (linga); po ashtu tregojnë se, si simbol kanë përdorur edhe svastikën. Me sa duket arianët, të cilët në vitin 1500 dhe 1250 para erës sonë janë shpërngulur prej ngushitave të verilindjes për në Penxhab, e kanë shkatërruar këtë kulturë të vjetër dhe kanë lëvizur drejt lindjes; dhe në masë të madhe janë ndikuar nga kultura vendase. Kështu që hinduizmi, dubet të jetë një sintezë e përzjerjes së besimit të arianëve dhe popujve vendas.

a. Shkrimet e shenjta

Në krye të shkrimeve fetare indiane janë *Vedat* të shkruara në sanskritisht. Veda si fjalë ka kuptimin “dituri, urtësi e përhershme”. Është një përmbledhje e madhe e teksteve fetare e shfaqur në vitet 1250 dhe 800 para erës sonë. Në shek. 5 para erës sonë është filluar studimi për gramatikën e gjuhës. Kjo gjuhë edhe sot për studiuesit indianë është gjuhë fetare. Literatura e vedave përbëhet nga katër grupe tekstesh:

1. *Rigveda*: ka kuptimin të njohësh këngët fetare për sakrificën dhe përbëhet prej dhjetë librave që përmbajnë 1028 këngë fetare shumica e të cilave janë nga katër rreshta. Ajo me një sasi të madhe fjalësh, zotërat, sidomos mbretin e zotërve indianë e fton në drekën e sakrificës. Rigveda, paraqet edhe raste të ndryshme sociale të arianëve që janë shpërngulur në Indi në vitin 1500 para erës sonë.

2. *Samaveda*: Ka kuptimin “vedat e melodive”. Priftërinjtë në një formë muzikale, duke lexuar me melodi, e shoqërojnë sakrificën.

3. *Jaxhurveda*: Është veda e fjalëve të sakrificës së caktuar. Përbëhet prej lutjeve dhe fjalëve të

sakrificës, nga të cilat disa janë shkruar në prozë e disa në poezi. Prifti këto lutje i lexon gjatë sakrificimit duke murmuritur.

4. *Atharvaveda*: Është veda e fjalëve magjike. Brahmanët janë të detyruar që ta lexojnë në raste të ndryshme të jetës. Është një përmbledhje e madhe e përbërë prej 731 himneve fetare me 6000 strofa. Në krahasim me librat e mëparshëm është shkruar më vonë.

Ndërsa Brahmana, është futur në mesin e librave të shenjtë të shkruara më vonë nga ana priftërinjve. Në mënyrë të përgjithshme tregon për sakrificën dhe për problemet në lidhje me urtësinë dhe teologjinë të shkruara për nxënësit.

Upanishadat, janë pjesa e fundit e literaturës së Vedave. Esencën e tyre e përbëjnë teknika dhe udhëzimet për sakrificim. Por, gjithashtu ka edhe të atillë që Upanishadat nuk i llogarisin si Veda, por i pranojnë si libra të dorës së dytë të fesë indiane dhe brahmane. Këtu autoriteti i sakrificës është kthyer në misticizëm shpëtues. Sipas Upanishadave krijesat janë krijuar me bashkimin e shpirtit të njeriut (Atman) dhe shpirtit të universit (Brahman). Dhe kënaqësia e përhershme arrihet me njohjen e këtij krijimi. Njeriu dhe universi, sipas misticizmit, duke u bashkuar, në formë të një shëndritjeje të mrekullueshme, do të arrijnë në një kënaqësi. E tërë literatura e Vedave pranohet si shpallje dhe inspirim (Shuriti) i marrur nga Rishis-ët (fallxhinjtë e shenjtë të periudhës së parë). Gjithashtu pranohen si frymë e ekzistencës së pafillimtë, d.m.th. frymë e zotit Brahman. Ndërsa disa besojnë se Vedat janë të ligjëruara nga një zot ose se ato ekzistojnë që në eternitet.

Dy legjenda me emrin Mahabharata dhe Ramajana janë të përfshira në Vedat: E para, ëshë tregim i një lufte në mes familjeve Pendus dhe Kurus, me 100.000 strofa në sanskritisht. Përfshin edhe shumë poezi edukative dhe didaktike. Më e njohura nga këto është Bhagavadgita, që ka kuptimin "kënga e të mëdhenjve". Sipas shumicës "Gita" përbën Librin 6 të Mahabharata-së. Zoti Vishna, paraqitet në pamje botërore si Krishna i Madh dhe pas luftës së madhe trimit Arjuna, siç thuhet në një legjendë, i jep njohuri për ekzistimin e Zotit, botës dhe shpirtit. Arjuna, kur i sheh të afërmit e tij në fushën e luftës në grupin e kundërshtarëve, nuk dëshiron që të luftojë; vetëm se Zoti Vishnu, i cili kujdeset për qerren e Tij (Arjunasë), e bind Atë se duhet të luftojë. Fjalët e tij i mbështet në këtë bazë: "Kalimtarë janë vetëm trupat e njerëzve, ndërsa shpirti i tyre është i pavdekshëm". Sipas Bhagavadgita-së, Zoti veten e tij e ka përhapur në botë. Ai është çdo gjë dhe në çdo gjë. Në të njëjtën kohë është edhe sundues i universit. Ata që me dëshirën e tyre vetëveten ia nënshtrojnë Zotit Krishna-Vishnu edhe Zoti do t'iu përkulet dhe do t'iu përgjigjet.

Mbështetja e fesë subjektive (individuale) nga Libri, ka shumë rëndësi për shumë njerëz në Evropë dhe Indi. Për shembull, Mahatma Gandhi thotë:

"Kur demoralizohem e hap Bhagavadgita-në; lexoj një strofë këtu një strofë atje dhe edhe nëse jam në brengë të mëdha, menjëherë filloj të qesh".

Ramajana, me 24.000 strofa shpjegon tregimin e jetës së një princi legjendë Ramasë. Sipas kësaj, Ravana, mbreti i viganëve, e grabit gruan e Ramasë dhe e çon në ishullin Cejlon (Lanka). Edhe Rama, me ndihmën e majmunëve, të cilët kanë ndërtuar ura mbi oqean, korr sukses në shpëtimin e gruas së tij Sitasë. Në veprën e tij 18 Purana (tregime të vjetra) me përmbajtje legjendare, tregon për krijimin e botës, adhurimet dhe urtësitë. Purana më e njohur "Bhagavata", ka një ndikim të madh falë epopesë së Krishnasë.

Përveç librave të lartpërmendur ka edhe shkrime të shenjta të tjera të fraksioneve të ndryshme. Vetëm se këto nuk pranohen nga të gjithë hindusët. Shkrimet, e përmbledhura nën titullin "Tantra" (tekst) dhe "Agama" (transmetim), kanë dalë në shesh në fund të mijëvjetëshit të parë. Libri i Ligjit të Manusë dhe veprat tjera legjendare numërohen si Smriti (shpallje). Kjo literaturë madhështore është shkruar në sanskritisht, gjuhë të cilën e kanë përdorur intelektualët e lashtë. Por ka 1400 vjet që literatura e hinduizmit dalëngadalë është larguar nga sanskritishtja. Poetët preferojnë gjuhë të ndryshme të reja indiane. Më të rëndësishme nga këto gjuhë janë ajo indiane, bengale, maratanaje, gujxhouje. Historia e zotëve që është shkruar në këtë gjuhë i është prezentuar për dobi rrethit më të gjerë. Këto vepra janë vazhdim i literaturës në sanskritisht. Përkundër kësaj, një pjesë e literaturës së shkruar në gjuhët dravid (kanara, telegu, tamil dhe malajane), të cilat nuk janë ariane, janë shkruar në mijëvjetshin e parë para erës sonë. Sado që të jenë të ndikuara nga literatura sanskritishte, ato në aspektin e gjuhës dhe përmbajtjes paraqesin një specifikë tjetër.

b. Mendimi për universin

Sipas konceptit indian universi është i përhershëm; vetëm se botërat (në Zotin Brahman, d.m.th. në Vezën-Brahman) të cilat e përbëjnë atë gjithmonë pësojnë ndryshime. Periodikisht dalin në shesh, jetojnë dhe zhduken. Çdo shkollë dhe fraksion ka mendim të ndryshëm në lidhje me atë se në çfarë forme dhe si është krijuar bota dhe se pas një kohe të gjatë si do të zhduket ajo. Këto, për elementet përbërëse të botës, sipas formës së daljes nga Zoti, kanë zhvilluar mendime të ndryshme. Bota udhëhiqet nga Zoti. Ajo është krijuar nga substancat ose nga lëmsbi i atomeve të përbërshme, të cilat ekzistojnë bashkë me Zotin. Në çdo vend të botës, në kontinentet e rrethuara me detëra jetojnë njerëz dhe kafshë. Në katet e epërme të botës nëntokësore qëndrojnë demonët. Ndërsa mbi sipërfaqe të tokës ka një mbi një vendbanime qiellore.

Të gjitha gjallesat prej Brahmanëve, që kanë katër fytyra, e deri në një livadh, kanë shpirtëra të pavdekshëm të mbështjellur me trup material që janë që në eternitet (amëshim). Sipas parimit, i cili vepron mbi përgjigjen e punëve të mira dhe të këqija, (shpirti) është i detyruar të sbëtisë prej një krijese në një krijesë tjetër. Sipas asaj që e pranojnë të gjithë fraksionet të gjitha krijesat, duke marrë parasysb edhe zotërat përveç Zotit të madh dhe të përhershëm Ishvarasë, i janë nënshtruar këtij ligji të përgjithshëm të universit.

Sipas këtyre koncepteve, pranohet se në çdo sistem të universit ekziston një Zot i Zjarrit dhe një Indra. Nëse veprat e shpirtave që gjenden në qeniet hyjnore nuk janë në përputhshmëri me nivelin ku gjenden, si përgjigje për të do të lindin përsëri në tokë. Ndërsa vendet e tyre i zotërojnë shpirtërat e tjerë me karma të përshtatshme, që kanë të njëjtin obligim dhe të njëjtat aftësi. Ndryshimet periodike në lindjen dhe perëndimin e botës, ndodhin në një udhëtim historik të caktuar të cilat vazhdojnë me miliona vite.

Brahman është zoti që jeton më shumë nga zotërat e vdekur. Jeta e tij është sa një qind vjet të Brahmasë. Kjo në vite njerëzore është 311.041.000.000.000 vjet. Kur të afrohet fundi i jetës do të shkatërrohet edhe sistemi botëror. Do të bëhet një substancë e pakuptueshme dhe e pandjeshme sikur hiçi. Përsëri pas qëndrimit kaq të gjatë në qetësi absolute do të lindë një botë e re, një Brahman i ri. Në jetën e Brahmanit do të ketë ndryshime kohore si ditët dhe netët njerëzore të cilat ndjekin njëra-tjetrën. Me mbarimin e një dite të Brahmanit një pjesë e botës do të zhduket dhe drejt kësaj humbjeje shkojnë vetëm pjesët e poshtme të sistemit botëror. Me lindjen e një dite të re të Brahmasë, në pjesët e epërme të sistemit botëror, do të fillojë një krijim i pjesërishëm. Një ditë e Brahmasë bën një "kalpa", i cili përfshin edhe jetën botërore të madhe 1000 vjeçare. Ndërsa një jetë botërore (Mahajuga) është sa 320.000×4 jetë njeriu. Një jetë më e gjatë botërore është e përbërë nga mbledhja e periudhave të quajtura Krita, Treta, Dvapara dhe Kali dhe çdo njëra nga ato (sipas rënditjes) reflekton 4, 3, 2, 1 mijë (Vjet Zoti). Jugatë (periudhat botërore) dallojnë nga njëra tjetra sipas vazhdueshmërisë dhe cilësisë. Një Juga xhevabiri është periudha më e gjatë. Në këtë periudhë ka një lumturi të përgjithshme. Njerëzit janë dashamirë të së vërtetës dhe të drejtë. Në çdo Juga që e pason atë do të ketë një keqësim të vazhdueshëm, kështu që më në fund, në Kali-Juga në etikë dhe në çdo send do të ketë një rënie; kjo rënie në jetën e njeriut dhe në botë arrin kulminacionin. Së fundi përsëri fillon një jetë botërore e lumtur që do të jetë e detyruar që në të ardhmen vendin e vet t'ua lërë periudhave që pasojnë. Në çdonjërin nga këto Juga ka nga një të kuqe mëngjezi dhe një të kuqe mbrëmjeje që zgjatë sa një e katërta e vetë asaj.

Sot ne gjendemi në Mëngjesin e Kuq të Jugasë Kali, që fillon më 17 Shkurt 3102 me vdekjen e Krishnasë. Luftërat e përshkuara në Mahabharata kanë ndodhur në Juganë Dvapara, kurse aventurat e Ramasë dhe Ranasë në Juganë Treta.

Indusët janë mësuar me këtë llogari madhështore të kohës. Besojnë se njohuritë metafizike, sikur që e pranojnë se para mijëra vitesh kanë jetuar trima historikë, dhe shkrimet e shenjta janë shpallur në periudha aq të vjetra, sa që s'mund të paramendohet; ndodhitë të cilat shkrimtarët ua shpjegojnë Mahabharatasë dhe Ramasë besojnë se ata vetë i kanë përjetuar. Mendimin botëror indian që e shpjeguam deri më tash, e pranojnë shumica e indusëve. Ka mundësi që, në kundërshtim për atë që i kemi shpjeguar, të rastisen edhe mendime të shkollave dhe fraksioneve të ndryshme.

c. Karma

Çfarë është besimi, udhëzimi i vërtetë i fundit për shpërblimet dhe ndëshkimet në hinduizëm? Hinduizmi beson në ekzistencën e një rregulle universale dhe të përhershme të quajtur "Karma". Karma është një rregull moral i universit, sipas të cilës punët që bëhen në këtë jetë ndikojnë në kuadrin e gjallesës dhe luajnë rol në kthimin e saj përsëri në trup. Kështu që, çdo gjallesë pozitive e saj e fiton me punët që i vepron. Nëse pozita e një gjallesë shkon nga e keqja, ajo do të përjetojë vuajtjen e veprave të

këqija të vepruara në ekzistencën më të hershme. Nëse pozita e një ekzistence, e cila është në brendi të veprave të këqija, shkon nga e mira, d.t.th. se edhe ajo ende shfrytëzon fitimin e punëve më të hershme. Karma është një kundërrregull që vepron automatikisht dhe pa mëshirë dhe ndikon si shpërblim i formës së krijesës më të hershme. Kështu, me vendimin e ligjit karma, të gjitha përcaktimet në tokë, duke mos e distancuar vullnetin e lirë të njeriut, dalin në shesh në forma të ndryshme. Për punët të cilat do të ndikojnë negativisht ose pozitivisht, vendos vetë gjallesa. D.t.th., karma është një rezultat i përgjithshëm i jetës së botës së çdo krijese. Vetë gjykimi i jetës është i pafillim dhe i pafund. Njeriu vazhdon të jetojë në zinxhirin e rimishërimit të pafund. Për këtë shkak vdekja nuk është zhdukje apo mjet frike, por është kalim prej një ekzistence në tjetrën. Megjithatë Karma, e lidhur me besimin e inkarnacionit, është udhëheqësi kryesor i mendimit indian. Ajo shihet që në kohën e upanishadave. Çdo indian, mundohet që kur të kthehet përsëri në botë, me punët e mira, të fitojë një trup të mirë, jetën e ardhme ta marrë në siguri. Në të kundërtën, frikësohet se për shkak të mëkateve të tashme, në lindjen e dytë të mos lind si bimë ose kafshë. Gjithashtu edhe kasti (klasë sociale) ku ka lindur, është rezultat i punëve të bëra.

Hinduizmi nuk njeh fund të botës dhe ekzistencës. Në këtë aspekt, sipas indianëve, ngjarjet historike nuk janë vlerësim i të kaluarës, por, janë pasqyrim i kohës së tashme e cila vazhdon pa fund. Rrota sansara, d.t.th. kthimi përsëri i turbinës së vdekjes dhe lindjes, nuk do të ndërpritet asnjëherë. Të gjitha përcaktimet e ekzistencave që jetojnë që në eternitet, janë vetëm ndryshim i formave dhe mbulesës materiale. Shpirtërat janë të pavdekshëm dhe të përhershëm. Ata me anë të ligjit karma, sipas punëve të mira ose të këqija, marrin trup hyjnor, njerëzor, të kafshës apo të bimëve.

ç. Sistemi i besimit

Hinduizmi është një fe e themeluar, dhe fe që ka lindur prej zhvillimeve historike. Nuk ka një sistem të caktuar të besimit si në islam e as një rrugë të qartë të udhëzimit si në budizëm. Në të shihen manifestime të ndryshme të jetës fetare si fetishizmi (kulti i kafshëve, për shembull, lopa në rajonin Ganxh pranohet e shenjtë), politeizmi, panteizmi, henoteizmi. Hinduizmi është si një grumbull i dukurive fetare të vendosura në histori njëra pas tjetrës. Ai, për shkak se në të gjenden kundërshtimet, mendimet e thjeshta ose të përparuara, drejtësitë e ndryshme njëra pranë tjetrës, quhet “enciklopedi e të gjitha feve”.

Mospërcaktimi i parimeve të caktuara, doktrinave dhe koncepteve është një specifikë e hinduizmit. Për këtë në sy bie një mirëkuptim i gjerë fetar. Në këtë fe, numri i ekzistencave të shenjta është i pakufizuar. Edhe rrugët e shpëtimit janë shumë. Krahas indianëve vegjetarianë ka edhe indianë të cilët bëjnë gëzime epshore dhe jetojnë një jetë mjaft asketike. Edhe numri i zotave në hinduizëm është i madh. Në kohën më të lashtë mendohej se brahmani katërkokësh në krijimin e botës ka luajtur një rol shumë të madh, ndërsa më vonë është pranuar si një lloj shpirti botëror. Në krahasim me të kaluarën konsiderata ndaj Zotit Shiva dhe Vishnu është rritur më tepër dhe kanë hyrë në klasën e zotërave të mëdhenj. Shiva, që është njohur edhe me emrin Rudra (i kuq), në të kaluarën cilësohej si Zot i frikshëm. Njihej si zot dhunues dhe sensual. Ndërsa si zot i prodhimit ishte phallus (organi gjeneral i mashkullit) dhe kau. Ganesha, që njihet si djali i tij, pranoheshte si zot i shiut dhe i bimëve.

Më kryesoja nga krijesat, për të cilat indusët kanë respekt të veçantë dhe të cilave u vishet shenjtëri e caktuar ose fuqi mbinatyrore, janë shfaqjet e ndryshme të natyrës. Gjithashtu të shenjta llogariten edhe toka-nënë, disa male (Kajlasa, Himalaja), gurëzit në forma të çuditshme (për shembull, *phallusi* i Shivasë) dhe disa lumenj (Gang, Jamuna etj.). Po ashtu të shenjta janë edhe bimët speciale (druri i fikut, tulsistaude etj.) dhe kafshët (majmuni, krokodili, gjarpëri etj.), sidomos të shenjta janë edhe lopët, të cilat nuk lejohet që askush t'i mbytë. Disa fraksione prijësit e tyre i respektojnë duke ju veshur shenjtëri. Për t'iu ndihmuar trimave dhe të shenjtëve bëhen lutje. Fshatarët, si zakonisht, besojnë se forcat ndikojnë vetëm rreth e përqark tyre dhe zotërave lokalë të fshatit (Grama-Devatas) ju dhurojnë sakrificë. Besojnë në ekzistencën e xhinëve (Rakshasa, Bhuta etj.) dhe frikësohen prej tyre. Kalimi në ekzistencat e lartësuara të panteonit bëhet me qeniet gjysëmhyjnore si Gandharva (muzicentët hyjnorë), Apsara (zanë e bukur) dhe Jaksha (shpirti i deposë). Besohet edhe në ekzistencën e shumë hyjneshave, të cilat sjellin dhe shmangin sëmundjen.

Shumë zotëra që kanë luajtur rol të rëndësishëm në periudhën e Vedave, sot e kanë humbur

rëndësinë e tyre. Atyre iu bëhet rrallë herë ndonjë lutje. Sa për ilustrim mund të përmendim vetëm Ashvinin, i cili i ndihmon ata që janë në rrezik, Mitranë, mbrojtësi i shoqërisë, Pushanin, zotin e rrugëve dhe Vishvakarman, zotin e artit.

Besohet se zotërat përkujdesen për qenie të caktuara natyrore. Surja është sundues i diellit, Soma i hënës, Vaju i erës, Varuna i ujit, Indra i shiut, Agni i zjarrit, Jama i botës së të vdekurve, Kubera i thesarit.

Në Veda, Indra është një shembull qiellor, hyjnor i luftëtarëve. Ndërsa Agni është prifti i kurbanëve të zotërave. Kama, që sot me një hark dhe një shigjetë prej luleje vizatohet i hipur mbi një papagall, në Veda është zoti i dashurisë. Njëri prej zotërave më të dashur është edhe Ganesha; është me fytyrë të një mashkulli me kokë elefanti dhe me trup të madh. Kafsha për bartje është miu. Atij i bëhet lutje që t'i zhdukë pengesat. Për këtë, edhe lutjet që i përshkruhen Ganeshasë dhe rrezatimet për të, zbukurojnë fillimin e shumë librave indianë. Skanda, është zot i luftës, së cilës i thuhet edhe Kartikeje ose Subrahmanja dhe ka shumë simpatizues në Rajonin e Dravidëve.

Në krye të panteonit gjenden tre zotëra: Brahma, Vishnu dhe Shiva. Brahma simbolizon krijimin e botës, Vishnu mbrojtjen, ndërsa Shiva shkatërrimin. Por ky koncept është plotësisht një mendim filozofik; nuk ka shumë ndikim në jetën fetare. Në përgjithësi ajo që mendohet për Brahma, nuk është zoti më i lart i brahmanizmit. Ai është vetëm një mjeshër (демиург), i cili me urdhërin e Zotit të Madh Ishvarasë i jep formë botës. Në literaturën e vjetër kjo nuk ekziston. Atij i janë veshur mitologjitë e vjetra në lidhje me zotin e krijesave Prajapati dhe krijesave të tjera. Besohet se udhëtimin e ka bërë i hipur në një rosë. Ndërsa gruaja e tij Sarasvati është zoti i urtësisë. Vendet e pakta për kultin e saj tregojnë se ajo nuk zë shumë vend në zemrat e indusëve.

Zotat më të lartë të indusëve janë Vishnu dhe Shiva. Edhe pse shumë krijesa qiellore janë të përcaktuara për mishërim, dashamirët e tyre besojnë se janë të përhershëm dhe se kanë mbetur jashtë Karmasë. Për Vishnunë tregohet edhe në Vedatë. Vetëm se ndonjëherë rastiset në pikturat e saj të udhëtimit hipur në shqiponjën Gradu, që është bartës i topuzit, guacës, lotos dhe diskut. Shumica e vizatimeve janë përshkrim i pushimit të tij mbi përbindshin e botës. Gruaja e tij Lakshmi (Shri), që është zot i bukurisë dhe historisë, në përgjithësi u bën masazh këmbëve të burrit të saj. Besohet se Vishnu për të shpëtuar njeriun, për të zhdukur fatkeqësitë, shumë herë merr pamjen e njeriut dhe kafshëve. Lajmet se shndërrohet në formën e peshkut, se do të shpëtohet prej babait të dytë të njerëzimit Manusë dhe se në fund do të kthehet si Kalki, janë disa nga këto legjenda.

Shiva, para Rudrasë, zotit të furtunës sipas Vedave, dhe Arjave, është bashkuar edhe me shumë zotëra të tjerë. Ai përshkruhet si asket me një apo me pesë kokë mbi të cilat është hedhur pluhur ose një zinxhir i përbërë nga kafkat e njerëzve. Në katër duart e tij si simbol mban një fletë, një shtizë dhe një daulle. Ai në anën tjetër me simbolin e *phollusit* (linga) është edhe babai i madh. Në fund, ai është një asket që bën jogë. Gruaja e tij është Parvati (Vajza e malit). Shiva, gjithashtu përshkruhet edhe si një qenie që sjell shpëtim dhe mëshirë. Gruaja e tij Parvati në të shumtën e rasteve njihet edhe me ofiqin Durga. Ajo posedon edhe natyrën e butë edhe natyrën e egër. Në kohën më të hershme për të sakrifikohet për të fituar mëshirën e këtij luftëtari legjendar, që mund të t'u bëjë ballë demonëve. Në anën tjetër ajo respektohet edhe si nënë e mëshirshme që ju siguron ushqim të gjitha krijesave të gjalla.

Mendimet për zotrat ndryshojnë sipas shkollave dhe fraksioneve të ndryshme. Sipas mësimëve të Karmamimanzasë dhe Sankjasë klasike të gjithë zotrat pa përjashtim i nënshtrohen reinkarnacionit. Për këtë arsye parimi i qiellit më të lartë është ligji Karma. Të gjithë punët e mira dhe të këqija në mënyrë automatike do ta marrin shpërblimin dhe dënimin. Ndërsa një pjesë e indusëve janë monoteistë, sepse, besojnë në Zotin e përhershëm të universit me emrin Ishvara dhe se të gjitha krijesat tjera të lartësuara janë shërbyesit dhe nëpunësit e vdekshëm. Ndërsa bota dhe marrëdhëniet me Zotin mendohen në forma të ndryshme.

Sistemi i besimit indian shkurtimisht mund të përmblihet në këtë Kredo të Mahatma Gandhi-t:

“Unë veten e quaj një Indu Sanatani. Për shkak se unë besoj në Veda, Upanishada, Purana dhe në të gjithë shkrimet indiane dhe në avatara (rimishërimi i zotit brenda krijesave të ndryshme) dhe në reinkarnacion. Unë gjithashtu brenda të kuptuarit të Vedave besoj në vernashrama (sistemi indian i kastave dhe kategoritë e jetës)”¹⁹⁷

Kredon e Gandhit mund ta sistemojmë në këtë formë: Indiuzmi është respektim dhe besim:

¹⁹⁷ Lahnean, f.19.

1. në të gjitha shkrimet e shenjta, duke përfshirë edhe shkrimet jashta hinduizmit;
 2. në shfaqjet e ndryshme hyjnore;
 3. në konceptin e rilindjes (reinkarnacion);
 4. në sistemin e kastave, që është sistem shoqëror dhe fetar;
 5. në konceptin e shkallëve të jetës;
 6. në krijesat e shenjta jashtë njeriut (si që është respektimi i lopës);
 7. në idhujt (me piktura të zotit).
- Të gjithë këto manifestojnë shkrimet e shenjta indiane.

d. Kulti, adhurimi

Simboli i përbashkët të të gjithë indianët është shkrimi sanskritisht dhe i stolitur i fjalës “Om”. Këto tre shkronja (“a, u, m”) që ndjekin njëra tjetrën dhe që gjenden në fillim të çdo teksti fetar, shprehin Brahman apo treshin Vishnu, Shiva dhe Brahman. Për këtë çështje bëhen komentime të ndryshme.

Arjatë, pjestarët e Vedave, besojnë se mbi ta janë ulur zotëra të padukshëm dhe u luten zotërave para të cilëve janë përhapur kullosat dhe që gjenden në vendet në hapësirë ku theren kurbanët. Përmbajtjen e adhurimeve e përbëjnë zjarri që digjet në emër të zotërave, drithrat, pasta, kafsha e therur dhe shërbimi i pijes soma (pije alkoolike). Edhe pse edhe sot si në kohën e Vedave, për ata sakrifikohet, por që nga Periudha e Epenit dhe Puranasë janë bërë disa ndryshime. Në Tempuj, përpara simboleve dhe vizatimeve që përfaqësojnë Zotin, bëhen shumë lëvizje. Besohet se me këndimin e himneve fetare, larjen, zbukurimin dhe shenjtërimin e idhujve, me ndërrimin e dritave, me ndezjen e fumiganteve (lule që përdoret për shërbim zotit) dhe me dhurimin e pijeve dhe ushqimeve bimore do t'i kënaqin qeniet qiellore. Flijimi i kafshëve sot bëhet vetëm për disa zotëra si Durga. Ditëve të festave ata, me qerre të mrekullueshme dhe të zbukuruara me statujat dhe vizatimet e zotit, ceremonialisht shëtiten nëpër rrugët e qytetit dhe fshatit. Festa më e njohur është Divali. Në këtë festë për hirë të Lakshmit shtëpitë dhe rrugët zbukurohen me llamba. Ndërsa në festën Holi, indianët në veten e tyre derdhin ujë të ngjyrosur me të kuqe. Përveç festave të panumërta të zotërave, në jetën e indianëve rol të rëndësishëm luajnë edhe vizitat në vendet e shenjta dhe udhëtimi për pelegrinazh. Pelegrinët bëjnë banjo në vendet e shenjta, e sidomos në ujërat e shenjta si Benares, Mathure dhe Allahabad.

E tërë jeta e një indusi varet prej realizimit të disa ceremonive të caktuara prej lindjes e deri në vdekje. Edukimi shpirtëror dhe pastërtia, realizimi i premtimeve dhe meditacioni ndihmojnë në ndriçimin e zemrës dhe në fitimin e një Karmaje të mirë. Trupat e të vdekurve në Periudhën e Vedave pjesërisht varroseshin e pjesërisht digjeshin. Ndërsa sot përveç asketëve (trupi i të cilëve varrosët me pozitë të përlur në gjuhë), trupi i të gjithëve digjet. Djegja e vejushave asnjëherë nuk ka qenë një rregull i përgjithshëm. Vetëm se deri më 1829, kur edhe vijnë anglezët, kjo traditë në sarajet e princave përsëritej shpesh. Krahas të gjitha ndalesave, edhe sot mund të rastiset në traditën e djegjes së vejushave. Besohet se në fund të kësaj ceremonie gruaja në qiell do të bashkohet me burrin e saj. Vejushat porositen që në vend që të digjen, të mos marthohen.

Hinduizmi nuk njih një institucion të profetësisë. Për ta rregullat, traditat dhe obligimet e *sistemit kastian* janë më të rëndësishme se besimi dhe hyjnia. Nuk ka një institucion fetar që do të përcaktojë pjesën e besimit dhe punën në fe siç është priftëria dhe të ngjashme me të. Shumica respektojnë zotra të panumërt lokalë. Sidomos nëpër fshatra atyre iu bëhen sakrificë ushqimet si oriz, pemë etj. Zotrat e mëdhenj gjenden në tempuj të zbukuruar në formë të pikturave dhe statujave. Në çdo mëngjez me zërin e këmbanës zgjohen, vishen dhe ushqehen me sakrificat e realizuara. Në ditët e festave shëtisin nëpër rrugë të ulur nëpër qerre.

dh. Priftëria

Indusët kanë klasën e priftërinjëve që është trashëgimi prej babait të djali dhe quhen brahmanë. Edhe pse numri i pjesëtarëve të kësaj klase është i madh (15 milionë), vetëm një numër i vogël i tyre punon nëpër tempuj dhe shërbime fetare. Ndërsa shumica tjetër merret me profesione të ndryshme.

Kurse priftërinjtë, asketët dhe të vetmuarit e lirë (sadhu, sannjasi), që jetojnë në manastire të rëndeve dhe drejtimeve të ndryshme, janë në shërbim të popullit.

e. Jeta shoqërore

Për indusët doktrina Karma është shkaku i vetëm i ndarjes mes të gjitha gjallesave. Të gjithë janë të dënuar të respektojnë ndarjen nga varen që nga fillimi (eterniteti). Sepse ligji i përhershëm i gjithësisë (karma), siç besojnë të gjithë drejtimit induse i detyron që të klasifikohen dhe të ndahen në klasa, të gjitha gjallesat duke filluar prej zotërave e deri te bimët. Përsëri ky ligj ka formuar forma të qëndrueshme të Sistemit Kastian, i cili përbën bazën e sistemit shoqëror indian, ashtu siç është edhe në fe. Kasta është një grup individësh të cilët janë të lidhur njëri me tjetrin me tradita, me obligime dhe me të drejta të trashëguara nga paraardhësit dhe që merren me të njëjtën punë. Kasta nuk zgjedhet, por në të njeriu lind, dhe atë duhte ta mbrojë. Martohet me njerëzit e të njëjtës kastë dhe ulet të hajë po me të njëjtë. Kjo nuk është vetëm një çështje fetare, por në të njëjtën kohë është edhe çështje ekonomike. Edhe profesionet janë të ndara në bazë të saj. Sidomos dobia e tre kastave të klasave të pastra si e priftërinjve, e ushtarëve dhe e bujqve, është shumë e madhe. Klasa më e lartë janë priftërinjtë (brahmanët), detyrë e të cilëve është mësuesia dhe detyrat fetare. Për të ruajtur pastërtinë fetare në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, në banjo dhe në ushqim, ka urdhëra të shkruara shumë strikte. Klasa e dytë me rëndësi, është klasa e luftëtarëve e quajtur Kshatrija. Në këtë klasë përfshihen mbretërit dhe punëtorët e shtetit, të cilët janë përgjegjës për rritjen dhe shtimin e fuqisë fizike. Klasa e tretë është ajo e bujqve dhe e zejtarëve dhe quhet Vaishja. Fusha të veprimit të pjesëtarëve të saj janë profesionet si blegtoaria, bujqësia dhe tregtia.

Atyre që lindin në këto tre kasta të larta ju bëhet një lloj ceremonie që quhet lindje e dytë. Për këtë dhe ju thuhet “ata që kanë lindur dy herë”. Ndërsa përveç këtyre, shumica e cila quhet Shudra, punon në profesione të ndryshme dhe është përgjegjëse për shërbimet ndaj atyre që kanë lindur dy herë. Përsëri këto kasta, sipas shkallës së pastërtisë që i jepet profesionit, ndahen në shumë pjesë. Një pjesë që nuk konsiderohet e pastër në aspektin fetar shihet si Parja (të paprekshmit). Për shembull, ata që mbysin gjallesa si peshkatarët dhe kasapët llogariten më të ulët se ata që bëjnë enë prej balte. Ndërsa anëtarët e grupeve më të ulëta të shoqërisë indiane që përbëjnë pjesën e pestë dhe quhen Panxham, janë posedues të profesioneve që llogariten të papastra si pastrues të qytetit, pastrues të banjove dhe si hajdutë. Klasa e atyre që nuk janë indusë, është më e ulët nga të gjitha. Kështu që ata nuk kanë asnjëfarë kaste.

Sipas botëkuptimit indian, kjo hierarki është një strukturë që plotësisht i takon ligjit të përhershëm të universit. Çdo kastë ka rregulla speciale të saj për ceremonitë e dasmës dhe fejesës, ushqimit, pijes, veshjes dhe profesionit. Të kundërshtosh një sistem kastian, mund të jetë shkak për nxerrjen prej tij, gjegjësisht mund të jetë shkak për zhdukjen fizikisht. Natyrisht zhvillimi teknologjik dhe industrializimi kanë bërë që të luhatet ekzistenca e kastave të Indisë moderne. Për shembull, praktikimi i rregullave të ushqimit gjendet vetëm në mesin e fshatarëve. Kushtetuta e Indisë më 1949, për shkak të asaj që është në kundërshtim me zhvillimin, ka ndaluar klasën Parja me 70 milion banorë dhe klasën e atyre që s’kanë kastë. Ndërsa në çështjen e martesës sistemin kastian e praktikojnë në mënyrë të rreptë.

ë. Koncepti për botën e ardhshme

Kur ndonjëri vdes, shpirti i tij mbështillet në një trup të hollë të padukshëm, si një krijesë e re. Nëse në këtë nuk arrin sukses, atëherë shëtit rreth e përqark si fantazmë (Preta) dhe urinë e saj e shuan me kurbanët e të vdekurve, që ua kanë dhuruar të afërmit e tyre. Nëse veprat, sjelljet janë shumë të këqia, ringjallje mund të bëhet edhe në këtë botë, ose, me mijëra vite jeta e ferrit këtë mund ta stagnojë. Të mirët, si kundërvlerë të punëve të tyre, një periudhë të shkurtër ose të gjatë jetojnë në botën qiellore. Ndërsa gjendja e atyre që janë shpëtuar nga rrethi i inkarnacionit konceptohet në forma të ndryshme. Sipas shumicës së sistemit vishnuist dhe shivaist, ata në një botë mbinatyrore jetojnë të përhershëm në praninë e Zotit. Ndërsa fraksionet Sankhja, Njaja-Vaisheshika dhe Mimansa besojnë se shpirti i secilit, i ndarë plotësisht nga kjo botë, jeton një jetë speciale. Ndërsa sipas Shankarasë shpirti individual,

plotësisht zhduket në shpirtin kolektiv.

g. Zhvillimi i hinduizmit dhe rrymat e reja

Në shek. e VIII dhe IX të erës sonë, nga reformatori dhe filozofi Shankara u bënë komentime të reja të teksteve të vjetra të Vedave. Sipas tij, Brahma ishte një tërësi jo një person, një hyjni-zot. Ky mendim në mesin e brahmanëve ortodoksë pati një jehonë të madhe. Ndërsa ata që adhuronin Shivanë, Shankaranë, edhe pse ky adhuronte hyjneshën kryesore Shaktinë, e shihnin si një inkarnacion të Shivasë. Dituria e Shankarasë ndahet në të ulët dhe të lartë. Dituria e ulët botën e pranon si realitet. Ndërsa dituria e lartë pranon se bota është një ëndërr dhe se udhëhiqet vetëm nga ana e shpirtit. Në shkallën e diturisë së lartë dhe në Brahma mund të arrihet vetëm me të menduarit dhe të studiuarit e Vedave.

Një reformator tjetër është Ramanuja, i cili ka jetuar 200 vjet pas Shankarasë. Sipas tij Brahman është trupëzimi i Vishnusë dhe deri te bukuria hyjnore dhe qiellore, apo në hyjni mund të arrihet me dashuri hyjnore dhe me nënshtrim të plotë ndaj saj.

Rrymat e mendimit bashkëkohor dhe aktivitetet misionare janë shkak i lindjes së lëvizjeve të reja në hinduizëm. Me përhapjen e aktiviteteve të tyre jashtë Indisë kanë tërhequr vëmendjen (e opinionit) për ta. Nga këto më të rëndësishme janë lëvizja Meditacioni Transhendental dhe Hare Krishna.

Meditacioni transcendent

Literatura: Reller, 591-608. Friedrich W. Haack, 183-215. J. Lahemann, 74-78.

Më 1958 në Madras nga ana e priftit hindus Maharishi Mahesh Jogi themelohet një lëvizje fetare e mbështetur në teknikën e meditacionit me emrin “Lëvizja për ripërtrirje shpirtërore”. Kjo ka për qëllim përhapjen e bazave shpirtërore në tërë botën. Emri “Maharishi Mahesh Jogi” është një titull për lartësim dhe pozitë fetare. Maharishi ka kuptimin “Prijës i Madh”, “Fallxhi i Madh”. Mahesh është emri special i tij, ndërsa Jogi është një titull që shpreh ushtrimin joga të hindusëve. Emri origjinal i themeluesit është Mahesh Prasad Warma.

Maharishi Mahesh Jogi programin e tij e mbështet në mësuesin e tij Swami Brahmananda Saraswari, që njihet me ofiqin Guru Dev. Guru Dev është përfaqësues i Shankaracharjasë, që është trashëgim shpirtëror i Shanakarasë (rreth vitit 800 të e. s.). Maharishi është bërë i njohur me komentimet dhe përkthimet e tij në diskutimet që kanë lindur në lidhje me komentimin e drejt të Bhagavadgitasë. Ky komentim numërohet si “Ringjallje e diturisë së vjetër”. Pas kësaj filozofie fetare të “Meditacionit Transhendental” të mbështetur në njërin prej autoriteteve më të mëdha të historisë fetare indiane, Shankaranë, gjendet Doktrina Advaita. Në rënjen e teknikës së meditacionit gjendet Mantra-meditacioni dhe tantrizmi. Në esencën e mendimit fetar qëndron nxjerrja në shesh e hyjnores (Zotit) që gjendet njeriu. Sipas kësaj:

a. Ajo është bashkimi i rrugës Joga me absoluten. Jo shpëputje nga bota, por, zgjedhje të vetëdijshme të rrugës së jetës aktive.

b. Ajo është besimi në forcën dhe pakufijshmërinë e thellësisë së vetëdijes njerëzore.

Maharishi Mahesh Jogi ka lindur rreth vitit 1918 dhe ka mësuar edukimin fizik. Më vonë ka marrë pjesë në grupin e nxënësve të Guru Devit. Me vdekjen e mësuesit të tij më 1953, dy vjet tërhiqet në vetmi në Himalaje dhe pastaj duke e lënë jetën asketike është shpërngulur në Indinë Jugore, ku ka filluar me ligjëratat dhe konferencat e tij. Më 1959 aktivitetet e tij misionerike i ka përsheptuar dhe në vende të ndryshme të botës. Krahas asaj që në vendin e tij në Indi nuk kishte shumë simpati, ai shumë përkrahës gjeti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë. Më 1976 numri i simpatizuesve të “Meditacionit Transhendental” në ShBA kishte kaluar milionin.

Maharishi duke vënë theksin mbi ripërtrirjen shpirtërore i ka shtuar edhe sqarimet e dukshme “shkencore”. Ai thoshte se me Meditacionin Transhendental komunisti bëhet komunist më i mirë, i

krishteri bëhet i krishter më i mirë. Hinduizmi në mendimin fetar dhe botëror luan një rol shumë të rëndësishëm. Më 1973 në ShBA themelon universitetin privat “Maharishi International University”. Me meditacionet drejtuar Zotit Brahma mbrohet teoria se do të zhduken krimet në tokë, fatkeqësitë në trafik, luftërat, fatkeqësitë, do të pakësohet skamja dhe se do të shtohen paqa dhe qetësia.

Sado që ata, për të mos ua tërhequr vëmendëjn grupeve fetare, të thonë se nuk janë një lëvizje fetare e ndarë, Gjykata e New Jersey-t me vendimin e marrur më datën 19.10.1977, ata i pranon si fe më vete dhe i ka regjistruar. Ata e mbrojnë atë se ka filluar Periudha e Iluminizmit Botëror dhe për këtë kanë përcaktuar një “Qeveri Botërore dhe një Kryetar”. Mendojmë se me një teknikë të quajtur “Siddhi-Programm” mund të arrihen “aftësi mbinatyrore” si fluturimi, të bërit i padukshëm, të depërtosh nëpër murë. Ky sistem është themeluar mbi filozofinë fetare indiane.¹⁹⁸ Anëtarët e fraksionit të ri nuk duan që të ndahen nga fetë e vjetra. Vetëm se, gradualisht duke u edukuar mundohen të vënë themelet e filozofisë së tyre. Rituale të bëhen përpara fotografisë së Guru Devit. Flijohen lule dhe pemë. Njerëzit për të arritur deri te Brahma i drejtohen fuqisë magjike dhe shpirtërore. Njeriu, për të zhdukur karman e keqe dhe për të grumbulluar karman e mirë, u kthehet lëvizjeve pozitive. Kanë shumë organizata nacionale dhe internacionale. Ata mundohen që ta fshehin dhe të mos tregojnë se janë një fraksion i hinduizmit. Ata mundohen të bëjnë përshtypjen se janë prodhim i një programi shkencor. Konceptet e tyre për universin i përbën filozofia indiane.

Hare Krishna

Kjo është vazhdim në Perëndim i fraksionit Krishna Indiane. Esencën e besimit e përbën respekti i Krishnas i cili është avatara e njobur e Zotit Vishnu. Krishna, si krijues i çdo gjëje, gjindet në çdo gjallesë. Lëvizja llogaritet si çelës i rrugës hyjnore. “Bhakti” do të thotë nënshtrim Zotit. Krishna historik është vazhdim i lëvizjes. Kjo lëvizje në të kaluarën zgjatet deri te prifti bengalas Sri Caitanja (1486-1534). Përfaqësuesi dhe themeluesi i sotëm është Guru Swami Prabhupoda (1896-1977). Ai në Universitetin e Kalkutës ka studiuar gjuhën angleze, filozofinë dhe tregtinë dhe është diplomuar më 1926. Një kohë ka qenë udhëbëqës i tregtisë dhe i fabrikës. Ai, i obliguar nga mësuesi i tij Bhaktisidanta Saraswati, më 1965 në moshën 70 vjeçare për të përhapur besimin në Zotin Krishna shkoi në New York. Filloi të thotë një këngë monotone:

*“Hare Krishna, hare Krishna
Krishna Krishna, hare hare
Hare Rama, hare Rama
Rama Rama hare hare...”*

Në New York formoi qendrën misionerike (1966). Tha se ka filluar periudha e iluminizmit botëror. Filozofia themelore e fraksionit mbështetet në hinduizëm. Rruga e plasuar, përveç që është një sistem i pastër fetar, është edhe një paraqitje teknike në drejtim të përforcimit të inteligjencës, qëndrueshmërisë dhe durimit, të largimit nga entuziazmi dhe stresi, ofrimin të qetësisë të personalitetit njerëzor. Ajo është një strehimore për të rinjtë që kanë frikë provimi, brengë dashurie dhe nga zënkat brenda në familje. Prabhupoda, si gurutë e tjerë indianë, beson se Vedat janë shpallje. Liderët fetarë llogariten si fotografi lejendash të vetë Krishnasë, Brahmasë apo Noradasë dhe Jasudevasë. Vjasa llogaritet si Guru-Polar, i cili i ngjallë shpalljet e shenjtja në kohë të ndryshme. E njëjta vazhdon edhe për Narada-në. Të dy janë bartës të udhëzimit hyjnor. Ata propagandojnë madhësinë e Krishnas.

Sot është periudha e keqe “Kali-Juga” e kohës së Fundit. Edhe vetë ai është një lloj Shpëtimtari Hindus. Swami Prabhupoda dhe nxënësit e tij thonë se nuk janë as indusë e as nga India dhe as që janë ndonjë popull tjetër, por propaganda e tyre është e pavarur dhe ata janë shprehje e të vërtetës themelore të të gjitha feve. Përmbajtja e shkrimeve është përmbajtja e vedave indiane. Sipas sqarimeve:

1. Librat e shenjtë botëror si Dhiata e Vjetër, Dhiata e Re dhe Kur’ani përmbajnë të vërtetat absolute. Vetëm se Vedat janë dokumente më të vjetra të shpallura në botë. Sidomos Bhagavat Gita është vetë fjalë e Zotit.

2. Zoti apo Krishna është i përhershëm, ai di çdo gjë dhe gjendet në çdo vend, është i fuqishëm dhe çdo gjallesë i jep jetë. Ai në dorë mban forcën e tërë universit.

3. Njeriu është një pjesë e qenies shpirtërore të Zotit, prandaj nuk është kalimtar.

4. Të gjithë njerëzit janë vëllezër. Babai i të gjithë njerëzve është Zoti.

5. Para ushqimit, prej çdo artikulli ushqimor mund t’i bëjmë fli Zotit.

¹⁹⁸ Reller, 591-608; Haack, 183-215; Lahnemann, 78-85.

Njerëzimi tash është duke jetuar në Kali Juga (një periudhë në të cilën të këqijat e Kobës së Fundit kanë arritur në zenit), larg Zotit dhe në një rrëmujë. Rruga e shpëtimit është gjetja e Zotit dhe përmendja e emrave të Tij. Me këndimin e këngës Hare Krishna shpirti mbushet me vetëdije të përshërshme. Kjo është nënshtrim i dashurisë dhe i robërisë. Me këtë përsëri fillon cikli lindje-vdekje, ndërpritet reinkarnacioni dhe shpirti arrinë lumturinë. Zoti dhe Krijuesi i universit është Zoti Krishna. I gjithë panteoni indian ka lindur nga ai. Gjysëmhyjnia e Indrasë, Varunasë, Agnisë, Rudrasë dhe Brahmasë janë shkallë të gjysëmhyjnise së Tij. Përbajtja e çdo krijese është vetë Krishna. Është përbajtja e lumturisë. Krishna është një ekzistencë që nuk mund ta prekë dhe nuk mund ta arrijë materia. Besimi në materie rrjedh nga injoranca (Avidja) që është një iluzion, mashtrim, përgënjeshttrim. Njeriu e çon në brendësi të karmasë. Shpëtimi arrihet vetëm me anë të Vidjasë (dituri dhe ndriçim). Dituria i shpallet njeriut që kërkohet nga vetë Krishna. Kjo arrihet vetëm me dashuri dhe nënshtrim. Shpirti shpëton nga materia dhe njeriu karshi Zotit jeton i përshërshëm. Kështu që mohohet monizmi absolut i Shankarasë dhe dualizmi i papersonalitetit i Sankjasë. Më thënie në mënyrë të përsëritur të këngës Krishna hapet rruga e njerëzimit. Vetëm se këtu ka nevojë për një liderizim apo për një udhëbeqe të një gurni. Ai e siguron rrugën e shpëtimit. Gurutë janë dhunti të dukshme të Krishnasë. Janë të shenjtët e Zotit. Krishna flet me gojën e tyre. Fjalët e tyre janë të vërteta dhe të pagabueshme. Në shtetet Perëndimore dhe në Amerikë qendrat e tempujve shtohen çdo ditë. Qendra kryesore është në Los Anxhelos.¹⁹⁹ Jetën e kalojnë me të lypur. Jetojnë një jetë vegjeteriane.

gj. Qëndrimi i hinduizmit ndaj feve të tjera

Shikimin e hinduizmit ndaj feve të tjera mund ta përmbledhim me sa vijon: dogmatik dhe pajtues e pluralist. Fetë e tjera sipas hinduizmit janë të një kohe të njëjtë. Vetëm se këto qëndrime të përafërta nuk përfaqësohen në masë të barabartë. Më tepër peshë ka qëndrimi dogmatik:

1. Në mendimin dogmatik hindus themelin e pluralizmit fetar e përbën koncepti “sanatana dharma”. Sipas kësaj, sistemet e tyre, rrugën e pafillim të dhe të pambarimtë e shohin si fe universale, natyrore. Ai është një sistem i një strukture të lartë që përfshin sistemet e të gjithë besimeve, sistem i besimit universal ose është një sistem meta-fe. Ndërsa fetë e tjera llogariten fraksione të hinduizmit, si shivaizmi, vishnuizmi, tantrizmi etj. Kurse ata që nuk i njohin dhe nuk i pranojnë Vedat janë “heretikë”.
2. Një prej përfaqësuesve të pluralizmit dhe pajtueshmërisë është Ramakrishna (1836-1888). Ata qenien e traditës së shumë feve në tokë e shohin si dhunti dhe mirësi të Zotit dhënë njeriut dhe besojnë se njeriu do të arrijë idealin e tij më të lartë dhe të kuptuarit hyjnor. Ai thotë se edhe sikur sistemet e ibadeteve të jenë të ndara, qëllimi i sistemeve fetare është i njëjtë. Pasuesit e Ramakrishnasë komentojnë se fetë e tjera janë pozitive por, janë të pamjaftueshme në arritjen e shpëtimit.

Sipas Vivekanandasë, të gjithë themeluesit e feve në botë si Jezusi, Muhamedi etj., janë nga një avatara e Zotit. Çdonjëra është një sistem fetar i formuar nga ana e Zotit. Ndërsa sipas Gandhit, në esencën e feve nuk ka dallim. Dallimi është vetëm në syrin e njeriut i cili mundohet të përkapë këtë realitet. Të gjithë peygamberët meritojnë respekt. Me rëndësi është shpëtimi i shpirtit. Njeriu është i lirë në zgjedhjen e Zotit të cilin do ta adhurojë.²⁰⁰

¹⁹⁹ Reller, 627-648; Haack, 82-91.

²⁰⁰ Ali İhsan Yitik, *Hinduizm'in Diğer Dinlere Bakışı*, II: Türkiye Dinler Tarihi Sempozyumu, 8-9 Nëntor 1996.

2. Jogizmi

Literatura: James Hewitt, *Yoga*, Londër 1970; Sophy Hoare, *Yoga*, Stamboll 1978.

Joga është edukatë e dëshirës krijuese psiko-teknike dhe ka kuptimin “gjimnastikë”. Kjo, njeriut, me qëllim që ai të arrijë njohuritë e larta që do ta çojnë në qetësim dhe rehatllëk, i mëson që me të menduarit, me ekstazë dhe me hipnozë të koncentrohet në një pikë dhe që mendimin e tij ta orientojë drejt pikave të caktuara. Vetëdijen dhe ndjenjat i përdor vetëm si mjet për të arritur në ndjenjat më të larta. Edhe pse nuk është zbuluar data e themelimit të Jogasë si një sistem, ekzistencën e saj që në kohët më të hershme e vërteton një statujë perëndie në pozitën e Jogas, që ka dalë në shesh në gjurmimet që janë bërë në rajonin e Indus. Sipas shpjegimeve të bëra, kjo statujë tregon se në vitin 2500 para erës sonë, populli që ka jetuar para Arjave në rajonin Indus e ka përdorur ushtrimin joga. Edhe në Vedat tregohet se zotrat dhe njerëzit e urtë, në sajë të koncentrimin shpirtëror, fitojnë forcë për të bërë vepra mistere. Në periudhën e mëvonshme mendimet për Jogan janë zhvilluar edhe më tepër. Joga nuk është një mendim dhe një teknikë e posaçme vetëm për indusët. Në zhvillimin e saj vend të rëndësishëm zënë edhe xhajnistët dhe budistët. Indusët me këtë metod të të menduarit dëshirojnë të formojnë lidhje me Vishnu dhe Shiva dhe të bashkohen me Absoluten Abstrakte; ndërsa xhajnistët dhe budistët këtë teknikë e shohin si shpëtim dhe udhëzim.

Në sistemin Joga janë përvetësuar mendimet filozofike të Shankjasë në lidhje me kozmologjinë, fiziologjinë dhe psikologjinë. Ajo që Jogan e ndanë nga Shankja është se, Shankja e kundërshton mendimin ateist, ndërsa ekstazën dhe hipnozën i pranon si zgjidhje më me influencë për të arritur diturinë që çon në shpëtim. Qëllimi i orientimit drejt një zoti personal të sistemit Joga është që t'i kënaqë ata që besojnë në Zotin. Sipas Jogasë, ekzistenca e Zotit është e njëjtë me shpirtin e pafillim dhe pambarim të njeriut. Dallimi në mes Zotit dhe njeriut është në marrëdhëniet me materien. Marrëdhëniet e Zotit me materien nuk janë ndërprerë krejtësisht, siç është rasti me shpirtërat e shpëtuar. Sikur të ishte ashtu atëherë në Zotin nuk do të kishte vetëdije. Megjithatë, Ai është i pastër nga elementet materiale dhe është bashkuar me një substancë origjinale dhe të pastër. Për këtë Ai është pronar i urtësisë dhe i forcës së lartë. Atij i mungon cilësia e lindjes, e mëkatit dhe e shpërblimit.

Librat të cilët shqyrtojnë këtë sistem, kanë shqyrtuar në imtësi edhe atë se si mund të koncentrohen mendimet në një pikë; si mund t'i tërheqim dhe t'i paaftësojmë ndjenjat nga lëndët që janë shkak për shqisat; si mund të anulohen mendimet që u janë nënshtruar ndikimeve të botës së jashtme dhe si mund të koncentrohen ato në atman. Thuhet se, kur ushtrimet Joga të bëhen në mënyrë të rregullt, e shpëtojnë njeriun nga aspiratat natyrore, ia mundësojnë të arrijë diturinë e udhëzimit dhe ia zhdukin vështirësitë. Hipnoza që mund të ngrihet në lartësi dhe të zbresë në thellësi, pengon që mendimet të shpërndahen në drejtime të tjera. Edukimi Joga përbëhet nga një sërë fazash nëpërmjet të cilave duhet të kalojnë ihtarët e saj. Në mesin e tyre ka lëvizje të ndryshme siç është të numërosh frymëmarrjen, të ndërprisësh frymëmarrjen dhe t'i përqëndrosh sytë në një pikë të caktuar, si në majë të hundës, në kërthizë etj., e cila quhet me emrin “asana”. Besohet se në Yoganidra (në gjumin e Jogas), që është ushtrim për humbjen e vetëdijes, jeta merr fund. Ndërkaq kjo nuk është asgjë tjetër vetëm se një gjumë hipnotik. Përsëri, forcimi i trupit sikur të jetë një copë dërrase, si rezultat i ngulitjes së syve në një pikë të vogël, quhet “trataka”. Ai që i bën këto ushtrime arrin në dituritë e larta. Me fuqinë e lartë shpërtërore shkrihen ndjenjat e urisë dhe etshmerisë, trupi nuk lëndohet me gjëra me majë të mprehta, trupi bëhet i padukshëm, mund të shëtisë nëpër hapësirë. Së fundi shpirti, ndahet plotësisht nga materia, zhduken forcat shpirtërore që grumbullojnë karma të reja në ndër dije. Shkenca e Jogasë është bërë themel i sistemit të mendimit edhe të xhajnizmit edhe të budizmit.

Joga klasike në hinduizëm është përcaktuar me 194 sentenca në veprën me titull “Yoga Sutra”. Autori i këtij teksti llogaritet të jetë i dituri Patanzhali. Nuk dihet se kur është shkruar vepra. Gjegjësisht indianët, Patanzhalin shkrimtarin e këtij libri, dhe gramaticientin Patanzhali që ka jetuar në shek. II. para erës sonë, i pranojnë si njerëz të njëjtë. Megjithatë, ka të tillë që supozojnë se Yoga Sutra është shkruar rreth viteve 420 të erës sonë dhe se shkrimtar i këtij libri është dikush tjetër e jo gramati-

cienti Patanzhali. Sot Yoga Sutra haset edhe në gjurmët e mendimit budist. Nëse Sutra mbështetet apo jo në një tekst më të vjetër është temë diskutabile.

Si në shumë sisteme edhe në sistemin Joga janë bërë përpjekje për reforma. Në vitin 1861 Shiv Dayal Singh, është inspiruar nga Kabiri dhe ka mësuar një misticizëm mbifetar dhe ka zhvilluar një Joga personale. Sot, komuniteti i tij me emrin “Radhasvamis”, jeton në Indinë Veriore.

Një doktrinë të re të Jogasë, nxënësve që janë grumbulluar rreth tij ua ka mësuar edhe Aurobindo Ghosh (1872-1950) nga Bengali. Ai në këtë ka kërkuar që me sintezën e mendimit perëndimor dhe indian, njeriun ta furnizojë me aftësi metafizike.

a. Ananda Marga

“Ananda Marga” mund të përkthehet si “Rruga e Lumturisë”. Ky komunitet u formua më 1955 në krahinën Bihar të Indisë. Ai pretendon të ndihmojë në përparimin social dhe shpirtëror të njerëzimit. Themeluesi i saj është Prabhata Ranzhana Sarkar. Ithtarët e tij i thonë “*Margji*”. Ka lindur më 1921 në një familje mesatare. Shkoi në lice në Kalkuta dhe deri në vdekjen e babait të tij punoi si “gazetar”. Pastaj hyri në grupin Tantra-Joga-Meditacion. Për ta zhvilluar edhe më tepër teknikën e vjetër të Jogas, u mor me psikologjinë dhe sociologjinë moderne. Vetveten e ka paraqitur si “manifestim të hyjnisë” (Taraka brahma). Fraksioni mbron mendimin se, individin dhe shoqërinë, me ushtrimet e Jogas dhe meditacionit, do t’i lartësojë moralisht do t’ua mundësojë arritjen e lumturisë. Mendohet se në botë ata kanë afër 2.5 milion simpatizues, të cilët gjenden në Indi, Amerikë dhe Evropë.

b. Lëvizja Neo-Sannyas Bhagawan Shree Rajneesh

Në lagjen Koregaon të qytetit Poona të Indisë gjenden ndërtesa të Organizatës Ashram. Këto ndërtesa, si Shtëpia e Krishnasë, Shtëpia e Zaratustrës, Shtëpia e Lao Tzësë përfaqësojnë shpirtin universal të komunitetit. Anëtarët e Ashramit janë përafërsisht 4/5 perëndimorë, 1/5 nga populli vendas. Lideri i komunitetit me emër “Bhagwan Shree Rajneesh Movement” pranohet si person i ngjashëm me zotin. Rajneesh Chandra Mohan ka lindur më 1931 në krahinën Madhya Pradesh. Në moshën 21 vjeçare përjetoi një “ndriçim”. Ai e ndjeu se Zoti i është zbuluar atij dhe i ka dhënë shpallje. Studimin filozofik në universitet e la më 1957. E filloi gazetarinë. E shëtiti vendin. I mësoi teknikat e meditacionit. Prej vitit 1966, si ligjërues (i lirë) filloi të shëtitet nëpër qytetet e mëdha të Indisë. Më 1969 nën mbrojtjen e nxënësve të tij formoi Ashramin e vet. Ceremonia-Tantra e tij filloi t’ia tërbeqë vëmendjen popullit. Në moshën 70 vjeçare filloi të vizitohet nga vizitues, shumicën e të cilëve e përbënin nxënësit amerikanë. Ligjëratat i mbante në gjuhën induse dhe anglisht. Pas një kobe nga reagimet e popullit mërgoi në Bombaj. Më 1974 u vendos në Poona, qytet i Universitetit. Formoi ashramin e hapur (për të gjithë). Si alternativë kundër psikologjisë perëndimore vendoi fraksionin Tantra-Joga. Sipas simpatizantëve ai është mjeshtër (profesor), avatara e Shivasë, manifestim i nivelit të ulët, zot në formë të njeriut. Në të njëjtën kohë, sipas tyre, ai është një profet, një guru. Si një profesionalist i Psiko-Teknikës moderne ai ka bashkuar rrugë të ndryshme mistike si Tantra, Zen dhe sufizmin, e ka realizuar sintezën Lindje-Perëndim, njerëzve ua ka mundësuar të arrijnë vetëdijen për ekzistencën kozmike. Simpatizues të tij shtohen në shtetet perëndimore.²⁰¹ Është e ditur se edhe në Stamboll ka një komunitet të vogël të tyre. Numri i simpatizantëve në botë supozohet të jetë deri më 300.000.

²⁰¹ Reller, 730-743; Haack, 128-146; Lahnemann, 85-93.

3. Xhajnizmi

Literatura: Ö. Hilmi Budda, *Hint Dinleri*, Stamboll 1953; Helmuth Von Glasenapp, *Die Religionen Indiens*, Tübingen 1943; H. Von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, f.114-120.

Xhajna themeluesi i xhajnizmit, është nga Kasti Kshatria, që është klasë e luftëtarëve dhe princave. Atij i është dhënë emri Xhina që ka kuptimin ngadhnyesi dhe emri Mahavira që ka kuptimin trimi i madh. Xhajna në shek. VI. para erës sonë ka bërë një jetë të thjeshtë, me edukim shpirtëror dhe nuk ka veshur asgjë. Është munduar që doktrinën e tij ta përhapë në mesin e popullit dhe ka përfituar shumë simpatizantë dhe nxënës. Sipas transmetimeve ai ka vdekur në moshën 72 vjeçare, në vendin e quajtur Pava.

a. Librat e shenjtë

Ligjëratat e Mahavirasë në fillim janë transmetuar gojarisht. Në vitin 300 para erës sonë në Pataliputra u mbledh një koncil, i cili punoi për grumbullimin e teksteve të humbura. Ata kanë grumbulluar një pjesë të teksteve, por nuk kanë mundur që të pengojnë zhdukjen e një pjese të madhe të transmetimeve. 980 vjet pas vdekjes së Mahavirasë, në Koncilin e të veshurve me të bardha të tubuar në Vallabhi, pjesët e mbetura të transmetimeve gojore janë përmbledhur në një libër me titull “Siddhanta”. Vepra është në gjuhën prakrite. Në parimet të cilave duhet t’u përshtaten priftërinjtë bëjnë pjesë legjendat dhe doktrina e xhajnizmit. Xhajnistët e pranojnë se ato janë grumbulluar brenda shekujve V. para e. s.-VIII. pas e.s. Edhe kritikët historikë pohojnë se tekstet më të vjetra të veprës shkojnë deri në shek. III. para e.s.

Ndërsa fraksioni “Ata që vishen me ajër” i xhajnizmit librat e shenjtë të tyre që vishen me të bardha nuk i vlerësojnë si të vërteta dhe nuk i pranojnë. Për ata vendin e këtyre librave e zënë veprat me titull “Vedat”, të cilat janë prodhim i katër grupeve të mëdha të dijetarëve, të cilat përmbajnë historinë botërore të *xhajnistëve*, konceptet për universin, filozofinë e tyre, mendimet e tyre për etikë dhe adhurim (ibadet). Përveç librave që llogariten të vërteta nga ana e të dy fraksioneve, ka edhe shumë libra të tjerë hyjnorë, libra tregimesh dhe traditë etike.

b. Xhajna

Bashkohësi i Budës dhe princi, siç ishte Buda, Tima (Xhajna) si rrugë të tij për shpëtim kishte zgjedhur asketizmin. Pas vdekjes së prindërve të tij, ai e la shtëpinë, gruan dhe fëmijët dhe u bë murg. Pas një viti i hoqi edhe teshat që kishte në trup dhe filloi të shëtisë i zhveshur. Pas meditimit 12 vjeçar nën një dru pranë lumit gjeti shpëtim në reinkarnacion (Samsara). Kështu që u bë një Xhina (ngadhnyesi), Tirtankara (çelës kalimesh), Mahavira (trim), Bagavat (i përsosur). Pas kësaj ai përmendet me emra të ndryshëm nderi. Është munduar që me ligjëratat e tij të ndriçojë popullin dhe përreth tij ka grumbulluar murgj dhe murgesha. Pas 30 vite jetë shpirtërore në vitin 527 para e. s. vdes në Parapuri. Sipas studiuesve evropianë kjo rastis në vitin 447 apo 467 para e. s. Hyrja e tij në nirvana llogaritet si fillim i kalendarit xhajnist. Bashkësia e tij gjatë kohës është përhapur në Bihar dhe Orissa. Më vonë një pjesë e priftërnjve braktisën traditën e mësuesit që *shëtiste i zhveshur*. Kështu që bashkësia e tij u nda në dy pjesë: Dig-ambara (ata që vishen me ajër) dhe Svet-ambara (ata që vishen me të bardha). Në shek. I. të erës sonë, për shkak të disa çështjeve të tjera fetare ndodhi ndarja definitive në mes dy fraksioneve.

Nën mbrojtjen e sundimtarëve të ndyshëm, në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit I. xhajnizmi u përhap në Indinë Veriore, Dekkan dhe Indinë Jugore, ndërsa në fillim të mijëvjeçarit II. u përhap në Guxharat dhe arriti periudhën më madhështore. Regresi i tij filloi me përhapjen në Indi të budizmit dhe islamit. Supozohet se sot ka afërsisht 2 milion xhajnistë.

c. Koncepti për gjithësinë

Sipas xhajnistëve ata që besojnë në këtë fe janë të pavdekshëm dhe të amshueshëm. Gjithësia nuk ka themelues. Gjithësia ka një madhësi importante dhe rreth saj ka një boshllëk. Në këtë gjithësi gjendet toka e rrumbullakët. Ndërsa në mesin e tokës ekziston mali i botës. Detrat dhe kontinentet janë të renditura në formë rrethi rreth Malit të Botës. Ndërsa nën tokë gjendet bota nëntokësore. Këtu jetojnë demonët dhe zanat, krijesat e së keqes. Nën të gjendet ferri, në të cilin gjenden ata që kanë dënime të rënda. Ata aty do të qëndrojnë deri sa të përfundojnë dënimet e tyre. Ndërsa në sipërfaqe të tokës gjendet bota e qiejve të renditur kate kate. Në këto kate të ndryshme sipas forcës së tyre janë të pozicionuara krijesat hyjnore. Edhe pse në mesin e zotrave jetojnë gjatë, përsëri në fund ato zhduken. Mbi botën e qiellrave ka edhe një botë tjetër dhe ajo është vendi misterioz te i cili është kthimi. Këtu qëndrojnë ata që kanë shpëtuar. Ky vend është për ata që kanë shpëtuar prej mundimit të kthimit përsëri në botë. Gjithësia është e përbershme dhe nuk është e krijuar. Këtu rregullat as nuk ndryshojnë, as nuk shtohen, as nuk zvogëlohen e as nuk shkatërrohen. Bota përbëhet prej krijesave të përbershme të gjalla dhe jo të gjalla. Krijesat jo të gjalla janë vendi, lëvizja, qetësia, koha dhe materia. Krijesat e gjalla janë krijesat shpirtërore. Këto janë në masë të shumtë, gjenden në tërë botën, trupëzohen në tokë, në ujë, në zjarr, në erë, në bimë, në kafshë, në krijesat e ferrit, në njerëz dhe në zotëra. Shpirtërat si ekzistenca janë plotësisht të pavarura nga njëra tjetra, por ndikojnë në njëra tjetrën. Çdonjëra është e pakrijuar dhe ka një njësi të pandashme. Çdo shpirt ka kapacitete dhe specifika natyrore të shumta e të pakufizuar. Ai di çdo gjë dhe ka energji të pakufizuar. Kur del jashtë dëshirave dhe brengave gjendet në pozitën e të shenjtës.

Më e rëndësishmja nga krijesat jo të gjalla apo krijesave që nuk janë shpirtërore është materia. Materia krijohet prej atomëve të panumërt, nuk mund të ndahet dhe nuk mund të kuptohet me shqisa. Atomët mund të zgjerohen, të mbështillen dhe mund të mbushen në vende të mëdha dhe të vogla. Çdo atom ka ndjeshmëri për erë, ngjyrë dhe shije. Sipas ligjeve të tyre ata bashkohen mes vete ose me të tjerë dhe kështu krijojnë grupin. Nëpërmjet kësaj nxjerrin në pah dukuri të ndryshme të botës.

Materia mund të ndikojë në shpirtin, në të mund të shkaktojë ndryshime radikale. Materia, e cila mund të ndikojë në shpirtin, diturinë gjenerale dhe energjinë e pakufizuar të shpirtit e mbulon, kështu fuqia njohëse e shpirtit dobësohet, i zvogëlohet forca, i humb specifikat e natyrës së vet, hyn në një trup kalimtar, habitet me brengat dhe dëshirat e veta. Në veten e tij ndërton një fat të caktuar dhe kjo e bën të domosdoshme që ata të ekzistojnë gjatë një kobe të caktuar në njërin nga format e katër krijesave, si kafshë, njeri, krijesë qiellore dhe krijesë ferri. Materiet, që ndikojnë në shpirt, në të krijojnë “karman”, e cila, sipas asaj që e pranojnë të gjithë filozofitë indiane, jep vendim për ekzistencën e gjërave substanciale përplot me mistere dhe për ekzistencën e gjallesave.

Marrëdhëniet e substancës shpirt dhe karma janë pa fillim dhe pa mbarim. Kur një shpirt është në gjendje aksioni, atëherë pjesët e materies që gjenden në vendin e okupuar nga ai, ndikojnë në të dhe, sikur që pluburi ngjitet dhe mbetet në trupin e lyer me vaj, ashtu edhe elementet materiale janë ngjitur dhe kanë mbetur në shpirt. Materiet e marra në shpirt marrin formën e caktuar të karmasë dhe sipas karmasë krijojnë pjesët e ndryshme të trupit. Forma e karmasë, edhe pse është vazhdimi dhe ardhmëria e materies që është mbushur në shpirt, varet nga vlera etike e veprave të kryera nga materia që ndikon në shpirt. Veprat e mira krijojnë karman e mirë, ndërsa veprat e këqia krijojnë karman e keq. Prodhimi pas themelimit të karmasë është shkak që ajo të zhdukë vetveten. Por në çdo moment, çdo lëvizje është shkak për formimin e karmasë së re, vendin e asaj që zhduket e zë një e re. Kështu që, zinxhiri i ekzistimit si i pafillim dhe i pambarim vazhdon të ndjekë njëra-tjetrën.

ç. Doktrina e shpëtimit dhe udhëzimit

Qëllimi i doktrinës xhajna, si në çdo sistem metafizik të induve, është që shpirtin ta shpëtojë nga rrotullimi i përhershëm i çarkut të lindjes dhe vdekjes. Është shpëtimi i shpirtit nga mosndryshimi, përsëritja, lodhja dhe kompleksiteti i sansara-së (samsara). Çdo shpirt nuk ka mundësi që ta arrijë këtë qëllim, sepse shumë shpirtëra nga natyra e tyre janë abhavjas, d.t.th., shumë shpirtëra nuk posedojnë aftësi dhe dituri për të arritur këtë shenjtëri. Por ai paprerë vazhdon të rrotullohet në rrethin e lindjes dhe vdekjes. Vetëm se, shpirtërat që posedojnë aftësi të posaçme në fund të trupave (duke kaluar nëpër shumë trupa) të panumërt mund të arrijnë në “qetësinë e përsosmërisë” (siddhi, nirvana). Duke punuar në pjekurinë e unit të tyre ata dëshirojnë të ndajnë dhe të shpëtojnë shpirtin nga materia e ndytë. Këtu ka dy çështje me rëndësi. E para është nevoja e pengimit të ndikimit të materies së re karma në shpirt, kurse e dyta është nevoja e zhdukjes së karmasë ekzistuese në shpirt. Mbrojtja nga karma dhe shpartallimi i saj varen nga këto pesë ndalesa: të mos vrasësh, të mos vjedhësh, të mos gënjesh, të mos

jetosh pandershëm, të mos mundohesh që me lakmi të tepërt të bëhesh pronar i pasurisë së tepërt. Para së gjithash ka nevojë për një disiplinë të fortë, për një durim ndaj vështirësive, për mbytjen e epshit, për studim dhe mendim. Shkurtimisht, është asketizmi i jashtëm dhe i brendshëm ai që hap rrugën e së shenjtës. Vetëm priftërinjtë dhe priftëreshat, të cilët mund plotësisht të braktisin botën, mund të largojnë mendjet e tyre nga të gjitha çështjet e kësaj bote, dhe mund të shpëtojnë, mund të shprehin se në fund të luftës së ashpër që bëjnë me epshet e tyre mund në të ardhmen të arrijnë përsosmërinë dhe mund që në të ardhmen të shpëtojnë nga sansara.

Shpirti si një pronar i diturisë së përgjithshme, apo si kavalin, që qëndron në tokë pa brenga dhe pa dëshira dhe që shëtit deri sa të zhduket edhe mbeturina e fundit e karmasë, si kungulli i pastër nga ndytësia që qëndron mbi ujë, pa mos u takuar me asnjë vështirësi materiale lartësohet deri në majë të botës. Arrin afër shenjtërive që qëndrojnë si ombrellë në majë të universit dhe në burimin e sekreteve (Ishatpragbhara), që jetojnë të padukshëm dhe pa trup. Këto më në fund zënë 2/3 e hapësirës në proporcionalitet me krijesat në përgjithësi. Dhe atje shijojnë lumturinë e pafund, të pavdekshme dhe të papakësueshme. Asnjëherë nuk bien në rrezikun e sansarasë. Krahas forcës dhe diturisë gjenerale ata, pa mos u marrë me punë të kësaj bote, jetojnë në qetësi duke ia kthyer shpinën botës.

d. Adhurimi

Udhëheqja shpirtërore e komunitetit xhajna është në duart e priftërinjëve dhe priftëreshave. Sikur priftërinjtë edhe populli kryen lutjet e caktuara ditore. Gjatë adhurimit këndojnë këngë fetare për Tirthankaratë, meditojnë dhe pendohen. Realizojnë lëvizje të caktuara. Mundohen që të mos lëndojnë asnjë gjallesë dhe për këtë ushqehen me ushqime bimore. Pije dehëse nuk përdorin, për arsye se, sipas xhajnistëve në to gjenden gjallesa. Duke u frikësuar mos iu futet ndonjë gjallesë në gojë, pasi errësohet nuk hanë fare. Madje asketët parimorë, nga merakun mos përtypin aksidentalisht ndonjë gjallesë në ajër, rregullisht, sikur kirurgët modernë, gojën e mbyllin me një mbulesë. Janë të njohura spitalet e xhajnistëve për vizitat dhe shërimin e gjallesave, të ndërtuara nga komunitetet xhajniste. Xhajnistët fetarë i japin shumë rëndësi vdekjes nga uria.

Xhajnistët besojnë se në botërat qiellore ekzistojnë shumë zotra. Vetëm se këta i janë nënshtruar reinkarnacionit. Njeriun nuk e ndihmojnë në rrugën e shpëtimit. Edhe Tirthankaratë pasi arrijnë në nirvana, nuk kanë forcë të ndikojnë në ndodhitë botërore. Krahas kësaj atyre iu është kushtuar një kult madh. Kështu që xhajnistët besojnë se me të menduar Tirthankaratë, me të shenjtëruarit e tyre, shpirti do të lartësohet, do të pastrohet dhe për këtë atyre ju bëjnë shumë respekt. I shenjtërojnë dhe i adhurojnë idhujt që gjenden në tempujt madhështorë të xhajnistëve. Përpara tyre këndojnë këngë fetare dhe flijojnë nga pemët dhe perimet. Përpara tyre vëndosin llamba dhe fumigante (lëndë tymosëse), dhe i vajosin idhujt dhe i zbkurojnë me lule. Dhe përsëri i vizitojnë vendet ku besohet se jeton Tirthankara. Nga malet e njohura që vizitohen janë Mali Parasnath, Shatruxhaja, Girnar dhe Abu. Për realizimin e dëshirave botërore ju bëhet lutje Tirthankarasë dhe zotërave, ndërsa disa xhajnistë ju luten edhe zotërave indianë si Bhayron, Hanuman, Ganesha. Adhurimi në tempuj nuk udhëhiqet nga priftërinjtë, por, nga vetë populli. Në disa raste në tempujt xhajnistë haset edhe në brahmanë të cilët punojnë me pagë.

4. Sihizmi

Literatura: G. Tümer-A. Küçük, *Dinler Tarihi*, Botimi 2, Ankara 1993, f.100-106; Abdurrahman Küçük, *Sihizm*, AÜİFD, v.28, 1986, f.391-417; Huzeyfe Sayım, *Sih Dini'nin Kurucusu Guru Nanak'ın Hayatı ve Öğretileri*, (Yüksek Lisans Tezi) Kajseri 1986, 100 faqe.

Sihizmi është një lëvizje fetare e përbërë nga islami dhe hinduizmi. Mendohet se në kohën e tashme ka afër 6-7 milion përkrahës. Edhe pse shumica e simpatizuesve jetojnë në Indi, ata bashkë me simpatizuesit me origjinë indiane janë përhapur në vende të ndryshme të botës, e sidomos në Angli dhe

Kanada.

Themeluesi Nanak ka lindur më 1469 në fshatin Talvandi, që tani mban emrin Nankana Sahib, 60 km në juglindje të Lahorës. Fëmijërinë dhe moshën rinore të tij e ka kaluar në fshat. Është martuar dhe ka qenë baba i dy djemve. Bënte pjesë në një kast të lartë. Në fëmijëri mori edukimin tradicional indus. Në moshën e re u largua nga fshati dhe shkoi në qytetin Sultanpur dhe atje punoi si shërbyes i një zotërie musliman. Në kohën e lirë qëndronte i vetmuar dhe zhytej në mendime të thella. Sipas një transmetimi ai e kuptoi “Zotin e lartësuar, që është krijues, i pastër nga frika dhe armiqësia, që nuk ka lindur dhe që ekziston vetvetiu”. Ai e ndjeu se është i obliguar të merret me predikimin e tij. Në vitin 1500 e braktisi Sultanpurin dhe filloi të shëtisë dhe të ligjërojë mendimet e tij në lidhje me “Zotin e vërtetë dhe të vetëm”. U bë i njohur me ligjëratat e tij dhe vizitoi shumë vende të shenjta të feve të ndryshme, e ndër ta edhe Mekken. Diskutonte me indusët dhe muslimanët.

Fundin e jetës së tij e kaloi në fshatin Kartapur, i cili i ishte dhuruar atij, dhe vdiq në vitin 1539 në moshën 70 vjeçare. U nda nga kjo botë duke lënë pas tij dy djem dhe një numër të madh nxënësish e simpatizuesish.

a. Lindja e sihizmit

Pas përhapjes së islamit në Indi, interesimi i simpatizuesve për njëri-tjetrin, diskutimet e njëshmërisë dhe shumësisë së Zotit, nxitja e sundimitarit të njohur Kabir (1435-1528), dëshira e Shahut të Madh (Ekber Shah, 1542-1605) për bashkimin e feve rreth monoteizmit e rritën edhe më tepër ndikimin e aktivitetit të Nanakut në këtë drejtim. Nanaku, edhe pse nuk ka tentuar që të themelojë një fe të re, ai duke e ngritur politeizmin, sistemin kastian dhe adhurimin e idhujve, kërkoi një kompromis mes islamit dhe hinduizmit. Kjo lëvizje për kompromis nxorri në shesh një sintezë të re. E nxorri në shesh lëvizjen sihe. Ai bashkoi konceptin monoteist islam-besimin në një Zot, dhe konceptet filozofike indiane “*maja*”, “*nirvana*”, “*reinkarnacion*”, kurse besimin hinduist “*avatara*” (reinkarnacioni i zotit) e kundërshtoi.

b. Zhvillimi i sihizmit

Nanaku para se të vdesë, Angadin, njërin prej nxënësve besnik të tij, e obligoi si pasues dhe si trashëgimtar të tij. Pas vdekjes së Nanakut, pasuesit e tij me përvetësimin e konceptit të reinkarnacionit hinduist filluan të besojnë se shpirti i tij ka kaluar në pasuesin e tij “Angad” dhe se shpirti i Nanakut do të vazhdojë të manifestohet në udhëheqësin e ri dhe në gurutë. Komuniteti një periudhë prej 200 vjetësh është udhëhequr nga gurutë, të cilët kanë bartur shpirtin e Nanakut. Ky zinxhir mori fund me vdekjen e Guru Govind Singut X. më 1708.

Së pari Nanaku dhe simpatizuesit e tij janë quajtur “Nanakpanthi”, ndërsa më vonë “Sih” (në sanskritishte: nxënës, çirak). Ndërsa ata vetë besimin dhe komunitetin e tyre e quajnë me termin “Gurmat”.

Edhe pse Nanaku para vdekjes së tij Angadin e zgjodhi si udhëheqës, një pjesë e nxënësve të tij u bënë ndjekës të djalit të Nanakut, Sri Chandasë dhe formuan komunitetin “Udasis”. Këta duke e hequr mjekrën dhe çallmën u ndanë nga sihizmi tradicional. Angadi deri më 1552 i ka grumbulluar vjershat e Nanakut. Libri i shenjtë “Gurmukhi” që përdoret në Penxhab bazohet në Angadin. Guru i 3. është Amar Das (v. 1574). Ka kontribuar në ceremonializimin e traditave sihe në lidhje me lindjen dhe martesën. Përparim i rëndësishëm në komunitetin sih është arritur në kohën e gurut të 5. Arxhun. Arxhun e ka përfunduar Tempullin e Arit (Harimandir), ndërtimi i të cilit ka filluar më herët në Amritsar dhe ka tubuar librin e shenjtë “Adi Grand”. Me vdekjen e tij më 1606, në krye të sihëve si guru i 6. kalon djali i tij Hargobind (v.1664).

Edhe pse në kohën e Rangh Singhut (1780-1830) është themeluar një mbretëri sihe, më 1849 është shkatërruar nga anglezët. Më 1947 edhe sihët marrin pjesë në lëvizjen për pavarësinë e Pakistanit, kështu që është realizuar formimi i një rajoni sih në Penxhab.

c. Besimi dhe adhurimi

Sihët krahas besimit në ekzistencën dhe njësinë e Zotit, besojnë se ai nuk mund që në mënyrë të mjaftueshme të kuptohet nga njeriu që është i vdekshëm. Që njerëzit ta kuptojnë Zotin, ai atyre ju ka dhënë mendjen dhe të kuptuarit. Ai në çdo vend është gati dhe prezent dhe mund të shihet në çdo gjë. Emri i tij në mesin e sihëve është “Nam”. Shpëtimi fillon me të kuptuarit se bota dhe gjërat me vlerë janë “maja” bosh dhe gënjeshtare. Në të kundërtën shpirti nuk mund të shpëtojë nga rrethi vicioz lindje dhe vdekje. Librat e shenjtë janë “Adi Granth”. *Granth* ka kuptimin *libër*. Ato janë të shkruara në vargje dhe ritme të ndryshme. Një pjesë e madhe e tyre janë të shkruara me shkronja Gurmukhi të gjuhës së vjetër induse. Përafërsisht kanë 1200 faqe. Shtojca është Dasam Granth. Besojnë në atë se veprat e gjallesave ndikojnë në gjendjen e ardhshme të tyre (ndryshimin e karmas) dhe në reinkarnacion.

Adhurimi i tyre përbëhet prej lutjeve drejtuar Zotit, prej larjeve që llogariten si një lloj abdesi dhe shkuarjes për “peligrinazh” në qytetin Amritsar. Adhurim ditor është leximi i Adi Granthit dhe lutja.

Të vdekurit, sikurse indusët, edhe këta i djejin. Lejojnë që të martohen vejanët dhe vejushat. Cigare dhe alkohol nuk pinë. Dënimet për kriminalitetet i paguajnë me para. Rëndësi të veçantë i japin ushtrisë, bujqësisë dhe artit. Ndaj ithtarëve të feve të tjera kanë një respekt të posaçëm.

5. Budizmi

Budizmi, i bazuar në filozofinë indiane Sankya, është shumë i rëndësishëm për kulturën fetare dhe kombëtare të turqve, për shkak se, edhe pse sot ajo është një rrugë që ndiqet nga materialistët bashkëkohorë, para islamit ka qenë fe kombëtare e turqve, kurse më vonë metoda budiste është përdorur edhe në tasavvuf. Emri Buda, që ka kuptimin “i zgjuar, intelektual”, është emri i themeluesit të budizmit. Kurse budizëm është emri i fesë, sistemit të besimit të themeluar nga Buda. Në lidhje me sistemin dhe jetën e themeluesit ka shumë diskutime. Më e pranueshmja për vdekjen e Budës është ajo e vitit 483 para erës sonë, por për vdekjen e tij ka edhe transmetime të tjera indiane-budiste si viti 652 apo 353 apo 252 para erës sonë. Llogaritet që sot të ketë afër 250 milionë simpatizues budistë.

Në kohët e vjetra shumë grekë dinin për ekzistencën e brahmanëve në Indi, për ekzistencën e klerikëve budistë me emrin Shramana. Fjalën Shramana e kishin përdorur si Samanajo (në gjuhën pali Samana). Është e shënuar se klerikët budistë kanë ardhur deri në Baktrija dhe Iran. Gjithashtu edhe etërit e kishës tregojnë për Budën dhe mësimet e tij.

Edhe pse në mënyrë direkte në Kur'an nuk diskutohet për Budën, përsëri disa studiues muslimanë fjalën “Dhu'l-kifl” e krahasojnë me emrin *Kapilavasti*, vendlindja e Budës, dhe nga kuptimi ushqim apo ushqyes i fjalës Dhu'l-kifl, mundohen të krijojnë lidhje me emrin e babait të Budës, *Suddhodana* (ushqim i pastër, i kulluar). Ndërsa disa të tjerë, duke u nisur nga fjala “tin” fik, i sures Tin, supozojnë se kjo simbolizon drurin e fikut nën të cilin Buda ka pranuar shpallje.²⁰² Ata mundohen që të formojnë ura në mes të Budës dhe islamit.

Nga fillimi i shek. XVII., si rezultat i rritjes së marrëdhënieve të Evropës me Azinë Lindore dhe Jugore, fillojnë të shtohen edhe njohjet për të. Kurse studimet e para shkencore fillojnë në shek. XIX. Në këtë fushë rol të rëndësishëm kanë luajtur sinologët, tibetistët dhe indologët. Kështu që më 1882 në Londër themelohet “Shoqëria e Literaturës Pali” që vite me radhë është marrë me botimin e teksteve dhe përkthimeve shkencore. Anëtarët më të njohur të saj janë T.W. Rhys dhe H. Oldenberg. Ndërsa nga fillimi i shek. XX., janë dhënë pas teksteve sanskritishte dhe me punimet e Th. Stcherbatsky, O. Rosenberg dhe të belgut L. De la Vallee janë arritur rezultate të kënaqshme. Kurse në studimet e muslimanëve nuk ka diçka më tepër në këtë temë. Edhe Biruniu, i cili ka patur interesim të veçantë për fetë indiane, tregohet i brengosur për mosgjatjen te asnjë libri budist.

²⁰² Muhammed Hamidullah, *Islam Peygamberi*, Stamboll, 1966, f. 430 dhe në vazhdim.

a. Jeta e Budës

Nëse Budën, siç është rasti me themeluesit e feve të tjera, do ta shikonim si një person që ka jetuar në një kohë të caktuar dhe ka themeluar një sistem besimi të caktuar, këtu do të kishim transmetuar vetëm mendimet e jobudistëve në lidhje me atë. Kurse budistët, Budën e shohin në dy aspekte:

Buda historik

Si njeri Buda ka jetuar përafërsisht në vitet 563-483 para e.s. në Indinë Veriore. Vendi ku ka jetuar ai quhet "Tarai", vend kënetor, me pyje dhe me lagështi. Dokumenti i parë historik në lidhje me këtë çështje është gjetur në vitin 1896 dhe është një monument i ndërtuar nga mbreti Ashoka në vitin 250 para e.s. Mbi këtë përkujtimore gjendet shkrimi "Këtu ka lindur i madhi". Gjithashtu po në këtë rajon, në njërën prej enëve të gjetura në varrezat në vendin e quajtur "Piprava" në gjuhën dhe shkrimin e vjetër gjendet shprehja "Kjo enë është gjë e shenjtë e Budës së Madh me gjenezë nga Shakja dhe është pronë e Sukitit dhe vllazërve, djemve dhe grave të tij". Këto dokumente simbolizojnë vendin ku ka lindur dhe është rritur Buda.

Babai i tij Suddhodana, ishte sundues i një principate të vogël të *Mbretërisë Kosala*. Në tekstet e vjetra përmendet si "raxha". Kryeqyteti i principatës ishte Kapilavastu. Transmetohet se emri i nënës së tij ka qenë Maja që ka vdekur shtatë ditë pas lindjes së Budës. Emri i fisit të tij ishte Shakja; për këtë arsye atij i është dhënë titulli "i vetmuari i fisit Shakja". Emri i Budës ka qenë Siddharda (i suksesshëm, ai që ia ka arritur qëllimit) ose Sarvarthasidha, që ka të njëjtin kuptim. Kurse emri familjar i tij ishte Gautama. Ndërsa fjala Buda, nuk është emër por atribut i tij, për shkak se ai ka fituar Bodhin (diturinë e thellë). Ai është i zgjuar, e ka njohur të vërtetën. Atij i thuhet edhe "Thatagata" (ai i cili ka arritur përsosmërinë).

Princi Siddharta është rritur si fëmija i një familjeje udhëheqëse dhe të pasur dhe ka marrur edukatën dhe arsimin më të mirë të kohës. Kur arriti në moshën e martesës, u martua me vajzën e xhaxhait, Jashodhara dhe me të pati një djalë me emrin Rahula. Në moshën 29 vjeçare, edhe pse familja ishte kundër, ia ktheu shpinën jetës së kësaj bote dhe u tërhoq në vetmi në Pyllin Uruvela. Ai, për shkak të presionit të mendimit për problemin e ekzistencës dhe qëllimit të njeriut, nuk ishte i kënaqur nga jeta që e jetonte. Së pari, për zgjidhjen e problemit i ka kërkuar brahmanët dhe i ka ndjekur ata. Brahmanët atë nuk e kanë kënaqur. Dhe, për të fituar diturinë e udhëzimit dhe shpëtimit, ka filluar jetën me stërvitje asketike. Pas sfilitjes që i ka bërë vetvetes dhe që ka zgjatur vite me radhë, Siddharta, nuk ka mundur që edhe me këtë të gjejë atë që ka shpresuar, ai e lë këtë rrugë, vjen nën drurin e fikut të quajtur "druri bodhi" fillon meditacionin. Pasi studioi shtatë vjet, Buda shpall se e ka zgjidhur fshehtësinë e jetës së kësaj bote dhe se e ka gjetur rrugën e shpëtimit nga rrethi i reinkarnacionit.

Pas kësaj, filloi të shëtisë nëpër vend si ligjërues (shëtitës) dhe të sqarojë të vërtetat te të cilat ka arritur. Përfitoi shumë nxënës, mësimet e tij i përhapoi rreth e përqark, u dha përgjigje kundërshtarëve. Kishte mjaft nga ata që me dashuri dhe admirim i dhanë besë se do ta ndjekin, por kishte edhe nga ata që me armiqësi dhe xhelozë u munduan ta vrasin. Kontrollloi dhe udhëhoqi fraksionin që formoi dhe punët e tyre. Më vonë atij iu nënshtrua edhe familja e tij. Ndërsa fushë e propagandimit të tij ishte, vendi i vogël i tij dhe komshinjtë perëndimorë dhe jugorë, rajoni Magadha dhe Kosala. Ky rajon përkonte me meridianet 81 dhe 87, në qendrën e të cilit gjendeshin Patna dhe Benares. Sipas trasmetimit, Buda ka vdekur në moshën 80 vjeçare nën drujtë (hijen e drujve) në Kushinagara.

Buda si parim shpirtëror

Që në kohët e hershme njohuritë në lidhje me Budën janë zbuluar me legjenda; ndërsa tani është shumë e vështirë që të ndahet e vërteta historike nga legjenda. Në fakt, për budistët nuk është shumë me rëndësi ekzistenca fizike e Budës. Ai nuk është një profet që sjell lajme nga bota hyjnore. Ai është sqarues i rrugës së shpëtimit, të cilën e ka zbuluar në vetveten e tij dhe lëvizës i "rrethit doktrinor". Buda është shembulli i gjetjes së të vërtetës në personalitetin e tij. Çdo budist Budën mund ta mendojë si ekzistencë personale. Ndërkaq teologët nuk e pranojnë konceptimin e Budës si person. Sipas tyre, Buda është tip i amshueshmërisë, i cili është i shëndritshëm dhe në botë ka ekzistuar në kohëra të ndryshme, në krijesa dhe personalitete të ndryshme. Karakteri i tij personal nuk është me rëndësi. Sipas budistëve që besojnë në reinkarnacion, besimise Buda për herë të parë në botë nuk ka ardhur në vitin 563

para e.s., është shumë normal. Sikur që shpirtërat e tjerë kanë lindur në këtë botë shumë herë, kanë jetuar si kafshë, njerëz dhe zotëra, ashtu edhe Gautama, në kohëra të ndryshme, ka jetuar në vende të ndryshme dhe e ka shijuar fatin e përbashkët të të gjitha gjallesave. Budës për të arritur përsosmërinë shpirtërore nuk i mjafton vetëm një jetë, por qindra vite me radhë duke ardhur shumë herë në botë gradualisht arrin atë përsosmëri. Kjo rrugë është aq e gjatë sa që nuk mund të mendohet. Sipas llogarive tradicionale kjo rrugë është më e gjatë se sa tre periudhat e pafundta (nga Mahakalpa). Nëse do të llogaritej në vite atëherë do të kishte përafërsisht 3 x 10.56. Gjatë kësaj kohe Buda i ka realizuar të gjitha llojet e virtyteve. Shumë statuja të Budës të punuara me dorë, simbolizojnë përgatitjet e gjata të kësaj përsosmërie. Legjendat shpjegojnë luftërat e Budës në jetërat e ndryshme të tij me Mara, zotërinë e të keqes dhe botës, dhe se si Buda flijoi pasurinë dhe sundimin i tij botëror.

Sikur doktrina e Budës të ishte një shpjegim individual, nuk do të ishte një autoritet obligues. Në realitet ai del në shesh nga parimi shpirtëror i natyrës së Budës, që është fshehur në personalitetin e Gautamasë. Për këtë budistët Budën e shikojnë si parim shpirtëror dhe e quajnë Tathagata dhe tregojnë për trupin-dharma të tij. Budën e ndajnë nga trupi historik dhe qëndrojnë në të vërtetën se zinxhiri i Tathagatave të panumërt, të cilët çdo herë shihen në tokë dhe shpjegojnë të njëjtën doktrinë, është njëri nga hallkat e pafundëta. Për këtë edhe Tathagata në aspektin e ekzistimit është një komponent i një grupi. Arti budist me shtatë drunj simbolizon shtatë Tathagat apo Shakjamunin dhe gjashtë pasuesit e tij, poshtë të shëndritur, të cilët kanë arritur të vërtetën. Në Mathura dhe Aganta shtatë Budat janë bërë në formë të njeriut dhe në praktikë njëri nga tjetri nuk mund të ndahen.

Ndërsa trupin e tij njerëzor e shohin si diç të rastësishëm, i cili mbulon personalitetin e vërtetë të tij. Pas këtij trupi që duket, pranojnë ekzistencën e trupit tjetër, i cili dallon nga trupat normal të vdekshëm, që mund të kuptohet dhe të shihet me syrin e besimit. Budistët këtë e quajnë me emrat si “trup i paprishur, trup i lumturisë etj”. Në këtë trup të shndërrtshëm dhe të lartësuar gjenden 32 sinjale të mëdha të Budës dhe 80 të vogla. Sidomos, lista e 32 sinjaleve është e pranuar nga të gjitha fraksionet. Për këtë, vizatimet dhe statujat e Budës asnjëherë nuk paraqesin trupin e vërtetë njerëzor të tij. Ato janë shëmbëlltyrë të trupit të shndërritur dhe të lartësuar të Budës. Ky trup nuk është i kufizuar si trupi i njeriut normal. Ai mund të lëvizë në një hapësirë sa një kokërr hardalli dhe me tre hapa mund të ngjitet në qiellin e Indrasë. Studimet perëndimore për Budën historik paraqesin vetëm mendimet e tyre për të. Ato nuk reflektojnë besimin e besimtarëve budistë. Budistët nuk i japin rëndësi Budës historik, por, Budës shpirtëror.

b. Librat e shenjtë

Buda për propagandimin e doktrinës së tij ka vepruar si ligjërues shëtitës. Por, ai vetë nuk ka lënë ndonjë libër. Ligjëratat i ka mbajtur në dialektin e atëhershëm Maghadi (e ngjashme me gjuhën e sotme Bihar). Budistët besojnë se ligjëratat e Budës janë përmbledhur të shkruara në libër me titull Pali-Kanon, me formën e tyre origjinale 400 vjet me rradhë janë transmetuar gojarisht dhe më vonë janë shkruar. Ndërsa studiuesit shkencorë këtë e shikojnë me skepticizëm. Sepse kanë bindjen se, gjuha Pali nuk është e njëjtë me gjuhën Maghadi, poashtu edhe fjalimet e Budës edhe sikur të përkthehen në gjuhën Pali, në një kohë aq të gjatë nuk mund që ta ruajnë origjinalitetin. Megjithatë, nuk ka dyshim se bërthamën e Pali-Kanon-it e përbëjnë fjalët e Budës. Pali-Kanon përbëhet nga një numër i madh librash. Në brendi ka shumë përsëritje. Vepra ndahet në tre pjesë të quajtura Pitaka (shportë): Vinaja-Pitaka (shporta i disiplinës së rendit), Sutta-Pitaka (shporta e doktrinës) dhe Abhidhama-Pitaka (shporta e besimit filozofik skolastik). S’ka dyshim se i fundit i takon periudhave më të vonshme. Sipas budistëve ai është një libër i të vërtetave të sqaruara nga ana e Budës, jo për njerëzit por, për zotrat.

Kurse shkrimet e shenjta të periudhës së mëvonshme shpjegohen në forma të ndryshme. Për shembull këtyre u thuhet “Praxhnaparamita-Sutra” (Tekste nga besimi i përsosur) dhe të gjithë budistët besojnë se këto janë të shpallura nga vetë Buda; pasi për njerëzit e rëndomtë janë të vështira për t’u kuptuar, janë të fshehura në pallatin e përbindëshve nëntokësorë; me përshtatshmërinë e kohës (me pjekjen e kushteve), nga ana e dijetarit të njohur Nagar Xhuna janë nxjerrur nga nëntoka në sipërfaqe. Përsëri, pretendohet se librat e shkruar më vonë dhe të cilat i ngarkohen Budës, nuk janë të shkruara prej tij si trup material, por, nga Buda si shpirtëror dhe si trup mbinatyror.

Veprat sistematike, titujt e të cilave nuk i dimë dhe që janë të bazuara në Sutrat, mund t’i quajmë si

aforizma të Budës, quhen edhe Shastra. Në tërësi literatura e budizmit ka një përmbledhje të gjerë. Për shembull, përkthimi japonsht i Tripitaka-së me emrin “Taisho Issaikyo” është një përmbledhje që përmban 2184 vepra të cilat përbëhen nga 55 vëllime me nga 1000 faqe.

c. Koncepti për Zotin

Përgjithësisht ka pretendime se doktrina e Budës është ateizëm, bile pretendohet se budizmi nga shkakut që nuk njeh asnjë zot nuk mund të llogaritet si fe. Përkundër kësaj ka edhe të atillë që pretendojnë se për një fe besimi në zot nuk është nevojë e domosdoshme, kështu që budizmi është një fe pa zot. Që tema në fjalë të jetë më e qartë, është e nevojshme që së pari të përqendrohemi mbi termin zot.

Në çdo fe ekziston koncepti për një fuqi mbinatyrore jashtë njeriut. Kjo fuqi në disa raste është krijuesi i universit, zoti njeri, ndërsa në disa raste është hyjni ose “ligj i universit”, që nuk është njeri dhe mendohet si diçka mbinjeri dhe si përfundim kjo fuqi është një grup zotësh ose një grup engjujsh që nuk mund të ndahen qartë nga zotët. Nga këndi i këtyre mendimeve Buda, në lidhje me ekzistencën e një Zoti krijues, nuk ka mbajtur një qëndrim të qartë. Ai këtë temë nuk e ka diskutuar. Edhe budistët duken si të painteresuar për çështjen se kush e ka krijuar gjithësinë, dhe nuk besojnë se nga kjo çështje mund të kenë ndonjë dobi. Udhëzim dhe shpëtim sipas tyre, është shpëtimi nga kjo botë dhe nga brengat e saj, shpëtimi nga reinkarnacioni. Gjithashtu sipas teologjisë brahmane, shpirti që ka gjetur shpëtimin dhe ka arritur në Nirvana është më i lartë se Brahma krijuesi i universit. Sipas budistëve Brahma është përplot me mburrje dhe gjithashtu mburret duke thënë: “Unë jam Brahma, Unë jam Brahma i madh, jam mbreti i zotëve, unë nuk jam i krijuar, unë e kam krijuar univesin, unë jam Zoti i universit, unë mund të krijoj, mund të ndryshoj çdo gjë, mund të drejtoj, unë jam babai i çdo gjëje”. Ndërsa Tathagata nga fjalë dhe mendime të këtilla fëmijësh qëndron larg. Budistët me këto bindje Zotin nuk e refuzojnë, vetëm se nuk kanë ndonjë interesim ndaj Tij.

Nëse do të krahasoheshin cilësitë hyjnore në transmetimet mistike dhe Nirvana, do të shihet se në aspektin përmbajtësor në mesin e tyre nuk ka ndonjë dallim të madh. Në budizëm Nirvana nuk ka ndonjë aksion kozmik, bota nuk është botë e Zotit. Për këtë ata mohojnë gjithçka botërore. Budistët në anën tjetër, besojnë dhe thonë se Nirvana është zot i amshueshëm, i pafund, i palëvizshëm, nuk plaket dhe nuk vdes, nuk lind, nuk është i lindur, është i fuqishëm dhe vendstrehim, vend shpëtimi, është e vërteta më e drejtë dhe më e lartë, është e bukur dhe e mirë, misterioze dhe e pakuptueshme. Në disa raste, edhe Buda mendohet si personifikim i Nirvanas dhe bëhet objekt i ndjenjave fetare.

Budizmi ndaj politeizmit është shumë tolerant. Çdo burim, çdo dru, lumë, gjallesë etj., në vete fsheh një hyjni. Besohet se kjo e mbron zotërinë e vet nga fatkeqësitë si sëmundja dhe zjarri; besohet se ka qenie shpirtërore. Për këtë edhe shumë hyjnive, të cilat mendohen si ndihmës dhe mbrojtës, u bëhet lutje. Lutja drejtuar zotave nuk kundërshtohet, sepse teologët budistë këto i shohin si nevoja të popullit.

Tek budistët koncepti i monoteizmit, në përgjithësi, nuk është fare. Vetëm se disa fraksione në Nepal dhe Tibet, për të formuar një balancë me islamin, përdorin një Buda të fuqishëm, të ditur, të përhershëm pafillim dhe pambarim dhe supozojnë se universi është krijuar me anë të meditacionit dhe ekzistimit të Budës.

Sipas budistëve, karma është fuqia e vetme që udhëheq çdo gjë. Është një “ligj i universit” i përhershëm dhe ndaj akteve praktike reciprokisht e paraqet vetveten. Në budizëm e kundërta e Zotit të feve që besojnë në Zot mund të thuhet se është ky parim. Edhe pse nuk besohet në një Zot të përhershëm, besohet në zotët si Brahma dhe Indra, që janë të vdekshëm dhe të nënshtruar karmasë. Sidomos ng ana e popullit për pasuri botërore u bëhet lutje atyre; por, këto nuk kanë asnjë ndikim në çështjet e shpëtimit dhe universit. Fraksionet si mahajana dhe vaxhrajana, pasi janë nënshtruar traditave indiane, zotëve u japin rëndësi të madhe dhe i kryejnë veprimet e kultit. Përkundër kësaj, në Siam dhe Kamboxhia, që i përkasin fraksionit Seravada, këto punë i kryejnë brahmanët jobudistë.

ç. Doktrina e udhëzimit dhe shpëtimit

Nuk ka dyshim se mendimet e Budës kanë lidhje të përafërta me filozofinë fetare indiane. Në

periudhën kur ka jetuar Buda, zotët e Vedave, që shumica janë fuqi natyrore hyjnizuara, kanë filluar ta humbin forcën e tyre. Kërkohej një forcë e re shpirtërore dhe kjo forcë përfshihej në dy terma dhe emra. Atman dhe Brahman. Brahman ishte fuqi në fjalët hyjnore, madhësi mbinatyrore në flijime dhe në fund u bë krijuesi dhe bartësi i universit. Ndërsa Atman, si koncepti “Unë”, që është sundues i personalitetit, e lindi konceptin “Unë”, që është sundues i universit dhe ekziston edhe vetë në të. Gradualisht, duke iu afruar çdonjëri tjetrit, të shikuar nga dy kënde të ndryshme u dukën si një fuqi absolute e njëjtë. Këtu u zhduk mendimi për Zotin, ndërsa mendimi për fuqinë u bë më i rëndësishëm.

Në Indinë parabadiste, ku mendimi për Zotin ishte i dobësuar, mendimi i shpëtimit dhe i udhëzimit filloi të bëhet i rëndësishëm. Ekzistenca mendohej si mbështjellja e parimit shpirtëror me materien. Rezultati është brenga. Edhe jeta ndijore shihet si brengë, iluzion dhe hutim. Edhe të metat botërore si vdekja, plakja dhe sëmundja janë argumente për ndrydhjen e parimit shpirtëror në materie. Kështu nga dita në ditë kjo dëshirë e shpëtimit nga brenga dhe varësia vjen e bëhet më e gjallë. Ndërsa vdekja, nuk kishte mundësi që të gjallin ta shpëtojë prej botës, sepse këtë e pengonte reinkarnacioni. Vdekja e trupit e bënte të domosdoshëm ekzistimin e një trupi të ri. Njeriu mund të gjente përsëri trup, qoftë në kafshë, qoftë në bimë. Shëtija e përhershme e shpirtit prej një trupi në tjetrin, prej një gjallese në tjetrën, nuk kishte kuptim tjetër veç se një skllavërie të dhimbshme. Kësaj hutie në oqeanin e lindjes dhe vdekjes i thuhet “sansara”. Vendin e shpirtit në mes trupit të njeriut dhe kafshës e caktojnë sjelljet etike. Këtij koncepti i thuhet “karma” (punë, vepër). Karma është tërësi e të gjitha punëve të një jete, ka ndikim edhe në trupin e mëvonshëm. Këtu nuk shihet ndonjë ligj hyjnor. Gjykimi i karmasë është si ligji i natyrës. Pra dhe ky koncept i karmasë e përforcoi mendimin për kërkimin e rrugëve për shpëtim nga trupi, ekzistenca. Përgjigjet e dhëna përfshihen në dy aspekte: E para është rruga Joga, e cila bazohet në përvojën fizike dhe shpirtërore. E dyta është në drejtim të njohjes së anës së vërtetë të ekzistencës. Këtu njihet esenca e ekzistencës. Mësohet se si materia me mashtrime dhe me dinakëri e ka skllavëruar shpirtin dhe kërkohet rruga e shpëtimit të shpirtit nga kjo skllavëri.

Buda, i cili është rritur në këtë rreth që e përmendëm më lart, rrugën që e ka gjetur për udhëzim dhe shpëtim në ligjëratën e tij të mëposhtme e shpallë si katër të vërtetat e shenjtja:

“O murgj! Këtu ka dy ekstreme, të mos e refuzosh botën që nuk është e detyruar të nënshtrohet. Cilat thoni? Njëra është dorëzim dëshirave të paqëllimta, të pafisnikshme, të këqia, boshe, të poshtëra dhe që i kënaqin ndjenjat; tjetra është dorëzim i vetvetes torturave të epshit të pafisnikshëm dhe të paqëllimtë. Po, o priftërinj, Tathagata nga të dyja këto ekstreme ka qëndruar larg, shkoi të mësojë rrugën e mesme, që i hap sytë dhe e shndërit mendjen. Është rruga që çon në Nirvana. Por ç’është kjo o priftërinj? Ç’është rruga e mesme, që Tathagatanë e çon në shndërritje, i hap sytë, e qartëson të kuptuarit dhe çon në njohje, qetësi, shndërritje dhe në Nirvana?”

Kjo është rruga origjinale me tetë pjesë: bindje e vërtetë, dëshirë e vërtetë, të folurit e vërtetë, punë e vërtetë, jetë e vërtetë, vullnet i vërtetë, mendim i vërtetë (sati), meditim i vërtetë (samadhi). Po, kjo është rruga e mesme, e cila Tathagatanë e çon në shndërritje, i hap sytë, e qartëson të kuptuarit dhe çon në njohje, qetësi, shndërritje dhe në Nirvana, o asketë!

O murgj! E vërteta origjinale për dhembjet është kjo: Lindja është dhembje, pleqëria është dhembje, sëmundja është dhembje, vdekja është dhembje, të qëndruarit bashkë me atë që nuk e do është dhembje, të ndahesh nga e dashuruara është dhembje, të mos e arrish atë që e dëshiron është dhembje, thënë shkurt këto janë shkaqet e ekzistimit të dhembjes.

O murgj! E vërteta mbi origjinalitetin e burimit të dhembjes është kjo: ambicia është ajo që çon përsëri në lindje, ajo varet prej dëshirave dhe dhembjes, ajo këtu dhe atje kërkon qejf, ajo vrapon pas ekzistencës dhe joekzistencës dhe kërkon qejfe ndjenjash.

O murgj! E vërteta mbi origjinalitetin e shtypjes së dhembjeve është kjo: ajo është shtypje e kësaj ambicie në të gjitha ato që janë pa dhembje. Ta braktisë, ta refuzosh këtë ambicie është të mos e pranosh.

O murgj! E vërteta mbi origjinalitetin e rrugës së shtypjes së dhembjes është kjo: edhe kjo është rrugë e njëjtë me tetë pjesë: shiqim i drejtë, të folurit e drejtë, dëshirë e drejtë, punë e drejtë, jetë e drejtë, zell i drejtë, mendim i drejtë, meditim i drejtë.”²⁰³

Kjo ligjëratë, që përbën themelin e doktrinës, më vonë është zhvilluar kështu:

²⁰³ Johannes Lahnamann, *Weltreligionen im Unterricht*, Teil I, Fernostliche Religionen, Göttingen 1986, f.165.

E vërteta e parë. Ka të bëjë me esencën e dhembjes. Sipas Budës lindja, sëmundja, pleqëria dhe vdekja janë dhembje. Edhe të qëndruarit bashkë me atë që e urren dhe të qëndruarit larg atij që e dashuron është dhembje. Të mos arrish të ajo që e dëshiron dhe e dashuron është dhembje. Shkurtimisht, të përqafosh botën është dhembje.

Në disa raste gjërat të cilat neve na japin qejf, të tjerëve u japin dhembje. Përgjithësisht ndaj qejfeve tona bëhemi të verbër. Ndërkaq, në çfarë mase jemi ortakë me dhembjet e të tjerëve, në atë masë zgjerohet edhe fusha e dhembjeve që i ndjejmë. Për shembull, një pëllumb i pjekur është i këndshëm, por, kjo kënaqësi tek ne vazhdon të ekzistojë derisa i harrojmë ndjenjat e pëllumbit. Nëse ne për t'i realizuar dëshirat tona e prishim lumturinë e tjetrit, ne bashkë me gëzimin e lartësisimit dhe të suksesit në ndërdoje ndjejmë një ndjenjë fajësimi.

Edhe gjërat, edhe pse në disa raste janë gëzimprurëse, që varen nga brenga e mbrojtjes dhe frika e humbjes njeriut i sjellin mundime. Budistët kësaj i thonë *“mundimi i kthimit”*. Për shembull, kjo është sikur atyre që, për shkak të frikës se mos u vidhet perla, u ikën gjumi. Vetëm se ata të cilët janë të shpëtuar nga kjo ndjenjë e flakin frikën, arrijnë lumturinë shpirtërore.

Aspiratat botërore nuk mund të jenë të mjaftueshme në shuarjen e dëshirave të thella shpirtërore. Sa do që të punojmë në kënaqjen e vetvetes tonë, në pafundësinë e iluzionit nuk mund të arrijmë kënaqësinë e vërtetë. Ajo që qejfet janë kalimtare i hap rrugë pangopësisë, ndërsa shpirtin e shqetëson.

E vërteta e dytë. Ka të bëjë me problemin e burimit të dhembjes. Burime të dhembjes janë qejfet, që gjallesat i çojnë prej lindjes në lindje, dhe dëshira për të jetuar apo dëshira për t'i kënaqur qejfet, që i shoqërojnë dhembjet. Ajo është dashuria ndaj jetës, etja dhe dëshira për të jetuar. Edhe në raste të sëmundjeve të dhembshme dhe të rënda, për të jetuar edhe pak, flijojmë shumë.

E vërteta e tretë. Çështja e zhdukjes së dhembjeve. Të njohësh ekzistencën se është dhembje, do të thotë të shkrishë dëshirën për të jetuar, të cilën e ushqejnë ndjenjat dhe shqisat. Sikur që flaka e llambës kur nuk ka vaj shuhet, ashtu edhe gjëja të cilës i thuhet jetë dhe “unë” zhduken sikur t'i shuash dëshirat për të jetuar. Por, dëshirat epushore, sikur urrejtja dhe mahnitja, i nxjerrin në shesh tre dobësitë e njeriut dhe përsëri e ndezin flakën e jetës. Të gjitha dëshirat për jetë vijnë nga etshmëria e epushit për jetë, i cili gjithmonë e shton peshën e karmasë. Kështu që jeta vazhdon të rrjedhë me një përsëritje të përhershme. Përkundër kësaj njohja e Skandhasit (se bota dhe jeta janë dhembje), i dobëson lidhjet e botës. Ndërsa etshmëria, e cila është kundër të jetuarit, zhduket me zhdukjen e katër të këqijave themelore të botës, të cilat janë: dëshirat epushore, qejfet për të ekzistuar, besimet e kota dhe injoranca.

E vërteta e katërt. Ka të bëjë me rrugën që çon në largimin e dhembjeve. Këto janë tetë rrugët e shenjta:

Besimi i drejtë, të duash drejt, të flasësh drejt, të lëvizurit drejt, të jetuarit drejt, vendimi i drejtë, të menduarit drejt (sati), të medituarit drejt.

E para nga katër të vërtetat e shenjta neve nuk ka rëndon shumë. Ndërsa të tjerat ballafaqohen me kundërshtimet e epushit tanë. Normalisht ne nuk e pëlqejmë aq okupimin me dhembjet. Ato mundohemi t'i hedhim pas perdes së ndjenjave tona. Besojmë se të merresh me to do të thotë që jetën ta vështirësosh. Sa që, duke u larguar nga të shprehurit e drejtpërdrejtë të tyre, mundohemi që t'i shpjegojmë të maskuara. Për këtë dhe në çdo gjuhë hasim në shumë terma të formave të ndryshme dhe të maskuara, që kanë të bëjnë me vdekjen, jetën seksuale, sëmundjen, procesin e tretjes etj. Për shembull, në lidhje me vdekjen përdoren edhe shprehjet: njeriu nuk vdes ai jep frymën e fundit, ai zhytet në gjumin e përhershëm, ai ndahet nga bota, ai kthehet tek krijuesi, ai shkon në anën tjetër, ai takohet me mëshirën e të vërtetë etj. Të gjendurit ballëpërballë me realitetin e vdekjes shpreh një brengë të panjohur, mundohemi që të vërtetën ta shprehim në mënyrë indirekte. Që të mos e shohim realitetin në ngjarjet zemëruese i mbyllim sytë tanë. Mërzitemi të shohim trupin dhe e kthejmë fytyrën. Me një shprehje tjetër, për të marrë shijen e jetës, për të qëndruar larg dhembjeve, sikur struci që kur e sheh gjahtarin, kokën e fut në rërë, sytë i mbyllim. Edhe Buda thotë se në botë çdo gjë, edhe këto të vërteta nga përmendja e të cilave u përmbajtëm, është dhembje. Për të shpjeguar se të kuptuarit e këtyre të vërtetave nuk është shumë vështirë, jep një shembull:

“Dy shtiza të hedhura nga larg njëra pas tjetrës, që të qëllonjë në një birë të gjilpërës është shumë vështirë. Që një qime e ndarë në një qind pjesë, të zërë apo ta shpojë një qime tjetër të ndarë në po aq pjesë është shumë më vështirë. Ndërsa, të kuptuarit e të vërtetës se çdo gjë në botë është dhembje, është shumë më vështirë se këto.”

Sidomos për popullin ka pesë ndalesa etike:

“Do të qëndroj larg vrasjes së krijesave të gjalla;

Do të qëndroj larg nga papastërtia/padëlirësia;

Do të qëndroj larg marrja e asaj që nuk më jepet;

Do të qëndroj larg gënjeshtërisë;

Do të qëndroj larg çdo materieje dehëse dhe narkotike.”²⁰⁴

Më vonë priftërinjtë këtyre ua kanë shtuar edhe pesë ndalesa të tjera. Këto janë:

“Të qëndruarit larg të ushqyerit të pakohë; të qëndruarit larg nga vallëzimi, kënga, muzika dhe lojërat publike; të qëndruarit larg çdo stolie dhe të stolisurit me kurore, larg erërave të mira dhe kremrave të ndryshme; të qëndruarit larg të fjeturit në krevate të mëdha dhe të larta.”²⁰⁵

Budizmi nuk i pranon kastat shoqërore. Budistët thonë se, “sikurse lumenjtë që pasi që derdhen në dete e humbasin emrin e tyre, ashtu edhe emrat e kastave humbasin pas futjes në rendin e Budës”. Varfëria që paramendohet për priftërinjtë, nuk e përfshinë edhe popullin. Mundimet e popullit për tregti, bujqësi, ushtri, për shtimin e pasurisë dhe për të shpëtuar nga vjedhësit, nuk shihen si të vogla. Ata thonë se, nuk do të habitemi dhe nuk do të gëzohemi as në fitim dhe as në humbje.

d. Koncepti për jetën e pas vdekjes

Budizmi mëson se, shpirtërat përsëriten në forma të ndryshme të krijesave dhe trupëzohen. Shpirtërat e atyre që bëjnë punë të këqija, pas vdekjes së bashku me karmanë e keqe një kohë të gjatë dënohen në ferr dhe pastaj lindin në tokë me një trup tjetër. Ndërsa ata që kanë bërë punë të mira, e fitojnë shpërblimin e të qëndruarit në botën e zotave. Ata sipas përsosmërisë shkojnë në njërin prej kateve të parajsës dhe një kohë qëndrojnë atje. Kurse dijetarët, nuk i japin rëndësi as jetës së këndshme të botës së zotave, sepse e dinë se edhe ekzistencat qiellore një ditë do të kthehen përsëri në jetën me mundime të kësaj bote. Edhe jeta e lumtur e zotave është kalimtare. Ndërsa lumturia e vërtetë arrihet me shpëtimin përfundimtar nga dhembjet, gjegjësisht, ajo bëhet vetëm me arritjen në Nirvana.

Ç’është Nirvana? Fjala *Nirvana* ka kuptimin *të shubet, të fiket, të pushojë*. Sipas mendimit të fraksionit Hinajana, (Nirvana) është shpëtim që në këtë botë nga tre ngarkesa, urrejtja, ambicia dhe shpresa e kotë. Një i shenjtë që e realizon këtë me vdekjen e tij zhduk të gjitha llojet e shkaqeve që e përbëjnë ekzistencën. I zhduk mundësitë për t’u trupëzuar përsëri. Në këtë rast Nirvana do të thotë një hiç. Ka edhe të atillë që Nirvanën e krahasojnë me një vend të zbrazët. Por ky është një hiç relativ e jo absolut. Ata që mund të arrijnë atje, arrijnë dëshirat mbinatyrore të cilat nuk mund të shpreheshin me fjalë.

Ndërsa fraksioni Mahajana, Nirvanën e krahason me fikjen e llambës dhe mendimin e fraksionit Hinajana e cilëson si një Nirvana pa cilësi. Ai thotë se, me rëndësi është Nirvana e vërtetë dhe e lartësuar të cilën e ka arritur Bodhisattva, që është një gjendje e lëvizshme e jo e palëvizshme. Njeriu i shenjtë që është ngritur në këtë pozitë ka shpëtuar nga injoranca, dhembjet dhe karma dhe në mënyrë të përhershme punon për lumturinë e të gjitha gjallesave.

Budizmi është një sistem që mëson shpëtimin individual. Shpëtimin e përgjithshëm nuk e sheh të mundshëm; sepse numri i krijesave është në një madhësi të pakufizuar. Individit mund të arrijë shpëtimin, gjegjësisht Nirvanën, vetëm duke kaluar nëpër krijesat të panumërta dhe duke e braktisur gradualisht vetveten dhe botën. Budizmi nuk pranon një ditë ringjalljeje dhe llogarie, siç është në islam.

dh. Murgëria (Sangha)

Në mesin e budistëve ndarja më e madhe është midis murgjive dhe popullit, që jeton një jetë normale. Murgëria përbën thelbin e budizmit. Në fakt kushteve për të arritur qëllime të larta mund t’u përshtaten vetëm murgjit. Murgjit jetojnë në bashkësi ose të vetmuar. Murgërisë i thuhet “sangha”. Sangha natyrisht përbën një pjesë të komunitetit budist. Përpjesëtimi në mes tyre dallon në bazë të

²⁰⁴ Lahnemann, f. 166.

²⁰⁵ Vep. e cit.

kohëve dhe shteteve të ndryshme. Për shembull, në Kinë në vitin 450 të e.s. ka patur 77258 murgj dhe murgësia, ndërsa pas 75 viteve, në vitin 525 të e.s. numri i tyre ka arritur në 2.000.000. Në Cejlon në vitin 450 të e.s. ka patur 2500 murgj, kurse në vitin 1901 numri arriti në 7300 të tillë.

Murgjit përbëjnë klasën e lartë të budizmit. Me fjalë të tjera vetëm këta janë budistë të vërtetë. Është e pamundur që dallimi jetik të zhduket dhe të bëhet një pajtesë mes murgjve dhe jo murgjve. Sa do që të thubet se edhe jomurgjit mund të arrijnë në Nirvana, për ta është e domosdoshme që ta braktisin jetën. Një murg me jetën e tij aktuale mund të arrijë në Nirvana vetëm nëse në jetën e mëparshme të tij ka bërë një jetë murgu. Ndërkaq, fraksioni mahajana shkon edhe më tej, dhe e pranon se edhe jomurgu me mundin e tij mund të bëhet një Buda i pavarur. Vetëm se ky është si një njeri në mes të hajdutëve në majë të malit, që dridhet nga frika dhe dëshiron të shpëtojë nga kjo gjendje, ky duhet të punojë që të shpëtojë dhe të urrejë jetën epshore.

Jeta në manastir është e përcaktuar në bazë të rregullave Hinajana. Shprehja rrjedh nga fjala "vinajati" që ka kuptimin "ai që të çon nga ligësia në mirësi, nga kaosi në rregull". Murgjit punojnë që t'i realizojnë rregullat e Hinajanas. Rregulli i manastirit është përcaktuar në rregullat "pratimoksha". Fraksione të ndryshme numrin e këtyre rregullave e tregojnë mes numrit 227 dhe 253. Këto në burime të ndryshme dhe në forma shumë të përafërta përsëriten. Fjala prati-moksha ka kuptimin "të kthesh nga gabimet ose të pasjësë me parzmore (pancir)".

Jetën e murgut e përbëjnë tre norma thelbësore: varfëria, beqaria dhe qetësia. Murgjit nuk kanë pasuri aspak. Vetëm se atyre u është e lejuar që të bartin një këmishë të gjerë dhe të gjatë të përbërë prej leshi, një pjatë lëmoshe, një gjilpërë, një tespil, një brisk për të qethur kokën një herë në dy javë dhe një kullësë për të filtëruar ujin e pijshëm nga gjallesat e vogla (insektet). Në fillim teshat e tyre bëheshin duke i arnuar/qepur leckat e grumbulluara nga mbeturinat e fshatrave dhe të ngjyrosura me saf-ran/krokull. Më vonë në formë lëmoshe nga ana e besimtarëve filloi t'u dhurohet stof anteri. Teorikisht murgjit ishin të detyruar të jetonin pa shtëpi dhe pa atdhe. Më herët kërkohej që ata të jetonin në pyll, nën qiell, nën hijen e një druri. Vetëm se më vonë, edhe pse e papëlqyeshme, u lejua që të jetojnë në manastire, tempuj, shtëpi dhe shpella dhe jeta e re plot me rreziqe u cilësua si jetë luksoze. Kurse ushqimin e tyre e sigurojnë vetëm me anë të lypjes lëmoshë. Një kohë të gjatë ka qenë i ndaluar edhe posedimi i parave. Pas themelimit të rendit disa nga Vaishe-ja (Vaiseli) u munduan që ta prishin këtë rregull. Kjo çështje u bë shkak i një krize të rrezikshme brenda rendit. Edhe pse më herët ishte marrë vendimi për rregullat, edhe më vonë nga ana e murgjve nuk iu dha rëndësi posedimit të pasurisë si para, tokë etj.

Në rend, guri i lëmoshës është shenjë e lartësimit të Budës. Shumë statuja Budën e paraqesin me tasin e lëmoshës dhe kjo simbolizon të qëndruarit larg pa pjesëmarrje në sundimin e botës. Shumë budistë të mëdhenj pasuesve të tyre më të rinj, si shenjë e dorëzimit të autoritetit, u kanë dhuruar pjatat që i kanë përdorur për mbledhjen e lëmoshës. Murgjit besojnë se lypësia është burim i të jetuarit dhe nuk ndjenjë asnjëfarë poshtërimi. Ata këtë nuk e ndjejnë si përtaci dhe dembeli. Përkundrazi, ata besojnë se kjo ndihmon në verbërimin e epshit dhe në ushtrimet e meditacionit. Gjithashtu besojnë se, dhënia lëmoshës është virtyti më i lartë për dhuruesit. Për shkak të lypësisë në shumë raste ballafaqohen me ngjarje nënçmuese. Ata nuk fyhen edhe nga shprehjet si kokëtullac etj. Ndërkaq sipas tyre, rruga më e mirë e zhdukjes së mburrjes është lypësia. Përsëri ata mësojnë që të jetojnë me pak, të jenë të kënaqur me të dhe të zhdukin skepticizmin dhe zemërimin. Qëndrimi i virtytshëm, i qetë dhe i shkujdesur ndaj lypësve dhe ndaj pasurisë botërore i forcon besimtarët dhe bëhet shkak për pranimin e kësaj feje nga ana e shumë njerëzve të tjerë.

Që në fillim është themeluar edhe rendi i grave. Sipas trasnmetimit, Buda, për shkak të paqendrueshmërisë karshi tentimeve të dadës së tij Mahapachapati dhe nxënësit të tij Ananda-së, kanë dhënë leje për themelimin e rendit të grave.

Beqaria përbën themelin e jetës. Qëndrimet e një murgu ndaj grave dhe murgësive, të cilat i takon në rrugë, janë të varura prej rregullave definitive. Marrëdhëniet jashtë rregullave, janë shkak për nxerrjen nga rendi. Beqaria (Brahmaxharja) është ideali më i lartë. Edhe në rrezik vdekjeje nuk mund të hiqet dorë nga kjo. Ndërsa fraksioni Tantra çështjen e shikon më mirëkuptim dhe e lejon martesën e murgjve. Mbrojtësi i fraksionit Shonim Shinran është martuar dhe ka jetuar si njerëzit e tjerë.

Paqja dhe qetësia, si në xhajnzëm, urdhërojnë që të mos fyhet asnjë gjallesë dhe bazohen në dy themele: E para është besimi se të gjitha gjallesat janë familje njëra me tjetrën. Ky besim mbështetet në doktrinën e reinkarnacionit. Nëse një krijesë e gjallë sot është njeri, nesër mund të jetë një lepër, pastaj një mollë, pastaj përsëri një kalë etj. Kush sillet keq ndaj një kafshe, ndoshta në një kohë në të ardhmen do të gjendet edhe vetë në gjendjen e keqe të asaj kafshe. Mund të sillet keq ndaj nënës që i ka vdekur apo ndaj ndonjë shoku të tij. Të ndjejmë të njëjtën gjë që e ndjejnë edhe të tjerët, me qëllim që

edhe të tjerët të ndjejnë atë që e ndjejmë ne. Nëse ne e zhvillojmë virtytin e ndjeshmërisë nuk do t'u bëjmë keq të tjerëve. Sikurse ne nuk i bëjmë keq vetvetes tonë, ashtu nuk do t'i bëjmë keq të tjerëve. Me shtimin e dashurisë ndaj vetvetes do t'i bëjmë keq të tjerët të na duan dhe do ta shembim kufirin ndarës mes nesh dhe atyre.

Ky qëndrim i budizmit ka ndikuar shumë edhe në zhvillimin e marrëdhënieve njerëzore. Në shtetet, si Burma, ku budizmi është plotësisht i vendosur, miqësia dhe dashamirësia e njerëzve tërheq vëmendjen e vëzhguesve.

Më kujtohet një pyetje: A thua vallë në mesin e budistëve, që nuk i mbytin as gjallesat më të vogla, nuk ndodhin zënka fetare? Për fat të keq, njeriu në çdo skaj të botës është i njëjtë. Edhe pse budizmi nuk është një dogmë, por një rrugë, një filozofi, si në çdo fe tjetër, ka shfaqje jotolerante. Në fetë me doktrinë dogmatike, ai që del nga dogma llogaritet i devijuar (beretik). Ekstremizmi mes tyre pjesërisht mund të shihet i logjiksibëm. Është shumë vështirë mbrojtja absolute e mendimit të drejtë dhe të gabuar, doktrina e të cilit është një rrugë, një metodë. Megjithatë në përhapjen e budizmit rol të rëndësishëm kanë luajtur sundimtarët, të cilët kanë përdorur forcën. Kështu që murgjit, kryetarët e shteteve që nuk u kanë shkuar për qejf i kanë rrëzuar nga fronti. Në vitin 900 të e.s. sundimtari i Tibetit Lang Dharma është rrarë nga një murg. Historia e Tibetit zyrtar, vrasësin e laudëron, sepse "ai ka treguar mëshirë ndaj sundimtarit dhe ka penguar që mëkatet e sundimtarit të shtohen". Në vend që ta fajësojnë, ata murgun vrasës e llogaritin prej njerëzve të shenjtë. Në shek. XI. Mbreti i Burmas, Anuruddha, për t'ia marrur shkrimin e shenjtë mbretit të shtetit fqinj, Tathanit, i hap luftë. Edhe njerëzit e Burmas në vitin 1930 nën udhëheqjen e Saja Sanit janë ngritur kundër anglezëve dhe kanë bërë luftë. Kur të përkujtojmë luftërat e Vietnamit dhe të Kamboxhias, shembujt e këtyllë mund t'i shtojmë edhe më tepër.

e. Adhurimi në budizëm

Edhe pse në budizëm nuk thuhet asgjë në lidhje me adhurimin dhe ekzistencën e Zotit, përsëri me parimet etike që i ka vendosur dhe kultet e zhvilluara më vonë, ka formuar një kulturë adhurimi. Së pari dolën stupat, në të cilat fshihen kujtimet e Budës, dhe pastaj dolën pagodat, në të cilat ishin të vendosura statujat e Budës dhe të njerëzve të tjerë të shenjtë. Adhurimi dhe respekti ndaj Budës bëhet duke stolisur statujat e Budës me lule dhe veshje dhe duke kënduar lëvdata muzikale. Adhurimi bëhet në mënyrë individuale. Kur hyhet në pagoda nderohet statuja e Budës. Ndizet famigant (me erë) dhe qiri. Bëhet lutje për t'u falur gabimet që janë bërë. Kurse nëpër shtëpi ka një kënd ku gjendet statuja ose fotografia e Budës dhe lutjet bëhen aty.

Budistët, në përgjithësi, të vdekurit i djegin. Por, kjo nuk është një praktikë e përgjithshme. Trupat e atyre që janë të varfër dhe të fëmijëve varrosen. Ndërkaq, familjet e pasura të vdekurit i djegin. Për familjet që kanë dhembje bëhen këshilla fetare dhe ngushëlluese.

ë. Rrymat kryesore të budizmit

Budizmi sot ndahet në dy fraksione kryesore. Këto janë Hinajana dhe Hahajana. Në hinajana bien në sy "Fraksionet e vjetra të urtësisë". Këto janë shfaqur afërsisht 200 vjet pas arritjes së Budës në Nirvana dhe janë zhvilluar në dy drejtime. Në Indinë Lindore është fraksioni Therevadin, i cili ende sot është fraksion dominues në Cejlon, Burma dhe Siam (Tajlandë). Ndërsa tjetri është Servastivadin, i cili është zhvilluar gjatë 1500 viteve në Perëndim, qendra të të cilit janë Mathura, Gandhara dhe Kashmiri. Edhe sikur të ketë fraksione të tjera, ne për ta nuk kemi njohuri. Edhe pse Mahasanghika, në vitin 250 para e.s. në Magadha dhe në Indinë Jugore veç nga "Fraksionet e vjetra të urtësisë", formon një fraksion tjetër budist, me zhdukjen e budizmit në Indi, edhe ky fraksion zhduket krejtësisht.

Aspekti liberal i Mahasanghika-së është zhvilluar nën emrin Mahajana, që është një fraksion i ri, dhe brenda 400 vjetësh është ndarë në grupe të ndryshme. Fraksioni Madhjamika i formuar nga Nagarxhuna në vitin 150 të e.s., shpëtimin e sheh në realizimin e urtësisë. Një fraksion tjetër që është afër madhjamikas, shpëtimin e sheh në besim në Budën dhe Bodhisattvanë që është shpëtimtari Budist.

Ndërsa fraksioni jogaxhara, që me ndikimin e filozofisë sankhya-joga është formuar në vitin 400 të e.s. nga Asnaga, shpëtimin e sheh në meditacion dhe trans. Me zhvillimin e Tantrasë në hinduizëm, fraksioni vaxhrajana (qerreja e xhevahirtë), që është formuar në vitin 500 të e.s. dhe është një formë magjike e budizmit, shpëtimin dhe shndëritjen e sheh në ushtrimet magjike. Është i përhapur, sidomos, në Nepal, Tibet, Kinë, Japoni, Java dhe Sumatra. Gjithashtu edhe nga bashkimi i mahajana-së me

shumë elemente lokale kanë lindur shumë fraksione. Nga fraksionet me rëndësi në Japoni dhe Kinë janë han dhe amidizmi, kurse në Tibet Nuing-Ma-Pa.

g. Përhapja e budizmit

Budizmi, edhe pse është një lëvizje pothuajse e murgërisë, ka nevojë për një masë të gjerë të popullit, që me ta të mund të mbijetojë. Siç e pamë edhe më lart jeta e murgjve varet prej masës së besimtarëve të popullit. Murgjit ushqimin e jetës nuk mund ta sigurojnë vetë, por jetojnë me lëmoshën dhe dashurinë e popullit. Ata veten e quajnë përgjegjës për hyrjen e popullit në rrugën e shpëtimit dhe besojnë se doktrina (dharma) duhet të ndahet edhe me të tjerët. Për këtë ekziston edhe një aksion misionarësh i fuqishëm. Mbreti Ashoka, si një sundimtar shembullor, për t'ua bërë të njohur të vërtetën edhe të tjerëve, në shtetet fqinje ka dërguar misionarë. Njëri nga apostujt e Budës, duke qenë Buda gjallë, Purna, për të shkuar vetë si misionar në vendet barbare të quajtura Sronaparanta, kërkon leje nga Mësuesi i tij. Buda mundohet që atë ta bindë që të heqë dorë nga ky vendim dhe pas bisedës së zhvilluar mes tyre Buda i jep leje që të shkojë si misionar:

“Buda: Populli në Stronaparanta është i egër, përdorë forcën dhe është tiran. Karakteri i tyre është të nënçmojnë njëri-tjetrin, të shpifin dhe t'i akuzojnë njerëzit e tjerë. Nëse ty të nënçmojnë me fjalë të këqija dhe boshe, të shpifin dhe të akuzojnë, ti çfarë bën?

Purna: Në këtë rast do të mendoj se populli i Sronaparanta-së është me të vërtetë i mirë dhe simpatik. Sepse mua mund të më rrihnin dhe të më gurëzonin.

Buda: Nëse të rrahin dhe të gurëzojnë, ti çfarë bën?

Purna: Në këtë rast mendoj se ata janë njerëz të mirë dhe simpatikë, se nuk u nisën drejt meje me kamxhik dhe armë.

Buda: E nëse nisen për tek ti me kamxhik dhe armë, ti çfarë bën?

Purna: Mendoj se ata janë njerëz të mirë dhe simpatikë dhe se mua nuk më mbytn.

Buda: Purna, nëse ata të mbysin, ti çfarë bën?

Purna: Në këtë rast mendoj se ata janë njerëz të mirë dhe simpatikë, sepse ata duke mos më dhënë zahmet do të më shpëtojnë nga ky trup i keq. Unë e di se ata murgjit, të cilët janë turpëruar dhe e kanë urrejtur trupin e tyre, i kanë mbytur me armë, i kanë helmuar, i kanë varur ose i kanë hedhur në ndonjë humnerë.

Buda: Purna, ti je shumë trim dhe njerëzor. Mund të jetosh në vendin Sronaparanta. Atje shko dhe mësoi ata, bëhu i lirë si të duash!”²⁰⁶

Disa supozojnë se hinajana nuk ka bërë aq aksion misionerik sa mahajana. Por, kjo njohje nuk është e qëlluar. Edhe hinajana, sikur mahajana, është përhapur deri në Cejlon, Burma, Tibet, Kinë, Java dhe Sumatra. Ndërsa mbajtja e mahajanasë në Tibet dhe Kinë, është arritur ngase ky fraksion është më i përshtatur për popujt e atij rajoni. Për shembull, Mbreti i Tibetit në vitin 750 në Tibet e ftoi Sarvastivadinin e fraksionit hinajana, i përhapur në atë kohë në Kashmir dhe Azi të Mesme. Por, për shkak që shumica e popullit dëshironin një fe me magji, Sarvastivadini në Tibet nuk arriti sukses.

Të mos ishte mbrojtja e perandorit dhe e mbretit, edhe fitorja e budizmit në Azi nuk do të ishte e mundshme. Mbreti Ashoka (274-236 para e.s.), që është njëri nga sundimtarët më të mëdhenj të Indisë, budizmin e ka përhapur në Indi, Cejlon, Keshmir dhe Gandhara. Sa që ka dërguar misionarë edhe në oborrin grek. Budistët, më vonë, e kanë patur edhe mbrojtjen e Kanishkasë (78-103 t. e.s.) sundimtarit iskit, i cili ka sunduar në Indinë Veriore. Ata kanë shfrytëzuar edhe mundësitë e fisit Pala dhe Harshavardha (606-647), që ka qenë nën udhëheqjen e Bengalit. Ndërsa jashtë Indisë, budizmin e kanë ndihmuar edhe perandorët dhe perandoreshat e Kinës, kanat e Mongolëve dhe burrshtetasit e përparuar të Japonisë.

Shumë burra shtetesh për shkaqe politike e kanë përkrahur budizmin. Mungka Kani, aq sa i ka mbrojtur budistët, aq i ka mbrojtur edhe të krishterët nestorianë dhe taoistët. Sipas tij, të gjitha fetë janë si gishtërinjtë e një dore. Kubilaj Kani, edhe pse përparësi i ka dhënë nestorianizmit, edhe budizmit i është përrulur. Mbreti Kanishka, njërën anë të monedhave që i ka shtypur e ka stolisur me zotët e Iranit

²⁰⁶ Conze, *Der Buddhismus*, f. 66.

dhe Indisë, kurse anën tjetër e ka stolitur me vizatimet e Budës duke qëndruar në këmbë dhe poshtë me shkronja greke ka shkruar fjalët Boddo dhe Boudo. Mbretërit Gupta, i kanë ndihmuar si budizmit, ashtu edhe vishnuizmit. S'ka dyshim se sundimtarët, para së gjithash janë munduar për vazhdimin e sundimit të tyre. Shkaku i paraqitjes së qëndrimeve tolerante ndaj budizmit është se ata krahas besimit të tyre, pak apo shumë janë përkujdesur për sundimin e tyre. Sepse budistët dëshirojnë një qetësi në botë dhe atyre që e duan botën ua lehtësojnë (realizimin e qëllimeve të tyre). Me atë se bota është një vend dhembjeje dhe se duhet të përmirësohen gabimet, i mbulojnë gabimet e udhëheqësve dhe nuk i kritikojnë. Madje, ata sundimtarë që u ndimojnë, i shohin si Bodhisattva. Në një shkrim uigur të mbetur që nga viti 1326, Xhengiz Kanin e cilësojnë si lindje e fundit e Bodhisattvasë. Sipas njoftimeve mongole, Kubilaj Kani është një Xhakravartin, një njeri i shenjtë. Historianët, sundimtarët e Tibeit dhe të Mongolisë i llogaritin në pëgjithësi si “Buda që jeton”.

gj. Budizmi tibetian ose lamaizmi

Fraksioni budist mahajana, i cili në Tibeit ka shkelur në shek. VII., atje arriti një zhvillim të posaçëm. Më herët këtu gjendej “feja Bon”, e cila bazohet në animizëm dhe shamanizëm, kurse edhe sot pjesëtarët e kësaj feje jetojnë në jug dhe veri të shtetit. Njerëzit që jetojnë në këtë vend malor të Himalajave, veten e shohin nën kërcënimin e forcave të padukshme, magjistarët dhe xhinët i besojnë si shpëtimtarë. Këta gjatë kohës janë bërë murgj budistë. Në Tibeit është zhvilluar një krah i fraksionit Mahajana i quajtur Mantra ose Tantrizëm. Shumë ceremoni përplot me fjalë magjike, rite kulti dhe formula betimi, kanë fituar peshë. Fjala “*Tantra*” përdoret për perin që përdoret në endje. Ai llogaritet si “*formulë*” e fshehtë, e padukshme, me anë të të cilës bëhen ushtrimet e përshtatshme. Këtij fraksioni i thuhet edhe “qerreja prej xhevahiri”. Këtu me rëndësi është leximi i *Mantrasë*: fshehtësitë e pakapshme me ndjenja dalin në shesh nga fuqia e teksteve me fjalë misterioze. Sikur që është në konceptin e mbikqyrjes në islam, trupi, zëri dhe shpirti ndikojnë bashkërisht. Në ushtrime pozita e trupit është shumë me rëndësi. Në Tantrajana meditacioni bëhet në katër shkallë:

1. Zbrazëtia e teshës,
2. Të menduarit e temave të tantrasë (për shembull, om mani padme hum),
3. Ta përfytyrosh vetveten në formë dhe në vend të shpëtimtarit,
4. Meditacioni për të qenë bashkë dhe një me shpëtimtarin (Buda, Bodhisattva).

Fraksioni posedon një literaturë të pasur. Shumë tekste në gjuhën indiane janë përkthyer në gjuhën tibetase dhe me komentimet e murgjve është formuar një bibliotekë e pasur me shkrime të shenjta sa që përbëjnë mbi 300 vëllime. Kjo seri e librave të shenjtë formën e fundit të tyre e kanë marrë në vitin 1300 të e.s. Organizata e murgjve tibetianë e quajtur Lama, ka treguar një zhvillim të posaçëm. Sepse këtu murgjit janë të ndarë nga kolegët e tyre të shteteve të tjera budiste. Këta nuk merren vetëm me punë fetare, por merren edhe me politikë, shumë poste sunduese i mbajnë në dorë si autoritete botërore. Një e shtata e popullit është në klasën e murgjve. Murgjit me 3000 manastire e kanë në dorë fuqinë ekonomike të shtetit. Për këtë dhe Tibeit i thuhet “parajsa e murgjve”. Në fillim nuk ishte e ndaluar martesja e murgjve, për këtë dhe janë formuar fise murgjish sundues. Por, në shek. XV. me përpjekjen e reformatorit Tsung-Kha-pa (1356-1418), u bë e domosdoshme veshja e teshave të verdha, si shenjë e murgjve, dhe të bartin një pjatë për ndihmë, kurse rreptësisht u ndalua pirja e alkoolit, martesja dhe, sidomos, magjia. Gjithashtu këtyre iu shtua edhe besimi në Lamanë. Prandaj doli “fraksioni i verdhë”. Doktrina e Budës mori një kahje të re. Pasardhësit e Budës filluan të kërkohen në mesin e fëmijëve, të cilët lindin në orën e vdekjes së dalajlamave. Në trupin e ri të fëmijës të gjetur shihet Dalajlama, personi i shenjtë i mëparshëm. dalajlamatë fronin e tyre, që nga koha e Tsung-kha-pa, e kanë patur në Lhasa, kryeqytet i Tibeit.

Ndërsa Lama i ri, me një sistem të rrallë kërkohet në mes të fëmijëve meshkuj. Që nga shek. XV. i pari i Lamaizmit ose Budizmit tibetian nuk vjen me trashëgimi gjaku, siç është rasti me mbretërit, e as me zgjedhje, si rasti me papët. Këtu masë është trashëgimia shpirtërore e inkarnacionit. Këtu vështirësia është në njohjen e inkarnacionit të vërtetë apo pasardhësit të vërtetë të Budës. Njohja dhe gjetja shekuj me radhë bëhet me rregulla të njëjta. Për Laman, pasardhësin e fundit, që ka lindur në një shtëpi të një fshati kinez 40 km në lindje të Manastirit Kumbum, 49 ditë pas vdekjes së Lamas së Madh, jepet kjo kronikë: “Tash vizita i bëhet Pabo Dangrubas, i cili ka lindur më 6 qershor 1935. Fëmija ata që hynë

brenda, i priti me kujdes dhe briti “Sera Lama” dhe vrapoi drejt prijësit të grupit të udhëtarëve, që ishte i veshur me tasha shërbëtori. Pa ngurruar fare i përqafoi teshpihët e mbetur nga Dalajlama i 13. Murgjit të nesërmen erdhën me teshat origjinale të tyre dhe fëmijën e provuan në bazë të parimeve. Ai ishte i detyruar që edhe një herë në mes të katër teshpihëve të njëjtë të gjejë teshpihët që i ka përdorur më herët Dalajlama. Gjithashtu në mesin e shumë daulleve e ka njohur saktësisht daullen e Dalajlamasë, të cilën e ka përdorur për t’i thirrur shërbyesit e tij. Po ashtu, në të njëjtën mënyrë fëmija, pa mos shëtitur aspak me bastunë të tjerë të stolitur me argjend dhe fildish, menjëherë e mori bastunin e Dalajlamasë së vjetër. Edhe trupi i fëmijës kur u kontrollua, në të u gjetën shenja që argumentonin se ai është inkarnacion i Budës: në të gjendet vend edhe për dy krah të tjerë, që e pëshkruan zotin Patmapani që ka katër krahë dhe kokë të madhe”.²⁰⁷

Çështja e bartjes së fëmijës në Tibet u zgjodh me pagesën e një shume të madhe qeverisë së Çiang Kaj Shek. Edhe pse çmimet e shpëtimit në kontaktet e bëra janë rritur, më 1939 fëmija pati mundësi që ta braktisë Kinën dhe në shkurt të vitit 1940 me një ceremoni u ul në fron në Lhasa. Në të njëjtën kohë bashkë me ceremonitë ai mori edhe tituj dhe emra si, “i Shenjtë, Ligjërues, E Vërteta Absolute, Doktrinë e Vërtetë, Oqean i Madh, Xhevahir i Madh i Fitores”.

Këtu shihen konceptet e para të shamanizmit dhe budizmit. Dalajlama është një mëkëmbës dhe “një Zot që jeton”. Ai është një Buda shpëtimtar. Ai krahas detyrave si ndërmjetësues në mes kësaj bote dhe botës tjetër, shërbime murgërie, ai udhëheq edhe politikën e Qeverisë së Tibetit. Atij i ndihmonte Pançen Lama ose Rinpoçe, i cili qëndronte në Manastirin Taçilhumpol. Edhe ai gjithashtu gjendet në rrugën e njëjtë si të Dalaj Lamasë dhe llogaritet si inkarnacion i Buddha Amitabha. Pançen Lama jeton një jetë shpirtërore si njeri i dytë i Tibetit dhe si një dijetar më i madh. Gjatë kohës kur Dalaj Lama ishte sundimtari më i lartë botëror i Tibetit në fronin në Lhasa, Pançen Lama ishte përgjegjës për punët fetare.

Ndërsa zhvillimet më të vonshme në Tibet situatën e kanë ndryshuar plotësisht. Pas sundimit të Tibetit nga Kina e Kuqe, Pançen Lama si simpatizant i komunizmit e vazhdon sovranitetin e tij politik, kurse Dalaj Lama është detyruar që ta lëshojë shtetin dhe sot të jetojë si refugjat në Indi.

Numërimi i panteonit të zotëve të lamaizmit do të ishte një punë shumë e lodhshme. Këtu bien në sy hyjnitë, hyjneshat dhe format e ndryshme të kulteve fetare, gjithashtu bie në sy edhe një kaos fetar me figura gjigante të trishtueshme dhe të zhveshura të fesë së vjetër Bon. Formën dhe madhësinë e kësaj feje e rritin edhe njëherë recetat e lutjeve, teshpihët, prodhuesit e letrave magjike, flamujt e lutjeve, letrat e shkruara me formula të shenjta, rrotat e mëdha të mbushura plot me formula lutjesh që rrotullohen nga kalimtarët ose varen nëpër tempuj. Kur rrotat e lutjes rrotullohen nga era ose nga lëvizja e kalimtarëve shqiptohet formula e lutjes e njohur e lamaizmit, “Om Mani Patme Hum”. “Om” dhe “Hum” janë fjalë magjike të mbushura plot me mistere. “Mani” ka kuptimin xhevahir ose Buda, ndërsa “Patme” lule lotus. Ka të atillë që këto fjalë i komentojnë me kuptime magjike dhe si demon.

h. Budizmi kinez

Sipas transmetimeve të vjetra, budizmi Mahajana për së pari herë në Kinë ka ardhur në vitin 61 të e.s. dhe në shek. e VI. u bë fe shtetërore e Kinës. Budizmi kinez ka krijuar një përmbledhje të shkrimeve të shenjta që për nga përmbajtja janë 700 herë më tepër se Kur’ani. Pjesa më e madhe e tyre është përkthyer nga sanskritishtja dhe janë shkrime Mahajana. Në Kinën e vjetër kjo literaturë voluminoze është bërë shkak për themelimin e 10 fraksioneve budiste. Fraksioni që është më i përhapur mes njerëzve dhe që i jep rëndësi praktikës është “Çan-tsung” (japonisht Zen) dhe “Tsing-to” (japonisht Xhodo).

Fraksioni Çan-tsung (Zen)

Ky fraksion me meditacion është drejtuar drejt shndëritjes së brendshme. Rrënjët e tij zgjaten deri te Bodhidarma, i cili është njëri prej mistikëve të shek. VI. Sipas transmetimit ky person, ka qëndruar në meditacion nëntë vjet para një muri. Njëra prej fjalëve të njohura të tij është shprehja “Shiko zemrën tënde, aty do të shohësh Budën”. Sipas një thënie të Fraksionit Zen, Buda një ditë, në vend që të sqarojë apo të komentojë doktrinën e tij, përpara dëgjuesve të tij e ka ngritur një lule dhe luleja ka

²⁰⁷ Schoeps, *Religionen*, f. 208.

buzëqeshur. Por, këtë përveç një të riu që ka buzëqeshur nuk e ka parë askush tjetër, pasi këtu misteri nuk është në fjalë, por, në kontemplacionin e vetë lules në brendinë e saj.

Metodat shkencore për të kërkuar të vërtetën, gjenden e objektit e shikojnë në aspekte të ndryshme. Për shembull, nëse e studiojnë një lule, atë e studiojnë në aspektin botanik, kimik dhe fizik, e analizojnë dhe mundohen që ta kuptojnë si është dhe çfarë është. Vetëm se, është e pamundur që ta kuptojnë tërë objektin në marrëdhënie të ndryshme. Ndërsa studiuesi me metodat Zen, mundohet që të futet brenda në objekt dhe atë ta shikojë nga brendësia e tij. Të njohësh lulen do të thotë të bëhesh vetë lule, të çelësh si lule, të gëzohesh në diell dhe në shi. Nëse këtë mund ta bëjmë atëherë mund të flasim me lulet, mund të kuptojmë fshehtësitë, gëzimin dhe dhembjet e saj, me një fjalë mund të kuptojmë tërë jetën e saj. Me këtë metodë nuk i njohim vetëm fshehtësitë e universit, por, edhe unin tonë, mund ta njohim unin tonë si hije dhe si objekt, i cili është ndarë në dualizëm, që gjatë tërë jetës ka qëndruar larg vetes ose e ka ndjekur veten. Siç e njohim lulen mund ta njohim edhe veten tonë.

Zeni mundohet që të zbresë në burimin e fuqisë krijuese dhe atje të thithë jetën. Për të zbuluar diç të re shkenctarët vrasin, artistët bëjnë eksperimente, kurse Zeni duke jetuar brenda në objekt mundohet ta shohë të vërtetën. Punon që me anë të meditacionit të arrijë vetëdijen e shpëtimit. Themeluesi i këtij fraksioni Bodhidarma, prej Indie në vitin 520 vjen në Kinë. Më vonë mendimet e tij janë përhapur edhe në Kore dhe Japoni. Ushtrimet e tij bazohen në të qëndruarit drejt, në programimin e frymëmarrjes dhe në koncentrimin shpirtëror. Njeriu që e jeton doktrinën Zen rri, rri, rri. “Në uljen klasike Lotos”, ulet këmbëkryq dhe në këtë interval kohor gjunjët i mbështet në tokë. Sipas këtij parimi trupi qëndron drejt, koka ulet pak, sytë mbeten të hapur dhe shikohet në tokë, duart qëndrojnë në kraharor. Në këtë gjendje të përshtashme mundohet që të programojë dhe të kontrollojë frymëmarrjen. Frymëmarrjen dhe frymëdhënien e numëron me një ritëm. Çdo numërim prej një e deri më dhjetë e përsërit. Vëmendja përqendrohet mbi marrjen dhe dhënien e frymës. Pastaj kthehet në mendime, vizatime dhe në jetën shoqërore. Më pastaj njeriu mundohet që të zbresë në brendinë e tij dhe koncentrohet shpirtërisht.

Fraksioni Tsing-to (Xhodo)

60 % e budistëve kinezë janë anëtarë të fraksionit Tsing-to. Këtu Buda është një dritë e papërcaktuar, ai udhëheqësinë e tij e vazhdon në qiell. Buda qiellor është zot i parajsës apo dritës së përhershme dhe shpëtimtar i besimtarëve. Ai është Zoti i Mëshirshëm dhe Shpirtmadh te i cili mbështeten dhe të cilit shikojnë me rradhë i luten murgjit dhe klerikë të panumërt të Lindjes së largët. Populli që nuk dëshiron që të bëhet Arhat (i shenjtë), mjafton që vetëm të besojë. Ai është shpëtimtari qiellor i besimtarëve, besimtari më nuk ka nevojë as për jetë asketike e për vepra të mira. Fraksioni Xhudo, është fe e mëshirës. Buda, besimtarët që i besojnë atij, pas vdekjes së tyre do t'i marrë në parajsë. Kështu që këtu budizmi nuk ka më lidhje me doktrinën Nirvana.

i. Fraksioni Scientologjia

Literatura: Ekrem Sarıçoğlu, “L. Ron Hubbard ve Sayentoloji”, *19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, nr. 1-2.

Themeluesi dhe lideri i këtij fraksioni është amerikani Lafajette Ron Hubbard. Ai ka lindur më 1911 në Tilden (Nebraska-ShBA). Ishte fëmijë i një familjeje krishtere. Pasi babai i tij që ishte oficer marinari u caktua me punë në Azinë e Largët, ai e la liceun dhe shkoi bashkë me familjen e tij. Shëtitë nëpër shtete të ndryshme. Dëgjoi ligjëratat nga mësuesit budistë dhe e mësoi dhe përvetësoi budizmin. Pas kthimit në vendlindje e kreu shkollën e mesme dhe studioi inxhinierinë. Aftësinë e tij origjinale e tregoi në shkrime. Për të jetuar filloi të fitojë me shkrimet e skenarëve dhe tregimeve Shkencë-Imagjinatë. Në Luftën e Dytë Botërore u plagos gjatë pjesëmarrjes në Forcat Detare. Në spitalin e vendosur u njoh me mjekë psikoanalistë dhe vetë krijoi teori në lidhje me shërimin e sëmundjeve shpirtërore. Shoqëria, të cilën e formoi me simpatizantët e tij, në vitin 1954 u shndërrua në një lëvizje fetare.

Me anë të sintezave të reja, të cilat përbënin bazën e mendimeve psikoanalitike dhe të metafizikës budiste, vetveten e shpalli si pasardhës të Budës dhe si Mehdi të budizmit “Majtreja”. Ai supozonte se, me sistemin dhe metodat që i ka shpikur vetë, njerëzit duke i ngritur shpirtërisht mund të arrijnë në

shkallën e zotit (OT) dhe se mund të shpëtojë nga vorbulla e metempsikozës. Për sistemin e shpëtimit ka shkruar mbi 30 libra, në krye të të cilave qëndron vepra “Daianetics”.

Sipas Hubbardit, në pafillim bota materiale nuk ka ekzistuar, por, në pafundësi kanë ekzistuar vetëm shpirtërat. Si rezultat i mendimit të thellë u krijuan elementet fizike si materia, energjia, vendi dhe koha. Shpirtërat këto elemente i kanë përdorur si materiale në krijimin e universit. Historikisht kjo ngjarje ka filluar para 70×10^{84} trilion vitesh. Shpirtërat duke luajtur me objektet fizike, të cilat i kanë përdorur si lojëra fëmijësh, marrëdhëniet e botës shpirtërore dhe fizike kanë filluar që para 70-74 trilion vitesh. Në këto kohëra filluan të infektohen me materien e krijuar nga vetë ata dhe të gëlltiten prej saj. Ranë në lojën të cilën e luanin dhe e harruan natyrën dhe origjinën e tyre. I humbën aftësitë e tyre të posaçme shpirtërore. Dhe filluan të kuptojnë se nuk kanë diçka tjetër nga shpirtërat që i posedojnë. Kështu filloi, dhe ende është në vazhdim, reinkarnacioni i shpirtërave. Shpëtimi është në të përkujtuarit dhe në të njohurit e së kaluarës dhe ekzistencës së njeriut dhe, gjithashtu, është në veprimin për shpëtim me metoda psikoanalitike që quhen “Daianetics”. Po ashtu është në atë që shpirti përsëri të fitojë gjendjen e mëparshme në eternitet, i pastruar nga materia. Kjo është një lloj shkalle perëndie.

Hubbardi nuk njeh një besim në “Zotin”, si që është në të kuptuarit e islamit. Çështjes të cilës i thotë hyjnore (perëndi, zot) është “gjendje shpirtërore e pastër, i shpëtuar nga reinkarnacioni, i pastruar nga materia”. Në vend të filozofisë së shpëtimit budist, ai bën një komentim të ri dhe në vend të “Katër realiteteve të shenjta” të Budës vë metodën psikoanalitike, të cilën e quan “Daianetics”. Hubbard ka vdekur në vitin 1986.

Fraksioni scientologjik punon që mendimet e tij t’i përhapë në shtete të ndryshme të botës. Pengesat, me të cilat ballafaqohet, mundohet t’i kapërcejë duke shfrytëzuar mangësitë juridike.

FETË E LINDJES SË LARGËT

Besimeve dhe feve të njerëzve që jetojnë në Kinë, Japoni, Kore, Vietnam dhe në Ishujt e Oqeanisë, të cilat me një term gjeografik janë shtete lindore dhe jug-lindore të Azisë, i quajmë fe të Lindjes së Largët. Vëmendje të veçantë tërheq edhe ndikimi reciprok mes tyre. Besimet e këtij rajoni të gjerë për lehtësim do t'i studiojmë brenda një grupi. Në disa raste në grupin Fetë e Lindjes së Largët do të bëjnë pjesë edhe tema të cilat, për shkak të veprimtarisë së budizmit në këtë rajon, i kemi studiuar si grup të veçantë në fetë indiane.



1. Feja popullore kineze

Feja popullore kineze është një përzierje e konfuçianizmit dhe budizmit. Është fe përafërsisht e një miliardë njerëzve me rrënjë të zhytura në errësirën e legjendave të kohës së vjetër. Respektimi dhe madhërimi i forcave magjike dhe i shpirtërave, të cilat besohet se gjenden në elementet kryesore të koncepteve si toka, uji dhe ajri, dhe gjithashtu përfitimi i shoqërisë me anë të lutjes, flijimit etj., do të thotë mbrojtje nga të këqijat e tyre. Besimi në shpirtin dhe në ndikimin e tyre, është trashëgimi dhe mbe-turinë e kulturës së vjetër kineze. Elementet etike ideale në shoqëri vijnë nga mësimet e Konfuçit, ndërsa konceptet mistike vijnë nga ndikimet sipërfaqësore të mësimet të thella të Laotsesë. Në shek. I. të e.s., pas hyrjes së budizmit Mahajana në Kinë, janë përzier besimet lokale dhe doktrinat dhe janë formuar fraksione të reja të posaçme për ta.

Gjatë historisë nuk mund të haset në një besim gjeneral në Kinë. Shtresat fetare të popullit, gjegjësisht njerëzit njëri me tjetrin lidhen me anë të traditave, si nëpërmjet një ndjenje të përbashkët jetike, ceremonive të caktuara, respektimit të paraardhësve dhe me ndjenjën e brendshme të bashkimit të njeriut dhe rrethit. Çdo kinez bën përpjekje që jetën e tij t'ia përshtasë harmonisë së universit. Sepse harmonia e universit është më e rëndësishme se hyjnitë dhe njerëzit, të cilëve ju bëhet lutje. Njeriu, deri te forcat të cilat e udhëheqin këtë harmoni, mund të arrijë me një meditacion të thellë. Ai është Tao dhe mister. Tao është bashkim harmonik i elementit aktiv mashkull dhe pasiv femër, të cilët quhen "Jin dhe Jang". Këto në mënyrë rrethore kanë hyrë në njëra tjetrën dhe janë forca të përhershme të universit. Në mes tyre nuk ka asnjë kundërshtim dhe armiqësi, në çdo vend shihen bashkë dhe në harmoni. Femra Jin dhe mashkulli Jang e përfaqësojnë tokën dhe qiellin dhe që të dy janë të nevojshëm për rregullin e botës. Derisa vazhdohet në rrugë të drejtë dhe pozitive janë të mirë. Nëse njeriu devijon rrugën, atëherë toka dhe qielli hidhërohen dhe bimët bëhen të pamjaftueshme.

Në termin Tao, i cili llogaritet burim i rregullit të universit, rastiset edhe në shkrimet shumë të vjetra kineze. Vetëm se fjala, si term kryesor i rregullit kozmik dhe i filozofisë së Laotse-së, është futur në qendrën e mendimit kinez. Në mendimin kinez harmonia mes njeriut dhe natyrës gjithmonë është një përmallim. Respekti ndaj kodrave dhe lumenjve është manifestim i marrëdhënieve të ndryshueshme.

Në hyrje të fshatrave kineze gjendet një mur prej dheu, i cili simbolizon vendin prodhues. Në pranverë ky mur bëhet qendër e ceremonive të festuara me këngë dhe valle, për rritjen e prodhimtarisë. Ndërsa në vjeshtë, këtu bëhet festa e korrijës. Edhe sot bujqit kinezë duke prerë kurban dhe duke i kryer ritet fetare mundohen që të fitojnë bëmirësinë dhe mëshirën e zotave Ujë dhe Tokë.

Çdokush mund ta adhurojë qiellin, por kulti qiellor më tepër praktikohet nga perandori. Perandori, si ndërmjetës mes qiellit dhe popullit, i kryente obligimet fetare dhe politike. Natën e kthimit të Dimrit (23 shtator) në Tempullin e Qiellit therte kurban dhe kjo llogaritej adhurimi më i rëndësishëm i vitit. Ky

kult shtetëror vazhdoi deri në rrëzimin e Fisit Mançu nga fronti, në vitin 1911.

Si përfundim, krahas besimit në shpirta dhe xhinnë, në fenë popullore kineze vend të rëndësishëm zë edhe respekti ndaj paraardhësve dhe familjes si bërthamë e shoqërisë. Çdo familje i respekton shpirtërat e paraardhësve, si mbrojtës të tyre. Në skajin jugperëndimor të shtëpive, për t'u shërbyer të vdekurve gjendet një kënd i shenjtë. Kjo traditë vazhdon që nga koha e fisit Shang, i cili ka sunduar në vitet 1776-1122 para e.s. Emrat e paraardhësve (baballarëve dhe stërgjyshërve) janë të shënuar në listën e pjesëtarëve të çdo shtëpie.

2. Taoizmi

Literatura: Lao-Tzu, *Taoizmi*, botimi 2., Ankara 1963; H. Von Glasenapp, *Die nichtchristlichen Religionen*, f.110-114; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f.117-127.

Në Kinë kulmin e spekulimit fetar e arriti mendimtari i Kinës Jugore Laotse. Sikur që bëjnë të ditur burimet e dyshimta historike, Laotse ka lindur në fshatin Çu-jen të rajonit Ku në shtetin Çu të Kinës në vitin 604 para e.s. Emri i tij është Erh, kurse i familjes Li. Ai u bë historian dhe arkivist i një princi të fisit Çu. Ai kishte një fëmijë dhe disa nipër. Por ai shpejt u bezdis nga jeta e sarajit dhe punët shtetërore dhe u vendos në një kasolle në rrëpirën e një mali në Rajonin Han Kvan. Atje jetoj vite me radhë dhe e shkroi një libër të vogël. Në fund në moshën 80 vjeçare, e braktisi kasollen dhe shkoi drejt perëndimit dhe nuk u pa më asnjëherë dhe askund. Burimet kineze transmetojnë se ai ka shkuar në Hotan dhe atje ka vdekur.²⁰⁸

Për Laotse-në nuk kemi shumë njohuri. Por dihet se libri i tij është njëri nga librat më të vështirë për t'u kuptuar, në botë. Pasi gjërat në të janë shkruar shkurtimisht, ndërsa për Tao dhe për Te gjenden 81 shkrime. Paqartësia në shprehje fillon me pyetjen se ç'është ajo. Termi "Tao" ka kuptimin "esenca e ekzistencës, drejtimit, rrugë, rruga që lëviz brenda në univers". Kurse "Te" do të thotë "punë e mirë, virtyt". Vetëm se shprehja virtyt është një fjalë e përgjithshme. Se çka ka për qëllim me këtë, nuk është aq e qartë.

Tao-Te-King ka kuptimin "*rruga e virtytit, ligji i universit dhe ndikimi i tij*". Në vitin 664 është pranuar si libër i shenjtë dhe në vitin 719 njëri prej perandorëve të fisit T'ang, Ming Huang, i ka bërë një komentim. Në kohët më të vjetra qielli llogaritej si udhëheqës i çdo sendi. Më vonë në vete ngërtheu edhe kuptimin etik. Fjala kyçe për të kuptuar doktrinën e Laotse-së, i cili ishte një mendimtar panteist dhe mistik, varej nga Tao. Pyetjes se, *ç'është Tao?*, i duhet dhënë përgjigje. Laotse në librin e tij jep këtë përgjigje: "*Toka është norma e njerëzve, Qielli është norma e tokës, Tao është norma e Qiellit, ndërsa norma e Taos është vetë jeta e tij*". Tao është pa veprim dhe i përhershëm. Prandaj nuk ka asgjë ku ai jeton. Mosaktiviteti i krijesave, apo qetësia i ndihmon më tepër ata që të bëjnë punë. Sipas tij, parimi i parë nga i cili ka dalë gjithësia është Tao. Ai është i pafillim dhe pambarim, gjendet në çdo vend, vetëm se nuk mund të dihet dhe është i paemër. Çdo gjë vjen nga ai, ai është nëna, esenca e çdo gjëje. Përveç kësaj, profeti nga Korea, Moon, atë e ka cilësuar si "zot".

Qëllimi i jetës duhet të jetë qetësia. Njeriu para se të fillojë të lëvizë me ndenjat e tij duhet të arrijë në Wu-vey (të mos bëjë asgjë), Puh-yen (të mos flasë asgjë) dhe Hu-wu (në pozitën e peshorës). Në këtë mënyrë jeta në çdo aspekt bëhet ideale dhe e bukur. Sepse ligjet natyrore janë të forta. Njeriu brenda zhvillimit natyror të tij duhet që çdo gjëje t'i ndihmojë; por nuk duhet që të ndërhyjë në të. Natyra definitivisht është e mirë dhe e bukur. Gjërat që i ka bërë njeriu afër gjërave që i ka sjellë natyra janë të thjeshta dhe banale. Atëherë Wu-vey është ndikim pa aksion. Uji është njëra prej pamjeve të Taos. Nuk bën zënka dhe merr vendin më të ulët. Megjithatë ai është shumë i rëndësishëm. Në fakt çdo gjë bëhet nga vetvetja, nuk ka nevojë që të harxhohet fuqi. Prodhimi i dëmton krijimit të rregullit dhe Tao-n e çon në zhdukje. Kështu del në shesh mendja dhe drejtësia, ndërsa në mesin e njerëzve e shton

²⁰⁸ Lao Tzu, *Taoizmi*, (përkth. në turq. Mukaddere N. Özerdim), botimi 2., Ankara 1963, f. 10 dhe në vazhdim.

përçarjen dhe grindjen.²⁰⁹

Etika e Laotse-së kryesisht ka kuptim negativ. Kjo mbështetet në bazat e të jetuarit me qetësi dhe me rehati absolute t'ia kthejë shpinën botës, t'i braktisë dëshirat dhe aspiratat, vetveten t'ia nënshtrojë dhe ta bashkojë me Zotin. Njeriu nuk ka një vend special në mesin e krijesave. Por, duke e liruar atë nga vartësia e jetës dëshiron që ta hedhë në thellësitë e Taos. Në njohjen e Taos as dituria teorike ka dobi e as urtësia praktike botërore. Laotse thotë se, “Rruga e qiellit duket pa shikuar në dritare. Bota njihet pa dalë nga shtëpia. Për këtë i urti i njeh të gjitha gjërat pa shkuar, pa i parë dhe pa i dëgjuar”. Sipas Laotse-së, të gjitha të këqijat, ambiciet dhe tollovitë në botë vijnë nga gjërat që njihen:

“Njeriu në vend që të mësojë gjërat të cilat ia ringjallin ambiciet, duhet ta dëgjojë veten dhe në këtë mënyrë duhet të gjejë rrugën e leximit të zemrës dhe brendësisë së tij. Vetëm atëherë mund të arrihet në pjekurinë e përhershme. Për këtë arsye njeriu aq sa ka mundësi duhet të punojë që të arrijë qetësi dhe rehati. Zgjidhja e vetme e kësaj është të mosvepruarit asgjë”.²¹⁰

Sipas tij njeriu është njeri vetëm me anë të virtyteve shpirtërore. Ndërsa njeriu ideal është njeri modest, që punon për përshtatshmëri të vetvetes me çdo gjë, që është i drejtë, i sinqertë, bamirës dhe i mirë. Disa dijetarë këtë e sqarojnë kështu: “njeriu ka dy natyra, njëra shpirtërore dhe tjetra materiale, dhe ka dy orientime, njëra është kthyer në mirësi, e tjetra në keqësi. Obligimi më i madh i njeriut është që ta zhvillojë orientimin kah e mira”.²¹¹

Sundimtari më i mirë është ai që e ndjek Taon. Të mburresh me autoritetin dhe me pasurinë është një sjellje shumë e poshtër. Ai që e mbron veten nga këto e gjenë rrugën e qiellit. E pranon se nuk është e drejtë që t'i jepet vlerë jetës materiale. Për këtë paraqitja e gjërave që populli i do pa masë dhe vlerësimi i tyre deri në atë masë sa që të tjerët do t'i zhvlerësojë, janë gjëra që një njeri nuk mund t'i bëjë. Ata që e shohin vetëm veten nuk janë të mençur. Ata që lavdërohen me vetveten nuk mund të bëjnë asnjë punë. Këta nuk i do askush.

Në taoizëm shtetit nuk i takojnë obligime pozitive, lufta kritikohet, përparimi material përçmohet. Shumë nëpunës dhe organizata shihen si të panevojshme. Duhet të mos ketë një qëllim pozitiv, të caktuar, duhet të ndiqet gjendja e palëvizshmërisë dhe qetësisë, duhet të njihet Tao. Lumturia më e lartë në Laotse është gjendja shpirtërore. “Ata që e udhëheqin shtetin, duhet të kenë kujdes në nxitjen dhe ngacmimin e dëshirave dhe aspiratave të popullit. Për këtë njerëzit e mëdhenj i mbushin stomakët e njerëzve dhe zbrazin zemrat dhe kokat e tyre; i dobësojnë dëshirat e tyre, i forcojnë eshtrat e tyre dhe gjithmonë i lënë pa dituri.”²¹² Dëshira e Laotse-së që populli të mbetet pa dituri, nuk është nga që do ta shohë të poshtëruar, por, është nga besimi se populli rehatinë dhe qetësinë mund t'i realizojë vetëm nëpërmjet kësaj rruge.

Disa këshilla të Laotse-së:

“Të punosh në zbulimin e jetës së brendshme është shumë më mirë se të flasësh shumë!” (k.5)

“Atij, që botën e vlerëson aq sa e vlerëson vetveten e tij, i beson çdo kush. Atë që e do shtetin aq sa e do vetveten e respekton çdokush.” (k.13)

“Jam dëshmitar i çdonjërit që ka dëshiruar ta zotërojë botën dhe në fund këtë e ka arritur. Por, e kam parë se përsëri nuk është bërë plotësisht i suksesshëm. Bota është si një enë prej shpirtit. Ajo nuk mund të ndalohet. Ata që e ndërtojnë atë e rrënojnë. Ata që e përvetësojnë atë e humbin.” (k.29).

3. Konfuçionizmi

Literatura: Ezra Pound, *Konfucyus*, (përkth. turq. Ahmet Yücel), Stamboll 1981; Thomas Cleary, *Konfucyus*, (përkth. turq. Sibel Özbudun), Stamboll (pa datë botimi), f.192; Rudolf Wrede, *Worte des Konfuzius*, Munchen; H.

²⁰⁹ Lao-Tzu, f.14.

²¹⁰ Lao-Tzu, f.9.

²¹¹ Lao-Tzu, f. 15.

²¹² Lao-Tzu, f. 16.

Edhe Konfuçi (*Kungtse*) nga Kina Veriore, themeluesi i Konfuçionizmit, sikur Laotse, asnjëherë nuk e ndjeu vetveten si i dërguar i një fuqie hyjnore. Vetëm se nga ai dallohej me atë që Konfuçi ishte një politikan praktik. Në kritikata e tij kishte për qëllim aktivitetin aktual (situatën aktuale pasive). Sipas transmetimeve, Konfuçi ka lindur (550 para e.s.) në Çe-Fo (sot qyteti Shantung), ku babai i tij ishte prefekt, përfaqësuesi 50 vjet pas Laotse-s. Ai, për shkak të vdekjes së babait të tij, kur ai ishte në moshën 3 vjeçare dhe të varfërimin të familjes, jetoi në kushte shumë të vështira. Krahas problemeve të jetës ai merrej edhe me sport. Thuhet se ai ka qenë një gjuajtës i mirë me shigjetë. Pas moshës 15 vjeçare është interesuar për mësim dhe këtë interesim e ka vazhduar gjatë tërë jetës së tij. Në moshën 17 vjeçare fillon punën në udhëheqësinë e një ferme. Në kohën e lirë me një pasion të madh iu përkushtua studimit të transmetimeve dhe burimeve të vjetra. Edhe me dëshirën e nënës së tij, në moshën 19 vjeçare u martua, por kjo martesë atij nuk i solli lumturi. Konfuçi vetveten nuk e ka ndjerë të varur prej familjes dhe pas moshës mesatare ka qëndruar larg familjes. Në shpirtin e tij më tepër vend kanë zënë nxënësit se sa djali i tij. Të ardhurat për t'u përkujdesur për familjen i ka fituar duke mbajtur ligjëratat të posaçme në sarajet e princave. Qytetin Lu, në të cilin ka jetuar një kohë të gjatë e ka braktisur, për shkak të të shqetësimeve të shumta. Kur një shok i ngushtë i tij u bë kryetar i një krahine, ai u zgjodh prefekt i qytetit Çung-tu dhe gjatë tërë jetës gjeti mundësinë që t'i mësonte të tjerët. Suksesi në detyrën që kishte i krijoi atij mundësi që të arrijë deri në Ministrin të Drejtësisë. Vetëm se në këtë detyrë nuk mundi të bëhet i suksesshëm, u shkatërrua dhe pas tre vitesh e la detyrën shtetërore. Atëherë ishte 54 vjeç. Me nxënësit e singertë të tij shëtitte qytet më qytet dhe ligjëroi. Edhe pse shtetet fqinje i ofronin detyra të larta, ai këto nuk i pranoi. Sepse nuk kanë lejuar që ai të realizojë planin e tij për reforma. Pas një periudhe të jetës së tij në emigracion, Lu, njëri prej nxënësve të tij që mori një funksion të lartë, edhe pse shpresonte që në vendin e tij të gjejë një detyrë për mësuesin e moshuar, ajo nuk u realizua. Konfuçi veten ia përkushtoi studimeve letrare. Ai tuboi dokumentacione për historinë e Kinës dhe poezinë e vjetër. Ai përjetoi vdekjen e djalit dhe të nxënësve të dashur. Ai me këtë zemërim vdiq në vitin 479 para e.s., në moshën 71 vjeçare. U varros në afërsi të qytetit Çu-Fu. Nxënësit e tij, që e respektonin atë, afër varrit ndërtuan një kasolle në bazë të traditës së kohës dhe 27 ditë mbajtën zi për mësuesin e tyre. Edhe sot ai varr i thjeshtë, mund të vizitohet.²¹³

a. Librat

Konfuçi, mendimet e tij i ka përhapur me ligjëratat që mbante. Fjalët e transmetuara nga ai, më vonë janë shkruar nga nxënësit e tij. Njëra nga veprat e tij është përmbledhje e dokumentacioneve të vjetra kineze. Në të jepen shembuj nga veprimtaria dhe jeta e nëpunësve aktivë dhe qeveritarëve të mëdhenj. Të dhënat historike të popullit për të luajnë rolin e shpalljes hyjnore të themeluesve të feve të popujt e tjerë. Prandaj ai, shërbimet dhe kumtesat e tij i sheh si “transmetim të urtësive të vjetra dhe jo si diçka të re”. Për të kjo përmbledhje, përveç që është veprë letrare dhe mjet ligjëratash, është edhe një monument historik. Kjo, për të, është edhe burim dhe bazë historike për mendimet reformuese politike dhe për filozofinë e etikës. Këto vepra janë: “*Përkujtimet e Pranverës dhe Vjeshtës*”, “*Libri i Dokumenteve*” (Shu-King), “*Libri i Ndryshimeve*” (I King), “*Libri i Këngëve*” (Shi-King) dhe më i rëndësishmi “*Libri i Ligjëratave*” (Lun-Yu).²¹⁴ Në këtë libër (të fundit), të përgatitur nga brezi i tretë i nxënësve të tij, gjenden kujtime nga mësuesi dhe fjalët e tij. Përfaqësuesi trashëgimia shkrimore e tij përbëhet prej njëzet librave. Ato libra që sot gjenden kanë mbetur që nga shek. III. të e.s. dhe në to ka shumë përmirësime.

b. Doktrina

Nga mozaiku i shkapërderdhur i veprës së njohur të Konfuçit, Lun-Yu, kuptohet virtyti dhe etika e

²¹³ Rudolf Wrede, *Worte des Konfuzius*, Munchen, (pa datë botimi), f. 13-19; Thomas Cleary, *Konfüçius*, Stamboll, (pa datë botimi), f. 192.

²¹⁴ Wrede, f. 21-24.

obligimit. Ajo nuk përmban një karakter fetar. Në të nuk shihen termat si mëkat dhe faj, shpërblim dhe dënim, shpallje hyjnore dhe i dërguar i shenjtë. Sipas feve tjera esenca e kumtimit të fesë është “sjellja dhe qëndrimi i njeriut ndaj Zotit”. Kjo i përshtatet ekzistencës kineze e cila është brilante, e dobishme dhe që i tejkalon të gjitha mendimet metafizike. Megjithatë në mësimet e tij ka një ndikim dhe një forcë e cila i tejkalon kohët. Asaj mund t’i thuhet edhe filozofi edhe fe. Ajo ka patur influencë në çdo fushë të jetës dhe është formuar me shpirt.

Konfuçi është njeri i vetëm në mesin e themeluesve të mëdhenj të feve, që vetveten nuk e ka llogaritur si të dërguar të fuqisë hyjnore dhe nuk ka folur për botën e ardhshme. Ai ka besuar në Shpirtëra dhe Qiell, të cilat ia kanë ngjallur ndjenjën e obligimit. Edhe pse doktrina e tij vlerësohet si fe, kjo fe nuk është bazë e propozimeve të tija etike. Ai nuk është marrë me problemet fetare me të cilat merremi ne. Ai është munduar që veten ta mbajë larg bisedave për çështje fetare. E as që ka synuar ndryshimin e besimeve tradicionale të popullit. Ai mbronte mendimin se, në vazhdimin e traditave ndikim kanë ngjarjet metafizike, shpirtërat dhe xhinnët dhe se detyra e njeriut është që të jetojë në harmoni me ta, t’i respektojë ata, të mos ankohet nga fati i tij. Për këtë arsye Konfuçi nuk e ka ndjerë obligim që të krijojë opinione për probleme metafizike. Doktrina e tij ishte filozofia praktike jetike.²¹⁵

Edhe pse Konfuçi qëndronte larg asaj që filozofinë e tij ta mbështeste në baza metafizike, ai Tao-n, gjegjësisht, filozofinë natyrore apo metafizikën mistike të kohës nuk e refuzonte. Fjala Tao ka kuptimin rrugë, ka kuptimin e fuqisë mistere që posedon çdo gjë. Ajo ka kuptimin rrugë të e cila kthehen të gjithë. Ajo është harmonia e të gjitha ngjarjeve në tokë dhe në qiell. Për veprimtarinë dhe interesimin e Konfuçit, “Tao”ja e shoqërisë njerëzore ishte rrugë ideale. Në këtë aspekt Tao është parim etik, fuqi botërore, qeverisës i shoqërisë dhe forcë që zhvillon. Kënaqësia e njerëzve dhe e shoqërisë varet prej Taos. Qëndrimi i Taos varet nga qëndrimi i çdo qeverie të mirë. Nëse qeveria është e mirë, edhe ai është i mirë. Përhapja apo humbja e Taos është fat, njeriu këtu nuk mund të ndikojë. Rrugët ndikuese të Taos janë prej rregullave muzikore, ritmike dhe të jetuarit në mënyrë shoqërore.

c. Muzika dhe ritmi

Sipas mësimet të Konfuçit, Tao shoqërinë njerëzore e paraqet në dy mënyra. Njëra është në muzikë, ndërsa tjetra në Li, gjegjësisht në rregullat e të jetuarit bashkë. Për Konfuçin të dyja këto janë plot me forca mistere. Jetën shoqërore e ndikojnë në një formë të posaçme të tyre. Njerëzit i edukojnë në mënyrë harmonike. Nëse ata egërsohen në shtet dhe shoqëri fillon parregullsi. Ato duhet të mbrohen dhe të përmirësohen. Kjo detyrë i takon perandorit, mbrojtësit të madh të drejtësisë. Tao intensifikohet veçanërisht në drejtësi dhe ligjësi.

Li (harmoni ose ceremoni, kështu përmendet shpesh në literaturë) për jetën shoqërore më tepër domethënie fiton me muzikë. Konfuçi nga kjo nuk kupton vetëm formën egzoterike e cila shihet në marrëdhënie me njerëzit, por, në të njëjtën kohë ai kupton edhe mendjet e shëndosha dhe qëndrimet ezoterike të njerëzve. Li është shprehje më e lartë e ligjësisë në sipërfaqe të tokës dhe për ligjet e universit është ekuilibër njerëzor. Ai është përmbajtja e traditës dhe e drejtësisë. Ai gjithashtu është bukuri në veshje, biseda dhe fytyrë. Njeriu me respektin që ia bën Lisë, arrin mendjen e shëndoshë dhe mendimet e drejta. Sistemi aktual, për të cilin ka nevojë, është përshatshmëria traditave të paraardhësve. Kjo njerëzve u jep lumturi dhe kënaqësi. Pa mos qenë jeta e njeriut nuk mund të këtë harmoni, nuk mund të varrosen të vdekurit, nuk mund të respektohet qielli. Nëse lëshohet pe në kryerjen e ceremonive, humbet populli, shoqëria shkon drejt të keqes. Shkaku që popujt në kohërat e lashta kanë qenë të lumtur dhe të kënaqur, ka qenë mbrojtja e ceremonive. Për këtë Konfuçi si obligim të parë të tij e quan që, ceremonitë dhe traditat e mbetura trashëgim nga paraardhësit e tyre, t’ua mësojë të tjerëve në formën e mëparshme të tyre. Me studimin e Lisë mbahet gjallë mirësia natyrore e njeriut. Mirësia natyrore pa edukatë dhe mësim humbet brenda shprehive të këqija. Për këtë arsye mirësia, sipas Konfuçit, mund të mësohet. Ai që mundohet ta mbrojë formën egzoterike, arrin të vërtetën në qëndrimet ezoterike. Mendimi i drejtë është shprehje e mendjes së shëndoshë, është mirësi egzoterike.

²¹⁵ Wrede, f. 25-27.

ç. Perfeksionimi

Konfuçi, i cili mbron mendimin e të mësuarit të të mirës, është bërë një shembull njerëzor ideal për shoqërinë. Ai, në syrin e kinezëve që i drejtohen atij, është një njeri i lartë. Ai posedon cilësi origjinale dhe cilësi mirësie. Konfuçi është një njeri, në të cilin është realizuar Tao, rregulli i universit, në të është formësuar edhe ndjenja e rregullave etike. Ai është njeri i madh. Ai është pronar i ekuilibrit dhe i masës. Është zot i dëshirës dhe i përkuljes. Është gjykatës. Në veten e tij ka bashkuar mirësinë në mendjen e shëndoshë dhe qëndrimet etike. Duke e përgatitur vetveten me veprime të durueshme dhe lodhëse, ai ka arritur një pjekuri etike.²¹⁶

Pjekuria dhe përsosshmëria e njeriut për të nuk është qëllim, por, është një mjet me të cilën edhe njerëzit e tjerë të arrijnë këtë pjekuri. Për këtë arsye sistemi i Konfuçit nuk përqëndrohet tepër në vlerën e njeriut si individ. Vlera kryesore e njeriut është në atë se ai është krijesë shoqërore. Virtyte janë cilësitë që mund t'i prezentohen shoqërisë. Të gjitha gjërat që e zgjidhin dhe e shpërndajnë shoqërinë janë ngarkesë. Në këtë aspekt të gjitha vlerat etike mbështeten në bazën e reciprocitetit. Konfuçi këtë e cilëson si "Tërësi e Doktrinës". Marrëdhëniet në mesin e njerëzve i përcakton reciprociteti. Në Lun Yu thuhet: "Atë që nuk e do për vete, mos ia bën edhe tjetrit". Frytë më i mirë i këtij parimi është dashuria njerëzore dhe njerëzia. Në bisedat e Konfuçit reciprociteti është rezultat.²¹⁷ Theksi mbahet mbi parimin që, në vend që padrejtësisë dhe të keqes t'i përgjigjet me dashuri, t'i përgjigjet me parimin e reciprocitetit të drejtësisë. Dera e urrejtjes dhe e hakmarrjes është e mbyllur. Në Lun-Yu thuhet se e keqja mund të zhduket, jo me të keqe, por me mirësi dhe mëshirë.

Pa mos qenë drejtësia dhe reciprociteti nuk mund të mendohet përsosshmëria njerëzore. Në marrëdhënie me njerëzit në shesh dalin tre virtyte me rëndësi, për të cilat duhet patur kujdes: drejtësia, korrektësia dhe respekti. Për Konfuçin trimëria dhe dituria janë nevojë e pamohueshme në formimin e personalitetit. Kush i nëpërkëmb këto detyra të virtytshme, një ditë do të dënohet, dhe nuk bëhet mëkat. Sepse për Konfuçin termi "mëkat" nuk ekziston. Për konfuçionizmin mëkati është i huaj. Njeriu që bën gabim, nëse përsëri kthehet në rrugën e drejtë, ai e ka zbatuar rregullin, e ka plotësuar Taon. Kjo është e mjaftueshme. Në konfuçionizëm nuk ekzistojnë termat si pajtim me Zotin, fitim i kënaqësisë së Tij. Nuk ka edhe një mendim për shpërblim ndaj kryerjes së detyrave dhe realizimit të drejtësisë. E mira nuk bëhet për shpëtim, shpërblim, por ajo bëhet për vetë atë se është e mirë. Shpërblimi i saj është brenda në të.²¹⁸

d. Doktrina e shtetit

Detyrat që mungojnë nga realizimi i parimit të reciprocitetit, e zhvillojnë shoqërinë. Doktrina për shtetin e Konfuçit është e koncentruar në këtë pikë. Sipas tij ka tre forma të shoqërisë: familja, shokët, shteti. Virtytet e shoqërisë njerëzore dhe detyrat që mungullohen nga ajo shprehjet e posaçme i gjejnë në familje, miqësi dhe shtet.

Kuptimi i familjes, që është baza e shtetit të Konfuçit, në jetë është detyrë më e rëndësishme dhe fetarësia më e madhe. Në familje jetohet sipas rregullave ceremoniale. Ajo përfshin çdo gjë, nga respekti i sinqertë që përforcon familjen e deri te kurbanit për të vdekurit që fëmijët ua kanë borxh paraardhësve të tyre. Siç shihet qartë, ato nuk janë marrëdhënie grua-burrë, por janë marrëdhënie baba fëmijë, baba djalë. Vajzat, me qenë se nuk ju vazhdon breznia nuk e kanë për detyrë të presin kurban për paraardhësit pasi nuk llogariten si të familjes. Në përshtatshmëri me traditat e kohës, gruaja në realizimin e obligimeve e ndjek burrin. Nëse vdes babai, nëna respekton djalin më të madh dhe vëllezërit e rinj i respektojnë më të vjetrit. Sipas këtij interpretimi detyrë e burrit dhe gruas është të kenë fëmijë, e sidomos djem. Bashkëshortët që nuk mund të realizojnë këtë detyrë mund të ndahen. Në këtë aspekt besnikëria e mashkullit nuk ka aspak kuptim etik.

Ajo, të cilës i jepet më tepër vlerë se sa familjes dhe që i përshtatet natyrës së Konfuçit, është rrethi i shokëve. Edhe këtu esenca është në obligim reciprok dhe drejtësi. Bamirësia reciproke e shokëve është

²¹⁶ Wrede, f. 29 dhe në vazhdim.

²¹⁷ Wrede, f. 31.

²¹⁸ Wrede, f.32.

natyrore. Në lidhje me këtë çështje Konfuçi nuk e ndjen të nevojshme të thotë diç më tepër. Qëndrimet e drejta në rrethin shoqëror janë të përcaktuara në masat e ceremonive. Shoqëria, sikur familja, llogaritet njëra nga bazat e shtetit.²¹⁹

dh. Udhëheqja e shtetit

Nëse rendi i familjes dhe i rrethit të miqësisë nuk është i mirë, nuk mund të ketë një shtet të rregullt dhe qeveri të mirë. Në jetën e shtetit rol të rëndësishëm luan udhëheqja e mirë. Për këtë dhe Konfuçi nuk merret me detyrat e masës, por merret me detyrat e udhëheqësve. Sepse nëse qeveria është e mirë, edhe populli do ta respektojë. Për këtë edhe lideri udhëheqës duhet të jetë një njeri i madh i cili në vete realizon Tao-n dhe i zbaton ligjet e tij. Para syve të njeriut pa zell, që vepron sipas ndjenjave dhe që është i përshtatshëm për të udhëhequr, ka mendime të mëdha për profit. Atij njeriu nuk duhet t'i jepet rast që të udhëheq. Ai nuk është i përshtatshëm për udhëheqje. Në të gjitha udhëheqësitë çështje me peshë është të jesh shembull i mirë. Ligjet dhe dënimet çojnë në respektim sipërfaqësor, suksesin nuk e bëjnë të përherëshëm. Përkundër kësaj shembulli i mirë është një fuqi që ndikon në çdo gjë. "Autoriteti etik i sundimtarit i ngjanë erës, ekzistenca e popullit i ngjanë kullotës, populli, sikur kullota e cila i përkulet erës që frynë përherë, i përkulet autoritetit etik." Në Lun-Yu thuhet se: "Ai që e sundon fuqinë e personalitetit është si ylli polar. Ai qëndron në vend statik, yjet e tjerë rrotullohen rreth tij." Shembull i mirë mund të bëhet vetëm pjekuria etike. Për këtë pjekuria e lartë etike është për sundimtarin e zgjedhur të qiellit. Kjo është kushti i parë për një udhëheqje të mirë. Ai është trupëzim i Taos, rendit të gjithësisë, për këtë njeriu brenda në rregull është kulti i Taos. Detyrë e tij është edhe përdorimi Taos në qeveri. Kjo detyrë bëhet me nxitjen dhe mbështetjen e muzikës dhe ceremonive. Sidomos ceremonia Li është mjet më i pasur në dorën e tij. Nëse atë e përdor mirë, populli bëhet i lumtur. Kjo plotësisht varet prej udhëheqjes, qeverisë. Ky duhet të jetë qëllimi i udhëheqësit. Sipas Konfuçit, udhëheqësi është guvernator i pakufizuar dhe të gjitha shtetet i udhëheq sikur pasurinë e vet. Ai, regjimin e ashpër dhe autoritativ që është egërsuar, e zbut. Popullin e qetëson me parimet themelore dhe me varësi ndaj Taos. Kjo në jetën shtetërore do të thotë, që udhëheqësi t'i llogaritet dhe t'i realizojë dëshirat e popullit. Dëshira më e rëndësishme është marrëdhënia në mes udhëheqësit dhe të udhëhequrve. Konfuçi sigurimin e vë mbi të gjitha elementet e forcës së shtetit. Udhëheqësi popullin e tij e udhëheq me fuqinë shpirtërore, sepse forca materiale e udhëheqësisë praktike nuk është e mjaftueshme. Për këtë nëpunësit duhet të zgjidhen, jo sipas dëshirave personale, por, sipas specifikave të aftësisë dhe të karakterit. Në marrëdhëniet nëpunës-popull, vendimi merret mbi bazën e reciprocitetit. Nëpunësit duhet të posedojnë inteligjencë, aftësi praktike dhe sinqeritet dhe lojalitet ndaj udhëheqësit. Nëse të gjitha këto rregulla merren parasysh shoqëria vepron duke mos rrëshqitur dhe duke mos kapërcyer rrotat. Tao i shtetit rregullohet. Në të kundërtën udhëheqësi nuk mund të jetë i denjë për meritën "*bir i qiellit*", "*sovrانيتet i shenjtë*".

Siç u pa, rendi shtetëror i Konfuçit nuk është i ndërtuar mbi një autoritet të dukshëm dhe mbi një doktrinë etike të formuar. Ajo është një doktrinë etike e formuar mbi bazën e reciprocitetit dhe të modelit.

Qëllimi i Konfuçit ishte që me këtë doktrinë të ndryshojë njerëzit dhe rrethin e tyre shoqëror. Kjo është një dukuri që ia vlen të kihet kujdes në historinë shpirtërore të njerëzimit, për shkak se ia ka dalë të qëndrojë në këmbë pa mos u bazuar në një besim fetar. Rrënjët e kësaj duken dhe shkojnë deri në periudhat krijuese të historisë kineze para Konfuçit. Shërbimi i pavdekshëm i Konfuçit është shndërrimi i këtyre parimeve dhe vlerave të kohës, në doktrinë. Kështu e ka shpëtuar rendin e vjetër të shoqërisë. Doktrina e tij asnjëherë nuk është nëpërkëmbur dhe për njerëzit e përsosur të shtresës së mesme ka shërbyer si kriter. Të shenjtat e bazuara në filozofi dhe ekstazë i ka refuzuar, për bazë ka marrë të kuptuarit e shëndoshë të njeriut, ndërsa shenjtoreve dhe trimave të legjendave nuk iu jep rëndësi. Kjo doktrinë është trashëgimi e racës së Kinës.²²⁰

Detyra e shtetit është edukimi dhe të ndihmuarit e popullit në këtë aspekt. Mbi këtë bazë do të

²¹⁹ Wrede, f. 34.

²²⁰ Wrede, f. 37.

realizohet parimi themeltar i jetës së shtetit. Konfuçi i ka refuzuar mendimet për ekzistencën e zotave dhe shpirtërave. Për këtë arsye disa kanë thënë se vendi i tij nuk është në fe por në historinë e filozofisë. Konfuçio nuk është interesuar aq për jetën pas vdekjes. Pyetjen për këtë çështje të njërit nga nxënësit e tij: “Nëse njeriu ende nuk mund ta njohë jetën e tij, si mund ta kuptojë vdekjen”, e ka lënë pa përgjigje. Krahas qëndrimit ngurrues ndaj fesë, ai nuk ka qenë larg pjesëmarrjes në ceremonitë fetare. Sipas tij virtyti është tre llojesh: respektimi i udhëheqësisë qiellore, i njerëzve më të vjetër dhe i fjalëve të njerëzve të shenjtë. Kjo është një mbeturinë e fesë së vjetër në konfuçionizëm. Natyrisht Konfuçi, në jetën e tij dhe në periudhën e parë pas vdekjes së tij, nuk ka gëzuar aq respekt. Kur sundimtari i Kinës, mendimin e tij etik e bëri fe shtetërore dhe, gradualisht e shenjtëroi atë, atëherë, filloi edhe respektimi ndaj Konfuçit. Shkrimet e tij në vitin 140 para e.s. u bënë libra shkollorë dhe respekti ndaj tij u shpall zyrtar. Për së pari herë në shek. I. të e.s., në shkollat shtetërore u pre kurban për Konfuçin. Kjo traditë në shek. VI. u gjeneralizua. Në shek. VII iu dha titulli “mësuesi i madh” dhe për nder të tij u urdhërua të ndërtohet një tempull, gjithashtu, u bë edhe një panoramë e nxënësve të tij. Në shek. XI iu dhanë titujt “princ” dhe “shenjtor”. Në shek. XIII një njeri me emrin Chu-Hsi, me zhvillimin e konfuçionizmit krahas budizmit, konfuçionizmin e ngriti në nivelin e doktrinës shtetërore dhe kjo vazhdoi deri në vitin 1906.

Zotave zyrtarë të konfuçionizmit ju shtuan edhe disa personalitete. Perandori atë njeri dhe atë gjeni legjendar që dëshironte, e shpallte për zot. Kështu që në shek. XIV një yll shpirtëror i vjetër u ngrit në “*hyjnitë të literaturës*”. Gjithashtu u vërtetua edhe hyjnija e “*Zotit të murit të qytetit*”, të cilin populli e respektonte edhe më herët. Kurse në shek. XVI një hero historik u ngrit në “*hyjni luftarake*”.

Me shkatërrimin e *fisit mançu*, në vitin 1911, mori fund edhe perandoria e kultit, që kishte vazhduar deri në atë kohë. Tempulli i njohur i Qiellit u shndërrua në një muze. Ndërsa Mao Ce-Tung, shokëve të tij partiakë u tërhoqi vëmendjen që, ashtu sikurse mësojnë Marksini dhe Leninin, të mësojnë edhe Konfuçin.

4. Shintoizmi

Literatura: F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f.135; H. Von Glasenapp, *Die nichtchristlichen Religionen*, f.268-274; Ernst Benz, *Neue Religionen*, Stuttgart 1971.

Fjala *shinto* ka kuptimin “rruga e zotave”. Është një fjalë me të cilën japonezët i quajnë fetë vendase. “Shin, shen” (shpirti natyror) ka kuptimin “to, tao”. Bletës në japonishte i thuhet “kami no miçi”.

Njohuria jonë për fenë japoneze fillon me shkuarjen e misionarëve jezuitë në Japoni në shek. XVI dhe XVII dhe qëndrimin e tyre për një kohë të gjatë atje. Historia Shinto studiohet në tre periudha: periudha e parë fillon në kohën e legjendave dhe përfundon në vitin 552, datë e hyrjes së budizmit në Japoni. Ndërsa periudha e dytë, vazhdon deri në shek. IX, që është koha e luftës mes budizmit dhe shintoizmit. Në këtë periudhë elementet dhe mendimet budiste influencojnë shintoizmin. Kurse periudha e tretë, vazhdon deri në reformat perandorake të vitit 1868. Sepse, autoriteti dhe sundimi i Perandorit, që nga viti 1192, ka qenë në duart e komandantëve të fronit (*Shogun*). Përsëri në këtë periudhë u ndanë budizmi dhe shintoizmi, dhe u formua “një Shinto i pastër” ose “Shinto i reformuar” që më pas u shpall fe zyrtare e shtetit. Por, ajo lëvizje, që nuk e kënaqi popullin, hapi rrugën e paraqitjes së shumë fraksioneve shinto.

a. Librat e shenjtë

Japonezët, para pranimit të shkrimit kinez nuk kishin ndonjë shkrim të tyre special, kurse njohuritë për periudhat e mëhershme mbështeteshin në transmetimet gojore. Në vitin 712, transmetimet historike dhe legjendat e vjetra janë përmbledhur në veprën me titull “Koçiki”, dhe në vitin 720 u botua vepra me titull “Nihongi”, ku paraqitet historia e perandorisë së parë. Ndërsa përmbledhjet për kultin shtetëror dhe fenë, të përmbledhura në shek. IX dhe X, në vitin 927 janë botuar në 50 libra. Më i

rëndësishmi nga këta është “Engishiki”.

b. Konceptet për gjithësinë

Si në popujt e vjetër, edhe për shintoistët bota përbëhet prej tre shtresave që qëndrojnë njëra mbi tjetrën. Qielli, toka dhe nëntoka. Në të tre shtresat qëndrojnë hyjnitë. Vetëm se në nëntokë më tepër gjenden të vdekurit dhe viganët. Sipas legjendës për krijim nën ndikimin e kulturës kineze, në fillim ka ekzistuar një shkëmb në formë të vezës. Nga pjesët e imëta dhe të lehta të saj është krijuar qielli, ndërsa nga pjesët e trasha toka. Kurse hyjnitë janë krijuar vetvetiu. Zotët si Izinagi dhe motra e tij Izinami, me propozim të zotave të tjerë qëndrojnë mbi një urë të gjatë dhe të lartë, dhe përziejnë me shtizë të xhevahirtë, deri sa të thahet, shkëmbin prej baltës të paformuar. Me ngritjen e shtizave, balta që pikon prej tyre krijon një ishull. Më vonë, Izinagi dhe Izinami vendosen në këtë ishull dhe atje martohen. Nga kjo martesë lindin tetë ishuj japonezë, Zoti i Diellit Amaterasu dhe një mori zotash. Edhe për zotat e tjerë tregohen legjenda të ndryshme: Ninigi, nipi i Hyjneshës së Qiellit, afër tij mban shenjat (pasqyrën, shpatën dhe pe prej xhevahiri) e perandorisë japoneze. Ai zbret në ishullin Kijushu dhe atje martohet me vajzën e zotit të kodrës. Nga trashëgimtarët e tij të mëvonshëm është sundimtari i luftëtarëve hyjnorë, Xhimmu-Tenno. Ninigi popullin e tij e ka dërguar prej Kijushu në Jamato të perëndimit dhe atje është bërë “sundimtar i parë njerëzor”. Ninigi llogaritet themeluesi i fisit të sotëm sundimtar. Historianët japonezë si vit të hipjes në fron të Ninigit japin vitin 660 para e.s.

Këto legjenda paraqesin dy elemente të bashkuara në shintoizëm: në një anë është, pa dallim nga legjendat e popujve primitivë, arritja deri në ditët e sotme e një feje natyrore të thjeshtë; në anën tjetër, futja e themelimit të Perandorisë së Japonisë në mesin e ngjarjeve kozmike dhe ngritja e saj në shtresën e zotave. Kjo lidhje nxjerr në shesh të vërtetën se shintoizmi është fe më e vjetër natyrore që, në një popull me kulturë të lartë, ka jetuar deri më sot. Fenë, me një mendim të thelluar ia lidh perandorisë dhe e shenjtëron sundimtarin.

c. Forcat metafizike

Numri i zotave dhe i shpirtërave në shintoizëm, është aq i madh sa nuk mund të numërohen. Megjithatë, bëhet fjalë për 80 apo 800 kami (zota). Në krye të Panteonit gjendet Hyjneshja e Diellit, Amaterasu. Por kjo asnjëherë nuk është sundimtar i përgjithshëm i universit; ajo udhëheq vetëm shtetin Qiellor. Kurse udhëheqësia e botës më tepër gjendet në dorë të një kuvendi të zotave. Vendi i kultit më të madh të Amaterasusë është tek Isai, ndërsa simbol i hyjnisë është pasqyra. Tsukijomi, Zoti i Hënës, sot nuk duket fort në shesh. Rolin e tij pjesërisht e ka zoti i detit dhe i stuhisë, Susanowo. Ndërsa zoti i rrezikshëm është Atago, Zot i Zjarrit. Vendi i kultit kryesor është te Kijoto, në kodrën Atago. Edhe pse shumica e shtëpive prej druri të japonezëve zhduken nga ai dhe krahas asaj që është një forcë që jep lumturi, zjarri shihet si një forcë shkatërruese. Ndërkaq Inari, zot i ushqimit në kohërat e vjetëra, sot është bërë Njeri Orizi. Dhelpra llogaritet kafshë e shenjtë e tij. Për këtë në tempujt e tyre ushqehen dhelpra dhe nëpër to gjenden statuja të tyre. Përveç këtyre zotave të rëndësishëm, ka zotëra të vendeve dhe rrugëve të caktuara, zotëra të profesioneve të ndryshme të forcave natyrore. Bile besohet se çdo pjesë e shtëpisë si dera, kuzhina, oxhaku etj. kanë zotat e tyre specialë. Në periudhën e parë, kulti Phallus ka qenë shumë i përhapur. Sidomos respektoheshin edhe kafshët dhe kodrat e shenjta. Gjithashtu me futjen e disa sundimtarëve të vdekur në Panteon, Panteoni është zgjeruar edhe më shumë. Shumë respektohen Xhimmu, njëri prej sundimtarëve të shenjtëruar dhe themeluesi i shtetit, Mejxhi, perandor i vdekur më 1912 dhe sidomos shumë respektohet edhe Oxhini. Edhe nga njerëzit e mëdhenj edhe nga komandantët ka shumë të shenjtëruar.

ç. Kulti

Adhurimi i *kami*-ve (zotave) bëhet me leximin e lutjeve dhe me bërjen kurban të orizit dhe të pijeve nga orizi. Sot nuk ka shumë sakrificë kafshë. Gjithashtu nuk haset edhe në sakrificë njerëz, përveç atyre

që në raste të rralla e sakrifikojnë vetveten me dëshirën e tyre. Për shembull, Gjenerali Nogi dhe gruaja e tij, në ditën e varrimit të pernadorit Mejxhi, e kanë sakrifikuar veten duke u vrrarë me “harakiri”. Adhurimi bëhet ose nëpër shtëpi, ose nëpër tempuj në formë të kubeve të quajtura “mija”. Shumica e tempujve janë të thjeshtë dhe shtëpiza prej druri. Ato përbëhen prej një saloni për lutje dhe një saloni kryesor. Besimtari përpara salonit për lutje duke i shkundur duart ia tërheq vëmendjen zotit dhe fillon lutjen. Pas një perdeje në salonin kryesor, të fshehura në një qese të mbuluar gjenden simbolet (*pasqyra, arma, jastëku ose gjëra të ngjashme*) që e përfaqësojnë zotin. Pamjet dhe ndërtesat e tempujve të zotit gjendeshin në Shinton e vjetër, më vonë me influencën e budizmit u bë traditë ndërtimi i godinave të mëdha të shenjta. Përpara tempujve Shinto gjenden një apo më shumë dyer të hapura, të bëra prej dërrase, guri ose minerali, të quajtura “*tori*”. Për adhurim vizitohen edhe male dhe tempuj të shenjtë. Vizituesit gjatë intervalit të vizitës vishen me tesha të bardha dhe me kësulë prej hasëre. Në situatat si gjendja e papastërtisë, është e nevojshme larja e trupit më ujë të pastër.

Në adhurim udhëheqin murgjit. Në martesën e tyre nuk ka pengesa. Në të shumtën e rasteve detyrat u mbesin trashëgim nga baballarët e tyre. Gjatë adhurimit vënë një kësulë faktor të zezë, veshin xhup të bardhë dhe bartin një bastun.

d. Koncepti për botën e ardhshme

Shintoizmi, sipas transmetimeve të vjetra, ka një besim sipëfaqësor për botën e ardhshme. Besohet se shpirti i atij që ka vdekur ka shkuar në botën nëntokësore, kurse personalitetet e mëdha vazhdojnë të jetojnë fshehurazi në botë. Disa korrin sukses që të dalin në qiell. Në shintoizëm nuk besohet në shpërblimin e të mirës dhe të keqes. Vetëm se, si në popujt e tjerë, ashtu edhe në shintoizëm, besohet se paraardhësit i mbrojnë trashëgimtarët. Ndërkaq sipas mendimit të sotëm, çdo kush që vdes bëhet “kami” (zot).

dh. Shinto i shtetit

Me reformat e lëvizjes të shintoizmit të bëra në vitin 1868, u planifikua regresioni i budizmit, ndërsa shintoizmi u bë fe shtetërore. Por, pa kaluar shumë kohë, në vitin 1889 u shpall edhe liria e besimit. Që nga viti 1900 u kërkua që shintoizmi të jetë kult shtetëror, çdo japonez, pa marrë parasysh se cilës fe i takon, mund të marrë pjesë në këtë kult. Me këtë pretendohet që të forcohet ndjenja nacionale dhe autoriteti perandorak. Në vitin 1945 ngatërresat në mes të politikës së Japonisë dhe Shintosit së Shtetit i zgjidhi Amerika, ndërkaq në vitin 1946 perandori hoqi dorë nga pretendimi se është bir i zotit. Shinto e shtetit vendin ia la shekullarizmit dhe laicizmit. Zbrazëtinë që u krijua u munduan që ta mbushin fetë dhe rrymat e reja. Për shembull, Soka-Gakkai përbënte shumicën e të zgjedhurve në parlamentin Japonez. Sot është një realitet social dhe politik me peshë.

5. Fetë e reja japoneze

Një pjesë e rrymave kanë lindur në shekullin e kaluar. *Feja-Tenri* dhe *feja-Omoto* janë disa prej tyre. Në vitin 1945 kanë bërë një zhvillim të përshpejtuar. Kur shintoizmi ishte fe e shtetit budizmi dhe krishterimi ishin nën kontrollin e shtetit. Ndarja e administratës së fesë dhe shtetit, ardhja e një lirie të re fetare, hapi rrugën e daljes së shumë komuniteteve të reja përpara shoqërisë. Komunitetet, numri i të cilave më herët nuk kalonte numrin 34, në periudhën pas vitit 1946 arriti numrin mbi 400.²²¹ Është vështirë që këto komunitete t'i tubosh në një emër të përbashkët. Çdonjëri ka metodën e vet të zhvillimit.

E veçantë e feve të reja është që të gjitha ato mbështeten në një shpallje hyjnore dhe themeluesit e feve llogariten bartësit e shpalljes apo inkarnacion hyjnor. Kjo e vërtetë përbën themelin e suksesit të feve të reja. Çdo fe prek në aktualitetin e përvojës hyjnore. Propagandon udhërrëfënës për udhëzim. Në shoqërinë japoneze, ajo që tërheq vëmendjen është, krahas strukturës së saj patriarkale, prezenca e shumë grave në mesin e bartësve të shpalljes. Themeluesja e fesë-tenri, Miki Nakajama, ishte gruaja e një marangozi. Ajo në vitin 1838 shpalli se zotat e kanë thirrur që t'iu shërbejë atyre. Nipi i madh i saj, Zen-e Nakajama, është lider i besimtarëve, numri i të cilëve sot e kalon tre milionshin. Në të njëjtën mënyrë edhe feja-omoto bazohet në Nao Deguchi, bartës i shpalljes së krijuesit të gjithësisë dhe zotit të qiellit, dhe nipi i tij sot është kryetar i komunitetit. Numri i sampatizantëve kalon mbi një milion. Disa themelues të tjerë të feve shpalljet hyjnore i mbështesin në rrugën e re të udhëzimit të Budës. Për shembull, njëri nga këta është Baba-Kakushun, themelues i Issaj-Shuit. Gjithashtu edhe Jasaka Kakusho mbështet shpalljen e Kobo Daishit, lider i drejtimit budist Shingon. Poashtu, Ogura Raigan, themeluesi i Nempo-Shinkjo-së, fraksionin e tij e mbështet në manifestimin e Amida Budhha-s. Ndërsa disa të tjerë shpalljen e tyre e bazojnë në zotat e adhuruar tradicionale japonezë. Për shembull, Kitamura Sajo, themeluesi i komunitetit të quajtur “fe e atyre që vallëzojnë”, pretendon se nga hyjnia e një burri dhe një gruaje është obliguar që ai vetë në tokë të themelojë sundimin hyjnor. Ndërsa një grup tjetër pretendojnë se janë negocues mes njerëzve dhe shpirtërave dhe se janë të obliguar t'iu tregojnë njerëzve rrugën e drejtë.²²²

Sipas rrënjëve ku mbështeten fetë, ndryshon edhe koncepti për shpalljen. Në përgjithësi ndërmjetësit e rinj që janë në pozitë të të dërguarit të botës qiellore, kanë bindjen se fuqia madhështore njerëzve u ka sjellë zgjidhje të reja të përshtatshme me nevojat e kohës sonë.

Ana e rëndësishme e feve të reja është formimi i marrëdhënieve të brendshme mes udhëzimit fetar dhe mes shëndetit e shërimit trupor. Të dërguarit e rinj të udhëzimit si rrugë për arritjen e shpëtimit theksojnë se ata nuk shpërndajnë vetëm shpëtim shpirtëror, por, shpërndajnë edhe ilaç edhe për shërim trupor dhe shpirtëror. Gjithashtu në fetë e reja mrekullitë e shpërndarjes së shërimit janë shumë të përhapura. Shërimi shpirtëror dhe trupor, paramendohet si ripërtirje e trupit dhe shpirtit të njeriut. Mund të bëhemi dëshmitarë të punëve të çuditshme dhe admiruese të personave, të cilët pretendojnë se janë në marrëdhënie me botën hyjnore.²²³

Në fetë e reja theksohet edhe etika sociale. Bashkë me shërimin dhe udhëzimin priten edhe zgjidhjet e problemeve shoqërore që i kanë sjellë luftërat dhe varfëria. Pjesa më e madhe e këtyre feve manifestojnë qëndrim pasiv. Aktivitetet etike brenda në komunitete janë shumë të forta, në këtë aspekt përdorin mjetet më moderne. Për shembull, fetë tenri dhe omoto garojnë njëra me tjetrën në ndërtim në të gjitha fushat shoqërore, si çerdhe fëmijësh, strehimore për të varfër, spitale, pushimore etj. Specifikë me rëndësi në institucionet fetare është garantimi i sigurisë dhe mbrojtja sociale e personave të familjeve të mëdha të vjetra japoneze dhe kalimi i komuniteteve fetare në vend të familjeve të mëdha të shkatërruara bashkë me industrializimin modern. Këtu individët gjejnë, jo vetëm ngopje shpirtërore,

²²¹ Ernst Benz, *Neue Religionen*, Stuttgart 1971, f. 18.

²²² Benz, f. 19.

²²³ Benz, f. 20.

por, në të njëjtën kohë gjejnë edhe dashuri dhe mbrojtje sociale brenda në komunitet.²²⁴ Siç shihet në rendet, në përfaqësimin e liderit fetar jetohen ideale shpirtërore dhe administrative.

Fetë e reja nuk manifestohen vetëm në formë të librave të shenjtë dhe të shkrimeve të shenjta, në to edhe shpalljet e reja dhe personalitetet e rinj janë përfaqësues të fuqisë shpirtërore. Këta liderë luajnë rol të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve shpirtërore dhe materiale brenda në komunitet. Ende nuk është themeluar sistemi hierarkik. Marrëdhëniet mes komunitetit dhe liderit janë të natyrshme. Respekti dhe dashuria e treguar ndaj liderëve nuk është pengesë që individët problemet e tyre t'i dërgojnë individualisht tek liderët, por, edhe në atë që lideri të merret me ta.

Kjo lëvizje shoqërore, varet edhe nga pritja për *Kobën e Fundit*. Qëllimi kryesor nuk është vetëm ripërtëritja e njeriut, por, edhe ripërtëritja e shoqërisë. Ka një pritje të gjallë për të ardhmen dhe kjo pritje është zhdukja e të gjitha fatkeqësive sociale si uria, mjerimi dhe luftërat, dhe formimi i shoqërive ideale. Për këtë qëllim, ndërtohen qytete të komuniteteve të reja ku do të jetojë shoqëria idealiste. Masa e fetarisë është sukcesi i respektit dhe dashurisë brenda në komunitet.²²⁵

6. Feja Cao-Dai e Vietnamit

Në gjuhën vietnameze Cao-Dai është emri i Zotit të Madh dhe gjithashtu është edhe emri i fesë së re, të krijuar në fillim të shek. XIX. Për një kohë të shkurtër ka fituar mbi dy milionë simpatizues. Cao-Dai ka bashkuar fetë e vjetra dhe thotë se ka hapur rrugën dhe e ka filluar periudhën e shpëtimit. Në aspektin egzotik manifeston strukturën hierarkike të kishës katolike dhe murgërisë budiste, etikën e konfuçionizmit dhe konceptin taoist për universin. Specifika mesianike në pretendimin universal të kësaj feje të re, paraqet një paralelizëm me rrymat e reja të paraqitura në rajone të ndryshme të botës. Specifikë më e rëndësishme e saj është dhënia peshë mendimit spiritualist. Spiritualizmi tradicional që haset nëpër rajone të ndryshme të Azisë është sintezë e respektit të shpirtërave të paraardhësve, të shpirtërave të personave të vdekur dhe spiritualizmit “shkencor” perëndimor, i bazuar në francezin Allen Kardec.²²⁶

Nga përzieria e mendimeve spiritualiste të tipit perëndimor, të bartura në Vietnam nëpërmjet nëpunësve dhe oficerëve kolonizues francezë, dhe e besimeve shpirtërore vendëse, ka lindur një rrymë e re. Profeti dhe përfaqësuesi i kësaj rryme është Phu-ven-Chieu. Ai pretendon se ka pranuar shpallje nga zoti Cao-Dai, dhe se është dërguar për të udhëzuar popullin vietnamez. Më vonë shpalljen dhe profetësinë e ka vazhduar Le-van-Trung. Trung ka ndaluar përdorimin e alkoolit dhe pijeve të tjera dehëse, ushqimet e kafshëve si ngrënien e mishit dhe peshkut, dhe ka shpjeguar nevojën e të ushqyerit me ushqime bimore.²²⁷

Në vitin 1926 Cao-Dai zyrtarisht njihet si fe e re dhe tempujt e parë janë hapur në Taj-Ninh. Ata kanë një rajon (kamp) simbolik të pavarur, të ngjashëm me Vatikanin, ku udhëheqin. Sipas një libri të katekizmit të botuar në vitin 1953, bota gjithnjë e më shumë shkon drejt të keqes dhe i afrohet Ditës së Fundit. Cao-Dai është Zoti i Madh, njësinë dhe ekzistencën e të cilit e kanë lajmëruar të gjithë të dërguarit. Shpirtërat, menjëherë pas vdekjes së trupit vazhdojnë të jetojnë në trupa të tjerë pasues. Masa e reinkarnacionit, si përgjigje e sjelljeve të mira dhe të këqia në sistemin Karma të hinduizmit, ndikimin e saj e paraqet në trupat e ardhshëm. Ringjallja (jeta e dytë) nuk ndodh vetëm në botë, ajo ndodh edhe në yje dhe planete të tjera. Shpirtërat me njerëzit e tjerë flasin nëpërmjet ndërmjetësuesve. Shpalljet e reja mund të merren në seancat e kultit. Në shpallje nuk ka kufizim kohor dhe vendor. Vetëm se, u lejohet mbajtja e seancave individuale që bëhen për keqpërdorime. Në tempujt e ligjshëm është shpallja e pranuar dhe lidhja me botën hyjnore gjatë intervalit të ceremonisë nga ana e murgjve.²²⁸

²²⁴ Benz, f. 21.

²²⁵ Benz, f. 22.

²²⁶ Benz, f. 25.

²²⁷ Benz, f. 26-28.

²²⁸ Benz, f. 29-42.

7. Sun Myung Moon dhe Lëvizja e Unitetit

Lëvizja ka filluar me Organizatën “*Shpirti i Shenjtë*”, e themeluar nga koreani Sun Myung Moon në vitin 1954. Qëllimi i lëvizjes është që në bazë të parimeve të veta, të bashkojë krishterimin dhe të gjitha fetë e tjera botërore në komunitetin me emër “mesia i pritur”. Ky “bashkim” është edhe botëror edhe fetar. Bazat themelore të këtij sistemi janë sqaruar në librat e shenjtë me emrin “Parimet Hyjnore”. Moon është lideri shpirtëror që të gjithë fetë e presin si “mesia”. Ai është i obliguar të formojë vëllazërinë botërore. Ai do ta plotësojë detyrën e lënë përgjysëm nga ana e Jezu Krishtit.²²⁹

Themeluesi i lëvizjes, Sun Myung Moon, ka lindur në vitin 1920 në Sangari të Koresë Veriore. Kur Moon ka qenë 10 vjeç familja e tij e ka lënë budizmin dhe ka përqaftuar krishterimin. Edhe në doktrinë bien në sy ndikimet e parimeve themelore të të dyja këtyre feve. Ai ka studiuar inxhinieri. Në moshën 16 vjeçare, për shkak të vizionit *Jezu Krishti* të përjetuar dhe për shkak të ndjeshmërisë se kjo detyrë i ka kaluar atij, ai vazhdoi meditimit dhe në dritën e shpalljes dhe inspirimit në moshën 25 vjeçare, ka përgatitur bazat e doktrinës të paraqitura me titull “*Parimet e Unifikimit*”.²³⁰ Në vitin 1951 fillon propagandimin e detyrës. Së shpejti do të realizohet premtimi i dhënë Mesias, i cili do të sundojë botën e re. Lëvizja zyrtare filloi më 1954.

Moon, për të zhdukur ndarjen mes njerëzve dhe ndjenjat nacionaliste, ka nxitur martesën e përzier. Në fusha të ndryshme ka formuar organizata ndërkombëtare. Ai llogaritet “*babai*” i komunitetit. Tre martesat e para të tij nuk kanë qenë të suksesshme. Por, ai bashkë me gruan e katërt të tij janë “prindër të vërtetë”. Edhe familja e formuar me vënien e kurorës është “familja e vërtetë”. Fëmijët që do të lindin janë fëmijë pa mëkate. Ai e ka gjetur rrugën e shpëtimit të njerëzimit nga sundimi i djallit dhe atë e propagandon. Mëkati i cili ka filluar me “*adulterin*” e Eva-së dhe të djallit, ka vazhduar me “*Kabilin*”. Kështu që babai i racës njerëzore është bërë “*djall*”. Tash, me themelimin e “Familjes së Vërtetë” të Moon-it dhe me familjet e tjera të shenjtëruara nga ai, do të përfundojë sundimi dhe mëkati i djallit.

Sipas Moon-it, koha legjitime e periudhës së Dhiatës së Vjetër dhe të Re, ka përfunduar dhe ka filluar periudha II e Jezu Krishtit. Njerëzit përsosmërinë e tyre do ta arrijnë me anë të besimit të drejtë dhe sjelljeve etike.

“Trupi kur ta përfundojë funksionin e tij vdes, ndërsa në dimensionin metafizik vazhdon të jetojë shpirti, që nuk duket por ka arritur një përsosshmëri të caktuar.” Qëllimi i strukturës fizike është të ndihmojë zhvillimin e shpirtit.²³¹

*“Kur trupi, me kryerjen e funksionit vdes, që të mos ketë më asnjëherë mundësi të formohet një tërësi materiale, këthehet në tokë, vend ky ku trupi do të ndahet në elemente që e përbëjnë strukturën e tij. Kur trupi vdes, shpirti ndahet nga ai dhe fillon jetën e tij deri në pafundësi në botën shpirtërore, pa mos ekzistuar një përkufizim trupor. Shpirti, që kalon në këtë dimension, ka aftësi për të komunikuar edhe me ekzistencat tjera shpirtërore, në botën e shpirtërore, edhe me personalitetet shpirtërore të njerëzve, të cilët momentalisht gjenden në trupa fizikë të botës fizike.”*²³² *“Njerëzit që gjatë jetës në këtë botë nuk kanë mundur të arrijnë përsosmërinë, që është qëllim i krijimit, janë të detyruar t’i vazhdojnë përpjekjet e tyre për ta arritur atë, nëse nuk kanë ndonjë dallim trupor në botën shpirtërore, në bashkëpunim me njerëzit që ende jetojnë në trupa fizikë. Shpirti, në këtë dimension të ri të privuar nga avantazhet trupore që mundëson elemente gjallërie, e cila do të ndihmojë në mënyrë direkte në lartësimin e tij, atë e detyron që, për lartësimin e tij, në krabasim me mundin në këtë botë të harxhojë mund më të madh...duke ndihmuar njerëzit e drejtë, ai mund të shfrytëzojë rrugët indirekte që zgjatë më tepër.”*²³³ *“Pas vdekjes së trupit, nuk janë të vërteta pretendimet se shpirti që e lë trupi, me një ndryshim magjik pa asnjëfarë përgjegjësie, do të jetojë në parajsë. Po edhe pretendimet se shpirti, kur është i ulët, i mallkuar do të qëndrojë deri në pafundësi në ferr... Shpirtërat e ulët, duke i përgatitur vetvetes jetë qendrore duke bërë presion mbi të tjerët, jetojnë në vendin e quajtur ferr, është një fushë shpirtërore nën fazën e krijimit. Ndërsa në vendin e quajtur parajsë, në afërsi të hapësirës së ferrit, qëndrojnë shpirtërat të cilat besojnë në Zotin apo jetojnë jetë të vetëdijshme*

²²⁹ Chung Hwan Kwak-Thomas Cromwell, *Unification Prenciplerinin Özü, Sun Myung Moon’un Öğretisinin Esasları*, pa vend dhe datë botimi, f. 233-241.

²³⁰ Kwak-Cromwell, f. 3.

²³¹ Kwak-Cromwell, f. 41.

²³² Kwak-Cromwell, f. 52.

²³³ Kwak-Cromwell, f. 56-57.

duke qëndruar lidhur me vlerat e drejta që janë të grupëzuara sipas kulturës dhe grupeve që u takojnë.”²³⁴ “Në botën ideale të Zotit nuk ka ndonjë vend që qubet ferr dhe kur njeriu, të arrijë bashkimin absolut me Të (Zotin), arrinë kënaqësinë e të jetuarit nën dominimin e dashurisë së pafund dhe të pabarxhueshme të Tij.”²³⁵

Pra, shpirtërat që arrijnë përsosmërinë, pas vdekjes lartësohen në katin e Zotit. Ndërsa shpirtërat e njerëzve, të cilët me sjellje dhe besim të gabuar, nuk kanë mundur të arrijnë përsosmërinë, si fantazmë (hije), pa trup vazhdojnë të shëtisin dhe të ndjejnë dhembje. Shpirtërat, të cilët në jetën fizike nuk kanë mundur të arrijnë shpëtimin, pas vdekjes u ndihmojnë pozitivisht ekzistencave fizike, ata mund t'i shtojnë punët e mira dhe bamirësitë, të cilët duke e zhvilluar përsosmërinë bashkohen me Zotin. Parajsja është shprehja simbolike e bashkimit me Zotin, ndërsa ferri është shprehja simbolike e largësisë nga Zoti dhe e shtimit të mërzisë. Siç shihet, nuk ka Kohë të Fundit, Ditë të Llogarisë dhe Besim në ringjallje, si në islam.²³⁶

Jezusi në misionin e tij mesianik nuk ka qenë i suksesshëm, kurse Muhamedi, “është një profet që i është dërguar njerëzimit me detyrë për të bërë përgatitjet për ardhjen e prindërve të vërtetë.”²³⁷

Me themelimin e qeverisjes së Zotit në botë nga ana e Mesias II. ka filluar “periudha e artë”. Veprimet e saja vazhdojnë me organizata të ndryshme internacionale për paqe. Njeriu i zgjedhur nga Zoti, me të përfunduar misionin e tij, Zoti do t'ua bëjë me dije njerëzimit dhe ata do ta ndjekin atë.

Qenia dhe thelbi i Zotit shpjegohet me parimin e mashkullit dhe femrës “Jin dhe Jang”, siç është në besimin Tao të kinezëve. Sipas kësaj, ekzistenca e Zotit del në shesh nga bashkimi harmonik i parimeve mashkull dhe femër, që shprehen me Jin dhe Jang. Pra, Zoti është një ekzistencë e përbërë prej dy substancave. Megjithatë mes këtyre dy specifikave nuk bëhet fjalë për ndarje, por, mes tyre ka një harmoni të përsosur.²³⁸ Edhe krijesat në univers, siç shpjegohet në filozofinë islame dhe greke, kanë dalë nga ekzistenca e Tij; cilësitë pozitive dhe negative që i bartin, manifestojnë strukturën ezoterike të Zotit:

“Natyra shpirtërore e njerëzve manifeston specifikat e brendshme të Zotit, kurse natyra fizike manifeston specifikat e dukshme të Zotit... Të gjitha krijesat, prej njeriut e deri te atomet, janë krijuar me qëllim që t'i ngjajnë natyrës së vërtetë të Zotit dhe t'i përdorin të gjitha mundësitë që duhen për gjeneralizimin e kësaj ngjashmërie, gjegjësisht, qëllimet e ekzistimit.”²³⁹ “Çdo burrë manifeston dhe shpreh në mënyrë të përkryer cilësitë e ilustruara të Zotit, ndërsa çdo grua manifeston dhe shpreh në mënyrë të përkryer cilësitë femërore të Zotit.”²⁴⁰

Lëvizja punon në organizimin e saj në fusha të ndryshme dhe në përforcimin e ndikimit shpirtëror dhe material në supermarketet tregtare. Në vende të ndryshme të botës si në Kore, Japoni, ShBA, ka formuar qendra misionerike dhe e vazhdon veprimtarinë për ta bërë të njohur vetveten dhe për të përfutur simpatizues. Edhe në Stamboll ka një qendër misionerike.

²³⁴ Kwak-Cromwell, f. 56.

²³⁵ Kwak-Cromwell, f. 57.

²³⁶ Kwak-Cromwell, f. 233 dhe në vazhdim.

²³⁷ Kwak-Cromwell, f. 213.

²³⁸ Kwak-Cromwell, f. 13.

²³⁹ Kwak-Cromwell, f. 19 dhe në vazhdim.

²⁴⁰ Kwak-Cromwell, f. 20.

8. Kulti-Kargo

Sipas perëndimorëve, lëvizjeve të reja mesianike të vendësve në Ishujt e Oqeanisë, si Malenezi, Guine e Re dhe rajonit për rreth, u thuhet kulti “Kargo”. Kuptimi kryesor i fjalës Kargo është “*barra e anijes*”. Në lëvizjet që shihen te vendësit, të ngritur kundër sundimeve kolonizuese në rajon, ekziston mendimi se parajsja dhe shpirtërat e paraardhësve gjenden në lindje dhe se një ditë do të kthehen me lumturi, dhe plot me pasuri; dhe se ata do të sjellin prosperitet dhe shpëtim shpirtëror. Koncepti për parajsën, koha e fundit dhe kulti për paraardhësit janë bashkuar, komentimet fetare për anijet dhe barrën që sjell prosperitet janë shndëruar në “*anije të shpëtimit dhe lumturisë*”. Në fund të shekullit të kaluar është përhapur mendimi se pritja dhe ngarkesa e anijes me pasuri të shtrenjtë nga Europa, do t’u shpërndahet vendësve pa pagesë dhe pa kthim. Kryengritjet e vendësve kundër perëndimorëve dhe misionarëve janë ngjyrosur edhe me karakter fetar.

Njëri prej të dërguarve të lëvizjes së re ishte Ndugomoi. Edhe Fixhi ishte një vendës nga një familje murgjish.²⁴¹ Ai thoshte se pranon shpallje nga zotat e fiseve të vjetra; se ditët e mira të së kaluarës (Periudha e Artë) janë afruar dhe se zotat dhe shpirtërat e paraardhësve do ta ndihmojnë atë. Sihariqi i shpalljes është jetë dhe lumturi e përhershme. Të vjetrit do të bëhen të rinj dhe do të jenë të pavdekshëm. Ndërsa mosbesimtarët, do të shkojnë përgjithmonë në ferr ose mundësia më e mirë për ta është se do të bëhen shërbyes dhe sklevër të besimtarëve. Pasuritë perëndimore do t’i sjellë Zoti dhe shpirtërat e paraardhësve. Në këto sihariqe të periudhës mesianike shpëtimi fetar dhe bota e ardhshme, qëllimet sociale dhe politika janë të bashkuara. Kjo ishte një kundërveprim ndaj invaduesve dhe kolonizuesve.²⁴² Mesia që pret në lëvizje, ishte një dysi hyjnore, janë Jahve dhe Jezusi, që në gjuhën vendëse njihen si Natirikaumoli dhe Nakausambaia. Kryengritja që u bë në vitin 1885 u shtyp me gjak. Lëvizje e ngjashme u bë edhe në Guine të Veriut në vitin 1937, e filluar nga një vendës me emrin Mambu. Mambu thoshte se profecia e tij do të fillojë së shpejti dhe do të jetë e vërtetë. Pritja për kohën e fundit jepte sihariqe për pasuri dhe përparim. Në vitin 1938 Mambu u kap dhe u burgos. Edhe kryengritja u shtyp në vitin 1939. Lëvizje të ngjashme kohë pas kohe vazhduan të bëhen në vende të ndryshme të rajonit.²⁴³

²⁴¹ Benz, f. 129.

²⁴² Benz, f. 130.

²⁴³ Benz, f. 131-133.

HEBRAIZMI

Literatura: *Yahudilike Kavram ve Değerler*, përg. Suzan Alalu, Klara Arditi, Eda Asayas etj., Gözlem Gazetecilik Basın ve Yayın A.Ş., Stamboll 1997, f.302; Ali Sayı, *Hız. Musa*, Stamboll, 1992, 322 f.; Hikmet Tanyu, *Tarih Boyunca Yahudiler ve Türkler*, Stamboll, 1997; Ahmet Çelebi, *Yahudilik*, Stamboll, 1978; Günter Lanczkovski, *Heilige Schriften*, Stuttgart, 1956, f.20-27; Carl Clemen, *Die Religionen der Erde*, V. III, f.7-55; H. Von Glasenapp, *Die Nicht-christlichen Religionen*, Frankfurt, 1963; F. Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f.652-636; H.J. Schoeps, *Religionen*, f.239-263; Türkiye Başhahamlığı, *İbrani Din Bilgisi*, Stamboll, 1992, f.60; Nisim Behar, *İbrani Taribi*, Stamboll, 1979, 200 f.; Mehmet Aydın, (pëmb. dhe përkth.), *Din Fenomeni*, Konya, 1993. Ahmet Hikmet Eroğlu, *Osmanlı Devletinde Yahudiler*, (Dini ve Sosyal Durmu XVI ve XIXç Yüzyıllar), Seba Yayınları, Ankara, 1997, f.250; Abdurrahman Küçük, *Dönmeler ve Dönmelik Taribi*, Stamboll 1979; İsidore Epstein, *Judaism*, G.B. 1979; Roland de Vaux, *The Early History of İsrail*, Londër, 1978, v.I-II; Zafer ul-Islam Han, *Yahudilik'te Talmud'un Merkezi ve Prensipleri*, përkth. M. Aydın, Stamboll, 1981, f.90.

Hebraizmi është njëra prej feve më të vjetra që ende jeton. Nuk është e qartë a është fe apo komb. Në historinë e feve zë vend të posaçëm. Këtu janë të përziera feja dhe nacioni dhe është shumë vështirë që këto të ndahen njëra prej tjetrës. Shprehja në tregimin Balam në Dhiatën e Vjetër, ndriçon pozitën e hebraizmit.²⁴⁴ Nëse kjo situatë speciale do të shprehej me një thënie moderne, atëherë mund të thuhet se hebraizmi është një bashkim i besimit dhe nacionit, që kanë të njëjtën gjenezë biologjike dhe të njëjtën shoqëri fetare. Supozohet se në botë ka përafërsisht 15–20 milionë hebrenj. Nga këta, 3 milionë jetojnë në Izrael, 6 milionë në ShBA, ndërsa të tjerët si grupacione minoritare jetojnë në shtete të ndryshme të botës.

Sipas transmetimit si nevojë e premtimit që Perëndia i ka bërë profetit Abraham/Ibrahim, nga gjeneza e të cilit rrjedh ky popull, ai (populli izraelit) është i zgjedhur nga popujt e tjerë dhe është dërguar në gadishullin Sinai, ku i është dhënë edhe Dhiata e Vjetër/Tevrati.

Termi jahudi (hebre): Emri i djalit të 4 nga 12 djemtë e profetit Jakob ishte Juda ose Jehuda, ai më pas u bë babai i fisit Jehuda. Pas vdekjes së Solomonit shteti u nda në dy pjesë. Njëri prej tyre, mbretërisë jugore i jepet emri Jahuda. Ky emër për fiset dhe anëtarët e mbretërisë filloi të përdoret pas syrgjynosjes në Babiloni dhe gradualisht u bë një emër gjeneral.

İsrail: është nofka e Jakobit/Jakubit. Ky emër i është dhënë atij në kuptimin “ai që merret me fatin”.²⁴⁵ Më vonë u bë emër i fisit, ndërsa pas Solomonit u bë emër i shtetit verior. Sot është emër i Republikës Izraelite të formuar në 1948 në Palestinë. Populli njihet me emrin izraelitë. Në vende të ndryshme në Kur'an shpesh përmendet fjala “*Beni İsrail*” (Bijtë e Izraelit), me të cilën përcaktohen hebrenjtë.

Ibrani: kjo fjalë rrjedh nga fjala “*Ibrim*”. Bazohet në fiset me emër “*Ibrî*” ose “*Hibrî*” të cilët në shek. XIV para e.s. kanë jetuar në Kenan (Palestinë). Kurse në hieroglifë kjo fjalë kalon si “*Hapiri*”. Ky popull herët ka bërë marrëveshje me Bijtë e Izraelit, më vonë duke u mbështetur në babain e fisit me emër “*Eber*” është përzier me ta. Ndërkaq vetë hebrenjtë nga të huajt njihen si “*Ibrim*” (Eber), që ka kuptimin “Ata të cilët banojnë në anën tjetër të lumit Jordan”. Edhe emri “*ıbraniş*”, që është gjuhë e Dhitaës së Vjetër, rrjedh nga kjo rrënjë.

Musevî: Ka kuptimin ithtarët e Moisiut, i cili konsiderohet nga ata si themeluesi i fesë hebraike.

Sot këto katër terma përdoren në të njëjtin kuptim. Për ata që cilët jetojnë në shtetet krishtere



²⁴⁴ *Numrat*, XXIII, 9.

²⁴⁵ *Zanafilla*, XXXII, 22-23.

përdoret termi “*ashkenazë*” ndërsa për ata që jetojnë në shtetet islame përdoret termi “*sefaradë*”. Para krijimit të shtetit Izraelit në atë rajon ka patur 65.000 hebrenj. Shpërngulja atje e hebrenjve ashkenazë dhe sefaradë e ka rritur dukshëm numrin dhe numri i popullatës në Izrael sot është përafërsisht 3 milionë. Dendshmëria më e madhe e tyre është në ShBA, numri i të cilëve arrinë në 6 milionë. Pas kësaj pasojnë Rusia dhe Franca.

1. Moisiu

Moisiu llogaritet si themelues i fesë hebraike. Për këtë edhe kësaj feje i thuhet musevizëm. Sipas mendimit gjeneral, Moisiu/Musai ka jetuar në vitet 1250 para e.s. Emri i tij sqarohet në forma të ndryshme. Sipas pjesës “*Eksodusi*” të Dhiatës së Vjetër, emri i tij ka kuptimin “i nxjerrur nga uji”.²⁴⁶ Me siguri fjala Mashe në ibranishte, mund të jetë një fjalë që në gjuhën e vjetër egjiptiane, ka kuptimin “*Zoti dha*”.

Sipas transmetimeve të Dhiatës së Vjetër, Moisiu është prej fisit Levi. Nëna e tij është Yohabed, ndërsa babai Anron. Është nip i brezit të pestë të Abrahamit, dhe ka lindur në Egjipt. Në atë kohë Faraoni, për shkak të fallit se në mesin e Bijve të Izraelit do të lindë një djalë që do të bëhet sundimtar i Egjiptit, urdhëron që të vriten të gjithë fëmijët meshkuj.²⁴⁷ Edhe nëna e Moisiut është inspiruar që fëmijën e saj të mos e dorëzojë dhe t’ia japë atë një mendëshe, ndërsa, nëse paraqitet ndonjë rrezik ta lëshojë atë në lumë.²⁴⁸ Nëna që e tajisi atë tre muaj, e futi në një sënduq dhe e la në një anë të lumit. Sënduqin e pa vajza e Faraonit dhe kur ia sollti atij, ai në të gjeti një djalë. Nga simpatia që kishte ndaj fëmijës, nuk mundi të lejojë vrasjen e tij, por mori vendim të adoptohet dhe të rritet në saraj.²⁴⁹ Vendimin e mbështeti edhe gruaja e Faraonit.²⁵⁰ Kështu që Moisiu si një princ në sarajin e perandorisë më të fortë botërore të asaj kohe, mori edukimin më të lartë të kohës dhe u përgatit si udhëheqës dhe komandant. Mësoi shkrimin dhe shkencat e kohës. Perëndia në mënyrë indirekte atij ia mundësoi të marrë edukatën që do t’i nevojitet për obligimin që do t’i ngarkohet në të ardhmen.

Kur arriti moshën e pjekurisë, një ditë duke shëtitur nëpër qytet, nga që nuk mundi të durojë sjelljen e keqe të një egjiptiani ndaj një hebreu, egjiptianin e goditi me shuplakë. Egjiptiani vdiq. Moisiu për shkak të frikës se ndoshta ndaj tij do të hakmerren ikën. Që të mos e gjejnë shkoi drejt Medjenit dhe sipas Kur’anit atje u martua me vajzën e një njeriu të mirë plak, ndërsa sipas Dhiatës së Vjetër u martua me Zipparan vajzë e priftit Jesro, dhe vazhdoi jetën si bari.²⁵¹ Literatura islame thotë se ky njeri i mirë është Shuajbi (a.s.), dhe e ka identifikuar me të. Moisiu me vajzën e njeriut të mirë nga Medjeni ka patur dy djem, Gershemin dhe Eliezerin.²⁵² Ai kur arriti moshën 40 vjeçare, në Medjen krijoi shoqëri me të afërmit e besimit të Abrahamit, të cilët rrjedhin nga fisi i Abrahamit/Ibrahimit (a.s.).²⁵³ Atë edhe në Medjen e nxorri në plan të parë, ajo që ai ishte dhëndër i njeriut të drejtë dhe të mirë. Atje mësoi klimën dhe rrugët e jetës normale, gjithashtu mësoi edhe burimet e të jetuarit. Ka mundësi që këtu të kishte mësuar njësinë e Zotit (*monoteizmin*), të cilën nuk ka patur mundësi që ta mësojë në saraj. Gjeti rastin që të vendosë familjen dhe bashkëkombasit e tij në Egjipt. Në një natë të ftohtë, në shkretirë pa diçka që shndritte dhe kur iu afrua që të ngrohet dhe të marrë prush me vete, u ballafaqua me thirrjen hyjnore (të Zotit). U thirr në detyrën e profecisë.²⁵⁴ Mori urdhërat hyjnore dhe bashkë me familjen e tij morri rrugën për t’u kthyer në Egjipt. Për shkak të vështirësisë së tij në të folur, u lut që vëllai i tij Aroni të jetë ndihmësi i tij dhe lutja iu pranua. U obligua që sundimtarin e Egjiptit Faraonin ta thirrë në besim në një Zot, ndërsa popullin ta shpëtojë nga skllavëria.²⁵⁵

Përsëri u kthye në sarajin e Faraonit dhe sipas obligimit që kishte, Faraonin dhe ata që ishin rreth tij

²⁴⁶ *Eksodi*, II, 10.

²⁴⁷ Kur’ani, Bakara, 49.

²⁴⁸ *Kur’ani*, Kasas, 7.

²⁴⁹ *Eksodi*, II, 5-10.

²⁵⁰ Kur’ani, Kasas, 9.

²⁵¹ Kur’ani, Kasas, 25-26; *Eksodi*, II, 21, III, 1.

²⁵² *Eksodi*, II, 22, XVIII, 3-4.

²⁵³ *Eksodi*, XVIII, 10-12.

²⁵⁴ Kur’ani, Kasas, 29-32.

²⁵⁵ Kur’ani, Kasas, 34-35.

i thirri në besim në një Zot. Ndërsa nga Faraoni kërkoi leje që popullin e tij në fillim ta nxjerrë nga Egjipti. Edhe pse Faraoni tregoi mirëkuptim në dhënien e lejes, ai më vonë kthen nga vendimi i tij. Moisiu, në këtë rast Musai (a.s.), paraqiti mrekullitë si argument për profecinë/pejgamberllëkun e tij. Por nuk u pranua dhe u fajësua si magjisttar. U fajësua edhe me atë se dëshiron ta uzurpojë shtetin dhe forcën politike.²⁵⁶ Sepse Faraoni besonte se nëse ata i lë të lirë, ai do ta humbë forcën punuese të shtetit, punët që janë duke u bërë do të mbeten në gjysëm dhe se shteti do të ketë humbje. Një rrezik tjetër ishte se Bijtë e Izraelit do të dalin prej Egjiptit e do të takohen dhe do të bashkëpunojnë me armiqtë në veri të Egjiptit dhe kështu që, Egjipti do të jetë në pozitë të vështirë. Pasi që nuk iu dha leje, Moisiu filloi të përgatitet që Bijtë e Izraelit t'i nxjerrë fshehurazi prej Egjipti. Kur arritën pranë brigjeve të Suezit panë se edhe Faraoni me ushtrinë e tij është duke iu afruar atyre. Në këtë moment kritik, sipas Kur'anit, si mrekulli e Musait (a.s.), Deti i Kuq u nda dhe Bijve të Izraelit iu çel rrugë për kalim. Moisiu dhe ata që ishin me të shpëtuan në sajë të rrugës që u hap në Detin e Kuq. Ndërsa ndjekësit e tyre, Faraoni dhe ushtarët e tij (1224 p.e.s.), u mbytën në valët e ujit. Mendohet se Bijtë e Izraelit që kur kanë hyrë në Egjipt numri i tyre ka qenë 70 vetë, ndërsa 220 vjet më vonë në Egjipt ata janë bërë me qindra mijëra njerëz.

Faraoni i cili i ka shtypur Bijtë e Izraelit ka qenë Ramses II. (1301-1234 p.e.s). Ndërsa Faraoni, që ka qenë sundimtar në kohën kur Bijtë e Izraelit janë larguar nga Egjipti, ka qenë Minfitani (1290 – 1224), djali i Ramses II. Ngjarja e largimit ka ndodhur në vitin 1224 para e.s.²⁵⁷

2. Jeta në Sina dhe dhjetë urdhërat

Tubimi i Bijve të Izraelit rreth Moisiut ndodhi ngaqë ata, atë më tepër e shihnin si një lider dhe një komandant që ata do t'i shpëtojnë nga skllavëria e egjiptasve dhe jo ngaqë i besonin atij si një profet. Por pasi e humbën rehatinë që e kishin në Egjipt dhe ranë në gjendje të mjerueshme duke poshtëruar Moisiun dhe Aronin, u thanë atyre: „...*Ab, le të kishim vdekur nga dora e Zotit në vendin e Egjiptit, ku uleshim pranë tenxhereve me mish dhe banim bukë sa ngopeshim! Sepse ju na çuat në këtë shkeretëti që të vdesë nga uria tërë kjo asamble.*“²⁵⁸

Moisiu, duke u afruar drejt Palestinës (qytetit të Kenanit), me urdhërin e Zotit u largua nga fisi i tij dhe shkoi në malin që ishte porositur nga Zoti. Ky mal, në literaturën islame njihet me emrin Tur-i Sina, ku fjala “*tur*” ka kuptimin mali, që do të thotë mali Sina. Ky mal në këtë gadishull të Sinasë, nëse është më i larti apo është ndonjë tjetër, është vështirë të dallohet. Kurse sot me emrin “Mali Sina” është një mal në jug të gadishullit. Njihet edhe me emrin mali Hareb. Moisiu në maje të këtij mali, te i cili shkoi me urdhërin hyjnor, priti 40 ditë me radhë duke agjëruar dhe i bëri lutje të tjera Zotit, mori urdhërat dhe porositë e Tij. Atij në formë të dhjetë urdhërave iu dhanë themelet e besimit dhe sjelljes të cilat duhet t'i realizojë populli. Edhe ato janë:

- 1 - Besimi në ekzistencën dhe njëshmërinë e Zotit,
- 2 - Të mos bëjnë idhuj dhe të mos i adhurojë ata,
- 3 - Të mos e përmendin emrin e Zotit në vend jo të duhur,
- 4 - Të respektojnë shenjtërinë e ditës së Shtunë, të mos punojnë asgjë dhe të pushojnë atë ditë,
- 5 - Të respektojnë nënën dhe babain,
- 6 - Të mos vrasin,
- 7 - Të mos bëjnë zina (tradhti bashkëshortore),
- 8 - Të mos vjedhin,
- 9 - Të mos dëshmojnë rejsëm dhe
- 10 - Të mos lakmojnë shtëpinë, bukën, gruan, shërbyesën, kaun, gomarin, pra, pasurinë dhe

²⁵⁶ Kur'ani, Taha, 63; Junus, 75, 78, 87; Mu'min, 26.

²⁵⁷ Ahmet Çelebi, *Yabudilik*, Stamboll 1978, f.45.

²⁵⁸ *Eksodi*, XVI, 2-3.

shpirtin e askujt.²⁵⁹

Por me zgjatjen e kohës së qëndrimit atje të Moisiut, populli erdhi te Aroni dhe i thanë: “Eja dhe na ndreq neve zotat që do të na udhëzojnë, sepse njeriu na nxorri prej Egjipti dhe Moisiu ende nuk po vjen. Ne nuk e dimë se çfarë i ka ndodhur”. Një njeri me emrin Haron, sipas Dhiatës së Vjetër²⁶⁰, ndërsa sipas Kur’anit Samiri²⁶¹, e tuboi arin e familjeve dhe me të bëri një skulpturë viçi dhe kështu Bijve të Izraelit ua mundësoi që të adhurojnë atë. Sipas Kur’anit, profeti Harun edhe pse dëshiroi që ta pengojë këtë punë, ai nuk mundi ta bëjë. Ua tërhoqi vërejtjen, por nuk e dëgjoi askush. Profeti Musa kur u kthye e kapi vëllain e tij për jake dhe e poshtëroi²⁶², nga hidhërimi që kishte pllakat që i kishte në dorë i përplasi në tokë. Pllakat që u thyen, u shkruan përsëri. Kurse Kur’ani thotë se, Musai prej hidhërimit tabelat i hodhi në tokë, por pasi i kaloi hidhërimi ato i mori përsëri.²⁶³ Ndërsa nuk tregon për rishkrimin e tyre. Kjo situatë qartazi tregon se populli që ka qëndruar një periudhë të gjatë në Egjipt, është ndikuar shumë nga feja egjiptase. Largimi i Musait për një kohë të shkurtër nga mesi i tyre dhe se si ata menjëherë janë kthyer prapa në besimin e vjetër, është një provë e qartë për këtë. Kurse edhe Aroni edhe pse ishte aty, nuk mundi ta pengojë atë. Kjo gjendje është me rëndësi edhe në paraqitjen e fuqisë administrative të Moisiut.

Moisiu e mori popullin dhe u nis drejt Palestinës. Vetëm se, adhurimi i viçit nga populli, u bë shkak i zemërimit të Zotit. Edhe sikur Zoti të pranonte pendimin e tyre, këtë radhë udhëheqësit e popullit e refuzuan dëshirën e Moisiut që të kalojnë në tokën e Palestinës. Ky refuzim bëri që ata 40 vjet radhazi të shëtisin nëpër shkretëtirë të mërzhitur. Gjatë kësaj periudhe Bijve të Izraelit iu shpallën rregulla të tjera të Ligjit. Moisiu vdiq në Nebo në shkretëtirë si endacak në moshën 120 vjeçare. Transmetohet se trupi i tij është varrosur nga Zoti dhe se askush nuk ka mundur ta gjejë varrin e tij.²⁶⁴

Shkurtimisht, Moisiu është një profet themelues i marrëveshjes mes Zotit dhe Bijve të Izraelit. Ai është themelues i jetës së atij populli dhe shpëtimtar i tij nga zgjedha e Egjiptit, është një lider dhe një themelues i Ligjit.

3. Aroni

Kur’ani thotë: “Nga mëshira Jonë i dhamë vëllain e tij Harunin, Pejgamber, e bashkuam me vëllaun e vet, Harunin, që ta ketë si ndihmës”²⁶⁵, dhe lajmëron se ai është ndihmës i Musait (a.s.). Edhe kur Samiriu e ka nxitur popullin që të krijojë skulpturën e viçit, ai u ka kërkuar atyre që viçin të mos e adhurojnë dhe ta ndjekin atë, e jo Samiriun. Por, ai edhe vëllait të tij ia bëri me dije se, nuk e ka ngritur zërin që të mos bëhet shkak për një shpifje më të madhe dhe të mos krijojë ndarje mes popullit.²⁶⁶ Aroni ishte tre vjet më i madh se vëllai i tij. Në librin Numrat, shpjegohet se ai ka vdekur në moshën 123 vjeçare në kodrën Hor, ku edhe është varrosur.²⁶⁷

²⁵⁹ Eksodi, XX, 1-17; Ligji i Përtërirë, V, 6-21.

²⁶⁰ Eksodi, XXXII, 1-6.

²⁶¹ Kur’ani, Taha, 87.

²⁶² Kur’ani, Taha, 88 dhe në vazhdim.

²⁶³ Kur’ani, A’raf, 150-154.

²⁶⁴ Ligji i Përtërirë, 34, 6.

²⁶⁵ Kur’ani, Merjem, 53; Furkan, 35.

²⁶⁶ Kur’ani, Taha, 92-94.

²⁶⁷ Numrat, XX,20-29; XXX, 37-39; Ligji i Përtërirë, XXXII, 50.

4. Hidri (Hëzri)

Hidri në literaturën islame pranohet si bashkëkohës i profetëve Musa dhe Harun. Në Dhiatën e Vjetër nuk përmendet emër i tij. Njohuria për të është folklorike dhe e tipit të legjendave. Të dhëna historike nuk ka. Muslimanët kanë bindjen se Hidri është Njeriu i Urtë²⁶⁸ që takohet me Musain, për të cilën tregon Kur'ani. Vetëm se në Kur'an emri Hidri nuk përmendet. Njeriu i Urtë, i cili takohet me Musain, ka aftësinë e vlerësimit të të kuptuarit ezoterik të gjërave. Vendi ku takohet me Musain është “*Mexhmau'l – Babrej*”, ky është një vend ku bashkohen dy detra.²⁶⁹ Ky vend mund të jetë në bregdet të Sinait tek uji i ëmbël që derdhet në Detin e Kuq ose në Detin Mesdhe, apo mund të jetë edhe një vend ku një lumë i madh derdhet në det.²⁷⁰ Të bërit fjalë për rrezikun e piratëve, që enden nëpër dete, e forcon mundësinë se vendi i takimit është një bregdet i një deti të hapur.

Në shekujt e mëvonshëm kishte të atillë që kishin bindjen se njeriu i mirë i cili ka fituar autoritet me emrin Hidri, nuk është peygamber, por është një rob i dashur i Allahut (xh.sh.).²⁷¹

Ndërsa komentimet se do të jetojë deri në kijamet dhe se është i padukshëm, përkujtojnë mitologjinë e vjetër greke për Hermesin, dhe janë në kundërshtim me ajetin kur'anor: “*Ne asnjë njeriu para teje (Muhamed) nuk i dhamë jetë të përbërshme... Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen...*”²⁷².

5. Jozueu bir i Nunit²⁷³ dhe periudha e njerëzve të urtë

Pas Moisiut, në krye të Bijve të Izraelit erdhi Jozueu. Ai ishte njëri prej shokëve më të afërt të Moisiut. Para se të vdiste Moisiu atë e zgjodhi kryetar të Bijve të Izraelit.²⁷⁴ Pas kalimit të Jozueut në krye të Bijve të Izraelit u nis drejt verilindjes së lumit Jordan. Pastaj duke e kaluar lumin Jordan, filloi përgatitjet për vendosje në tokën e Palestinës. Pas kalimit të lumit, vendi i parë që pushtuan ishte Eriha. Jozueu më parë kishte dërguar dy spiunë dhe këta ishin fshehur në shtëpinë e një prostitute me emrin Rahab. Bijtë e Izraelit pasi e morën Erihanë, mbytën çdo gjë të gjallë që kishte në qytet. Gruaja, që i kishte fshehur këta spiunë, dhe familja e saj, për shkak të fjalës së dhënë, shpëtuan nga ky gjenocid.²⁷⁵ Pas kësaj pasoi çlirimi i qyteteve të tjera dhe rritja e autoritetit të Jozueusë.

Pas vdekjes së Jozueut, bir i Nunit, politika e Moisiut vazhdoi, kurse udhëheqësit e Bijve të Izraelit filluan të zgjidhen nga lidërsipit i popullit. Në disa raste në këtë pozitë mund të vinin edhe gra. Populli jetonte në dymbëdhjetë fise. Administrimi klanor ishte dominant. Personat që ishin në krye të klaneve kishin formuar një kuvend. Një gjykatëse që kishin zgjedhur nga mesi i tyre, i zgjidhte mosmarrëveshjet mes njëri-tjetrit. Për zgjidhjen e çështjeve me rëndësi të gjithë personat drejtues të klaneve tuboheshin nën udhëheqësinë e gjykatësit dhe problemet i zgjidhnin duke u konsultuar. Kjo periudhë ka zgjatur tre shekuj. Populli kishte filluar të kalojë nga gjendja nomade në një jetë të vendosur, nga tentat nëpër fshatra të vegjël kishte filluar të mësojë bujqësinë dhe profesionet e tjera.

Vetëm se, në periudhën e gjykatësve ose në *periudhën e njerëzve të urtë*, përhapja e paudhësisë, si ryshfeti etj., edhe dhuna e shteteve fqinje, për shkak të problemeve që ka nxjerrë lufta, edhe Bijtë e Izraelit filluan të dëshirojnë një sundimtar me autoritet, si në shtetet fqinje, me qëndrime të

²⁶⁸ Kur'ani, Kasas, 7.

²⁶⁹ Kur'ani, Kehf, 60-62.

²⁷⁰ Kur'ani, Kehf, 60-62.

²⁷¹ *Tecrid Tercümesi*, IX, 145.

²⁷² Kur'ani, Enbija, 34-35.

²⁷³ Në literaturën islame përmendet si Jusha ibën Nun. (Shënim i përkth).

²⁷⁴ *Numrat*, XXVIII, 15-20.

²⁷⁵ Libri i Joz., Kapitulli VI.

përgjithshme.

Kur'ani këtë situatë e shpjegon kështu:

“*A nuk ke marrë vesh për parinë e Bijve të Israilit pas Musait? Kur i patën thënë një të dërguarit të tyre (Shem'unit): Cakto për neve një sundues e të luftojmë në rrugën e Allahut...*”²⁷⁶ Për këtë gjykatësi Samuel, Saulin (Talut) e pagëzon mbret dhe udhëheqësinë e shtetit ia lë atij. Në ajetin e lartpërmendur, për shkak që hebrenjtë shprehin fjalën ‘hakim’, kurse për pasuesit e Musait përdornin fjalën “nebij”²⁷⁷, sipas muslimanëve sundimtarët prej Jozueut, bir i Nunit, (Jusha b. Nunit) e deri te Samuel I., llogariten njerëz të urtë, “pejgamberë”. Ata përmenden me ofiqin pejgamber. Edhe pse në Kur'an nuk përmenden qartazi, shkak i përmendjes së disa personaliteteve si “pejgamber” në historinë e pejgamberëve, është ajeti që e përmendëm.

6. Periudha e sundimtarëve

Në periudhën e personaliteteve të urtë përhapja e paudhësisë, si ryshfeti etj., dhe dhuna e shteteve fqinjë, për shkak të problemeve që ka nxjerrë lufta, edhe Bijtë e Izraelit kërkonin një sundimtar me autoritet siç është në shtetet fqinjë, me qëndrime dhe urdhëra kategorike. Kundërshtimet për zgjedhjen e Saulit (Talutit) nga ana e murgut Samuel, u rritën. Ata thanë: “*Si mund të jetë ai sundues yni, kur ne kemi më shumë meritë se ai për sundim, madje ai nuk është i pasur...*”²⁷⁸ Samueli duke thënë: “*Allahu e zgjodhi atë sundues tuajin dhe e pajisi me dituri të gjerë dhe me fuqi trupore...*”²⁷⁹ iu përgjig kundërshtimeve.

Taluti u nis drejt fqinjëve të tij palestinezë, të cilët ishin idhujtarë. Ai me ata që i besonin e kaloi lumin dhe e mundi armikun. Në këtë luftë Davudi, që ishte i ri në moshë, me talentin e tij e mundi Xhalutin/Goliatin.²⁸⁰ Ai tërhoqi vëmendjen me aftësinë e tij luftarake dhe talentin e tij. Pas vdekjes së Saulit, në luftë me fiset fqinjë e mori fronin Davidi/Davudi.²⁸¹

a. Davidi

Davidi nga Bijtë e Izraelit njihet si një sundimtar i madh; edhe pse pranohet virtyti dhe urtësia e tij, profecia e tij nuk pranohet. Për këtë çështje muslimanët dhe hebrenjtë kanë mendime të ndryshme. Me vdekjen e mbretit Saul (Talut), Davidi u bë mbreti i dytë i Bijve të Izraelit. Ai ka qenë autoritet rreth viteve 1006-966 para e.s. Me ushtrinë që formoi, i zgjeroi kufijtë e shtetit nga Egjipti në jug, e deri në Toros në veri dhe Jerusalemin e bëri kryeqytet. Ai këtu e sollë *Tabutu's-sekine*-në (Arkën e qetësisë), në të cilën mbroheshin Dhiata e Vjetër e Moisiut dhe porositë e tjera të shenjta. Ai gjithashtu rregulloi tempullin, i cili më vonë u zgjerua nga djali i tij Solomoni, ku edhe e vendosi tabutin. Filloi periudhën madhështore që Bijtë e Izraelit shekuj me radhë nuk kanë mundur ta harrojnë dhe duke e rrethuar Jerusalemin me mure, ka mundësuar sigurinë e qytetit.

Davidi ishte vëllai më i vogël i një familjeje të varfër nga Betlehemi. Ai ishte një fëmijë me fytyrë të kuqe, flokëverdhe dhe simpatik. Nëna e tij ishte një grua fetare. Si më i vogli i shtëpisë kishte për detyrë kullotjen e kopesë. Ai me talentin e tij ka ditur se si të largojë sulmuesit e kopeve, herën e parë luanin, ndërsa një ditë tjetër ariun. Ky talent i tij e ka shpuar derën e sarajit të mbretit Saul. Kurse më vonë ai arriti të bëhet mbrojtës i armëve të Saulit. Në luftën që zhvillohej me palestinezët, edhe pse ishte në moshë të re, me talentin dhe trimërinë që posedonte e mbyti komandantin dhe luftëtarin e njohur Goliatin/Xhalutin dhe

²⁷⁶ Kur'ani, Bakara, 246.

²⁷⁷ Kur'ani, Bakara, 247-248.

²⁷⁸ Kur'ani, Bakara, 247.

²⁷⁹ Kur'ani, Bakara, 247.

²⁸⁰ Kur'ani, Bakara, 249-251; *Libri 1 Sam.*, XVII, 50-51.

²⁸¹ Për më shumë shih, Dhiata e Vjetër, *Libri 2 Sam.*, I-IV.

Bijve të Izraelit u garanoi fitore.²⁸² U bë dhëndër dhe komandant i Saulit. Mbreti, i frikësuar nga rritja e shpejtë e autoritetit të Davidit në mesin e popullit, donte ta zhdukë atë dhe të shpëtojë prej tij, Davidi iku dhe shpëtoi. Ai e respektonte Saulin edhe pse Sauli mbante sjellje armiqësore ndaj tij. Davidi duke thënë, “*Ndaj njeriut, të cilin Zoti e ka shenjtëruar dhe i ka dhënë sundim, nuk ngritet dorë*”, ata që nuk e respektonin i dënoi.²⁸³

Psallmet (Zeburin) e Dhiatës së Vjetër i përshkruhen atij. Në ceremoni të ndryshme fetare lexohen pjesë prej tyre. Ky libër përbëhet nga 150 psallme. Ai është munduar që popullit t’ia tregojë rrugën e drejtë, dhe u bë shembull i mirë. Aforizma, “*kryeja e urtësisë është frika nga Zoti*”, është një prej verseve të Psallmeve.²⁸⁴ Ai i është nënshtruar Ligjit të Dhiatës së Vjetër. Davidi ishte i njohur edhe për zërin e bukur të tij.²⁸⁵ (Sipas Islamit, Allahu xh.sh. atij ia ka mësuar mjeshtërinë e farkëtarit dhe atë të regullimit të pancirëve).²⁸⁶ Nga ky lajm dhe nga këto të dhëna kuptojmë se në kohën e Davidit, fillon periudha (koha) e hekurit dhe ai ka jetuar në atë kohë. Sepse hekuri është një xehe e sapozbuluar në këta shekuj. Nga bashkëkohësit e tij prej njerëzve me urtësi dhe mision, përmendet edhe Llokmani i Urtë.

Llokmani i Urtë: Për shkak të këshillave dhe njohurive fetare që i jep djalit të tij, është potencuar fakti se ka mundësi që ai të jetë profet.²⁸⁷ Në mesin e popullit veprimtaria mjekësore e tij është bërë e njohur. Ky person, për të cilin nuk ka të dhëna historike transmetohet se ka jetuar në periudhën e profetëve dhe se është parë dhe takuar me Davidin. Fjalët e urta që i atribuohen atij, për shkak se shpesh krahasohen me fjalët e filozofit perëndimor Ezopit (Aesopos), ka të atillë që e identifikojnë me të.²⁸⁸

b. Solomoni

Pas vdekjes së Davidit në vend të tij kalon djali i tij, Solomoni, i lindur nga Betsaba. Ai ishte më i afti nga vëllezërit e tij. Ndërsa Kur’ani duke thënë, “*Ne Davudit i falëm Sulejmanin...*”²⁸⁹ sinjalizon në aftësinë e tij dhe atë e përmend me lëvdatë. Solomoni ka sunduar gjatë viteve 966-926 para e.s. Sipas besimit Islam, Allahu xh.sh. atij, sikurse babait të tij, i ka dhuruar edhe mbretëri edhe profeci. Ndërkaq hebrenjtë, atë e shohin vetëm si mbret. Në këtë çështje hebraizmi ndahet nga islami.²⁹⁰ Sipas Kur’anit. Allahu atij i ka dhënë aftësi që t’i udhëheqë xhinnët dhe t’i kuptojë gjuhët e gjallesave. Për shkak të kësaj aftësie ai është fajësuar si magjistar.²⁹¹ Zbukurimi i sarajit dhe i kopshteve me hauze dhe statuja²⁹², martesat e tij me njërin prej vajzave të Faraonit, kanë qenë shkak që populli konservator dhe kundërshtarët e kanë fajësuar me idhujtari dhe nëpërkëmbje të ligjit. Populli izraelit, humbjen e rajonit Arami dhe Edoniz, e komentoi si dënim nga Zoti.

Në kohën e tij, edhe krahas humbjes së territoreve, tregtia në shtet është forcuar, populli është pasuruar, Jerusalemi është rindërtuar, është stolitur me saraje dhe vila të ndryshme. Ai prishi tempullin e babait dhe në vend të tij ndërtoi tempullin e njohur madhështor dhe të madh me emrin Tempulli i Solomonit.

Për marrëdhëniet e tij me Belkisen, mbretëreshën e Sabasë tregon Kur’ani dhe Dhiata e Vjetër, kurse deri te njohuritë e tjera, përveç shpalljes ende nuk është arritur. Pjesa proverbat e Solomonit e Dhiatës së Vjetër, janë këngë hyjnore të bazuara në të.

²⁸² *Libri 1 Sam.*, XVII, 51; *el-Bakara*, 251.

²⁸³ *Libri 1 Sam.*, XXIV, 6; XXVI, 11.

²⁸⁴ *Psallmet*, 111, 10.

²⁸⁵ Kur’ani, Nisa, 163; Enbija’, 79; Sebe, 10.

²⁸⁶ Kur’ani, Enbija, 80; Sebe’, 11.

²⁸⁷ Kur’ani, Lukman, 12-19.

²⁸⁸ Ateş, *Kur’an-i Kerim ve Yüce Mealî*, f. 411-412; Heller, “*Lokman*”, *İslam Ansiklopedisi*, v.VII, f. 66.

²⁸⁹ Kur’ani, Sad, 30.

²⁹⁰ Kur’ani, Enbija,

²⁹¹ Kur’ani, Bakara, 102; Neml, 14-43; Sebe’, 12.

²⁹² Kur’ani, Sebe’, 13.

7. Ndarja e shtetit

Zgjerimi i kufijve të shtetit në kohën e Davidit, mundësoi që Bijtë e Izraelit të jetojnë bashkë me idhujtarët e rrethit. Pas vdekjes së Solomonit, sipas disa hulumtuesve, në vitin 920 para e.s., kurse sipas disa të tjerëve në vitin 935 para e.s., shteti u nda në jugor dhe verior. Rehobeam njëri prej djemve, shpalli se është mbret i shtetit *Jebuda* në jug. *Jerusalem* e bëri kryeqytet. Fiset jehuda dhe benjamin iu zotuan atij. Vetëm se, edhe pse kishte simpatizues të flaktë, 10 fise nga bijtë e Izraelit në veri atij nuk i zotuan dhe për vete zgjodhën mbret vëllain e Rehobeam-it, Jerobeam-in. Emri i këtij shteti të forumuar në veri ishte *Israel* ndërsa kryeqyteti i tij ishte *Shekemi*.

Ndarja e shtetit në dy pjesë e lëkundti edhe jetën fetare në shoqëri. Mbreti i Veriut, Jerobeam, nga frika se populli do të kthehej drejt tempullit në Jerusalem, bëri dy viça prej ari dhe i vendosi në tempujt e vjetër të idhujtarisë në *Dau* dhe *Bethel*. Popullin e nxiti të adhurojnë idhujt.²⁹³ Deklaroi se këta janë zotat që, Bijtë e Izraelit i kanë nxjerrë nga Egjipti. U mundua që edhe pelegrinazhin ta drejtojë drejt tyre. Dhiatën e Vjetër e hoqi nga përdorimi. Mbretëria monoteiste u bë idhujtare.²⁹⁴

Vendin autoritativ në mbretëri, që ishte e dobësuar nga luftërat e bëra me shtetet fqinje, e mori njëri prej komandantëve me emrin Omri, dhe u bë mbret. Pas mbretërisë së tij (878-852 para e.s.), në vend të Omrit erdhi i biri Ahab. Ahab ishte i martuar me Izabelën, princeshë e Fenikes. Gjate periudhës së sundimit të tij (871-852 para e.s.) me ndikimin edhe të gruas së tij, u mundua që ta bëjë dominant kultin *baal*. Shumë prijës fetarë që e mbronin monoteizmin i vrau, kurse murgjit baalë i shpërbleu. Ngjarjet e shumta të Kur'anit që simbolizojnë shkakun e vrasjes së shumë pejgamberëve, janë zhvilluar në këtë kohë. Me shkatërrimin e mbretërisë në vitin 722 para e.s., nga ana e asurëve, për besimtarët filluan ditët e hidhura të skllavërisë (syrgjynosjes) në Babiloni. Hebrenjtë që kanë jetuar në këto vende janë syrgjynosur në Mesopotami dhe në vend të tyre janë vendosur popujt e sjellur prej tokave asure. Sipas transmetimeve në mesin e këtyre popujve ishte edhe populli i qytetit Kuta. Këta, më vonë e kanë pranuar hebraizmin dhe janë quajtur samiritë.²⁹⁵ Kurse samiritët janë të mendimin se ata janë mbeturinë e Bijve të Izraelit të shpërndarë, që nuk janë syrgjynosur.²⁹⁶

Edhe mbretërit e Jahudës në Jug e kanë braktisur Dhiatën e Vjetër dhe një kohë të shkurtër e kanë pëlqyer idhujtarinë. Disa mbretër janë munduar të zhdukin besimin e Moisiut. Për shembull, Ahazja, i cili bëhet mbret më 841 para e.s., i ka hequr emrat e Zotit nga Dhiata e Vjetër dhe në vend të tyre ka vendosur emrat e idhujve. Edhe mbreti Ahaz (736-716 para e.s.) dhe mbreti Menasseh (687-642) e kanë ndaluar leximin e Dhiatës së Vjetër, kurse kopjet e saj i kanë zhdukur.²⁹⁷

a. Elias

Ai, në një kohë kur politeizmi nxitej, u mundua që të mbrojë fenë dhe popullin e tij nga idhulli Baal dhe mbreti Ahab (874-853 para e.s.).²⁹⁸ Me shprehjen kuranore "*A e adhuroni Baalën (emër i një statuje) e braktisni adhurimin ndaj më të mirit që është Krijues?*"²⁹⁹, sqarohet mëkati në të cilin kishin rënë ata. Në të shumtën e rasteve Iljazi/Elias fshihej nga e keqja dhe vrasja nga ana e mbretit. Ai fshehurazi i kumtonte popullit dhe i paraqiste mu'xhizet.³⁰⁰

Luftën e tij e vazhdoi edhe pasi Ahasjanë dhe Joramin pasi bëhen mbretër në vend të mbretit

²⁹³ Libri 1 i Mbr., XII, 28-31; XIV, 23-24.

²⁹⁴ Adam, *Yahudi Kaynaklarına Göre Dhiata e Vjetër*, Ankara 1997, f. 82.

²⁹⁵ Vep. e cit., f. 83.

²⁹⁶ Vep. e cit., f. 99.

²⁹⁷ Vep. e cit., f. 83 dhe në vazhdim.

²⁹⁸ Për më gjerë shih, *Libri 1 i Mbr.*, XVII-XVIII.

²⁹⁹ Kur'ani, Saffat, 125.

³⁰⁰ *Libri 1 i Mbr.*, XVII, 27-46.

Ahab, kur ai vdiq dhe propozoi që të mos adhurohet Baali.³⁰¹ Një ditë kur mësoi se Ahasja misionarin e tij e ka dërguar për tempullin Baal-Sebub në Ekron, për të marrë njohuri magjike për gjendjen e tij, u nis për rrugën e misionarit dhe i tha: “...Pse nuk paska në Izrael asnjë Perëndi, me fjalën e të cilit të mund të kështillosh, që ti dërgove lajmëtarë te Baal-Zebubi, perëndi e Ekronit?...”³⁰², dhe e bindi që të kthehet prapa. Me një urdhër hyjnor, shkoi te mbreti dhe për të njëjtën gjë e pyeti edhe atë. Pas kësaj mbreti e pyeti për të ardhmen dhe Elias i tha: “...Për këtë arsye ti nuk do të zhbresësh nga shtrati në të cilin ke hipur, por ke për të vdekur me siguri”.³⁰³ Ende pa përfunduar fjala e Eliasit mbreti vdiq, kurse njerëzit rreth e qark tij, të habitur u bënë dëshmitarë të kësaj mrekullie.

Dhiata e Vjetër pohon se, në fund të jetës së Eliasit, zbriti nga qielli një qerre e zjarrtë e mori atë dhe e çoi në qiell.³⁰⁴ Për shkak të thënieve të tjera të ngjajshme për Idrisin (a.s.), disa komentatorë të Kur’anit thonë se ata do të kthehen përsëri në tokë nga fundi i jetës së kësaj bote.

b. Elisa

Elisa/Eljesa ishte në mesin e të rinjve që vëzhgonin mrekullitë e Elias në kodrën Karmel. Pasi u takua me të, nuk u nda më prej tij.³⁰⁵ Pas vdekjes së Elias e mori këtë detyrë dhe nxënësit e tjerë iu zotuan atij.³⁰⁶ Bashkë me nxënësit e tij u kthye nga Jordani në Jeriha, Bethel dhe prej andej në kodrën Karmel në Samara.³⁰⁷ Udhëtoi në shoqëritë përreth dhe nëpër Siri. Duke treguar mrekulli njerëzit i thirrte në besim në njëshmërinë e Zotit. Ai paraqiti disa mrekulli, si shërimi i të sëmurëve në emrin e Zotit, nxjerrja e ujit nga bunari i thatë etj. Ai përkundër baalit mbronte ekzistencën dhe njëshmërinë e Zotit dhe e vazhdoi këtë kumtim. Ai Jehunë (845-817 para e.s.), njërin nga komandantët, e pagëzoi mbret dhe u mundua që t’i zhdukë simpatizuesit e baalit. Ai vdiq në kohën e mbretit Joas.³⁰⁸ Në Kur’an emri i tij përmendet në mesin e pejgamberëve të respektuar.³⁰⁹

c. Ishaja

Ishaja ka jetuar në Jerusalem, në kohën e mbretërisë Jahuda, në shek. VIII para e.s.. Është bashkëkohës i mbretërve të Jahudas, si Uzzija, Jotam dhe Hizkija. Gjithmonë ishte në anën e jetimëve dhe varfanjakëve. Në vitin 742 p.e.s., nëpërmjet një ëndrrë që e pa në Tempull, u thirr në detyrën e profecisë.³¹⁰ Emri i tij në Kur’an nuk përmendet, por nga Dhiata e Vjetër kuptohet se është njëri prej mbrojtësve të monoteizmit. Ai, krahas adhurimeve që bënte, më tepër rëndësi i jepte pastrimit të zemrës dhe punëve të mira dhe shërbimit popullit. Ai porosiste që të përqafohen vlerat etike. Sulmet dhe sukseset e asurëve i komentonte si dënime të Perëndisë ndaj Bijve të Izraelit. Hebrenjve ua tërhiqte vërejtjen, që të mos përzihen me idhujtarët dhe i porosiste që ta përqafojnë njëshmërinë e Zotit.³¹¹

³⁰¹ *Libri 2 i Mbr.*, I, 1-18.

³⁰² *Libri 1 i Mbr.*, I, 16.

³⁰³ *Libri 2 i Mbr.*, I, 16.

³⁰⁴ *Libri 2 i Mbr.*, II, 11.

³⁰⁵ *Libri 1 i Mbr.*, XIX, 21.

³⁰⁶ *Libri 2 i Mbr.*, 15 dhe në vazhdim.

³⁰⁷ *Libri 1 i Mbr.*, II, 19-25.

³⁰⁸ *Libri 2 i Mbr.*, XIII, 20.

³⁰⁹ Kur’ani, Enbija, 86 dhe Sad, 48-49; Për njohuri më të gjërë shih: *Libri 1 i Mbr.*, XIX, 16-19; *Libri 2 i Mbr.*, I, 18.

³¹⁰ Dhiata e Vjetër, *Isaia*, VI, 8.

³¹¹ Shih, *Isaia*.

ç. Jeremja

Ky llogaritet si shkruar i librit Jeremja në Dhiatën e Vjetër. Misioni i profecisë i ka filluar në vitin 13 të sundimit të mbretit Joshija, gjegjësisht në vitin 627-626 para e.s., në Jehuda, shtetin jugor. Kritikonte adhurimin e idhujve dhe padrejtësinë shoqërore, ndërkaq popullit i bënte thirrje për pendim. Burimin e mëkateve e kërkonte në zemrën e njeriut dhe në dobësinë e vullnetit. Thuhet se ka vdekur nga gurrëzimi i popullit të tij në Egjipt. Është njëri nga profetëve hebraikë, emri i të cilit nuk përmendet në Kur'an.

d. Dhu'l-Kifli

Dhel-i i fjalës *dhul'kifl*, që përmendet në Kur'an (Enbija, 85 dhe Sad, 48), sipas komentatorëve, është kuptuar si emër, por për shkak të provave jobindëse, ai është identifikuar me njerëzit si Shrefi (Bishër) i biri i Ejubit, me pejgamberë të ndryshëm si me djalin e xhaxhait të Eljesasë/Elisa apo Iljasin/Elias, Zekerijan, Hezekielin. Kjo fjalë është komentuar edhe si një cilësi e njeriut nga këta. Kurse muslimanët e Lindjes së Lartë janë munduar ta identifikojnë me Budën.

Disa komentatorë bashkëkohorë, thonë se shprehja *dhul'kifl* nuk është emër i përveçëm (rrjedh nga një send, ose person), por kanë bindjen se rrjedh prej rrënjës së fjalës *keffele*, *u bë përgjegjës*, *e premtoi veten*, gjegjësisht rrjedh prej foljes *tekeffele*, që do të thotë: *u bë dorëzuanë* (për diçka), *e mori mbi vete*, prej nga rrjedh shprehja "*ai që e premtonte vetveten*".³¹²

8. Periudha e syrgjynosjes

Ndarja e Bijve të Izraelit, u bë shkak i shumë tronditjeve në fushën sociale dhe fetare, si padrejtësia sociale, dëfrimi i tepërt të popullit dhe tolerimi i idhujtarisë nga ana e mbretërve. U shtua shturja e moralit. Në vitin 721 para e.s. shteti izraelit u shkatërrua nga ana e Sargonit II., mbretit asurian, që mbretin e fundit të Izraelit, Hosea, bir i Elias, bashkë me familjen e tij i dërgoi në Mesopotami. Atje emëroi një prefekt që do të udhëhiqte në emër të tij. Ndërsa, në vitin 608 para e.s., me ushtrinë e Faraonit u nis drejt Jahudas dhe e okupoi. Më vonë pushtoi edhe tokat izraelite, që ishin nën sundimin asurian. Vetëm se, mbreti i Babilonisë Buhtunnasir, nuk e pranoi këtë qëndrim të Faraonit, ai tha se këto toka ai i ka marrë prej asurëve dhe për të rikthyer tokat e Palestinës u nis drejt Izraelit dhe e mori atë përsëri. Në këtë kohë ai u nis edhe drejt tokës së Jehudas, Jerusalemin e plaçkiti, e dogji dhe e shkatërroi. Kështu që pas një shekulli e gjysëm (586 para e.s.) shteti Jehuda u shkatërrua nga ana e babilonasve. Buhtunnasir (Nabukadnezari II.), i cili shtetin e bëri rrafsh me tokën, Bijtë e Izraelit i syrgjynosi në Babiloni. Sipas transmetimeve të përgjithshme, në Palestinë nuk mbeti asnjë hebre, kurse sipas disa studiuesve të tjerë, janë syrgjynosur vetëm klasa sunduese, ndërsa bujqit dhe zejtarët janë lejuar që të jetojnë në vendin e tyre.³¹³

Shohim se, që të mos humbasë feja dhe populli gjatë kësaj periudhe syrgjynosjeje, u paraqitën profetë dhe lajmëtarë. Më kryesoret nga mësimet e tyre janë vërejtjet e njohura të profetëve, si Jona/Junusi dhe Danieli. Këta e vazhduan misonin dhe propagandimin për t'u mbrojtur nga besimet e gabuara që ndikojnë në fe nga elementët e huaj.

³¹² Esad, *Kur'an Mesaj*, f. 256.

³¹³ Çelebi, vep. e cit., f. 68.

9. Kthimi në Palestinë

Kjo periudhë vazhdoi deri në kohën e okupimit të Babilonisë nga ana e mbretit persian Kurusit (Husrevit), në vitin 538 para e.s.. Kështu ai u bë sundimtar edhe i tokave të Jahudas dhe Izraelit të mëparshëm. Hebrejtë i la të lirë dhe u dha leje që të kthehen në shtetin e tyre të mëparshëm. Kështu që nën sundimin e Kurusit, në Palestinë filloi periudha e lirisë. Vetëm se një pjesë e hebrenjve i ishin përshtatur jetës në Mesopotami, atje ishin shtuar gjeneratat e reja të tyre dhe i kishin mësuar punët me profit. Për këtë nuk deshën të kthehen në Jerusalem. Pjesa më e madhe vendosën të qëndrojnë në Mesopotami dhe në Egjipt, kurse ata që ndjenin mall për vendlindjen e tyre, u kthyen nën udhëheqjen e Sarubabelit, që ishte nga fisi i Davidit. Pas kësaj, në Egjipt dhe Babiloni vazhduan të jetojnë edhe disa koloni hebraike. Këtyre komuniteteve të tubuara përreth sinagogave larg Palestinës iu dha emri “Diaspora”. Edhe në adhurim edhe në shariat pjesërisht ishin larguar nga rajoni Jahuda. Vetën e tyre ia kishin përshtatur ndikimin babilonas. Vendlindjen e ceremonisë së sakrificës e kishin zënë Dhiata e Vjetër dhe lutja. Mendohet se krahas ekzistencave shpirtërore, si engjujt, djajtë, edhe koncepti për eskatologjinë, ndikim të madh kishte edhe adhurimi i zjarrit (zaratuizmi).

Ata që u kthyen në Palestinë, me ndihmën e Kurusit, i ndërjuan përsëri tempujt. Vetëm se me kthimin e tyre nuk u rikthyen edhe shtetet e vjetëra. Në aspektin politik vazhduan të jetojnë nën sundimin persian.

Restauruesit e fesë dhe kultit ishin lideri fetar dhe kryemurgu Ezra dhe prefekti Nehemia. Këta u munduan që me forcë të madhe, përsëri t'i praktikojnë rregullat e pastërtisë, të periudhës së hershme. Hebrejtë, që ishin të martuar me të huaj, për shkak të përzierjes së “gjeneratave të shenjta” me idhujtarët, ishin të detyruar që t'i braktisnin gratë dhe fëmijët e tyre. Gjithashtu edhe *dita Sabbath* (e Shtunë), dita e pushimit, ashtu praktikohesh, sa që atë ditë, dera e Jerusalem, duke filluar që nga mbrëmja e ditës së premtë e deri në fund të ditës së shtunë, mbetej e mbyllur dhe pengohesh çdo aktivitet tregtar.

Aleksandri i Madh, në vitin 330 para e.s., u nis drejt Palestinës dhe administrata e rajonit kaloi në duart e tij. Pas tij pasoi administrimi i Ptolemeve. Hebrejtë nën administrimin persik dhe grek ishin gjysëm të pavarur. Në fund hebrejtë, që nuk mundën më t'i qëndrojnë dhunës ekstreme të sundimitarit të selojkiajve, Autokjasit 4, në vitin 169 para e.s. u ngritën në kryengritje dhe nën udhëheqjen e Judas Makkabit arritën pavarësinë. Në krye të këtyre shteteve, të quajtura *Makkabitët* ose *Hasmonitët*, në vitin 37 para e.s., me ndihmën e romakëve, u vendos Herodes. Ai, tempullin e mëparshëm e rindërtoi në një mënyrë madhështore. Kurse pasuesit e tij, që shtetin nuk mundën ta mbrojnë nga sundimi romak, vazhduan të jetojnë të varur nga Roma.

Në këtë periudhë për punët e komunitetit hebraik përkujdesej kuvendi i lartë hebraik, që ishte themeluar në shek. III para e.s. dhe kishte emrin Sanhedrin. Ky kuvend, i përbërë prej 70-71 personave, deri në shkatërrimin e Tempullit në vitin 63 para e.s.-70 të e.s., mbledhej në Tempull. Më vonë, deri në shek. V, vazhduan të mbledhen në qytete të ndryshme të Palestinës.³¹⁴

10. Ezra

Ezra ka jetuar në shekullin IV- V para e.s. Ai ka punuar që, shoqërisë hebraike të kthyer nga syrgjynosja në Babiloni, t'i mësojë fenë dhe hebrenjtë e shpërndarë t'i bashkojë në një komunitet. Për shkak të suksesit, në popull ka fituar autoritet, sa që është llogaritur Moisiu II. Njohuritë për të bazohen në *Librin Ezra* dhe *Nehamja* të Dhiatës së Vjetër. Studiuesit e sotëm janë të mendimit se Ezra në Jerusalem është kthyer në vitin 397 para e.s. Pas shpërnguljes, në mesin e hebrenjve kishte një shturrje të përgjithshme të moralit. Për të mbrojtur shoqërinë e kishin ndaluar martesën me të huajt dhe idhujtarët. Ai ishte në pozitën e përfaqësuesit zyrtar të shtetit persian. Shërbimi më i madh i tij ishte përmbledhja e teksteve të shenjta të Dhiatës së Vjetër. Nga shprehjet simbolike të Kur'anit (Tevbe, 30),

³¹⁴ David Goodblatt, “Sanhedrin”, The Encyclopedia of Religion, New York 1987, v. XIII, f. 61.

kuptojmë se, Ezra/Uzejri, për shkak të shërbimit të madh të tij, është dashuruar dhe është vlerësuar aq shumë sa që është quajtur edhe hyjni.³¹⁵ Edhe pse, edhe sot Ezra lartësohet për shërbimin e tij që ka bërë, por nuk dihet për asnjë komunitet hebraik që e hyjnizon atë.

11. Prej Bijve të Izraelit deri në hebraizëm

Periudha e aftësisë krijuese të historisë fetare të Bijve të Izraelit, mori fund me syrgjynosjen në Babiloni. Periudha pas syrgjynosjes është periudha e imitimit. Vendin e profetëve mundohet ta mbushë rregulli i murgërisë. Pra, roli aktiv ishte i tyre. Edhe kryetarë të komuniteteve ishin murgjit e parësisë. Shekuj me radhë komuniteti është mbajtur larg politikës. Populli vetveten e tregon për herë të parë në periudhën e makkabejve. Thelbin e punës dhe mendimit të murgjve e përbën jeta shpirtërore e komunitetit, gjegjësisht, shpjegimi i ligjeve të Dhiatës së Vjetër. Termi “Dhiata e Vjetër” në fillim përmbante përgjigje, decizione të shkurtëra pyetjeve të murgjve për pastërtinë.³¹⁶ Kjo llogaritej dëshirë e Jahves në kohën e Moisiut, shprehje e shkurtër ditore e shpalljes. Për së pari herë, pas *periudhës së syrgjynosjes*, ky Ligj i Dhiatës së Vjetër, në vend që për komunitetin të jetë lehtësim, filloi të bëhet barrë. Rruga e njeriut fetar konceptohej si një rrugë e ngushtë, dy anët e të cilës Zoti i ka thurrur me gardh. Detyra fetare ishte të ecurit në këtë rrugë të ngushtë dhe mosdalja nga ky gardh i ligjit. E tërë jeta ishte e kufizuar me ligje fetare. Çdo pore e jetës, pa asnjëfarë të mete, ishte mbështjellur me ligje fetare. Jeta ishte përshtatje analogjise, decizionit dhe ligjit të komentuar dhe të vlerësuar nga juristët.³¹⁷ Mosrespektimi i ligjit mallkohej, kurse, realizmi i tij, garantonte mëshirën. Fjalët mëshirë dhe mallkim janë përhapur shumë. Padyshim se në periudhën e Moisiut ka ekzistuar mendimi për kundërvlerën e veprave, vetëm se, këto nuk janë gjykime ligjore ku janë numëruar të gjitha sjelljet. Kurse tani, analogjia dhe vendimet e dijetarëve janë bërë dogmë. Zhvillimet historike për çdo sjellje paraqesin skemën *mëkat-dënim-pëndim-shpëtim*. Tanimë ekuivalenca mes tyre ishte njëra prej burimeve të besimit. Zoti ishte i detyruar që fetarin ta shpërblejë, kurse mëkatarin ta dënojë.³¹⁸

Njëri prej termave me rëndësi pas Syrgjynosjes është vetëdija për *Komunitetin e Jahvesë (Jehovait)*. Vetë vetëdija për Jahvenë (Zotin), me kalimin e kohës u braktis. Në vend të emrit të tij, popullaritet fitoi përdorimi i fjalës “Zot”. Nuk kishte trimëri që emri Jahve të përdoret si “emri më i madh”. Në vend të ndërhyrjes së tij drejtpërsëdrejti në ngjarjet, peshë fitoi koncepti i fuqisë, mjet i krijuar nga Ai për t’i realizuar urdhërat e Tij. Sidomos në sarajin e qeverisjes qiellore të Zotit gjendeshin engjujt të cilët me veprimet pozitive ishin të gatshme për t’i realizuar urdhërat e tij, kurse punët negative, të padëshiruara, ia lanë djallit. S’ka dyshim se besimi për djallin ekzistonte edhe më herët, vetëm se atëherë ky ndikim i tij vazhdonte si “shpirt” larg ndikimit material, kurse tash ka marrë për obligim krijimin e të keqës dhe të qenët rival i Zotit. Vetëm se, ky koncept nuk shkoi aq larg sa të lëndojë besimin monoteist.³¹⁹

Gjithashtu njëra prej termave që ka fituar peshë pas syrgjynosjes, është termi “*urtësi?*” që ka kuptim të pranosh dhe të njohësh qëllimin mes ngjarjeve. Termi “urtësi” u vendos brenda në teologji dhe u personifikua. Në disa raste u identifikua me Biblën, kurse në disa raste me fjalën krijim të Zotit. Ndërkaq në disa raste, në situata të paqarta dhe të dyshimta u bë qëllim i panjohur dhe i padukshëm. Liderët e komunitetit ngjarjet historike i vlerësonin si veprime përplot me shenjtëri dhe udhëzim të Zotit, kurse të tjerët i llogaritën si fusha të rëndësishme veprimi të Zotit. Ato u vlerësuan, në disa raste si qëllime botërore, kurse në disa raste si qëllime eskatologjike.³²⁰

³¹⁵ Ndërkaq Kur’ani me shprehjen (Tevbe, 31), “*Ehli Kitabët rabinët dhe priftërinjtë i kanë marrë për zotat*”, tregon për stërzmadhimin e tepërt që ju është bërë disa dijetarëve nga ana e tyre.

³¹⁶ Heiler, f. 589.

³¹⁷ Heiler, f. 589.

³¹⁸ Heiler, f. 590.

³¹⁹ Heiler, f. 592.

³²⁰ Heiler, f. 593.

12. Mesjeta dhe koha e re

Pas kryengritjes së pasukseshme, në vitin 135 të e.s. të Bar Kohbasë, i cili e shpalli veten Mesia, në Perandorinë Romake filloi përndjekja e hebrenjve dhe kjo situatë vazhdoi në këtë rajon deri në vitin 636 të e.s., kur në këto vende erdhën muslimanët. Muslimanët ata i llogaritnin si *ehl-i kitab* (ithtarë të librit) dhe besonin se Muhamedi (a.s.) është plotësuesi i fesë dhe hallka e fundit e zinxhirit të pejgamberëve të dalur edhe nga mesi i tyre (hebrenjve). Edhe pse gjendja e hebrenjve, gjatë kryqëzatave u keqësua, por, kjo situatë, pasi humbën kryqëzatat, nuk zgjati shumë.

Kurse në Mesjetë, fati i hebrenjve në Europë, në bazë të shteteve dhe udhëheqjeve, ishte i ndryshëm. Periudhën më madhështore të tyre e kanë përjetuar në Andaluzi në kohën e dinastisë emevite. Atje u përgatitën mjekë të mëdhenj, matematicientë dhe filozofë si Majmonidesi (Musa b. Mejmun, 1136–1204). Por me përfundimin e qeverisjes muslimane edhe madhështia e hebrenjve mori fund. Ata atje janë ballafaquar me presionin e krishterimit (katolicizmit), me dhunën dhe me përndjekjen e tyre. Jetën e tyre, një pjesë e ka shpëtuar duke u shpërngulur, ndërkaq një pjesë tjetër duke pranuar krishterimin (siç është rasti me maronitët). Për së pari herë në Gjermani hebrenjtë kanë hyrë në vitin 321 të e.s., me lejen e mbretit Konstantin. Vetëm se, gjatë luftërave të kryqëzatave dhe më vonë gjendja e tyre ishte keqësuar shumë. Atje ata iu nënshtruan përndjekjeve të dhimbshme dhe, gjithashtu për ta u nxorën edhe ligje speciale me pretekst se e kanë vjedhur bukën e kungimit, që llogaritet trupi i Jezusit në Kishë, se i kanë helmuar çezmat dhe se me qëllim adhurimi i kanë mbytur fëmijët e krishterë. Për këtë arsye, shumë familje hebraike që jetonin në Gjermani, u detyruan që të shpërngulen në shtetet e Europës Lindore, si në Poloni.

Një pjesë e madhe e hebrenjve gjenden në Rusi, ku shumica janë nga populli vendës i Rusisë. Nga këta llogariten turqit *Hazarë*, të cilët në vitin 740 e pranuan dhe e mbrojtën hebraizmin. Këtyre mund t'iu shtohen edhe hebrenjtë gjeorgjianë dhe malësorë të Kaukazit.³²¹

Ndërsa hebrenjtë e Indisë, sipas grupeve të ndryshme emigruese, ndahen në tre pjesë:

1. *Hebrenjtë e zi*. E kanë marrë këtë emër për shkak se janë përzier me indianët. Mendohet se kanë ardhur nga Mesopotamia në shek. I. të e.s.
2. *Hebrenjtë e bardhë*. Pas shkatërrimit të tempullit të dytë nga Titusi, kanë ikur në Indi. Vetëm se për këtë çështje të dyja grupet nuk posedojnë prova bindëse. Lajmet për ta i përbëjnë transmetimet e ndryshme. Me ndikimin e sistemit indian të kastave, edhe pse më herët dy fqinjë kanë qenë bashkë, ata tani njëri me tjetrin as në një sofër nuk ulen dhe as që martohen në mes tyre.
3. *Bijtë e Izraelit*. Këta jetojnë në Bombej. Transmetohet se në vitin 1500 kanë ardhur nga Jemeni ose Irani.

Sinagogat hebraike në Kajfung-Fu të Kinës kanë ekzistuar që në shek. XII. Mendohet të jenë emigrantë nga Irani ose India.

Ndërkaq në Amerikë kanë ardhur qysh me Kolombin. Sipas urdhërit të datës 2 gusht 1492 të mbretit spanjoll ata ishin të detyruar që ta lëshojnë shtetin. Kurse në të njëjtin vit më 3 gusht është nisur edhe Kolombi. Por në periudhat e mëvonshme në Amerikën spanjolle dhe portugeze, historikisht dihet se që nga viti 1650 kanë jetuar hebrenjë.

13. Themelet e besimit në hebraizëm

Në hebraizëm nuk ka rregulla të formuara besimi. Megjithatë, disa parime të besimit janë caktuar. Por në shesh nuk ka dalur një sistem i formuar. Nuk kanë një fron, një autoritet që do ta thotë fjalën e fundit në çështjet e besimit. Besimi hebraik më tepër është i dukshëm në adhurimet ditore dhe në jetë. Me rëndësi është që të punohet në praktikimin e ligjit që bëhet i ditur në Dhiatën e Vjetër.

³²¹ Për më gjerë shih, Ü. Günay, H. Güngör, *Baslangıçtan Günümüze Türklerin Dini Tarihi*, Kajseri 1997.

a. Besimi në Zotin

Burimi kryesor i besimit në hebraizëm, është besimi në njëshmërinë dhe në ekzistencën e Zotit. Ky besim është, në njërin anë kundër politeizmit në idhujtari, dhe në anën tjetër kundër besimit të trinitetit në krishterim. Zoti, të cilit i besohet, nuk shihet dhe nuk mund të përshkruhet me vizatime dhe statuja. Inkarnacioni (rimishërimi) i Zotit në njeriun, sikur në krishterim, nuk është i pranuar. Zoti veten e tregon vetëm me krijimtari dhe me fjalët që i ka shpallur nëpërmjet profetëve. Në mesin e Zotit dhe njerëzve, nuk mund të paramendohet ndonjë mjet tjetër, përveç profetëve.

Hebrenjtë besojnë se, janë një popull i zgjedhur nga Zoti dhe se te Ai janë më të lartë, e më të ngritur se njerëzit e tjerë. Kjo lidhje në mes Zotit dhe Bijve të Izraelit, bazohet në marrëveshjen e bërë me Abrahamin (*Zanafilla*, 17:9 dhe në vazhdim). Po ashtu kjo marrëveshje është vërtetuar edhe nga Moisiu në Sina. Kjo do të vazhdojë deri sa të jetë bota. Shenja e saj (marrëveshjes) është synetimi i fëmijëve të sapolindur. Nëpërmjet kësaj fëmija bëhet trashëgimtar i premtimit hyjnor. Kjo marrëveshje nuk prishet asnjëherë, nëse populli hebre që ka bërë mëkat pendohet, përsëri lidhet me marrëveshjen. Vetëm se, për shkak të këtyre mëkateve, Zoti ata mund t'i dënojë. Syrgjynosja në Babiloni, prishja e Dytë e Tempullit nga romakët (70 të e.s.) dhe shpërndarja nëpër botë, të gjitha këto janë komentuar si rezultat i dënimit hyjnor.

Filozofi hebraik, Majmonides (1135-1204) burimet e besimit të hebraizmit, duke ia përngjarë *amentu*-së në islam, kah viti 1180, i ka formuluar në 13 pika kryesore:

“Me gjithë zemër besoj se:

- 1. Zoti krijoi çdo gjë që ekziston dhe Ai vetë sundon.*
- 2. Zoti është një dhe nuk ka zot tjetër përveç Tij.*
- 3. Zoti është Krijuesi i parë dhe i fundit.*
- 4. Zoti është i vetëm që meriton adhurim dhe nuk ka tjetër që meriton adhurim.*
- 5. Fjalët e të gjithë profetëve janë të vërteta.*
- 6. Mësuesi ynë, Moisiu, është më i madhi nga të gjithë profetët.*
- 7. Dhiata e Vjetër, që e kemi në dorë, i ka zbritur Moisiut nga Zoti.*
- 8. Dhiata e Vjetër nuk është ndryshuar dhe nuk është dërguar veç se nga Krijuesi.*
- 9. Atë që punon dhe mendon njeriu e di Zoti.*
- 10. Ata që i pranojnë urdhërat e Zotit shpërblehen, ata që nuk i pranojnë urdhërat e Tij dënohen.*
- 11. Zoti do ta dërgojë Mehobin dhe, edhe nëse do të vonohet, unë këmbëngul në pritje çdo ditë ardhjen e tij.*
- 12. Të vdekurit do të ringjallen, në një kohë kur do të dojë Zoti.*
- 13. Zoti nuk ka trup dhe nuk mund të përshkruhet në asnjë mënyrë, çdo falenderim dhe lutje i takon vetëm Zotit”.*³²²

b. Besimi në botën e ardhshme

Sipas burimeve që i posedojmë, nuk kanë arritur dituri deri tek ne se në kohët e hershme ka egzistuar besimi në botën tjetër. Për këtë ka të atillë që pretendojnë se në hebraizmin e vjetër nuk ka patur besim në botën tjetër. Për shpërblimin e të mirës dhe të keqes, mospërmendja e botë tjetër në librin e shenjtë, ka hapur rrugë për shumë dyshime. Vetëm se, jepeshin përgjigje se, si kundërvlerë të veprave do të shpërblehet gjenerata e ardhshme. Kurse të vdekurit, jetojnë në një botë nëntokësore - brenda kësaj bote, të quajtur “sheol”. Edhe në Dhiatën e Vjetër nuk ka ndonjë provë të qartë për amshueshmërinë dhe botën tjetër. Vetëm se, ekziston bindja se, pas syrgjynosjes në Babiloni, me ndikimin e Iranit, në mesin e hebrenjve del në shesh besimi i ringjalljes. Është filluar të diskutohet për shpërblim të përhershëm për të mirët dhe dënim të përhershëm për të këqinjët. Ndërkaq, një fraksion i vjetër hebraik, *saddukitët*, këtë besim, për shkak se nuk kanë mundur ta gjejnë në Dhiatën e Vjetër, nuk e pranojnë. Kurse simpatizuesit e veprës mistike të njohur me emrin Kabbala, besojnë në metempsikozë. Ndërsa fraksionet si *essenitët*, që janë shfaqur në shekujt e erës sonë, besojnë në ferr dhe parajsë. Në shekujt e mëvonshëm shihet se të gjithë hebrenjtë e kanë përvetësuar këtë besim.

³²² *Ibrani Din Bilgisi*, Türkiye Hahambaşlığı, Stamboll 1992, f. 20-21; Schoeps, *Religionen*, f. 243.

Kur'ani tregon se Musait, njohuritë për besimin në ahiret, i janë dhënë nga Zoti (Taha, 15). Në aspektin historik, për Bijtë e Izraelit, edhe besimi i egjiptasve të vjetër për ahiretin, nuk ishte i panjohur. Duke shkuar prapa deri në shek. VI para e.s., se sa e vërtetë është lidhshmëria e kësaj me syrgjynosjen në Babiloni dhe ndikimin e idhujtarisë, është e hapur për diskutim. Për konceptin e botës tjetër kishin njohuri edhe më herët. Islami e kritikon besimin e tyre se, me mendimin se janë njerëz të zgjedhur nga ana e Zotit, ata, dënimin për mëkatet që i kanë bërë do ta përjetojnë vetëm një kohë të shkurtër.³²³

c. Besimi në engjëjt

Në hebraizëm besohet se, engjëjt janë krijesa shpirtërore, të krijuara nga Zoti dhe gjenden nën urdhërin e Tij. Ata ndahen në shkallë të ndryshme, më kryesorët janë: Mikaili, Xhebraili, Urijeli, dhe Rafaeli (Israfil). Rojet e xhennetit janë kerabinët. Presin te xhenneti me shpata prej zjarri. Edhe serafinët janë nga engjëjt e mëdhenj. Kurse aktiviteti i engjëjve është i ndryshëm. Një pjesë e tyre, gjenden nën fronin e Zotit dhe i shërbejnë Atij. Engjëjve kryesorë u janë dhënë obligime të ndryshme në lidhje me fuqitë natyrore. Për shembull, Mikaili është i obliguar të mbrojë hebrenjtë dhe përkujdeset për qiellin. Xhebraili është bartësi i shpalljes dhe mbrojtësi i zjarrit. Urijel, është kryetari i ajrit dhe i yjeve. Edhe Rafael është një engjëll me mrekulli. Engjëjt konceptohen në formë të njeriut me krahë. Ka mundësi që ky mendim i hebrenjëve të kishte kaluar nga grekët. Sepse sipas besimeve të vjetra, engjujt për të zbritur nga qielli në tokë përdorin shkallë.

Engjujt, Zotin e respektojnë absolutisht. Për shembull, një engjëll për të kryer urdhërin e Jehovasë, me murtajë ka zhdukur 70.000 njerëz.³²⁴ Në një shtab të asurianëve një engjëll për një natë ka vrarë 185.000 njerëz.³²⁵ Nëse ndonjë vdes, atij *engjëlli i vdekjes* i ka rënë me shpatë. Për atë, të gjitha ujërat që gjenden në shtëpi, duhet të zbrazen. Sepse engjëlli i vdekjes, shpatën e përlyer e lanë në këta ujëra. Në kohët e mëvonshme me ndikimin e dualizmit engjëlli i vdekjes, ka filluar të mendohet si trajtë e veçantë e djallit. Djalli, pranohet si kryetar i engjëjve të këqinj të panumërt. Sipas kabbalasë, djalli është pronari mbrojtës i Romës. Në kohët më të vjetëra besohet se edhe e mira dhe e keqja bëhen nga Zoti, kurse, në periudhat e mëvonshme është shkruar se të gjitha të këqijat bëhen nga fuqitë e djallit. Në tregimin e Davidit për regjistrimin e popullatës, Zoti i hidhëruar duke e nxitur Davidin që të bëjë regjistrimin e popullatës, që është mëkat të bëhet, i ka thënë: “*Shko dhe numëro Jabudën dhe Izraelin*”³²⁶

Edhe xhinnët pranohen si engjuj që janë ballafaquar me zemërimin e Zotit. Atyre kundër fuqive natyrore mund t’iu ndihmojnë vetëm magjia dhe nuskat (amuletë). Sipas kabbalasë, edhe shpirtërat e vdekur, sikur xhinnët, shkojnë te të gjallët, mund t’i kapin dhe t’i çmendin ata.

ç. Besimi në profetët

Zoti, për të shndërritur njerëzit dhe për t’ua kumtuar diturinë hyjnore, nga Bijtë e Izraelit ka zgjedhur profetë. Vend më të rëndësishëm në mesin e profetëve të zgjedhur zë Moisiu. Besohet në të gjithë profetët që përmenden në Dhiatën e Vjetër, prej Noahit e deri te Malahi. Davidin dhe Solomonin, të cilët Kur’ani i përmend edhe si pejgamberë edhe si sundimtarë, i pranojnë vetëm si sundimtarë. Kështu që hebrenjtë në këtë çështje dallojnë prej muslimanëve. Ata besojnë se edhe ndihmësprofetë Zoti u ka dhënë shpallje. Ndihmësprofetët, përgjithësisht qëndrojnë larg ceremonive fetare dhe botërore dhe nuk i respektojnë aq traditat formale. Çështje mbi të cilën përqëndrohen më tepër është tërheqja e vërejtjes atyre që janë larguar nga rruga e drejtë, dhe janë në rrugë të gabuar. Njerëzve u tregonin gabimet. Ndihmësprofetët nuk merren me punët e tempullit dhe të flijimit. Nuk kanë edhe ndonjë autoritet botëror që do t’i emërojë ata. Nuk mund të thuhet se kanë ndonjë edukim të caktuar. Ata e kritikojnë shumicën e magjistarëve. Rreptësisht i respektojnë rregullat e ndërgjegjes dhe të etikës.

³²³ Kur’ani, Bakara, 80-81.

³²⁴ *Libri 2 i Sam.*, 24, 15.

³²⁵ *Libri 2 i Mbr.*, 19, 35.

³²⁶ *Libri 2 i Sam.*, 243, 1.

d. Besimi në librat e shpallur

Librat e shenjtë që i respekton hebraizmi janë Tanah dhe Talmudi. Tanah është emër i përveçëm i përbërë nga shkronjat kryesore të titujve të librave në ibranishte, si dhe Tora, Neviim (profetët) dhe Ketuviim (shkrimet e shenjta). Këto libra përafërsisht e përbëjnë Dhiatën e Vjetër të Biblës. Tora, është titulli i pjesës së parë të Dhiatës së Vjetër, për të cilën besohet se i ka zbritur Moisiut. Neviim, është pjesa që u ka zbritur profetëve pas Moisiut. Ky libër ndahet në dy pjesë: në pjesën e parë janë profetët e parë. Në këtë pjesë tregohet vendosja e Bijve të Izraelit, pas vdekjes së Moisiut, në tokën e premtuar nga ana e Zotit, themelimi i mbretërisë, udhëheqja dhe sjelljet e mbretërve. Gjithashtu tregohen edhe luftrat e zhvilluara me popujt idhujtarë. Profetët e parë janë Jeshua, Shoftim (Gjykatësit), Samuel dhe Melahim (Mbretërit). Në pjesën e dytë janë profetët e fundit. Këtu shpjegohen luftërat e profetëve me idhujtarët, këshillat dhe porositë e tyre fetare. Ata janë: Jezaja, Jeremija, Hezekieli, Oshea, Joel, Amos, Oredja, Jona, Miha, Nahum, Habakuk, Tsefanja, Hagaj, Zaharja dhe Malahi. Ketuviim, do të thotë shkrime. Këta janë Psallmet dhe Aforizmat e Solomonit. Bazohen në Davidin dhe në Solomonin. Përmbajnë thënie të bukura dhe etike. Edhe libri Shir Ashirim i përshkruhet Solomonit. Kohelet, llogaritet si një vepër filozofike dhe i përshkruhet gjithashtu Solomonit. Ester, shpjegon shpëtimin e hebrenjve nga një gjenocid i planifikuar nga mbretëresha Ester. Eha, shpjegon shkatërrimin e Jerusalemit dhe brengat e Jeremjes. Daniel, shpjegon shkatërrimin e Tempullit dhe jetën e Danielit në syrgjynosje në Babiloni. Ezra dhe Nehemja shpjegojnë kthimin e hebrenjve nga syrgjynosja në Babiloni dhe rindërtimin e Jerusalemit dhe tempullit. Divre Ajamim, e rezymon historinë e musevitëve. Të gjitha këta libra njihen me emrin Dhiata e Vjetër. Në aspektin e ndarjes në pjesë dhe numrit të librave, dallohen nga të krishterët. Kisha numëron 39 libra, kurse hebrenjtë 24 libra. Gjithashtu dallojnë edhe në renditjen e tyre.

Gjuha origjinale e tekstit të Dhiatës së Vjetër është ibranishteja, e cila është nga gjuhët perëndimore semite. Dialektet me rëndësi të kësaj gjuhe janë kenane, fenike dhe ugarite. Sikurse në arabisht, ashtu edhe në ibranisht, zanoret nuk shkruhen. Edhe pse në të kaluarën kanë qenë të varfra në të shprehurit, pasuria e aksionit dhe e termave është në nivel. Shkrimi është në formë katrori dhe fillon nga e djathta në të majtë. Për të penguar leximin gabim të tyre, mungesa e zanoreve plotësohet me shenjat e pikësimit (si vokalet në gjuhën arabe).

Dhiata e Vjetër është përgatitur afërsisht brenda 1000 vjetëve. Vetëm se, përkufizimi i librit është bërë në koncilin Jemnia, të mbledhur në vitin 90 të e.s., duke u seleksionuar në shkrimet e sotme. Kurse caktimi dhe korrigjimi komplet i tekstit, ka mundësi të jetë bërë në vitin 100 të e.s. Diskutimet rreth origjinalitetit të shkrimeve vazhdojnë shekuj me rradhë.³²⁷ Shkrimet që komuniteti nuk i ka llogaritur si të vërteta nuk janë shënuar në libër. Por, këta ruhen në përkthim greqisht (Septuaginta) të Dhiatës së Vjetër. Këta janë: Ezra III, Tobit, Judis, Lutja e Manesetit, Danieli dhe Esteri Barah, Letra e Jeremjasë, Isa Sirah dhe Aforizmat e Solomonit.

Talmudi: krahas Dhiatës së Vjetër ka edhe transmetime nga rabinët, brez pas brezi. Përmbledhja e tyre quhet Talmud. Në vitin 150 të e.s., rabinin me emër Judas, i frikësuar nga zhdukja e parimeve fetare dhe e lajmeve të transmetuara deri tek ai, të gjitha këto i përmbledhi në një vepër me emër Mishna. Mishna do të thotë „Ligji i përsëritur“. Sepse përsëritja e Toras llogaritet shpjegim dhe komentim i ligjit. Më vonë, rabinët babilonas dhe palestinezë i bënë shumë shtesa veprës së përgatitur nga Judas. Në vitin 216 të e.s. një dijetar me emrin Jahuda bëri të mundshme kompletimin e shtojcave dhe të transmetimeve gojore dhe, kështu, fjala Mishna u bë shprehja e të gjitha shkrimeve nga koha e Judas e deri te koha e Jahudas.

Pasi që Mishna ishte e vështirë të kuptohet nga disa lexues, dijetarët hebraikë asaj i bënë shumë komentime dhe anëshkrime, të cilat e morën emrin “Gemara”.

Pra, Talmudi përbëhet nga tërësia e veprave Mishna dhe Gemara. Studimi i saj shërben për përvetësimin e normave të edukimit dhe të fesë. Mishnasë, në të cilën gjenden shtesat dhe komentimet e rabinëve palestinezë, i thuhet Talmudi i Jerusalemit. Kurse asaj në të cilën gjenden shtesat e rabinëve

³²⁷ Adam, f. 176.

babilonas i thuhet Talmudi i Babilonisë. Shumica e hebrenjve besojnë se Talmudi është libër i shpallur nga ana e Zotit dhe atë e vlerësojnë njësoj me Toran. Ata që nuk e pranojnë Talmudin nuk vlerësohen hebrenjë të vërtetë.

Talmudi, në aspektin përmbajtësor, u ngjan vendimeve të kuvendit popullor, të marra për probleme të rëndësishme jetike. Vetëm se këtu njerëzit për të cilët bëhet fjalë janë vetë hebrenjtë. Ligji, doktrina, komentimi i Librit të Shenjtë, ligjëratat, shpjegimi i historisë dhe tregimet e shkurtëra, janë një mozaik në njëra-tjetrën. Ai është i rregulluar në ujdi me urdhëresat dhe ndalesat për problemet e jetës ditore, me Librin e Shenjtë dhe me transmetimet gojore të Ligjit. Në të kundërtën nuk numërohet si urdhër hyjnor. Për këtë çështje në Talmud thuhet: *“Kush kryen një obligim fiton një ndërmjetësues, ndërsa kush e nëpërkëmb një obligim fiton një paditës. Pendimi dhe punët e mira janë një ombrellë ndaj dënimit hyjnor”*.³²⁸

Periudhat e rregullave jetike të ligjit nuk kryhen dhe nuk përfundojnë. Kompletimi i Talmudit përafërsisht ka zgjatur 500 vjet. Karaitët, që numërohen si një lloj protestantizmi hebraik, kanë dashur që Librin e Shenjtë në shek. VIII, ta numërojnë si burim të vetëm. Kjo rrymë në Mesjetë i hapi rrugë kodifikimit Mishna-Tora të Majmonidest dhe shkrimit të katekizmit hebraik të Schulchan Aruch-it (1565).

Përmbajtja e Talmudit ndahet në dy pjesë, në Halaha dhe Haggada. Në Halaha shpjegohen rregullat si: urdhëresat, ndalesat, lejesat etj. Sipas llogaritjes së rabinëve në Talmud ka 613 ligje, 248 janë urdhëra, kurse 365 janë ndalesa. Ndërkaq Haggada është pjesa në të cilën shpjegohen tregimet e simboleve dhe të ligjëratave, legjendat dhe fjalët e urta e etike. Halaha njeriun e shtërëngon me ligje fetare, kurse Haggada me këshillat, fjalët e urta dhe me tregimet e saj jep lehtësim dhe qetësim. Të dyja synojnë që Talmudin dhe të kaluarën ta lidhin me të tashmen.

Ahabja ben Mahalel thotë:

*“Nëse i di tre gjëra nuk bën mëkat, pra nëse e di se nga vjen, ku shkon dhe përpara kujt do të japësh llogari! Nga vjen? Nga një pikë me erë të keqe. Ku shkon? Në vendin ku gjenden pluhuri, toka, krimbat dhe insektet e tjera. Përpara kujt do të japësh llogari? Përpara Mbretit të mbretërve, emri i të Cilit përmendet me respekt.”*³²⁹

Rabbi Hanina thotë:

“Lutu për udhëheqësinë e mirë, që të mos frikësohesh prej tyre, në të kundërtën, ata gëlltitin të gjallë njëri-tjetrin”.

Rabbi Jakob thotë:

“Kjo botë është dhomë pritjeje për botën e ardhshme. Zbukuroje veten në dhomëpritje, nëse do të të pranojnë në salon!” Gjithashtu thotë se: *“Një orë që e kalon me lutje dhe punë të mira është më e mirë se e tërë jeta e botës së ardhshme, çdo orë e botës së ardhshme është më e lumtur se sa e tërë jeta e kësaj bote.”*

Samueli thotë:

“Nëse armiku bie mos u gëzo dhe nëse lubatet mos u kënaq. Që të mos të të shohë Zoti e të zëmërohet në ty”.³³⁰

dh. Besimi në Mesian

Fjala „mesia“, e cila shpreh konceptin hebraik, e më vonë edhe atë të krishterë, është forma në aramishte e fjalës *(ba) Mashiah* në ibranshte dhe *meshiba* në gjuhën arameje. Fjala ka kuptimin *„i stërpikur me vaj, i lyer me vaj, i pastruar“*. Në fillim termi mesia/mesih përdorej për mbretërit hebraikë, kurse më vonë, filloi të përdoret edhe për murgjit dhe kryemurgjit. Sepse kur mbretërit merrnin fronin mbretëror, gjithashtu edhe murgjit kur emëroheshin lyheshin me vaj. Besohej se ata me këtë fitonin shenjtëri dhe një fuqi speciale. Madje më vonë filluan të lyheshin edhe profetët.

Kjo shprehje, pas syrgjynosjes në Babiloni, filloi të përdorej për një lider apo për një profet, i cili do të dërgohet nga Zoti në Kohën e Fundit. Ky term që më përpara nuk është parë të përdoret në mesin e hebrenjve, ekziston që në kohën e sumerëve. Sargoni I. (2350 para e.s.) dhe Hammurabi (1728-1686 para e.s.) besohej se ishin mehdî-mesia. Sipas termit të ri, me kalimin e kohës, në sipërfaqe të tokës do të përhapen pafesia dhe amoraliteti, njerëzve do t’iu zvogëlohet ndjenja e turpit, do të rriten çmimet, respekt nuk do të ketë, do të zvogëlohet bota dhe shtetet do të shndërrohen në shkretëtira. Jerusalemi

³²⁸ Schoeps, f. 253.

³²⁹ Schoeps, f. 253.

³³⁰ Schoeps, f. 253.

do të rrënohet dhe do të bëhet vend për kullotje të bagëtive. Kurse kur do të afrohet koha e ardhjes së Mesias, dielli do të nxihet, uji i lumit Jordan do të shndërrohet në gjak dhe do të bëhet luftë qytetare. Sipas llogaritjes së rabinëve, Mesia do të vijë në vitin 240 ose 471 të e.s., kurse mbretëria e tij do të zgjatë 400 vjet. Por, siç kishte nga ato që mendonin se kjo kohë do të zgjatë 2000 vjet, kishte edhe të atillë që mendonin se do të zgjatë 70 apo 40 vjet.

Përsëri, sipas konceptit tradicional, ditën e ardhjes së Mesias nëpër shkretëtira do të burojë ujë, nga stepa të ndryshme do të rrjedhin lumenj. Shkretëtirat do të shndërrohen në kopshtin Eden të parajsës. Drita e hënës do të shkëlqejë si e diellit që është sot, kurse drita e diellit do të jetë shtatë herë më e shndritshme se sa sot. Drurët do të japin frute rregullisht, bimët e tokës do të mbushen me erë aromatike. Në sipërfaqe të tokës nuk do të mbetet kafshë e egër, luani dhe qengji do të bëhen shokë si në parajsë, fëmijët do të luajnë me gjarpërinjtë si me lodrat e tyre. Mizat dhe insektet nuk do të kafshojnë askënd. Ariu dhe luani, sikur kau, do të hanë barë. Mesia, Shtëpinë e Zotit (tempullin) do ta ndërtojë në majën Sion të Jerusalemit. Jerusalemi me mëshirën hyjnore do të bëhet qytet bregdetar. Atë do ta rrethojë një mur prej zjarri me 12 dyer. Armiqtë që do të dëshirojnë të hyjnë brenda do t'i zhdukë. Qyteti do të stoliset me xhevahire dhe margaritarë. Komuniteti i ndarë do të mblidhet këtu dhe nga brendia e pluhurit do të ngritet një bashkësi diçka e çuditshme. Rrugët, shtëpitë, muret do të ndërtohen prej xhevahiri. Qyteti do të zgjerohet deri te dyert e Sirisë.

Mesia, sipas hebrenjve, do të vijë nga fisi i Davidit dhe do të lindë në Betlehem. Ditën e lindjes së tij tempulli do të priset, kurse lindjen e tij do ta shpallë Mikaili. Ai, si zëvendës i Zotit në tokë, do të udhëheqë hebrenjtë dhe johebrejtë. Ai, si perandor i botës, hebrenjve do t'iu sjellë mëshirën e Zotit, kurse mosbesimtarëve (johebrejve) mallkimin e Tij. Si një sundimtar i drejtë, do të udhëheqë nga fronti i Davidit, kufijtë e shtetit do t'i zgjerojë prej deti në detë. Do ta çlirojë Romën, kurse arabët nëpërmjet egjiptasve do t'i obligojë me tatim, shtetin e tij do ta udhëheqë sipas ligjeve hyjnore, të gjithë njerëzve do t'u mundësojë të jetojnë në paqe dhe lumturi. Edhe Dhiatën e Vjetër do t'ua mësojë të gjithëve. Zemrat e njerëzve do të mbushen me besim. Luftën do ta ngrejë nga toka, shpatën dhe shtizën do t'i shndërrojë në mjete bujqësie. Në kohën e tij nuk do të ketë asnjë që të mos gëzojë, bile edhe unukëve do t'ua mundësojë martesën dhe të kenë fëmijë. Jexhuxhin dhe Mexhuxhin (Xhuxhmaxhuxhin-Gog and Magog), të cilët do ta rrethojnë Jerusalemin, Zoti do t'i zhdukë me sëmundje, zjarr dhe breshër. Kurse kufomat e tyre do t'i pastrojnë kafshët e egra.

Mbretëria e botës do të përfundojë në 6 mijëvjetëshin e botës dhe në sipërfaqe të tokës nuk do të mbetet asnjë gjallesë e gjallë. Kurse në 7 mijëvjetëshin e botës do të ndodhë gjykimi i fundit (kijameti). Pastaj do të vijë dita e ringjalljes dhe e llogarisë.³³¹

14. Adhurimi dhe traditat

Populli hebraik, me prishjen e Dytë të Tempullit, e kishte humbur lagjen e shenjtë, për të cilën besonte se Zoti në të është i pranishëm gjithmonë. Bashkë me tempullin mori fund edhe riti i sakrificës. Kjo goditje u tejkalua nëpërmjet sinagogave në diasporë. Sinagogat, që janë vende lutjeje dhe tubimi, shihen si vende ku mblidhen shumë njerëz. Edhe në sinagoga gjendet “vendi i shenjtë” (*aron hattodesh*). Ato janë të mbuluara me perde të shenjta dhe të kthyera drejt Jerusalemit. Brenda në një arkë gjendet i fshehur në formë të rules teksti i Dhiatës së Vjetër. Para arkës qëndron ndezur “llamba e përhershmerisë” (*ner tamid*). Shandani me shtatë krahë që gjendet në tempullin e Jerusalemit, gjendet edhe në sinagoga. Momenti më madhështor gjatë kohës së ritualit është nxjerrja nga trasta, e qëndisur e ruleve të Dhiatës së Vjetër dhe leximi i tyre me ceremoni nga rabini në pedestal.

a. Lutjet

Adhurimi i hebrenjve nuk bëhet vetëm në grup, por, ai bëhet edhe në familje. Punët e murgut i

³³¹ Sarikçioğlu, *Dinlerde Mehdî Tasavvurları*, Samsun, 1997.

kryen babai. Pas derës hyrëse në shtëpi gjendet një tekst në të cilin janë të shënuara versetet nga Dhiata e Vjetër. Ato janë të vendosura në formë të rules, në një kuti të gjatë në formë cilindri, të quajtura *mezuzza*. Në këtë tekst gjenden versetet, Ligji i Përtërirë VI, 4-9, dhe XI, 13-21, që shprehin se adhurimi i një zoti tjetër përveç Zotit të vërtetë është i ndaluar. Në hyrje dhe dalje nga shtëpia këto rule preken me gishta dhe gishtat puthen. Hebreu fetar, nëse nuk mund të marrë pjesë në adhurimin e bërë në grup, adhurimin e detyrueshëm e bën vetë. Gjatë adhurimit e vendosin një shall me emrin „*tallit*“, e mbulojnë me të kokën dhe kthehen drejt Jerusalemit. Jerusalemi është vendorientimi i hebrenjve.

Hebrenjtë, përveç lutjeve të lira, kanë edhe rituale si tre kohë faljesh të detyrueshme në ditë: mëngjezi (*shaharit*), mesdita (*minha*) dhe mbrëmja (*maarib*). Të shtunën dhe në ditët e festave shtohet edhe rituali i paraditës (*musaf*). Të hënën dhe të enjten bëhen lutje pendimi. Kurse lutjet e kufomave, që në gjuhën arameje quhen *kaddish*, edhe nëse nuk ka në momentin kufoma, lexohen për përgatitje për ndonjë kufomë të papritur.

Sipas filozofisë profetike mëkati dhe dënimi mund të zhduken vetëm me pendim dhe lutje. Dyert e mëshirës, më tepër se adhurimet me formë, i hap kthimi drejt Zotit me sinjeritet dhe seriozitet. Të menduarit e Zotit dhe lutja që i bëhet Atij hap rrugën e mëshirës hyjnore. Nuk ka shlyerje mëkatesh nëpërmjet murgut, sikur që është në krishterim.

b. Agjërimi

Agjërimi (*Tanit*) mbahet në përvjetorin e ditëve të fatkeqësisë në histori dhe në ditën e pendimit (*dita e Kipur-it*). Këto ditë janë rrethimi i Jerusalemit, okupimi i Jerusalemit, shkatërrimi i Tempullit, vrasja e liderit hebraik Gedaljasë dhe dita e 13 e Adar-it (muajit të dymbëdhjetë).³³²

c. Llogaritja e kohës

Hebrenjtë kanë një kalendar të pandryshueshëm. Ata fillojnë që nga dita e krijimit të botës. Ky krijim ka ndodhur me shtatë tetor të vitit 3761 para e.s. Në vitin 1958, viti hebraik ka filluar si viti 5719. Në kalendar përdoret viti hënor. Një vit përbëhet nga dymbëdhjetë muaj, çdo njëri zgjat 29 deri 30 ditë. Vetëm se, tërësia e ditëve të tepruara, që dalin sipas kalendarit diellor, plotëson vitet me një muaj të trembëdhjetë. Këtyre viteve u thuhet viti kalimtar ose viti i mesëm. Muajit të tepërt i thuhet edhe *adari i dytë*. Emrat e muajve, që nga syrgjynosja në Babiloni nuk kanë pasur asnjë ndryshim. Këto janë muajt: Nisan, Ijjar, Sivan, Tammuz, Ab, Elul (fillimi i vitit të ri), Tishri, Marheshvan, Kislev, Tebet, Shebat, Adar.³³³

ç. Festat

Tre festat e mëdha hebraike janë të trashëguara prej festave të vjetra natyrore. Në këto festa, jetohet historia e popullit hebraik. Nga këto është festa *Pasab* (pa tharm) (15-22 Prill), që zgjat tetë ditë dhe është festa e parë e prodhimit. Kjo festë përkujton largimin nga Egjipti dhe shpëtimin prej skllavërisë. Në gostitë e festave, plot me lutje dhe lexim të Dhiatës së Vjetër, ushqimi fillon me bukë pa tharm dhe me barë të hidhur (*maror*). Gotat e alkoolit mbushen katër herë, si shenjë e shpëtimit dhe e gëzimit. Ndërkaq *Shabuos*, që festohet ditën e 6 dhe 7 të muajit Sivan, është festa e zbritjes së Dhjetë Urdhërave. Festohet si përkujtim i shpalljes në Sina. Kurse festa e *Sukotit*, që festohet më 15 Tishrit, është përkujtim i jetës së Bijve të Izraelit në shkretëtirë. Populli atë ditë, duke kujtuar jetën që ka bërë nëpër tenda të ndryshme, ndërton një kasolle me dega, me lule dhe me giethe dhe rreth saj lexohen pjesët e përshtatshme nga Dhiata e Vjetër. Kështu e festojnë festën. Mund të numërojmë edhe festën *Hanukaj* (festa e kandilit), e cila fillon me 15 Kislev. *Festa e Makkabive* është përkujtimi i shenjtërimit të dytë të tempullit dhe i fitores ndaj mbretit idhujtar sirian Antijahusit. Kjo festë zgjat tetë ditë. Ndërsa një tjetër

³³² Suzan Alalu dhe Klara Arditi, *Yahudilike Kavram ve Değerler*, Gözlem Gazetecilik Basım ve Yayın (A.S.), Stamboll 1996, f. 76.

³³³ Vep. e cit., f. 9-73.

është festa *Purim* dhe festohet më 14 Adar. Kjo është festa për vrasjen e Hamanit (nuk ka të bëjë me Hamanin që e përmend Kur'ani), kryemurgut të mbretit persian Ahasvarit (485-461 të e.s.). Sipas transmetimit Hamani ka dashur që t'i vrasë të gjithë hebrenjtë brenda perandorisë persiane. Me vrasjen e tij, pengohet edhe gjenocidi i planifikuar. Në këtë festë të varfërve u shpërndahen dhurata, ndërsa shokët gostiten. Ditën që pason agjërohet. Gjithashtu në mesin e festave numërohen edhe *Resh Hashana* (Viti i ri) dhe *Jom Kippur* (Dita e pajtimit). *Sabati*, dita e shtunë dallohet nga ditët tjera të punës. Ajo është ditë feste, ditë e qetësisë dhe ditë pushimi. Sabati fillon ditën e premte, 45 minuta para se të errësohet. Kështu që fillon me lutje dhe adhurime dhe ndalet çdo punë. Për shembull, çdo veprim dhe punë është e ndaluar, si cigarja, shkrimi, numërimi i parave etj.

d. Traditat

Fëmijët meshkuj të hebrenjve, ditën e tetë pas lindjes bëhen synet dhe atë ditë edhe pagëzohen. Ndarja e lëkurës së përparme (me synetim), llogaritet shenjë e dukshme e marrëveshjes mes Zotit dhe Abrahamit. Fëmija kur të arrijë moshën 13 vjeçare llogaritet „*bar mizva*“ (i pjekur) dhe duke iu lidhur një qemer lutjeje merret në komunitetin fetar. Fëmija, nga ky moment llogaritet përgjegjës përpara Zotit për urdhërat fetarë.

Kurse në jetën familjare ngjarje më e rëndësishme është martesja. Deri në vitin 1000 të e.s. është lejuar martesja me shumë gra. Vetëm se, më vonë, me kontributin e rabinut Hershem ben Juda, ky veprim është ndaluar. Kurse unazën e kurorëzimit, që është shenjë e martesës, e vendosin në gishtin tregues të dorës së djathtë.

Të vdekurit i varrosin në tokë. Gratë nuk marrin pjesë në ceremoninë e varrimit. Sipas fesë, gratë me menstruacion, lehonat dhe me disa sëmundje të tjera, nuk llogariten të pastërta. Prekja e një kafshe të ngordhur, apo njeriu të vdekur, është shkak për prishjen e pastërtisë. Nuk është mirë që një hebreu fetar të gjendet në vendin ku gjendet një i vdekur. Nga këto papastërti shpirtërore njeriu mund të pastrohet me larje speciale fetare, e ngjashme si abdesti në islam.

15. Rregullat e ushqimit

Njërës prej çështjeve që i jepet rëndësi janë edhe rregullat e të ushqyerit. Sipas vlerësimeve fetare mishi i disa kafshëve është i lejuar, kurse i disave është i ndaluar. Nga këto i ndaluar llogaritet mishi dhe qumështi i kafshëve me katër këmbë, që nuk janë përtypëse dhe nuk janë me thonjë të ndarë, mishi i kafshëve të therura në kundërshtim me rregullat fetare, mishi i derrit, mishi i insekteve dhe i zvaranikve, mishi i peshqve që kanë pulla dhe nuk janë notues, mishi me produkte të qumështit. Kurse të lejuara janë kafshët me thonjë të ndarë dhe përtypëse, përveç devesë. Gjithashtu prej kafshëve të lejuara dallohet që të hahet aorta dhe dhjami i pazier (i gjallë). Po ashtu pengesë për ngrënie e mishit të disa kafshëve janë edhe disa sëmundje dhe plagë të ndryshme.

16. Simbolet

Njëri nga dy simbolet me rëndësi të hebraizmit është ylli gjashtëkëndësh, të cilin e përbëjnë dy trekëndësh të futur në njëri tjetrin dhe që quhet *Ylli i Davidit*. Ky yll është një shenjë magjike që haset në mesin e njerëzve të shumë shteteve. Për herë të parë është parë në unazën e një hebreu në Sidon, në shek. VII para e.s. Me siguri se në fillim ka qenë një shenjë e Zotit dhe në kryengritjen e Bar Kohbasë është përdorur si simbol. Më vonë ky yll gjashtëkëndësh, është bërë një shenjë e Kabbalasë.

Edhe Menora, që është *shandan me shtatë kerabë*, është një simbol tjetër i hebrenjve. Sipas transmetimit, izraelitët duke shëtitur nëpër shkretëtirë, këtë yll e kanë përdorur si shndërritës të tendës

së shenjtë. Kurse sot është stema shtetërore e Republikës Izraelite.

17. Misticismi hebraik

Misticizmi, i cili është prezent në fe të ndryshme dhe është një manifestim i fetarisë së thellë, flet për botën mbinatyrore dhe mendon që me atë botë të lidhë marrëdhënie dhe të komunikojë me të. Ai pasqyron përvojën e qenies së diturisë mbinatyrore, ndërsa e lë ndarjen subjekt objekt. Në fillim ka vështirësi në të kuptuarit e shumë fushave të zhvillimit dhe të sistemeve të mbyllura të hapësirës ndërplanetare. Gjithashtu nga afër kujdeset për pritjen e mesias të shpresuar.

Rrënjët e misticizmit kërkohen në Librin e Shenjtë. Pasqyrimet e tij mundohen të shihen te profetët (Moisiu, Elias, Elisa dhe të tjerë). Ai formon doktrinën e transmetimit për krijim në “Zanafilla”, dhe për vizionin e Ishajasë në Tempull, për përshkrimet mrekulluese të Ezekielit, për natyrën hyjnore dhe për universin. Kjo fetari e bazuar në Dhiatën e Vjetër, vazhdohet edhe në Talmud. Pas ndërtimit të Dytë të Tempullit, edhe te farisejtë ka patur mendime për spekulacione mistike. Më vonë shihet se konceptet helene-gnostike janë përzier me spekulacionet hebraike. Vizioni “Qerrja e fuqisë” (merkaba) e Hezekielit është muguulluar nga mendimi, “*Të shobësh, të kuptosh fronin e Zotit, në gjendje -ekstazë dhe kontemplacion?*”, në misticizmin e shek.V dhe VI.

Sigurisht njoftimet që burojnë nga periudha e vjetër dhe që janë të grumbulluara nën titullin “Kabbala”, i kanë dhënë forcë lëvizjes shpirtërore, të përhapur nga Spanja në Francën jugore në shek. XIII., dhe misticizmit hebraik. Material kryesor ishte libri “Zohar”, i shkruar me një gjuhë aremeje të mbyllur, nga Rabbi Simon bar Jahaj, në shek. II. Vetëm se kjo vepër nuk ishte një e tërë, por ishte një komentim i Dhiatës së Vjetër, në formë të “*Midrashit*”, që ka për qëllim ritmin. Shumë pjesë të saj janë të shkruara nga Moshe ben Shemtob de Leon, kabbalist prej Guadalahasë, që ka vdekur në vitin 1305. Zohar për herë të parë është botuar në Kremona dhe Mautua në 1558.

Temë kryesore e misticizmit hebraik është drita e përleshme mbi qiellin e dukshëm dhe ekzistenca para krijimit. Sipas doktrinës së botës me 10 qiej, të lindur nga Zoti, botëror është aktiviteti për nxjerrjen përsëri të shkëndijave të dritës qiellore që ndikon në brendinë e çdo gjëje, gjegjësisht, është aktiviteti për shpëtimin e shpirtit. E dyta është nxjerrja në shesh e kuptimeve të thella në Dhiatën e Vjetër me anë të misticizmit të numrave. Burimi kryesor i misticizmit të shkronjave dhe të numrave është “libri mbi krijimin” (*Sefer Jetsira*), që është një nga pjesët e Kabbalasë. Kjo është përgatitur në shek III dhe VI. Burim kryesor janë 10 numrat bazorë dhe 22 shkronjat e alfabetit hebraik. Të dyja së bashku krijojnë 32 “*rrugë të urtësisë*”. Zoti vetveten e pëshkruan me shenja të “shkronjave”. Sipas kësaj, fjalëve të Librit të Shenjtë u jepen domethënie simbolike. Sepse ligjet dhe ngjarjet historike që i shpjegon Dhiata e Vjetër, janë vetëm trupi dhe veshjet e fjalës hyjnore. Kurse të kuptuarit e shpirtit të tyre e mundëson vetëm mendimi mistik.³³⁴ Ndërkaq temat për magji dhe kundërmagji gjenden në kapitullit “Kabbala praktike”. Qëllimi i fundit i Kabbalasë është njohja kuptimore e misterit të fundit. Gjithashtu është bashkimi mistik i Zotit me njeriun, që është krijuar në mënyrë të përhershme. Kjo arrihet me lutje për koncentrim, me ekstazë dhe me kontemplacion.

Gjithashtu, në shek. XII në zhvillimin e misticizmit hebraik ka ndikuar edhe Sefer ha-bahir, njëri prej teksteve Kabbala. Me anë të kësaj në hebraizëm u fut shprehja shpërngulje e shpirtërave (*gilgul*). Sefer ha-temuna, i shkruar në shek. XIII, bënte komentimin mistik të cilësive të Zotit. Vepra e tij, Libri i Dritës, fitoi shumë vlerë.

Sidomos në shek. XVI, në Europë jeta shpirtërore e hebraizmit arriti shkëlqimin me anë të mistikut kabbalist Moses Cardaveros (1522-1570) dhe të Isaak Lurjas (1534-1572). Gjatë shek. XVII, shkolla pedagogjike talmudiste nuk u pa e mjaftueshme dhe u pritën ndryshime të mëdha. Vetëm se të gjitha zhvillimet mbetën në një rreth të ngushtë në gettonë hebraike.³³⁵

³³⁴ Mehmet Aydın, *Din Fenomeni*, Konja 1993, f. 111.

³³⁵ Schoeps, f. 254.

a. Sabataj Sevi

Sabataj Sevi është një mistik hebraik i lindur në Izmir më 1626. Shtimi i numrit të nxënësve rreth tij, ngjallën në të ndjenjat e mesianizmit. Gjatë një gostie në Selanik ai arriti bindjen se u bashkua me Dhiatën e Vjetër, i cili llogaritet njeri i parë e inkarnuar (trupëzuar) prej Zotit. Sabataj Sevi, veten e shpalli mesia për herë të parë më 5408 (v. 1648), vit që kabbalistët e kanë llogaritur si vit të shpëtimit. Viti i Mesias, që pritej nga vetë ai dhe simpatizuesit e tij, do të realizohej në vitin 1666. Viti arriti, por ajo që pritej të realizohej nuk u realizua. Kurse mesia i vetshpallur ra në duart e sulltanit osman. Ai duhej që të braktiste o pretendimin për mesia, o jetën e tij. Ai zgjodhi të parën dhe deklaroi se është bërë musliman. Sevi, 10 vjetët e fundit të jetës së tij i kaloi në një tronditje të madhe.

Lëvizja mistike mesianike, pas vdekjes së Sabataj Sevit, lindi përsëri me Jakob Frankun dhe vajzën e tij Eva dhe vazhdoi deri në Revolucionin Francez.

b. Hassidizmi

Hassidizmi u zhvillua nga misticizmi i Merkaba-së. Fjala *bassid* (në ibranishte: fetar), në fillim përdorej për fetarët ekstremë të periudhës Makkabi, ndërsa më vonë u përhap edhe si emër për mistikët dhe mësuesit. Fetarësia u bë emër i ushtrimeve shpirtërore dhe i dashurisë për Zotin. U zhvillua mendimi i thellë, që të përkujton metodën e Jogës indiane. Me anë të kontemplacionit u hap dera e takimit me misteret e profecisë. Ekstaza është shpjeguar edhe si njohje edhe si harresë e unit. Synimi ishte bashkimi mistik me Zotin. Misteri i shkronjave e argumenton doktrinën mistike të emrave të Zotit. Zohar-i (libri i madhështisë, dritës), pas Dhiatës së Vjetër dhe Talmudit, është libri më me rëndësi.

Sistemi kabbalist bazohet në filozofinë e Philos dhe të neoplatonizmit. Sipas termave për Zotin, Zoti as nuk njihet, as nuk shihet, as nuk definohet. Edhe mendimet për krijimin shprehen me anë të teorisë së emanacionit: Froni, drejtësia, urtësia, dhuntia, fuqia, madhështia, shkëlqimi, sundimi etj., të gjitha këto, nga pamja qiellore e njeriut janë të grumbulluara në “*njeriun e parë*”. Nga bota shpirtërore kanë dalë krijimi i gjithësisë, froni i Zotit, kurse nga këta kanë dalë bota e krijuar, engjëjt dhe shpirtrat e këqinj. Kurse nga këto të fundit ka dalë bota materiale, gjegjësisht bota e dukshme. Në Kabbala ka tre lloje konceptesh për shpirtin: *Shpirti logjik* (neshema), afër tij gjendet “*shpirti ndijor, epsb?*” (ruah) dhe “*shpirti bimor*” (nefesh). Shpirti njerëzor është forca e parë ekzistenciale e dalë nga bota e lartë dhe është e përmalluar të kthehet në vendin prej nga ka ardhur. Ai, pasi që me anë të inkarnacionit të përsëritur të arrijë përsosmërinë, do të mund të shpëtojë nga varësia e krijesave botërore. Sidomos rrotën e lindjeve (gilgul) ua ka mësuar Manessa ben Israel (1604-1657) nga Amsterdami. Burimi i të keqes shihet në largimin e substancave hyjnore dhe në moskuptimin e mëshirës së Zotit. Lartësimi te Zoti bëhet me lutje dhe me adhurim. Shpirti shkon drejt misticizmit të përbashkët me Zotin, kurse Shkrimet e shenjta komentohen me simbole. Shkronjave, fjalëve dhe emrave u përshkruhen fshehtësi hyjnore.

Ligji mistik kabbalist është në anën e kundërt të fesë. Për këtë edhe talmudistët e poshtërojnë atë. Kurse në Zohar, Mishna përshkruhet si robëreshë, kurse Kabbala si zonjë. Thuhet se edukimi i Talmudit krahasohet me një shkëmb pa fryte, nëse copëtohet dalin në shesh guraleca, përkundër kësaj Kabbala është një burim i freskët dhe rrjedhës.³³⁶

Hassidizmi, duke e kthyer atë rreptësi të dispozitave të ligjit, i ka hapur rrugë fushës shpirtërore dhe është përhapur në një rreth të gjerë. Lëvizja sabatajiste dhe frankeniste u bashkuan. Themeluesi i hassidizmit, Rabbi Izrael ben Elizer (1700-1760), llogaritet si përfaqësuesi kryesor i tij në shek. XVIII. Me ligjëratat dhe komentimet e tij mistike ka fituar autoritet dhe ka marrë titullin “*Baal shem Tov*” (zotëria i emrit të gëzuar). Ai mbron një zemër fetare të sinqertë. Nëse njerëzit e adhurojnë Zotin me dashurinë që e kanë në zemrat e tyre, bota e ndarë përsëri do të arrijë të bashkohet. E keqja shihet si shkalla më e ulët e të mirës.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, me vrajsen e një numri të madh të hebrenjve, hassidizmi mori një goditje të madhe. Sot ka simpatizues edhe në ShBA edhe në Izrael. Filozofi Martin Buber (lindi 1878)

³³⁶ Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, f. 632.

është nga komentatorët e rinj të kësaj lëvizjeje.³³⁷

18. Rrymat e reja në hebraizëm

Pas Revolucionit Francez, u zhvillua koncepti që hebrenjtë mos të shikohen si të “syrgjynosur” dhe filloi t’u njihet e drejta e shtetësisë. Të drejtën e tyre civile në Gjermani e fituan më 1848, në Angli më 1858, kurse në Itali më 1870. Më këto zhvillime hebrenjtë për herë të parë filluan të mendojnë për ndryshime në jetën fetare. Duke i ndryshuar qëndrimet e mëhershme, që ishin të mbyllura ndaj botës së jashtme, hapën *gettot* e tyre.³³⁸ Kjo hapsirë për hebrenjtë europianë kishte një karakter revolucionar. Vetëm se kjo nevojë nuk ishte vetëm për një getto të jashtme, por ishte edhe për një getto të brendshme. Nevoja e liberalizmit fetar vazhdoi edhe në shek. XIX dhe XX. Për shkak të këtyre dukurive jashtë vendit lindën reagime të quajtura “*antisemitizëm*”, kurse në mesin e hebrenjve u hap edhe rruga e komentimit dhe diskutimit ortodoks, konservator dhe liberal të termave fetarë, si adhurimet, ligji etj. Së pari, rrymat ekstreme të liberalizmit dhe të cionizmit, filluan të krahasohen besimet e rretheve të ndryshme me format ekzistuese të tyre. Për zgjidhjen e problemeve, paralel me rrymat nacionaliste europiane, shpresë për zgjidhjen e tyre me kërkimin e “*të drejtës nacionale*” dhe me formimin e shtetit nacional, forcuan rrymën politike dhe fetare, që është cionizmi. U kristalizuan edhe grupet e ndryshme fetare.

a. Hebraizmi orodoks

Është një bashkësi kundër modernizimit të fesë. Është zhvilluar në shek. XIX dhe XX. Kjo mbron tradicionalitetin e zhvilluar shekuj me rradhë. Teveratin, Talmudin, veprat e tjera klasike dhe mendimet tradicionaliste i mbajnë larg çdo kritike. Kundërshton rikomentimin e ligjit dhe të Librave të Shenjtë. Sepse këtë e vlerëson si largim nga feja. Respektimin e ndalimeve në lidhje me ushqimet dhe me adhurimin, e vazhdon në mënyrë ekstreme. Sot është edhe fraksion zyrtar i shtetit izraelit.³³⁹

b. Hebraizmi reformues

Nëpërmjet veprave të Moses Mendelsohnit (1729-1786), që janë nën ndikim të revolucionit francez, është ndikuar në komunitetin, që e vazhdon tradicionalizmin. Ndikimin kryesor të tij e paraqiti në mes të hebrenjve në Amerikë. Parimet e këtij komuniteti janë:

1. Ata nuk pranojnë botën tjetër dhe ringjalljen.
2. Nuk presin Mesian person.
3. Hebraizmin nuk e vlerësojnë si komb, por, si komunitet.
4. Nuk e pranojnë në tërësi Ligjin tradicional, por e pranojnë me një seleksionim të përshtatur për jetën moderne.
5. Dhiatën e Vjetër dhe Talmudin nuk i respektojnë në tërësi dhe, gjithashtu, e diskutojnë edhe burimin hyjnor të tyre.
6. Parimet e Sabatit dhe Kasherit nuk i respektojnë.
7. Lëvizjen e konvertimit në hebraizëm nuk e kufizojnë.
8. Në sinagogë burrat dhe gratë ulen bashkë.
9. Adhurimet i kryejnë në gjuhën e shtetit ku jetojnë.³⁴⁰

³³⁷ Heiler, f. 633.

³³⁸ *Getto*, është një vendbanim i cili i ndante hebrenjtë prej të krishterëve në shtetet krishtere në kohën e mesjetës. Këtyre në Afrikë u thuhej “*Mellali*”, kurse në Rusi “*Rajone vendbanimi*”. (Aydın, *Din Fenomeni*, f. 108).

³³⁹ Günay Tümer-Abdurrahman Küçük, *Dinler Tarihi*, Ankara 1993, f. 213.

³⁴⁰ Vep. e cit., f. 214; Aydın, f. 216.

c. Hebraizmi konservator

Ka lindur si reagim ndaj hebraizmit reformues. Dallimi nga ortodoksët është se këta adhurimin e tyre, në vend që ta bëjnë në ibranshte, e bëjnë në anglishte. Nuk e refuzojnë ligjin e vjetër hebraik, vetëm e pranojnë ndryshueshmërinë e tij. Në sinagogë burri dhe gruaja ulen pranë njëri-tjetrit. Janë kundër martesës nga jashtë.

Në këtë komunitet, hebraizmi konservator, nën udhëheqësinë e hebreat me emrin Mordacai Kaplan, ka lindur edhe një rrymë e quajtur “rekonstruksionistët”, dhe është afër mendimeve reformiste.³⁴¹

19. Shteti osman dhe hebrenjtë

Kontakti i hebrenjve me turqit, në histori, mendohet të jetë bërë pas kryengritjes kundër romakëve në vitin 70 të e.s., me shkatërrimin e Dytë të Tempullit dhe me syrgjynosjen e hebrenjve në të katër anët e botës. Kurse kontaktet historike kanë filluar në shek. VIII të e.s., kur turqit hazarë pranojnë hebraizmin.³⁴² Dihet se një pjesë e turqve në shek. X. e kanë pranuar islamin. S’ka dyshim se turqit, pas ardhjes në Anadoll, janë takuar edhe me shoqëritë hebraike, të shpërndara tashmë nëpër Perandorinë Bizantine. Kështu që, kur Orhan Gazi e merr Bursën, atje ka gjetur një komunitet hebraik që u ka lejuar të ndërtojnë sinagoga.³⁴³ Pas çlirimit të Ballkanit, Edreneja dhe Selaniku kanë qenë qendra kolonish hebraike. Edhe me çlirimin e Stambollit haset në dy komunitete të ndryshme hebraike, *Rabbani* dhe *Karai*. Më vonë në Stamboll u është lejuar të vendosen edhe hebrenjtë e shpërngulur. Ata këtu kanë punuar si mjekë dhe përkthyes në nivele të ndryshme shtetërore. Ata që iknin dhe shpërnguleshin nga trysnia që iu bëhej në Europë, strehoheshin në shtetin osman. Numri i të shpërngulurve hebrenj spanjollë supozohet të ketë qenë 200-500 mijë vetë.³⁴⁴ Ata janë vendosur në zona të ndryshme të perandorisë. Shpërngulja e hebrenjve në tokat osmane ka vazhduar edhe në periudhat e mëvonshme.

Edhe pse, pretendimi për mesia i Sabataj Sevit (1648) një kohë e tendosi situatën, përsëri forca shtetërore, dorëhejta e Sabataj Sevit nga pretendimi dhe pranimi i islamit nga ana e tij dhe nga simpatizuesit e tij, e zgjodhi çështjen. Vetëm se ky konvertim i detyruar, nuk ishte një konvertim i vërtetë. Por, transmetohet se edhe pse një kohë Sevi u bë musliman, në të vërtetë ai e ka vazhduar besimin e tij të vjetër. Këtij rasti në histori i thuhet “*të konvertuarit*” (*dönmeler*). Edhe sot aktualizohen diskutimet për atë se e pranoi në të vërtetë islamin, Sabataj Sevi, apo jo.³⁴⁵

Në shtetin osman problemet administrative të hebrenjve zgjidheshin nëpërmjet kryerabinit, i cili gjykonte sipas Dhiatës së Vjetër dhe Halahasë, në gjykatën e quajtur Bet-Din. Këtu shqyrtoheshin edhe mosmarrëveshjet mes një hebreu dhe një muslimani, apo të ndonjë të krishteri.³⁴⁶ Përveç në mosmarrëveshjet tregtare, nuk haset shumë në mosmarrëveshje tjera të hebrenjve me fqinjët muslimanë. Edhe pse në shek. XIX dhe XX, aksionet politike të rrymave cioniste e kanë shqetësuar shtetin, kjo nuk është reflektuar edhe në popull.

Hebrenjtë në shtetin osman ishin një shoqëri me shumë gjuhë. Gjuhët ndryshonin sipas vendit prej ku ata kanë ardhur, gjegjësisht sipas zonës ku kanë jetuar më herët, sipas punës që e kanë bërë, bile kanë ndryshuar edhe sipas numrit të tyre se a kanë qenë shumicë apo pakicë. Në përgjithësi, *sefaradët* kanë

³⁴¹ Vep. e cit., f. 216 dhe në vazhdim.

³⁴² Şaban Kuzgun, *Haşar ve Karatay Türkleri*, Ankara 1985, 272 faqe; Şaban Kuzgun, *Dinler Tarihi Dersleri*, v.1, Kajseri 1993, f. 71 dhe në vazhdim.

³⁴³ Jak V. Kamhi, *500 Yıl Vakfı (Raporu)*, 1992, f. 6.

³⁴⁴ Küçük, *Dönmeler Tarihi*, f. 40-56.

³⁴⁵ Küçük, f. 80, 262.

³⁴⁶ Ahmet Hikmet Eroğlu, *Belgeler Işığında Osmanlı Devletindeki Yahudilerin Dini ve Sosyal Durumu*, Ankara 1996, temë doktorature e pabotuar, f. 218.

folur hebraishten spanjolle (ladino), *eshkenazët* gjuhën jidish, kurse *mustaribët* gjuhën arabe.³⁴⁷

Supozohet se sot numri i hebrenjve si shtetas të Turqisë arrinë deri në 25.000 vetë, dhe gjenden nën *kryesinë e rabinëve* me qendër në Stamboll. Sinagogat dhe komunitetet e vogla të tyre gjenden në qytetet e mëdha, si në Stamboll, në Ankara dhe në Izmir. Pas themelimit të shtetit izraelit, një pjesë e madhe e tyre u shpërngul atje, dhe kështu numri i tyre në Turqi çdo ditë zvogëlohej. Kohët e fundit shihet se këto shpërngulje janë ndërprerë.

20. Qëndrimi i hebraizmit ndaj feve të tjera

Sipas Halahasë ata që nuk janë hebre ndahen në dy grupe, “*nubitël*” dhe “*idhujtarël*”. Nuhitë janë ata që pranojnë shtatë ligjet themelore të bazuara në monoteizmin e profetit Noah/Nuh. Këta parime janë: 1-Mosadhurimi i idhujve, 2-Ikja nga mosbesimi, 3-Qëndrimi larg tradhëtisë bashkëshortore (zinasë) me të afërmit e familjes, 4-Respektimi i drejtësisë, 5-Mosderdhja e gjakut, 6-Mosvjedhja, 7-Mosngrënia e mishit bashkë me gjakun (mosshkëputja e një cope mishi nga kafsha e gjallë). Sipas Maimonidesit, respektuesit e këtyre parimeve quhen “*gÿysëm të udhëzuar*”, dhe në të dy botërat arrijnë shpëtimin. Ata, sipas punës që kanë bërë, fitojnë edhe shenjtëri, gjegjësisht arrijnë shpëtimin.

Islami dhe krishterimi numërohen prej feve nuhite/noahite. Ato, sipas hebraizmit, kanë shërbyer për përhapjen e monoteizmit. Vetëm se, kalimi i një hebreu në islam ose në krishterim llogaritet mëkat i madh, sepse hebreu që e ka braktisur hebraizmin e ka prishur “marrëveshjen” që e ka me njerëzit dhe me Zotin.


Hebraizmi, edhe pse muslimanët i quan nuhitë, islamin e quan të vjedhur nga hebraizmi. Hebrenjtë Muhamedin (a.s.) nuk e pranojnë si profet, vetëm se pranojnë një afërsi serioze me muslimanët. Prej çështjeve të përbashkëta të të dyja feve janë mosfutja e fotografive në tempuj, mosngrënia e mishit të dërrit dhe syetimi. Islamin e shohin më afër hebraizmit, se sa krishterimin. Kurse politeistët dhe idhujtarët, të cilët përbëjnë grupin e dytë, sipas hebraizmit, nuk kanë asnjë lloj shprese për shpëtim.³⁴⁸

³⁴⁷ Vep. e cit., f. 218.

³⁴⁸ Adam, *Yabudilighin Dini Açudan Hıristiyanlığa ve İslam'a Bakış*, II. Türkiye Dinler Tarihi Sempozyumu, 8-9 Nëntor 1996.

KRISHTERIMI

Përafërsisht 1.5 miliardë njerëz nga 6 miliardë banorët e botës së sotëm besojnë në krishterim. 90% e Evropës janë pjestarë të këtij besimi. Në Turqi, sipas regjistrimit të vitit 1960, numri i të krishterëve ka qenë 230.000. Ndërsa në vitin 1965 numri i tyre ka rënë në 206.000. Kjo situatë mund të shpjgohet me anë të ikjes jashtë atdheut për të punuar dhe magjepsjes nga pasuria dhe jeta shoqërore perëndimore, gjithashtu, edhe me hapjen e deryve nga ana perëndimore për bashkëfetarët e tyre. Shpjgohet se ky numër ka rënë përafërsisht në 110 mijë.³⁴⁹ Çështja e vlerësimit të kësaj feje universale në aspekte të ndryshme në histori dhe sot, nga fraksione të ndryshme dhe për shkak të paraqitjes universale të saj, neve na krijon disa vështirësi të mëdha. Për çdo vlerësim të paraqitur ekziston edhe mendimi i kundërt. Këtë gjendje mund ta hasim në çdo fraksion. Dikush nga të krishterët mund të dalë dhe të thotë se ne si të krishterë nuk besojmë kështu, kjo nuk paraqet besimin tonë. Prandaj ne në vlerësimet tona dhe në pjesën hyrëse do të përdorim shkurtimisht mendimet e fraksioneve të mëdha.



Krishterimi është një fe që është zhvilluar në rrethin ku ka jetuar Jezusi nga Nazareti, përafërsisht 2000 vjet më parë. Lindja e lëvizjes në fjalë mbështetet në shpresën dhe besimin e mesianizmit hebraik. Jezusi misionin e tij e ka filluar me përgatitjen e Bijve të Izraelit për mbretërinë e Zotit, që do t'u dburobet në të ardhmen. Misioni dhe ekzistenca e tij me komentimet karizmatike të Palit, i cili ka hyrë në komunitet pas vdekjes së tij (Jezusit), kanë fituar një dimension të ri dhe përbëjnë themelet e krishterimit të sotëm.

Fjala krishter mugullon nga rrënja e fjalës greke hristos (krisht) dhe ka kuptimin ata që respektojnë Jezusin. Kurse në ibranishte është fjala meshiah dhe ka kuptimin i bërë me vaj, i shenjtëruar. Sepse mbretërit dhe klerikët fetarë para se të fillonin punën lyeshin me vaj dhe shenjtëroheshin. Edhe Jezusi, gjegjësisht mbreti, misionari, përgjuesi dhe shpëtimtari i ardhshëm, është quajtur "Krisht".

Në kohën kur ka lindur Jezusi përfaqësues zyrtarë të Palestinës ishin romakët. Ndërkaq autoritet juridik dhe fetar hebraik në Jerusalem ishte Sanhedriumi (kuvendi i lartë). Hebrejtë ishin vendosur në vende të ndryshme të perandorisë dhe përdornin gjuhët romake dhe greke. Për pelegrinët që vinin nga provinca (nga jashtë) dhe që nuk dinin gjuhën arameje, në Jerusalem kishte sinagoga të posaçme hebraike. Gjuhë administrative ishte latinishtja. Shumica e hebrenjve të asaj kohe për shkak të profesionit dhe tregtisë e flisnin gjuhën greke. Kurse që nga viti 250 gjuhë e popullit ishte gjuha arameje. Ibranishtja përdorej vetëm në adhurim në sinagoga dhe në Tora . Edhe Jezusi si shumë hebrenj të asaj kohe dinte së paku tre gjuhë.

Kurse disa grupe nga masa e popullit besojnë në lirinë politike 1000 vjeçare që do të sjellë Krishti dhe presin periudhën e paqes që do të vijë. Gjithashtu, në kohën e Jezusit, një ushtri nacionale, politike dëshironte të bëjë kryengritje kundër sundimit të huaj të Romës. Pas vdekjes së prefektit të Romës, Herodosit e deri në shkatërrimin e Jerusalemit në vitin 66, ka dëshmi për kryengritje të shpeshta të kësaj organizate të quajtur Zelot. Në mesin e nxënësve të Jezusit gjendet edhe njëri me emrin Simon që është anëtar i partisë revolucionare.

Ndërkaq grupet fetare të njohura të asaj kohe janë: saddukitët, farizitët, essenitët. Saddukitët i takonin shtresës së pasur dominuese, kundërshtonin çdo risi, kurse shkrimet që llogariteshin të shenjta, përveç Dhiatës së Vjetër, nuk i pranonin. Gjithashtu me pretekst se çështjet si ringjallja, bota e ardhshme, besimi në caktimin e Zotit, nuk kanë argumente të mjaftueshme dhe nuk mund të vërtetohen, nuk i pranonin. Ndërkaq, farizitët, mbrojnë mendimin se krabas Dhiatës së Vjetër, të vërteta janë edhe transmetimet gojore, dhe se gjithashtu legjitime janë edhe rregullat për të ndaluarën në jetën e përditshme. Këta nuk janë përfaqësues vetëm të përparimit fetar por edhe të fetarisë së vërtetë. Ndërkaq grupi ekstrem i farizitëve janë essenitët. Këta jetojnë në manastire të vogëla. Për t'u mbajtur rregullave të pastërtisë ashtu si është e nevojshme, ata, duke u larguar nga hebrenjtë e tjerë, janë tërhequr në fshatra. Ata mendojnë të marrin pjesë në shtetin hyjnor të Krishtit, që do të vijë si rezultat i lidhjeve vëllazërore dhe dashurisë mes tyre. Krahas rrymave me peshë

³⁴⁹ Stephan Teplan, *Christen in der Türkei*, Weltbild (30 janar 1998) Nr. 3. Sipas kësaj gazete supozohet se ka afër 30.000 simpatizues katolikë, 1.000 protestantë, 15.000 syrianitë, 60.000 ermenë, 3.000 ortodoksë grekë, 1.000 të Kishës së Lirë.

fetare, kishte edhe rryma mesianike që u jepnin përparësi ndjenjave nacionaliste. Koha kur Jezusi vazhonte me kumtimin e shpalljes, ishte përplot me synime kryengritëse të pjesëtarëve të rrymës të quajtur zelotët. Historiani Jozefus, duke i vlerësuar këto si të gabuara, ai këtë e shpalli si kryengritje hajdutësh (kucarësh). Pretendimet e tyre ishin pastër për mesianizëm. Ishin përgëzues të periudhës së re. Profetët Zakaria/Zekerija dhe Gjoni/Jahja, të cilët Kur'ani i ka përmendur me lëndata, janë të ngjashëm me këta përgëzues.

1. Zakaria

Zakaria/Zekerija ka jetuar si mistik në tempullin e Jerusalemit në shek. I. të e.s. Kur'ani tregon se ai është njëri prej profetëve, i dërguar te hebrejt. Ai nga hebrejtë nuk pranohet si profet. Ai është babai i profetit Jahja/Gjon Pagëzori. Kur ai ishte në moshë Zoti ia ka dhuruar Gjonin.³⁵⁰ Sipas legendës, edhe pse duke ikur nga prefekti i Palestinës, Herodesi, Zakaria fshibet në lëvoren e një druri, ushtarët e Herodesit e gjejnë dhe e ndajnë në dysh bashkë me drurin dhe kështu ai vritet. Vendi i varrit të tij është në Haleb. Libri i Zakarias, që është i futur në Dhiatën e Vjetër nga të krishterët, mban emrin e tij. Ai ishte edukatori dhe burri i tezesë së Marias. (Shih, Dhiata e Vjetër, Libri i Zakarias).

2. Gjoni

Gjoni/Jahja është biri i Zakarias dhe gruas së tij Elizabetës. Sipas hebrejve profecia e tij nuk pranohet. Sipas të krishterëve dhe muslimanëve ai fuqimisht i është përqendruar Dhiatës së Vjetër dhe qysh në moshën fëmijërore Zoti atij i ka dhuruar urtësi.³⁵¹ Atij i ka dhënë këshilla për të udhëzuar Bijtë e Izraelit. Ai për të vazhduar jetën me devotshmëri në të shumtën e rasteve ka preferuar të jetojë në shkretëtirë pa gjumë. Ishte bashkëkohës i Jezusit/Isait. Në vitet 28 të e.s., ai ende ka jetuar. Sipas njoftimeve krishtere, ai kur e ka parë Jezusin e ka kuptuar detyrën në të ardhmen dhe se ai është Mesia i pritur. Ai e ka pagëzuar Jezusin në lumin Jordan. Por ai ra dëshmor duke ia prerë kokën për shkak se fliste për ardhmërinë, për shkak të qëndrimeve të tij ndaj administratës dhe për shkak të kundërshtimit të martesës të Herodesit me vajzën e gruas së tij. Transmetohet se varri i tij është në Samara. Ai për shkak se njerëzit i thërriste të pagëzohen, në mesin e të krishterëve përmendet me emrin Gjon Pagëzori. Ai ka lajmëruar për botën e ardhshme dhe ringjalljen e afërt, ka porositur që populli të pendohet dhe i ka pagëzuar ata. Me një shprehje islame Jahja njerëzit i ka çuar të lajnë trupin dhe të pastrohen shpirtërisht.

Misioni i Gjonit nuk ishte i ndarë nga mesianizmi. Ai ishte i gjallë në vitin 15 të Tiberiusit, gjegjësisht në vitin 28 të e.s. Ai, sikur essentët, është larguar nga kultura helene e qytetit. Ai shpalli ditën e afruar të Zotit. Dita e madhe do të vijë vetvetiu. Mesia do ta vazhdojë misionin e tij sundues, do ta ndajë kallirin nga kashta. Zgjidhje e vetme përpara ditës së frikshme që mund të komentohet si lloj gjykimi dhe ringjalljeje, është pendimi dhe pagëzimi. Ai thoshte se unë pagëztoj me ujë, kurse ai do të pagëztoj me zjarr, kështu që ai përgëzon për pritjen e afruar të hebrejve për ripërtërirjen e botës me një zjarr. Kur'ani tregon se (Ali Imran, 39) edhe babai i tij, Zekerija ka ditur se i biri do të jetë përgëzues i peygamberisë së Isait.

Pagëzimi i Gjonit ishte një lloj dushi, e cila bëhej për pendim dhe faljen e gabimeve, por ishte ndryshe nga ai i banjës që bën sot një idhujtar që pranon hebraizmin. Ajo nuk është as një punë magjike e as një punë simbolike. Ajo është një marrëveshje mes Zotit dhe njeriut, e cila në të ardhmen do të ketë ndjesë ndaj mëkateve. Bashkësia e tij qubej nasuritët. Për shkak të dbunës dhe të ngatërresave në rajonin e Palestinës kanë qenë të detyruar të braktisin shtetin e tyre. Më vonë këta dolën në skenën historike në Mesopotami dhe në vende të tjera me emrin sabiitë.

³⁵⁰ Kur'ani, Ali Imran, 38-41; Merjem, 5-11; Enbija, 90.

³⁵¹ Kur'ani, Merjem, 3-11; *Ibrani Incili*, (përkth. Ekrem Sankçioğlu), 19 Mayıs Üniversitesi, *Türkiye I. Dinler Tarihi Sempozyumu*, Samsun 1994.

3. Jezusi³⁵²

Jezusi/Isai, i cili vlerësohet themelues i krishterimit, ka lindur në një familje hebraike në qytetin Nazaret të Palestinës, në kohën e Herodesit, prefektit të Romës, respektivisht në fillim të kalendarit të cilin sot e përdorin shumë shtete në botë. Sipas Librave të Shenjtë, nëna e tij Maria/Merjemja, ka lindur prej një njeriu të mirë me emrin Imran dhe gruas së tij Hanna, të dy bij të Izraelit të moshuar. Emri Imran është edhe emri i një sureje në Kur'an. Kjo familje, e cila në rininë e saj nuk ka patur fëmijë, fëmijët e tyre, para se të lindin ata për falënderim Zotit, ia kanë premtuar tempullit. Edhe pse Hanna, e cila kur e sheh se fëmiju që lind është vajzë thotë, vajza nuk është si djali dhe mërçizet pak për realizimin e premtimit të dhënë, por, kur fëmiju me emrin Maria kalon fëmijërinë, për t'u bërë murgeshë e dburon në Tempull. Zakaria, burri i tezesë së Marias, interesohet për nevojat dhe edukimin e fëmijës.³⁵³ Kur Maria arrinë moshën e pjekurisë aktualizohet diskutimi se kush do të jetë mbikqyrësi i saj. Për zgjidhjen e diskutimeve u hodh short, dhe ky i ra marangozit Josef. Dhe kështu për Marian filloi të interesohet marangozi Josef, që njëkohësisht është edhe djali i xhaxhait të Marias. Sipas Ungjillit të Jakobit, që sipas të krishterëve të sotëm llogaritet apokrif, Maria në moshën 16 vjeçare kur shkon të nxjerrë ujë nga bunari, dëgjon një zë nga bota e fshehtë, që thotë: Të përsbëndes ty që ke gjetur mirësi, ti që në mesin e grave ke gjetur bollëk, Zoti qoftë me ty! Kur ka shikuar rreth saj nuk ka parë askënd. E frikësuar hynë në shtëpinë e saj; pas një kohe përpara saj paraqitet një engjëll dhe duke i treguar se do të mbetej me barrë, i thotë: "Fuqia e Zotit do të të marrë ty nën hije".³⁵⁴ Pas një kohe mbikqyrësi i Marias, djali i axhës, marangozi moshatar Jozefi, e beton shtatzëninë e saj. Ai për situatën flet me të, por, fjalët e Marias atë nuk e kënaqin. Të nesërmen, edhe pse dëshiron që këtë t'ua tregojë të afërmeve të tij, ëndërra që e kishte parë atë natë e kthen nga ky mendim. Ai (Josefi) për të mbrojtur nderin e familjes vendos që të fejobet dhe të martohet me të (Marian).³⁵⁵ Kur afrohet koha e lindjes së fëmijës, edhe për Jezusin thuheshin profeci të fallxhorëve, se do të lindë një fëmijë i cili do t'i japë fund dominimit të sundimtarit që shpjegohet për Abrahamin dhe Moisiun. Për të mbrojtur fëmijën që lindë nga rreziku i vdekjes, Josefi dhe Maria të inspiruar nisen për në Egjipt. Fëmija lindë gjatë rrugës në një abur, ku familja ishin strehuar për të kaluar natën.

Për shkak të shndërrimit nga mrekullitë e rrethit ku lindi Jezusi, barinjët që në errësirën e natës e shohin këtë vrapojnë drejt aburit që shkëlqen ku e shohin Jezusin fëmijë të shtrirë në graxhdin e kafshëve. Fëmijën e përsbëndesin dhe e falenderojnë Zotin.³⁵⁶ Gjithashtu tregohet se edhe tre njerëz të mençur (të urtë) duke i ndjekur yjet e gjejnë foshnjën dhe e respektojnë atë. Pas përfundimit të kohës së pastrimit, fëmija, për synetim dhe për t'u sakrifikuar për të, dërgohet në Jerusalem, bëhet synet në Tempull dhe gjithashtu shpjegohet se, një njeri i urtë me emrin Simeon ia ka njohur ardhmërinë fëmijës dhe ka thënë fjalë lavdëruese për të.³⁵⁷

Më vonë familja shkoi në Egjipt dhe për një kohë qëndroi atje. Pas vdekjes së prefektit Herodes dhe kalimit të rrezikut ata kthehen në Nasara të Palestinës.³⁵⁸ Kur në rrugë ballafaqohet me nevojën e pijes dhe ushqimit, si mrekulli afër tyre paraqitet një dru me fruta të freskëta burmashe dhe një lumë dhe kështu u plotësohen nevojat.³⁵⁹

Për shkak të njoftimeve se, Maria para se të martohet me Josefin, ka qenë me barrë në Jezusin, shumica e fraksioneve të sotme, Josefin nuk e shohin si baba biologjik të tij.³⁶⁰ Sipas Ungjillit të Markut, Jezusi ka patur katër vëllezër, së paku dy apo tre motra: "A nuk është ky biri i Marisë dhe vëlla i Jakobit, i Jozefit, i Judës dhe i Simonit? Vëllezërit e tij a nuk janë këtu me ne?" (Marku, VI, 3). Sipas Gjonit, këta që përmenden më lartë nuk janë vëllezërit (motrat) e Jezusit, por janë djemtë e axhës (hallës, tejes, dajës) së tij. Vetëm se në lidhje me këtë çështje në mesin e fraksioneve ka mendime të ndryshme. Fraksioni protestan këtë martesë e quan të vërtetë dhe baba të Jezusit e konsideron Josefin, kurse fraksioni katolik mbron mendimin se kjo martesë është një formalitet. Josefi dhe Maria kanë jetuar në një

³⁵² Kur do të bëhet fjalë në krishterim/katolicizëm do të përdorim emrin Jezus, pasi ortodoksë shqiptarë përdorin emrin Isui. Ndërkaq kur do të bëhet fjalë në islam do të përdorim emrin Isai. (Shënim i përkthyesit).

³⁵³ Yakub Incili, (përkth. Ekrem Sarıkoçlu), I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu, 24-25 Shtator 1992, Samsun, f. 9-14; Kur'ani, Ali Imran, 35-44.

³⁵⁴ Yakub Incili, XI, 3; Luka, I., 27-38.

³⁵⁵ Yakub Incili, XII-XVIII; Mateu, I., 19-23; Luka, I., 27-38.

³⁵⁶ Luka, II., 15-21.

³⁵⁷ Luka, II., 25-35.

³⁵⁸ Mateu, II.

³⁵⁹ İbrani Tomas Incili, XX.; I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu, 1992; Kur'ani, Merjem, 24-26.

³⁶⁰ Mateu, I., 18-20.

shtëpi si vëlla e motër dhe se vëllezërit dhe motrat që i përshkruhen Jezusit, janë vëllezër dhe motra shpirtërorë. Kur'ani për lindjen e Isait/Jezusit, paralel me mendimin katolik, thotë se ai është krijuar në Merjemen/Marian pa baba, dhe se ajo është një grua e ndershme; dhe thotë se për Krijuesin, krabas krijimit të Ademit pa baba dhe nënë, është shumë lehtë të krijojë vetëm pa baba.³⁶¹ Por për martesën e saj, pas mbetjes me barrë në Jezusit, dhe për vëllezërit e tjerë të tij, nuk shpreh ndonjë mendim pozitiv apo negativ.

Një pjesë e njohurive që lajmëron Kur'ani për Merjemen dhe Isain nuk gjenden në ungjijtë zyrtarë, që llogariten të vërtetë nga ana e të krishterëve. Disa nga këto lajme gjenden në ungjijtë hebraikë të Jakobit dhe Thomasit, të cilët kisha i llogarit apokrifë.³⁶² Perëndimorët këtyre iu thonë “ungjijtë për fëmijë”; deri sot është arritur deri te një numër i vogël i këtyre ekzemplarëve.

Për rininë e Jezusit dhe edukimin e tij nuk ka njohuri as në ungjijtë e as në burime të tjera. Lajmi i parë është se ai kur ka arritur moshën 12 vjeçare bashkë me familjen e tij për festën e Pashkëve shkon në Jerusalem; një kohë qëndron atje, kur vjen koha të kthehen Jezusit nuk mund ta gjejnë. E kërkojnë por, atë e gjejnë pas tre ditësh në tempull duke diskutuar me murgjit.³⁶³ Në ungjillin hebraik të Tomasit ka edhe disa mrekulli, një pjesë e të cilave sinjalizohen edhe në Kur'an. Për shembull, shpjegohet se ai në moshën 5 vjeçare ka qenë duke luajtur me dhe afër një përroi, por, për shkak se ajo ditë ishte e shtunë, murgjit ishin ankuar te babai i tij Josefi. Për këtë Josefi vjen afër fëmijës të tij dhe e qorton. Jezusi harabelave prej dheu u tha “shkoni” dhe ata u shndërruan në zogj të gjallë dhe duke cicëruar fluturuan kurse njerëzit rreth e përqark tij mbetën të habitur.³⁶⁴ Gjithashtu tregon se ai që në moshën 5 vjeçare është futur në diskutime që i ka habitur edhe mësuesit më të njohur të rrethit³⁶⁵, i ka rringjallur të vdekurit në fëmijëri dhe i ka shëruar të verbërit dhe ata me sëmundje hemoragjike.³⁶⁶ Në mesin e ungjijve për këtë çështje nuk ka pajtueshmëri të plotë.

Grupi i dytë i lajmeve në Ungjill është skena e pagëzimit, respektivisht kontakti i Jezusit me Gjonin.³⁶⁷ Sipas transmetimit të ungjijve, gjatë pagëzimit vjen Shpirti i Shenjtë në formë të pëllumbit dhe vendoset mbi kokën e tij, po në atë moment është dëgjuar një zë nga qielli: “Ky është biri im i dashur, i zgjedhuri im”. Gjithashtu, edhe “Gjoni kërkoi t'ia kthejë mendjen dhe i tha: Unë duhet të pagëzohem prej teje, e jo anasjelltas!” Dhe ka thënë se ai është Mesia i pritur.³⁶⁸ Kjo ngjarje ka luajtur rolin kryesor në lindjen e vetedijes mesianike të Jezu Krishtit.

Misioni i Jezusit fillon pas burgosjes së Gjonit. Flamurin e misionit të tij e ngre si predikues nomad. Supozohet se në këtë kohë ka qenë në moshën 30 vjeçare. Edhe ai, si paraardhësi i tij, dëshironte që njerëzit të pendohen për mëkatet e tyre dhe mbretëria hyjnore, për të cilën besonte se do të themelohej në Kohën e Fundit, që së shpejti do të ndodhte, por lajmëronte se për të duhet bërë përgatitje.³⁶⁹ Bashkë me dishepujt, që ishin besnikët e tij, njerëzit i grumbullonte përreth vetes dhe u fliste për ditët e ardhshme. Për të shkruar shpalljen që iu shpallej atij, as vetë e as të tjerët nuk i urdhëronte që të kontribuojnë në këtë drejtim. Ai shprehej për respektim ndaj Dhiatës së Vjetër dhe nuk fliste për libër të ri. Në aspektin e adhurimit dhe sjelljes ishte plotësisht anëtar i një shoqërie hebraike. Në predikimet dhe sjelljet e tij theks të veçantë vinte mbi thellësinë etike dhe mbi shtetin hyjnor, që do të themelohej në të ardhmen. Kështu që atyre që pritnin mrekulli, ai u sillte prova si shërimi i sëmundjeve të përhapura në popull³⁷⁰, ngopja e një popullate të madhe me ushqim shumë të pakët.³⁷¹ Në lidhje me misionin e tij predikimi më i njohur është predikimi në Malin e Ullirit:

“Lum skamësit në frymë, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.

Lum ata që vajtojnë, sepse ata do të ngushëllohen.

Lum ata që janë zemërbutë, sepse ata do ta trashëgojnë tokën.

Lum ata që janë të uritur dhe të etur për drejtësi, sepse ata do të ngopen.

Lum ata që janë të mëshirshëm, sepse ata do të gjejnë mëshirë.

Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin Perëndinë.

³⁶¹ Kur'ani, Ali Imran, 56.

³⁶² Shih, *Huristyanlarda Çocukluk İncili*, I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu, Samsun 1992, f. 5-42.

³⁶³ *Lluka*, II, 41-52; *İbrani Tomas İncili*, (përkth. Ekrem Sarıçioğlu), XIX.

³⁶⁴ *İbrani Tomas İncili*, (përkth. Ekrem Sarıçioğlu), f. 25; Kur'ani, Ali Imran, 49.

³⁶⁵ Ali Imran, 46; *İbrani Tomas İncili*, III-VIII.

³⁶⁶ *İbrani Tomas İncili*, IX-X, XVII-XVIII; Kur'ani, Ali Imran, 49.

³⁶⁷ *Mateu*, III.

³⁶⁸ *Mateu*, III, 13-16; *Marku*, 19-11; *Lluka*, III, 21-22.

³⁶⁹ *Mateu*, IV, 17; *Marku*, I, 14.

³⁷⁰ *Mateu*, V.

³⁷¹ *Mateu*, XIV, 15-2.

Lum ata që përpigën për paqen, sepse ata do të quben bij të Perëndisë.

Lum ata që janë përndjekur për bir të drejtësisë, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.

Lum ju kur do t'ju shajnë dhe do t'ju përndjekin dhe, duke gënjyer, do të thonë të gjitha të zezat kundër jush, për shkakun tim.

Gëzobuni dhe ngazëllobuni, sepse shpërblimi juaj është i madh në qiej, sepse kështu i kanë përndjekur profetët që qenë para jush.

Ju jeni kripa e tokës; por në qoftë se kripa bëhet e amësht, me se mund ta rifitojë shijen? Nuk vlen për asgjë, veçse për t'u hedhur dhe ta shkelin njerëzit.

Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshehet..." (Mateu, V, 3-VI, 20).

Dëguesit e ligëratave të Jezusit dhe ndjekësit e tij shtobeshin çdo ditë. Praktikimi formal dhe tradicional i ligjit kritikohet dhe tërhiqet vëmendja për singëritetin dhe përmbajtjen shpirtërore. Këto tema, siç e shqetësonin Kuvendin e lartë hebraik (Sanhedrium) dhe diskutimin për themelimin së shpejti të mbretërisë hyjnore, e shqetësonin edhe prefektin e Romës. Kështu që për këtë brengosej edhe Sanhedriumi edhe Shteti. Misioni i Jezusit ishte i koncentruar mbi dy tema kryesore: mesianizmi dhe ligji.

a. Mesianizmi

Përmbajta kryesore e misionit të Jezusit ishte lajmi se sundimi i Mesias, i cili do të vijë me detyrë hyjnore, është në pritje përpara derës. Jezusi në sibariqin e tij thotë: "Lum për ata sy që shohin atë që shihni ju. Sepse juve t'ju them se shumë profetë dhe mbretër kanë patur dëshirë që të shohin atë që e shihni ju, por nuk mundën t'i shohin; dëshiruan t'i dëgjojnë, por nuk mundën t'i dëgjojnë". Atyre që e kundërshtonin u thoshte: "Unë me gishtin e Zotit i nxjerr xhinnët/demonët, kështu që Sundimi i Zotit ka arritur tek ju", dhe vetvetiu mundohet që me mrekulli ta mbrojë atë. Ai vetvetiu e tregonte se është Mesia i pritur dhe thoshte: "Dhe kush nuk rrëshqet nga unë, lum për të". Është e pamundur që vërtetësia historike e mrekullive, të përqendrohet në një vendim. Vetëm se lajmërimi i shpëtimtarit Jezus, për themelimin në të ardhmen, e shtetit të Mesias hyjnor, paraqet qëllimin final të misionit të tij.

Sipas Jezusit, ndryshimi i botës është detyrë e Zotit. Kurse detyra e Jezusit është sibariqimi për afrimin e shtetit hyjnor dhe Ditës së Llogarisë. Por detyra e tij nuk përfundonte me sibariq dhe me kumtim. Qenia e tij ishte një shenjë e Kobës së Fundit dhe një mjet i ditës së pritur. Për këtë ai me një grup të vogël shkoi në Jerusalem për të pastruar tempullin nga gjërat jo të shenjta. Prej atje i nxorri shitësit dhe hypësit. Gjithashtu, siç kuptohet nga transmetimet e komunitetit gjatë festimit me shokët e tij të Festës së Pashkëve, mbajti një predikim dhe lajmëroi se pashkën e ardhshme do ta festojnë së bashku në shtetin hyjnor.

Ç'ishte shteti dhe sundimi hyjnor? Ajo do të ishte fillimi i një jete madhështore në parajsë që do të vijë në Kohën e Fundit në të cilën pritet një ngjarje trishtuese, e cila do të zgjasë një mijë vjet. Së pari, do të realizohen shpresat e politikanëve nacionalistë hebraikë, do të shkatërrohen administrimet e huaja, do të ndërtohet mbretëria e Davidit dhe të gjithë hebrenjtë do të tubohen në tokën e shenjtë. Për këtë arsye, në shkrimet që tregojnë për Mesian dhe Kohën e Fundit, është krijuar një literaturë speciale që përshkruan aktivitetet e Mesias dhe ngjarjet mbinatyrore të Kobës së Fundit. Priten të ndodhin ngjarje mbinatyrore si ardhja e Mesias, ringjallja, nxjerrja e dhimbjes dhe e dëshirës për të keqen nga zemra e njerëzve, vënia e zemrave të reja të cilat i kanë premtuar profetët. Mbreti hyjnor, gjegjësisht Mesia do të sundojë botën, dëshira e tij do të jetë dëshirë e vetme dhe emri i tij do të jetë emër i vetëm. Kjo gjendje e botës së ndryshuar do të jetë një lloj fillimi i botës pa mëkate në parajsë.

Rryma të ndryshme ideologjike në mesin e hebrenjve, në kohën e Jezusit janë përzier njëra me tjetrën dhe është shumë vështirë që këto të veçohen. Nëse Jezusi flet për një sundim hyjnor që është në ardhje e sipër, ai këto i ka menduar bashkarisht. Por, ai nuk pranonte një ndarje dhe identifikim, siç është caktimi vendor dhe kohor. Ai lajmëronte se sundimi hyjnor do të vijë papritmas, si një kusar i natës, dhe se atë moment do ta përjetojnë edhe bashkëkohësit e tij. Por, asnjëra nga këto që pritej nuk mundi të realizohet. Sidomos, llogaritja e pritjes së komunitetit apostolik, se Jezusi do të vijë përsëri ende duke jetuar ata dhe se do t'i realizojë premtimet e dhëna, nuk dha rezultat. Apostulli Pjetri thotë: "U afrua fundi i çdo gjëje", Gjoni: "është ura e fundit", Pali: "Zoti është afër". Të gjithë këta gjatë tërë jetës së tyre punuan për t'i qetësuar dhe për t'iu dhënë shpresë komunitetit të tyre. Kështu që deri sot kaluan shumë kohë dhe nuk është bërë asnjë ndryshim. Jezusi, që ka zënë vend në zemrat e miliona njerëzve, që llogaritet dhe pritet si një individ që do të formojë shtetin hyjnor mesianik të përgëzuar, ende nuk është kthyer.

Muslimanët lajmet për "sundimin dhe shtetin hyjnor" të Isait/Jezusit, i kuptojnë si afrim i kësaj jete dhe kohës së fundit dhe si sibariqe për jetën e ahiretit. Në komentimin e përmbajtjes së temës në fjalë dallojnë nga të krishterët. Për disa transmetime në librat e hadithit, që tregojnë një paralelizëm me atë që tregohet në krishterim, është formuar bindja se

janë të dobëta dhe të shpikura. Ata para krijimit dhe ringjalljes, nuk pranojnë një sundim të pavdekshëm 1000 vjeçar të Mesias.

b. Ç'është e ligjit

Mateu, njëri prej shkrimtarëve të ungjillit, thotë një fjalë në vërtetësinë e së cilës nuk mund të dyshohet. Me siguri kjo fjalë, është e marrë nga përmbledhjet më të vjetëra të Jezusit: “Mos mendoni se erdha për të anuluar ligjin e Moisiut dhe udhëzimet e profetëve. Nuk erdha për t'i anuluar ato, por për t'i bërë realitet”.³⁷² Fati i kësaj fjale në kishën e vjetër u bë shumëdimensional. Mund të thuhet, pa mos anuar në ekstremizëm, e tërë historia e besimit krishter është ndërtuar mbi komentimin e kësaj fjale. Edhe kishat e vjetra janë munduar që këtë fjali ta kuptojnë. Dhe përveç *ebionitëve* askush tjetër nuk e ka praktikuar ligjin e Dhiatës së Vjetër. Marsioni me trimëri thotë se kjo fjali është gënjeshtër dhe nuk është fjalë e Jezusit.

Data e komentimit të kësaj fjalie është shumë me rëndësi, sepse, për t'u kuptuar se është apo nuk është legjitim ligji hebraik në kishën e Jezu Krishtit, varet krejt nga pranimi dhe të kuptuarit e plotë të kësaj fjalie. Është e mundshme që me këtë fjali krishterimi t'i lidhet hebraizmit. Kisha kësaj pyetjeje i ka gjetur një rrugë zgjidhjeje kaotike që çdo herë të jetë e vazhdueshme për të. Sipas kësaj Jezusi duke i shkurtuar ligjet e Dhiatës së Vjetër, i ka mbrojtur dhe i ka ripërtërirë ato. Ligjet e adhurimit dhe ceremonive rreth dhjetë urdhërave kanë vazhduar, kurse ligjet etike janë zhvilluar. Sipas asaj që u kuptua deri më tani krishterimi parimet e veta i ka të bazuara në qëndrimet e jo në fjalët e Jezusit.

Atëherë si duhej të kuptohet fjalia në Ungjillin e Mateut: “Por kam ardhur për t'i bërë realitet (ose plotësuar)”? A thua Jezusi me fjalën: “Në Dhiatën e Vjetër është thënë, por unë ju them që...”, nuk është kundër Moisiut? Ose mos vallë dëshiron të japë bazat e një ligji të ri? Apo mos dëshiron të tregojë vërtetësinë dhe pamundësinë e praktikimit të ligjeve të Dhiatës së Vjetër?

Përgjigjja parciale e pyetjes gjendet në predikimin në Malin e Ullirit: Ai dëshironte që dëgjuesve t'u mësojë dëshirat e Zotit dhe ligjet e Toras, që dihen më herët, t'i çojë në qëllimin kryesor të tyre. Qëllimi nuk ishte që ligjin ta shtrojë me shtesa të ndryshme e as që ta vështirësojë praktikimin e tij. Ai, përveç ligjeve të bëra shprehi në jetën e përditshme, dëshironte të tërheqë vëmendjen në dëshirat e vërteta të Zotit. Jezusi as ligjin e shtonte e as propozonte praktikë formale larg shpirtit.

Kur'ani e sqaron misionin e Isait në lidhje me ligjin, ndërkaq ai, Isai thotë: “Dhe (kam ardhur) që t'iu vërtetoj Tëvratin që e kemi para nesh, t'iu lejoj disa që iu ishin ndaluar juve...”.³⁷³ Ky ajet tregon se Isai dëshiron të lehtësojë vërtetësinë e shariatit dhe në vend të përmbajtjes së shariatit e shpjeguar në predikimin e malit, ka dashur të sjellë kualitet etik dhe sinjeritet, dhe gjithashtu ka theksuar se në vend të parimeve formale ligjore, duhet dhënë përparësi ndjenjës fetare që vjen nga brendësia, sinjeriteti dhe devotshmëria.

c. Misioni i Jezusit

Misioni i Jezusit është më tepër i orientuar për nga hebrenjtë. Edhe pse në disa raste realizonte disa dëshira të johebrenjve, qendra kryesore e shërbimit ishin hebrenjtë: “Zoti më dërgoi vetëm te kopeja e humbur, te populli izraelit”.³⁷⁴ Ai, për të siharuar shtetin hyjnor, apostujt i dërgonte vetëm te hebrenjtë dhe atyre ua tërhiqte vërejtjen duke u thënë: “Mos shkoni në rrugën e popujve dhe mos hyni në asnjërin nga qytetet e samirijve, por, më tepër shkoni te kopetë e humbura të shtëpisë së Izraelit dhe kur të shkoni predikoni se mbretëria e qiellit (shteti hyjnor) është afër”. Edhe njoftimet e ungjijve tregojnë se Jezusi gjatë tërë jetës ka mbetur në kufijtë hebraikë. Sipas të krishterëve të sotëm Jezusi, i ngritur në qiell, nxënësve të tij u ka shpallë që ata të predikojnë edhe në mes popujve të tjerë: “Dilni në mbarë botën dhe predikojuni lajmin e mirë të gjithë njerëzve”. (Marku, 16,15). Aksionet misionerike në mes idhujtarve kanë filluar pasi Pali ka

³⁷² Mateu, V, 17.

³⁷³ Kur'ani, Ali Imran, 50.

³⁷⁴ Mateu, Xv, 24; Të njëjtën gjë e vërteton edhe Kur'ani në Ali Imran, 49).

pranuar predikimet e Jezusit. Në fillim caku i parë ishin hebrenjtë, më vonë rëndësia e aksioneve misionerike u drejtua drejt përfitimt të hebrenjve në krishterim. Në këto momente iu dha vend edhe misionit idhujtar.

Sipas mendimit tonë, lëvizja e kufizuar e Jezusit në fillim ishte mbrojtja e komunitetit me bërthamë hebrenjtë, ndërsa më vonë duhet të jetë zgjerimi i rrethit misionerik rreth komunitetit qendror. Duhet të kishte shpresuar se misioni i tij më mirë mund të kuptohej në vetë popullin e tij. Përndryshe një i dërguar me obligim nga Zoti, nuk mund të bëjë dallim mes njerëzve. Ndërkaq Kur'ani thekson se detyrë e tij është, jo vetëm për një popull, për një fis, por është mision për tërë njerëzimin: *“Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t’ua publikoni atë njerëzve, e të mos e fshihni, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe.”* (Ali Imran, 187). Kjo i qartëson transmetimet dhe komentimet e kufizuara në fillim. Kur'ani, konceptin se Tevratit është vetëm për popullin hebre dhe mosvazhdimin e detyrës misionerike edhe për popujt tjerë, e kritikon. Ai tregon se versetet e përkufizuara në Inxhil, mund të vazhdojnë edhe për disa kushte speciale.

ç. Ndarja nga bota dhe vlerësimet

Edhe krabas ndalesës së të shtunës, shërimi i të sëmurëve dhe sinjalizimi i butësisë së ligjit në rast nevojë nga ana e Jezusit, do të thotë të jeshë kundër hebraizmit tradicional. Jezusi fliste kundër fetarisë formale, kurse ndaj kuvendit hebraik nuk kishte ndonjë konsideratë. Të tubuar rreth e përçark tij u predikonte, bënte komentime të reja. Këto qëndrime krijuan pakënaqësi në qarqet udhëbeqëse. Sidomos pretendimi për Mesia, edhe më tepër e rriti këtë pakënaqësi. Ende nuk kishte 2 apo 3 vjet që filloi misionin e tij, u kap dhe u pengua që të mos forcohej më tepër. Sipas transmetimeve ai u kap me ndihmën e njërit prej 12 apostujve të tij, Juda Iskarioti, dhe me vendim më të hershëm u gjykua në gjykatën e lartë hebraike. U dënua me varje. Për zbatimin e vendimit iu dorëzua prefektit të Romës, Pontius Pilatusit. Kështu që u ekzekutua në kryq bashkë me dy kusarë të dënuar po ashtu me ekzekutim.³⁷⁵ Këto skena në ungjijtë përsëkruben në mënyrë të hidhur.

Gjithashtu sipas përskrimeve të ungjijve, trupi i Jezusit të kryqëzuar u mor nga nëna dhe dishepujt e tij dhe u varros ditën e premte para mbrëmjes. Nëna dhe dishepujt ditën e shtunë e kalojnë të qetë. Kurse ditën e dielë në mëngjes kur shkojnë te varri për ta vizituar panë se varri ishte i hapur, pjesët e qefinit të hedhura rreth e përçark kurse trupi nuk ekzistonte. Duke kërkuar të brengosur trupin e tij, ai iu paraqit atyre dhe iu tha se do të shkojë pranë Zotit. Edhe në ditët e mëvonshme ka vazhduar t’iu shfaqet të afërmve dhe dishepujve të tij dhe u ka dhënë atyre mesazhe.³⁷⁶

Ndërkaq Kur'ani kumton se, Isai nuk është kryqëzuar e as është vrarë me torturë, por tradhtari i Isait është shndërruar në pamje të tij dhe është ekzekutuar me paramendimin se është vetë Isai.³⁷⁷ Gjithashtu ai tregon se Allahu xh.sh. Isain e ka ngritur pranë Vetës.³⁷⁸ Në anën tjetër Kur'ani thotë se ai ka vdekur.³⁷⁹ Transmetimet e zhvilluara në komentimet e reja të muslimanëve, që burojnë nga krishterimi, dhe tefsiret në lidhje me të, kanë nxjerrë në shesh mendime të reja. Ajetet në lidhje me “...Allahu e ngriti atë pranë Vetës...” dhe shprehja, “...dhe ditën kur do të ngrihet i gjallë...” në ajetin e sures Merjem, në vend që të komentohet në kontekst të asaj se Isai do të rringjallet, ato janë komentuar paralelisht me krishterimin, si rringjallje para ditës së kijametit. Edhe pse shprehja “ngritje pranë Zotit”, është përdorur edhe për Idrisin, Iljasin dhe për Jahjanë, askush nuk mbron mendimin se edhe këta peygamberë do të kthehen në

³⁷⁵ *Maten*, XXVI-XXVII; *Marku*, XV-XVI; *Lluka*, XXIII; *Gjoni*, XIX.

³⁷⁶ *Marku*, XVI; *Lluka*, XXIV; *Gjoni*, XX-XXI.

³⁷⁷ Kur'ani, Ali Imran, 55; Maide, 117.

³⁷⁸ Kur'ani, Nisa, 157-158.

³⁷⁹ Allahu Fuqiplotë në Kur'an thotë: *“O Isa, Unë po të marr ty, po të ngre tek Unë, po të shpëtoj prej atyre që nuk besuan...”* (Ali Imran, 55), *“... E pasi që më more Mua, ti ishe roje dhe dëshmues i tyre...”* (Maide, 117). Në lidhje me këto dy ajete kuranore në mesin e komentatorëve të Kur'anit ka dy lloje qasjesh. Një grup mendon se këto ajete tregojnë se Isai a.s. nuk ka vdekur por, është ngritur në qiell nga ana e Allahut dhe se prej shenjave të Kijametit është kthimi i tij përsëri në Tokë me lejen e Allahut, me të cilën edhe do të përfundojë edhe jeta e kësaj bote. Ky është edhe besimi i popullatës tonë në këto troje. Kurse sipas mendimit të dytë, që është një mendim që më shumë ekziston në mesin e dijetarëve islamë, Isain a.s. Allahu e ka vdekur dhe se ai më nuk do të kthehet në Tokë. Autori i librit që e keni në dorë mbron mendimin e dytë. (Shih, Elmalili M. Hamdi Yazir, *Hak Dini Kur'an Dili*, V. 2, Stamboll, (pa datë), f. 371-375; S. Ates, Vep. e cit., f. 49-56; *Tefsiru't-Taberi*, V. 2, Bejrut, 1994, f. 265). (Shënim i përkthyesit).

d. Jezusi hyjnor

Njoftimet e ungjijve se Jezusi, Marias i është dhuruar nëpërmjet “Shpirtit të Shenjtë”, mbetjen me barrë të Marias pa burrë (Mateu I, 18) dhe versetet për pagëzimin “...dhe ai pa Frymën e Perëndisë duke zbritur si një pëllumb e duke ardhur mbi të; dhe ja një zë nga qielli që tha: Ky është biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur.” (Mateu III, 16-17). “...dhe i tha: Nëse je Biri i Perëndisë, hidhu poshtë, sepse kështu është shkruar...” (Mateu IV, 3-6), gjithashtu edhe përshkrimi nga ana e apostujve të tij si hyjnor dhe lajmet për rringjallje pas vdekjes, kanë qenë shkak që disa fraksione Jezusin ta komentojnë dhe ta shohin si ekzistencë hyjnore. Fraksionet e sotme si katolicizmi, ortodoksizmi dhe protestantizmi atë e pranojnë si njëri nga tre personat hyjnorë që ka jetuar në botë në formë të njeriut. Për këtë në teologjinë krishtere ka lindur dega e shkencës e quajtur kristologji. Kjo mundohet ta qartësojë çështjen hyjnore dhe njerëzore të Jezusit dhe çështjen e marrëdhënieve të të dy substancave. Historia e besimit krishter është përplotë e mbushur me diskutime të këtij lloji. Sot mundohet që njëshmëria e Zotit të shpjegohet si inkarnacion i Zotit në Jezusin; Shpirti i Shenjtë si manifestim i forcës së Zotit.

4. Pritja e Mesias

Të krishterët, duke u bazuar në lajmet për rringjalljen e Jezusit pas vdekjes dhe për ngritjen e tij te Zoti, mendojnë dhe besojnë se ai është larguar pa mos e plotësuar detyrën e tij si Mesia dhe kështu që do të vijë përsëri dhe do ta themelojë shtetin hyjnor mesianik. Në fillim pritja ishte ditore, më vonë u bë javore dhe dita e dielë ishte ditë pritjeje. Pas kalimit të disa shekujve pritja (e Mesias) bëhej çdo vit në festën e Pashkëve. Kishat e mëdha datën e Pashkës së pritur ia kanë lënë Zotit, kurse rrymat e reja fetare për ardhjen e Jezusit supozojnë se do të realizohet në një kohë të afërt. Kur numrat e dhënë nuk realizohen, komuniteteve të ndryshme u bëhet e ditur se kjo për disa arsye është lënë për më vonë. Mundohen që të mbajnë gjallë pasionin e komuniteteve për “shtetin hyjnor”. Këto konceptione kanë ndikuar edhe tek muslimanët. Shprehjet kur’anore se Isai nuk është vrarë, se ai është ngritur te Zoti, me komentime dhe transmetime paralele me krishterimin, u janë përshtatur koncepteve krishtere. Këto komentime duke u bashkuar me konceptin për Mesian, janë zhvilluar në drejtim të asaj se Isai nuk ka vdekur, ai jeton në qiell, në Kohën e Fundit do të zbresë në botë nga minareja e bardhë në Siri, do të marrë pjesë në shtetin e formuar nga Mehdiu dhe do ta ndihmojë në veprimtarinë e tij. Nuk janë marrë në konsideratë shprehjet “Isai ka vdekur, por nuk është vrarë”, të caktuara në komentimin e ajeteve të sures Ali Imarn, 55 dhe Maide, 117, “O Isa, Unë po të marr ty (po të vdes), po të ngre tek Unë...”, “... E pasi që më more Mua, ti ishe roje dhe dëshmues i tyre...”, dhe kështu janë përhapur mendimet, sintezat ndikuese të krishterimit.³⁸¹

Jehona e shtetit hyjnor

Mosrealizimi i ngjarjeve të Kohës së Fundit dhe shtetit hyjnor, të lajmëruara nga Jezu Krishti dhe sihariqi i tij se dishepujt e tij do të shohin një gjë të tillë e demoralizoi komunitetin e parë. U dobësua bindja për realizimin e periudhës së lajmëruar në kohën e apostujve. Vetëm se lajmet për vdekjen dhe rringjalljen e Jezusit, vazhduan të komentohej në lidhje me Kohën e Fundit. Dita e parë e javës, e diela,

³⁸⁰ Kur’ani, Merjem, 15 dhe 33; Edhe pse në ajetin 15 flitet e njëjta për Jahjanë (a.s.), askush nuk mund të pretendojë se është ngritur në qiell.

³⁸¹ Hüseyin Atay, *Kur’an’a Göre Araştırmalar*, I, Ankara 1993, f. 49.

dita e ringjalljes, u pranuan si “*dita e Zotit*”. Gjithashtu edhe rikthimi i Jezusit dhe ndryshimet mbinatyrore priteshin ditën e diel. Siç është ringjallur Jezusi, ashtu edhe në një ditë të dielë të re do të kthehet, do të hapë periudhën e ngjarjeve mbinatyrore dhe do të fillojë një lloj jete e botës tjetër. Për këtë ceremonia e çdoditëshme “*gostia e Zotit*” do të lihet për ditën e Zotit (e diel). Kjo ceremoni konsiderohet si thirrje për rikthimin e Jezusit, si lutje dhe si festë e ribashkimit me komunitetin. Vetëm se, për shkak të zgjatjes së ditës së pritur, dita e kthimit të Jezusit u la për një ditë jave, për festën e Pashkëve. Deri në shekullin e III ekzistenca e këtij besimi është vërtetuar me fakte të gjalla. Si shenjë për ditën e pritur janë bërë edhe disa komentime. Shenjat e Kohës së Fundit, si grisja e perdes së Tempullit, tërmeti, hapja e varreve dhe ringjallja e të vdekurve, tregohet se do të ndodhin gjatë vdekjes së Jezusit dhe se atëherë është afruar edhe Gjykimi i Fundit.

Ngjarjet brengosëse, grisja e perdes së Tempullit, shkatërrimi i vendeve të shenja që kanë ndodhur për shkak të kryengritjeve hebraike, llogariteshin shenja të qarta të Kohës së Fundit. Por ringjallja ishte e ndërprerë. Shkruesit e Ungjillit, Nikodemusi, Kirili nga Jerusalemi dhe Epifaniusi, situatën e përshkruanin ende më të gjallë. Sipas tyre njerëzit e Jerusalemit që ende jetojnë kanë qenë dëshmitarë të ringjalljes dhe të ngritjes nga varri të të afërmëve të tyre të vdekur para 10-15 viteve, kështu që baballarët dhe vëllezërit e vdekur takohen me njëri-tjetrin nëpër sokakë dhe të habitur pyesin njëri-tjetrin: “*Ti a nuk je filani që e kemi varrosur këtu?*”. Në shekujt e mëvonshëm, disa shkrimtarë krishterë, si Amfilokius Ikoniumi, bashkë me ringjalljen e Jezusit përgënjeshtrojnë edhe ringjalljen gjenerale të shenjtorëve, kurse numrin e të ringjallurve e përkufizojnë me 500 persona.

Burimi i kësaj tollovie ishte në llogaritjen e kohës nga ana e Kishës sipas dëshmisë së Letrës së Bernabës, të shkruar në shekullin e II. Qysh në periudhën e parë teoria për kohën e hebrenjve ka qenë e pranuar nga të krishterët. Transmetimi se krijimi është bërë për gjashtë ditë në “*Zanafillë*” komentohet në atë mënyrë që mosha e Botës së Vjetër përkon me 6000 vjetë sipas llogarissë së kësaj bote. Kurse fillimi i 7000 vjetëshit pranohet me fillimin e shtetit hyjnor, e periudhës së mëshirës që do të fillojë me Mesian në Kohën e Fundit. Kjo llogari përfaqëson atë që Zoti botën e ka krijuar për 6 ditë, kurse ditën e shtatë ka pushuar. Pranimin e kësaj teorie e bën të domosdoshme ngjarja e pranimit pas krijimit të botës në 6000 vjetëshin, e krijimit të Jezusit që komentohet si shenjë e Kohës së Fundit. Adamantiusi, në 6000 vjetëshin nuk e pranon vdekjen por lindjen e Jezusit. Në fakt fundi i 6000 vjetëshit pranohet si fundi i botës. Vetëm se, vonesa me shekuj e periudhës së pritur, e bëri të pamundshëm futjen e vdekjes së Jezusit në 6000 vjetëshin.

Kjo çështje, qysh në kohën e apostujve e ka shqetësuar edhe komunitetin. Mosardhja e shtetit hyjnor të premtuar. Pali për të vdekurit, edhe pse janë pagëzuar, thotë se besimtarët e vdekur nuk do të dallojnë nga të gjallët, vetëm se ata deri në ditën e premtuar, e cila do të vijë së shpejti, do të presin në varret e tyre, kurse ditën kur do të vijë Jezusi ata do të ringjallen dhe do të jenë bashkë me të gjallët e tjerë.

Si përfundim janë paraqitur shumë mesia të rinj si Sositheusi, Simon Magusi, Judas Galileusi dhe Montanusi. Jeta e komunitetit u përzie shumë. Montanistët filluan të tubohen duke thënë, jo vetëm se është afruar fundi i botës, por ata lajmëronin se edhe Jerusalemi qiellor do të themelohet në Firikja. Ata u larguan nga familjet e tyre. Hippolitusi flet për dy mesia: njëri në Siri e tjetri në Pontus (Anadoli verior). Me nxitjen e tyre populli e braktisi fushën dhe punën e tij, pasurinë e shpërndau, u tërhoq në shkretëtirë dhe filloi të presë shtetin hyjnor. Sidomos etërit e kishës në predikimet e tyre thoshin: “*Nëse të thënnurat nuk realizohen, atëherë mos besoni më në Libër dhe zgjidhni rrugën që dëshironi?*”. Natyrisht si rezultat i këtyre fjalëve të guximshme një pjesë e komunitetit u nda, kurse populli i pashpresë thoshte: “*Ne këto i kemi dëgjuar në kohën e baballarëve tanë, shikoni ne u mplantëm por atje nuk ka asgjë nga premtimet?*”. Kurse disa të tjerë në formë tallëse thoshin: “*Ku janë ata që premtuan? Çdo gjë është e njëjtë qysh në kohën e baballarëve tanë?*”. Për këtë, për të ardhur ajo ditë u fillua të bëhet lutje nëpër kisha. Gradualisht u hoq dorë nga këto pritje dhe tema pashpresë. Por, në shek. III, kjo temë përsëri u ringjall nga ana e Montanusit nga Ferikja dhe nga ana e dy profetëve gra. U sihariqua se Mesia do të vijë së shpejti. Sipas kësaj, në një vend në Pepuza (Firikja), do të zbrësë *Jerusalemi Qiellor*. Montanusi menjëherë gjeti simpatizues dhe jehona e tij kumboi tërë kishën. Në fillim kjo lëvizje ishte ripërtëritja e bisedave dhe e pritjes së Gjykimit të Fundit në kishën e parë. Për të pritur datën e sihariquar populli filloi të bëjë një jetë asketike dhe më vonë kjo rrymë u bë fraksion. Montanusi, më vonë filloi të besojë se ai është Parakleti i sihariquar në Ungjillin e Gjonit. Edhe Tertuliani një afrikan i njohur në vitin 202, pesë vjet ka marrë pjesë në këtë lëvizje dhe ka

shërbyer për të. Si përfundim kisha u bind se duhen penguar këto lëvizjeve pa përgjegjësi. Edhe për këtë ai, në Dhiatën e Re, përveç shkrimeve të Gjonit që tregojnë për Kohën e Fundit, nuk futi asnjë shkrim tjetër profetësie.³⁸² Ata që u ndanë nga mendimi kishtar u fajësuan me herezi, u lanë jashtë kishës. Sot kishat e mëdha nuk qëndrojnë aq mbi këtë çështje. Kurse fraksionet dhe kishat e vogla si *dëshmitarët e Jebovait* etj. mundohen që temën ta gjallërojnë me tërë fuqinë që kanë.

5. Shkrimet e shenjta

Jezusi ka lindur dhe është rritur në komunitetin hebraik dhe, si një anëtar i këtij komuniteti, *Tanahin* (Dhiatën e Vjetër) e ka parë si libër të shenjtë dhe me interpretimet e tij është munduar që të përfitojë domethënie të thella. Burimi i predikimeve dhe i misionit të tij ka qenë Dhiata e Vjetër. Për këtë edhe sot pjesën e parë të shkrimeve të shenjta e përbën po ashtu Dhiata e Vjetër, kurse pjesën e dytë e përbën Dhiata e Re, e cila ka dalë në shesh pas vdekjes së Jezusit dhe përmban transmetimet në lidhje me Jezusin dhe predikimet e tij.

Jezusi, duke qenë gjallë, versetet e shpallura vetë nuk i ka shënuar askund e as që i ka urdhëruar të tjerët që t'i shënojnë. Ai i ka respektuar edhe librat e shpallura më herët, por ai ka qenë edhe reformator, mësues dhe komentator i librave të reja. Përndjekja dhe ekskomunikimi i dishepujve të tij nga ana e hebrenjve hapi rrugë që në komunitet të formohet një grup i ri. Ndërkaq gjykimi dhe kërkesa për ekzekutim të tij përgatiti terrenin që grupi i Jezu Krishtit të ndahet dhe të largohet tërësisht nga komuniteti hebraik. Regjistrimi i tregimeve jetike dhe predikimeve të Jezusit nga ana e mësuesve dhe anëtarëve të komunitetit të ri ka filluar në vitin 25-30 pas vdekjes së tij. Për regjistrimin kaq të vonë të tyre ka dy shkaqe: e para, ai, në kushtet e atëhershme nuk e ka gjetur momentin që t'i shkruajë vetë ose të tjerët; e dyta, mund të jetë edhe ajo se nuk e ka parë të nevojshme që të shkruajë e të lërë mbrapa diçka, pasi shpresonin se së shpejti do të formohej *shteti i pritur mesianik*. Ndërkaq edhe dishepujt e tij me shpresa se së shpejti do të kthehet mësuesi i tyre, nuk e kanë ndier të nevojshme që mësuesin e tyre ta shpjegojnë me shkrim. Ata kanë preferuar që fëmijëve dhe anëtarëve të komunitetit të ri, që dëshirojnë të mësojnë për Jezusin dhe mësime të tij, kujtimet dhe atë që kanë dëgjuar nga ai, t'ua mësojnë gojarisht.

Moskthimi i Jezusit, fillimi i vdekjes së të pagëzuarve në komunitet dhe pakësimi i dëshmitarëve të gjallë, i nxiti në lëvizje udhëheqësit e komunitetit dhe kështu në vende dhe rajone të ndryshme filloi shkrimi i broshurave për shpjegimin e predikimeve të Jezusit. Shkrimtarët pa përjashtim kanë qenë o ata të cilët e kanë parë Jezusin, si apostujt, o kanë qenë dishepujt që përbëjnë gjeneratën e parë pas tyre, si pasuesit. Të krishterët nuk pretendojnë se të gjithë shkrimtarët e Dhiatës së Re kanë qenë dëshmitarë të eksperiencës jetike të Jezusit. Shkruesit e Dhiatës së Re nuk i llogaritin as si “profetë”, vetëm se i pranojnë se i kanë shkruar me inspirim nga ana e Zotit.³⁸³ Këtyre u thuhet ungjij dhe letra të apostujve. Në arabisht përdoret fjala *inxhil*, që ka kuptimin *sibariq, lajmi i mirë*. Ungjijtë para se të shkruhen, një kohë janë transmetuar gojarisht. Me kalimin e kohës, rritja e komunitetit të Jezu Krishtit, dalja në shesh e ndarjeve të mendimeve dhe zakoneve të reja, hapi rrugën që komunitetet e reja të regjistrohen dhe të tubohen rreth ungjijve dhe letrave të të mëdhenjve të tyre. Kështu që u paraqitën letra dhe ungjij që reflektonin mendimet dhe besimin e komunitetit të vet.

Këtu dua të theksoj edhe këtë çështje: “*Të krishterët nuk mbrojnë mendimin se Jezusi ka sjellë një libër, një Ungjill*”.³⁸⁴ Për këtë çështje ata mendojnë ndryshe nga muslimanët. *Sipas tyre Jezusi është fjalë e Zotit*, i mbështjellur me eshtra dhe mish dhe i bërë njeri në trupin e Marias. Megjithatë ai është shpallje e Zotit njerëzve. Shpallja e Moisiut është shndërruar në “*Librin e Dhiatës së Vjetër*”, kurse në krishterim shpallja është shndërruar në personin e Jezusit. Mesazhi i shpalljes janë jeta dhe predikimet e Jezusit. Librin që e posedojmë me emrin Ungjill nuk llogaritet shpallja e Zotit dërguar Jezusit, sikurse e pranojnë

³⁸² Më gjërësisht shih, Martin Werner, *Die Entstehung des Christlichen Dogmas*, botim 2, Tubingan, f. 61-79, 83-105.

³⁸³ Michel, f. 32.

³⁸⁴ Michel, f. 39.

muslimanët inxhilin e shpallur nga Zoti Isait. Ato janë shënimet e atyre që kanë parë dhe dëgjuar dishepujt e periudhës së parë. Ndoshta për shkak të asaj që komuniteti rreth viteve 60-150 u drejtohen shkruarve të Ungjillit duke u thënë ”*neve na shpjegoni Jezusin dhe ngjarjet për të*”, ata (shkruarët) i kanë shkruar dhe tubuar lajmet dhe transmetimet e thëna deri në kohën e tyre. Ata sikurse kanë besuar vetë ashtu i kanë shkruar dhe shpjeguar ato ngjarje. Ato nuk janë shpallje në kuptimin islam. Megjithatë, të krishterët besojnë se shkruarët e Ungjillit kanë qenë në mbrojtjen dhe dhuntinë e Zotit dhe Shpirtit të Shenjtë, dhe se ajo që është shkruar u është shpallur atyre.

Në shek. II përgatitja nga ana e Marsionit, njërit nga të mëdhenjtë e kishës, e një përmbledhjeje shkrimesh të shenjta që reflekton mendimet speciale të tij dhe shpallja nga ai, është shpikje e letrave nga Ungjilli. Kjo çështje kishën romake e aktivizoi. Marsionin e komunikoi si heretik dhe vetë ajo, letrat dhe ungjijtë që përbënin mendimet e fraksioneve të ndryshme, ndjeu nevojën t’i vlerësojë dhe t’i ndajë në “*të vërteta dhe apokrifë*” (kanonike dhe apokrif).

Këto, qysh në shek. III janë katër ungjij dhe 27 fletushka ose letra të shkruara në greqisht. Kisha këto i pranon si të “*ardhura nga apostujt dhe si të vërteta*”. Këto shkrime i përbëjnë katër ungjijtë: i Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit. Krahas ndryshimeve të shumta, tre të parët janë të ngjashëm në çështje kryesore. Për këtë, tre ungjijve të parë që në vitin 150 u thuhet *ungjij sinoptikë*. Nga studimi dhe renditja e tekstit është e caktuar se Ungjilli i Markut është burimi i Ungjillit të Mateut dhe të Lukës dhe se këta të tre bazohen në një burim të panjohur, i cili përfshin fjalët e Jezusit. Këta tre ungjij sinoptikë, në aspektin kohor janë para Ungjillit të katërt të Gjonit. Këtë e tregojnë gjuha dhe krahasimet përmbajtësore. Por të gjithë janë shkruar shumë vonë dhe kjo kuptohet nga lajmet që na japin, gjeneratat dhe fatkeqësitë që i përmendin. Kurse përmbajtjet historike janë zhdukur që në kohët e para. Lajmet e dhëna bazohen në transmetimet gojore, të përzgjedhura nga dishepujt e Jezusit.

Ungjijtë, në aspektin burimor, nuk mund të krahasohen as me tregimet moderne e as me ata të periudhës së vjetër. Shkrimtarët trimat e tyre i përshkruajnë ashtu si ata i mendojnë, si i kanë mësuar në studimet e tyre dhe ashtu si besojnë se ata janë. Në këtë aspekt, transmetimet nuk janë njohuri të dorës së parë, e as nuk janë tregime për jetën e Jezusit historik, e as janë ngjarje historike. Shkrimtarët e ungjijve sinoptikë, transmetimet që kanë arritur deri te ata, ku gjenden edhe fjalët e Jezusit, në tërësi i kanë bartë deri tek ne. Gjoni, duke punuar edhe individualisht mbi këto transmetime, Ungjillin e tij e ka përgatitur me interpretimet e tij.

a) Ungjilli i Markut; sipas mendimit të përgjithshëm të studiuesve të krishterë, është ungjilli i parë. Marku përafërsisht në vitet 63-70, para shkatërrimit të Tempullit, me dëshirën e besimtarëve romakë, Ungjillin e tij e shkruan greqisht. Emri i vërtetë i shkrimtarit është Gjon. Nuk ishte njëri nga apostujt, ai ishte anëtar i një familjeje hebraike. Njohurinë duhet ta kishte marrë nga apostujt. Duke e vazhduar misionin e tij në Egjipt, ai është vlarë nga intrigat e idhujtarëve. Bëhet e ditur se Marku bashkë me Pjetrin, që është njëri nga apostujt, nuk e kanë pranuar hyjninë e Jezusit.³⁸⁵ Supozohet se Mateu dhe Luka për të përgatitur ungjijtë e tyre kanë përdorur edhe Ungjillin e Markut. Krahas këtyre duhet që të gjendet një përmbledhje tjetër që përfshin fjalët e Jezusit. Edhe Luka e ka përdorur këtë burim, por ende deri më sot kjo çështje nuk është qartësuar. Sidomos, ai ungjill duhet të ketë edhe transmetime të posaçme.³⁸⁶

b) Mateu; është shkruar i Ungjillit dhe njëri nga 12 apostujt. Para se të bashkohet me Jezusin në qytetin Kafarnahum (në rajonin Xhelil) ishte tagrambledhës. Ai pasi u njoh me Jezusin nuk u nda më nga ai. Ai edhe pas vdekjes së Jezusit, për të përhapur fenë e Jezusit shëtiti nëpër shtete të ndryshme. Në vitet 62-70 vdes në Etiopi pas goditjes me një shtizë. Mendohet se Ungjillin e ka shkruar në sirianishte dhe ibranishte në vitet 60-ta, kurse ky Ungjill nga një i panjohur është përkthyer në greqisht.³⁸⁷ Ai tërheq vëmendjen me theksimin e asaj se Jezusi nuk ka ardhur për ta ngritur ligjin hyjnor, por për ta zhvilluar atë.

c) Luka; është shkruar i Ungjillit, kurse me profesion ka qenë mjek. Ai gjithashtu ka shkruar edhe librin e pestë të Dhiatës së Re, “Veprat e apostujve”. Besohet se këtë e ka shkruar në periudhën mes

³⁸⁵ Muhamed Ebu Zehra, *Hristijyanlık Üzerine Konferanslar*, Stamboll 1978; Şaban Kuzgun, *Dört İnciller Farklılıkları ve Çelişkileri*, Stamboll 1991, f. 146.

³⁸⁶ Eduard Schweizer, *Jesus Christus*, München-Hamburg 1968, f. 12.

³⁸⁷ Ebu Zehra, f. 73.

viteve 60-80, në gjuhën greke, për johebrenjtë. Për këtë, ai në shkrimet e tij paraqet tregime magjepsëse për politeistët. Ai ka qenë nga një familje me origjinë hebreje në Antaki. Bashkë me burimin special ai ka përdorur edhe dy ungjijtë para tij. Burimi më i rëndësishëm i tij ishte mësuesi Pal, i cili i ka ndihmuar atij. Ka të atillë që mendojnë se ai ka qenë romak.³⁸⁸

c) Ungjilli i Gjonit; dallon nga tre ungjijtë para tij. Ata përqendrohen mbi “*shtetin hynor*”, kurse Gjoni thekson hyjninë e Jezusit. Ka që mendojnë se shkrimtari i Ungjillit nuk është Gjoni apostull, por është filozofi Gjon, i cili ka jetuar në shek. II. Shkrimtari me ndikim neoplatonist Jezusin e identifikon me *logosin*. Mendohet se, Gjoni Ungjillin e ka shkruar në Efes ose në Antaki, në vitet 90-110.³⁸⁹ Vetëm se disa historianë janë të mendimit se asnjëri nga ungjijtë e lartpërmendur nuk kanë ekzistuar para shek.III. Për këta katër ungjij i pari flet Ariusi, në vitin 209 pas e. s. Më vonë Klemen Alexandrianusi (viti pas e.s. 216) thekson nevojën e pranimit të këtyre katër ungjijve.³⁹⁰

d) Letrat e apostujve; është pjesë e Biblës që pason pas katër ungjijve të Dhiatës së Re. Përbëhet prej 22 librave. E para është “Veprat e apostujve”, e cila i përshkruhet Lukës. Nga këto letra 14 janë të Palit, njëra është e Jakobit, e dyta e Pjetrit, e treta e Gjonit, kurse një tjetër është e Judas. Përveç këtyre 22 letrave, ka edhe një pjesë me emrin “Apokalipsi” (shpallja e Gjonit). Letrat në përgjithësi përmbajnë predikime dhe këshilla. Vetëm se, me këto në një mënyrë të vetëdijshme mundohet të theksohet hyjnia e Jezusit.

Në mesin e shkrimtarëve të letrave më tepër përmendet emri i Palit (Paulos), i cili përmendet në 12 letra. Ai është një person energjik dhe llogaritet atë i kishave të sotme. Ai ka lindur në një familje hebreje në Tarsus dhe është rritur në një rreth idhujtarësh. Në fillim ka qenë armik i Jezusit, pas vdekjes së Jezusit, me një vizion shndritës pranon misionin e tij. Me interpretimin që e ka bërë mbron hyjninë e Jezusit, kurse krishterimit i ka dhënë një dimension të ri. Mbron mendimin se, me vdekjen e Jezusit, ligji i Dhiatës Vjetër është deroguar si dëmshpërblim, ndërsa veten e ka vendosur në qendër të krishterimit.

Jakobi, njëri nga shkrimtarët e letrave, ka qenë i biri i peshkatarit Zebed, apostull dhe vëlla i Gjonit. Për shkak të hidhërimit të liderëve hebraikë me të, ai është vrarë duke u gurëzuar, në vitin 62 të e.s.

Jehuda; është Taddeusi, emri i të cilit përmendet në Ungjillin e Mateut. Është vëlla i vogël i Jakobit. Ai është vrarë në Irsan, ku ka shkuar si misionar.³⁹¹

Pjetri; emri i vërtetë i tij ka qenë Simon, kurse ka qenë njëri nga apostujt e Jezusit. Ai ka kaluar nga peshkataria në misionarizëm. Kurse në vitin 65 duke u kryqëzuar vritet në Romë. Njëri nga transmetimet është se Pjetri dhe nxënësi i tij Marku nuk i kanë pranuar pretenditet për hyjninë e Jezusit.³⁹²

Të krishterët, asnjërin nga ungjijtë nuk e pranojnë si shpallje të ardhur për Jezusin, deri sa ai ka qenë gjallë. Besohet se edhe letrat, bashkë me të gjitha shkrimet e Dhiatës së Re, janë të shkruar nga shkrimtarët me inspirimin e Jezusit dhe Shpirtit të Shenjtë. Zoti me këto shkrime e shpjegon veten dhe dëshirat e tij. Këtu inspirimi nuk është fjalë, fjali apo tekst, por është temë dhe përmbajtje.

Ungjijtë apokrifë

Përveç teksteve të përfshira në Dhiatën e Re dhe teksteve të llogaritura si të vërteta nga të krishterët, ka edhe disa letra dhe ungjij që llogariten si të shpikur dhe jo të vërtetë. Më të njohur nga këto janë Ungjilli i Ebionitëve, Ungjilli Hebraik dhe Ungjilli i Bernabës. Këta ungjij, përkundër krishterimit të sotëm, mbrojnë mendimin se Zoti është Një, se Jezusi është rob dhe i dërguari i Zotit dhe se ai nuk është Zot. Disa pjesë të Ungjillit të Ebionitëve kanë arritur deri më sot. Por me që nuk është i plotë është vështirë të bëhen shpjegime më të gjera për këtë çështje. Ungjilli i Bernabës që e

³⁸⁸ Kuzgun, f. 149.

³⁸⁹ Ebu Zehra, f. 85; Kuzgun, f. 150.

³⁹⁰ Ebu Zehra, f. 70.

³⁹¹ Ebu Zehra, f. 114.

³⁹² Ebu Zehra, f. 113.

posedojmë edhe sot, pas përkthimit në anglisht nga dy dijetarë anglezë, Lonsdale dhe Laura Ragg, në gjysmën e parë të shek. XX e këndeje, është shkak i studimeve dhe i diskutimeve të shumta.³⁹³ Ungjilli i Jakobit bazohet në vëllain e Jezusit, Jakobin, i cili është vlarë në vitet 63-66 nga ana e romakëve. Malli për fëmijë i babait Imran dhe nënës Hanna, fillon me lindjen e Marias. Tregimi për rritjen e Merjemes, dhënien e saj nën mbrojtjen e Zekerijasë (a.s.), shorti në mes djemve për t'u martuar me Merjemen, shansi që i bie Jusufit, mbetja me barrë nga Shpirti i Shenjtë dhe lindja e Isait, paralelisht dhe imtësisht shpjegohen në Kur'an në suren Ali Imran, 33-48 dhe Merjem, 2-35.³⁹⁴ Ungjilli i Tomasit hebre përmban fëmijërinë, mrekullitë e Jezusit dhe lajmet për Gjon Pagëzorin. Ky jep disa të dhëna paralele me atë që gjendet në suren Ali Imran dhe suren Merjem.³⁹⁵ Këtyre dy ungjijve sipas dijetarëve krishterë u thuhet, "Ungjijtë e fëmijërisë së Jezusit". Përveç Ungjillit të Tomasit hebre, ka edhe një tjetër me emrin Ungjilli i Tomasit. Ky është gjetur në Egjipt në vitin 1945. Ky ungjill transmeton disa fjalë të Jezusit.³⁹⁶ Ungjilli i Pjetrit është gjetur në Egjiptin e Epërm në vitin 1886-87.³⁹⁷ Ungjilli i Filipit është gjetur në Egjipt në mesin e literaturës *Nag Hammadi*. Ky ungjill përmban fjalë të Jezusit por nuk përmban tregime për jetën e tij. Aty veten e tregon ndikimi i mendimit gnostik.³⁹⁸

Në një paralelizëm të njëjtë, krahas letrave të Dhiatës së Re, që llogariten si të vërteta, gjenden edhe libra të përbërë prej letrave të Pjetrit, Palit, Gjonit dhe Andreasit. Këto i takojnë fundit të shek. II. Gjithashtu, përveç dy letrave të para të Klemensit dhe të Bernabës dhe dy letrave të tjera që i përshkruhen Palit, bëhet fjalë edhe për letra të tjera. Këto, për shkak se nuk kanë qenë të pranuar nga ana e komunitetit të parë krishter dhe nuk kanë qenë pjesë e Dhiatës së Re, edhe nga ana e të krishterëve të më vonshëm nuk kanë qenë të pranuar.³⁹⁹

6. Komuniteti i parë dhe fillimi i ndarjeve

Është më se e vërtetë se, Jezusi nuk ka ardhur për të formuar një fe të re, por kisha është një rezultat i jetës dhe sjelljeve të tij. Ai njerëzve u tregonte për shtetin hyjnor që së shpejti do të formohet. Dëgjuesit e parë të tij përbënin bërthamën e komunitetit të parë. Komuniteti i parë krishter ka qenë dëshmitar, duke besuar në ringjalljen e Jezusit pas vdekjes, i asaj se si ka lindur lëvizja e re për Mesian. Komuniteti i parë i Jerusalemit, i mbledhur nga rrethe të ndryshme, sipas të dhënave historike për apostujt, me zbritjen e Shpirtit të Shenjtë në festën e Pashkëve, ka filluar të flasë gjuhë të huaja. Kjo për këtë komunitet ishte shenjë se ata janë komuniteti i Kohës së Fundit. Në fakt, sipas pritjes së hebrenjve, ishte e premtuar zbritja e shpirtit Kohën e Fundit. Vetëm se dyshimi dhe refuzimi i hebrenjve u bë shkak që komuniteti i Jezusit të ndahet nga hebrenjtë dhe të formohet një kishë e pavarur. Më pastaj nga të krishterët e parë, Jezu Krishti i kryqëzuar dhe i ringjallur përsëri, bartet jashtë Palestinës, në të gjithë botën. Sapo kishin kaluar katër vjet pas vdekjes së Jezusit, pranimi i krishterimit nga Pali dhe bashkë me përfitim të forcës dhe lëvizjes së re që ia bëri ai komunitetit, u bë shkak i futjes së komentimeve dhe mendimeve të ndryshme në komunitetin krishter të sapolindur. Anëtarët e komunitetit, të ballafaquar me komentime të reja, u ndanë në dy mendime të ndryshme themelore. Kjo ishte një shenjë e ndarjes në dysh të komunitetit në të ardhmen.

Një periudhë e shkurtër kishte kaluar nga ndarja e Jezusit nga mesi i tyre ku, për të zhdukur shqetësimin brenda në komunitet dhe për të bërë rehabilitimin e tij, apostujt dhe të afërmit e Jezusit, në vitin 48-49 të e.s., u tubuan dhe ndjenë domosdoshmëri për diskutim. Kështu u mblodh koncili i njohur

³⁹³ Tomas Michel, *Hristiyan Tanrı Bilimine Giriş*, Stamboll 1992, f. 43; Poashtu shih, *Ungjilli i Bernabës*.

³⁹⁴ Yakub Incili, (përkth. Ekrem Sarıkçıoğlu), f. 6-22.

³⁹⁵ *İbrani Tomas İncili*, (përkth. Ekrem Sarıkçıoğlu), f. 23-42.

³⁹⁶ *Tomas İncili*, (përkth. Ekrem Sarıkçıoğlu), f. 13-25; *Thomas İncili* (përkth. Ergun Arıkdal) Stamboll 1988.

³⁹⁷ *Apokrif Petrus İncili*, (përkth. Ekrem Sarıkçıoğlu), 19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, nr. 7, Samsun 1993, f. 3-6.

³⁹⁸ *Filip İncili*, (përkth. Ekrem Sarıkçıoğlu), 19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, nr. 6, Samsun 1992, f. 1-20.

³⁹⁹ Michel, f. 42 dhe në vazhdim.

me emrin Koncili i Apostujve, ku edhe startoi diskutimi mes tyre. Ndarja dhe temat për diskutim u shtruan qartazi. Madje edhe nga letra e Palit dërguar korintasve kuptohet se në Galilea është formuar një grup i posaçëm i të krishterëve. Ka mundësi që në mes të atyre që janë të kthyer nga idhujtaria, qysh para Palit dhe të atyre që janë të kthyer nga hebraizmi, të kenë ndodhur disa ndarje në mendime. Sepse, sikur njerëz të një populli dhe besimi të pranonin krishterimin, duke u ndikuar nga konceptet e mëhershme të tyre të besimit dhe adhurimit, do të ishte normale që ata të jenë një tërësi mes tyre. Për t'i kuptuar më mirë mendimet e Kur'anit për qëllimin e ardhjes së Isait/Jezusit, është me rëndësi të theksohet se sa thellë kanë arritur këto ndarje dhe grupëzime dhe se çfarë janë ato në thelb. Në historinë e kishës krishtere kësaj çështjeje nuk i jepet shumë vend ose mundohet që të mbahet larg. Për këtë edhe studimet lidhur me këtë temë janë të kufizuara.

a. Problemet krishtere me origjinë idhujtare

Pali, një kundërshtar i vjetër i krishterimit, në vizionin e tij në rrugë për në Siri, brenda një mjegulle ka parë Jezusin dhe ka pranuar krishterimin. Kështu që veten e ndjente të obliguar ndaj Jezusit, për t'iu treguar idhujtarëve rrugën e shpëtimit. Ai përqëndrohej në problemet që do të lindnin me kalimin e idhujtarëve në krishterim. Gjithashtu edhe më herët, problemet që kanë lindur me kalimin e idhujtarëve në hebraizëm, janë diskutuar brenda hebraizmit. Çështja kryesore e një njeriu që kalon prej idhujtarie në hebraizëm, ka qenë se sa ai njeri është përgjegjës ndaj ligjeve të Moisiut. Të krishterët me origjinë hebraike rrugën e zgjedhur, që e dinin qysh më herët (siç ishte rasti me ata që kaluan nga idhujtaria në hebraizëm), e morën si shembull për vete. Nëse Pali nuk ndalej mbi këtë çështje, kjo do të ishte një rrugëdalje. Por, Pali, për dallim nga apostujt e tjerë, për ata që ishin kthyer nga idhujtaria refuzonte çdo lloj propozimi ligjor. Madje komuniteti Galatja kishte një mosmarrëveshje në lidhje me synetimin. Hebrejtë e vërtetë e mbronin mendimin se çdo i ardhur nga idhujtaria duhet të synetohet. Kurse Pali pretendonte se kjo do të thotë futje në zgjedhën e ligjit hebraik, ndërkaq do të ishte edhe në kundërshtim me qëllimin e dërgimit të Jezusit. Kjo çështje e ligjit në komunitetin e ri kishtar u bë shkëndija e parë e mosmarrëveshjes. Një pjesë duke e parë shpëtimit në besim dhe vepër (ligj) thoshin: *“të bërit synet është vula e anëtarësimit të Mesias”*. Në krye të mbrojtësve të këtij mendimi ishte apostulli Petrus dhe Jakobi, vëllai i Jezusit. Ndërkaq pjesa tjetër shpëtimit e shihnin vetëm në besim, kurse veprën e konsideronin si të panevojshme. Në fund, nëpërmjet koncilit, pas diskutimeve të shumta, u arrit një marrëveshje mes komuniteteve dhe, duke u pranuar që të kthyerit nga idhujtaria së paku t'u përshtaten ligjeve të Noahit, u mor vendimi se kanë mundësi të mos bëhen synet. Vetëm se, katër çështje në ligjin e Moisiut duhej t'i pranonin. Ato janë; mosgrënia e mishit të kafshës së therur për idhujt ose kafshës së ngordhur para therjes, mosmartesa me farefisën e afërt dhe të mos kihet marrëdhënie me gjallesat e llojeve të tjera. Ky ligj merrej nga versetet 17-18 të pjesës *“Levitët”* të Dhiatës së Vjetër. Por, mosbesimi, vjedhja, derdhja e gjakut dhe padrejtësia që janë nga burimet e ligjeve të Noahit, nuk përmenden në komunikatë. Këto duhej të shiheshin të natyrshme për t'iu përshtatur.⁴⁰⁰

Mosmarrëveshjet në të kuptuarit e termit apostull

Apostujt kanë ngrënë dhe kanë pirë bashkë me Jezusin dhe i kanë dëgjuar predikimet e tij. Jezusi vetë i ka zgjedhur apostujt, ndërkaq pas hyrjes së Palit në krishterim me interpretimet e reja të tij, në komunitet lindën ndarjet në mendime. Këtu diskutohet legjitimiteti i Palit si apostull. Sipas apostujve Jezusi ende duke qenë gjallë ata i ka zgjedhur si më të afërmit e tij. Edhe ata bashkë me mësuesin e tyre kanë ngrënë dhe kanë pirë dhe i kanë dëgjuar predikimet e tij. Kurse predikimet e Palit bazohen në vizionin e tij (një pamje në gjendje ekstaze). Edhe sikur të pranohet, ky ishte vetëm një takim me mësuesin e larguar nga bota. Ishte diçka si ëndërr. Ai nuk e ka parë Jezusin në këtë botë dhe nuk e ka njohur atë. Për këtë, në komunitetin e parë krishter çështja *apostolos* u bë shkak ndarjeje. Kur çdokush, sikur Pali, në çfarëdo kohe ta shpallë veten apostull, çfarë do të ishte kriteri për matjen e apostolizmit si

⁴⁰⁰ Schoeps, *Das Judenchristentum*, f. 22 dhe në vazhdim.

Mosmarrëveshjet në udhëheqësinë e komunitetit

Komuniteti apostolik, kur diskutonte për nevojën e udhëheqësisë së komunitetit, për administratën e një komuniteti, siç ishte personaliteti i Jezusit, Pali nuk e ndjente këtë nevojë. Pretendonte se udhëheqësinë e komunitetit do ta bëjë shpirti i Jezusit të ringjallur, kurse kontrollin e komunitetit ia linte shpirtit të Jezusit. Natyrisht ky mendim i Palit gjykohej nga apostujt dhe shihej i rrezikshëm për jetën e komunitetit. Për këtë, ata respektonin autoritetin shpirtëror të Jakobit, vëllait të Jezusit.

Dallimet në kungim

Komuniteti i Jerusalemit këtë traditë e vazhdon si kujtim të darkës së fundit të Jezusit. Pali kur ka hyrë në krishterim këtë praktikë e ka gjetur të gatshme. Por asaj i ka bërë një interpretim të ri. Bukën e përdorur në ceremoninë e kungimit e ka komentuar si mishi i Jezusit, ndërkaq alkoolin si gjakun e tij. Ai pretendonte se, pjesëmarrësi në sakramentin e komunione bashkohet me Jezusin edhe shpirtërisht edhe fizikisht. Ndërkaq sipas apostujve kjo është vetëm një përkujtim.

Dallimet në të kuptuarit e personalitetit të Jezusit

Apostujt Jezusin e shohin si hallka e fundit e zinxhirit të profetëve, kurse Pali mbron teorinë se nuk është një njeri normal, por është krijesa e parë e Zotit dhe djali i Tij. Për ata me origjinë hebraike ky pretendim është blasfemia dhe humbja më e madhe. Kurse për ata me origjinë idhujtare, të cilët ishin të lodhur me kulturë të vjetër greke dhe gnostike, kjo ishte natyrore dhe e përshtatshme për logjikën.⁴⁰²

Mosmarrëveshjet për qëllimin e ardhjes së Jezusit

Sipas Palit, Jezusi ka ardhur për ta ngritur ligjin hyjnor. Sepse ligji ishte burimi i mëkateve. Të mos ishte ligji, nuk do të ishte as mëkati. Zoti si shpagim të mëkatisht të përhershëm që daton prej Adamit dhe si shpagim për mëkatisht të tjera që kryhen për shkak të ligjit, birin e Tij e dërgon në botë dhe e sakrifikon. Me flijimin e Jezusit, mëkati i përhershëm dhe ligji janë ngritur. Në Periudhën e Mesias së Ri, i cili ringjallet pas vdekjes nuk ka ligj e as mëkat.

Kurse apostujt, përkundër Palit mbrojnë mendimin që shprehet në Ungjillin e Mateut, se Jezusi nuk ka ardhur për të ngritur ligjin, por për t'i plotësuar mungesat e tij.

Për këtë arsye zgjerohen dallimet mes të krishterëve me origjinë idhujtare të tubuar rreth Palit dhe të krishterëve me origjinë hebraike të tubuar rreth Jakobit, vëllait të Jezusit. Degët e komunitetit të ndarë në dy pjesë, zhvillohen vetvetiu dhe humnera mes grupeve arrin në një gjendje të pambuluar. Komunitetit në fjalë, që ishte i përbërë nga shumica e të krishterëve me origjinë hebraike dhe kryetari i të cilit është vëllai i Jezusit, Jakobi, në histori do t'i thuhet "*hebreo-krishterë*" ose "*ebionitët*". Vetëm se, pasi nuk mundi të zhvillohej sa duhej, gradualisht është zhdukur nga skena historike. Ky emër nuk simbolizon vetëm të krishterët me origjinë hebraike, por simbolizon një fraksion të vetëm. Kurse grupi i zgjeruar rreth Palit, çdo ditë rritej dhe është bërë bërthama dhe themeli i krishterimit të sotëm botëror.⁴⁰³

b. Hebreo-krishterët apo ebionitët

Me një shprehje më të gjerë, hebreo-krishterë janë të gjithë të krishterët me gjak hebraik. Por, ky emër, si definicion i një grupi apo fraksioni, ka kuptime të ndryshme. Qëllimi i këtij emri, krahas

⁴⁰¹ Schoeps, *Theologie und Geschichte des Judenchristentum*, Tübingen 1949, f. 71-146.

⁴⁰² Schoeps, *Judenchr.*, f. 53 dhe në vazhdim; Më gjërësisht shih, Schoeps, *Theologie und Geschichte des Judenchristentum*, f. 400.

⁴⁰³ Schoeps, *Judenchr.*, f. 63 dhe në vazhdim.

simpatizuesve të Palit, i cili është kthyer nga idhujtaria, është një grup i ndarë nga ata dhe përbën një grup me fat të posaçëm. Sidomos, nga kishat e ndërtuara mbi teologjinë e Palit janë fajësuar me herezi. Ky emër, nuk simbolizon më një grup me gjenezë hebraike, por një fraksion më vete. Ky emër nuk ka të bëjë me ata me gjenezë hebraike, të mbetur në Kishën e madhe. Këtyre u thuhet edhe ebionitë.

Epifaniusi, një historian i njohur i kishës, daljen e hebreo-krishterëve e daton me vitet e çlirimit të Jerusalemit. Ndërkaq, fillimin e saj e çon deri te komuniteti i parë i Jerusalemit, menjëherë pas vdekjes së Jezusit. Në tubimin gjeneral, të quajtur Koncili i Apostujve, në vitin 40/41 (48/49), mendimet që dalin në shesh për shkak të Palit paraqesin ekzistencën e një grupi hebreo-krishterë në komunitetin e parë. Këta mund të llogartien paraardhësit e ebionitëve, gjegjësisht të hebreo-krishterëve, të cilët më vonë, një kohë të shkurtër, do të shihen në skenën historike, sespe, ky grup Palin e ka fajësuar me herezi. Çështje diskutimi në Koncilin e Apostujve ka qenë respektimi apo mosrespektimi i traditave hebraike në komunitetin krishter, të atyre që konvertohen; sepse apostujt shpëtimin e kushtëzonin me veprën. Por, pikat e lëvizjes nuk u pranuan. Koncili ishte i detyruar që të tolerojë Palin dhe simpatizantët e tij. Jakobi ishte kryetar i komunitetit. Edhe pse nuk ishte i një mendimi me Palin, Jakobi, për të mos e rrezikuar komunitetin ndoqi rrugën e pajtimit. Pas vdekjes së Jakobit filloi ndarja mes të krishterëve. Jakobi më vonë u bë trimi i legjendave hebreo-krishtere. Atë e paraqesin si vegjetarian, si asket. Sipas transmetimeve, ai, për faljen e mëkateve të komuniteteve të tij, aq gjatë ka qëndruar në Tempull, sa që lëkura e gjunjve i është bërë shtresa-shtresa, si e devesë.⁴⁰⁴

Për vrasjen e Jakobit ka dy data të ndryshme. Njëra paraqet vitin 62/63 kurse tjetra vitin 66. Transmetimet ebionite, vdekjen e Jakobit e paraqesin si fillimin e shpërndarjes. Fatkeqësinë që u bie në kokë hebrenjve në vitet 70-ta, e lidhin me vdekjen e Jakobit. Në të njëjtën kohë këtë e komentojnë si një dënim që Zoti ua ka dërguar hebrenjve. Ndërkaq, vdekjen e Jakobit e kanë pasuar shpërnguljet e ebionitëve. Sepse, hija e afruar e fatkeqësisë që do të vijë në vitet shtatëdhjetë do të përgatisë vendimin për ndarjen nga Jerusalemi, atdheu i tyre, për shkak të armiqësisë së hebrenjve dhe për shkak të fërkimeve të brendshme me simpatizuesit e Palit.

Ebionitët e braktisën Jerusalemin ende pa filluar lufta, kurse shpërngulja u bë në vitet 66/67 në Jordanin Jugor. Qëllimi i shpërnguljes ishte vendi Pella ose i njohur si Dekapolisi. Kështu që ebionitët në këtë vend do të jetojnë të qetë. Kurse qendra tjetër kryesore e vendosjes ishte qyteti Kohba. Ky vend është themeluar pas Pellas. Me sa duket, mendimi se vendi i sotëm është Tel el-Amarna është dominant. Ky vend ndodhet tridhjetë km. në veri të Pellës. Më vonë janë përhapur në Haleb dhe në rajonin e Damaskut. Në Jordanin jugor, që bie në malet e Jordanit ose në skaje të shkretëtirës kanë qëndruar deri në shek. IV. Për peshkopatën e parë në Pella, do të bëhet fjalë në shek. V.

Marrëdhëniet e hebreo-krishterëve me hebrenjtë nuk ishin të hapura. Hebrenjtë ata i vlerësonin si tradhtarë. Bile, pas luftës filluan t'i largojnë edhe nga adhurimi nëpër sinagoga. Ata më llogaritëshin se janë jashtë komunitetit hebraik. Rabini Samuel, me propozim të Sanhedriumit, për heretikët ka shkruar lutjen mallkuese. Ata, hebrenjtë i merrnin për tradhtarë të popullit të vet, kurse romakët i shihnin si kryengritës në hije dhe nuk i ndanin nga hebrenjtë. Kështu që në vitin e 10 të Trajanit, gjegjësisht në vitin 107, për shkak të ankesës se janë përzier në politikë, perfekti Atticus peshkopët e moshuar i ka kryqëzuar.

Deri në kryengritjen *Bar-Kohba*, që ka ngjarë në vitin 135, ebionitët kanë pasur 15 peshkopë që kanë pasuar njëri tjetrin, për të cilët nuk kemi njohuri të mjaftueshme. Në fund të kryengritjes, që ka zgjatur një vit e gjysëm, bashkësia hebreo-krishtere në Jerusalem, *de facto*, ka përfunduar. Pas kësaj, peshkopi që do të bëhet kryetar është Markos, që nuk ka origjinë hebraike. Natyrisht që ebionitët nuk janë përzier në kryengritjen Bar-Kohba, edhe pse janë llogaritur si tradhtarë dhe janë përndjekur nga romakët dhe nga hebrenjtë, si pasojë e së cilës bashkësia e Jerusalemit merr fund. Në Jordanin lindor ekzistenca e tyre ka vazhduar deri në vitin 450. Më vonë, me ndarjet dhe dallimet në mendime, janë dobësuar dhe janë zhdukur nga skena historike.

Sipas transmetimit që vjen nga Selman Farisiu, shpresohet se mund të na jepet një dritë për fundin e hebreo-krishterëve. Sipas këtij transmetimi, Selman Farisiu duke qenë i krishter, e pyet mësuesin se pas vdekjes së tij cilin duhet të ndjekë. Mësuesi i thotë që, përveç tij nuk ka më anëtarë të fesë së vërtetë, ka mundësi që Zoti të dërgojë një profet dhe e porosit atë që nëse e sheh atë profet t'i

⁴⁰⁴ Vep. e cit., 23.

nënshtrohet atij.⁴⁰⁵

Hyrja e Selman Farisiut në islam dhe paralelizmi i madh mes islamit dhe hebreo-krishterëve shton mundësinë që mësuesi tij të kishte qenë një hebreo-krishter. Ka mundësi që mësuesi i Selman Farisiut të ketë vdekur pak para islamit, gjegjësisht mes viteve 550-600. Pra, supozohet se hebreo-krishterët ekzistencën e tyre e kanë mbrojtur deri në këto vite.

c. Disa çështje të besimit të hebreo-krishterët

Që t'i theksojmë disa mendime të hebreo-krishterëve, është e nevojshme të dihet që ai është fraksioni më i vjetër i krishter, i bazuar në Jezusin dhe në apostujt e tij, të dihet bindja e tyre për njësinë e Zotit, të dihet paraqitja e paralelizmit në mes të besimit të tyre dhe mendimeve të Kur'anit për Isain/Jezusin dhe krishterimin. Përndryshe e kemi shumë të vështirë që krishterimin e sotëm ta shpjegojmë në vargun e njësisë të paraqitur nga Kur'ani.

Udhëheqësia e komunitetit

Sipas hebreo-krishterëve kryetar i komunitetit pas Jezusit nuk është Pjetri, sikur që pretendon kisha katolike, por, është Jakobi, sepse Pjetri për predikimet dhe aksionet e tij çdo vit raportonte përpara Jakobit. Kjo tregon se Jakobi ishte udhëheqësi i Pjetrit. Sipas organizatave administrative, të themeluara duke imituar kuvendin hebraik, nën udhëheqësinë e Jakobit kishte një kuvend të përbërë prej 70-72 vetëve. Këtu diskutoheshin çështjet e komunitetit. Edhe në Koncilin e Apostujve të mbledhur në vitin 40/41, ka kryesuar Jakobi. Kundër kryerabinit Kajfas, zëdhënës në këtë tubim ka qenë vetë Jakobi. Kështu që, pasues i Jezusit në komunitetin e parë nuk ka qenë as Pjetri e as Palit, por, ka qenë vetë Jakobi.

Çështja apostull

Sipas hebreo-krishterëve Jezusi 12 dishepujt e tij i ka zgjedhur qysh kur ka qenë gjallë. Ata i ka quajtur edhe “apostuj”. Ai bashkë me ta ka ngrënë, ka pirë dhe ka shëtitur. Krahas kësaj, Palit, kontemplacioni (kundrimi) dhe vizioni i tij, të cilat i ka përjetuar në rrugë për në Siri, nuk i japin titullin apostull. Për këtë, Palit nuk e njohin si misioner dhe apostull i dërguar te idhujtarët nga Jezusi i ringjallur. Hebreo-krishterët thonë se, përcaktimi i kësaj detyre Palit s'është bërë me kontemplacion, por nga ana e shpirtit të keq, gjegjësisht djallit. Thonë se mësimi nuk bëhet me kontemplacion, por me personalitet profeti. Pjetri, i cili paraqitet si hebreo-krishter, Palit i thotë:

“Sikur çështja të bëhej me iluzion, atëherë pse Mësuesi ynë vite me radhë ka shëtitur me ne? Si t'i besojmë asaj se ai të është paraqitur ty? Ti ishe armiku i tij, deri sa ti mendon të kundërtën me të, si ka mundësi të të paraqitet ty? Mirë, ti mendon se me një paraqitje njëorëshe të tij, ke mësuar çdo gjë, je bërë apostull, atëherë tregoji fjalët e tij, mos polemizoj me apostujt që kanë qenë bashkë me Mësuesin, duaj ata? Nëse ti dëshiron t'i kthehesh të vërtetës, së pari Jezusin mësoje prej nesh dhe bëhu ndihmësi ynë.”⁴⁰⁶

Nga këto polemika kuptojmë se qysh në kohën e parë, mes Palit dhe apostujve të tjerë ka patur diferenca.

Gjendja e Jezusit

Sipas hebreo-krishterëve Jezusi është i sihariqar nga Moisiu dhe është “profet”, sikur ai. Që të dy, kanë treguar disa mrekulli, vetëm se Jezusi, përveç që është profet, në të njëjtën kohë është edhe Mesia. Ai është ringjallur dhe do të kthehet përsëri. Pastaj ai do të formojë shtetin hyjnor.

Jezusi ka ardhur si reformues i ligjit hyjnor të Moisiut. Kultin e sakrificës e ka ngritur. Ai vetë është edhe mbrojtësi i ligjit në fjalë. Ai ka dashur të jetojë në përputhshmëri me frymën e ligjit. Ka dashur t'i pastrojë elementet jo të shpallura dhe ndryshimet e bëra në Librin e Shenjtë. Ai është një njeri i cili ka

⁴⁰⁵ Nuredin Ali b. Abi Bekr el-Heysemi, *Mexbmu-ez-Zevaid ve Mendau'l-Fevaid*, v. 9, botim 2., Bjerut 1967, f. 333 dhe në vazhdim.

⁴⁰⁶ Schoeps, *Judenchris*, f. 42.

pranuar shpallje dhe është profet i Zotit. Vetëm se përshkrimet që i bëhen si hyjni dhe si bir i Zotit, janë politeizëm, mëkat i madh. Ceremonia e kungimit përbëhet prej një përkujtimi.⁴⁰⁷

⁴⁰⁷ Vep. e cit., f. 66.

KRISHTERIMI SOT

Transmetohet se Jezusi është ndarë nga bota në vitin 33. Katër vjet pas kësaj ngjarje Pali merr pjesë në komunitet. Me komentimet e reja të Palit për qëllimin e ardhjes së Jezusit, largimin e tij nga kjo botë dhe aftësinë e tij karizmatike, fillon grupimi rreth tij. “Koncili hebraik” i tubuar, sipas disave në vitin 40/41, e sipas disa të tjerëve në vitin 48/49, për temat që janë diskutuar nuk ka mundur të marrë vendime definitive. Në fakt ata ishin një grup që ndiqeshin, kurse liderët e tyre ishin të vdekur. Anëtarët e të dy mendimeve, që nuk janë bindur pas shpërndarjes së koncilit, kanë vazhduar të jetojnë çdonjëri në rrugën e vet. Edhe shoqëria hebraike e asaj kohe me mesianizmin dhe me rrymat e tjera, ishin në valavitje me dhunën politike të romakëve. Këto valavitje shoqërore, duke qenë e nevojshme që të dy grupet brenda tyre ta ofrojnë njëra-tjetrën dhe ta shtojnë mbështetjen ndaj njëra-tjetrës, ata mund të pengojnë madje edhe largimin e tyre. Hebreo-krishterët, që i shihnin shenjat e afrimit të kryengritjes hebreje, u shpërngulën nga Jerusalemi për në Jordanin jugor. Ata që ishin me origjinë hebraike e që ishin nën udhëheqjen e Palit, në vend që të tërhiqen në një skaj, ata u shpërndanë nëpër rajone të ndryshme të Perandorisë dhe i vazhduan aksionet e tyre misionerike. Numri dhe forca e tyre rritej për çdo ditë.

Qendrat e para të tyre (të Palit), ishin sinagogat hebraike të përhapura rreth Mesdheut, nga të cilat nuk ishin shkëputur ende. Dëshira e idhujtarëve për mesazhin e ri ishte më e madhe se sa e hebrenjve. Interesim më të madh treguan filozofët dhe besimtarët e kultit Mitra. Siç mësohet në jetë mistere, specifike gjenerale e kohës ishte dëshira dhe malli për rrugën e shpëtimit dhe për shpëtimtarin. Sidomos, të pambrojturit, të shtypurit, skllëvërit besonin se me doktrinën e re do të arrinin nderin njerëzor dhe barazinë. Kjo gjendje ishte e njëjtë edhe për gratë. Në Librin e Shenjtë thuhet: “Nuk ka as hebre, as grekë. As mashkull e as femër. Sepse në Jezun Krishtin të gjithë jemi të njëjtë”. Bota idhujtare ndihmesën dhe dashurinë që nuk e njihnte dhe nuk e kishte parë mes veti, e gjeti në krishterim. Dhe kjo ishte një element tjetër që i tërhiqte idhujtarët në krishterim.

Krishterimi predikonte virtetet që i kishte zbuluar bota antike dhe sillte gjëra të reja. Interesimi i saj ishte për jetën e brendshme, drejt shpirtit. Qëllimin e jetës e kishte kthyer nga jeta pas vdekjes. Këto gjëra që ishin të pakonceptueshme dhe të frikshme për përfaqësuesit e kulturës klasike, i magjepsnin masën dhe popullin dhe në ta gjenin simpatizues. Shumë të krishterë që i prishën marrëdhëniet me shtetin, nga pasioni i madh nuk mundën të fshehnin krishterimin e tyre, vdiqën për hir të besimit të tyre.

1. Pali

Emri i vërtetë i Palit është Saul. Ai ka lindur nga një familje hebraike në Tarsus, në vitin 5-15 të e.s. Katër vjet pas vdekjes së Jezusit, Pali, me një jetë kontemplacioni (soditëse) Jezusin e ka parë mbi mjegulla, ai u ndikua nga predikimi i tij dhe e pranoi krishterimin. Vetëm se, interpretimet e reja që ia bëri ai lëvizjes së re të krishterimit (mesianizmit), atë e nxorri nga ajo që të jetë një fraksion hebraik dhe e bëri atë një rrugë, një fe më vete.

Para se Pali të bëhet pjesëtar i komunitetit, apostujt jetonin bashkë me Jezusin dhe për bazë kishin predikimet, gjendjen dhe sjelljet e tij. Ata e vazhdonin jetën e tyre me disa komentime të reja për disa çështje brenda kufijve të hebraizmit. Ndoshta, sikur Pali të mos pranonte komunitetin e ri, krishterimi do të ishte një fraksion i hebraizmit dhe do të vazhdonte jetën e tij si një grup fetar. Me hyrjen e Palit në komunitet filloi të diskutohet hyjniteti i Jezusit. Në shesh nuk doli jeta e Jezusit që ka jetuar, por, komentimet e Jezusit të ringjallur pas vdekjes. Me theksimin e këtyre interpretimeve dolën në pah burimet që përbëjnë themelet edhe të fraksionit të krishterimit të sotëm.

Arkitekti i këtij ndryshimi dhe zhvillimi ka qenë Pali. Të krishterët me origjinë hebraike, të cilët në epiqendër të besimit të tyre kishin jetën e Jezusit që ka jetuar, gradualisht kanë shkuar duke u zhdukur nga skena historike, kurse krishterimi i rritur dhe i zhvilluar me interpretimet e Palit, e mbuloi botën. Kjo gjendje edhe sot përbën themelin e fraksioneve krishtere. Për këtë arsye Pali llogaritet themelues i krishterimit të sotëm. Mendimet e tij përbëjnë, përafërsisht, një të tretën e Dhiatës së Re, dhe luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e ungjijve të vërtetë, të cilat janë tekstet më të vjetra të krishterimit.

Pali është rritur në vendlindjen e tij, në Tarsus, me një kulturë idhujtareske. Në kohën e Gameljelit I në Jerusalem, ai ka mësuar për *rabin*. Më herët si *farisej ekstrem*, ka punuar kundër Jezusit dhe simpatizuesve të tij. Kurse pas transit/kontemplacionit e pranon krishterimin dhe veten ia dhuron misionit për thirrje të idhujtarëve në krishterim. Me komentimet e tij në komunitet ka krijuar një kaos. Ai në kuvend *apostujt e Jerusalemit* i ka detyruar të pranojnë që, ligjet e Dhiatës së Vjetër të mos zbatohen prej të krishterëve me origjinë idhujtareske. Gjithashtu edhe doktrina se kungimi përbën trupin hyjnor të Jezusit, se ai ka eliminuar mëkatën e përhershëm, se Pali vetë është i obliguar si apostull për idhujtarët, gjithçka mbështeten në të (Palin). Për shkak të kundërshtimeve mes të krishterëve me origjinë hebraike dhe Jakobit, vëllait të Jezusit, dhe kryetarit të komunitetit fetar të asaj kohe, Palit, si qendër misionerike ka zgjedhur Antakinë, kurse punimet e tij i ka përqendruar mbi idhujtarët. Veprimtarinë e tij e ka realizuar duke udhëtuar në Siri, Anadoll, Greqi, Qipro, Romë.

Ngaqë veprimet e tij janë parë si të dëmshme edhe nga hebrenjtë edhe nga romakët, ai është dënuar me vdekje me prerje të kokës, në vitin 67 të e.s. në Ostia.

2. Zhvillimi i besimeve krishtere

Përhapja e shpejtë e krishterimit në mes të idhujtarëve, hapi rrugën e zhvillimit dhe të dominimit të mendimeve të Palit, kurse, ata me origjinë hebraike, duke u dobësuar për çdo ditë, u zhdukën nga skena historike. Sipas Palit pagëzimit ishte zënia vend real e besimtarëve në trupin e Krishtit dhe si ekzistencë e shenjtë, të poseduarit e një pjese në vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Ai për këtë çështje thotë:

*“Po a nuk e dini se ne të gjithë që u pagëzuar në Jezu Krishtin, u pagëzuar në vdekjen e tij? Ne, pra, u varrosëm me të me anë të pagëzimit në vdekje, që, ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish me anë të lavidisë së Atit, kështu edhe ne gjithashtu të ecim në risinë e jetës.”*⁴⁰⁸

Funksioni i pagëzimit të bërë me ujë garantonte që të krishterët të qëndrojnë pranë Jezusit dhe të marrin Shpirtin e Shenjtë. Ai ishte i vdekur bashkë me Jezusin, i varrosur dhe, gjithashtu, i ringjallur bashkë me të.

Edhe ushqimi i lamtumirës i Jezusit është llogaritur i shenjtë. Ushqimi i fundit i Jezusit bashkë me dishepujt e tij, është vendosur dhe llogaritur si një nga sjelljet dhe adhurimet e shenjta të të krishterëve. Edhe në këtë çështje detyra më e madhe i takon Palit. Pali atë e quan si bashkim i Krishtit me Zotin dhe me komunitetin, duke u gostitur. Kështu që *“mysafirët e ushqimit të mbrëmjes?”* llogariten shokë tryeze të Jezusit të ngritur në qiell, kurse vetë ata mendonin, se kanë marrë një pjesë nga trupi i Jezusit. Sikur edhe shpirtërisht të jetë, ata e hanë mishin dhe e pinë gjakun e Jezusit. Pali gjithashtu thotë: *“Tasi i frytshëm që e shenjtëruam, a nuk është bashkim me gjakun e Krishtit? Jemi pjesëtarë të një buke?”*. Jezusi, që është edhe esenca e shpëtimit në krishterim, ndikon edhe në vdekjen dhe në ringjalljen e simpatizuesve. Në fakt, ky duhet të jetë edhe qëllimi i shenjtë i kultit të Krishtit. Ky koncept shkonte edhe më tej. Nëse, me të vërtetë në Ushqimin e Shenjtë të Mbrëmjes, nga ana e besimtarëve hahet mishi dhe pihet gjaku i Jezusit, atëherë buka dhe vera janë vazhdim i ekzistencës trupore të Jezusit. Ky besim, që mund të lidhet me mënyrën e të besuarit dhe të menduarit helenist, shumë shpejtë është formuar në kishën e vjetër dhe edhe Ignatiusi nga Antakia e ka mësuar në këtë formë prej etërve të mëdhenj të kishës.

Sipas kësaj, gjatë ritualit Zoti, për të cilin besohet se është brenda në ndonjë element, flijohet. Sespe Sakramenti i Kungimit që e ka bërë prifti, ishte një ceremoni flijimi. Kjo i ngjante sakrificës së kryqë dhe ishte bashkim me Zotin. Këtë mendim e ka kundërshtuar Martin Luteri dhe e ka cilësuar si

⁴⁰⁸ *Letrat e Apostullit Pal drejtuar Romakëve*, VI, 3-4.

keqkuptim.

3. Marsioni

Vazhdimi i pranimit të krishterimit nga ana e simpatizuesve të fesë gnostike dhe idhujtarëve, luante një rol jashtëzakonisht të madh, në interpretimin e krishterimit dhe në fitimin e kuptimeve të reja. Disa mendime të tyre, në lidhje me fetë e vjetra i futnin në fenë e re, kurse disa çështje të fesë së re, i futnin nën ndikimin e kulturës dhe fesë së vjetër. Në fakt komuniteti krishter jetonte bashkë me idhujtarët dhe fraksionet gnostike. Edhe teologjia e Palit u jepte mundësi këtyre zhvillimeve. Në këto kushte ai që e kuptonte më mirë Palin ishte Marsioni. Sipas Marsionit, krijuesi i botës nuk është Zoti i madh, por një ekzistencë tjetër nga Ai, Demiurgu, zoti i Dhiatës së Vjetër. Ai ishte një zot që vë ligje dhe kanune, një zot shtypës dhe me veti të liga. Nuk ishte i Ati i Jezusit. Ndërkaq zoti i Dhiatës së Re ishte Krishti. Kurse zoti i botës së dritës ishte i mëshirshëm dhe qëllimmirë. Ky dualizëm, aspektin mendor e orienton drejt mohimit të botës, gjegjësisht drejt etikës asketike. Vetëm se, përkushtimi eksrem i Marsionit ndaj Palit bëri që atë ta gjykojë kisha dhe në vitin 144 ta ekskomunikojë. Mendimet e Marsionit, se bota “*në të cilën Jezusi është dukur zoti i huaj*”, “*është krijuar nga zoti hebre*”, sipas kishës u shpallën si “*vepër e djallit*”. Dëshira për ta ndarë krishterimin nga Dhiata e Vjetër dhe mohimi i saj, u cilësuan si herezi. Për këtë shkak Marsioni formoi një kishë të re. Edhe pse mbante një qëndrim negativ ndaj kuptimit për një jetë asketike, ai pati sukses të madh. Ajo për kishën katolike dhe atë ortodokse, sidomos në vitet 150-190 në Perëndim, kurse në shek. IV në Lindje, u bë një rrezik i madh. Dhe në fund me dekret perandorak për heretikët, kisha e Marsionit u zhduk nga skena historike.

Marsioni për kishën katolike ka një domethënie shumë të madhe, sepse, për shkak se ai Ungjillin e Lukës, mbi të cilin është punuar, historinë e apostujve dhe Letrat e Palit i shpalli si libra të shenjtë të kishës. Në këtë rast edhe kisha katolike u detyrua që t'i përcaktojë librat e shenjtë të saj. Simboli i parë apostolik i kishës katolike, u formulua si burim i fesë dhe u fut në gjuhën e adhurimit si dëshmi pagëzimi. Megjithatë shkrimet e “Dhiatës së Re” dhe “dëshmia e Pagëzimit”, janë zyrtarizuar me nxitjen e Marsionit. Kurse humbja e Marsionit e rriti forcën kundër rrymave të reja që do të dalin në të ardhmen kundër kishës së madhe. Vetëm se, veten nuk mundi ta mbrojë prej ndikimeve gnostike.

4. Dhuna ndaj krishterimit

Fillimi i zhvillimit të krishterimit brenda në perandori u bë shkak edhe për rritjen e reagimeve. Në fakt Perandoria Romake ndaj të gjitha feve dhe besimeve kultivonte një tolerancë të madhe. Së paku toleranca e treguar ndaj hebrenjve kishte mundësi të tregohet edhe ndaj të krishterëve. Në rrënjën e jotolerancës nuk ishte as mosprerja e sakrificës për kultin perandorak, e as ikja nga adhurimi i zotave të Romës. Këtyre problemeve kishte mundësi t'u gjendej një formulë. Problem i pazgjidhur ishte dëshira e të krishterëve që feja e tyre të jetë dominante. E kjo paraqiste një humnerë mes krishterimit dhe shtetit. Durimi dhe gjendja ligjore, që një kohë të gjatë janë fshehur, dolën në shesh në shek. III në kohën e perandorëve Diokletian (Dakjan) dhe Valerian. Në fillimin e përhapjes së ndjekjes së tmershme në Perandori të krishterët pësuan humbje të mëdha. Edhe komentatorët muslimanë të Kur'anit janë të mendimit se, ngjarja që shpjegohet në suren Kehf në lidhje me banorët e shpellës (*as'hab-i kehf*), ka ndodhur në kohën e Diokletianit.⁴⁰⁹ Mbeturinat kishtarë të hasura në qytetet nëntokësore rreth Nevshehrit, janë mbeturina historike të gjetura nga besimtarët në kohën e përndjekjes së tyre. Dhuna nuk ka qenë vetëm në Perandorinë Romake, por, disa herë është bërë edhe nga disa shtete të tjera.

Për shembull edhe “*as'hab-u uhud*” (populli i hendekut), për të cilët tregohet se janë torturuar në

⁴⁰⁹ Ateş, *Yüce Kur'an'ın Çağdas Tefsiri*, v. 5, f. 293.

Jemen,⁴¹⁰ sinjalizon për fatin e të krishterëve të Nexhranit që janë hedhur të gjallë në hendeqe plotë zjarr, për shkak të kthimit të tyre në hebraizëm në kohën e *hebreut Zunuvas* (shek. V), mbretit himjeras.⁴¹¹

Për të krishterët thuhej se janë armiq të botës dhe se njerëzit i nënçmojnë. Kurse për aksionet e shenjtërimit mendohej se janë rituale jashtë etikës dhe mbi ta hidhej çdo lloj shpifjeje; çdo lloj poshtërimi ndaj tyre shihej si e drejtë. Kurse qetësimi më vonë i pozitave të tyre komentohej si hakmarrje dhe dënim nga zotat e vjetër. Tertulliani hidhërimin dhe zemërimin e përgjithshëm e shpjegonte kështu: “*Sikur lumi Tiber të derdhej mbi mure, sikur Nili t’i ujiste arat, sikur koba të mos ndryshonte, sikur të kishte një tërmet, një mungesë ushqimi ose një sëmundje ngjithëse, të krishterët në mënyrë permanente do të bëheshin provë përpara luanëve!*” Edhe pse një kohë të shkurtër pushuan këto përndjekje, në kohën e Diokletianit (284-305), me qëllim të përforcimit dhe rregullimit të perandorisë, rifilluan përndjekjet ndaj të krishterëve. Në tre dekrete të vitit 303 thuhej: “*Kisbat dubet të prishen, librat e shenjtë dubet të mblidhen dhe murojt dubet të burgosen dhe të vriten*”. Kjo përndjekje vazhdoi dy vjet, ku ranë shumë dëshmorë. Por, arriti deri në një fazë dhe u ndal. Shkrimtarët krishterë këtë e shprehin kështu: “*Valët u copëtuan në shkëmbinjtë e Pjetrit!*”. Gjatë kësaj kohe filloi të rritet numri i të krishterëve, u forcuan tubimet krishtere dhe ra edhe ndikimi i përndjekjeve. Në vitin 313 u shpall dekreti për liri fetare i Perandorit Konstantin, pasi ai i mundi rivalët e tij, Liciniusin dhe Maxentiusin. Kësaj kishe me qendër perandorake i është thënë edhe kisha apostolike.

5. Konstantini dhe krishterimi si fe perandorake

Konstantini, pasi mori pushtetin në vitin 313 dhe njohu lirinë fetare të të krishterëve, edhe vetë në shtratin e vdekjes (337 të e.s.) e pranoi krishterimin. Në kohën e tij shiheshin shenjat e prishjes dhe të prapambetjes së perandorisë. Konstantini besonte se me anë të besimit të ri Perandorisë Romake i është dhënë një forcë dhe një frymë të re. Në këtë kohë populli i perandorisë numëronte afër 80 milionë banorë. Në vitin 310 përafërsisht 25% e këtij numri ishin të krishterë. Vetëm se ishin të shpërndarë në mënyrë jo të balancuar. Në shumë rajone (në Anadoll) më shumë se gjysma e popullit ishin të krishterë. Komuniteti kishtar aktiv që binte në sy në Egjipt, Romë, Itali të Poshtme dhe në Spanjë ishte minoritet. Hapat e para të krishterimit kishin filluar t’i hidhnin edhe nëpër vendet tjera si në Galë, Gjermani etj. Kurse në zhvillimin e krishterimit lindor, roli politik fetar i Konstantinit ishte i madh. Me fermanin e tolerancës të gjitha fetë arritën të fitojnë lirinë. Vetëm se, politika dhe ligjet shoqërore të Perandorisë u bënë shkak i futjes zyrtare të krishterimit në perandori. Pozitave kishtarë iu dha autoritet i papërjetuar më parë. Njëri nga qëllimet e Konstantinit ishte themelimi i një kryeqyteti tjetër në Lindje, si alternativë e Romës, qëllim ky të cilin e realizoi. Ky kryeqytet alternativ ishte Konstantinopoja (Stambolli), i cili deri vonë është quajtur me emrin e perandorit. Sakrifika për idhujt u ndalua. Peshkopata e Konstantinopojës u lidh me perandorin. Vet ai këtu qëndronte më shumë. Qëndrimi i perandorit larg Romës u bë shkak për zgjerimin e autoritetit të Papës. Dhe kështu Papatë arriti që në krahasim me Patrikanën të zhvillohej më tepër. Për shkak të kushteve të ndryshme politike mes Lindjes dhe Perëndimit, edhe në mesin e kishave u arrit një dallim në zhvillimin e tyre.

Perandori ndërtoi një kishë madhështore në Konstantinopojë. Më vonë, Justiniani (483-565), në vend të kësaj kishe ndërtoi kishën me emrin Aja Sofia (viti 537). Sipas mendimit të përgjithshëm ndërtesa e kishës duhej që tërë botës t’ia paraqiste besimin krishter. Kështu që në Jerusalem u ndërtua kisha e varrit (kisha e bërë mbi varrin në të cilin besohet se është varrosur Jezusi), në Romë kisha shpëtimtare dhe sipas legjendës bazilika e vjetër e Shën Pjetrit e ndërtuar në sheshin e cirkut të Neronit, ku është vrarë Pjetri. Perandori atë e ka ndërtuar për kujtimin e të krishterëve të vrarë nga shteti i Romës dhe me këtë ka vërtetuar fitoren e peshkopëve romakë kundër shtetit idhujtar. Kjo ngjarje në të ardhmen do të përdoret si arsye për rritjen e ndikimit të papëve.

Kështu që, krishterimi në shek. IV llogaritej bashkë me fetë dhe format e tjera të kultit, kurse në

⁴¹⁰ Kur’ani, *Buruxh*, 4.

⁴¹¹ Ates, v. 10, f. 396.

kohën e Perandorit Teodosiusit të madh (v. 380), u bë fe e vetme e perandorisë. Nga ana e Teodosiusit idhujtaria jo që u ndalua, por ajo u shpall edhe si tradhëti ndaj shtetit. Për këtë, kultet idhujtare urgjentisht u zhdukën nga jeta e përditshme fetare. Në vitin 529 nga ana e Perandorit Justinian u mbyll edhe akademia e Platonit në Athinë dhe kështu në këtë formë ky zhvillim u aprovua.

6. Zënkat doktrinale për ekzistencën e Jezusit

Historia e krishterimit gjatë shekujve IV-VII është plotë zënka të ashpra teologjike. Të gjitha këto mbështeten në Librin e Shenjtë dhe mendimet e të mëdhenjve krishterë, të zhvilluara prej fillimit e deri në atë kohë. Këtyre u thuhet edhe diskutime dogmatike. Për këtë në fillim të shohim se çështje dogmë? *Dogmë është një fjali besimi e predikuar nga ana e kishës dhe e formuluar me një shprehje të veçantë.*

Qëllimi i formuluar me një shprehje të veçantë, është një burim i besimit i marrë nga shkrimet e shenjta dhe i shprehur me një gjuhë shkencore dhe filozofike. Vepra që përbën dogmën është obligim i ditorisë, gjegjësisht teologjisë së kishës në fushën e besimit. Vendin e mendimeve të zëna mes vete duhet ta zërë e vërteta, ndërsa kjo ndodhë në kishë, gjegjësisht në vendin e peshkopëve, sepse besohet se në konsultimet e tyre është prezent “Shpirti i Shenjtë”. Për këtë arsye punimet dogmatike dhe teologjike ende nuk janë mbyllur në kishën katolike. Koncili I Vatikanit në vitin 1870 shpalli dogmën se Papa (pasuesi i apostullit Pjetër) është i pagabueshëm, kurse në vitin 1950 deklaroi dogmën e ngritjes në qiell të Marias me trup. Por, periodha më madhështore e shprehjes dhe e përcaktimit të parimeve të besimit, gjegjësisht të formulimit të dogmës ka qenë shekulli IV dhe V.

Tema më kryesore ishte çështja e kristologjisë, gjegjësisht diskutimi mbi esencën e Jezu Krishtit. Sepse, edhe pse thuhej se Zoti është *një*, thuhej se Jezusi dhe Shpirti i Shenjtë janë zota, Jezusi është edhe Zot edhe njeri. Ishte shumë vështirë që logjikisht të shpjegohej gjendja e tre hyjnive në një Zot. Gjithashtu edhe zgjidhja e marrëdhënive të Jezusit dhe Shpirtit të Shenjtë me Zotin, ishte e vështirë. Në anën tjetër, qëndrohej mbi barazinë e Jezusit me Zotin, të cilin Jezusi e quante “At” dhe në të njëjtën kohë qëndrohej edhe mbi dallimin mes tyre. Kërkohehin rrugëdaljet shpëtimtare nga këto kundërshtime pa mos rënë në politeizëm.

Ariusi (v. 336) nga Aleksandria, supozonte se, *Jezusi nuk është Zot, por ai është vetëm një krijesë e furnizuar me fuqi hyjnore dhe i pranuar nga ana e Zotit si Bir i Tij*. Edhe më herët peshkopi i Antakisë Pali nga Samosata (pas vitit 260), marrëdhëniet e Jezusit me Zotin ua ka përngjarë marrëdhënive të mendjes me zemrën e njeriut. Sipas kësaj, Jezusi historik ishte një mbinjeri, por me një mëshirë të posaçme të Zotit, kurse Shpirti i Shenjtë (*logos*) është ulur në trupin e tij, sikur të ishte ulur në tempull. Fuqia e njëjtë hyjnore përveç Jezusit historik rol të rëndësishëm ka luajtur edhe në krijimin e botës. Sipas tij ky shpirt hyjnor është bashkuar me Jezusin historik dhe është vendosur në të. Siç është inkarnuar në profetët e tjerë në histori, është inkarnuar edhe në të. Por, Pali nga Samosata nuk bën fjalë për dy natyra në Jezusin. Dionisiusi nga Aleksandria (viti 265) mendon se logosi është manifestim i Zotit në nivel të ulët dhe për këtë mendon se logosi duhet të pranohet si krijesë e Zotit. Ndërkaq Dionisiusi, peshkopi i Romës, (viti 259-269), thoshte se, “ *biri Jezus është i përbershëm, mes Atit dhe Birit nuk ka dallime substancialë*”. Kishte edhe nga ata që pretendonin se logosi, është një mjet mes Zotit At dhe botës së krijuar, se është fotografi shpalljeje dhe i ngjan Atit. Si përfundim i këtyre diskutimeve edhe Maria cilësohej si lindëse e Zotit. Këtu “Maria” shihet si një vend misterioz ku bashkohet bota fizike me botën e padukshme hyjnore. Në të janë bashkuar dy substanca, ajo botërore dhe ajo qiellore. Përkundër kësaj në shkollën e Antakisë pretendohet se Jezusi është njeri.

Kështu që Ariusi, njëri nga përfaqësuesit e shkollës së Antakisë, kritikonte mendimin se Jezusi, gjegjësisht logosi, është substancë hyjnore. Jezusi ka mundësi që të pranohej si birësim i Zotit, kurse birë nuk mund të bëhet. Zoti, siç i krijoi krijesat prej hiçit edhe atë e ka krijuar pastaj. Në aspektin ekzistencial është ndryshe nga Zoti. Në aspektin substancial është i huaj për Krijuesin e tij dhe nuk i ngjajnë njëri-tjetrit. Ndoshta në aspektin substancial mund të krahasohet me engjëjt. Kundër kësaj, në një koncil të mbledhur në Aleksandri, në vitin 319, mendimet e Ariusit u refuzuan. Peshkopi i Aleksandrisë, Aleksandri, çështjen e rriti edhe më tepër, kështu që Perandori Konstantin me qëllim të negocimit mes dy palëve thirri në mbledhjen e Koncilit të Nikesë (në vitin 325). Si përfundim parimet e besimit u formuluan

kështu:

“Ne e dimë që Zoti është një, nuk ka lindur, është i padukshëm, i përbershëm, e vërtetë e vetme, i vetmi i pavdekur, i dituri i vetëm, i miri i vetëm, poseduesi i forcës i vetëm, sundues dhe administrues i çdo gjëje. I pandryshueshëm, i drejtë dhe në të njëjtën kohë i mirë. Është Zoti i Ligjit, i profetëve dhe i Dhiatës së Re, në periudhën e parakohore Ai ka pasur një djalë; Ai nëpërmjet tij ka krijuar kohën dhe çdo gjë...dhe Zoti është shkak i të gjitha krijesave, vetëm Ai nuk ka burim, por, biri është bërë prej Zotit pa kohë dhe është krijuar dhe vendosur para kohës. Ai para se të krijohet nuk ishte, por ishte krijuar pa kohë, para të gjitha krijesave, ai është bërë vetëm prej Atit, sepse ai nuk është i përbershëm dhe nuk është i njëjtë me Atin, në të njëjtën kohë nuk është i njëjtë me ekzistencën e Atit, nuk është fuqi e përbershme e pabërë, sikurse thonë disa, por para të gjithave është një njësi dhe një burim; kështu që Zoti është para të gjitha ekzistencave.”⁴¹²

Kjo shprehje e formuluar në Koncilin e Nikesë nuk i kënaqi simpatizuesit. Ndihmës peshkopi i Aleksandrisë dhe njëri nga kundërshtarët e Ariusit, Athanasiusi (295-373), vazhdoi të mbrojtë mendimin se logosi nuk është i krijuar por është i një substance me Zotin At, se është biri i përbershëm. Edhe Euseb, peshkopi i Nikomedjasë, në Koncilin II të Nikesë (327), gjeti një formulë që i bashkon grupet. Sipas kësaj, ai është krijesë joindivid, pas hyjnisë, ai është manifestim i Atit, i Birit dhe i Shpirtit. Ky mendim u pranua nga koncili. Vetëm se, për shkak të mospërfundimit të diskutimeve u mblodhën koncile të reja si në vitin 362 në Aleksandri, më 381 në Nike, më 431 në Efes. Ndërkaq mendimi se Maria e ka lindur Zotin e vërtetë u pranua në Koncilin e Efesit të mbledhur më 431. Edhe mendimi se Jezusi ka dy natyra, ishte nga çështjet diskutabile. Fshehtësia se Zoti është njeri përfundoi me kundërshtimin e monofizitëve (ata që mbrojnë mendimin se Jezusi posedon një natyrë) dhe diofizitëve (nasturitët). Për këtë u bë edhe një Koncil në Kadikoj (Kalkedon) më 451. Sipas vendimit të marrë tema formulohet kështu: *“Ka konsenzus për Birin një dhe të njëjtë, për hyjninë e plotë dhe njerëzjinë e plotë të Jezu Krishtit...ka dy natyra të përzjera dhe të pandryshueshme, të pandashme dhe të paizolueshme, të dyja janë në një vend, në një person...”⁴¹³* Ky vendim përbën themelin edhe të koncileve të tjerë që u mblodhën më vonë, vetëm se nuk ka mundur të pengojë daljen e fraksioneve të reja.

7. Parimet e besimit në krishterim

Njëra prej temave më të vështira është të kuptuarit e themeleve të besimit në krishterim. Pikënisja dallon prej hebraizmit dhe prej islamit. Në hebraizëm esencën e besimit e përbën Tora, kurse në Islam Kur’ani, ndërkaq profetët mbeten jashtë kësaj shpalljeje, ato llogariten vetëm si interpretues aktualë të shpalljes. Kurse në krishterim, shpallja dhe fjala janë ekzistenca të shndërruara në mish dhe në gjak të Jezusit. Vetë Jezusi është shpallje dhe fjalë. Ai nuk ka sjellur ndonjë libër të shpallur, sikur që janë Dhiata e Vjetër dhe Kur’ani. Urdhërat hyjnorë njerëzve ua ka kumtuar me fjalët dhe me sjelljet e tij. Për këtë, sipas të krishterëve më me rëndësi nga predikimi i Jezusit janë esenca e Jezusit, lindja, jeta, ekzekutimi, më vonë ringjallja nga bota e të vdekurve dhe ngritja, ulja e tij pranë Zotit për t’u rikthyer përsëri në botë. Kështu që, vdekja dhe komentimi i Jezusit të ringjallur, janë shumë më të rëndësishme se çështja e lindjes, jetës dhe të predikimeve të tij. Komentimet e këtyre përbëjnë themelin e parimeve të besimit krishter. Për këtë, në mesin e botëkuptimeve të të krishterëve ndaj Jezusit dhe misionit të tij dhe botëkuptimeve të muslimanëve ndaj Muhamedit (a.s.) dhe misionit të tij, ka dallime shumë të mëdha. Çdo komentim fetar reflekton vetëm mendimet dhe këndvështrimet e asaj feje të cilës i takon. Nuk i reflekton mendimet e palës tjetër. Sipas këndvështrimit krishter, krishterimi *“është fe e vetme e formuar nga zoti i trupëzuar, i cili ka zbritur nga qielli për të shpëtuar njerëzimin...vazhdon për tërë botën”⁴¹⁴*

Gjithashtu është shumë i vështirë shpjegimi i tërësishëm i krishterimit. Vlerësimet dhe pozitat e kundërta ndaj njëra tjetrës të njësisë së trinitetit të Zotit, të Shpirtit të Shenjtë, të Jezusit dhe të Zotit, të cilët e përbëjnë këtë trinitet, ka shumë dallime në mes fraksioneve në histori dhe fraksioneve të sotme. Shpesh haset në shprehje kontradiktore. Në disa raste fjalët e thëna me qëllime misionerike të

⁴¹² Alfred Adam, *Lerhbuch der Dogmengeschichte*, v. 1, Gutersloch 1965, f. 224.

⁴¹³ Adam, f. 336 dhe në vazhdim.

⁴¹⁴ Aslan, f. 177.

individëve të caktuar dhe fjalët të cilat nuk reflektojnë mendimet e komunitetit kishtar, u hapin rrugë ndërlikimeve ende më të mëdha. Për këtë arsye, do të mundohemi që për çështjet që janë më të ndjeshme për ne, të rezymojmë ose të huazojmë shprehjet e tyre (krishtere) nga librat e botuara nga ana e kishës katolike.

a. Besimi tek Zoti

Të krishterët, sikur hebrenjtë dhe muslimanët, thonë se Zoti është një. Vetëm se, kjo *njësi* është esenciale dhe substanciale e tre ekzistencave hyjnore. Ati është Zot, i cili shprehet si Zot në vete. Ai është i përhershëm, i fuqishëm për çdo gjë, di çdo send, ka fuqi për të krijuar gjithësinë dhe çdo gjë që përmban ajo, është prezent çdo kund dhe sheh çdo gjë, jetën e bën të mirë, është i mëshirshëm dhe falës. Zoti, që është mbi gjithçka, është gjykuesi i drejtë i të gjithë njerëzve ditën e gjykimit, është ekzistencë e vetme që jep shpërblimin dhe dënimin e përhershëm.⁴¹⁵ Vetëm se çështjen e krijimit ia ka dhënë Jezusit, nëpërmjet të cilit është krijuar edhe gjithësia.⁴¹⁶ Islami këtu dallon nga krishterimi, kurse mundësinë e krijimit nga ana e një ekzistence tjetër përveç Zotit e llogarit si mveshje dobësi dhe shok Zotit dhe e refuzon një gjë të tillë.⁴¹⁷ Gjithashtu krishterimi Jezusin, përveç që e pranon si sundues të ditës së llogarisë dhe të ringjalljes, e pranon edhe si autoritet gjykues të njerëzve. Pra ai është edhe këshillues dhe gjykues i njerëzve.⁴¹⁸

Tradita e të quajturit Zotin “At” ka kaluar prej hebrenjve, të cilët “Zotit i kanë thënë Ati, kurse popullit të tyre bijtë e Zotit”, te të krishterët. Në njërin nga psallmet e Davidit Zoti popullit izrealit i thotë kështu: “*Ti je biri Im, Unë ty të kam lindur sot*”. Edhe në kapitullin profeti Hoshea Zoti thotë: “*Unë e thirra birin Tim (popullin izrealit) nga Egjipti*”. Jezusi kësaj i dha kuptim më të sinqertë dhe më të thellë duke i mësuar nxënësit e tij që Zotit t’i thonë *Abba*. Abba është një shprehje dashurie, njëjtë si emri që fëmija ia jep babait të tij në familje (në anglisht Daddy, arabisht Eb, frengjisht Papa, shqip Ati).⁴¹⁹ Sipas mendimit tradicional, përkundër mendimeve moderne, Zoti është i lindur nga Zoti (Gjoni I, 3:9; 5:5). Nuk është birësi (*adoptianism*) e Zotit, por, bir i vërtetë i Zotit. Zoti llogaritet At i vërtetë i Jezusit. Kjo temë ka qenë çështje e diskutimeve të gjata në periudhën e parë edhe pse një grup ka pretenduar se Jezusi është një njeri dhe edhe pse gjatë pagëzimit, për shkak të dashurisë tek Zoti, ai është pranuar si birësi. Ky mendim nga tradicionalistët është pranuar si herezi dhe është refuzuar, kurse është pranuar ajo se Jezusi është bir i vërtetë i Zotit dhe se është zot i lindur nga Zoti. Sot 95 % e të krishterëve besojnë se Zoti është Ati i vërtetë i Jezusit, jo vetëm në aspektin shpirtëror, por edhe atë se që të dy janë bashkë qoftë në aspektin struktural, shpirtëror apo në atë esencial.

b. Jezusi dhe trupëzimi i tij (incarnatio)

Themeli i dytë i besimit është fakti i trupëzimit të Jezusit. Besohet se mesazhi i përhershëm dhe i pakrijuar i Zotit është trupëzuar dhe se Jezusi jeton në mesin tonë. Me një shprehje tjetër mund të thuhet se Mesazhi dhe Fjala janë shpallur në njerëzoren e Jezusit. Siç u shpreh edhe më herët, Jezusi, sipas krishterimit, nuk ka sjellë ndonjë libër, por vetëm se, shpalljes së Zotit i ka dhënë trup. Pra, vetë ai është shpallje e Zotit. Në Ungjillin e Gjonit, I:1-2, thuhet: “*Dhe në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ajo (Fjala) ishte në fillim me Perëndinë.*” Njëri prej dallimeve kryesore mes islamit dhe krishterimit është të kuptuarit dhe të komentuarit e ndryshëm të çështjes së lartpërmendur.

Të krishterët besojnë se, Jezusi me fuqinë e Zotit, ka lindur nga Maria Virgjëreshë, e cila vetveten ia ka premtuar Zotit. Vetëm se, nuk ka ndonjë mendim se Maria është gruaja e Zotit ose se ndonjë “*farë*” hyjnore është pllenuar tek Maria. Për të krishterët, “*Jezusi në sajë të fuqisë së Zotit (Shpirtit të Shenjtë) ka rënë*

⁴¹⁵ Michel, f. 56. (Shkrimtari është një profesor i teologjisë dhe për momentin ka një post të lartë në Vatikan).

⁴¹⁶ Gjoni, I, 3; *Letër Dërguar Hebrenjve*, I, 2; *Letra e Apostullit Pal Drejtuar Kolosianëve*, I, 15-17.

⁴¹⁷ Kur’ani, Ra’d, 16; Furkan, 2; A’raf, 111.

⁴¹⁸ Gjoni, V, 21, 27, 28-29. Vep. e cit., 73.

⁴¹⁹ Michel, f. 56.

në uterus dha ka lindur nga Maria Virgjëreshë”.

“Jezusi, përveç mëkatit, në çdo aspekt është njeri i plotë, po në të njëjtën kohë është edhe me Fjalën e Zotit. Edhe njohuria dhe vetëdija e Jezusit u zgjerua, si në çdo njeri, në sajë të marrëdhënieve me njerëzit e tjerë dhe në sajë të përvojës së përfatuar gjatë jetës”.

“Katolikët, bashkë me ortodoksët, besojnë se Maria tërë jetën e saj ka qenë Virgjëreshë. Për këtë është e pamundur që Jezusi të ketë vëlla ose motër në aspektin fizik, kurse shprehjes “vëlla”, që përmendet në Ungjill, i japin kuptimin e familjes së zgjeruar të Marias me Josefin. Kurse protestantët, të cilët dëshirojnë të pranojnë kuptimin real të fjalës familje, besojnë se Jezusi ka lindur nga Maria Virgjëreshë, krabas kësaj ata kanë bindjen se përveç Jezusit, Maria dhe Josefi kanë edhe fëmijë të tjerë.”⁴²⁰

c. Cilësitë e Jezusit

Të krishterët Jezusin e cilësojnë dhe i japin titullin bir i Zotit. Besojnë se Jezusi është i përhershëm dhe i pakrijuar. “Zoti tërë gjithësinë e ka krijuar në Jezu Krishtin, nëpërmjet të Jezu Krishtit dhe për Jezu Krishtin”.⁴²¹ “Jezusi nuk është Ati, por atë e ka dërguar Ati...të dy janë persona të ndryshëm. Por deri në pafund janë bashkë...Ata nuk janë një për shkak të esencës së njëjtë, por tek të dy gjendet dashuria, dituria dhe forca e pafund, të cilat e kanë krijuar botën”.⁴²²

“Sipas besimit katolik, Jezusi është Zoti i vërtetë. Ai është Fjala dhe Biri i përbërshëm i Atit të përbërshëm. Ky pra, është Mesazhi që jep besimi i krishter. Ai është Zoti, mëshira dhe forca e të cilit mundëson ekzistencën e të gjitha krijesave dhe është Zoti i botërave, i mjaftueshëm për të gjithë...Fjala dhe Biri i përbërshëm në dashurinë e përbërshme, që përbëhet prej Njësisë së Trinitetit të Shenjtë, kanë dalur nga Ati. Biri është që në eternitet bir i vetëm i Atit...Si natyrë dhe si esencë Biri është një i vetëm. Edhe ai është Biri i vetëm i Zotit. Kisha bën të ditur se, Jezusi është bir i Zotit, jo për shkak të birësisë së Jezusit sikurse të tjerët, por për shkak të ngjashmërisë esenciale me Zotin. Jezusi nuk është njeri në të cilin jeton Zoti, por, Bir i vetëm dhe origjinal i Zotit. Kështu që origjinaliteti i Jezusit me të Zotit, i cili jeton deri në pafund, është i njëjtë”.⁴²³

Cilësia biri i njerëzisë, përdoret në librin e Danielit, për njeriun, i cili do të ketë autoritet gjykues në shtetin hyjnor dhe që Kohën e Fundit do të vijë prej qielli. Në të njëjtën kohë ky emër që shpreh shpresën për Krishtin, sipas të krishterëve i përshkruhet Jezusit dhe besohet se është realizuar në të. Jezusi, sikur që është Zot, është edhe njëri i përsosur:

“Është pamja e Zotit të padukshëm...ai si çdo njeri ka punuar me duart e tij. Ka menduar me mendje dhe ka përdorur vullnetin e lirë dhe ka dashuruar me zemër sikur njerëzit e tjerë. Atë e lindi Maria Virgjëreshë. Ai ishte një njeri si ne por nuk bëri mëkate... Ai kur u kryqëzua në kryq haptazi tregoi njerëzoren e tij. Edhe shpirtërisht edhe fizikisht pati shumë dhimbje. Atë e rrahën me këmba dhe e kryqëzuan. Ai me të vërtetë vdiq. Veshjen njerëzore që e veshi për ne nuk e nxorri asnjëherë. Shumë me rëndësi është ajo që Jezusi është njeri, sepse në të natyra njerëzore përcaktobet në mënyrë më të theksuar dhe kështu Ai bëhet shembull më i përsosur”.⁴²⁴

Vetëm se, “Jezusi nuk kishte një personalitet njerëzor. Këtu fjala person përdoret me plotkuptimin e fjalës për ekzistencë-krijesë të pavarur mendore”. “Jezusi nuk është ndonjë ekzistencë tjetër përveç se personi që është Bir i Zotit. Atë që dëshirojmë të themi është kjo: Jezusi nuk është i ndarë. Nuk ka ndonjë person njerëzor të quajtur me emrin Jezus, përveç Birit të përbërshëm të Zotit. Jezusi është personi që është biri i Zotit prej eterniteti e deri në pafundësi”.⁴²⁵

Zot, është njëra prej cilësive dhe titujve të dhënë Jezusit nga ana e të krishterëve. Te krishterët besojnë se ky autoritet dhe kjo kompetencë Atij i është dhënë nga ana e Zotit, në momentin kur ai ringjallet pas vdekjes. Ky titull simbolizon besimin krishterë se Jezusi është mjet i vetëm mes Zotit dhe njerëzve. Sidomos në letrat e Palit cilësia Zot, përmendet shpesh. Gjithashtu ajo shpreh besimin se Jezusi do të vijë përsëri, dhe Ditën e Llogarisë si Gjykatës do të ulet në anën e djathtë të Zotit.

Krisht- Hristos, është emri i dytë i Jezusit. Fjala ibranishte *Mesia*, në greqishte është *Hristos*. Besohet

⁴²⁰ Michel f. 57.

⁴²¹ *Hristijan İnanca*, (Türkiye Katolik Yayınları), Stamboll 1994, f. 49.

⁴²² Vep. e cit., f. 73.

⁴²³ Vep. e cit., f. 73.

⁴²⁴ Vep. e cit., f. 71.

⁴²⁵ Vep. e cit., f. 75.

se Jezusi është njeriu i premtuar hebrenjve. Për këtë përdoret edhe emri “Krisht”.

Sipas shprehjeve katolike:

“Jezu Krishti është njeri i vërtetë dhe Zot i vërtetë. Ai është fjalë hyjnore pafillim dhe pambarim. Ai është Biri i vetëm i Zotit, Ai që në eternitet ka dalur nga Ati. Është Zoti i ardhur-i lindur prej Zotit. Është i të njëjtës esencë me Atin”.

*“Ai ka ardhur nga parajsja dhe duke i mbrojtur cilësitë hyjnore është bërë njeri. Ai ka jetuar me njerëzit dhe atyre ua ka mësuar mënyrën e të jetuarit, jo me fjalë por me jetën e Tij. Ai është Shpëtimtari ynë që ka përjetuar dhimbje, ka vdekur dhe në mënyrë madhështore është ringjallur... Çdo gjë në qiell dhe në tokë, që duket dhe që nuk duket, fronet, udhëbëqesitë dhe sovranitetet janë krijuar në Të. Çdo gjë është krijuar nëpërmjet Tij dhe për Të. Ai e mbanë gjithësinë. Ne ekzistojmë në saje të Tij”.*⁴²⁶

Islami (Kur’ani, Kehf, 51) dallon nga këto besime të krishterimit dhe pretendon se Allahu xh.sh. në krijim askënd nuk ka marrë për ndihmës dhe askënd nuk e mban pranë Tij.

Në krishterim fjala e Zotit, përdoret në kuptimin e vendosjes së fjalës së Zotit në Jezusin. Besohet se fjala hyjnore në Jezusin është shndërruar në trup, mish-eshtra, dhe se si çdo njeri është munduar të jetojë, të ushqehet, të gjendet në familje, vetëm se nuk ka pasur asnjë mëkat. Besohet se është poseduesi i vërtetë i cilësisë së pastërt.

“Ai gjatë jetës nuk ka bërë aspak mëkat. Pjetri ka shkruar se Ai nuk ka bërë mëkat, dhe në gojën e Tij asnjëherë nuk ka patur mashtrim. Pa dyshim kur të njohim Jezu Krishtin, kur të kuptojmë se Ai është Zot dhe Biri i Zotit, atëherë kuptojmë se nuk ka gabuar aspak, sepse personaliteti i Tij ka krenari hyjnore”.

*“Ungjilli bën të ditur se ka patur prej atyre që kanë dalur të devijojnë Jezu Krishtin. Por Ai gjithmonë ka qëndruar larg të keqes, Ai nuk posedonte ekzistencë trupore që ngjallë e pshin nga brenda. Atë edhe Djalli e provokoi nga jashtë. Por zemra e Tij njerëzore gjithmonë i është përshtatur dëshirës së Atit”.*⁴²⁷

Për Jezusin përdoren tituj dhe cilësi si rob i Zotit, Shpëtimtar, Bari i mirë, Rrugë, i Vërtetë, Jetë.

ç. Shpirti i Shenjtë

Krishterimi, bashkë me Zotin dhe Jezusin beson edhe në Shpirtin e Shenjtë, i cili përbën ekzistencën e tretë të hyjnisë. Është një person i njësisë së Trinitetit të Shenjtë, e cila përbën hyjninë. Misteri i njësisë së trinitetit, gjegjësisht termi për manifestimin e Zotit në tre persona, ende nuk është i qartësuar. Ky mister ka mbetur fshehtësi deri në periudhën e paraqitjes së Ungjillit. Gjatë festës së Pashkëve dhe pesëdhjetë ditë pas pashkëve në festën Pentakost, është përcaktuar se Shpirti i Shenjtë është një person hyjnor i veçantë.

*“Kisha, siç kumton besimin në Zotin dhe Jezusin, po ashtu kumton edhe besimin në Shpirtin e Shenjtë. Ati dhe Biri njëri-tjetrin e dashurojnë me një dashuri të pafund. Kjo dashuri në ata të dy theksobet me një kuptim të plotë. Deri në pafundësi është e njëjtë dashuria te të dy. Kjo dashuri që buron prej Atit dhe Birit është një person, i cili është Shpirti i Shenjtë i pafillimtë dhe i pafund”.*⁴²⁸ Kisha Shpirtit të Shenjtë i lutet nga brendësia. Sidomos pesëdhjetë ditë pas festës së Pashkëve në festën Pentakost dhe në ritualin e përforcimit shihet qartë lidhshmëria me Shpirtin e Shenjtë. Ai është forcë që i jep jetë kishës. Nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë dhuratat e Jezu Krishtit i dhurohen kishës. Kurse Shpirti i Shenjtë u vjen njerëzve me anë të pagëzimit dhe ata fillojnë të jetojnë në Shpirtin e Shenjtë. Kështu ai e shenjtëron njeriun. Edhe ndikimi në të tjerët bëhet me ndihmën e Shpirtit të Shenjtë. Shpirti i Shenjtë është ai që ua ka paraqitur të vërtetën njerëzve nëpër koncile të ndryshme. Detyra e Shpirtit të Shenjtë është theksuar edhe në Koncilin II të Vatikanit.⁴²⁹

Shkrimtarët e shekujve të parë të krishterimit, që kanë shkruar tekste fetare, me kembëngulje kanë theksuar se kisha dhe Shpirti i Shenjtë nuk mund të ndahen. Ata thonë: *“Aty ku gjendet kisha aty gjendet edhe Shpirti i Shenjtë dhe aty ku është Shpirti i Zotit aty është edhe kisha”.* Edhe sot besohet se Shpirti i Shenjtë kishës i jep jetë dhe ia mundëson vazhdimin e ekzistencës.⁴³⁰ Shpirti i Shenjtë cilësohet edhe si Shpirt

⁴²⁶ Vep. e cit., f. 31 dhe në vazhdim.

⁴²⁷ Vep. e cit., f. 77.

⁴²⁸ Vep. e cit., f. 118.

⁴²⁹ Vep. e cit., f. 122.

⁴³⁰ Vep. e cit., f. 119.

hyjnor i Zotit edhe si Jezu Krishti.⁴³¹

Thuhet se kjo ekzistencë buron nga Jezusi dhe në disa raste besohet se është Zot, por në disa raste për ekzistencën hyjnore gjithashtu thuhet se është Forcë Hyjnore dhe quhet Shpirti i Shenjtë”. Këtë term muslimanët e kuptojnë ndryshe nga të krishterët. Sipas muslimanëve Shpirti i Shenjtë është emri i njërit prej melekëve të mëdhenj, Xhibrilit. P.sh., emri i ekzistencës nga i cili Maria është sihariquar për Jezusin, sipas të krishterëve është Shpirti, kurse sipas muslimanëve është Xhibrili. Të krishterët besojnë se Shpirti i Shenjtë nuk është krijuar dhe se është njëra prej tre ekzistencave hyjnore. Ndërkaq muslimanët besojnë se Xhibrili është krijesë e Allahut xh.sh.

d. Triniteti

Triniteti askund nuk përmendet në Libër të Shenjtë. Ky term për herë të parë në histori është përdorur nga Theophilusi nga Antakia në vitin 1080. Megjithatë baza e termit triniteti gjendet në Dhjatën e Re dhe shprehja më e qartë për këtë në formulën e pagëzimit në Ungjillin e Mateut është: *Pagëzoni në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë!* Në krishterim është shumë vështirë që të thuhet diçka definitive për konceptin e besimit të Trinitetit. Në transmetimet historike është shënuar se tre ekzistencat hyjnore përbëhen prej tre personave, bashkimi në mes tyre është bashkim substancial. Mund të mendohet një lloj nëne e cila është me barrë dhe ka dy binjakë. Në dukje është një person, kurse në të vërtetë është sikur të jenë tre persona.

*“Sipas Ungjillit, në Zotin që ka tre persona apo individë, të parit i thuhet At ose Ati Zot, të dytit Fjala, Fjalë Hyjnore ose Biri, kurse të tretit i thuhet Shpirti i Shenjtë; kështu që nuk thuhet as tre e as një-tre zotëra; por thuhet se në Zotin tek i cili ka tre persona, ose me një shprehje teknike ka tre elementë”.*⁴³²

Kohën e fundit për shkak të bindjes se disa kolegë janë larguar nga komentimet tradicionale dhe se Njësia e Zotit ka ra në hije bien në sy komentime të ndryshme për Trinitetin. Sipas kësaj, Zoti vetveten në Jezusin e ka paraqitur si Bir, kurse në kishë si dashuri dhe Shpirt. Ky një që tejkalon kufijtë e të të kuptuarit të njeriut, është manifestim në forma të ndryshme i inkarnacionit të ekzistencës së njëjtë. Këtë e quajnë edhe interpretim modern psikologjik. Vetëm se shumica e teologëve, shumica e popullit që besimin e tij e vazhdon në formën tradicionale beson në Zotin i cili nga shumica dërrmuese shprehet si “Ati Qiellor”.

dh. Maria

Të krishterët Marian e titullojnë me emrin “Nëna e Zotit” (*Theotokos*). Vetëm se asnjë krishter nuk pretendon se Maria është grua e Zotit. Asaj vetëm i jepet titulli “Nëna e Zotit”. Besohet se Maria me një dhunti të veçantë nga Zoti nuk ka bërë asnjë mëkat.

Shumë të krishterë, sidomos katolikët dhe ortodoksët vizitojnë vendet e shenjta që i përshkruhen Marias (si Efesi në Anadoll dhe Nasira në Palestinë). Në kishë vend të posaçëm kanë portetet e Marias respektivisht skulpturat e saj. Besimtarët për shpëtimin e tyre i kërkojnë që të ndërmmjetësojë.

Besohet se Maria, me përfundimin e jetës në këtë botë është ngritur në qiell dhe jeton bashkë me të Birin. Vetë ajo me shpirt dhe me trup është ngritur në qiell. Në Dhjatën e Re nuk ka njohuri definitive për ngritjen e Marias në qiell. Ky besim bazohet në doktrinën e kishës katolike për shenjtërimin dhe nderimin e Marias.⁴³³

e. Shpëtimi dhe udhëzimi

Të krishterët besojnë se Adami dhe Eva, me ngrënien e “pemës së ndaluar” në parajsë kanë bërë mëkat të përbëshëm dhe se ky mëkat atyre dhe fëmijëve të tyre u ka sjellur vdekjen. Sidomos ata besojnë se mëkati trashëgobet

⁴³¹ Xavier Jacob, *Sorabilir miyiz?*, Stamboll 1992, f. 13.

⁴³² Vep. e cit., f. 12.

⁴³³ Vep. e cit., f. 172.

edhe në gjeneratat e mëvonshme. Për shpëtimin e njerëzimit nga ky "mëkat i përhershëm", Zoti në fillim shpalli Dhiatën e Vjetër. Vetëm se askush nuk ka mundur ta bartë këtë barrë, askush nuk ka mundur që ligjin ta praktikojë tërësisht dhe askush nuk ka mundur të shpëtojë nga ky mëkat.

Për këtë Zoti fjalën e Tij, që është e përhershme dhe hyjnore, e ka paraqitur dhe e ka shpallur në vetë Jezusin, "në pamjen e tij". Jezusi tërë jetën e tij, njerëzimit i ka kumtuar urdhërat dhe dëshirat e Zotit dhe për shkak të keqkuptimit të njerëzve është dërguar në tryezën e ekzekutimit. Edhe Ai për respektin absolut ndaj Zotit, për shlyerjen e mëkateve të të gjithë njerëzve në të kaluar dhe në të ardhmen e ka flijuar veten. Fshehtësia e Zotit se, pse për shpëtimin e njerëzve nga mëkati ka bërë dhe ka realizuar një plan të tillë, është e pakuptueshme, vetëm se Zoti këtë rrugë e ka zgjedhur me dëshirën e lirë të Tij. Me këtë sakrificë të shlyerjes së mëkatit, është deroguar, gjegjësisht është ngritur i tërë ligjit hebraik dhe mëkati i përhershëm.

Për këtë ata që besojnë në Jezusin, do ta arrijnë shpëtimin vetëm me besimin dhe dashurinë e tyre, e jo me ndonjë varësi ndaj çdo lloj sjelljeje dhe parimi ligjor.

Të krishterët besojnë se Jezusi, i cili është kryqëzuar dhe ka vdekur, është ringjallur përsëri me një dhunti të Zotit. Zoti me këtë ringjallje ka miratuar misionin e Jezusit, veprën dhe mënyrën e të jetuarit të tij. Vdekja dhe ringjallja e Jezusit janë një fitore ndaj mëkatit dhe vdekjes. Ky mashtrim që zgjatet deri në vdekje, duke e mundur vdekjen ka hapur rrugën e ngritjes pas vdekjes.

Për këtë në shtëpitë dhe shkollat e të krishterëve shihen kryqe që bartin trupin e Jezu Krishtit. Kryqi për të gjithë të krishterët është simbol i besimit.

Vdekja e Jezusit llogaritet si një fillim i një periudhe të re, gjegjësisht bindje për një marrëveshjeje të re (Dhiata e Re) jo vetëm mes hebrenjve dhe Zotit por mes tërë njerëzimit dhe Zotit.

ë. Besimet e tjera

Është më se e natyrshme që muslimanët, duke u mundur që të mësojnë dhe kuptojnë sistemin e besimit të krishterë, në themelet e besimit të tyre, të kërkojnë përgjigje për çështjet paralele. Sado që çështjet e kapitujve në lidhje me besimin që do t'i diskutojmë nuk përmenden në librat e katekizmit krishter, ata luajnë rol në eliminimin e zbrazëtisë për të cilën ekziston kureshtja.

Bota e ardhshme

Sipas besimit krishter, pas kthimit të Jezu Krishtit dhe pas themelimit të shtetit hyjnor do të fillojë sundimi i Krishtit dhe në fund të periudhës që do të zgjat 1000 vjet, të gjithë njerëzit prej Adamit e këndej do të ringjallen dhe do të fillojë një ditë e gjykimit nën sundimin e Jezusit. Çdokush do të japë llogari për sjelljet dhe besimin e tij. Të krishterët mëkatarë në bazë të mëkatit të tyre do të dënohen me dënime të përkohshme dhe duke iu nënshtruar procesit të pastrimit, dëlirësisë, do të shpëtojnë prej mëkateve.⁴³⁴

Pas kësaj të krishterët do të merren në parajsën e përgatitur dhe do të gëzohen me shpërblimin e tyre të përhershëm. Ndërsa jo të krishterët (idhujtarët, muslimanët etj.) sipas disave, sikur fati i disa kafshëve që kanë jetuar më herët, për të mos u ringjallur më kurrë do të shndërrohen në dhé, kurse sipas disave, do të dënohen në ferrin e përhershëm.⁴³⁵

Engjëjt, satanët dhe xhinnët/demonët

Edhe pse çështja e engjëjve për katolikët dhe ortodoksët është problem besimi, për protestantët nuk është e tillë. Ka një afërsi në besimin islam mes engjëjve dhe shejtanit. Edhe sipas krishterimit engjëjt janë shpirt pa trup i furnizuar nga ana e Zotit me kuptim dhe vullnet të lirë, që absolutisht i praktikojnë urdhërat e Zotit. Ata janë ekzistenca mbi kohë dhe mbi vend. Ndërkaq satani dhe xhinni (demoni), janë shpirtëra të këqinj të shkëputur nga Zoti, me të cilët zoti është i zemëruar, këto mund të

⁴³⁴ P. Oskar Simmel, R. Stahlin, *Christliche Religio*, Frankfurt 1964, f. 77-78.

⁴³⁵ Kur'ani duke treguar të kundërtën thekson: "Ata thanë: Neve nuk do të na kapë zjarri vetëm për disa ditë të numëruara! Thuaj: A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim..." (Bakara, 80).

quhen edhe engjëjt rebelues; për këtë çështje, mes besimit krishterë në engjëjt dhe besimit islam në xhinnët shihet një paralelizëm. Në islam melekët janë krijesa që e respektojnë Zotin plotësisht dhe nuk kanë dëshira dhe iniciativë të tyre. Ata në esencë janë të krijuara prej dritës. Ndërkaq në krishterim nuk diskutohet për esencën e tyre, por, vetëm se, ato kanë aftësinë e zgjedhjes së respektit apo të rebelimit ndaj Zotit.

Profetët dhe librat e shenjtë

Mendimi për profetët në krishterim dallon nga ai i islamit. Krishterimi të gjithë profetët në Dhiatën e Vjetër i pranon. Sidomos për shkrimtarët e Dhiatës së Re dhe për apostujt përdoret termi profet, punët dhe veprimet e tyre vlerësohen si një lloj profecie.

Muhamedin, profetin e fundit, e shohin si një njeri të ditur të popullit arab, kurse anën shpirtërore të tij nuk e pranojnë. Edhe pse në vendimet e Koncilit II të Vatikanit bien në sy disa zbutje ndaj islamit dhe shprehet se në islam gjenden disa shkëndija të realitetit të posaçëm të fesë së Abrahamit, Kur'ani dhe lidhjet e Muhamedit me shpalljen nuk pranohen. Profetët dhe librat e shenjtë janë të përkufizuar me Dhiatën e Vjetër dhe të Re. Dallimet dhe kontradiktat mes Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re komentohen në bazë të Dhiatës së Re.

Siç u tha më lart, mes ungjijve, letrave dhe librave që i përmban Dhiata e Re dhe ungjijve që i lajmëron Kur'ani nuk ka asnjë lidhje. Të krishterët nuk pranojnë asnjë ungjill të konceptuar nga ana e muslimanëve. Sipas tyre fjala e Zotit nuk është e shndërruar në shkrim dhe libër por në mish dhe eshtra. Ai është Jezusi. Ndërsa shkrimet në Dhiatën e Re janë përkujtime që reflektojnë Jezusin dhe ngjarjet në kohën e tij dhe që janë të shkruara me shpalljen dhe inspirimin e apostujve dhe nxënësve të tjerë. Këto janë komentime. Shkurt thënë, Inxhili për të cilin Kur'ani thotë se i është zbritur Isait, në botë nuk ekziston. Njohuritë në konceptet e muslimanëve janë gabime që burojnë nga mosnjohja e mjaftueshme e të krishterëve të sotëm. Isai/Jezusi dhe inxhilët/ungjijtë për muslimanët janë pjesë e besimit të tyre. Ato, gjithashtu, manifestojnë mendimet dhe besimet e hebreo-krishterëve (ebionitëve), që është njëri prej fraksioneve krishtere dhe që sot nuk ka simpatizues.

8. Sacramentum-Misteret e kishës

Të krishterët besojnë se, Jezusi i ringjallur pas vdekjes jeton bashkë me komunitetin, sikurse ka jetuar para vdekjes, ashtu vazhdon të jetojë bashkë me ta. Adhurimi, shërbimi, ngopja e të uriturve, falja, vuajtja dhe vdekja e tij vazhdojnë pandërprerë. Këto aksione të padukshme të Jezusit në ceremoni të sakramenteve të kishës bëhen të dukshme. Me fjalë të tjera, një i krishterë beson se me pjesëmarrjen në këto ceremoni, ai shpirtërisht është bashkë dhe jeton me Jezusin e ringjallur.⁴³⁶

Për të krishterët mistere kryesore janë pagëzimi (baptizmi) dhe kungimi (euharistia). Si shtesë përveç këtyre dy mistereve ortodoksët dhe katolikët pranojnë edhe pesë mistere të tjera. Këto janë: mirosja, martesja, misteri i priftërve, pendimi (pajtimi) dhe vajimi i shenjtë. Shumica e protestantëve, edhe pse i pranojnë sakramentet e pagëzimit dhe kungimit, sakramenteve të tjera nuk u japin të njëjtën vlerë. Kurse në disa kisha protestante si *kuakerët* dhe *ushtria e shpëtimit*, nuk kanë besim në sakramente. Misteret as pjesërisht nuk mund të krahasohen me farzet në islam.

a. Pagëzimi

Është sakramenti i parë dhe është kushti themelor për pranimin e sakramenteve të tjera. Hyrja në krishterim bëhet me këtë veprim. Me këtë njeriu llogaritet se e ka pranuar besimin dhe adhurimin e krishterë. Kjo bëhet vetëm njëherë. Ceremonia e pagëzimit është si një lloj abdesti i madh (gusli) në islam. Me këtë besohet se njeriut i cili pranon fenë e re, i janë falur mëkatet dhe se është i shpëtuar nga

⁴³⁶ Michel, f. 88.

ato. Disa kisha, në kokën e njeriut që pagëzohet stërpikin ujë. Në përgjithësi pagëzimi bëhet gjatë Festës së Pashkëve.

b. Mirojsja

Kjo përbën pjesën e dytë të ritualit të hyrjes në krishterim. Besohet se me këtë besimtarit të ri i dhurohet forca e Shpirtit të Shenjtë. Ai thirret, që si një i krishterë i pjekur, t'i realizojë të gjitha përgjegjësitë që i ka marrë mbi vete. Nëse njeriu që pendohet në kishë është i pjekur, rituali i pagëzimit dhe i mirosjes bëhen në një moment në dy pjesë. Nëse është fëmijë i vogël, kur të rritet, mirosja bëhet në moshën 13-16 vjeçare. Peshkopi ose murgu, duke e lyer kokën e kandidatit me vaj thotë: *“Le të të simbolizojë ty Shpirti i Shenjtë që është dhuratë e Zotit. Zoti le të jetë bashkë me ty.”*

c. Martesa

Zakonisht realizohet gjatë ceremonisë *missa* (komunion). Për çiftet e rinj bëhet lutje speciale dhe e përgjithshme. Dy të rinjtë që do të martohen qëndrojnë përpara altarit dhe pranë tyre gjenden edhe dy dëshmitarë. Murgu mund të mbajë një ligjeratë për rëndësinë dhe seriozitetin e kurorëzimit. Ata që do të martohen pyeten se, vendimet për martesë i kanë marrë të lirë apo jo. Nëse merr përgjigje pozitive e vë kurorën, lexohen lutje dhe në fund çifti i ri dhe dëshmitarët e nënshkruajnë fletoren e martesës.

Martesa, sipas krishterimit, është një pjesë e jetës e cila simbolizon dashurinë e Zotit ndaj njerëzimit. Është një bashkim i dashurisë së dy personave, të cilët me sinqeritet dhe ndjenjë pozitive reciproke, i kanë dhënë fjalën njëri-tjetrit për përgatitjen e terrenit për rritjen e fëmijëve që do t'i lindin në të ardhmen në besimin krishter. Bashkëshortëve deri sa të jenë në jetë, nuk u lejohet të ndahen dhe të rimartohen, sidomos në katolicizëm.

ç. Misteri i priftërinjve

Individi, nëpërmjet këtij rituali jetën e tij ia premtos shoqërisë krishtere. Këto janë: Shenjtërimi i murgut, i peshkopit dhe i dhiakut. Kurse Papatë dhe Patrikana janë detyra speciale të kishës. Nuk kanë një kuptim misterik.⁴³⁷ Njeriu i shenjtëruar llogaritet se ka dalë nga laicizmi dhe ka kaluar në klasën e murgërisë.

d. Pendimi

Të krishterët besojnë se kur të pendohen për shkak të mëkateve, Zoti ata do t'i falë. Atëherë i drejtohen ritualit të pendimit (rëfimit të mëkateve). Ky ritual gjatë historisë është realizuar në forma të ndryshme. Në disa raste bëhet me rëfim special të mëkateve, kurse në disa raste në mënyrë të organizuar.

Pranimi i priftit si ndërmjetës në ceremoni mbështetet në shprehjen e Ungjillit të Gjonit, (XX, 23), *“Atij që ia falni mëkatet, Perëndia ia ka falur, e kujt nuk ia falni Perëndia nuk ia ka falur”*. Gjegjësisht prifti në ceremoni llogaritet si i obliguar dhe i autorizuar nga ana e Jezusit. Besohet se me pranimin e mëkatit të individit nga prifti, mëkati është i falur edhe nga Zoti.

dh. Vajimi i shenjtë

Të krishterët besojnë se Zoti, Jezusin e ka dërguar për shërimin e sëmundjeve ose për përgatitjen e tyre për vdekje. Mendojnë se Jezusi ka qëndruar pranë tyre në momentin e sëmundjeve të rënda dhe

⁴³⁷ Mitchell, f. 92.

vdekjes. Me këtë ai nuk i ka lënë ata që të ndjehen të vetmuar. Vajimi i të sëmurve është bërë ose individualisht ose në mënyrë të përbashkët. Nëse bëhet në mënyrë të përbashkët, të sëmuret bashkë me grupin e njerëzve tubohen në kishë, pas një lutjeje të shkurtër lexohen pjesë nga Ungjilli, kurse murgu me një predikim shpjegon kuptimin e kësaj ceremonie. Gjatë ceremonisë bëhen lutje. Nëse ceremonia bëhet individualisht, atëherë ajo bëhet e shkurtër, kurse balli i të sëmurit dhe duart e tij lyhen me vaj.⁴³⁸

e. Kungimi (eucharistia)

Është prej themeleve të adhurimit dhe besimit krishter. “*eucharistia*” do të thotë *të falënderosh*. Kjo ceremoni është përsëritje e darkës së fundit, të cilën Jezusi para vdekjes e ka ngrënë me dishepujt e tij. Besohet se në këtë ritual me verën dhe bukën, të cilat simbolizojnë gjakun dhe mishin e Jezusit, trupi i Jezusit është bashkuar me trupin e dishepujve të tij. Besohet se vera dhe buka që përdoren në ceremoni janë *gjaku* dhe *mishi* i Jezusit. Katolikët këtë ritual e përsërisin çdo ditë, kurse ortodoksët e praktikojnë në ditën e diel dhe në ditët e festave. Ndërkaq për protestantët është e mjaftueshme që kjo të festohet një herë në muaj ose katër herë në vit.⁴³⁹

9. Adhurimet

Si në çdo fe, ashtu edhe në krishterim ka disa rituale në bazë të fraksioneve dhe shteteve të ndryshme.

a. Ceremonia e kungimit (missa)

Është njëri nga adhurimet më me rëndësi dhe më të përhapur. Përbëhet prej dy pjesëve kryesore. Në pjesën e parë predikohet edhe pastaj lexohen pjesë nga libri i shenjtë dhe bashkë me këta bëhen shpjegime në lidhje me aktualitetin. Pjesa e dytë është pjesa e ceremonisë. Murgu, sipas domethënies së ditës, vishet me tesha me ngjyra të ndryshme. Për shembull, për Krishtlindje (Noel) dhe Pashkë vishet me të bardha, në ceremonitë normale të dielat vishet me të gjelbërta, kurse në ceremonitë për të vdekurit me të zeza. Në ceremoni këndohen këngë fetare, kryqëzohen dhe bëhet lutje dhe pendim. Nga prifti i cili qëndron pranë altarit, vera dhe buka shenjtërohet për Zotin. Lexohen këngë fetare dhe lutje falënderimi. Buka dhe vera shenjtërohen me lutje. Në disa lutje dhe këngë fetare merr pjesë komuniteti. Buka dhe vera e shenjtëruar i ndahet popullit. Rituali përfundon me lutjen.

b. Kryqi

Kryqëzimi është një lloj lutje më e thjeshtë dhe më e përhapur. Besimtari katolik së pari dorën e djathtë e çon në ballë, pastaj në kraharor, pastaj në shpatullën e djathtë dhe më në fund në shpatullën e majtë. Duke e bërë këtë thotë: “*Me emrin e Atit, Birit, dhe Shpirtit të Shenjtë. Amen!*”. Rregulli i mënyrës së realizimit të simbolit të kryqit ndryshon sipas fraksioneve.

c. Lutja e Zotit (Jezusit)

Edhe kjo është njëra nga lutjet më të përhapura. Kjo gjithashtu, ka rëndësinë, përafërsisht, të sures Fatihë në Kur’an. Përmbajtja është kjo:

⁴³⁸ Jacob, *Hristijyan Kiliseleri ve İbadet Yerleri*, f. 35.

⁴³⁹ Michel, f. 94; Për më tepër shih, *Hristijyan İnanca*, f. 291-377.

“Ati ynë në qiell, t’u lartësoftë emri, ardhhtë sundimi Yt, si në qiell ashtu edhe në tokë, dëshira jote u realizoftë. Ushqimin tonë të përditsbëm falna edhe sot. Sikur që i falim ata që na bëjnë keq, edhe Ti na i fal mëkatet tona. Neve na mbro nga mëkatet dhe na shpëto nga të këqijat!”⁴⁴⁰

ç. Lutjet e tjera

Lutjet e mëngjesit dhe të mbrëmjes janë lutje që bëhen para dhe pas ushqimit, të cilat llogariten si lutje falenderimi etj. Është më e pranueshme që lutjet ditore të bëhen në kishë. Koha e adhurimit caktohet në bazë të gjendjes dhe atmosferës së komunitetit. Lexohen pjesë nga Libri i Shenjtë dhe këngë fetare. Adhurimi dhe lutjet javore të së dielës zënë një vend të rëndësishëm në jetën e të krishterëve. Kujdes të veçantë i kushtojnë edhe pastërtisë. Sipas katolikëve pjesëmarrja në këtë adhurim është e domosdoshme. Edhe lutja dhe adhurimet vjetore bëhen në ditët e festave dhe ditët e shenjta.

10. Ditët e festave

Të krishterët gjatë vitit kanë shumë ditë festive dhe ditë të shenjta, të cilat ndahen në tre grupe: krishtlindjet (noel), periudha e festës së Pashkëve dhe ditët e diela. Para krishtlindjes dhe festës së Pashkëve ka nga një periudhë parapërgatitore. Kjo periudhë vazhdon edhe para ditëve të festave.

a. Koha e krishtlindjes (Noel)

Kalendari fetar nuk i përshtatet kalendarit diellor që përdoret në punët ditore. Viti fetar fillon të dielën e katërt para festës së krishtlindjes. Në këtë ditë të diel, fillon faza përgatitore për festën e Pashkëve, e quajtur dita e vogël apo e diela e krishtlindjes, ose pritja (gjermanisht Advent, frengjisht Avent). Kjo fazë përfshin katër të diela. Në këtë periudhë të krishterët veten e tyre e përgatisin për festën e krishtlindjes, që është dita e lindjes së Jezu Krishtit. Mbajnë dietë, agjërojnë, më tepër u përkushtohen lutjeve dhe adhurimit. Krishtlindja festohet më 25 dhjetor, kurse në kishën ortodokse festohet më 6 janar. Forma e festimit dallon sipas kishave dhe rajoneve. Sipas transmetimit, për përkujtimin e Jezusit, i cili ka lindur në ahur dhe është vendosur në grazhd, bëhen disa figura të ahurit dhe të grazhdit, të foshnjës Jezus, të Marias dhe Josefit, të kaut, të gomarit dhe të disa deleve dhe të disa qengjave. Shtohen edhe statujat e astrologëve të urtë të ardhur nga lindja më 6 janar. Si stoli, që në shek. XVI dhe XVII, është filluar të përdoret edhe druri i pishës. Tradita e pishës së krishtlindjes nga Gjermania është përhapur edhe në shumë shtete. Për shkak të festës edhe fëmijëve u shpërndahen dhurata speciale. E diela që pason pas krishtlindjes i dedikohet familjes. Në ditën e diel, më 6 janar ose mes 2-8 janarit, përkujtohet ardhja e astrologëve nga lindja dhe kjo quhet festa epifania. Dita e diel që pason pas kësaj feste është festa e pagëzimit të Jezu Krishtit. Kështu edhe përfundon periudha e krishtlindjes dhe fillojnë të dielat normale.

b. Periudha e pashkëve

Kjo periudhë fillon të mërkurën e hirit dhe përfundon me festën Pentakost. Këto ditë nuk kanë datë të caktuar. Llogariten sipas datës së festës së Pashkëve. Pashkët në kishën katolike festohen të dielën e parë pas të hënës së parë të plotë. Mund të rastisë, në një ditë mes 22 marsit dhe 25 Prillit. E mërkura e hirit është fillimi i periudhës së agjërimit të madh, e cila është përgatitje për festën e Pashkëve. E mërkura e hirit rastis ditën e mërkurë të javës së shtatë pas Pashkëve. Kjo është përkujtim i dhimbjeve dhe 40 ditë me radhë agjërim të Jezusit, pasi ai para se të fillojë misionin e tij është tërhequr

⁴⁴⁰ Jacob, *Hristijyan Kiliseleri ve İbadet Yerleri*, f. 15.

në shkretëtirë. Ditën e parë të kësaj faze të agjërimit, gjatë ceremonisë së kungimit hiri i shenjtë përzihet dhe hidhet në ballin ose në kokën e besimtarëve. Kjo shpreh dhimbjen dhe zemërimin. Në këtë fazë në Mesjetë janë praktikuar rregulla të ashpra agjërimi. Ndërkaq sot, në qytetet e mëdha në ditët para të Mërkurës së Hirit organizohen zbavitje dhe veprimtari të ndryshme. Në Mesjetë para agjërimit kishte zbavitje, pastaj deri në Festën e Pashkëve nuk haheshte ushqime me mish. Gostia ishte ushqimi i fundit me mish dhe për këtë quhej “Carne Vale”, që do të thotë “lamtumirë mish”. Sot kjo traditë është shndërruar në zbavitje marramendëse që nuk kanë të bëjnë me fenë.⁴⁴¹ Javës së para Festës së Pashkëve i thuhet java e shenjtë ose java e madhe. Të eijnjtën, të premtën, të shtunën dhe të dielën bëhen rituale speciale. Festa e Pashkëve festohet për përkujtimin e ringjalljes së Jezu Krishtit. 40 ditë pas kësaj festohet festa e ngritjes së Jezusit, me bindjen se Jezusi është ngritur në qiell. Nëse dita e 40-të nuk bie të dielën, atëherë përsëri kjo veprimtari lihet për të dielën. 50 ditë pas Pashkëve, për përkujtimin e zbritjes së Shpirtit të Shenjtë apostujve të tubuar në Jerusalem, festohet festa Pentokost.

c. Festimi i ditës së diel

Ditët e diela të rëndomta të vitit nuk kanë ndonjë specifike. Vetëm se festat si triniteti, kungimi, mbretëria e Jezu Krishtit, festohen me një kujdes pak si më të veçantë. Përveç këtyre ka edhe festa të shenjtorëve, të cilat dallojnë sipas kishës së shteteve. Numri i tyre është i madh. Kishat për këtë përgatisin kalendare të posaçme.

11. Kisha dhe pjesët e saj

Fjala *kishë* rrjedh prej fjalës greke “ekklessia”, që ka kuptimin “*me tubuar*” dhe “*tubim*”. Sipas kësaj, fjala kishë ka kuptimin “*tubimi i komunitetit kishtar*”. Vetëm se, përveç kuptimit si ndërtesë dhe si vend, ajo ka një kuptim edhe më të rëndësishëm, e që është komunitet, shoqëri krishtere. Me fjalë të tjera ajo përdoret edhe në kuptimin “fraksion”. Në këtu do të përqendrohemi në kuptimin e parë të saj, gjegjësisht në kuptimin e ndërtesës së shenjtë.

Vendet e adhurimit krishter janë të madhësive të ndryshme, mund të jenë të mëdha ose të vogla, a mund të jenë edhe të stileve të ndryshme arkitekturale. Kishave të vogla u thuhet “shapel”, kurse të mëdhave “katedrale”. Edhe stili arkitektural ndryshon sipas fraksioneve. Për shembull, kishat ortodokse në përgjithësi janë me kupolë, kurse në perëndim janë në stilin gotik, barok etj. Ajo që ato i dallon nga kishat tjera është se ato pranë tyre kanë një apo më shumë kulla këmbanash. Këto kulla tregojnë vendin e kishës dhe me tingujt e këmbanave të tyre shpallin orën e ritualit fetar. Kishat e fshatrave në përgjithësi i përngjajnë një korridor apo një saloni të madh dhe nuk kanë ndonjë stil arkitektural. Kishat e mëdha reflektojnë specifikat e rajonit dhe të periudhës kur janë ndërtuar. Para derës kryesore hyrëse të kishave të mëdha gjendet një hangar ose një strehë. Këto hangare janë të stolitura me statuja të shenjtorëve dhe me statuja ose shkrime nga Ungjilli që shprehin jetën e Jezusit.

Dy anët e salonit, me të cilat ballafaqohesh me të hyrë në kishë, janë të mbushura me karrige. Korridori mbaron para se të arrihet përballë salonit. Kësaj zbrazëtie i thuhet vendi i korit. Vendit ku gjendet korridori i thuhet trup. Pjesa e salonit, përgjithësisht, ndahet me tre kolona shtyllash. Kurse në pjesën hyrëse, në të dy anët, në mur ose në rreshtat e parë apo në njërin prej rreshtave gjendet varur nga një enë e shenjtëruar për ujë. Në këto enë gjendet ujë i shenjtëruar që kuptohet prej emrave të tyre, kurse besimtarët që hyjnë në kishë i lagin gishtat e dorës së djathtë, pastaj me këtë dorë bëjnë shenjën e kryqit. Me këtë ai tregon se adhurimi është kryer dhe se ai ka dalur përpara Zotit. Më tutje, afër murit ose në skaj shihen dy qeli për faljen e mëkateve. Sidomos në një anë të pjesës hyrëse gjendet tinari pagëzues ose dhoma e pagëzimit. Muri përballë hyrjes, gjegjësisht pjesa e përparme e salonit drejt brendisë merr një formë të dhomës me lakime. Kësaj pjese i thuhet “apsis, altar”. Ortodoksët kësaj pjese i thonë “ikonostas”. Në krye të kësaj pjese, përpara murit, gjendet edhe një altar i madh dhe i zbu-

⁴⁴¹ Vep. e cit., f. 24.

kuruar. Në murin pas altarit gjenden një kryq i madh dhe një statujë ose një grup fotografish. Në mesin e këtij altari kryesor, nën statujë apo nën kryq, gjendet dollapi, i cili i ngjanë një dollapi të vogël, ku qëndrojnë buka dhe vera e shenjtë. Ai përgjithësisht është i mbuluar me një stof të bukur. Në disa kisha, ky dollap mbrojtës, fshihet në murin e anës së djathtë të korit.

Në dy pjesët e salonit, duke vazhduar drejt apsisit, ka katërmbëdhjetë tabela të varura në mur. Zakonisht ato shprehin dhembjet e Jezusit. Pjesës ku gjenden këto tabela i thuhet “*rruga e kryqit*”. Të krishterët fetarë ndalen para çdo tabele, mendojnë për figurat dhe luten. E ndjekin rrugën e kryqit dhe e plotësojnë atë. Sidomos para pashkëve, në kohën e agjërimit, kanë shumë përparësi.

Altari, është element shumë i rëndësishëm i kishës. Ai gjendet në pjesën e korit të kishës, në pjesën ku mund të shihet lehtë nga çdo anë e kishës. Altarët në kishat e vjetra kanë qenë të thjeshtë, kurse në periudhat e mëvonshme janë bërë më madhështorë. Zakonisht mbi ta gjenden dy qirinj, të cilat ndizen gjatë ceremonisë së kungimit (*missa*) dhe ceremonive të tjera. Altari gjithmonë është i mbuluar me mbulesë të bardhë.

Kryqi, i cili simbolizon vdekjen e Jezusit dhe shpëtimin e njeriut nga mëkati i përhershëm, është dylllojesh. I pari, Jezusin e paraqet të varur, gjë që paraqitet te katolikët dhe te ortodoksët. Në të dytin, nuk ka statujë dhe shembëltyrë të Jezusit. Simboli përbëhet vetëm prej katër krahëve lakuriq. Edhe kryqi i protestantëve është i njëjtë. Së pari mbi kryq gjendet një tabelë e vogël dhe shkronjat INRI, kuptimi i të cilave është “*Jezusi nga Nasira, Mbreti i hebrenjve*”, gjegjësisht janë shkronjat e para të shprehjes latine “*Jesus Nazarenus Rex Indaeorum*”. Sipas formës ndryshojnë edhe emrat e tij. Për shembull, kryqi Antonius është në formë të T-së së madhe, gjegjësisht nuk ka krahë të epërm. Kryqi andreas është me katër krahë të kryqëzuar, gjegjësisht është në formë të X-it. Kurse kryqi grek të katër krahët i ka në formë të + -it. Kryqi rus ka tre krahë horizontal kurse krahun e mesëm e ka më të gjatë.⁴⁴²

12. Hierarkia e kishës

Kisha e parë krishtere përbëhej prej komuniteteve të ndryshme të lidhura vëllazërisht njëra me tjetrën. Qysh në periudhën e paraqitjes së ungjijve (50-150) shihen disa ndarje profesionale si *apostull*, *mësues*, *kryetar komuniteti* (peshkop) dhe *ndihmësit e tyre* (dhiakët). Ende nuk kishte një organizatë stabile, detyra dhe rregulla të përkufizuara. Kisha vetveten e shihte si vazhdim i trupit, i ekzistencës së Krishtit nën udhëheqjen e Shpirtit të Shenjtë. Por, ishte e nevojshme të caktohet se, Shpirti i Shenjtë ku dhe kur dhe në cilin individ gjendet. Kurse ky përcaktues ishte vetë kisha. Kurse ndarja e detyrës është bërë në fund të shek. I në Romë. Posti peshkop, në fillim ishte posti për mbrojtjen e kishës. Më pastaj e mori edhe udhëheqjen e komunitetit. Zëvendësit e saj ishin priftërinjtë, të cilët udhëhiqnin kishën. Peshkopi mund t’i thërriste të gjithë priftërinjtë e tjerë dhe t’u jepte poste. Të gjitha detyrat si pagëzimi, falja e mëkateve, udhëheqja në adhurim, pranimi në komunitet dhe nxjerrja nga komuniteti (ekskomunikimi) ishin nën udhëheqjen e tij. Këshu u hodhën themelet e para të një kisha të organizuar autoritative. Rajonet e priftërinjve të udhëhequra nga murgjit, i hasim në shek. IV. Ndërsa pozita e dhiakut ekziston që në kohën e apostujve, e cila në fillim haset si shërbim në përkujdesjen ndaj të sëmurëve dhe në ceremoninë e komunioneve. Përafërsisht pas viteve 250 kryedhiaku rastiset edhe në poste të tjera nëpër kisha të vogla, si ndjekës të së parës. Këto së pari janë praktikuar në Romë. Ndalea për martesën e peshkopëve dhe të priftërinjve ekzistonte si një rregull i vjetër. Vetëm se, edhe pse në fillim ndokush bëhej peshkop ose prift, jetën e tij familjare si i martuar kishte mundësi që ta vazhdojë. Ndalea e martesës për së pari herë u soll në Koncilin e II të Lateranit (1139). Punëtorët e kishës, qysh në shek. V, si shenjë e detyrës që kryenin, filluan të qethin majen e kokës në formë të rrumbullakët, të cilës i thonin “*tonsur*”.

Ndarja definitive mes priftërinjve dhe komunitetit lindi në vitin 95. Me zhvillimin e doktrinës së suksesionit në kishë, kjo ndarje u përforcua më shumë.⁴⁴³ Sepse për shërbime në kishë Jezusi caktoi

⁴⁴² Vep. e cit., f. 16 dhe në vazhdim.

⁴⁴³ *Sukcesion* është zinxhiri i pandërprerë i emrimeve dhe i shenjtërimeve në mënyrë hierarkale të shpirtërorëve të kishës prej Jezusit e deri te prifti i fshatit.

apostujt, kurse apostujt caktuan peshkopët dhe dhiakët. Pra, çdo nëpunës ishte i dërguar dhe zëvendës i Jezusit, Kështu peshkopët bëheshin posedues të të tre kompetencave të apostollisë dhe të priftërisë. Kompetenca për mbrojtjen e fesë dhe të komunitetit u jepej peshkopëve. Edhe kompetenca e caktimit të nëpunësve u lihej atyre. Shpërblimi i Shpirtit të Shenjtë, për të cilin besohet se gjendet në ta, vinte nga shenjtërimi që i bëhej postit. Ky shpërblim vazhdonte tërë jetën dhe nuk zhdukej asnjëherë. Për këtë arsye, sipas katolikëve, një klerik asnjëherë nuk mund të hiqet prej detyrës së tij. Kjo doktrinë është vërtetuar, përforcuar dhe është zhvilluar nga etërit e kishës. Kjo është edhe forma e lindjes së një kishe të organizuar.

Që në shek. II, me një vetëdije bashkimi, në kishë mbahen tubime peshkopësh për shqyrtimin e çështjeve gjenerale. Që nga viti 250 haset në koncile rajonale të përsëritura, në të cilat kanë marrë pjesë të gjithë peshkopët e rajonit në perandori. Koncili mbahet në mitropolinë e rajonit. Peshkopi i mitropolisë bëhet mitropolit dhe ishte udhëheqës juridik i peshkopëve të rajonit. Kisha, e cila udhëhiqej nga grupi i peshkopëve, pretendonte se gjatë kohës ka qenë burim i vetëm i shenjtë. Për këtë kisha u bë organizatë bashkuese dhe lidhëse e popujve të ndryshëm të Romës antike, në një komunitet të vetëm.

Papati

Njëra prej temave më diskutabile mes fraksioneve krishtere është koha e njohjes së autoritetit të peshkopit të Romës mbi peshkopatat e tjera në perandori. Viktori (190-191), peshkopi i Romës, për shkak të ndarjes së Kishës së Anadollit nga ajo e Romës, në lidhje me çështjen e datës së festës së madhe të Pashkëve, iu kërcënua asaj se do ta përjashtojë nga kisha.

Por, sipas katolikëve, fillimi i peshkopit të Romës, gjegjësisht autoriteti i Papës, shkon shumë më herët dhe bashkangjitet me themelimin e parë të kishës. Kurse Jezu Krishti për atë që do të ishte pasues i tij, sipas asaj që shprehet në Ungjillin e Mateut, me fjalët “*Ti je guri mbi të cilin do të themeloj kishën timë*”, sinjalizon Pjetrin. Kjo fjalë është shkruar me tabela të arta në kupolën e brendshme të kishës së Pjetrit në Romë dhe kinse asaj ia ka dhënë udhëheqjen dhe autoritetin absolut të kishave. Kurse ebionitët, të cilët më vonë janë fajësuar me herezi, mohojnë Pjetrin si pasues dhe thonë se pasues i Jezusit është Jakobi, kurse Pjetri, sipas tyre, i ka raportuar Jakobit. Megjithatë, mund të thuhet se, krahas autoritetit të Jakobit në Jerusalem ka mundësi që në Romë të ishte rritur ndikimi i Pjetrit në udhëheqjen e komunitetit. Në fakt, pas vrasjes së Pjetrit më 63, pasuesi i tij në peshkopatën e Romës, e ka mbrojtur autoritetin e tij mbi kishat e tjera. Krahas të gjitha kundërshtimeve është e vërtetë se, pas një kohe i kanë detyruar që ta pranojnë epërsinë e tij. Peshkopi i parë, i cili postin e tij e llogaritte të njëjtë dhe e unifikoi atë me postin e Pjetrit, ishte Calix I (221-227). Në fund të shek. III, situata ashtu ishte zhvilluar sa që peshkopi i Romës pretendonte se është “papë”, zëvendës i Jezusit në tokë (*Vicarius Christ*), dhe se vetëm ai mund të sillte vendim për parimet fetare. Gjithashtu, pas kësaj, ky ishte posti më i lartë për çështjet fetare dhe për udhëheqjen e kishës. Përmbajtja e mendimit papist të Romës ishte çështja e pasimit të Pjetrit dhe e dogmatizimit të postit të tij.

13. Ndarja e kishës në katolike dhe ortodokse (great schisma)

Termi *schisma* (ndarja), simbolizon një ndarje në mes dy grupeve krishtere, që në esencë nuk bazohet në ndarje doktrimore. Ndarja në mes kishës lindore dhe perëndimore është rezultat i një zhvillimi që vazhdon shekuj me radhë. Kisha romake mbronte mendimin se, kishat krishtere duhet të udhëhiqen nga peshkopë botërorë që veprojnë bashkë, kurse shoqërinë e peshkopëve ta udhëheqë peshkopi i Romës, gjegjësisht Papa. Ata kishin bindjen se, për shkak se Roma ishte qendra e parë e perandorisë, ajo duhet të ishte edhe qendra e parë e peshkopatave të rajoneve të tjera. Ndërkaq, sipas bindjes së kishave të Konstantinopojës (Stambollit), pesë qendrat e vjetra të krishterimit, si Jerusalemi, Antakia, Roma, Aleksandria dhe Kontantinopoja, kishin kompetenca të njëjta. Edhe krahas këtij mendimi dallues në lidhje me kompetencën në kishë, deri në shek. IX vazhdoi një bashkim i pjesërishtëm. Ndarja e parë provizore u paraqit në kohën e Fotiusit, patrikut të Konstantinopojës. Në

shekujt e mëvonshëm kishat një herë u ndanë e pastaj u bashkuan. Ndarja definitive në mes të Konstantinopojës dhe Romës u bë më 1054. Lindja dhe perëndimi u ndanë nga njëra tjetra në aspektin gjuhësor, kulturor dhe në aspektin e karaktereve të popujve të ndryshëm. Papët e vazhdonin autoritetin e tyre në Europë. Mbretërit kurorat e tyre i merrnin me dorën e papëve, gjithashtu me dorën e tyre ata edhe pagëzoheshin. Kurse zhvillimet në Bizant ishin krejt të tjera. Këtu sundimtarët sunduan edhe kishën. Patriku ishte një lloj peshkopi në pallatin mbretëror. Nuk kishin mundësi të kritikonin lëvizjet e mbretërve. Ishin të detyruar që vetëm të duartrokisnin dhe të bëjnë lutje për ta. Ndërkaq në Romë, ndikimi në jetën botërore ishte një specifikë e kishës. Kështu që, në dukje janë zhvilluar dy kisha, të cilat vazhdojnë edhe sot të jenë të ndara.

Shumë çështje në kishën lindore janë më të vjetra se ajo e Romës. Besimet e tyre bazohen në vendimet e koncileve të mbajtur mes shek. IV-IX, të cilat nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha. Ky tradicionalizëm vetvetes ia ka dhuruar titullin “ortodoks”. Fetaria në kishën ortodokse është një kult që simbolizon afërsinë e Zotit ndaj botës. Ai që këtë kult e realizon në bazë të rregullores llogaritet për ortodoks. Në vitin 726, zënkat për shenjtërimin e ikonave të shenjtoreve të paraqitura në Bizant, edhe më tepër e thelluan humnerën mes lindjes dhe perëndimit. Ikonat janë pranuar si fotografi të shpallura të ngjarjeve dhe paraqitjeve hyjnore dhe është porositur që këto të adhurohen dhe të respektohen. Altari dhe muret e brendshme, të stolisura me ikonat e Jezusit, të engjëjve dhe të shenjtoreve, janë të ndara nga saloni. Kurse në vitin 1054, mosmarrëveshja për të drejtat e patrikut u bë shkak për ndarjen e plotë të dy kishave nga njëra tjetra.

Në aspektin e besimit, për shkak të fjalës *filioque* (dhe i Biri), që bën pjesë në “credo”, gjegjësisht në rregulloren e besimit, ka depërtuar edhe një dallim. Katolikët dhe protestantët me deklarinimin e kësaj fjale deklarojnë se Shpirti i Shenjtë buron edhe nga Ati edhe nga i Biri, të cilët veprojnë bashkë. Kurse ortodoksët besojnë se Shpirti i Shenjtë buron vetëm prej Atit dhe shprehjen e lartpërmendur nuk e përdorin fare.

14. Sundimi botëror i papatit dhe shkatërrimi politik

Në fillimin dhe në zhvillimin e autoritetit botëror të papatit, në fushën juridike gjatë tërë mesjetës, kanë luajtur një rol të madh dy dokumente të falsifikuara, të cilave u është besuar. Njëri nga ata ekziston që në shek. VIII dhe supozohet se është dhuruar nga Konstantini. Sipas kësaj, perandori vërteton epërsinë e Romës dhe papës i jep, krahas sundimit të tij shpirtëror, edhe sundimin botëror të Romës, Italisë dhe të të gjitha rajoneve në Perëndim. Ky dekret historik, i cili e njeh epërsinë e papës në perandorinë Romake perëndimore, u bë shkak për përzierjen e mbretit frenk Pippi në punët e brendshme të Italisë dhe për themelimin e një shteti kishtar. Kjo bëri që papa 1100 vjet të jetë forcë politike botërore.

Një dokumentacion artificial në burimin e jurisprudencës kishtarë, daton prej shek. IX. Këtij dokumenti i thuhet “Urdhër pseudoisidor”. Sipas këtij peshkopët nuk janë as mitropolitë e as sundimtarë botërorë të vendit. Kështu që, me vendimin për sundimin qendror të papës është vërtetuar sundimi politik i papës në Romë, kurse pozita e peshkopëve është dobësuar. Nikolausi I (754-814) “Pseudoisidorin” e ka vlerësuar si një mbështetje të peshkopatës së përgjithshme të Papës. Karli i madh (768-814) ka poseduar një autoritet mbi kishën dhe Papën e ka ulur në nivelin e peshkopit të një rajoni. Por, kjo ka qenë kalimtare, kurse situata reale nuk ka ndryshuar.

Vetëm se, Papati karshi aristokratëve të Romës ka rënë në gjendje të vështirë, ndërkaq sundimtarëve gjermanë ua ka kthyer shpinën. Kurse titullin “Perandor i Perëndimit” më 962 ia ka dhënë Otto-së së Madh, kurse pas tij pasuesve të tij. Heinrich III (1039-1056), njëri prej sundimtarëve të mëdhenj gjermanë, në Koncilin Sutri (1046), e shpëton Papatin nga shkatërrimi dhe për papë shpall një gjerman. Papati pas kësaj, ka luftuar për mbrojtjen nga dhuna e sundimtarëve të ndryshëm. Kjo luftë, me anë të mendimeve reformiste të përhapura nga manastiri Clany, u bë kundër dhënies me ryshfet të posteve kishtarë atyre që janë laikë dhe që janë bërë priftër artificialisht (*simonie*). Kështu që me futjen

e caktimit të peshkopëve dhe të kryemurgjve të manastireve nën autoritetin e mbretërve gjermanë, përzjerja e shtetit në fe arriti kulmin.

Papa Gregori VII (1037-1085) botën dëshironte ta sundojë nën idealin “*Shteti i Zotit*” të Augustinit. Për këtë arsye, udhëheqësinë e kishës ua dha murgjve. Duke e ndaluar caktimin në poste të kishës, të atyre që nuk janë klerikë (1075), e filloi luftën me mbretin e ri Heinrich IV. Mbreti Heinrich në koncilin Worms, peshkopët gjermanë i detyroi që ta suspendojnë papën. Por, për shkak se fetarët e shtetit ishin në anën e papës, kjo luftë rezultoi në dëm të mbretit, kurse papa duke e suspenduar mbretin gjerman e shpalli edhe heretik. Për këtë, ata që ishin rreth mbretit e braktisën atë. Herezia zgjati deri kur Heinrich IV në vitin 1077, me këmbë zbathur nëpër borë, shkon prej Cannosa në sarajin e Papës, gjunjëzohet përpara tij dhe i lutet t’ia falë gabimin. Edhe papa Gregori VII nuk mbeti gjithnjë fitimtar, por, u syrgjynos dhe vdiq në mënyrë të dhimbshme. Lufta papë-mbret për emërtimin e peshkopëve, në vitin 1122, përfundoi me paraqitjen e kandidatit nga ana e mbretit dhe emërtimin e tij nga ana e papës. Pas shenjtërimit të kandidatit për peshkop, unazën dhe shkopin ia dhuronte papa, kurse shkopin e quajtur “*skeptër*”, që është simbol i sundimit ia dhuronte mbreti.

Papati posedonte një fuqi të pakufizueshme dhe ishte i vetëdijshëm për këtë. Ishte zotëri i botës dhe i kishës. Ai nuk ishte pasues vetëm i Pjetrit, por, edhe zëvendës i Jezusit dhe i Zotit në tokë. Në mesin e çështjeve që kanë të bëjnë me pozitën e tij janë: *i pamëkati* dhe *i pagabueshëmi*. Ai rregullonte dhe udhëhiqte çdo gjë, kurse ai nuk mund të udhëhiqej nga askush. Perandorët dhe princat ishin nën udhëheqjen e papës. Ata ia puthnin këmbët atij dhe duke e kapur kalin i jepnin besën atij. Ai ata mund t’i shkarkonte dhe mund që besën të mos ua pranonte. Papët, për këtë arsye, si shenjë pozite, që në shek. XIV, bartnin kurorë me tre sqepa të quajtur “*tiara*”.

Sundimi botëror i papatit arriti shkëlqimin e tij me shpërndarjen e Perandorisë Gjermane. Konradini, që ishte kundër papës, pasi ky nuk e kishte miratuar kandidimin e tij për mbret në Perandorinë Gjermane, u nis drejt Italisë, ku më 1268 e humbi luftën në Napoli dhe u ekzekutua duke iu prerë koka. Papa Bonifazi VIII (1294-1303), duke u bazuar në fjalët e Thomas Aquinasit, shpalli se për shpëtimin e shpirtërave është e domosdoshme që ata të hyjnë nën urdhërin e Papës. Me këtë ishte për qëllim politika botërore. Por, pasuesi i Bonifazit VIII u detyrua t’i nënshtrohej Francës, që zotëronte një bashkim popullor. Kështu që papët, fuqia politike e të cilëve iu ishte marrë mes viteve 1309-1377, ishin të detyruar të sundojnë në Avignonin francez. Në vitin 1336 dekreti i papatit zhdukoi rolin e papës në zgjedhjen e mbretit gjerman. Ndarja në dy pjesë, në Romë dhe në Avignon, e papatit në Koncilin Konstanz (1414-1418) mori fund (37 vjet papët qëndronin në Romë dhe në Avignon). Edhe pse në një koncil tjetër të mbajtur në Bazel, është dashur të bëhen reforma për anëtarët e kishës, por ai nuk ka qenë i suksesshëm.

15. Fetarësia e popullit

Fetarësia nuk ka ndikuar vetëm në shpirtërat e të zgjedhurve, por, me anë të koncepteve të komunionit dhe të pasionit (vdekja dhe ringjallja e Jezusit), me dashurinë për Marian, ka ndikuar në tërë katolicizmin dhe aty ka formuar format e reja të saj. Edhe fetë idhujtare të keltëve, romakëve dhe të xhermenëve të vjetër, një kohë të gjatë i paraqitën ndikimet e fuqishme të tyre. Kulti i gjërave që i kanë prekur shenjtoret në jetën e tyre të përditshme, janë ekspansionuar në një hapësirë të gjerë. Përveç respektit ndaj epërsisë etike të shenjtoreve ndihej edhe nevoja e respektimit të fuqive mistere të *religjinëve* (mbeturinave të shenjta), me lutje dhe me kontaktin me to, shfrytëzoheshin fuqitë mistere të tyre. Për shembull, që shumëkush të ketë mundësi të kontaktojë fizikisht me ta, eshtrat e shenjtoreve ndaheshin në pjesë të vogla dhe shpërndaheshin. Besohej se me fuqitë mistere të mbeturinave të trupave real ose të paramenduar të shenjtoreve, kalonin në trupin e atyre me të cilët kontaktonin. Prej gjërave të shenjta, për të cilat lutja dhe respekti ishin qyti (tuni) femënor i Jezusit, druri ekzekutues me gjemba, shkopi dhe brezi i tij, teshat e Marias, shkallët e gjykatës së Platusit, për të cilat besohet se janë dërguar në Romë dhe për në shtëpinë e familjes së shenjtë (familjes së Jezusit) dhe për të besohet se ka zbritur në Loreta me dorën e engjëjve. Populli, besonte se me prekje shfrytëzonte nga ata fuqinë magjike dhe mistere, edhe shenjtoret i thërriste për nevojat e tij të përgjithshme. Tashmë besimet e

këtilla zinin vendin e hyjnive parakristiane. Laurentiusi, që u dogj mbi kalë, llogaritet si mbrojtës nga zjarri dhe prej sëmundjeve me zjarr dhe si më i vjetri bukëpjekës thirret në ndihmë për profesionin që i përshkruhet atij. Shën Wandel dhe Shën Leonhard llogariten si mjekë të sëmundjeve të kafshëve, Shën Otilia dhe Klara si mjekë të dhembjeve të syve. Shën Pjetri ishte shenjtori i ajrit. Statujat e shenjtorëve, si idhujt e periudhave të lashta, pasi putheshin nga besimtarët, luteshin dhe shenjtëroheshin. Sakrifika më e pranuar ishte ndezja e një qiriu të madh ose të vogël nga lutësi në kishë. Sikur që shumë shenjtorë kanë marrë vendin e zotave të vjetër keltë dhe xhermenë, ashtu edhe shumë vende të vjetra të shenjta, zabele, burime etj., janë bërë vende të shenjta për vizitë në krishterim. Në fakt këto vende ishin vende të kulteve natyrore të idhujtarëve. Edhe sipas legjendave të shumta fillimi i vendeve të shenjta dhe i fotografive lartësoheshin mbi natyroren. Kjo nuk ka ndikuar vetëm në fetarinë popullore, por, ka ndikuar edhe në kishë. Sikurse më përpara, nëpër rrugë të qyteteve është shëtitur me portretet e zotave të idhujtarisë, edhe sot duke bërë ceremoni, shëtitet nëpër rrugë me relikte (*reliquine*) të shenjtorëve. Në vend të shenjtërimit të pelave, bëhej shenjtërimi i kuajve. Vendin e sakrificës të idhujtarëve e ka zënë sakrifika krishtere. Në vend të sakrificës së alkoolit, bëhet shenjtërimi i verës. Kisha, këtyre adhurimeve u ka luftuar vetëm anën idhujtare të tyre; duke i komentuar me kult krishter, është munduar që t'i krishterizojë. Gratë fallxhore, që janë murgesha të feve të vjetra, i ka cilësuar si shenjtor dhe si demonë. Kurse ata që janë marrë me fall dhe me magji, gjykata e inkuizicionit i ka vrarë në mënyrë të tmerrshme.

16. Lufta me herezinë

Në Mesjetë largimi nga parimet katolike ishte mëkat që e bënte të nevojshëm mallkimin, gjegjësisht luftën me herezinë dhe inkuizicionin. Pas kësaj, kisha për përndjekjen e heretikëve thirri në ndihmë fuqinë shtetërore. Organizata e inkuizicionit dhe çështja e përndjekjes së heretikëve për herë të parë doli në shesh në Koncilin e Veronas që është mbajtur në vitin 1184. Vendimet e Koncilit të Veronas janë vërtetuar edhe në koncilin IV të Lateranit (1215). Papa Gregori IX në vitin 1231 formoi inkuizicionin e papatit. Ata që punonin në këtë organizatë ishin anëtarë të rendit dominikian dhe françeskan. Të dyshuarit u nënshtroheshin torturave të ndryshme dhe detyroheshin që t'i tregojnë gabimet e tyre. Pasuria e tyre i jepej shtetit (nacionalizohej), kurse ata futeshin në burg dhe dënoheshin me djegie. Para realizimit të dënimit, duke iu veshur tesha dhe kurorë tallëse, i shëtisnin nëpër qytet hipur në gomar. Inkuizicioni aktivitet më të madh ka paraqitur në shek. XV në Spanjë, kurse në shek. XVI në Holandë dhe në Itali. Teologjia krishtere e mesjetës e ka mbështetur këtë. Murgeshat e fesë së vjetër të idhujtarisë janë llogaritur shtriga dhe gra të satanit, të cilat kanë shijuar fatin drastik të heretikëve. Papa Inozenci VIII me dekretin e tij të vitit 1484, ka urdhëruar që të digjen shtrigat. Kjo dhunë përfundoi me ndikimin e periudhës së iluminizmit dhe të reformizmit.

17. Rrymat e kundërta

Nga nevojat e popullit të pakënaqur fetar, pjesërisht të pëlçitura nga dhuna shekuj me radhë, dolën rryma të reja dhe gradualisht e prishën njësinë e kultit të kishës. Kryqëzatat dhe përhapja e imperializmit papist, në fakt përgatiti shkatërrimin e saj. Papa u detyrua të shkojë në azil në Avigon. Papët e renesancës për t'i realizuar nevojat ekonomike të organizatës së qeverisë të papatit, postet klerikale i ndanin me ryshfet dhe i shitnin me para. Kjo u bë shkak për shkatërrimin e shpejtë të autoritetit shpirtëror të papatit. Kundër amoralitetit dhe kompromentimit dhe kundër shekullarizimit të pozitivave të larta kishtarë, nën udhëheqësinë e kishës, doli Savonarola (1452-1498) me ligjëratat e tij. Savonarola në vitin 1498 në ligjëratën e tij të mbajtur me rastin e Agjërimit të Shkurtit, shprehet kështu:

“Të këqijat dalin prej Romës dhe i kalojnë të gjitha kufijtë. Ato janë më të këqinj se turqit dhe arabët. Nëse shikoni Romën do të shihni se e gjithë kisha dhe prona e saj janë fituar me ryshfet. Sidomos me një trimëri për vëllezërit dhe fëmijët e tyre me mijëra herë bëjnë mëkat. Kanë ambicie të mëdha dhe për para bëjnë çdo gjë. Në këmbanat e tyre

kumbon ambicia; priftërinjtë, në korin e kishës, në pozitat e tyre, në lutjet e mbrëmjes, shkojnë për para. Rituale të shesin; shkurt thënë, ritualet dhe çdo gjë e bëjnë për para dhe më në fund i frikësojnë të tjerët me herezi. Sa bie mbrëmja njëri shkon të luaj e tjetri te e dashura. Kurse në ceremoninë e funeralit shkojnë për shkak të gostisë që bëhet. Në vend që për të vdekurin të luten më shumë, ata më shumë hanë, pinë dhe bëjnë dërdëllitje...”⁴⁴⁴

Degjenerimet që përmenden këtu reflektojnë dërrmimet e brendshme që ekzistojnë që moti. Kritika e amoralitetit vazhonte shekuj me rradhë. Waldensët, përafërsisht në vitin 1176, u munduan që të praktikojnë krishterimin modest të kohës së apostujve. Por, me kryqëzatat e bëra iu nënshtruan përndjekjeve të tmershme. Mbeturinat e tyre ende sot jetojnë në Italinë e Epërme. Në vitin 1383-1384, profesori teolog në Oxford, John Wiclif, bëri të ditur se Antikrishti është vetë papa. Eshtrat e Wiclit, i cili pas vdekjes normale është mallkuar me herezi, 44 vjetë pas varrosjes me urdhërin e Papës janë nxjerrur dhe janë djegur. Si rezultat i ndikimit të letrës së Wiclit dërguar Johannes Husit (1370-1415) dhe Hierinymusit nga Praga, lindën “Hussitët dhe lëvizja e vëllezërve bohmenë”.

Johannes Hus, ishte kundër pasurisë së manastireve dhe kundër shekullarizimit të shërbimit kishtar. Ai dëshironte që pozitat kishtarë t’i jepen atij që është kompetent. Por, ai me këtë ishte kundër mendimit se kisha katolike është një organizatë pozitive. Për të mbrojtur mendimet e tij ai shkoi në Koncilin e Konstanzit. Atje, edhe pse ishte nën mbrojtjen e perandorit, u burgos dhe me fajësimin si heretik u dogj në zjarr në mes të sheshit, pasi ishte e lejuar që kundër heretikëve, që janë “*armiqtë të Zotit*”, të përdorej forca. Me qëllim që të evitohet dëmin e heretikëve dhe të devijuarve dhe për t’i pastruar ata, që nga viti 1231 ekzistonte organizata e inkuizicionit. Ata që llogariteshin si mëkatarë hidheshin në zjarr. Hus, për shkak se kërkoi lirinë e Kishës Bohmen, u dogj në shesh dhe kështu u bë trim popullor i çekëve dhe për nderë të mendimeve të tij, në vitin 1420-1436 u paraqit *lufta e hussitëve*.

Në anë tjetër në Mesjetë, shihej edhe shtimi i fetarësisë. Sipas kryetarit të Traktatit të Dominikajve gjermanë, mjeshtri Eckhart (v. 1327) dhe nxënësi i tij Johann Tauler (v. 1361), qëllimi i fetarësisë krishtere duhet të jetë manifestimi i Zotit në shpirt, si një “shndritje e brendshme”. Deri te kjo mund të arrihej me anë të qëndrimit larg botës, qetësisë shpirtërore dhe mbështetjes në Zotin. Thuhet se për këtë çështje Thomas von Kempen (1380-1471) nga Holanda, ka shkruar librin *Imitatio Christi* (T’i ngjash Krishtit). Kurse në Gjermani një libër i shkruar në vitin 1400 në lidhje me misticizmin krishter, shkrimtari i të cilit nuk dihet, është botuar me emrin e Luterit “*Theologiadeutch*”, në vitin 1516.

Renesanca dhe humanizmi, që kanë marrë si shembull botën antike, lindën në Itali dhe u përhapën në shek. XIV. Renesanca është një term në lidhje me historinë kulturore. Ajo paraqet rilindjen e kulturës dhe rilulëzimin e artit antik. Kurse humanizmi paraqet studimin e gjuhëve të vjetëra dhe edukimin e vendosur deri në brendi të popullit qytetar.

Ndërkaq thirrja, “të zbresim në burime”, para se gjithash ishte thirrje për rikthim studimit të Librit të Shenjtë. Në sajë të shtypshkronjës së formuar në vitin 1450, drita e shkencës e bëri të mundshëm dhënien e Dhiatës së Re në dorën e çdo njërit në gjermanishte dhe në greqishte. Humanizmi më i madh gjerman është ndarja nga Italia. Thirrjen e parë për shpëtimin e kishës nga ajo e Romës dhe për formimin e unit të vetë nacional, sigurisht që e ka bërë kalorësi Ulrich von Hutten (v. 1523). Për ata që ishin kundër humanizmit, ky ishte i pari që shpalli letrën “*Letra e njerëzve të zinj*”. Ai në këtë letër thoshte: “O shekull, o dituri, ajo është një kënaqësi jetike. Dituria-shkenca çel lule, lëshon shpirtëra si shiu”. Për pajtimin e krishterimit me kulturën e humanizmit është munduar edhe Johannes Reuchlin (v. 1522) dhe, sidomos, Erasmus von Rotterdam (1445-1536). Feja në veprat e Erasmusit ishte shndërruar në humanizëm. Edhe pse kisha gabimisht ka bërë luftë me Erasmusin, ai asnjëherë nuk është larguar nga katolicizmi. Humanizmi dhe renesanca kanë hapur periudhë të re dhe kanë patur ndikim të madh në zhvillimin e reformizmit. Reformizmi me parullën “*T’u kethehemi burimeve*”, si model për vete ka marrë humanizmin, i cili ishte lëvizje edukative, e nuk ishte një plaşe fetare siç ishte reformizmi. Humanizmi krishter i Erasmusit u pranua nga reformizmi, vetëm se reformizmi nuk mundi që ta zhvillojë humanizmin. Kurse duke u ndarë prej tij mori një rrugë të re.⁴⁴⁵

⁴⁴⁴ Schoeps, *Religionen*, f. 336 dhe në vazhdim.

⁴⁴⁵ Vep. e cit., f. 338.

18. Lëvizja reformiste dhe Martin Luteri

Inicuesi i lëvizjeve reformiste është Martin Luteri (1489-1546), njëri nga murgjit e *rendit Augustin*. Varja e komunikatës së njohur me 95 pika në derën e kishës Wittenberg, më 31 Tetor 1517, ka qenë shkëndija e parë e lëvizjes. Përhapja e zjarrit të reformizmit në tërë rajonin është shenjë se ai zjarr e ka mbështjellur tërë vendin. Falja e mëkateve nga ana e kishës, vërtetimi i kësaj në letër, bërja e fesë lojë, hapi rugën e zemërimit dhe të reagimit të popullit, kjo është argument për nivelin, përmasën dhe acarimin.

Lajmi, sikur shkëndija që shpërthen, u përhap në tërë Gjermaninë. Diskutimet së pari filluan në sektet e veta e më vonë në të tjerat. Reagimi i sektit të dominikajve në Romë, Luterin e fajësoi me herezi dhe gjykoji një rast të tillë. Kurse letrës së papës për herezi Luteri iu përgjigj duke e djegur përpara popullit. Djegja e këtij dekreti, që dijetarët si Peter Waldes, Wiclif, Hus, i ka dërguar në zjarrin e sheshit, pati ndikim më të madh se sa herezia. Luteri ishte njeriu i parë, i cili para se të digjet vetë, e ka djegur porosinë e papës. Luteri, me dëshirën e zotërisë të rajonit Friedrich von Sachsen, u gjykua nga perandori në Kuvendin Worms. Propozimi i përgënjeshtimit dhe i refuzimit të shkrimeve kundër pagabueshmërisë së kishës dhe Papës, nuk u pranua. Ai (Luteri) u sulmua në kthim dhe u mor nga kalorës të Kursanionit dhe u dërgua në Watburg. Luteri edhe atje e vazhdoi misionin e tij. Lëvizja kohën më të stuhishme e përjetoi në shek. XVI. Kalorësi Franz von Sickingen hapë luftë kundër princave të Trierit, e cila njihet me emrin Lufta Pfaffen (1522-1523), që është “Kryengritja e fshatarëve” (1525) të bezdisur nga dhuna e princave. Me kërkesën e lirisë nga komuniteti gjerman, u shpreh dëshira e miratimit të propozimit protestan. Luteri këto i mbështeti me një simpati të madhe. Reformizmi edhe krahas humbjes së fshatarëve, nuk mundi të bëhet as perandori e as lëvizje popullore.

Martesa e Martin Luterit me murgeshën Katerina realizoi një revolucion që s’mund të paramendohej. Martesa e një murgu të devijuar me një murgeshë për Mesjetën ishte një ngjarje që llogaritej mëkat i madh.

Edhe pse perandori Karli V dëshironte që t’i shkul rrënjët e herezisë së re, ai nuk pati sukses. Për shkak se u protestua në Kuvendin Speyer (1529), ata u quajtën “protestantë”. Edhe pse u dëshirua që besimet e tyre të pranohen, kjo u pranua vetëm pas vitit 1530 në Kuvendin e Augsburgut. Mendimet e Luterit, i cili për shkaqe sigurie nuk mundi të vijë në kuvend, i mbrojti Philipp Melanchthon (1497-1560). Në fillim, me qëllim të sigurimit të marrëveshjes me katolikët, Melanchthoni përgatiti formulën e besimit të Augsburgut (*Augsburgische Bekenntnis-Confessio Augustana*). Sipas kësaj, peshkopata, rregulli sakramental dhe teksti liturgjik janë të qëndrueshëm sipas parimeve të Kishës së Vjetër. Por, bashkimi nuk mundi të sigurohej. Në fund të dëgjimeve në kuvendin perandorak në Gjermani, u formuan dy parti. Si ngushëllim ndaj atyre që dëshirojnë shtypjen e besimit protestan në rajone, në shkurt të vitit 1531 u bashkuan në “marrëveshjen e Schmalkaldit”. Kështu që, protestantizmi bëhet një parti politike dhe perandori detyrohet ta respektojë armëpushimin.

Pas viteve të luftës periodike, në lluftën e Schmalkaldit (lufta e Muglbergut, 1547), kur protestantizmi ishte në humbje e sipër, në kuvendin Augsburg perandorak u siguroi liria fetare dhe liria e zotërinjve të rajoneve ndaj perandorit. Perandoria caktoi çështjen kryesore të lirisë fetare: i kujt është shteti, e atij është edhe feja. Ky vendim e shpëtoi katolicizmin në Gjermani. Me këtë protestantizmi arriti qëllimin më të madh të tij. Një çështje fetare zgjidhej nga pozitat gjermane, pa u marrë parasysh konciliet dhe priftërinjtë. Vetëm se, këto ishin larg kuptimit modern të lirisë fetare. Princat dhe zotërinjtë e rajoneve ishin të lirë. Kurse në kuvendin e Augsburgut nuk janë mbrojtur kalvinizmi dhe disa fraksione të tjera. Nëse ndokush nuk e pranonte besimin e zotërinjve të rajoneve, duhet që të shpërngulet nga ai vend. Të gjitha këto masa nuk kanë mundur t’i pengojnë luftërat tridhetëvjeçare.

Në aspektin e historisë së feve, vlera e Luterit mund të njihet nga pika e parë e komunikatës 95 pikëshe. Ajo pikë është:

“Nëse Jezhu Krishti thotë, pendobuni, shteti hyjnor është afër, ai me të dëshiron të tregojë se e tërë jeta e besimtarëve është pendim. Nuk është e mundur që as priftërinjtë të falin mëkate me mëshirën e kishës, e as të zënë rrugën e mëshirës së çfarëdo lloji pozite dhe mandati. Kjo më tepër varet prej të jetuarit të njeriut si besimtar. Atëherë e tërë jeta është pendim, Zoti i fuqishëm, individin e nënshtruar para Tij nuk e vlerëson sipas veprave të bëra. Ai, në mënyrë direkte njeriun e pranon si mëkatar dhe e trajton me mëshirën e tij. Individin nuk mund të zgjedh Zotin, por, Zoti i padukshëm e

*zgjedh individin, robin e pavlefshëm e bënë mjet të dobishëm për shërbim. Njeriu nuk posedon besim ose pabesi, por besimi dhe pabesia lindin tek njeriu. Asnjëherë besimi krishter nuk është pasuri e garantuar e ndokujt... Zoti im Ty të besoj, dhe Ti ndihmtoj mosbesimit tim!*⁴⁴⁶

Udhëzimi, sipas Luterit, është plotësisht në dhuntinë e Zotit dhe në besim. Drejtësia e Zotit nuk mund të fitohet me dëshirë, vepra të mira, me një specifikë të një ceremonie e cila propozohet me shenjtërim nga ana e njeriut. Ajo është një drejtësi që mund të gjejë shprehje vetëm në udhëzim, të cilit mund t'i besohet. Kjo drejtësi (përvoja e realizimit të drejtësisë) vetvetiu përbën zemrën e reformave. Kjo për Luterin është Ungjill i rizbuluar, i cili kuptohet nga studimi i letrave të Palit. Udhëzimi është një mëshirë e dhënë nga ana e Zotit ma anë të të cilit mund të arrihet premtimi hyjnor, e nuk mund të fitohet, pasi vdekja e Krishtit është shpagim i të gjitha mëkateve. Ai që udhëzohet pa shenjtërimin e priftërinjve dhe pa ndërmjetësimin e shenjtorëve, mund të arrijë i lirë te Zoti. Me këtë Luteri mohon pagabueshmërinë e papës dhe koncilet në përgjithësi dhe mbron mendimin se bazë e vetme e doktrinës janë Shkrimet e Shenjta.

Reformizmi, si organizatë popullore për shpëtim, i heq ndalesat e kishës së mesjetës dhe ndërmjetësimin e shpëtimit ia lë vetë personit. Vendin e fesë dogmë dhe të shenjtë të mesjetës e ka marrë feja që lidhet me Zotin pa ndërmjetësues. Hierarkia e murgjve mes njeriut dhe Zotit është prishur. Edhe shpëtimi nëpërmjet besimit, u pranua si një vepër e Zotit dhe u refuzua ndikimi i kishës në të.

Ndërkaq, për popullin gjerman, Luteri përkthen Librin e Shenjtë (Biblën) dhe ia ofron çdonjërit për shfrytëzim. Kështu që ai ndikoi edhe në zhvillimin e gjuhës së shkruar gjermane. Sipas tij, ka patur raste kur vite me radhë ka hulumtuar të gjejë në gjermanishte fjalët e ibranishtes. Pa përkthimin e Luterit nuk mund të paramendohet edhe gjermanishtja e sotme. Supozohet se mes viteve 1517-1520, janë shitur rreth 30 mijë ekzemplarë të Biblës. Në atë kohë një copë pa kushtuar 1.5 gulden, gjegjësisht sa çmimi i një kali në pazarin e atëhershëm. Gjthashtu, kisha protestante me veprën "*Libri i këngëve fetare*" të Luterit, është bërë kishë me muzikë. Në korin e Luterit duke u bashkuar besimi, lutja dhe lëvdatat, me fjalë bindëse dhe me melodi, është formuar një tërësi speciale. Ndërsa librat *Katekizmi i Madh dhe i Vogël* i Luterit, janë shkruar me një metodë të re dhe janë bërë mjete për një mësim-edukim të mirëfilltë. Edhe kisha katolike me "*Catechismus Romanus*", duke e imituar atë ka përgatitur katekizmin e saj.

a. Huldrich Zwingli

Përveç Martin Luterit, i cili është marrë me çështjen se si mund të gjendet Zoti i mëshirshëm për njeriun mëkatar dhe me atë se si të arrihet shpëtimi, është edhe reformatori nga Zurichu, Huldrich Zwingli (1484-1531). Ai që poashtu është marrë me të njëjtat probleme dhe që ka gjetur një rrugëzgjdhje më të harmonizuar. Gjendja politike e Zvicrës dhe rrënjët humaniste të Zwinglit, kanë ndihmuar në nxjerrjen e çështjeve në shesh në mënyrë më praktike dhe më logjike. Sipas Zwinglit, në ceremoninë e komunione Jezusi nuk është prezent fizikisht, por vetëm shpirtërisht. Ritualin në fjalë është një përkujtim dhe një simbol. Edhe pse për këtë çështje Zwingli dhe Luteri, në takimin fetar në Marburg më 1529, kanë dashur që të merren vesh, për shkak të pengimit nuk kanë mundur të jenë të suksesshëm në këtë çështje.

Zwingli dëshironte që të bashkojë protestantizmin dhe humanizmin. Vdekja e tij dhe e simpatizuesve të tij, për hir të protestantizmit, në një luftë të brendshme në Zvicër më 1531, nuk i dha mundësi që ta realizojë këtë dëshirë të tij. Sipas Luterit, vrasja e Zwinglit është një dënim për atë që si prift mori në dorë shpatën. Kjo lëvizje e tij në rajonet protestante ka qenë shembull për krishterimin politik dhe për politikanët e krishterë.

⁴⁴⁶ Vep. e cit., f. 342 dhe në vazhdim.

b. Johannes Calvin

Calvin, është reformator i breznisë së dytë. Me aftësinë mendore dhe ashpërsinë e tij tërheq vëmendjen e të qenurit me rrënjë juristi. Pas syrgjynosjes që i bëri shteti në Bazel, në moshën 27 vjeçare, ai ka publikuar librin e tij me titull *Mësimet fetare krishtere* (Institutio Religionis Christianae). Deri në fund të jetës është përpjekur që doktrinën protestante ta paraqesë në mënyrë sistematike. Ai donte të paraqesë fuqinë hyjnore dhe dëshirën e pandryshuar si sqarim mendor i rëndësishëm i reformave. E studioi doktrinën e Augustinit për “*fatim*” edhe e zhvilloi atë. Gjithashtu udhëzimin dhe mosbesimin, gjegjësisht burimin e mosarritjes deri te udhëzimi e gjen në vendimin e pandryshuar të Zotit. Simpatizantët anglo-saksonë të Calvinit, janë ndarë nga kjo doktrinë e fatit. Sipas tyre, prosperiteti dhe lumturia botërore argumentojnë udhëzimin e Zotit. Ka nga ata që pretendojnë se njëra nga rrënjët e kapitalizmit modern gjendet në këtë.

Për Luterin, punët e mira dhe frytet e tyre janë shenja të besimit. Kurse për Calvinin ato janë shenjë e zgjedhjes hyjnore. Calvini në Genf ka formuar një komunitet të fortë dhe me disiplinë. Sipas tij, shteti hyjnor mund të arrihet. Vetë Calvini ishte kryetar i këtij qytet-shteti dhe rregullin e jetës së komunitetit e mbante në dorë të vet. Kjo situatë nuk iu mundësua Luterit dhe ai gjatë tërë jetës mbeti qytetar i thjeshtë në Wittenberg.

19. Kishat e mëdha sot

Sot shohim se shumica e të krishterëve janë tubuar në fraksionet si katolicizmi, ortodoksozmi dhe protestantizmi. Përveç kësaj, si rezultat i ndarjes në bindje, që kanë dalë në mejdan pas reformizmit apo rrjedhin nga historia, shihen fraksione të reja të reformuara.

a. Katolicizmi

Organizata më e madhe e kishës është kisha katolike. Sipas statistikave të vitit 1970, përafërsisht në botë ka 613 milionë simpatizues. Nga këta 226 milionë në Amerikën Latine, 250 milionë në Europën Perëndimore, kurse nga pjesa tjetër 24 % në Amerikën Veriore, 14 % në Afrikë dhe një pjesë është e shpërndarë nëpër shtete të ndryshme të botës. Supozohet se në botën arabe janë 19 %, kurse në Azi 4 %.⁴⁴⁷ Nëse si kriter për katolicizmin e pranojmë papizmin, do të kuptojmë se simpatizues të shumtë të saj janë larg realizimit të veprave të parapara nga ana e kishës. Por, në ngjarjet si në ceremonitë e kuro-rëzimit dhe në funerale shihet një vetëdije fraksionale.

Katolicizmi nuk është një rrugë jetike shpirtërore. Ai është një kishë dhe një organizatë historike e krishterimit. Specifikë e veçantë është “Autoriteti dhe struktura udhëheqëse”. Kisha katolike posedon një bashkësi qendrore rreth papatit. Papa i emërton udhëheqësit e peshkopatave. Këta mbështeten nga priftërinjë beqarë dhe të përbetuar për këtë punë. Sot në botë llogaritet të ketë afër 268.000 priftërinj (jo murgjë). Shpërndarje e tyre është sipas shteteve.

Sipas katolikëve kisha është trupi i Jezu Krishtit, gjegjësisht është tërësia e dukshme e besimtarëve të krishterë. Kisha, si trupi i gjallë i Jezusit, është trupëzuar tek Papa, zëvendësi i tij dhe tek peshkopët e tjerë. Në çështjet e besimit dhe të etikës, me të cilat merren të gjithë të krishterët, papa është i pagabueshëm, kurse kisha është e shenjtë, që njerëzit me anë të doktrinës me mistere të shenjta i çon drejt shpëtimit. Komuniteti ndahet në klerikë, të klasifikuar në mënyrë hierarkike, dhe masa e thjeshtë. Klerikët administrojnë sakramentet e shenjta të obliguara nga Jezu Krishti. Me misterin e shenjtë që e shpërndan, njerëzit i bashkon me trupin e Jezusit, e cila shërben për shpëtimin shpirtëror të besimtarëve. Në Koncilin e Trientit është përcaktuar numri i shtatë sakramenteve, të cilat janë: pagëzimi, konfirmacioni, martesë, vajimi i priftërinjve, pendimi, vajimi i të sëmurit, kungimi. Besohet se sakramentet janë të obliguara nga ana e Jezusit. Ndikimi i misterit nuk varet prej shpërndarësit të tij.

⁴⁴⁷ Albert M. Bernard, “Katolik Mezhebi”, *Din Fenomeni*, f. 133.

Nga Reformizmi e kënde, numri i sekteve është rritur. Shumica e tyre merren me misionerizëm dhe aktivitete edukimi. Brenda tyre janë në zhvillim mendimet rilindëse dhe moderniste. Kjo lëvizje fillon me Koncilin e Trientesë. Ajo është theksuar më tepër në Koncilin II të Vatikanit. Koncilet, lëvizjet dhe besimin themelor i komentojnë sipas botëkuptimit të shekullit. Koncilet e tubuara nën udhëheqjen e papës kanë një rol konsultativ. Papa gëzon autoritet për marrjen e vendimeve. Në vitin 1854 papa Pius IX, si parim besimi shpall se “Maria si virgjëreshë ka mbetur me barrë në Jezusin”, ndërsa në vitin 1950 Papa Pius XII, shpall se “Maria me trup është ngritur në qiell”.

Kardinalët kanë nderin e zgjedhjes së papës. Ata janë dy grupe. Grupi i parë janë klerikët me titull kardinal, të cilët janë në krye të peshkopatës. Të tjerët janë ndihmës të Papës në papat, ku edhe i organizojnë punët ditore aty.

Nga Koncili i Vatikanit e kënde, në kishën katolike ka 15 patrikë, 1340 kryepeshkopë dhe 70 nëpunës të lartë të kishës, të lidhur direkt me Vatikanin, 12 apostuj administratorë. Në krye të të gjithëve qëndron Papa.

Specifikat kryesore të fraksionit mund t'i numërojmë në këtë formë:

- 1) Lider fetar është vetë papa, i cili është edhe zëvendës i Jezusit dhe pasues i Pjetrit.
- 2) Papa është autoriteti i pagabueshëm, kurse Roma është qendra kryesore shpirtërore e kishave të tjera.
- 3) Kisha është universale (fjala katolik ka kuptimin universale), jashtë saj nuk ka shpëtim. Kisha udhëhiqet nga Shpirti i Shenjtë, kurse komentimi i Ungjillit është në dorën e Kishës.
- 4) Shpirti i Shenjtë buron nga Ati dhe i Biri.
- 5) Jezusi ka dy natyra, atë hyjnore dhe njerzore.
- 6) Tradita është diçka e pranueshme.
- 7) Sikur Jezusi, edhe Maria është e pagabueshme, është larg mëkatit origjinal. Maria bashkë me Zotin mund të ndërmjetësojë.

8) Edhe shenjtoret mund të ndërmjetësojnë pranë Zotit. Portretet dhe porositë e shenjta të tyre respektohen. Kështu që për emrat e tyre gati se çdo ditë organizohen ceremoni.

9) Njeriu është brenda në mëkatin origjinal. Përkulja ndaj të keqes atë e çon në mëkat. Me rëndësi është shpëtimi nga mëkati. Kjo bëhet ma anë të rrëfimit të mëkateve priftit në qelinë e faljes së mëkateve. Rrëfimi i mëkateve së paku një herë në vit, sipas marrëveshjes së arritur në Koncilin Lateran të mbledhur më 1215, është obligim për çdo të krishter të moshës madhore.

10) Misteret janë shtatë. Klasa e klerikëve (shenjtoret) nuk martohen, kurse joshenjtoret që mund të martohen nuk mund të shkurorëzohen. Kurora që lidhet jashtë kishës është e pavlefshme. Martesa pas shkurorëzimit llogaritet amoralityt. Pagëzimi bëhet me stërpikje me ujë. Ai që vdes pa u pagëzuar llogaritet njeri i ferrit. Në ritualin e kungimit, bukës nuk i hidhet tharm. Konfirmacioni në kungim bëhet çfarëdo kohe pas kungimit të parë.

- 11) Njohin 21 koncilë dhe të gjitha vendimet e tyre.
- 12) Ditën e premtë nuk hanë ushqime me mish dhe me yndyrë. Kurse ditët e tjera mishin dhe gjakun e kafshëve të ngordhura e kanë të lejuar ta përdorin për ushqim.
- 13) E pranojnë Ditën e Fundit të Gjykimit, parajsën, ferrin dhe purgatorin.
- 14) Gjuha rituale është latinishtja (në vitin 1965 në Koncilin II të Vatikanit është lejuar realizimi i riteve edhe në gjuhë të ndryshme)⁴⁴⁸.

b. Kisha protestante

Pranohet se në botë ka rreth 300 milionë protestantë. Në Evropë ka 110 milionë anëtarë, në Amerikën Veriore 130 milionë, në Afrikë 22 milionë, në Azi 12 milionë, në Australi dhe në Amerikën Jugore ka dhjetëra milionë anëtarë.

Nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë për çështjet e përbashkëta dhe të ndara mes fraksioneve protestante. Kështu që është shumë vështirë dhënia e njohurive të hollësishme për të gjitha ato. Në përgjithësi, struktura e kishave është e ndryshme. Rëndësi i japin komunitetit. Komuniteti është forma

⁴⁴⁸ Tümer-Küçük, *Dinler Tarihi*, f. 270-271.

trupore e Jezu Krishtit. Kujdesi për këtë komunitet të personifikuar paraqet vazhdueshmërinë e Kishës Protestante. Universaliteti i Kishës nuk është i lënë pas dore. Ndryshimet e bëra dhe në disa raste ndarja mes tyre e ka lindur përmallimin për bashkim dhe kështu është formuar Bashkimi Rinor. Këto përmallime sot kanë hapur rrugën për realizimin dhe lindjen e shpirtit “*bashkimi i kishave*”. Specifikat që dallojnë nga katolikët dhe nga ortodoksët janë:

1) Ata autoritetet, si papa etj., nuk i pranojnë. Janë të mendimit se çdokush që ka dituri mund të japë vlerësimet e tij për krishterimin.

2) Kisha nuk ka autoritet për komentimin e Librit të Shenjtë, ndërkaq çdo i krishter mund të bëjë komentimin e tij. Adhurimi dhe predikimet nxirren nga Libri i Shenjtë.

3) Nga misteret e shenjtë pranojnë vetëm pagëzimin dhe kungimin. Sipas disave kungimi është vetëm një kujtim.

4) Ata nuk e pranojnë autoritetin e kishës për faljen e mëkateve.

5) Përpos simpatizuesve të anglikanëve të tjerët nuk kryqëzohen.

6) Adhurimin dhe ceremonitë i bëjnë në gjuhën e tyre.

7) Nuk besojnë në purgator dhe në dënim të përhershëm.

8) Nuk bëjnë pjesë në besimin katolik për Marinë.

9) Shenjtorët nuk i pranojnë dhe për ta nuk bëjnë rituale speciale.

10) Triniteti ekziston te të gjithë protestantët. Kurse në çështjet kryesore nuk dallojnë nga kishat tjera.⁴⁴⁹

c. Kisha ortodokse

Është njëra nga tre kishat e mëdha me 160 milionë simpatizues të pagëzuar. Fraksioni kryesor, që në periudhën e parë të krishterimit, ka fituar autoritet më të sinqert në mesin e fraksioneve të tjera janë kishat ortodokse. Këto janë trashëgimtare të kishës së Perandorisë së Bizantit të themeluar nga ana e mbretit Konstantin. Ato kanë besimet e tyre të posaçme. Përveç dallimeve të vogla, sistemet e adhurimit dhe të drejtësisë mes tyre janë të njëjta. Vetëm se, sipas nacionaliteteve të anëtarëve janë formuar edhe kisha të pavarura në aspektin administrativ. Në përgjithësi, adhurimin e bëjnë në format e vjetra të gjuhës, kurse pjesërisht edhe në format moderne. Këto kisha, të cilat në aspektin administrativ janë të pavarura nga njëra-tjetra, cilësohen si “autoqefale” dhe udhëheqësit e tyre quhen “patrikë”. Sidomos, në mesin e tyre, në aspektin historik më me konsiderat është patrikana e Stambollit. Kishat kryesore autoqefale janë Patrikana e Aleksandrisë, e Antakisë, e Jerusalemit dhe e Stambollit. Përveç këtyre kishave, këtu mund të numërohen edhe kishat si ajo e Qipros, Gjeorgjisë, Bullgarisë, Serbisë, Rusisë, Rumanisë, Greqisë dhe e Shqipërisë.⁴⁵⁰ Shumica e këtyre kishave, shekuj me radhë kanë vepruar

⁴⁴⁹ Vep. e cit., f. 273.

⁴⁵⁰ Kisha ortodokse maqedone (KOM) nuk bën pjesë në këtë grup nga fakti se ende nuk është e pranuar nga Patrikana e Stambollit, për shkak të obstrukcioneve që i bën Kisha ortodokse serbe. KOM pohon se krishterizmi në Maqedoni ekziston që në shekullin I, kurse Kryepeshkopata e Ohrit, e cila është themeluar në shek. IX., është nëna e KOM. Gjithashtu kjo kishë Kryepeshkopatën e Ohrit nuk e njeh si kishë bullgare, por, pretendon se ajo është maqedone. Kështu që, KOM, historinë e kishës së vet, duke filluar prej shek. IX., e vazhdon nëpërmjet Kryepeshkopatës së Ohrit, kurse i llogarit të gabuara shprehjet se ajo ka qenë greke, e më vonë bullgare e pastaj serbe. Kjo gjendje e KOM-it, ka vazhduar deri pas Luftës së Dytë Botërore. Në Mars të vitit 1945, në qytetin e Shkupit, mbahet mbledhja e parë e Kishës kombëtare maqedonase, ku kanë marrë pjesë 300 delegatë.

Pas kësaj KOM, nga Kisha ortodokse serbe (KOS) kërkoi që të pavarësohet, por përgjigjja ishte negative. Në vitin 1958 KOS, në mbledhjen e organizuar në qytetin e Ohrit, që është brenda kufijve të Maqedonisë, ftoi Këshillin e Kishës kombëtare maqedonase dhe me këtë rast u formua Kisha ortodokse maqedonase, kryetar i së cilës u zgjodh Dositej. Pas kësaj, nga ana e KOS-it u vu kusht që kryetar i KOM-it të jetë kryepeshkopi i KOS-it, dhe u mor vendim që të dyja kishat për çdo çështje, përveç të drejtës për kryetar, të kenë të drejta të barabarta. KOM, pasi kuptoi se nuk do të mund të fitojë pavarësinë, më 17 Qerashor 1967 mori vendim që vetë të shpallë pavarësinë e Kishës Maqedone, gjegjësisht të vetëshpalllet e pavarur. Pas këtij vendimi, të nesërmen, Sinodi i Shenjtë i KOM-it në kishën “Sv. Kliment Ohridski”, shpalli pavarësinë e KOM-it.

Për këto zhvillime Këshilli i KOS-it, në mbledhjen e mbajtur më 14-17 tetor 1967, udhëheqësit e KOM-it i ka cilësuar jolegitimë dhe KOM-in e shpalli “organizatë skizmatike e ndarë prej nënës së saj, KOS-it”. Pas kësaj KOS mori vendim për ndërprerjen e të gjitha lidhjeve ligjore dhe liturgjike me KOM-in, kurse Sinodin e Shenjtë Serb e obligoi “me detyrë për përgatitjen dhe gatishmërinë e saj kundër daljes në shesh të skizmës”.

Këto marrëdhënie negative mes KOS-it dhe KOM-it ende vazhdojnë, dhe sado që KOM të ketë shpallur veten autoqefale, KOS ende nuk është kah e pranon një gjë të tillë. (Shih, Ivan Snegarov, *Istorijska Arhiepiskopija*, tom I, Akademi~no Izdadelstvo, Sofija, 1995, f. 10-17; Jovan Bel~ovski, *Ohritska Arhiepiskopija*, Skopje 1997, s. 13-17; Slavko Dimevski, *Borbata za avtokefalnosta na pravoslavnite crkvi*

si kisha shtetërore. Posti më i lartë i kishës është kuvendi peshkopal.

Ndarja e kishës në lindore dhe në perëndimore, është rezultat i zhvillimit mes shek. XI-XIII Kryqëzata e katërt në vitin 1204 u realizua në Stamboll, ku u dogj dhe u shkatërua çdo gjë. U copëtuan ikonat dhe taset e shenjtë. Murgjit u varën. Laviret u detyruan të këndojnë në fronin e Patrikanës. Patriku latinizoi popullin vendës. Këto ngjarje edhe më tepër e ndanë kishën lindore nga ajo perëndimore.

Pas dominimit osman, rëndësi e veçantë iu dha ceremonive brenda në kishë. Me ndikimin e Ruisë, në fe filluan të përziheshin edhe ndjenjat nacionale dhe lindi “nacionalizmi fetar”. Dhënia e përgjegjësisë juridike për komunitetin krishter Patrikanës së Stambollit, i hapi rrugën dominimit të helenizmit, i cili ishte kundër sllavëve dhe arabëve. Kjo situatë e lindi konceptin rus për Patrikanën e Moskës si “Roma e Tretë”.⁴⁵¹

Dobësimi i shtetit osman përshpejtoi krijimin e kishave nacionale. Më 1850 Kisha greke u pranua zyrtarisht nga ana e Patrikanës së Stambollit. Kisha serbe, e cila e fitoi pavarësinë më 1879, më 1922 u bë Patrikanë. Kisha bullgare, e cila pavarësinë e saj e shpalli më 1860, më 1945 u njoh nga Patrikana e Stambollit, kurse më 1953 u bë Patrikanë, legjitimiteti i së cilës nga ana e Patrikanës së Stambollit u pranua më 1960.⁴⁵² Kurse Kisha ruse, pas revolucionit më 1917, jetoi ditë të vështira. Kjo situatë e krijuar u hapi rrugë lëvizjeve të reja, të cilat punonin t’i përshtateshin regjimit të ri. Edhe pse kisha në vitet 1943-1959, dëshiroi që të jetë e pavarur nga Patrikana dhe nga shteti, në kohën e Hrushovit dhuna e shtetit u rrit edhe më tepër, ku prej 22.000 kishave 15.000 u mbyllën, prej 68 manastireve 60 u mbyllën, prej 8 shkollave teologjike u mbyllën 5. Kjo dhunë, pas vdekjes së Hrushovit, u lehtësua pak.⁴⁵³ Sot përsëri e kanë lirinë e besimit.

Patrikana e Stambollit vepron që, përkundër tronditjeve që kanë patur gjatë historisë, t’i tubojë kishat e shpërndara. Ajo, në Koncilin “Bashkimi i kishave”, të mbajtur më 1948, bashkë me anglikanistët dhe luteristët, u bë themeluese e lëvizjes “Bashkimi krishter”. Që nga viti 1966, ka qenë anëtare e “Këshillit për bashkimin e kishave”. Ajo i nxit kishat e tjera lindore që të anëtarësohen në këtë këshill, e vazhdon aktivitetin e saj për dialog, për zhdukjen e ndarjeve mes kishave ortodokse dhe synon bashkimin e tyre. Vitet e fundit vazhdojnë synimet për dialog mes katolikëve dhe ortodoksëve; edhe sot janë duke vazhduar takimet dhe vizitat reciproke mes papës dhe patrikut.

vo Evropa sozadani na XX vek, Skopje: 1979, s. 117-120; Aco Aleksandar Girevski, Ohrid-skata Arhiepiskopija-Makedonska Pravoslavna Crkva, *Godišen Zbornik 3*, Skopje, 1997, s. 141-143. (Shënim i përkthyesit).

⁴⁵¹ Olivier Clement, “Ortodoks Mezhebi”, *Din Fenomeni*, ed. M. Aydın, f. 208.

⁴⁵² Pavarësia e Kishës ortodokse shqiptare për së pari herë është shpallur në Boston të ShBA nga ana e F.S. Nolit, priftit shqiptar, më 1908. Kurse në Rapublikën e Shqipërisë pavarësia e Kishës ortodokse shqiptare është shpallur më 1922 në Kongresin e Beratit. Në këtë kongres u themelua statuti i Kishës ortodokse autoqefale shqiptare (KOASH), i cili u shpall në “*Gazeta Zyrtare*” më 26 Shtator 1922 dhe që përbëhet prej 14 neneve (nyjeve). Sipas këtij statuti, deri sa të formohet *Sinodi i Kishës*, si organ më i lartë do të jetë “*Këshilla e Lartë*”, i përbërë prej 4 klerikëve dhe 4 laikëve. Vasil Marko, i cili u zgjodh kryetar i KOASH-it me qendër në Korçë, mori edhe titullin Kryetar i Këshillit të Lartë, që ishte mekanizëm më i lartë udhëheqës në Kishën ortodokse autoqefale kombëtare shqiptare. Pas tij për kryepeshkop u zgjodh Visarion Xhuvani. Krahas kongresit në Berat dhe aktiviteteve të bëra për njohjen e Kishës ortodokse shqiptare, përsëri autoqefaliteti i kishës shqiptare nuk u pranua as nga ana e Patrikanës së Fanarit e as nga ana e kishave të tjera ortodokse. Qeveria shqiptare duke mos ndejtur duarkryq, shprehu dëshirë që kjo orvatje për autoqefalitet të përfundojë sa më parë. Sa do që Shteti Shqiptar pavarësinë e tij e kishte shpallur më parë, sipas parimit politik parrulla “në shtet të pavarur kishë të pavarur”, është e pashmangshme. Kështu u organizua kongresi i dytë për pavarësinë e kishës, i cili u mbajt në Korçë më 1929. Edhe pas këtij kongresi Patrikana e Fanarit nuk shprehu dëshirë për ta pranuar të pavarur Kishën ortodokse shqiptare. Kjo situatë mori fund në vitin 1937 kur Patrikana e Fanarit me në krye patrikun Benjamin pranoi dhe nënshkroi marrëveshjen për praninë të kishës, e cila quhet *tomos*. Me direktivën e sistemit komunist në Shqipëri më 7 Shkurt 1950 mbahet edhe Kongresi III. i KOASH-it, ku miratohet edhe statuti i ri i kishës. Kongresin e ka hapur kryepeshkopi i ri Pasi Pashko-Vodica, i cili u zgjodh peshkop në vend të Kristofor Kissit. Pasi Pashko përshëndet pjesëmarrësit, gjeneral Enver Hoxhën dhe të gjithë autoritetet e tjera pjesëmarrëse në kongres, fjalën e merr Adil Çarçani, si përfaqësues i Republikës Popullore të Shqipërisë në kongres. Çarçani në fjalën e tij është përqendruar në rëndësinë e komunitetit ortodoks në themelimin e shtetit të ri shqiptar. Statuti i KOASH-it miratohet me vendimin e marrë nga Kryesia e kuvendit popullor më 4 Maj 1950, i cili menjëherë hyn në fuqi. Ky statut kishte disa dallime nga ai i vitit 1929. Në këtë statut përfshiheshin edhe disa pika në përputhshmëri me ideologjinë dhe politikën shtetërore ndaj komuniteteve fetare. Njëra nga pikat e ndryshuara ishte edhe pika 16, sipas së cilës kryepeshkopi dhe peshkopët e tjerë të KOASH-it është kusht që të jenë me origjinë shqiptare, të jetojnë në Shqipëri dhe të flasin gjuhën shqipe. Edhe sot në Shqipëri KOASH është e ndarë në KOASH me qendër në Tiranë nën udhëheqjen e kryepeshkopit Anastas Janullatos dhe në KOASH me qendër në Elbasan nën udhëheqjen e Nikolla Markut. (Shih, Viron Koka, Përpyqjet për njohjen e Kishës Ortodokse Shqiptare nga Patriku (vitet 1920-1930), *70 vjet të Kishës ortodokse autoqefale shqiptare, simpozium Tiranë 19 Shtator 1992*, Tiranë 1993, f. 71; Dhimitër Beduli, *Kisha ortodokse autoqefale e Shqipërisë gjër në vitin 1944*, Tiranë 1992, f. 22-23; Sherif Delvina, *Pa pavarësi fetare nuk ka pavarësi kombëtare*, Tiranë 1998, f. 4). (Shënim i përkthyesit).

⁴⁵³ Olivier Clement, “Ortodoks Mezhebi”, *Din Fenomeni*, f. 221.

Kishat ortodokse, për çështjen e besimit i llogaritin të ligjshme vendimet e kuvendit peshkopial. Vendimet e shtatë koncileve kanë forcë urdhëruese. Vendimet e Koncilit të Stambollit dhe të Nikesë kanë të bëjnë me parimet e besimit, ndërsa koncilet e tjera pranohen si mendime për teologjinë. Krahas Librit të Shenjtë, edhe shkrimet e etërve të kishës janë shkrime që gëzojnë respekt në kategorinë e dytë. Në kishat ortodokse nuk ka autoritet *të pagabueshëm*. Për ekzistencën, ndikimin dhe numrin e shenjtërisë, për gjendjen e kishës dhe për çështjet e Marisë nuk ka ndonjë dogmë. Për ekzistencën hyjnore dhe për fshehtësinë e udhëzimit, kanë bindjen se këto nuk mund as të kuptohen e as të shprehen. Adhurimet kanë karakter mistik dhe shpirtëror. Kisha mister është në pozitën e trashëgimitarit të feve antike. Ndërkaq ikonat përshkruajnë shpirtërat e patrup të gjallesave qiellore. Për këtë përpara tyre bëhet përulje, puthen, lakmohen dhe adhurohen. Komuniteti ortodoks beson se adhuron bashkë me Jezu Krishtin, Marinë, engjëjt dhe shenjtoret. Besohet se fëmijët me anë të pagëzimit ose me anë të vajimit të organeve me vaj miron, janë të mbrojtur nga fuqitë e djallit. Vaji dhe uji që përdoren në aktet fetare, përdoren, sidomos, për shenjtërimin e kurorëzimit, kufomës dhe për vajimin e priftërinjve. Adhurimet e tyre bëhen në mëngjes, gjatë ditës, në mbrëmje dhe gjatë natës. Gjatë këtij intervali lexohen pjesë nga Libri i Shenjtë, që llogariten si simbol i ardhjes së Jezu Krishtit në komunitet. Ndahet bukë dhe verë e shenjtëruar. Në kohë të ndryshme agjërohen ditë të quajtura Advent, Pashkë, Maria dhe Apostol.

Brenda kishave ortodokse kanë lindur edhe disa fraksione. Kishat ortodokse kombëtare në Ballkan dhe në Rusi janë një grup, kurse në shtetet islame janë kishat kombëtare, të cilat shekuj me radhë përbëjnë një grup tjetër.

Çështjet kryesore që i dallojnë ortodoksët nga kishat tjera janë me sa vijon:

- 1) Patriku ose kryepeshkopi janë udhëheqës shpirtërorë.
- 2) Ata nuk pranojnë epërsinë e papës.
- 3) Nuk pranojnë vendimet dhe koncilet, përveç shtatë koncileve të para.
- 4) Respektojnë dhe i adhurojnë ikonat.

Priftërinjt mund të martohen, kurse murgjit, peshkopët dhe patrikët nuk mund të martohen. Lejimi i shkuroëzimit është i kushtëzuar nga disa faktorë.

KISHAT KOMBËTARE

Këto kisha janë rezultat i mosmarrëveshjeve për çështjet e besimit brenda në krishterim, të zhvilluara gjatë shek. III dhe IV në perandorinë Romake lindore (Bizantine). Në këto zhvillime ndikim kanë politika edhe e perandorëve bizantinë edhe e patrikëve të Stambollit. Këto janë kisha siriane, ermene, kopte dhe etiopiane bashkë me kishat nestoriane dhe maronite.

1. Kisha siriane

Literatura: Bertold Spuler, *Die Morgenländischen Kirchen*, Leiden 1964, f. 170-216; Bertold Spuler, *Gegenwartslage der Ostkirchen*, Frankfurt 1968, f. 279-287; Hanna Dolaponu, *Tarihçe Mardin*, Stamboll 1972, 208 f.; Kemal Özbay, *Süryaniler, Kadim Süryaniler ve Türkiye'deki Durumları*, Stamboll, 1975, f. 30; Mithat Sertoğlu, *Süryani Türklerin Siyasi ve İctimai Tarihi*, Stamboll 1974, f. 88; P. Samuel Akdemir, *Dini Kurallarımız*, Stamboll 1972, f. 96; Saliba Samun, *Antakya ve Doğu Sayın Patriki Kadesetli Mar İgnatıyos 3. Yakub'un Hindistan Süryani Kilisesine Resuli Ziyaretleri*, Stamboll 1965, f. 188; Hanna Aksöz, *Sammasları Rütbeleri*, Mardin 1960, f. 8; Aziz Günel, *Türk Süryaniler Tarihi*, Diyarbakır 1970, f. 446; Mehmet Çelik, *Süryani Kadim Tarihi*, Stamboll 1987, f. 296.

Krishterimi në periudhën e parë, si në shumë vende të Perandorisë Romake, u përhap edhe në Mesdhe dhe në Mesopotami. Nga mendimet e ndryshme që lindën për natyrën dhe ekzistencën e Jezusit, ata përfaquan mendimet e Cyrill-it I. të quajtur “monofizitizëm”. Sipas Cyrill-it, pas bashkimit të natyrës njerëzore dhe hyjnore të Jezu Krishtit, Krishti u bë bartës vetëm i natyrës hyjnore. Për gjatë kohës populli i Egjiptit mendonte në përshtatshmërinë e tij me monofizitizmin. Ata që e flisnin greqishten në rajonin e Sirisë i pranonin mendimet e Patrikanës së Stambollit, ndërkaq ata që flisnin sirianishten, si populli egjiptian, pëlqenin monofizitizmin. Armenët, edhe pse kishin një gjuhë krejtësisht tjetër, në vend që me Stambollin mendimet e tyre i ndanin me popullin e Egjiptit dhe të Sirisë. Këto tre kisha, krahas dallimit nacional dhe gjuhësor të tyre, i afroi besimi i përbashkët. Vetëm se, afrimi i Patrikut të Jerusalemit të asaj kohe Stambollit, pengoi forcimin e monofizitizmit në Palestinë. Dominimi i ortodoksizmit grek në Perandorinë Bizantine, sikur që e shtoi dhunën ndaj monofizitëve, e pengoi edhe përhapjen e tyre në rajonet e tjera. Ortodoksët penguan edhe shenjtërimin e priftërinjve monofizitë, kurse monofizitizmin e futën në qorsokak.

Gjatë kësaj kohe, princi arab i gassanitëve, Harisi V, u takua dhe e bindi Perandorin (552) për nevojën e organizimit dhe bashkimit të monofizitëve të Sirisë, që është më se e nevojshme për një mbrojtje më të mirë të kufijve perandorakë ndaj sasanitëve. Dhe kështu mundësoi shenjtërimin e dy peshkopëve të quajtur Theodor dhe Jakob Bardaios. Nga këta të dy, Jakobi, greqishten, sirianishten dhe arabishten i njihnte shumë mirë dhe gjithashtu ishte edhe shumë i lëvizshëm. Ai mundësoi organizimin e kishës monofizite, që ishte në shkatërrim e sipër. Për monofizitët e rajonit të Sirisë dhe Egjiptit ai shenjtëroi 2 patrikë, 27 peshkopë dhe 100.000 priftërinj. Perandori bizantin, i penduar për lejen e dhënë, shumë u mundua që ta zë dhe ta vrasë Jakobin, por nuk pati sukses. Këto aktivitete jetëdhënëse dhe organizative të Jakobit, u bënë shkak që Kisha Monofizite e Sirisë të quhej jakobizëm. Pas kësaj, kisha siriane është përmendur me ofiqin jakobitët.

a. Marrëdhëniet me komunitetet e tjera krishtere

Kalimi i Egjiptit dhe të Sirisë nën administrimin e muslimanëve, i gëzoi pa masë jakobitët që

muslimanët i kanë pritur si shpëtimtarë. Në shtetin islam ata gjetën hapësirë për lëvizje dhe për diskutim të lirë të çështjeve të tyre. Marrëdhëniet e ortodoksëve me nestorianët dhe me armenët u formuan përsëri. Vetëm se ata kanë patur vështirësi në mbrojtjen e besimit të tyre ndaj fraksioneve dhe ndaj islamit.

Jakobitët nuk kanë qenë të interesuar për adhurimin e ikonave, sikur ishte te bizantinët. Ka mundësi që këtu rol të rëndësishëm të kishin luajtur ndalimi i adhurimit të ikonave në islam dhe diskutimet apologjetike në lidhje me çështjen në fjalë. Sidomos në këtë, ndikim mund të kenë edhe të krishterët, të cilët për shkak të armiqësisë ndaj ikonave ikin nga Bizanti në shtetin islam.

Edhe armenët, pasi ishin monofizitë, në disa çështje fetare dallonin nga jacobitët. Ky dallim erdhi se armenët me ndikimin e Julianit nga Halikarnasi, pranuan aftartodoketizmi,⁴⁵⁴ kurse jacobitët pranuan ptartolatrizmin.⁴⁵⁵

Për këtë armenët, sirianitët nuk i pranonin si të tyre. Edhe pse pas vitit 726 në mesin e tyre kishte një afrim, dalja në shesh e dallimeve në lidhje me çështjen e adhurimit, pengoi bashkimin e tyre.

b. Shkatërrimi i sirianitëve

Mosmarrëveshjet e brendshme ishin ato që i lëkundnin më tepër sirianitët. Të tronditurit nga kjo mosmarrëveshje qetësinë e tyre e gjenin në pranimin e islamit. Sidomos, kalimi i Sirisë për një kohë të shkurtër në duart e Bizantit, u bë shkak për transferimin e Patrikanës më 975 në Malatja (Turqi), e cila më parë ishte nën administrimin islam. Edhe pas kryqëzatave plaçkitja e Bar Savmasë, e cila ishte qendër e manastireve, nga ana e kryqtarëve në vitin 1148, sirianitët i afroji edhe më tepër drejt islamit. Këtë dobësim të tyre edhe më tepër e përshpejtuan udhëtimet e ilhanitëve më 1295 dhe më pastaj udhëtimet e Timurit. Ata nga ajo që ishin shumicë në Mardin dhe në Musul, mbetën minoritet.

Në shkatërrimin e jacobitëve rol të madh ka luajtur edhe kisha katolike. Që në vitet e kryqëzatave për pranimin e krishterimit janë bërë shtypje të mëdha, vetëm se një gjë e tillë nuk ka mundur të jetë edhe aq ndikuese. Politika ishte ajo që u bë më e suksesshme. Në vitin 1662, nëpërmjet konsullit francez në Haleb për patrik u zgjodh simpatizuesi i papës, Andreas Akixhijan. Filluan kontaktet mes sirianitëve dhe papatit. Edhe pse me vdekjen e Andreasit marrëdhëniet u ndërprejnë për një kohë, me iniciativën e patrikut Mikail Karve, në vitin 1760, filluan përsëri dhe kështu u formua pretendimi për afrim ndaj katolikëve. Kështu që në vitin 1830, me presione politike, sultani u detyrua që katolikët sirianitë t'i njohë si popull më vete brenda shtetit osman. Kështu që Kisha monofizite siriane zyrtarisht u nda në dy pjesë, njëra pjesë e saj u lidh me Romën dhe patriku i katolikëve sirianë u shpërngul prej Halebit në Antaki. Pas kryengritjes durzite, ajo u mbart në Mardin. Edhe pas Luftës së Parë Botërore, me formimin e Republikës së Turqisë, për shkak të afërsisë së saj me Rusinë dhe Anglinë, e pa të arsyeshme të bartet në Bejrut.

Sot në Turqi afër 40 fshatra flasin gjuhën siriane. Kisha e vjetër siriane, është një grup shumë i vogël që e vazhdon traditën historike monofizite. Shumica e simpatizuesve të komunitetit, që numëron 30 mijë përfaqësues, jetojnë në Mardin dhe në Stamboll dhe vazhdojnë të jenë nën administrimin e Patrikanës së Damaskut. Ndërkaq në Turqi udhëhiqen nga kryemurgu. Deri në vitin 1934 Patriku i Vjetër i sirianitëve ka qëndruar në manastirin Dejruzzaferan, në Mardin të Turqisë. Kurse pas vdekjes së tij, patriku i ri është zgjedhur në Damask me titullin "Patriku i Antakisë".

Edhe sirianitët që kanë kaluar në protestantizëm, janë ndarë nga komunitetet e vjetra dhe kanë preferuar që të jetojnë të shpërndarë.

c. Besimet dhe adhurimet e sirianitëve

Sipas sirianitëve, kisha është formuar nga Jezui Krishti dhe është e përbershme. Ajo, duke ua mësuar simpatizuesve

⁴⁵⁴ Aftartodoketizmi mbron mendimin se Jezusi, krahas asaj që është i njëjtë me njerëzit tjerë, është i përhershëm dhe i paprishur. Kësaj i thuhet edhe Julianizëm.

⁴⁵⁵ Ptartolatrizëm, mbron mendimin se ekzistenca e natyrës njerëzore në Jezusin është kalimtare dhe e përkohshme. Përfaqësues i këtij mendimi është Severus.

të lejuarën dhe të ndaluarën, atyre u mundëson që të arrijnë mëshirën e Zotit. Patrikana e Antakisë dhe e Aleksandrisë janë të një niveli. Patrikët janë kryeadministratorët e kishave dhe janë pasardhës të pozitës së apostullit Pjetër, në Antaki. Autoriteti që Krishti ia ka dhënë Pjetrit nuk gjendet në personalitetin e patrikut por në Kishë.

Sipas sirianitëve, çështja e numrit të sakramenteve është diskutabile. Sipas krabasimit të numërimeve, në shek. XIII, numri i sakramenteve është 5, kurse më vonë janë shtuar edhe 2, dhe kështu janë bërë 7: pagëzimi, mirosja, kungimi, vajimi i priftërinjve, pendimi, vajimi i të sëmurëve dhe martesat.

Adhurimet: lutjet që bëhen shoqërisht dhe individualisht janë kryqëzimi, puthja e kryqit, respektimi dhe pjesëmarrja në ceremoni.

2. Kisha armene

Literatura: Abdurrahman Küçük, *Ermeni Kilisesi ve Türkler*, Ocak Yayınları, Ankara 1997, 312 f.; B. Spuler, *Die Morgenländischen Kirchen*, f. 122-150; Necla Başgün, *Türk-Ermeni Münasebetleri*, Stamboll, 1980 f.; Sadi Kocas, *Tarih Boyunca Ermeniler ve Türk-Ermeni İlişkileri*, Ankara 1967; Esat Uraş, *Tarihte Ermeniler ve Ermeni Meselesi*, botim 2., Stamboll 1987.

Armenia është një rajon ku krishterimi është përhapur që në kohët më të hershme. Sipas transmetimeve kisha armene, që në periudhën më të hershme, me veprimet misionerike të Addaj-it (Thadeusit) dhe të Bartholomeusit, ka hyrë në rajone të ndryshme të shtetit krishter. Dokumentet historike tregojnë se, shek. III paraqitet si koha e themelimit të komunitetit të parë krishter në Armeni. Ka të dhëna se, në vitet 230 dhe 301 pas e.s. ata janë përndjekur. Kurse para krishterimit në këto vende ka qenë i përhapur adhurimi i zjarrit (zaratustrizmi).

Pranimi i krishterimit nga ana e mbretit armen, Tridatesi, ishte një moment shumë i rëndësishëm në zhvillimin e krishterimit, ku pas kësaj krishterimi pati një përhapje shumë të madhe. Tridatesi, në vitin 302 për patrik (katolikos) të kishës emëroi të afërmin e tij, Gregorin. Kjo kishë, për shkak të punëve të suksesshme të Gregorit quhet edhe Kisha Gregoriane. Gregori, djalin e tij, Rustakun, e emëroi peshkop. Ai, në Ashtishat, në vend të tempullit zaratustrian ndërtoi qendrën kishtare. Në vende të ndryshme të shtetit themeloi shkolla në sirianishte dhe në greqishte dhe punoi në mësimin e krishterimit. Armenët janë ata që të parët në histori krishterimin e bënë fe shtetërore.

Me invadimin e persianëve në vitin 367 u shkatërrua Mbretëria Armene dhe shumica e popullit janë syrgjynosur në Iran dhe në Mesopotami. Gjatë kësaj periudhe të jashtëzakonshme, Sahagi I (Isaak I), i biri i Nersesit të madh, bashkë me Mesropin, një murg dhe dijetar i shquar, në vitin 387-390, ka përgatitur alfabetin kombëtar armen.

a. Zhvillimi i kishës armene

Pas përgatitjes së alfabetit armen, edukimi fetar në greqishte dhe në sirianishte ia la vendin edukimit në gjuhën e vendit, gjegjësisht armenishtes. Edhe pse në fillim pjesa që flisnin greqisht refuzonin, por për të shpëtuar nga fajësimi, se janë simpatizues të Bizantit, u detyruan që urgjentisht ta braktisin greqishten. Bibla, në vitin 433 u përkthye në armenisht nga sirianishtja dhe u quajt Peshbitta. Kuvendet fetare të mbledhura në Ashtishat në vitet 432 dhe 435, vendimet e koncilin të Efesit i pranuan edhe për kishën armene. Edhe përkundër shtypjes së persianëve, ata ishin të lidhur shumë fortë me vendimet e Koncilin të Efesit. Monofizitizmi, edhe në kuvendet fetare të tubuara në Tevin më 506/507 dhe 552, është pranuar zyrtarisht. Në vitet 640-653 ata hynë nën mbrojtjen e muslimanëve dhe kështu shpëtuan prej ndikimit të dhunës bizantine.

Tevini, qendra e katolikosit, gjendej brenda kufijve të administrimit të muslimanëve. Aktivitetet fetare të katolikosit nuk u prekën aspak, populli vazhdoi lirisht jetën fetare dhe adhurimet e tij. Në vitin 893, shkatërrimi i Tevinit nga një tërmet i fortë, ishte shkak për transferimin e katolikosit në Valarshabat, e më vonë në Ishullin Akdamar në liqenin Van. Shtimi i muslimanëve dhe zvogëlimi i numrit të komunitetit, bëri që katolikosi (patrikana) më 992 të bartet në Ani, afër Karsit. Në Ani bashkë me jetën e pasur kishtare u zhvillua edhe një arkitekturë e bukur. Vetëm se, me kalimin e saj në duart e Bizantit më 1045 dhe me syrgjynosjen e katolikosit në Stamboll, u pengua zhvillimi në Ani.

Edhe ardhja e selxhukëve në Anadoll, nuk e kënaqi shtresën sunduese. Qendra fetare, krabas kundërshtimit të popullit, u mbart në Amasja, që ishte nën administrimin bizantin, kurse më vonë u mbart në kalanë greke, e cila gjendet në rajonin e epërm të Eufratit. Ky qëndrim i udhëheqësve u hapi rrugë ndarjeve mes armenëve, që u bë shkak që populli monofizit armen edhe më tepër të afrohet drejt kishës monofizite siriane.

Armenët gjatë kryqëzatave, me qëllim që të formojnë përsëri shtetin e shkatërruar nga ana e sasanidëve, iu afruan Papës. Në vitin 1198 Leoni II.; u shenjtërua mbret i Armenisë. Në Marash dhe rreth tij u themelua një shtet me emrin “Mbretëria e Armenisë së Vogël” dhe u bashkua me Papën. Vetëm se, më 1248 dëshira e Papatit që t’i katolikëzojë armenët, u bë shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve mes armenëve dhe papatit. Më 1344 populli u ngrit në kryengritje. Pas një periudhe “Mbretëria e Armenisë së Vogël” u shkatërrua nga ana e memlukëve dhe kështu u ndërpre plotësisht lidhja me Romën.

b. Armenët dhe muslimanët

Fatih sulltan Mehmedi II, pas çlirimit të Stambollit, në vitin 1461 peshkopin armen në Bursa e emëroi për patrik në kryeqytetin e ri. Atij i ka dhënë autoritet edhe për çështjet administrative brenda komunitetit krishter. Kështu që, patriku ishte në pozitën e një lideri fetar dhe kombëtar të armenëve. Vetëm që nuk kishte të drejtë përzjerjeje në kishat e të njëjtit fraksion, si në atë siriane dhe kopte. Gjatë kësaj kohe në Exhmiazin, që gjendej në principatën Kara Kojunlu, dhe në Jerusalem nën administrimin memluk janë themeluar patrikana armene. Në çdo shtet islam ka ekzistuar nga një Patrikanë, e cila ka qenë përgjegjëse për komunitetin armen.

Armenët deri në shek. XVII kanë jetuar të qetë. Për shkak të rënies së Erivanit pas vitit 1724 herë nën osmanët e herë nën persianët, për shkak të zënkave të brendshme në Iran dhe me fillimin e dobësimit të shtetit osman, armenët janë lidhur me Rusinë, gjë kjo që i forconte shpresat për pavarësi në Kaukaz. Edhe rusët në vitin 1770 kanë lejuar ndërtimin e një kisha armene në Petersburg dhe një tjetre në Moskë, mënyrë kjo me të cilën u munduan që t’i përfitojnë armenët. Pas vitit 1800, rusët filluan të përzihen në zgjedhjen e Patrikut armen në Iran dhe në shtetin osman. Në 1829 patrikana Exhmiazin u fut në rajonin e administrimit rus. Kështu që, armenët filluan të jetojnë në një administrim me shumicë ruse. Rregullimi i kushteve materiale për jetesë në shek XIX. nxiti shpërnguljen e 96.000 armenëve prej Anadollit për në Rusi.

Këtu luajtën rol edhe shqetësimet e brendshme në komunitetin armen. Sepse gjatë historisë roli i faktorëve, si aktivitetet misionare katolike dhe ortodokse brenda tyre, shtypjet dhe mundimet për të mbrojtur patrikanën historike gregoriane-monofizite, ndërhyrja e jashtme shtetërore etj., ishte i madh. Gjithashtu me formimin e shtypshkronjës në Stamboll më 1730, në masë të madhe u botuan libra në gjuhën armene dhe u forcua ndjenja fetare e tyre. Me presionin e shteteve europiane më 1847 në Stamboll u dha leja për formimin e një kuvendi armen, që do të ishte kuvend i pavarur fetar dhe civil. Në vitin 1860 nga qeveria osmane u pranua “Kuvendi kombëtar armen”. Pastaj kishin mundësi që punëtorët laikë t’i zgjedhnin vetë. Për t’i çuar këto zhvillime përpara, mes tyre u përgatitën edhe organizata të armatosura. Në Anadoll filluan të ndërmerren hapa për themelimin e shtetit armen. Luftërat, sidomos ato në Anadollin lindor, u shndërruan në luftëra qytetare. Në komunitetet islame dhe armene filloi të hidhet fara e armiqësisë. Tërheqja e mbështetjes ekonomike për shkak të kryengritjes më 1917, dha shanse për rezultimin e luftërave me fitoren e osmanlinjve. Lufta e humbur brenda, armenët e Anadollit lindor i detyroi që të shpërngulen. Kurse në perëndim dhe në Anadollin e mesëm, armenët të cilët nuk u përzien në ngjarjet politike, vazhduan jetën e tyre tradicionale. Numri i sotëm i tyre është përafërsisht 50.000. Shumica e komunitetit është e tubuar rreth Stambollit.

c. Besimi dhe adhurimi

Kisha tradicionale gregoriane, sikur kisha siriane dhe ajo kopte, është kishë monofizite. Patrikana e tyre merr titullin “katolikos”. Ata nuk pranojnë se ushqimi dhe alkooli në ritet e kungimit shndërrohen në mishin dhe në gjakun e Jezu Krishtit. Ata, gjithashtu, nuk pranojnë se kisha mund t’i falë mëkatet. Përveç me rastin e amoralitetit, shkurorëzim tjetër nuk pranojnë, ikonat i numërojnë si traditë e vjetër idhujtare dhe i refuzojnë dhe, gjithashtu në shtëpitë e tyre nuk mbajnë ikona të shenjta.

3. Kisha kopte në Egjipt

Literatura: Mustafa Erdem, Kipti Kilisesi Üzerine Bir Deneme, *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, nr. 35; B. Spuler, *Die Morgenländischen Kirchen*, f. 151-188.

Përhapjen e krishterimit në rajonin e Nilit transmetimet e të krishterëve egjiptianë e çojnë deri në periudhën e apostujve. Ata thonë se Marku, njëri nga shkruarit e ungjillit, është nga misionarët e parë me rëndësi dhe atë e llogaritin si Patrik të parë nga patrikët e Aleksandrisë. Nga shkrimet e zbuluara në Nag Hammadi në vitin 1945, kuptohet se Ungjilli i Ebionitëve në rajonin e Nilit ka qenë i njohur që në vitet 70 të e.s. Gjurmët e komunitetit hebreo-krishter (ebionit), kuptohen nga ekzistenca e ungjijve si “Ungjilli i hebrenjve”, “Ungjilli i egjiptasve”, “Ungjilli i Tomasit”. Ekzistonte edhe transmetimi se Bernaba ka qenë i dërguari i parë krishter në Egjipt, vend ky ku janë përgatitur dijetarë të mëdhenj krishterë.

Në diskutimet në lidhje me natyrën e Jezusit, llogaritja e Cyrillit I, si patriku i Aleksandrisë dhe babai i mendimit monofizit, ka hapur rrugën që ky mendim të pranohet edhe në Egjipt. Mes viteve 639-642, hyrja e shtetit nën administrimin islam, dha shansin që Egjipti monofizit të shpëtojë nga presioni bizantin. Braktisja e Egjiptit nga ata që ishin me origjinë greke, lehtësoi edhe më tepër dominimin monofizit në kishë. Në vitin 706 në kishat egjiptiane u ndalua të folurit greqisht, kurse adhurimi plotësisht bëhej në gjuhën kopte. Të jetuarit e tyre në të njëjtin shtet edhe më tepër e forcoi vëllazërimin e tyre me Kishën siriane. Më vonë në mesin e tyre me shpejtësi u përhap edhe arabishtja, e cila më vonë e zuri vendin e gjuhës kopte. Viti 1395 është data më e re e dorëshkrimeve në gjuhën kopte. Kurse në shek. XVII, për gjuhë zyrtare vendin e saj plotësisht ia lë gjuhës arabe. Ndërkaq sot gjuha kopte përdoret vetëm në kishë si gjuhë adhurimi.

Gjendja sot

Dobësimi i osmanëve mundësoi depërtimin e misionarëve perëndimorë në Egjipt. Në vitin 1741 një grup kanë kaluar në katolicizëm, të cilët kanë botuar edhe libra në lidhje me adhurimin katolik. Udhëtimi i Napoleonit në Egjipt, përforcoi edhe më tepër ndikimin evropian atje. Vetëm se, rivaliteti mes misionarëve protestanë, anglikanë dhe katolikë dhe dëshira e kishës tradicionale për të mbrojtur komunitetin e saj, kanë prishur qetësinë brenda në komunitet. Sot ata posedojnë afër 1.5 milion simpatizues, të cilët në përgjithësi jetojnë nëpër qytete dhe përbëjnë një klasë sociale të pasur. Në vitin 1956 numri i atyre që kanë pranuar islamin ka arritur në 10.000. Numri i të lidhurve me Romën, sipas regjistrimit të vitit 1957, ka qenë përafërsisht është 75.000.

4. Kisha etiopiane

Krishterimi në Etiopi ka arritur në shek. IV. Sipas transmetimit, në mesin e skllëve, të shitur si rezultat i një fatkeqësie në një det në Tيروس, gjenden edhe dy vëllezër me emrin Frumentios dhe Ajdesios. Këta skllëvër u sollën në sarajin mbretëror dhe aty jetuan si shërbyes. Sidomos mbretin e njohur me emrin Ebrahe ose Ezana, e përfituan në krishterim. Pastaj edhe mbreti kontribuoi në përhapjen e krishterimit. Në këtë kohë etiopianët në Arabinë Jugore luftonin me persianët dhe ka mundësi që të kishin kërkuar përkrahjen e Bizantit. Më 1955 në Etiopi janë numëruar 8 milionë të krishterë.

Sipas transmetimit, Ajdesosi, pas një kohe të gjatë pune është kthyer në shtetin e tij, në Siri dhe si u pagëzua prift përsëri kthehet në Etiopi, ku vazhdon punën e tij si misionar. Kurse Frumentios lidhi marrëdhënie me kishën egjiptiane dhe u shenjtërua si peshkop i Etiopisë. Me këtë kisha etiopiane u lidh me kishën monofizite në Egjipt. Në përhapjen e më lehtë të krishterimit në Etiopi rol të veçantë ka patur edhe komuniteti hebraik që gjendet atje.

Pas Luftës së Dytë Botërore, një çështje shumë e rëndësishme e marrëveshjes së bërë me

Perëndimin ishte, lejimi i veprimit lirshëm të misionarëve perëndimorë në shtet. Në vitin 1955 në Etiopi janë numëruar 37.000 katolikë.⁴⁵⁶

5. Nestorianët

Nuk posedojmë dituri të thella për atë se si është përhapur krishterimi në shtetet e Azisë së mesme, si në Iran dhe në Mesopotami. Shihet se në shek. III të e.s., në Mesopotami paraqitet kisha arameje, sepse në ato vende jetonin më tepër aramejë se iranianë. Sado që iranianët zaratustrizmin e kanë shpallur fe shtetërore dhe me të kanë dashur të mbrohen prej krishterimit dhe maniheizmit, ai e kishte humbur forcën e tij. Në fakt këtë e vërteton edhe suksesi i islamit që në shek. VII për një kohë të shkurtër të mbisundojë Iranin.

Mes të krishterëve në perandorinë sasanide, nuk kishte shumë interesim për diskutimet në lidhje me personalitetin e Jezu Krishtit, diskutime këto që vazhduan dhe u zhvilluan në perandorinë Bizantine. Vetëm se, mendimet e ekolit të Antakisë, që ishte e lidhur me Nestoriusin, patrikun e Konstantinopojës, ndikuan në tërë Azinë e Mesme, e sidomos, në rajonet ku flitej gjuha arameje. Nestoriusi ka lindur në rrethin e Marashit të sotëm më 382, kurse ka mësuar në Antaki. Më vonë në priftëri, me të cilën e lidhi fatin e tij, duke u zhvilluar me gojëtarinë (elokuencën) dhe me intelegjencën e tij, arriti në postin e patrikut. Punoi që t'i zhvillojë mendimet e ekolit ku mësoi. Sipas kësaj, “Maria nuk duhet thënë nëna e zotit (theotokos), ajo ka lindur vetëm Zotin njeri, për të cilën asaj i duhet thënë nëna e Krishtit (kristotokos)”. Vetëm se, më herët në adhurimet mes të krishterëve përdorej termi “nëna e zotit” dhe komuniteti ishte përshtatur në këtë. Nestoriusi me deklarin e një formule të re del kundër një bindjeje tradicionale dhe të pranuar më parë. Gjithashtu Nestoriusi, mbronte mendimin se në inkarnacionin e Jezu Krishtit mbrohen tërësia dhe specifika e dy natyrave. Kështu që, as logosi nuk zhduket në natyrën njerëzore të Jezusit e as që natyra e tij bëhet Zot. Kështu që, në të gjenden dy natyra pranë tyre, por në marrëdhënie të përafërta njëra me tjetrën. Nestoriusi këtë e shpreh kështu: Logosi vetëm që u vendos në njeriun e lindur nga Maria dhe ishte në njëshmëri të përafërt me të. Kjo gjendje e dy natyrave afër njëra-tjetrës, u bë një formë e një personaliteti të njësuar, duke mos e detyruar njëra-tjetrën.⁴⁵⁷ Për këto mendime të tij, Nestoriusi i fajësua me diofizitizëm (dy natyrshmëri). Nestoriusi, duke u larguar nga posti i Patrikut, më 451 vdiq në Egjipt. Mendimet e tij, të pranuar nga të krishterët e Iranit dhe të Mesopotamisë, u përhapën deri në Kinë. Simpatizuesve të tij u thuhet nestoritë (nestorianë).

Nestorianizmi ishte shumë i lidhur me besimin diofizit. Ata, mendimet se Jezusi është bir i Zotit dhe se Zoti ka dy fëmijë (Jezusi dhe Shpirti i Shenjtë), i refuzojnë. Mendimin se logosi dhe biri i njerëzimit bashkohen në një substancë, e vlerësojnë si monofizit dhe të humbur. Largohen prej përdorimit të shprehjes theothokos (Maria është nëna e Zotit). Zyrtarisht për Jezusin pranojnë formulën “dy natyra, dy substanca, një person”, të shprehura në vitin 612. Rreptësisht e refuzojnë mendimin se shpirtërat janë “ekzistenca të para” (*preexistence*). Sipas nestorianizmit, çdo shpirt krijohet drejtpërsëdrejti nga Zoti dhe se dita e dyzetë e barrës bashkohet me embrionin. Pas vdekjes e deri në ringjallje futen në “gjumin e shpirtërave”. Mendimin se mëkati i Adamit mbetet si trashëgimi (si mëkat i trashëguar), për pasardhësit e tij, nuk e pranojnë. Ata besojnë se shpëtimi është vetëm në kishën e tyre, fraksionet tjera janë në humbje. Gjithashtu besojnë se, pasues i apostullit Pjetër nuk është papa, por është katolikos, patriku i tyre.

Dobësimi i nestorianizmit

Nestorianizmi, sado që ishte përhapur, nuk ka mundur të bëhet fe shtetërore. Ai pati ndikim deri në sarajet osmane, irianiane dhe mongole, por nuk mundi të ndikojë në shtesa të gjera. Gjatë përhapjes në perëndim të turqve dhe të

⁴⁵⁶ Spuler, *Die Morgenlandischen Kirchen*, Leiden 1964, f. 191-200.

⁴⁵⁷ Adam, *Dogmengeschichte*, v. 1, Gutersloh 1965, f. 326.

mongolëve në shek. XIII, prezenca në ushtri e një numri të madh i të krishterëve nestorianë, nestorianëve nën administrimin abbasit u dha një forcë të madhe, përsëri ky ishte një lulëzim kalimtar, sepse pas një kohe të shkurtër të gjithë e pranuan islamin, nga i cili vendësit nuk kanë patur aq dobi. Edhe të krishterët vendës, me pranimin e islamit, kanë garuar me ushtarët osmanë dhe mongolë. Në fund nestorianët, numri i të cilëve është zvogëluar shumë, përgjatë invadimit të Timurit, janë tubuar në rajonin malor Hakkarit.

Peshkopi Gjon, me qëllim që të ndalojë këtë shkatërrim, u lidh me papatin dhe vërejtë ndonjë gjë të keqe në epërsinë e papës. Vetë ai nga papa u emërua patrik i lindjes. Qeveria osmane këtë e pranoi si një gabim politik dhe Gjonin e burgosi. Gjoni, i mërzhitur për këtë që ndodhi, vdiq më 1555. Vetëm se, ata që bashkë me të ishin të lidhur me Vatikanin, edhe pas kësaj ngjarjeje nuk u kthyen më në fraksionin e tyre të vjetër. Të krishterëve nestorianë që e kanë pranuar katolicizmin u thuhet “kaldetë”, kurse nestorianëve të vjetër diofizitë, që mbronin besimin tradicional historik, u thuhet “asirianë”.

Prej asaj kohe mes sirianëve perëndimorë gjenden dy fraksione dhe dy patrikë. Mendohet se nestorianët katolikë, gjegjësisht kaldetët, në vitin 1833 kanë qenë 50.000 vetë. Pas Luftës së Parë Botërore, patriku kaldet ka filluar të qëndrojë në Bagdad. Sipas regjistrimit të vitit 1957 ata janë llogaritur të jenë 176.000 besimtarë.

Patrikët asirianë gjithmonë kanë bartur titullin “simon”. Pas vitit 1834 futja e misionarëve amerikanë në rajon përshpejtoi shkatërrimin e komunitetit historik nestorian. Disa prej tyre u bënë katolikë, e disa u futën në kishën anglikane. Veprimet e misionarëve rusë kanë qenë më të suksesshme, kështu që më 1835 një grup prej 3000 vetave e braktisi tokën osmane dhe u shpërngul për në Kaukaz, në qeverinë ruse. Më vonë ky grup ndiqet nga grupe të tjera. Me hyrjen e osmanëve në Luftën e Parë Botërore, simpatizuesit rusë u ngritën kundër muslimanëve dhe këto lëvizje, me rritjen e erës së luftës së brendshme që afrohej, e rritën edhe më tepër shpërnguljen për në Rusi. Vetëm se, me shkatërrimin e mbretërisë ruse më 1917, asirianët mbetën në mes, as të vendosen në Rusi e as të kthehen në Turqi. Zgjidhjen e kanë gjetur në kthimin në tokat e Irakut Verior, që ishin nën sundimin anglez. Luftërat që lindën brenda muslimanëve irakianë më 1933, mundësuan që shumë prej asirianëve të shpërngulen për në Siri, Qipro dhe në Amerikë. Patrikët e tyre për momentin janë të vendosur në Chicago. Supozohet se numri i tyre i tërësishëm në botë arrinë deri në 100.000.⁴⁵⁸

6. Maronitët

Perandori Herakleos (610-641), në punimet e tij për përcaktimin e besimeve kryesore të krishterimit në perandorinë bizantine, duke u takuar me liderët sirianë dhe armenë, shpall këtë formulë: “Energjia njerëzore e Jezusit asnjëherë nuk mund të jetë në kundërshtim me fuqinë hyjnore, edhe dëshira njerëzore e Jezusit asnjëherë nuk mund të jetë kundër dëshirës hyjnore. Në Jezusin, edhe pse gjenden dy forca, përsëri ai posedon një dëshirë të vetme”. Shpjegimi se Jezusi ka “fuqi dëshire” e mohon mendimin e “monergizmit”, sipas të cilit se tek Jezusi ka vetëm një energji, kur theksi vihet mbi qenien e dy natyrave.

Propozimin e perandorit e ka pranuar një grup i krishter i rajonit të Palestinës. Simpatizuesit e këtij mendimi, në përgjithësi, janë priftërinj që jetojnë në manastirin e Shën Maronit, mes Hamait dhe Humusit. Kurse më vonë ata, vetëm pse prifti Gjon i ka quajtur nxënës të Maronit, e kanë braktisur këtë mendim të quajtur “monotheletizëm”. Ata nuk mund të shpjegojnë se përse janë bërë komunitet. Përgjithësisht, ata jetojnë në rajonin fushor të Libanit. Kanë patrikët e tyre dhe duke u bashkuar me Romën e kanë pranuar katolicizmin. Kurse adhurimet i kryejnë në gjuhën siriane.

Sipas regjistrimit të viteve 1952 numri i tyre në Siri dhe në Liban arrin 400.000, kurse në Egjipt 13.000. Sot grupin më të madh të krishterëve që jetojnë në shtetin e Libanit e përbëjnë maronitët.⁴⁵⁹

⁴⁵⁸ Spuler, f. 2-51.

⁴⁵⁹ Spuler, f. 99-105.

FRAKSIONET E PAVARURA KISHTARE

Në shtetet perëndimore, sikur kishat e përhapur katolike, ortodokse dhe protestante dhe si reaksion ndaj fraksioneve kryesore të krishterimit, me komentimet e tyre të llojlojshme për problemet fetare, janë formuar fraksione dhe komunitete të reja. Dallimet mes tyre në disa raste bazohen në komentimet e tyre në lidhje me dogmatikën e në disa raste me adhurimin e tyre. Ata kanë dalë në shesh me bindjen që të kthehen në jetën e pastër të komunitetit në periudhën e parë. Ata janë në marrëdhënie me bashkimin e kishave botërore, apo janë rryma të përshtatshme për marrëdhënie me ta. Për ta përdoret termi “kishë”, i cili në vete ngërthen kuptimin fraksion dhe komunitet në islam. Kishat e reja emrat e tyre i marrin o prej emrit të themeluesit, o prej temave kryesore mbi të cilat përqendrohen. Për rritjen dhe për forcimin e komuniteteve të vogla i jepet një rëndësi e veçantë propagandës dhe misionerizmit.

1. Baptistët

Këta janë vazhdë e puritanistëve anglezë. Biblën e vlerësojnë si themel të besimit dhe të jetës së tyre. Në fund të shek. XVI komunitetin e tyre e kanë llogaritur të pavarur nga kisha shtetërore. Kështu që, në mesin e tyre është formuar një njësi me emrin “komuniteti i shenjtoreve”. Për shkak të përndjekjes dhe dhunës shtetërore disa anëtarë e kanë braktisur Anglinë. John Smyth, njëri prej udhëheqësve të komunitetit, më 1608, u vendos në Amsterdam. Këtu formoi bindjen se besimtarët e “komunitetit të shenjtoreve” duhet të pagëzohen në bazë të shembullit biblik, si një praktikë e Jezu Krishtit. Disa anëtarë të komunitetit u ndanë prej Smythit dhe nën udhëheqjen e Thomas Helwyit (1611-1612), përsëri shkuan në Angli. Për të mos u ngatëruar me mennonitët, të cilët pagëzoheshin ngjashëm me ta, vetveten e quajtën “baptistë”, që ka kuptimin “të pagëzuarit”. Kjo lëvizje, gjatë kohës u përhap nëpër shtete të ndryshme të Europës dhe të Amerikës.

Themelin e jetës së komunitetit e përbëjnë adhurimet e të dielës. Nuk kanë ndonjë tekst definitiv që përcakton përmbajtjen e adhurimit. Esencën e predikimeve e përbëjnë përmbajtja dhe teksti i marrë nga Bibla. Thuhen këngë hyjnore.⁴⁶⁰ Ceremonia e kungimit të shtunën bëhet një herë në muaj. Buka e thyer në ceremoni është bukë natyrore dhe anëtarët e komunitetit të rreshtuar të gjithë marrin nga një pjesë. Po ashtu pinë edhe prej gotës me alkool. Por këtë nuk e kuptojnë si një sakrament, por, vetëm si një përkujtim. Edhe gjatë javës organizojnë tubime të ndryshme. Pagesa e priftit që shërben në komunitet dhe harxhimet e tjera, realizohen nga vetë komuniteti. Anëtarët e komunitetit njëri-tjetritin e thërrasin “vëlla”. Organi më i lartë administrativ është kuvendi i komunitetit. Ai tubohet një herë në vit.

Sot është anëtare e kishave protestante. Krishtin e llogaritin si Bir të Zotit, shpëtimtar dhe zotëri të botës. Mbrojnë mendimin se pagëzimi nuk realizohet për fëmijët, por për të rriturit dhe se besimi dhe pagëzimi janë të pandara njëri nga tjetri. Parimin e ndarjes së kishës dhe të shtetit e pëlqejnë. Nuk njohin autoritetin e njeriut shpirtëror në kishë. Sipas supozimeve të vitit 1975, mendohet se në botë ka afër 35 milionë baptistë.⁴⁶¹

⁴⁶⁰ Gunther Balders, “Der Bund Evangelisch-Freikirchlicher Gemeinden in Deutschland”, in: *Gliederd an Einm Leib*, Hrsg.: Hans-Motel, Konstanz 1975, f. 117 dhe në vazhdim.

⁴⁶¹ Reller, *Handuch Religiöse Gemeinschaften*, f. 27-45.

2. Protestantët e lirë

Këta bazohen në lëvizjen e pietizmit. Paraqitja e parë e tyre në skenën historike shihet në grumbullimin përreth Robert Haldane (1764-1842) në Genf më 1816. Zyrtarisht në Francë dhe në Zvicër, janë formuar më 1849, kurse në Gjermani më 1854. Ata kanë për ideal rregullimin e komunitetit të tyre, sipas Dhiatës së Re. Çdo anëtar i komunitetit llogaritet edhe anëtar shpirtëror. Ceremonitë fetare i udhëheqin njerëzit e edukuar të komunitetit. Në komunitet më tepër shërbejnë më të moshuarit. Ata nuk e refuzojnë pagëzimin e fëmijve, vetëm se pagëzimin e të rriturve e preferojnë më tepër. Pagëzimin e bëjnë me larje (zhytje) në ujë. Në aspektin fetar dëshirojnë të jenë të pavarur nga populli dhe nga shteti. Besojnë se pavarësia e vërtetë vjen prej Zotit dhe fjalëve të Tij.⁴⁶²

Ata po ashtu posedojnë edhe njerëz të autorizuar për predikimin e njohurive fetare dhe për udhëheqjen e shërbesave fetare. Rregulli i komunitetit dallon në bazë të kushteve të vendit. Çdo komunitet ka një listë të komunitetit të tij, kurse harxhimet bëhen sipas nevojës së komunitetit. Me anëtarët e komuniteteve tjera bashkohen me njësimin e zemrës me ta. Në shtetet ku ata jetojnë janë formuar “Njësi komunitetesh të protestantëve të lirë”. Ajo është një lloj federacioni i komuniteteve lokale. Këto njësi të larta i vazhdojnë aktivitetet e tyre si mbrojtja e komuniteteve, hapja e shkollave verore, botimet e ndryshme dhe aktivitetet misionerike. Sipas supozimeve të vitit 1960 në botë ka patur afërsisht 300.000 anëtarë të tyre. Ata janë anëtarë të lidhjes së kishave protestante.⁴⁶³

3. Metodistët

Kjo lëvizje ka lindur në Angli në shek. XVIII. Në krye të themeluesve qëndrojnë John Wesley (1703-1791) dhe vëllai i tij Charles (1707-1788). Këta janë quajtur “*metodistë*” për shkak se u janë përkushtuar parimeve dhe kohës së adhurimit të anëtarëve të “klubit të shenjtoreve” në Universitetin e Oxfordit. Në fakt Wesley nuk kishte për qëllim që të formojë ndonjë komunitet të ri. Vetëm se, me anë të komentimeve të tij në të kuptuarit e fesë erdhi deri te formimi i një komuniteti të ri. Kishat metodiste të shpërndara në shtete të ndryshme, në vitin 1968, mes veti formojnë një bashkim dhe kështu janë zhvilluar në frymën e protestantizmit. Biblën e llogaritin si themel të besimit dhe të jetës së tyre. Ata janë të përmalluar për organizimin e jetës së tyre mbi etikën krishtere. Nëpër kishat e tyre mund të ligjërojnë edhe jopriftërinj. Ata janë përhapur në Europë dhe Amerikë dhe në vitin 1967 mendohet se kanë patur afër 20 milionë anëtarë. Ata janë edhe anëtarë të lidhjes së kishave botërore.⁴⁶⁴

4. Vëllezërit e lirë (Freier Bruderkreis)

Ka lindur në mesin e libëralëve të Anglisë. Janë përhapur edhe në Europë edhe në Amerikë. Autoritetin e Biblës e kanë bazë të besimit të tyre. I mohojnë të gjitha kritikatat që i bëhen Biblës. Vetveten e llogaritin “fëmijë të zotit”. Pagëzimin e realizojnë me zhytje në ujë dhe këtë e llogaritin bazë për të qenë ithtar i Jezusit. Nuk e njohin klasën shpirtërore. Ritualin e kungimit e njohin si sakrament, por vetëm si përkujtim e jo si adhurim. Presin ditën e kthimit të Jezusit si Krisht në tokë nga qielli, i cili do të vijë për realizimin e autoritetit njëmijë vjet para apokalipsës. Sot shumica e këtij komuniteti gjenden në Gjermani. Numri i tyre arrinë përafërsisht 20.000.⁴⁶⁵

⁴⁶² Reller, f. 46-66; Erich Geldbach, *Freikirchen*, Göttingen 1989, f. 181-190.

⁴⁶³ Wilhelm Wohrle-Heinz Adolf Ritter, *Der Bund FreierEvangelischer Gemeinden, in Deutschland*, f. 218-237.

⁴⁶⁴ Reller, f. 67-83; Geldbach, f. 199-206; H. Viogt, *Die Evangelisch-Methodische Kirche*, in: *Glider an Einem Leib*, f. 174-218.

⁴⁶⁵ Reller, f. 86-94.

5. Mennonitët

Pranohet se ky fraksion ka dalë në shesh me anë të rrymës baptiste të lëvizjeve reformiste. Si ditë shpëtimi e llogaritin 25 janarin e vitit 1525. Ata preferojnë që të quhen “protestantë të lirë më të vjetër”. Thonë se janë ndjekës të Jezu Krishtit. Ata theksojnë se arma e tyre janë “Fjala e Zotit, Ungjijtë dhe Dashuria”. Nuk pranojnë që të shërbejnë në ushtri. E mbrojnë ndarjen e kishës nga shteti. Emri i tyre “mennonit” rrjedh prej anëtarësimit të tyre te murgu katolik Menno Simons (1496-1561). Nuk pranojnë që të betohen. E shohin të nevojshme që Zotit t’i jepet fjala për qëllime botërore. Besojnë se me anë të pagëzimit hyjnë në komunitetin e paqes dhe se u falen mëkatet. Jetojnë një jetë të mbyllur karshi botës moderne. Në aspektin numerik pjesa më e madhe e komunitetit janë në ShBA. Sipas regjistrimit të vitit 1975 ka përafërsisht 60.000 misionarë, të cilët janë të shpërndarë në vende të ndryshme të botës. Supozohet se bota ka afër 550.000 mennonitë. Ata gjithashtu janë anëtarë të lidhjes së kishave botërore.⁴⁶⁶

6. Ushtria e shpëtimit (Salvation Army)

Këta vetveten e llogaritin si një lëvizje mbifraksionale. Themelimi i saj i dedikohet William Boothit (1829-1912), me origjinë angleze. Kurse emri “ushtria e shpëtimit” i është dhënë më 1878. Pas kësaj ata më tepër i përvetësonin cilësitë ushtarake. Shërbim më të madh llogaritin predikimin dhe përhapjen e Biblës nëpër rrugë. Nuk i respektojnë misteret e kishës. Në vend të pagëzimit të fëmijës, theks i veçantë, “për përgjegjësinë e përgatitjes së fëmijëve, për trinitetin dhe për faljen e mëkateve”, vëhet mbi prindërit e tyre. Nuk kanë ndonjë tekst stabil adhurimi. Në tubimet për adhurim bëjnë lutje dhe recitojnë këngë fetare. Për t’ua tërhequr vëmendjen njerëzve, organizojnë tubime të lira nëpër rrugë dhe në vende ku ka pjesëmarrës. Brenda në komunitet respektojnë barazinë mes burrit dhe gruas. Pijet alkoolike, duhanin dhe futjen nëpër punët shtetërore i llogaritin të ndaluara. Thonë se, me këto janë në luftë. Në vitin 1978 kishte përafërsisht 2.5 milionë anëtarë. Qendra e tyre është në Londër. Janë anëtarë të unionit të kishave protestante.⁴⁶⁷

Themeluesi W. Booth predikimet e tij i mbante në vendet e varfëra të qytetit, duke i shoqëruar me daulle dhe me trumbetë. Anëtarët e parë janë laviret dhe të dehurit. Krahas ligjërimit ndikues organizonin edhe ndonjë ushqim për të mjerët. Më vonë, për t’i shpëtuar laviret dhe të dehurit formuan konvikte. Hapën shtëpi për jetimët, për vajzat e reja dhe shtëpi për kujdesjen e të moshuarve. Me suksesin që e arriti nga përvoja e tij, kjo parapriu edhe në hapjen e shumë spitaleve, poliklinikave, shkollave dhe për themelimin e qendrave për ndihmë sociale.⁴⁶⁸

7. Kuakerët (Komuniteti i shokëve)

Ky fraksion lindi për shkak të zënkave mes fraksioneve fetare dhe atyre politike në Angli. Themeluesi i lëvizjes është George Fox (1624-1691). Fox, Biblën e pranon si shpallje të tij dhe thotë se një gjë e tillë nuk ndodhë një herë, por ajo përsëritet gjithnjë. Ai thotë se, në çdo njeri ka “një dritë”, se Zoti nuk gjendet në kala të larta e as në ndërtesa madhështore, por në çdo vend, bile edhe në shpirt (zemër). Komuniteti ka një specifikë spiritualiste dhe mistike. Nuk diskutojnë për ndonjëfarë lloji sistemi të besimit. Theks të veçantë vënë mbi “vëllazërinë”. U përmbahen parimeve themelore të krish-

⁴⁶⁶ Reller, f. 95-105; Peter Foth, *Die Mennoniten, in: Glieder an Einem Leib*, Krsg. H. Motel, f. 50-92; Geldbach, f. 172-181.

⁴⁶⁷ Reller, f. 106-115; Geldbach, f. 207-211.

⁴⁶⁸ Wilhelm Kiefel, *Die Heilsarmee, in: Glieder an Einem Leib*, f. 241-242.

terimit. Punojnë që të ringjallin shpirtin e krishterimit të parë. Edhe pjesëtarët e feve të tjera i shikojnë me tolerancë. Vetëm se, atë që nuk është i krishter nuk e llogaritin për kuaker (mik). Besojnë se Zoti në mënyrë direkte paraqitet në trupin e njeriut. Ata nuk pranojnë askënd formalisht në adhurim, sakrament priftërie dhe në detyrat fetare. Në mesin e tyre organizojnë tubime meditimi dhe aty presin inspirimin nga Shpirti i Shenjtë. Nuk pranojnë të kryejnë shërbimin ushtarak dhe të betohen. Janë anëtarë në unionin e kishave ekumenike. Në vitin 1969 është supozuar se kanë patur përafërsisht 200.000 anëtarë. Ceremoninë e pagëzimit dhe të kungimit i kanë braktisur.⁴⁶⁹

8. Komuniteti Pfingst (Unioni i komuniteteve krishtere)

Llogaritet lëvizje kishtare fetare e shek. XX. Ata lëvizjen e tyre e llogaritin si “rizgjim për kohën e fundit”. Mbrojnë mendimin e inspirimit të shkrimeve të shenjta. Besojnë, për autoritetin njëmijëvjeçar të Jezu Krishtit, i cili së shpejti do të kthehet. Ata thonë se është e pamundur jeta fetare për shërbim. Kurse komuniteti i Krishtit është ai që veten ia ka premtuar Zotit. Fëmijët e tyre i edukojnë në shkolla të ndryshme të të dielave dhe në shkolla verore. Mes tyre mbisundon një botëkuptim i fortë për ndihmë sociale. Kungimin e llogaritin si provë të dashurisë së Jezu Krishtit. Punojnë që të marrin pjesë të gjithë individët. Janë anëtarë në unionin e kishave protestante. Mendohet se në botë kanë përafërsisht 65-75 mijë anëtarë.⁴⁷⁰

⁴⁶⁹ Reller, f. 116-131; Tümer-Küçük, f. 292; Curth Nuthmann, *Die Religiöse Gesellschaft der Freunde, in: Glieder an Einem Leib*, f. 264-271; Geldbach, f. 224-231.

⁴⁷⁰ Reller, f. 132-147; Wolfgang Meissner, *der Christliche Gemeinschaftsverband, in: Glieder an Einem Leib*, f. 248-263; Gelbach, f. 217-223.

9. Apostujt katolikë (Irvingianët)

Kishës katolike-apostolike i thuhet edhe “irvingiane”. Themeluesi i lëvizjes është anezi Edward Irving (1792-1834). Ai ka shpallur se është afruar fundi i botës dhe dita e Krishtit dhe të gjithë apostujt e rinj i ka thirrur në shërbim. Revolucioni Francez është pranuar si “shenjë e apokalipsit”. Besimet e përgjithshme të kësaj kisha janë në paralelizëm me ato të anglikanes. Besojnë se, për autoritetin njëmijëvjeçar të Krishtit, Jezusi do të vijë së shpejti. Për këtë mbrojnë mendimin se organizata kishtare duhet të jetë si “në kohën e apostujve”. Ata nuk pranojnë se në ceremoninë e kungimit buka është mishi i vërtetë dhe vera gjaku i vërtetë i Jezusit, por, ato i kuptojnë vetëm simbolikisht. Supozohet se në botë kanë 100.000 simpatizues.⁴⁷¹

10. Vëllazëria e mbretërisë së Jezu Krishtit

Themeluesi është Abram Pozhak. Pozhak ka lindur më 1900 në Rusi, nga një familje me origjinë hebraike. Pas shpërnguljes në Gjermani është interesuar për krishterimin dhe e ka pranuar atë. Më 1935 në Jerusalem themelon “Unionin hebraik-krishter”. Më pas lëvizjen e tij e bart në Europë. Kurse më 1963 vdes në Motthingen. Lider i komunitetit pas tij, është bërë mbreti i shtypit Albert von Springer.

Këta janë të mendimit se koha e Fundit ka ardhur dhe se së shpejti do të shihen ngjarjet mbinatyrore. Gjithashtu janë në pritje për shtetin hyjnor, të cilin do ta formojë Jezu Krishti. Numri i tyre nuk dihet. Kanë simpati ndaj unionit të kishave.⁴⁷²

11. Adventistët

Data e themelimit të fraksionit bazohet në fillimin e ligjërimit të William Millerit (1782-1849) nga New Yorku më 1833 në kishën baptiste. Në fillim i thuhej “lëvizja e Millerit”. Kjo ka lindur si një lëvizje mesianiste e cila thekson se Jezusi do të vijë së shpejti. Miller e ka llogaritur se Jezusi do të kthehet në vitin 1843. Ai pretendonte se ka biseduar me Zotin dhe se atij i është dhënë detyra për këshillimin e njerëzve. Për këtë qëllim kanë botuar Revistën Adventiste. Mijëra njerëz, në bazë të pretendimeve të tyre filluan të presin Jezu Krishtin. Kështu që, më 1844 për shkak të moskthimit të Krishtit në komunitet lindi një shqetësim. Për këtë kjo ide me anë të pretendimeve të ndryshme u shty për në një periudhë të pacaktuar. Miller vdiq më 1849. Një pjesë e komunitetit besonte se Jezusi është kthyer “shpirtërisht” dhe se ka filluar periudhën e mëshirës dhe kështu që vitin 1844 e llogaritin si fillim të Ditës së Madhe. Komuniteti me lider dhe me komentime të reja ka arritur deri në ditët e sotme.

Adventistët Biblën e pranojnë si “libër i parë i shenjtë”. Besojnë se Jezusi është i krijuar dhe se në Jezusin dhe në Shpirtin e Shenjtë gjendet shpirti hyjnor. Të krishterët e vdekur jetojnë në qiell bashkë me Jezusin. Kur të vijë koha të gjithë bashkërisht do të kthehen përsëri. D.m.th. se të gjithë do të ringjallen dhe do ta jetojnë madhështinë e shtetit mesianik që do të zgjasë njëmijë vjet. Gjërat dehëse dhe cigaren i llogaritin të ndaluara.⁴⁷³ Sipas hamendësimeve të vitit 1976 në botë janë llogaritur të jetojnë afër 3 milionë simpatizues të kësaj bashkësie.

⁴⁷¹ Reller, f. 159-169.

⁴⁷² Reller, f. 192-205.

⁴⁷³ Reller, f. 231-249.

12. Komuniteti shkencë krishtere (Christian Science)

Ky fraksion është themeluar nga ana e zonjës amerikane të quajtur Mary Baker Eddy (1821-1910). Në vitin 1883 filloi të botohet revista mujore me titull “Christian Science Journal”. Mbledhja e parë e fraksionit u mbajt në Chicago më 1888. Besojnë se libri *Science and Health* i Mary Baker Eddy-it është shpallje e pastërt e Zotit. Ky libër përbën mendimin themelor në krishterim. Jezusin e pranojnë si “Bir i Zotit”. Ata besojnë në njësinë e Zotit dhe të Jezusit dhe se “manifestimet dhe individualitetet hyjnore janë të panumërta”. Kanë simpatizues në shtete të ndryshme dhe janë anëtarë mbikëqyrës të unionit të kishave botërore. Gjithashtu janë në dialog me unionin e kishave protestante amerikane.⁴⁷⁴

13. Kisha e shtetit hyjnor

Themeluesi është Alexandre Freytag (1870-1947). Besojnë se në një jetë pa mëkate nuk ka vdekje. Ata ushqehen me ushqime bimore dhe punojnë në themelimin e shtetit të drejtë në të cilin në kohën e fundit do të udhëheqë Jezusi. Nuk kanë marrëdhënie me kishat e tjera. Supozohet se kanë afër 70.000 anëtarë.⁴⁷⁵

14. Mormonët

Themeluesi është amerikani Joseph Smith (1805-1844), i cili e ndjente se është një “profet” që është i obliguar për rithemelimin e kishës së parë të Jezusit. Ai nxorri librin *Libri i mormonëve* (The Book of Mormon), që është një libër i shenjtë dhe është paralel me Dhiatën e Vjetër dhe të Re. Shumica e komunitetit u shpërngulën në vendin “Deti i madh i kripur” të rajonit Utah më 1845 dhe atje themeluan Salt Lake City-n.

Mormonët zotin e konceptojnë në formë të njeriut dhe në madhësinë e njeriut si krijesë prej mishi dhe gjaku. Thonë se zotat, prej fëmijëve të përbërë prej shpirtit dhe njerëzores, zgjedhin për veten e tyre një bashkëshort. Ata e identifikojnë zotin Jahve të hebrenjve me Jezu Krishtin. Sipas tyre, Jezu Krishti është biri më i vjetër nga djemtë e shumtë të Zotit dhe është vëllai më i madh nga të tjerët. 10 % të pasurisë e paguajnë si tatim kishës. Alkoolin, duhanin, mishin, çajin, kafën dhe bisedën me cigare i llogaritin të ndaluara. Ata janë të përhapur nëpër shtete të ndryshme të botës, por më tepër hasen në Amerikë. Supozohet se kanë afër 50 milionë anëtarë.⁴⁷⁶

15. Swedenborgianët (Kisha e re)

Themeluesi i këtij fraksioni është filozofi naturalist Emanuel Swedenborg (1668-1772). Komunitetin e parë të tij e formon, duke u bazuar në vizionet dhe iluzionet e tij, më 1774 në Londër. Besohet se Swedenborgu ka marrë shpallje dhe se mendimet e tij bazohen në shpallje. Sipas kësaj, natyra dhe gjithësia nuk janë krijuar nga hiçi, por janë krijuar vetvetiu. Është në dorë të njeriut se a do të

⁴⁷⁴ Reller, f. 301-315.

⁴⁷⁵ Reller, f. 373-380.

⁴⁷⁶ Reller, f. 381-392.

jetë ai në parajsë apo në ferr. Engjëjt dhe xhinnët nuk i ka krijuar Zoti, por, ata janë shpirtëra të mirë dhe të këqinj njerëzish. Ndikojnë edhe tek njerëzit e gjallë. Ata kanë komentime speciale të tyre. Disa shkrime të Dhiatës së Vjetër dhe të Re i llogaritin apokrifë. Janë të mendimit se Jezusi është inkarnacion i Zotit, për këtë edhe nuk e pranojnë trinitetin. Ata besojnë në njësinë e Zotit dhe Jezusin dhe Shpirtin e Shenjtë i llogaritin manifestime të ndryshme të Zotit. Besojnë se ngritja e Jezusit është bërë shpirtërisht e jo edhe me trup. E pranojnë reinkarnacionin. Besojnë se për shpëtim të përhershëm krahas besimit rol të rëndësishëm luan edhe vepra. Mendimin se Jezusi do të vijë përsëri nuk e pranojnë. Supozohet se, të përhapur në shtete të ndryshme të Europës dhe në Amerikë, kanë përafërsisht 60.000 anëtarë.⁴⁷⁷

16. Dëshmitarët e Jehovahit

Themeluesi i këtij komuniteti është Charles Taze Russell (1852-1916). Çështje kryesore të lëvizjes janë: pritja së shpejti e ardhjes së Jezusit, themelimi nga ai e shtetit hyjnor në Kohën e Fundit dhe fillimi i mbretërisë që do të zgjatë një mij vjetë. Presupozimet e dhëna shpesh dhe mosrealizimi i tyre, bënë që me komentime të ndryshme të ndryshohen ato shpesh dhe kështu e mbanin gjallë entuziazmin për pritjen e Jezusit. Ata nuk pranonin mendimin për trinitetin dhe mosvdekjen e shpirtit. Teorinë e evolucionit e mohonin. Me anë të aktiviteteve misionerike të tyre ata janë përhapur nëpër vende të ndryshme të botës. Supozohet të kenë afër 5 milionë simpatizues.⁴⁷⁸

17. Kisha e Zotit (Kisha e Armstrongut)

Themeluesi i këtij fraksioni është Herbert W. Armstrong (1893-1987), i cili nën ndikimin e adventistëve dhe të lëvizjes së izraelitëve të Britanisë, kishte një mendim eklektik. Komuniteti priste Kohën e Fundit dhe llogarinë e fundit. Ithtarët e këtij komuniteti punonin që me anë të Biblës të shkatërrojnë teorinë e darvinizmit. Kishin një organizatë misionerike të fortë, disa revista të ndryshme dhe në bazë të numrit të lexuesve është supozuar se ishin deri në 4 milionë ithtarë. Në vende të ndryshme të botës, me anë të botimeve dhe të shtypit, e kanë vazhduar veprimin aktiv misionerik. Revistat, si *Klar und Wahr*, janë prej revistave më të shpërndara edhe në Turqi.⁴⁷⁹

18. Lëvizjet e kishave monoteiste (Kishat pa trinitet)

Mendimi i ebionitëve, siç vërehet më pastaj në monarshianizëm dhe në arianizëm, për mospranimin e trinitetit dhe kundërshtimi i shpjegimit të Zotit në tre persona në historinë e krishterimit, e sidomos ajo që haset në fillim të krishterimit, është mugulluar përsëri me paraqitjen e reformizmit. Në mesin e lëvizjes kishtare reformiste hasim në ekzistimin e rrymave që janë larguar nga triniteti, Jezusin nuk e kanë pranuar si Zot, por vetëm si profet dhe si njeri. Këto, për arsye se nga kishat e mëdha janë llogaritur të devijuara, deri sot nuk janë të pranuar në unionin e kishave botërore.

⁴⁷⁷ Reller, f. 402-417.

⁴⁷⁸ Reller, f. 441-453; Tümer-Küçük, f. 348-350; Për më tepër shih, H. Tanyu, *Yehova Şabitleri*, Ankara 1973.

⁴⁷⁹ Reller, f. 470-488.

a. Unitarianët

Literatura: Ismail Yılmaz, *Unitaryanizmin Doğuşu ve Bunu Etkileyen Dini Faktörler*, (Basılmamış Doktora Tezi) Bursa 1994; Bilal Ebaş, *Bir Hıristiyanlık Mezhebi Olarak Aryüscülük*, (Basılmamış Yüksek Lisans Tezi), Stamboll, 1999.

Themelusi i rrymës unitariane, e cila është formuar në bazë të asaj se rregulli i universit varet prej njësisë së Zotit dhe se Jezu Krishti nuk mund të hyjnëzohet dhe besimi se, Zoti për të qetësuar zemërimin e tij për Adamin dhe për gjenezën e tij, e bëri kurban Jezusin, është një shpifje e qartë e bërë ndaj Zotit mëshirues, është Michael Servetus (1511-1553), që sipas gjykatës institucionale është djegur i gjallë dhe kështu edhe është vvarë. Mendimet e tij që kanë bërë jehonë janë zhvilluar në Angli nga John Bidle (1615-1662), Samuel Clark (1675-1729), Thomas Emlyn (1663-1741), James Martineau (1805-1900); kurse në Amerikë nga William Ellery Channing (1780-1842). Zhvillime të ngjashme janë realizuar edhe në Poloni nën udhëheqjen e Faustus Socinus (1615-1662), në Hungari nën udhëheqjen e Fracis David (1510-1579).

Unitarianët besojnë se Zoti është një, rregulli i universit vepron sipas parimit të njësisë. Gjithashtu besojnë se të gjithë njerëzit simbolikisht llogariten fëmijë të Zotit. Kundërshtojnë doktrinën e trinitetit të kishave të tjera. Besojnë se Jezusi është i biri i Josefrit marangoz dhe i Marias, kurse “lindjen e tij mbinatyrore” nuk e pranojnë. Besojnë se, Zoti çdo herë, për t’ua mësuar njerëzve të vërtetën ka dërguar profetë dhe se edhe Jezusi është një hallkë e rëndësishme e këtij vargu të profetëve. Doktrinën e mëkatit origjinal nuk e pranojnë, ndërkaq një gjë të tillë e llogaritin si shpifje për Zotin. Kurse Shpirtin e Shenjtë e komentojnë si një mjet inspirimi, të cilin Zoti e ka vendosur në thellësi të shpirtit të njeriut. Gjithashtu edhe besimet për botën e ardhshme nuk janë të qarta. Theksojnë se ungjijtë përbëjnë themelin e sistemeve. Adhurimet kolektive i shohin si sjellje pozitive për vetëdijësimin e individit. Me gjithë pranimin e pagëzimit dhe të kungimit, ata pagëzimin e komentojnë si një falënderim Zotit për dhurimin e fëmijës, kurse kungimin si një “ceremoni që përkujton mesazhet e Jezusit dhe që zhvillon jetën fetare dhe etike të njerëzve.

Lëvizjet reformiste kanë lindur si reagim ndaj besimit të kishës në trinitet. Ato janë ndarë në grupe të ndryshme, si në kisha unitariane angleze, gjermane dhe në amerikane. Besimet e përbashkëta janë: mohimi i trinitetit dhe besimi në njësinë e Zotit. Racionalizmin e kanë nxjerrë përpara dogmatizmit. Komentimeve të kishës nuk u japin rëndësi, por rëndësi i japin Jezusit historik dhe jetës së tij. Besojnë se Jezusi është një njeri dhe profet i Zotit. Mes tyre ka dallime në adhurim. Supozohet se ka afër një milionë unitarianë të përhapur nëpër shtete të ndryshme. Më tepër janë në Amerikë dhe në Angli.⁴⁸⁰

b. Lorberianët

Themeluesi është Jakob Lorber (1801-1864). Komuniteti ka lindur në Gjermani. Lorber pretendon se ka marrë shpallje prej Zotit dhe këtë e quan “qehjallëk dhe përfaqësim të Zotit”. Ai pretendonte se deri në vdekje i ka ardhur shpallje. Shpalljen apo mendimet e tij i ka të shënuara në shkrimet e tij, prej të cilave është formuar edhe përmbledhja me shkrimet e shenjta prej 25 vëllimeve. Kurse jetën e ka siguruar nga mësimet e muzikës dhe të violinës. Ai ka vdekur si i gjerë dhe beqar në Graz më 1864.

Lorber ka thënë se, zërat që i ka dëgjuar dhe shpalljen që e ka pranuar, i kanë ardhur nga Jezu Krishti. Titulli i vëllimit 10-të të përmbledhjes së tij është “Grafe Evangelium Johannis”, ku përshkruhet jeta e Jezusit. Në brendinë e saj haset në imtësi të ndryshme nga ajo që është në ungjijtë. Aty zënë vend edhe temat pas vdekjes dhe temat për natyrën. Këtë përmbledhje e kanë botuar shokët pas vdekjes së tij.

Sipas Lorberit, Jezusi është “njeri” i plotë. Pretendimet e kishave të tjera për hyjninë e Jezusit janë të pavërteta. Jezusi me vlerën e tij ka arritur në “dritën hyjnore”. Anëtarët e këtij fraksioni janë një komunitet jozyrtar. Ata nuk e pranojnë trinitetin. Anëtarët e këtij komuniteti edhe pse janë anëtarë të

⁴⁸⁰ Reller, f. 428-440.

kishave të tjera, ata përsëri grumbullohen për rreth veprave të Lorberit. Supozohet se në botë kanë afër 45.000 anëtarë.⁴⁸¹

c. Apostolizmi i Jezu Krishtit

Kjo lëvizje, me qëllim që të ringjallë shpirtin apostolik të krishterimit, ka lindur më 1902. Udhëheqësi i komunitetit ishte Apostol Ephraim (v. 1923). Thuhet se ithtarët e kësaj lëvizjeje bazohen në shkrimet e shenjta dhe në mendimet apostolike. Gjithashtu thonë se feja nuk është për t'u kuptuar, por për t'u ndier. Tezën se Jezusi është “Bir i Zotit” nuk e pranojnë. Nuk kanë lidhje me unionin e kishave botërore. Shumica e simpatizuesve jetojnë në Gjermani.⁴⁸²

19. Lëvizja mesianike në Afrikë

Me anë të zhvillimeve në Afrikën e sotme, shndërrimi i sundimeve të vjetra kolonizuese në shtete të pavarura, me vete solli ndryshime të shumta edhe në aspektin fetar. Aktivitetet misionerike perëndimore, që kanë filluar në shek. XVI., janë bartur edhe në Afrikë dhe kështu janë mugulluar fraksione të ndryshme krishtere. Në këtë rajon ekziston edhe feja islame, e cila më herët është përhapur me anë të tregtarëve.

Sot shihet se, krahas ringjalljes së mbeturinave primitive fetare afrikane parakrishtere, janë futur në lëvizje edhe ndjenjat politike-nacionale dhe reagimet kundër kolonizimit. Gjatë kësaj kohe në fiset dhe shoqëritë afrikane shihet edhe lëvizja “Mesia i zi”, si themelues i fesë dhe bartës i shpalljes. Shumica e fraksioneve të reja janë formuar me shkatërrimin e komuniteteve misionerike të të bardhëve. Sa janë afër kolonializuesit dhe kishat misionerike aq janë të forta edhe ndjenjat ndarëse mes tyre. Shkëputjet e para fraksionale kanë filluar më 1872, në kishën misionerike në Paris. Këtu rol të madh kanë luajtur ndjenjat racore.⁴⁸³

a. Kisha Baptiste Nazareth

Nazareth Baptist Church (Kisha Baptiste Nazareth), që është themeluar nga Isaiah Shembe më 1911, është një nga fraksionet më me ndikim në Afrikë. Shembe është anëtar i familjes Natal të fisit Zulu, kurse këtë fraksion e themeloi në Oranzhe-rajon i pavarur më 1870. Shembe as ka shkuar në shkollë e as ka ditur të flasë anglisht. Më vonë kur oqeanit veproi si shërues i sëmundjeve dhe si nxjerrës i xhinnëve.⁴⁸⁴

Shembe, qysh si fëmijë dëgjonte zëra nga bota e fshehtë. Gjatë një furtune nëpërmjet vetëtimës i kanë ardhur predikime (fjalë të shpallura). Atij i thuhej “lëre pamoralësinë”! Kurse më vonë filloi që nëpërmjet vetëtimës të shohë vizione. Ai në tokë pa një njeri të shtrirë ose një grumbull engjëjsh. E pa trupin e tij duke u shkatërruar dhe duke folur. Në vizionin e tij fjala “lëre pamoralësinë” i dedikoej vetë atij. Ai filloi shërimin e të sëmurëve me fjalën “Jehovai më shpalli se shërimi nuk bëhet me barna, por, me fjalë”. Isaiah Shembe ligjëroi, i shëroi të sëmurët, i largoi xhinnët. Komuniteti i tij në vend të ditës së diel, të shenjtë e llogaritë të shtunën. Shembe, krahas aftësive shpirtërore, kishte aftësi për organizim, për poezi dhe për muzikë. Ka kompozuar mbi dyqind vjersha. Këto ishin shprehja e doktrinës dhe e dërgueshmërisë në gjuhën zulu. Ai nuk i ka dhënë vetes pasuri, por vazhdoi të jetojë në një kasollë të thjeshtë, si në të kaluarën. Pas Shembes, sipas porosisë së tij, udhëheqës i komunitetit u bë

⁴⁸¹ Reller, f. 170-182.

⁴⁸² Reller, f. 250-272.

⁴⁸³ Benz, f. 143.

⁴⁸⁴ Benz, f. 144.

djali i dytë Johannes Galilee Shembe, i lindur më 1904.⁴⁸⁵

Johannes u bë një mësues me edukim të mirë dhe me studime universitare dhe kështu u punësua në një lice. Ai, duke u inspiruar prej shkrimeve të babait e vazhdoi detyrën e të atit. Afrikanët pasi nuk gjetën atë që pritnin nga Mesia i bardhë, u kthyen nga Mesia i zi. Në jetën e përditshme të tij, njerëzit kanë parë rrugën e shpëtimit. Sipas komunitetit Nazareth, Shembe ishte Mesia i pritur. Çelësat e qiellit ishin tek ai. Ai ishte çelësi dhe pronari i derës së shpëtimit. Ai bashkë me besimtarët e sinqertë duhej ta hapte atë derë.⁴⁸⁶

b. Kisha Jezu Krishti

Sipas kishës së Jezu Krishtit, e cila është formuar nga Simon Kimbangu më 1921, profeti Kimbangu pas 30 vjetëve në burg ka vdekur më 1951. Besohet se ai është ringjallur dhe qëndron pranë Zotit. Ai vazhdon të jetojë në shpirtërat e besimtarëve, kurse në të ardhmen do të vijë me trup.⁴⁸⁷

Mesiati afrikanë krahas profetizmit dhe misionit fetar, kanë bërë edhe shërime. Sidomos, besohet se ata i kanë nxjerrur edhe xhinnët prej trupit të njerëzve. Ata e kanë ndaluar gjithashtu edhe përdorimin e barnave të të bardhëve dhe shërimin nga mjekë të racës së bardhë. Kjo ishte edhe njëri prej kushteve për pranim në komunitetin e Isaiah Shembesë. Komuniteti Nazareth, vaksinimin nuk e ka llogaritur si ilaç, përdorimin e saj e kanë filluar pas vitit 1944. Në ceremoninë e shërimit rol të rëndësishëm luajnë ujërat e burimeve dhe banjot. Në traditën zulu ëndërra dhe vizioni llogariten shpallje, gjegjësisht mesazhe të engjëjve dhe të shpirtit të shenjtë. Drita, teshat e shndritshme, lumi dhe uji që shihen në ëndërr llogariten mesazhe shpirtërore. Dëshira më e madhe e besimtarëve është që Jezusin dhe Zotin ta shohin ëndërr me tesha të shndritshme. Martesa me shumë gra, në masë të kufizuar, është e lirë. Në adhurime vend të rëndësishëm zënë këngët, këngët fetare dhe vallëzimet. Vallëzimi, edhe pse sipas të bardhëve llogaritet idhujtari, sipas të zinjve është një nevojë e pashmangshme. Burrat dhe gratë mes grupeve të moshës dhe gjinisë, me veshje tradicionale nacionale vallëzojnë. Sipas komunitetit Simon, ilaçi, duhani, alkooli, kafeja dhe mishi i dërrit janë të ndaluara.⁴⁸⁸

⁴⁸⁵ Benz, f. 145.

⁴⁸⁶ Benz, f. 146 dhe në vazhdim.

⁴⁸⁷ Benz, f. 148.

⁴⁸⁸ Benz, f. 151-156.

FRAKSIONET FETARE-FILOZOFIKE

Këto fraksione, edhe pse nuk kanë lidhje direkte me krishterimin, janë sintezë e krishterimit dhe filozofisë lindore ose janë lindur dhe janë zhvilluar në shtetet perëndimore ku të krishterët janë me shumicë:

1. Fraksioni theosophie

Parimi kryesor i këtij komuniteti është se, “asnjë fe realisht nuk është më e lartë se tjetra”. Ky komunitet është themeluar në New York më 1875. Themeluesi i saj është një grua e quajtur Helena Petrovna Blavatsky (1831-1891). Blavatsky, që ka bërë shumë udhëtime në Europë dhe në Amerikë, ka organizuar konferenca për eksperiencën spiritualiste. Qendra e komunitetit më 1879 është bartur në Indi, kështu që Blavatsky është futur në budizëm. Në Tëbet ka lidhur marrëdhënie me Mahatma-në, kurse mendimet e veta i ka shprehur në librat si “Doktrina e fshehtë”, “Kosmogenis”, “Anthrogenesis” dhe “Ezoterik”. Në vitin 1897 ka themeluar komunitetin “Vëllazëria ndërnacionale teozofike”.

Sipas besimit të saj, teozofia është qëllimi, fruti, thelbi dhe ekzistenca e të gjitha feve. Me anë të teozofisë “*e tërë bota do të bëhet kishë e Zotit*”. Shpëtimi gjendet në vetë brendinë e njeiut. Çdo krijesë e dukshme është një simbol i ekzistencës absolute, e cila është trupëzuar në botën fizike, është pra trupëzimi i mendimit. Ekzistimi i njeiut është fryti i karmasë më të hershme. Bartësi dhe depoja e karmasë është personaliteti i vetë njeiut. Njeriu deri sa, me anë të revolucionit të bëhet Zot, do të vazhdojë të shëtisë në rrethin e reinkarnacionit. Teozofistët e pranojnë teorinë e emanacionit të neoplatonistëve, si dhe mendimet për teorinë karma dhe për reinkarnacion të feve indiane. Thonë se qëllimi dhe shpëtimi i njeiut është zhveshja e njeiut nga materia dhe arritja në një gjendje të pastër shpirtërore. Numri i saktë i anëtarëve të komunitetit të përhapur nëpër Europë dhe Amerikë, nuk dihet.⁴⁸⁹ Kulte të posaçme nuk kanë. Adhurimet e tyre janë realizimi me karakter fetar i ceremonive, si përkujtimi i Blavatskyt, fotografia, muzika etj. Mendimi i përbashkët ka një rol të rëndësishëm.

2. Anthroposophie

Ky komunitet është themeluar më 1913. Themelimi dhe historia e tij ka lidhje të ngushta me Rudolf Steinerin (1861-1925). Besohet se njerëzimin do ta shndrit ditura e njeiut për veten e tij, e cila është e marrë nga bota mbinatyrore dhe jashtë ndjenjave. Qëndrojnë larg studimit të temës për ekzistimin e shpirtit. Mbrojnë mendimin se është më mirë që konceptet shpirtërore të kuptohen me anë të meditimit. Meditacionit i japin rëndësi të veçantë. Ata mendojnë se me kthim nga bota shpirtërore arrihet në botën e ndjenjave dhe në inspirim; mund të kuptohet marrëdhënia mes lindjes dhe vdekjes dhe me kosmologjinë; besojnë se inspirimi është shkrimi i palexueshëm e Zotit. Sipas Steinerit magjitë janë nga një libër parashikimesh dhe besimtarët i çojnë drejt Mesias. Shkrimtarët e ungjijve posedojnë urtësinë. Gjoni Jezusin e përshkruan njeri kosmik; Marku, botë ndjenjash; Mateu, botë e të menduarit. Poashtu temat e besimit dhe të adhurimit në krishterim mundohen t'i shpjegojnë me anë të metodës

⁴⁸⁹ Reller, f. 491-505.

teozofike. Ata thonë se në shpirtin e Jezusit është manifestuar Zaratustra dhe Buda. Për komunitetin e ri nuk ka nevojë për anëtarët e fraksionit që të dalin prej fesë ose fraksionit të mëparshëm. Për këtë ithtarët e kësaj rryme jetojnë të ndarë në fe të ndryshme. Marrëdhëniet mes tyre i vazhdojnë me anë të anëtarësimit në shoqatë. Supozohet se në Gjermani kanë 20.000 anëtarë.⁴⁹⁰

3. Fraksioni Rocy Cross

Është një lëvizje mistere dhe e hapur për mendime simbolike dhe mistike. Daton që nga shek. XVI dhe XVII. Në besimin e këtij fraksioni, rol të rëndësishëm luajnë filozofitë, si ajo e alkimisë, kabbalasë dhe e Paracelsusit (1493-1541). Në këtë fraksion, ndihma e mistikëve dhe e teozofëve është e madhe. Ata theks të veçantë vënë mbi atë se Zoti mund të njihet ma anë të shenjave hyjnore. Ndërkaq shkencat skolastike nuk i pranojnë. Ata kërkojnë një sintezë mes filozofisë dhe teologjisë, mes besimit dhe diturisë. Gjatë zhvillimit historik komuniteti është ndarë në ekole të reja. Shkollën më të vjetër të tyre në Europë e përbëjnë masonët, kurse si lëvizje të reja numërohen:

a. *Antiquus Mysticus ordo rosae crucis*; ky fraksion është themeluar në New York më 1916 nga gazetari dhe psikologu H. Spencer Lewis (1883-1936), e më vonë është përhapur edhe në Europë.

b. *Komuniteti Heindel Rosenkreuzer*; është themeluar në Gjermani nga Max Heindel (1865-1919). Komuniteti, pas Luftës së Dytë Botërore, nga ana e Georg Vollmer (v. 1971), është ringjallur përsëri në Darmstadt.

c. *Lectorium Rosicrucianum*; është themeluar nga Jan van Rijckenborgh. Qendra e kësaj lëvizjeje, që prej vitit 1936 është në Harlem, por ka përfaqësues edhe në Europë.

Ithtarët e këtij fraksioni e përdorin shumë shprehjen “transfiguration” (ndryshim). Ata kanë për qëllim që qenien njerëzore ta ndryshojnë me besim, sjellje dhe shenjtërim. Besojnë se fuqia hyjnore gjendet tek njeriu por, ajo duhet të zgjohet dhe të aktivizohet. Thonë se vetë njeriu është qëllimi i hyrjes në botën hyjnore, në botën e ndjenjave. Ata aspirojnë që me anë të veprimeve të shenjtërimit të shpëtojnë dhe të pastrohen prej pjesëve shtazarake, që me anë të diturisë dhe të meditimit të arrijnë fuqinë hyjnore dhe të bashkohen me të. Besojnë se njeriu duke kaluar nëpër fazat shpirtërore mund të bëhet zot. Edhe Jezu Krishtin e vlerësojnë në këtë aspekt. Ekzistencën e tyre e vazhdojnë në fraksione të ndryshme krishtere. Kanë për qëllim edukimin e anëtarëve të kurseve dhe të shkollave private. Në vende të ndryshme në Amerikë dhe në Europë kanë shoqata dhe qendra misionerike.⁴⁹¹

4. Spiraleja e gjithësisë

Ky fraksion është themeluar në qytetin Linz të Austrisë më 1963, me emrin *Welt Spirale* (komuniteti etik për ripërtëritje dhe zhvillim të gjithësisë). Themeluesi i saj, Leopold Brandstatter (1915-1968), kishte një mendim sintetik të formuar prej feve të ndryshme. Sipas tij, të gjitha krijesat në gjithësi, të cilat dallojnë edhe në pamje, kanë burim hyjnor dhe rrënjë të njëjtë. Dallimi dhe nduarnduarshmëria mes tyre si krijesa është vetëm një mashtrim. Niveli më i lartë i krijesave duke u nisur nga ato që janë të përbëra prej substancave të bukura e deri te ato më të thjeshtat, është i botës hyjnore, gjegjësisht i botës shpirtërore. Gjithësia dhe njeriu përbëhen prej shtatë shtresave. Në unin e njeriut, përveç materies ka edhe edhe materie të bukur dhe gjithashtu ka edhe parime. Kurse shkëndijat hyjnore i posedon vetëm njeriu. Asimiluesi kryesor i tërë jetës dhe i karmasë është njeriu. Në sajë të karmasë dhe të reinkarnacionit, në njeriun bëhen zhvillime.

Në gjithësi ka një strukturë spirale, ku lëvizin krijimi dhe shkatërrimi. Jeta, që del prej lart poshtë, përsëri ndahet në nënpjesë. Zhduket drejt brendësisë së materies dhe arrin në pamje shumë mashtruese.

⁴⁹⁰ Reller, f. 506-533.

⁴⁹¹ Reller, f. 534-556.

Logosi i universit është Zoti që mësoi Moisiun dhe Jezusin. Logosi i Venusit është nëna e gjithësisë. Në realitet edhe Zoti është një njeri. Për të qenë logosi i diellit dhe i rruga e qumështit, njeriu duhet të zhvillojë përsoshmërinë e tij.

Për të arritur në shkallët e larta të vetëdijes, njeriu ka nevojë për udhëheqjen e një mësuesi, dhe ky mësues në Tibet është Sambala. Ata jetojnë dhe detyrat e tyre i kryejnë me inkarnacion. Këto janë të manifestuara në Krishta, Buda, Jezusa, Muhammeda, Konfuça, Laotzea, Zaratustra, Pitagora, Platona, Sulejmana, Origenesa dhe në Jakobë Bohmena. Prej shkallëve shpirtërore “shkalla buda” është shkalla e tetë, më e lartë se shkalla e shtatë. Sot Sambala është mësuesi Morja.

Këta nuk kanë besim në Zotin sikur që është në islam dhe në hebraizëm. Anëtarët e komunitetit janë përhapur në Europën perëndimore dhe të Mesme. Komuniteti nuk ka ndonjë formë të posaçme adhurimi. Ata vazhdojnë të jetojnë në fe dhe në fraksione të ndryshme.⁴⁹²

5. Spiritizmi

Burimet e besimit në ekzistimin dhe në manifestimin e shpirtit mbështetet thellë në të kaluarën. Ky besim gjendet pothuajse në çdo fe. Konceptet e lidhjes me shpirtin si jeta pas vdekjes, bota e ardhshme, bota shpirtërore etj., u japin një pasuri feve. Vetëm se, kthimi i shkencës në racionalizëm dhe i njeriut në ekzistimin e elementeve, e zhvilloi dëshirën që edhe termit shpirt t'i kërkohet një bazë logjike, mendore, praktike. Shfrytëzimi i metodave shkencore natyrore, e lindi dëshirën që studimit të termit shpirt t'i vënë disa rregulla. Kështu që, spiritizmi është një prodhim i laicizmit dhe i zhvillimit modern në mendimin dhe besimin e njeriut. Në njërin anë është një protestë kundër shekullarizimit dhe materializimit, kurse në anën tjetër është hulumtim që mendimi botëror të bëhet element i pranueshëm dhe me anë të metodës për të treguar model, të bëhet i pranueshëm dhe i fortë.

Në librin e Ludwing Feuerbachut me titull “Përhapja e krishterimit”, i botuar më 1848, thuhet: “Ai që beson në botën e ardhshme e humb këtë jetë dhe vlerën e saj. Ose humb edhe më shumë se kjo. Besimi në jetën qiellore është besimi në jovlerën dhe në mosekzistimin e besimit”. Gjithashtu edhe Karl Marx më 1848 ka thënë: “Mohimi i botës së ardhshme do të thotë pranim i kësaj bote. Përgënjeshtrimi i një jete më të mirë në botën e ardhshme është ripërtëritje e plotë e jetës së kësaj bote dhe varësi nga një propozim më i mirë”. Edhe deklarimi armiqësor i mendimit botëror i Feuerbachut ndaj besimit në botën e ardhshme, ka hapur rrugën për lindjen e spiritizmit. Ngjarja përveç se si një teori ka filluar edhe si një fenomen. Dy vajzat e vogla të një çifti metodist John Fox, i cili ka qëndruar në Hydesvilli në afërsi të Rochesterit në ShBA, Leah (10 vjeçare) dhe Kate (12 vjeçare), natën në shtëpinë e tyre dëgjojnë një gogol, trokitje të derës, trokitje në mur etj. Për të bërë të njohur ngjarjen formohet një organ intelektualësh të Rochesterit. Fëmijët me këtë “shpirt që bën zhurmë” në formë loje lidhin kontakte të suksesshme. Me shndërrimin e zërave të kërcitjeve në alfabet, mundësohet kontakti me shpirtin. Shpirti që jeton në shtëpinë e Fox-ëve thotë se, më herët ai ka jetuar si tregtar, pastaj është vrarë dhe është varrosur në bodrum. Kur gërmohet në bodrum gjendet një skelet. Më pastaj Andrew Jackson Davis (1929-1910), boton një libër me titull “*The Philosophy of Spiritual Intercourse*”. Autori, në këtë libër është përqendruar mbi lajmet që vijnë nga bota e shpirtërave dhe mbi teknikën e komunikimit me ta. Supozohet se numri i atyre të cilët metodat si, kapja e masës, shkrimi automatik, trans i thellë etj., i besojnë dhe janë të interesuar për spiritizëm, në vitin 1885 ka arritur në dy milionë. Kjo lëvizje, e cila ka lindur në Amerikë, ka filluar të ketë simpatizues edhe në Europë. Më 1882 në Angli është themeluar “*Society for Psychical Research*” dhe në mesin e tyre kanë marrë pjesë kimistë, fizikantë, psikologë. Këtë komunitet e kanë ndjekur edhe komunitetet e tjera të themeluara në shtete të ndryshme. Janë formuar shoqëri hulumtuese dhe është botuar një literaturë e shumtë. Supozohet se, në vitin 1960 numri i anëtarëve ka arritur mbi 100 milionë.

Spiritistët bëjnë një aktivitet shumëdimensional. Në tubimet që kanë bërë me anë të medimeve, mundohen të flasin me të afërmit e tyre të vdekur dhe me shpirtërat e botës tjetër. Kështu që,

⁴⁹² Reller, f. 557-573.

mundohen të fitojnë njohuri për botën tjetër dhe për kaderin e tyre. Bëjnë mjekime shpirtërore dhe udhëheqin në shërim. Mundohen që, me anë të fuqive që japin shërim të ndikojnë te i sëmuri. Në disa raste bëjnë disa operime pa gjak. Bëjnë shërime prej së largu. Disa mendime thonë se, ata kanë bërë udhëtime astrale (qiellore) dhe se kanë vizituar vende shumë të largëta. Sa që ka edhe të atillë që pretendojnë se kanë shkuar në botën tjetër dhe kanë biseduar atje me njerëz.

Vetëm se, është e pamundur që në spiritizëm të bisedohet për një mendim dhe besim të përbashkët. Në ndikimin e feve të ndryshme dhe besimeve popullore është hapur një diapazon i gjerë përfytyrimi. Ka dallime në mesin e rrymave në shtetet e krishtera dhe të rrymave në vendet e tjera. Për këtë nuk bisedohet për një spiritualizëm, por për rryma të ndryshme spiritualiste:

Duhet dalluar spiritizmi nga “spiritualizmi”. Në gjermanisht me fjalën “spiritizëm” kuptohet studimi empirik-sistematik për botën tjetër. Temë kryesore është studimi se, a thua jeta pas vdekjes vazhdon apo jo. Për këtë qëllim thirret ose vëzhgohet parafenomeni dhe kontrollohet burimi dhe vërtetësia. Spiritizmi pretendon se për këtë qëllim punon shkencërisht. I vdekuri, me anë të mediumit mundohet të mësojnë përvojën e vdekjes dhe jetën në këtë botë.

Kurse spiritualizëm, është një mendim i universit i ndërtuar mbi aftësitë për studim të botës tjetër. Dituritë grumbullohen prej lajmeve të shpirtërave. Mbetet i varur prej eksperiencës së mediumit. Spiritualizmi tregon ligje për universin dhe për botën ezoterike të njeriut. Mundohet të kuptojë ekzistimi e Zotit.

Sipas spiritizmit bota materiale është një pjesë e vogël e një realiteti të madh. “Materia e mirë” mund të krahasohet me magnetizmin, që është një fuqi e fshehtë e universit. Spiritualizmi i sotëm shpesh i përdor termat e fizikës atomike. Ai përbëhet prej një substance që buron si drita. I tërë universi buron prej tij. Universi është “materie e trashë, e bymyer”, dritë e dendur, pjesët më të vogla të tij janë pjesë të atomit. Kurse bota me materie të bukur quhet astral ose botë eter. Ndërkaq njeriu përbëhet prej tre pjesëve: trupi fizik, trupi astral dhe shpirti. Trupi astral është një shok i sinqertë i trupit fizik. Specifikat e të dëgjuarit dhe të shijuarit janë të këtij lloji. Po ashtu ka edhe një pjesë që nuk sëmuret, nuk plakët dhe nuk vdes, e kjo është jashtë botës fizike. Ky është një vend i posaçëm për shpirtërat. Kjo është një substancë që nuk ndryshon, nuk priset dhe është një jetë e pafund. Këta shpirtëra janë të krijuar nga ana e Zotit. Jeta botërore në rrugën e përsosmërisë së shpirtërave është një stacion. Në këtë pikë koncepti i inkarnacionit të shpirtit futet brenda temës. Edhe me doktrinën karma shpjegohet vazhdueshmëria. Kurse vdekja në skenën botërore është kalim prej një bote në tjetrën.

Bota astrale u ngjanë pejsazheve në këtë botë si, kodrave, fushave, ujërave, drujve, luleve, qyteteve etj. Por atje ka edhe një ferr dhe një zjarr, ujë, baltë, errësirë, dhunë. Vetëm se, kjo nuk është e përhershme. Dënimi është i përkohshëm. Kurse bota shpirtërore është një vend ku gjendet çdo lloj i bukurisë. Bukuritë e kësaj bote vazhdojnë edhe atje.

Spiritizmi definitivisht e mohon materializmin dhe ideologjitë materialiste. Kurse fetë i vlerëson dhe i komenton në bazë të parimeve të tyre. Në këtë drejtim janë formuar organizata dhe grupe që përfaqësojnë “spiritizmin krishter”. Kurse mendimet e kishave tradicionale janë të mbyllura ndaj spiritistëve. Këto nuk përqendrohen shumë mbi Biblën. Shpirti i Shenjtë nuk është pjesë e Hyjit, sikur që e pranon kisha, por një anëtar i botës shpirtërore. Edhe shteti hyjnor në krishterim konceptohet si “bota shpirtërore e Zotit”. Ceremonitë e pagëzimit dhe të kungimit komentohej si hyrje në udhëheqjen e shpirtit.

Spiritistët, edhe pse kritikojnë fetë e tyre, ata nuk i braktisin ato. Ata preferojnë komentim sipas bindjes së tyre. Edhe pse kanë shumë anëtarë, është shumë i vështirë përcaktimi i numrit të simpatizuesve.⁴⁹³

6. Ufologjia, fraksioni Anijet Kozmike

Literatura: Ernst Benz, *Neue Religionen*, Stuttgart, 1971, f. 112-124.

Fraksioni ufologjia është prej feve më të reja që më së tepërmi kërkon të kihet kujdes. Temë e

⁴⁹³ Reller, f. 574-590.

doktrinës dhe e pritjes për udhëzim janë ufot. Ithtarët e fraksionit veten e quajnë “planetarienë”. Ufo është shkurtesa e fjalës Unkown Flying Object, që ka kuptimin, objekt i panjohur fluturues.

Krijesat që jetojnë në yje vlerësohen si mjete dhe si anije kozmike, që me fluturimin e tyre mes planetave, i afrohen botës sonë. Fraksionin e përbëjnë komunitete që përhapen dukshëm në Amerikë dhe në Europë. Nëpër gazeta dhe revista të ndryshme për të janë përhapur lajme të shumta. Rrënjët e kësaj rryme shkojnë deri në shek. XVI. dhe kjo gjithashtu zhvillohet me filozofitë e reja natyrore.

Kjo mbështetet në konceptet e shumë studiuesve natyrorë dhe të teologëve, sipas të cilëve në yje gjenden krijesa që në aspektin shpirtëror dhe shkencor janë më larta se ato të botës sonë. Prijatari i këtij mendimi është kryetari i pietistëve gjermanë, Friedrich Christoph Oetinger. Ky, për herë të parë, e ka bashkuar filozofinë natyrore moderne me kosmologjinë, me pritjen e Kohës së Fundit dhe me pritjen krishtere për Botën e Ardhshme. Shkrimet që janë botuar deri më tash kanë zgjuar një jehonë të madhe, kanë ndikuar shumë në filozofinë teologjike dhe në pietizëm. Ka ndihmuar astronomët për zhvillimin e mendimeve të tyre për “banorët e planetave”.⁴⁹⁴ Ai që çështjen e ka zbritur në nivelin e popullit është Fontelle. Ai, duke i përdorur dituritë e astronomisë së asaj kohe, ka formuar mendim për strukturën trupore dhe shpirtërore të banorëve të yjeve. Ai ka përfytyruar se ata, përveç që kanë aftësi më të mëdha se ne, na ngajnë ne dhe nuk i ngajnë ndonjë krijese tjetër përpos njeriut.⁴⁹⁵ Këto tema janë bërë bazë për romanet që ai i ka shkruar në periudhat e mëvonshme.

Më 1938 në Amerikë realizimi i një loje teatrale me titull “invadimi i egjiptasve”, u bë aq bindës sa popullin e zuri paniku dhe disa u munduan të bëjnë vetëvrasje. Zhvillimi i teknikës kozmike u hapi rrugë shumë brengave shpirtërore. Në vitin 1947 një pilot amator ka pretenduar se ka parë një flotë jashtëtokësorësh. Edhe gazetat i shtuan lajmet për fluturimin e këtyre apo trupave të ngjashëm. Për këtë Forcat Ajrore Amerikane, formuan një komision hulumtues dhe u detyruan që ta qartësonin çështjen. Shpjeguan se trupat qiellorë që shihen janë mjete të përdorura në eksperimente të bëra për studime kozmike amerikane. Edhe pse spekulacionet u zvogëluan, besimtarët nuk mundi t’i bindë. Në vitin 1952 një major marinar pensionist, Donald E. Keyhoe me librin e tij “Flying Saucers from Outer Space”, u bë shkak për një shok të ri. Një tjetër me emrin George Adamski, u bë kryepostulli i besimtarëve. Ufonë dhe konceptet për të i përfshiu në një identitet fetar. Ai pretendoi se ka biseduar me venusianët dhe filloi me predikimet e tij. Në fakt, Adamski, ishte një njeri që punonte në një bufe me alkool dhe ishte një amator, i cili me një teleskop të vogël të vendosur në çati të bufësë, i vëzhgonte yjet. Ai u pranua si profet dhe si pranues i shpalljes. Në komunitetin e formuar nga ata që ishin grumbulluar përreth tij, ishte formuar një atmosferë fetare.⁴⁹⁶

Sipas kësaj, në planin dhe në teknologjinë e disa ndërtesave të mëdha në botë, për shembull, piramidat e Egjiptit, pretendohet se punojnë jashtëtokësorët. Në anën tjetër nxjirret fall se konceptet e bashkuara për kohën do të zhduken me pritjen e Kohës së Fundit, kurse njerëzimi dhe vetë bota do të zhduken me teknologjinë e zhvilluar atomike. Rrugëdalje prej shpërthimeve atomike që priten është formimi i lidhjeve me banorët e yjeve të tjera dhe në kohën e fatkeqësisë me anije kozmike të shkohet në yje ose në planetet e tjera.⁴⁹⁷ Thuhet se, në udhëtimin shpirtëror nëpër planete takohen me persona të ngjashëm me Jezusin. Thuhet që, me rastin e mosrealizimit brenda kohës së caktuar, Zoti mëshiron dhe fatkeqësia prolongohet.⁴⁹⁸ Romanet e autorëve si, Erich von Daniken dhe të ngjashëm, të cilët kanë patur jehonë edhe në Turqi, luajnë një rol të madh në ndikimin në besimin e komunitetit. Në mars të vitit 1997, me rastin e pamjes së yllit me bisht Hale-Bopp në Rancho Santa Fe/Kaliforni 39 persona, duke i marrë me vete teshat e rrugës dhe ushqimet, bënë vetëvrasje kolektive. Ata, për të arritur te anijet kozmike, që janë të fshehura pas yllit me bisht, dhe për të arritur në parajsën e themeluar në yje, preferuan të shpëtonin nga trupi i tyre.

⁴⁹⁴ Benz, f. 115.

⁴⁹⁵ Benz, f. 116.

⁴⁹⁶ Benz, f. 118-120.

⁴⁹⁷ Benz, f. 122.

⁴⁹⁸ Benz, f. 122-124.

ISLAMI

Islami, i cili dominon te mbi një miliard e gjysëm njerëz të kohës së sotme, bazohet në besimin në njësinë e Allahut, në nënshtrim Atij përzhemësisht dhe në nënshtrim urdhërave të Tij. Krahas asaj që është i përhapur në tërë botën, dendësia e tij përfshinë një hapësirë prej Indonezisë e deri në oqeanin Atlantik. Si minoritet është përhapur edhe në vende tjera të botës. Themeli i komunitetit të këtyre besimtarëve është vendosur në kohën kur ka jetuar Muhamedi (a.s.).⁴⁹⁹ Edhe organizimi shtetëror është themeluar në kohën e tij.



1. Muhamedi (a.s.)

Muhamedi (a.s.) ka lindur më 570 në qytetin e Mekkes, në gadishullin Arabik dhe është fëmijë i një familje që është anëtare e fisit Kurejsh. Dy muaj para se të lindë i ka vdekur babai i tij, Abdullahu, kurse në moshën gjashtëvjeçare e ka humbur edhe nënën e tij, Eminen. Muhamedin jetim, e mori në mbikqyrje xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Ai pa frikë dhe duke sakrifikuar e mbrojti atë nga kundërshtarët mekkas, edhe pasi Muhamedi u bë peygamber.

Edhe pse për jetën e Pejgamberit (a.s.) para peygamberllëkut, para se ai t'i mbushte 40 vjetë, nuk kemi njohuri të mjaftueshme, dihet fort mirë se ai ishte me moral të fortë dhe shembëlltyrë për të tjerët, dhe se e meritonte titullin "*Muhammedu'l-emin*" (Muhamedi i besueshëm). Dihet edhe ajo se në moshën 25 vjeçare ai u martua me Hatixhen, e cila ishte vejtshë, e pasur dhe shumë më e moshuar se ai. Ai deri në vdekje të Hatixhesë nuk u martua me asnjë grua tjetër. Ndërkaq kur vdes Hatixheja ai i kishte kaluar të 50-tat.

Muhamedi (a.s.), para se t'i vijë peygamberllëku, ishte i shqetësuar nga prishja e etikës sociale në shoqërinë e Mekkes. Në disa raste vetmohej në shpellën Hira në afërsi të Mekkes. Atje kalonte ditë të tëra duke u zhytur në mendime. Kjo përvojë etike dhe e meditimit e përgatiti atë që të pranojë detyrën e peygamberllëkut. Ai propagandimin e fesë e filloi prej familjes dhe më të afërmve të tij. Ai, sidomos u ballafaqua me kundërshtimin e fortë të një grupi minoritar, që kontrollonte jetën në qytet. Kundërshtimi u rrit dhe fajësimet u rënduan. Çdo ditë e më tepër punohej në pengimin e misionit të Pejgamberit. Për shkak të rrezikut për jetë filloi të kërkojë vende më të përshtatshme për detyrën e tij jashtë Mekkes. Ai lidhi marrëdhënie me fise dhe qytete të ndryshme. Sidomos një grup nga Medineja, duke parë në të lartësinë në cilësinë e prijësit dhe të misionit të tij, e pranoi islam. Kështu që kur medinasit kuptuan brengën e Pejgamberit e thirrën të shpërngulet në Medine. Pas vendimit të kujdesshëm dhe të fshehtë Muhamedi (a.s.) në vitin 622 fshehurazi e braktisi Mekken dhe u shpërngul për në Medine. Kjo shpërngulje e Muhamedit (a.s.) quhet "*hixhret*". Në marrjen e këtij vendimi rol të rëndësishëm ka luajtur edhe përgatitja e mekkasve për atentat ndaj Pejgamberit. Kjo ngjarje është llogaritur edhe si fillim i *kalendarit bënor*.

Pasi arrinë në Medine ai pati sukses në krijimin e vëllazërisë së vërtetë mes shpërngulësve mekkasë (*muhaxhirun*) dhe të muslimanëve medinas (*ensar*). Vetëm se, mekkasit i vazhduan qëndrimet e tyre armiqësore ndaj muslimanëve edhe pas hixhretit të Muhamedit (a.s.) Mekkasit me rastin e marrjes së lajmit se karavani i tyre do të sulmohet nga ana e muslimanëve, tubuan një ushtri me mbi 1000 ushtarë

⁴⁹⁹ Alejhi's-Selam (Paqa e Zotit qoft mbi të). (Shënim i përkthyesit).

dhe në vitin 2. hixhri u nisën për në Medinë. Muslimanët për të mbrojtur veten, i pritën në Bedër me 300 ushtarë muslimanë. Kjo fitore që e arritën muslimanët në Bedër ua rriti vlerën te fiset e tyre. Vetëm se, armiqësia e mekkasve nuk përfundoi me këtë luftë. Acarimi vazhdoi edhe në luftërat e tjera, si Uhud dhe Hendek. Në fund, Muhamedi në vitin 8. hixhri (viti 629) e çliroi Mekken, kurse me pastrimin e Qabesë nga idhujt kjo çështje mori fund plotësisht. Edhe pas kësaj Pejgamberi misionin e tij e vazhdoi në Medinë. Vetëm se jeta nuk i premtoi dhe kështu më 8 qershor 632, në moshën 63 vjeçare vdes, duke lënë mbrapa tij një fe universale dhe një libër (Kur'anin).

2. Kur'ani i lartësuar

Kur'ani për muslimanët është një libër që përmban fjalën e Allahut. Ai i është zbritur Muhamedit, të Dërguarit të Allahut, pjesë pjesë për 23 vjetë. Pejgamberi, fjalët hyjnore që i janë shpallur atij, në një rën anë për mbrojtjen e Kur'anit, ata të cilët dinin shkrim lexim të quajtur "*shkruesit e shpalljes*", i ka obliguar me shkrimin e fjalës hyjnore, kurse në anën tjetër për mbrojtjen e tij, ai i ka porositur besimtarët me nxënien përmendësh të Kur'anit. Kur'ani ndahet në 114 kapituj të quajtura "*sure*". Në mesin e sureve, në aspektin e gjatësisë, nuk ka ngjashmëri. Suret që janë zbritur në Mekke janë prej më të shkurtërave. Në aspektin e të shprehurit ato janë majft të thella dhe të forta. Pas shpërnguljes kjo metodë, bashkë me përmbajtjen e nevojshme juridike për administrimin e shtetit të ri, ishte shndërruar në një metodë më të lehtë dhe më të kuptueshme.

Kur'ani para së gjithash është një libër me këshilla dhe parime fetare dhe etike. Vahji i shpallur gjatë intervalit kohor të formimit të shtetit islam në Medinë, përmban në vete edhe shprehje të rëndësishme juridike.

Çështje me rëndësi në këtë rast janë urdhërat e ndryshëm për gratë dhe skllëverit. Gruas i ka siguruar personalitet të plotë, kurse burrin dhe gruan i ka deklaruar si veshje dhe mbrojtës të njëri-tjetrit. Martesa me gra të panumërta është e ndaluar, gjegjësisht në lidhje me këtë çështje janë bërë perkufizime, që mundësojnë avancimin drejt monogamisë. Sistemi i skllavërisë është e reformuar, zhdukja e së cilës është paraqitur si një rrugë virtyti dhe për lirimin e të robëruarve është përgatitur çdo lloj atmosfere juridike dhe etike. "*Lirimi i skllëvërve*" është lavdëruar si një virtytshmëri dhe është punuar në nxitje për të. Vetëm se luftërat dhe robërit e luftës që kanë vazhduar në botë, edhe pse pas një kohe të gjatë, me anë të qëllimit të paraqitur nga ana e Kur'anit janë zhdukur.

Me anë të ajeteve për perkufizime juridike shoqëria është futur në një rregullim juridik universal. Kështu që me propozimin e dënimeve janë paraqitur kufijtë e jetës normale. Për shembull, në rast vrasjeje dënimi më i rëndë është *kisas* (dënimi me vdekje), kurse dënimi më i lehtë është *kompensimi* dhe *falja*. Kurse imtësitë mes këtyre dy poleve i janë lënë në disponim gjykatësve. Ndërkaq peshë më e madhe iu është dhënë dimensioneve etike.

3. Kushtet e besimit

Ajo që kërkohet prej një besimtari musliman është e rezytuar në suren Bakare (2-5) të Kur'ani Kerimit:

"Ky është libër që nuk ka dyshim në të (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata janë të devotshëm. Të cilët besojnë të fshehtë, e kryejnë faljen (namazin) dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë, ata japin (zëqat, sadaka etj.). Dhe ata, të cilët besojnë në atë që t'u shpall ty, dhe në atë që është shpallur para teje dhe që janë të bindur plotësisht për (jetën e ardhshme në) botën tjetër (abiretin). Të tillët janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuar."

a. Besimi në Allahun e Gjithëfuqishëm

Sipas islamit Allahu është i Butë, i Gjithëdijshëm, i Drejtë, i Gjithëfuqishëm, Zoti i botërave. Ai është një Zot i pafillim dhe i pambarim, i cili ka krijuar qiellrat dhe tokën, jetën dhe vdekjen. Ai është që i furnizon të gjitha gjallesat dhe që di çdo gjendje dhe çdo punë në kosmos, qoftë ajo e madhe ose e vogël. Ai është vëzhguesi i njerëzve, mbrojtësi i jetimëve, udhëzuesi i të paudhëve, falësi dhe shpëtuesi i atyre që kanë pësuar disfatë, mëshiruesi i të gjithëve. Ai nuk ka lindë e as është i lindur. Ai është vetëm, nuk ka shok të ngjashëm me të.

Allahu ekzistencën, diturinë dhe fuqinë e Tij e tregon nëpërmjet mrekullive që i realizon në krijesat e Tij dhe me anë të aftësisë që ua ka dhënë atyre. Struktura e njeriut nuk është e përshtatshme që në mënyrë direkte, nëpërmjet pesë shqisave, ta kuptojë Atë. Kështu Musai (a.s.), pasi kërkoi me këmbëngulje që ta shohë Atë, nuk pati mundësi që ta përballojë paraqitjen e Tij për një moment kodrës dhe kështu ra në tokë i alivanosur. Përkundër Dhiatës së Vjetër (Ishaja, 6: 1-5), sipas islamit njeriu nuk ka mundësi që Zotin ta shohë as i zgjuar, as në gjumë e as në ëndërr.

Ai i refuzon të gjitha mundësitë dhe koncepcionet si shndërrimin e Tij në krijesat që i ka krijuar, personifikimin (konkretizimin) e Tij në ato krijesa: idhujt që mund të tregojnë anën konkrete të Tij, avatarën etj. Gjithashtu të papranueshme janë mendimet se melekët, që janë krijesa të Tij, ose xhinnët apo çfarëdo lloji tjetër krijesash, i kanë ndihmuar Atij (Demiurgut) në krijimin, apo kanë ndërhyrë në caktimin dhe veprimet e Allahut. Në Kur'an (Kehf, 51) thuhet: “Unë nuk ua prezentova krijimin e qiejve e të tokës atyre që po i adhuroni e as krijimin e vetë atyre, e as nuk mora ndihmëtarë të humburit”. Kur’ani me këtë shprehje mohon vendimin⁵⁰⁰ “për krijimin e universit nga ana e Jezusit”, të krishterimit të marrur në koncilin e Nikesë.

Gjithashtu islami nuk i pranon mendimet, sikur që i konceptojnë politeistët se Zoti, i cili është i personifikuar në çfarëdo lloji pamjeje fizike, mund të posedojë një apo më tepër gra, se me to mund ketë djem dhe vajza, gjegjësisht, ose në çfarëdo forme që të paraqiten, qoftë si zotëra të nivelit më të lartë apo si krijesa hyjnore. I mohon të gjitha konceptet e kohës së sotme ose në histori, si metempsikozën, inkarnacionin, avataranë etj. Këto lloje koncepcionesh i pranon vetëm si politeizëm. Nuk pranon që krijesave fizike dhe metafizike, si melekëve, t’u përshkruhet hyjniteti.

Nuk pranon se Allahu, për të lidhur marrëdhënie me njerëzit apo me krijesat të tjera, apo për të mbrojtur prodhimin e tij nga shërr i krijesave tjera, e ka fshehur vetveten e Tij prej krijesave. Po ashtu, mohon paraqitjen e Tij në çfarëdo lloji të krijesave dhe avatarën (inkarnacionin). Kjo vlerësohet si mangësi apo dobësi që i vishet Zotit.

Cilësitë e Zotit manifestohen edhe në krijesat e Tij, vetëm se ajo cilësi apo specifike, nuk është vetë Ai, e as një pjesë e Tij. Për këtë muslimanët nuk e pranojnë konceptin e inkarnacionit dhe të avatara-së, sikurse është në krishterim dhe hinduizëm.⁵⁰¹ Ai me fjalën dhe me mendimin e Tij krijon çdo gjë. Vetëm se, nuk është vetë krijesa apo një pjesë e saj. Për këtë koncepti për birin hyjnor dhe për krijesën hyjnore, që janë pafillim dhe pambarim, nuk i pranojnë. Për shembull, përmbajtja dhe fjalët e Kur’anit janë fjalë të Zotit. Por nuk janë as Zot e as pjesë e Zotit. Sikur që ngjarjet dhe krijesat natyrore janë manifestim i krijimtarisë së Tij, ashtu edhe fjala e Tij është manifestim i cilësisë fjalë, por nuk është Zot. Megjithatë, sikurse pretendojnë disa grupe krishtere, edhe mendimi hyjnorë i *logos*it (fjalës hyjnore) vlerësohet si besim i gabuar.

Edhe konceptet, se Zoti (*ishvara*) është shumë larg, dhe se për t’i dëgjuar krijesat ka nevojë për krijesa hyjnore ndërmjetësuese, gjegjësisht për krijesa hyjnore, si në hinduizëm dhe në sisteme të ngjashme janë të papranueshme. Sipas islamit, Zoti është më afër njeriut edhe se vetvetja e tij, sa që Ai ka njohuri edhe për gjethin dhe thotë se, ai (gjethi) që bie nga druri, nuk bie pa lejen e Zotit. Kështu që Zoti për t’i dëgjuar krijesat nuk ka nevojë për asnjë ndërmjetësues. Asnjë ekzistencë tjetër përveç Zotit nuk posedon ndonjë specifike hyjnore. Çdo gjë jashtë Tij është krijesë e Tij.

Nuk e pranon edhe mendimin e panteizmit, se Zoti është përhapur në tërë natyrën, gjegjësisht gjendet i shtrirë në vetë gjësendin. Sipas islamit, fuqia hyjnore çdoherë dhe në çdo vend është prezente. Të gjitha krijesat, të gjalla ose jo të gjalla, u nënshtrohen ligjeve natyrore, programeve, urdhërave të

⁵⁰⁰ Adam, v. 1, f. 224.

⁵⁰¹ Kur’an, *Zuhruf*, 15.

vendosura ose të dhëna krijesës në krijimin e saj. Kurse Zoti vetë nuk është natyrë apo pjesë e ndonjë gjëje, krijese apo e ligjeve të natyrës. Ai është i pavarur nga sendet dhe krijesat e Tij.

Islami nuk pranon edhe besimin në Taonë ose në Zotin i cili përbëhet prej Jing dhe Jangut, gjegjësisht prej mashkullit dhe prej femrës apo prej dy fuqive të kombinuara. Sepse me këtë formohet një tip i ri i dualizmit, nga e cila del premisa se Zoti është një sintezë e dy krijesave të ndryshme. Kështu njëësia e Zotit ndahet në dy persona ose në dy substanca. Edhe nëse konceptohet si një ekzistencë e vetme, e cila është një sintezë e dy substancave të ndryshme, apo diç e ngjashëm me këtë, përsëri për islamit është e papranueshme. Po ashtu, islami nuk e pranon edhe dualizmin e Ehrimanit dhe Angramainjut, teori që ka lindur në periudhën e mëvonshme në *parsiçëm*, sipas së cilës besohet se këta të dy elemente kane emanuar prej Zotit që në parakohë.

Esenca e Zotit pranohet si një fshehtësi të cilën nuk e di askush tjetër përveç Tij.

Islami, vendimin dhe analogjinë e klerikëve fetarë (si rabinët, murgjit etj.), të cilat ata nuk i pranojnë si mendime shkencore por si shpallje hyjnore, nuk i pranon. Po ashtu islami, pranimin e pagabueshmërisë, sikur që është te papët, e llogarit si pranim në vend të Zotit, gjegjësisht e pranon si politeizëm. Kështu që Kur'ani me fjalët: **“Ata i konsideruan ‘ahbarët’ (priftër jehudi) të tyre, ‘ruhbanët’ (murgjit krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut...”** (Tevbe, 31), marrjen vendim në emër të Allahut, pranimin e tyre si autoritet për të dhënë vendime fetare, e llogarit si pranimin e tyre për zota dhe adhurim ndaj tyre. Sahabëve të cilët befasohen nga ky ajet, Pejgmaberi (a.s.) u thotë: **“Ju a nuk e llogaritnit për haram hallallin e Zotit, gjë të cilën e bëjnë edhe këta? Ju a nuk e llogaritnit hallall haramin e Zotit, gjë të cilën e bëjnë edhe këta? Kështu pra, këto janë adhurimet e tyre.”**⁵⁰²

b. Melekët dhe krijesat metafizike

Besohet se, përveç botës fizike, ekzistojnë edhe krijesa që kanë jetë shpirtërore. Këto janë melekët (engjëjt) dhe *xhinnët*. Kur'ani ka shpjeguar se njeriu është i krijuar prej dheut, kurse *xhinnët* prej zjarrit. Ndërkaq për melekët, se prej çfarë janë ato të krijuara, nuk është e theksuar në mënyrë të qartë. Vetëm se, prej një lajmi që na vjen nga Pejgmaberi (a.s.), kuptojmë se melekët janë të krijuar prej dritës.⁵⁰³ Natyra e melekëve dallon nga ajo e njeriut. Substanca nga e cila janë krijuar dallon gjithashtu. Melekët janë të padukshme, por kanë mundësi që të marrin cilëndo formë që e preferojnë. Ata nuk mund të veprojnë sipas dëshirës së tyre. Në mënyrë absolute u nënshtrohen urdhërave të Allahut. Ata nuk kanë lodhje dhe bezdisje. Ato nuk hanë e as nuk pinë dhe nuk kanë as gjini.

Melekët pejgamberëve ua dërgojnë shpalljen e Zotit. Edhe besimtarëve u ndihmojnë në punët e tyre, ua tregojnë rrugën e drejtë. Gjallesave, të cilat e kanë mbushur afatin e të jetuarit, ua marrin shpirtin. Bëjnë lutje për faljen e njerëzve. Regjistrojnë çdo sjellje të mirë dhe çdo të keqe të krijesave. Prej melekëve të mëdhenj që përmenden në Kur'an janë: Xhebraili, Mikaili, Israfil dhe Meleku i vdekjes (Azraili).

Islami nuk e pranon konceptin krishter se “Shpirti i Shenjtë” është pjesë e Hyjnisë, qenie dhe atribut hyjnor ose fuqia hyjnore. Sipas islamit Shpirti i Shenjtë është njëri prej emrave të Xhebrailit. Nuk është as Zot e as krijesë me tipare hyjnore, por, si çdo krijesë tjetër, është krijesë e Zotit.

Vetëm se është njëri prej melekëve me nivel më të lartë. Zakonisht njihet si i obliguar për bartjen e shpalljes së pejgamberëve. Sipas islamit, përsëkrimi si hyjnor i melekëve është politeizëm. Edhe cilësimi i tyre si djem apo vajza të Zotit është në kundërshtim me islamit.

Koncepti islam për melekët dallon nga ai i krishterë dhe hebraik. Sipas besimit islam melekët janë krijesa që e respektojnë plotësisht Allahun dhe nuk kanë specifikë kundërshtimi. Kurse tek të krishterët dhe tek hebrenjtë melekët janë krijesa që kanë mundësi të kundërshtojnë Zotin dhe kanë liri në të shprehurit. Kështu që, sipas tyre “shejtani” është një melek kundërshtues. Kurse sipas islamit shejtani (i blisi) është i krijuar prej zjarrit dhe është prej botës së *xhinnëve*. Ai, para se të kundërshtojë, bashkë me melekët i ka shërbyer Allahut. Por, për shkak të zilisë që kishte ndaj Ademit, nuk i është mbajtur fjalës hyjnore dhe kështu është mallkuar. Nga melekët dallon edhe në esencë.

Islami, edhe në lidhje me *xhinnët* dhe demonin, dallon nga fetë e tjera. Në fetë jashtë islamit ekziston mendimi për “shpirtin e keq” (demon). Sipas tyre, shpirtërat e keqin janë krijesa që nuk besojnë, me karakter negativ dhe me natyrën

⁵⁰² Yazır, *Hak Dini Kur'an Dili*, v. 4. f. 317 dhe në vazhdim.

⁵⁰³ Muslim, *Zuhd*, kapitulli: 10.

që posedojnë punojnë për të keqen. Këto nuk kanë botëkuptim të mirës. Puna e tyre është që njerëzit t'i çojnë drejt të keqes, t'i mashtrojnë etj. Janë një lloj ushtari i shejtanit. Janë ndihmësit e tij. Ndërkaq, sipas islamit, shpirtërat e këqinj janë shtresa e pafe e xhinnëve. Allahu edhe ato i ka krijuar prej zjarrit pa tym dhe u ka dhënë mundësi që të dallojnë të bukurën nga e shëmtuara. Por, për shkak të pabesisë së tyre, sikur njerëzit pafe, kanë zgjedhur rrugën e keqbërës. Të gjitha shoqëritë njerëzore dhe të xhinnëve ditën e gjykimit do të përgjigjen dhe do të japin llogari për punët që i kanë bërë. Sikurse njerëzit, edhe ata do të shpërblehen apo do të dënohen. Të gjitha janë nën mbikëqyrjen e Allahut. Pa lejen e Allahut nuk mund të bëjnë asgjë. Allahu ata deri në një masë i ka lënë të lirë që të vendosin për disa vendime dhe disa sjellje të tyre. Prej tyre, sikur të njerëzit, ka meshkuj dhe femra. Në besimin popullor femrave të tyre u thuhet “zanë”.

Dijetarët indusë muslimanë, zotat në hinduizëm, të cilëve ju bëhen idhuj dhe skulptura, dhe të cilët adhurohen, i quajnë “xhinnë” dhe manifestim i xhinnëve.⁵⁰⁴

Islami nuk i pranon edhe konceptet e ndryshme të feve të ndryshme për shpirtërat e këqinj, si “gogolët” dhe “lugetërit”. Sipas islamit, shpirti i krijesës së vdekur nga ana e melekëve të obliguar dërgohet në një vend pranë Allahut, të cilin vend ulematë e quajnë “bota e shpirtërave” dhe thelbin e këtij vendi njerëzit as mund ta njohin e as mund ta kuptojnë.⁵⁰⁵ Nuk kanë të drejtë të shëtisin lirshëm. Atje mbahen deri në ditën e gjykimit. Edhe lutjet e shpirtërave, si “O Zot, më dërgo mua përsëri në botë që të bëj punë me vlerë”, nuk pranohen në atë moment. Aty ka një perde (berzab) që i pengon që të mos kethehen përsëri në botë.⁵⁰⁶ Çdo gjë është nën mbikëqyrjen absolute të Allahut. Vetëm se besohet se, shpirti në botën e shpirtërave do të shpërblehet⁵⁰⁷ ose do të dënobet⁵⁰⁸ sipas sjelljeve në këtë botë.

Edhe melekët Haruti dhe Maruti nuk janë kundërshtarë, por janë krijesa që i janë nënshtuar Allahut. Vetëm në Babil disa njerëzve ata ua kanë mësuar metodën e ndikimit shpirtëror, por, në të njëjtën kohë edhe ua tërhiqin vërjetjen duke u thënë se të mos e keqpërdornin. Sipas Kur'anit magjia është një pjesë e privimit në këtë botë. Pa lejen e Allahut asnjë magji nuk mund të bëjë dëm.⁵⁰⁹

c. Besimi në librat e shpallura

Me fjalën libra të shpallura kuptojmë tekstet e shkruara të cilat përmbajnë porositë dhe urdhërat e Allahut që janë të dërguara për popujt e pejgamberëve. Këto janë *Tevrati*, *Zeburi*, *Inxhili*, të cilët i përmend Kur'ani, dhe *Kur'ani*. Muslimanët këtyre librave dhe librave tjerë të shpallur, të cilët nuk përmenden në Kur'an, u besojnë teorikisht. Në të shumtën e rasteve edhe ata libra të cilët i posedojmë, për shkak të asaj që e kanë humbur origjinalitetin e tyre, nuk mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën ditore të besimtarit. Kurse në aspektin shkencor, për shkak të përdorimit të shpeshtë të tyre në komentimin e Kur'anit, shihet ndikimi indirekt i tyre.

Edhe pse me ithtarët e librave për ekzistimin e Tevratit dhe të Zeburit nuk ka ndonjë mosmarrëveshje, për origjinalitetin e tyre diskutimet vazhdojnë. Vetëm se dallimi mes të kuptuarit e shpalljes dhe koncepteve për Inxhilin, në mesin e muslimanëve dhe të krishterëve është shumë i madh. Sipas të krishterëve, fjala hyjnore dhe shpallja janë shndërruar në mish dhe në gjak në Isain, kurse Isai pas tij nuk ka lënë ndonjë libër të shpallur sikur që është Kur'ani dhe Tevratit. Librat të cilat quhen “*Inxhil*”, të cilat edhe i posedojmë, janë “*libra të cilat i kanë të regjistruara, të grumbulluara lajmet e shpjeguara për Isain dhe jetën e tij*”, që janë të shkruara me inspirimin e Shpirtit të Shenjtë që iu është dhuruar havarijve (apostujve), dishepujve dhe besimtarëve të tyre. Në tokë, një “*Inxhil*” sikur që besojnë muslimanët nuk ka.

Ndërkaq sipas muslimanëve, Hz. Isai i është dhënë një shpallje e quajtur “*Inxhil*”. Por kjo shpallje, për shkak se Isai nuk e ka shkruar apo nuk ua ka diktuar dishepujve të tij, është zhdukur. Në librat aktualë, të quajtur ungjij, është e mundur që të jenë futur edhe disa pjesë nga ajo që i është shpallur Isait.

Edhe pse të krishterët e kohës së sotme tërë Ungjillin (Inxhilin) dhe Letrat e apostujve, të cilat e

⁵⁰⁴ Kur'an, *Nisa*, 117; Ernst Zbinden, *Islam'da ve Eski Doğu'da Cin ve Rub İnançları*, Stamboll: Yeni Ufuk Neşriyat 1997, f.72, 154.

⁵⁰⁵ Kur'ani, *En'am*, 62.

⁵⁰⁶ Kur'ani, *Mu'minun*, 99-100.

⁵⁰⁷ Kur'ani, *Ali İmran*, 169.

⁵⁰⁸ Për më gjërë shih, Ernst Zbinden, *vep. e cit.*, f. 200.

⁵⁰⁹ Kur'ani, *Bakara*, 102.

përbëjnë brendësinë e Dhiatës së Re, i llogaritin inspirim dhe shpallje të Shpirtit të Shenjtë dhe, edhe pse besojnë se ata reflektojnë të vërtetën hyjnore, ata për muslimanët paraqesin vetëm “dokumente historike” që shpjegojnë atë kohë. Kështu që, përveç inxhileve zyrtarë, të cilët kisha sot i llogarit si të vërtetë, ka edhe inxhile të tjerë. Disa nga këta ungjinj, si Ungjilli i ebionitëve dhe i ibranitëve, mbrojnë mendimin se Isai është peygamber dhe njeri. Sidomos Ungjilli i Bernabës shumë qartë tregon për Muhamedin (a.s.). Ungjijt zyrtarë janë përfaqësues të krishterimit të Palit. Është vështirë të mbrohet mendimi se ata reflektojnë plotësisht dhe në mënyrë origjinale shpalljen dhe realitetin hyjnor. Por, nuk ka dyshim edhe në atë se në brendësi të tyre ka shkëndija të relitetit të mbetur dhe të transmetuara nga Isai dhe nga apostujt e tij. Disa shembuj nga këto janë disa fjalë të urta dhe filozofike që gjenden në to.

Ajetet kur'anore që tregojnë se Kur'ani ka zbrtur si “*vërtetues*” (*musaddikun*) i librave të shpallura me herët, kuptohen në dy mënyra: E para, Kur'ani, për ajetet që janë dhe që i kanë edhe librat e shenjta dhe që janë paralel me ato të Kur'anit, ose kanë të njëjtin kuptim, është “*vërtetues dhe miratues*”. E dyta, Kur'ani është edhe përmirësues i gabimeve dhe sqarues i problemeve të ithtarëve të librave mes veti. Kështu që në suren Nahl, ajeti 64 thuhet: “*Ne nuk ta shpallim ty për tjetër Kur'anin, vetëm që t'u sqarosh atyre atë për çka u përçanë, e (ta zbritëm) që të jetë udhëzim për njerëzit që besojnë*”. Kurse ajetet (versetet) e librave të shenjta që janë në kundërshtim me Kur'anin, pranohen si ndryshime apo deformime gjatë përkthimeve të bëra në lidhje me ta. Atëherë Kur'ani për to është “*korrigjues, përmirësues*”. Për këtë, në kundërshtimet në Librin e Shenjtë, apo në çështjet diskutabile Kur'ani merret për bazë dhe versetet e Inxhilit komentohen sipas Kur'anit. Për këtë çështje në një ajet thuhet: “*...Allahu me mëshirën e Tij i udhëzoi ata që besuan tek e vërteta e asaj për çka ishin kundërshtuar...*” (Bakara, 213). Nga këto shprehje kuptohet se Kur'ani, në kundërshtitë në komentimin e Librit të Shenjtë, luan rolin e përmirësuesit.

Simpatizuesve të feve për të cilët supozohet se ata posedojnë Libër të Shenjtë në Kur'an u thuhet “*Ehlu'l-kitab*” (ithtarë të librit). Në radhë të parë, me shprehjen Ehlu'l-kitab nënkupton hebrejtë, të krishterët dhe sabiitët, të cilët posedojnë traditën fetare të Ibrahimit. Vetëm se kjo shprehje më vonë i ka përfshin “*të gjithë ithtarët e feve me libra, të cilët kanë pretenduar se librat e shenjta bazohen në shpallje*”. Edhe pse kjo bindje teorikisht nuk zë vend në librat e jurisprudencës islame, në jetën e përditshme ithtarët e zaratuizmit, maniheizmit, po bile edhe politeistët e feve indiane, juridikisht janë trajtuar si ithtarë të librave, dhe nuk u është ndërhyrë aspak në fetë e tyre. Historia është përplot me shembuj të këtillë. Muslimanët edhe pse këto fe dhe libra i kanë respektuar, në sistemin e tyre fetar atyre nuk ju kanë lënë vend. Pra, pretendimet e tyre për shpalljen dhe burimin hyjnor nuk janë marrë seriozisht.

ç. Besimi në peygamberët

Allahu, për shpjegimin dhe transmetimin e urdhërave, këshillave etike, të nevojshme për njerëzit, nga mesi i tyre ka zgjedhur disa të dërguar. Këta njerëz quhen “*peygamberë*”. Peygamberët janë njerëz me moral dhe me virtyte të larta. Ata njerëzve ua predikojnë urdhërat e Allahut. Nëse do të gabonin Allahu ua tërheq vërejtjen. Për këtë ata nuk pretendojnë në gabime. Ata janë njerëz të drejtë dhe me aftësi të larta.

Megjithatë Kur'ani, edhe pse tregon se çdo popull i është dërguar peygamber, emrat e disave nga ata, të cilët kanë qenë të dërguar vetëm në Arabi dhe përreth saj, i përmend si udhëheqës fetarë dhe etikë. Ata janë: *Ademi, Idrisi, Nubi, Hudi, Salihu, Ibrahim, Luti, Ismaili, Is'haku, Jakubi, Jusufi, Ejjubi, Shuajbi, Musai, Haruni, Davudi, Sulejmani, Ijasi, Eljesai, Dhu'l-Kifli, Junusi, Zekerijjai, Jahjai, Isai dhe Muhamedi (a.s.)* Poashtu përmenden edhe emrat si *Uzejir, Lokman dhe Dhu'l-Karnejn*. Vetëm se për këta polemizohet se a janë peygamberë apo janë *velij* (të dashur të Allahut xh.sh.).

Po ashtu ka edhe dijetarë, të cilët me këshillat e tyre dhe me anë të themelimit të sistemeve të tyre fetare-filozofike, njerëzimit i kanë dhënë kahje, kanë krijuar fe apo kanë treguar sjellje sikur të peygamberëve. Shembull për këtë janë Buda dhe Konfuçi. Vetëm se ne nuk posedojmë ndonjë dokument se këta njerëz të mëdhenj punën që kanë bërë, e kanë bërë me anë të shpalljes dhe obligimit që e kanë marrë nga ana e Zotit. Kur të shihet jeta e tyre do të kuptohet se, ata duke mësuar dhe hulumtuar të arriturat mendore dhe fetare të mëparshme, duke studiuar pasurinë e më parshme etike, kuptohet se ata mendimet që i kanë prodhuar për të mirën e popullit dhe të njerëzimit, kanë dashur që t'i përdorin për dobinë e popullit. Vetëm se nga që nuk posedojnë njohuri për atë se ata janë misionarët dhe mësuesit e njohurive hyjnore, nuk mund që ato as të refuzohen e as të pranohen. Islami ata nuk i

llogarit për pejgamberë. Kështu që, të dy filozofët, emrat e të cilëve i përmendëm më lart, nuk kanë diskutuar as për shpalljen e as për Zotin. Buda ka kërkuar rrugët e shpëtimit të gjallesave nga dhimbja e reinkarnacionit të pafund të shpirtit, si që është në mendimin dhe kulturën induse. Edhe Konfuçi është munduar që të tregojë se si mund të formohet një shoqëri e moralshme. Sipas muslimanëve këta personalitete nuk janë pejgamberë, por, janë mendimtarë dhe filozofë të mëdhenj në historinë e njerëzimit.

Mundësia se liderët dhe mendimtarët, të cilët gjatë tërë historisë e kanë patur simpatinë dhe respektin e njerëzimit, janë apo jo pejgamber, punohet që të vlerësohet me anë të studimit të veprave të cilat kanë arritur deri sot. Për shembull, Zaratustra ka treguar se pranon shpallje nga ana e Zotit, se u tregon të tjerëve për njësinë e Zotit dhe se i mëson ata. Ai ka shpallur se zotat që i bëhen shok Zotit janë xhinnët. Ai ka treguar edhe për ditën e llogarisë dhe për ahiretin. Kështu që në bazë të kësaj shtohet mundësia që ai të jetë pejgamber.

Muslimanët, ata që kanë lindur pas Muhamedit (a.s.) dhe kanë pretenduar se janë pejgamberë, i shikon si njerëz të dyshimtë. Kur'ani tregon se Muhamedi (a.s.) është pejgamberi i kohës së fundit, “*hatemu’l-enbija*”. Kjo shprehje ka kuptimin se ai është edhe vërtetues i atyre që kanë ardhur përpara tij, por edhe i fundit. Mendimi se fjala “*hatem*” (i fundit) ka kuptimin “*hatem*” (miratues), është një komentim i papranueshëm.

d. Besimi në botën e amshueshme (ahiret)

Koncepti i islamit për kohën fillon me një pikë dhe përfundon në një pikë tjetër. Për këtë kohë dhe historia nuk mund të kthehen prapa, nuk mund të përsëriten. Edhe njeriu në këtë rrjedhë kohore, e cila nuk ka kthim, vjen, jeton dhe vdes. Edhe kjo botë, sikur kjo rrjedhë natyrore e gjallesave, ka një jetë të veten që e jeton. Historia, e cila ka filluar me krijimin, do të përfundojë me shkatërrimin e çdo gjëje, të cilën ne e quajmë “*kejamel*”. Njohuria dhe caktimi i këtij procesi është te Allahu xh.sh. Përveç Tij këtë nuk mund ta dijë askush tjetër. Gjithashtu pas një kohe, të cilën po ashtu e di vetëm Allahu, bota do të shndërrohet në një botë tjetër, kurse qiellrat në qiej tjerë⁵¹⁰, do të përgatiten për ditën e ringjalljes, sidomos njerëzit për të dhënë llogari për jetën të cilën e kanë përjetuar vetëm një herë në këtë botë, do të ringjallen. Do të ringjallen me trup të ngjashëm si në këtë botë. Do të japin llogari për të gjitha punët që i kanë kryer me dëshirën e lirë të tyre, dhe do të gjykohen për to. Pas këtij gjykimi hyjnor, ata që do të llogariten gjynahqarë do të përjetojnë dënimin në vendin e quajtur *xhebennem*, kurse ata që do të falen apo do ta meritojnë të shpërblehen do të shkojnë në *xhennet*. Shpjegimet në Kur'an për xhennetin dhe për xhebennemin janë të përshkruara në atë formë që t'i kuptojë njeriu. Kurse të vërtetën e të shpjeguarave e di vetëm Allahu. Për botën e ahiretit përveç njohurive të shenjta (*nass*), burime të tjera nuk ka.

Vdekja realizohet me marrjen e shpirtit të të gjallit nga ana e të dërguarve të Allahut. Në Kur'an thuhet: “*Pastaj i ktheben Allabut, Sunduesit të vërtetë të tyre...*” (En'am, 62).

Për jetën e gjallesave, pas përfundimit të jetës botërore të tyre, mes ringjalljes dhe ahiretit, nuk dihet se ku qëndron shpirti i tyre dhe se si ato e jetojnë jetën atje. Kur'ani për këtë çështje nuk bën sqarime më tepër se kjo: “*Pastaj i ktheben Allabut, Sunduesit të vërtetë të tyre...*” (En'am, 62). Edhe dijetarët këtë vend e kanë quajtur “*arasat*” që ka kuptimin “*vendi për pritje*”, ose “*alem-i ervah*” (bota e shpirtërave), i cili është një koncept që nuk i dihet esenca. Në aspektin islam nuk dihet se ku është dhe si është ky vend. Krahas kësaj teologët kanë prodhuar mendime dhe koncepte të ndryshme dhe kanë diskutuar në lidhje me ta.

Islami respekton mendimet e feve të ndryshme për vendin se ku do të shkojnë shpirtërat pas vdekjes dhe ku do të qëndrojnë deri në ringjallje. Ata as i refuzon e as i pranon. Vetëm se islami nuk pranon se shpirtërat e vdekur mund të shëtisin të lirë, si fantazmë dhe luga. Gjithashtu ai nuk pranon se gjynahet e të këqinjve, gjegjësisht e atyre që sillen si djalli, shtohen; se sevapet e shpirtërave që kanë bërë mirë apo që e përmbajnë të mirën, shtohen; si dhe i mohon edhe mendimet se ata vazhdojnë ta shtojnë përsosmërinë e tyre. Sipas islamit, me vdekjen mbyllet dyert e sevapeve dhe të gjynaheve, por,

⁵¹⁰ Kur'ani, *Ibrahim*, 48; *Taha*, 55.

vetëm se besohet se, nëse i vdekuri ka lënë pas një fëmijë të dobishëm, ka bërë një punë të dobishme (ka shkruar një libër) ose ka punuar një vepër për të mirën e popullit, gjegjësisht ka bërë një “*sadaka-i xharije*”, shpirti i tij ka sevape (i shtohen sevapet edhe pas vdekjes). Po ashtu besohet se edhe ai i cili ka bërë gjynahe, deri sa të veprohet ai mëkat, edhe pas vdekjes së tij do të vazhdojë të fitojë gjynahe. Kurse shpirti me anë të melekeve të obliguar dërgohen në vendin ku dëshiron Allahu. Dëshira e shpirtërave, të cilët e kuptojnë realitetin e vdekjes dhe të jetës pas vdekjes, për t’u kthyer në botë nuk pranohet: “...*Ah, sikur të na lejohet një kthim (në dynja) e të largohemi prej tyre (prijësve) siç u larguan ata tash prej nesh!*...” (Bakara, 167). Kur’ani nuk i pranon edhe lajmet dhe mendimet se shpirtërat e vdekur i dëgjojnë zërat e të gjallëve, por, se nuk mund t’u përgjigjen atyre. Ajeti 22 i sures Fatir tregon se të vdekurit nuk ndëgjojnë: “*E nuk janë të njëjtë as të gjallët e të vdekurit, Allahu bën të dëgjojë atë që do, e ti nuk mund ta bësh të dëgjojë atë që është në varr*”.

Gjithashtu edhe mendimi se shpirti i vdekur, derisa të përsoset apo të fitojë kënaqësinë e Allahut, hyn në trupa të ndryshëm, gjegjësisht teoria e reinkarnacionit nuk pranohet. Në ajetin 100 të sures Mu’minunë në Kur’an, përdoret shprehja: “*Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur do të ringjallen*”. Ky ajet qartësisht e mohon mendimin për reinkarnacion.

Poashtu nuk e pranon mendimin, që është në budizëm, se shpirti hyn në Nirvana (në hiç ose në qetësi absolute). Sipas islamit, çdo shpirt do të presë ditën e llogarisë, pas kësaj ose do të dënohet ose do të shpërblehet sipas premtimit të dhënë. Dalja jashtë dëshirës së Allahut dhe vdekje në xhennet ose në xhehennem, nuk ka. Nuk ka mundësi që edhe të synohet që të vdiset. Gjithashtu në islam nuk pranohet edhe mendimi se, shpirti pas shpërblimit në xhennetin apo dënimit dhe në xhehennemin aktual, do të kthehet përsëri në këtë botë, dhe se do ta vazhdojë jetën e vet në nivele të ndryshme jetike, sikur që është në fetë indiane.

dh. Kader dhe kada

Kjo temë, si në çdo fe, ashtu edhe në mesin e muslimanëve, është një temë që më tepër diskutohet. Kader, është njohja e Allahut që në amëshim e veprimeve të mira dhe të këqija që do t’i veprojë krijesa në të ardhmen. Kurse kur të vijë koha, krijimi i ngjarjeve dhe i gjërave sipas diturisë në amëshim është kada. Përkundër mendimit të disa feve se “Zoti krijon dhe cakton vetëm të mirën, islami beson se Allahu është krijues edhe i së keqes edhe i së mirës. Vetëm se njeriu, për hirë të aftësisë që i është dhënë për të zgjedhur të mirën ose të keqen, për punët që do të veprojë dhe për sjelljet e tij gjatë tërë jetës do të jetë vetë përgjegjës. Zgjedhja brenda kufijve të vullnetit të lirë i takon njeriut, kurse krijimi i punës i takon Allahut. Megjithatë, njohja e Allahut për atë kush çfarë do të veprojë në të ardhmen dhe se çka ka punuar në të kaluarën, është nevojë e cilësi e diturisë universale të Tij.

4. Qasje besimeve të feve tjera në Mehdiun dhe Mesihun

Termet *Mesih* dhe *Mehdi* janë shprehje të kulturave të ndryshme, por, me koncept të njëjtë. Këto janë emra individësh, të cilët Zoti i ka dërguar ose do t’i dërgojë në Kohën e Fundit, që njerzve para kijametit t’ua tregojnë rrugën e drejtë, rrugën me të cilën është i kënaqur edhe Zoti, dhe që njerëzimit t’ia mësojnë fenë univertzale. Çdo teolog këtë koncept e formulon brenda kufijve të sistemit të besimit të vet.

Sipas Kur’anit, shpëtimtari dhe mesihu i kohës së fundit, të cilin e presin sidomos hebrenjtë dhe të krishterët, është Muhamedi (a.s.). Kurse ata “*ithtarë të librit*” që posedojnë mendje të shëndoshë atë “*e njihnin sikur që i njihnin fëmijët e tyre*”. Njëri prej titujve të Pejgamberit (a.s.) ishte edhe “*pejgamberi i kohës së fundit*” ose “*hatemu’l-nebijnin*”. Që në ditën kur erdhi ka shpjeguar “*universalen, të fundmen*”. Ai është i vetmi, që në historinë e pejgamberllëkut ka bërë një mision të paraleltë me Musain (a.s.). Këtë e

simbolizojnë universaliteti i shariatit që e solli, autoriteti politik në shtetin që e formoi, të qenët komandant i ushtrisë, të luftuarit e tij etj. Këto janë specifika të profecisë jashtë budizmit dhe taoizmit.

Mendimi i përhapur në mesin e të krishterëve se Isai, që shkoi para se ta kryejë obligimin e tij, do të vijë përsëri dhe detyrën e tij do ta plotësojë me një mbretëri njëmijëvjetëshe, sipas islamit nuk është i pranuar. Sepse Isai, sipas Ungjillit të Gjonit, ka lajmëruar se për të plotësuar këtë detyrë do të vijë një shpëtimtar me emrin Paraklet (*Ahmed*). Po ashtu sipas Kur'anit, Isai nuk është kryqëzuar, Allahu atë e ka shpëtuar nga një vdekje të dhimshme (me torturë), dhe e ka vdekur pa përjetuar ndonjë torturë. Edhe ai, Isai, si çdo pejgamber dhe çdo njeri tjetër ka vdekur dhe është në pritje të ditës së ringjalljes. Parakletos, për të cilin paralajmëron Ungjilli i Gjonit (Gjoni, 16), nuk është “Ndhimëtari ose Shpirti i Shenjtë”, ashtu si e komentojnë të krishterët, por është Muhamedi (a.s.). Kështu që në mesin e kuptimeve të ndryshme të kësaj fjale është edhe kuptimi “*Ahmed*” (falënderues). Sipas Kur'anit, dijetarët e mençur dhe me urtësi të ehl-i kitabit atë e njihnin sikur fëmijët e tyre.

Sipas transmetimeve krishtere, Isai ka lajmëruar se do të zhduket vdekja, ka lajmëruar për ringjalljen e të vdekurve, për ndryshimin e natyrës aktuale, për “shtetin dhe sundimin hyjnor”, prej të cilave muslimanët kuptojnë “ringjalljen dhe ahiretin”. “*Autoriteti i mehdiut*”, që do të zgjasë një kohë të shkurtër dhe do të përjetohet para kijametit, për të cilin flasin profecitë nëpër disa libra të muslimanëve, janë lajme jokur'anore dhe me ndikim israelitësh. Kur'ani, ndryshimet natyrore dhe shoqërore për të cilat përfytyrohet se do të ndodhin në periudhën e mehdiut-mesihut, thotë se nuk do të ndodhin para kijametit, por, ato i takojnë një botës së re, që do të formohet pas kijametit dhe si sinjalizim të ahiretit. Kur'ani me fjalët, “*Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt...*”⁵¹¹, konceptet mrekulluese të ithtarëve të librit për Mesihun, i pranon si rikonstruim të botës që do të lindë me kijametin dhe si fillim i një bote, gjegjësisht të botës së ahiretit, pas ringjalljes.

Muslimanët e Indisë, pasi që mehdiu në hinduizëm *Kalki* dhe mehdiu në budizëm *Majtreja* kanë kuptimin “*falenderues*”, janë të mendimit se edhe ata sinjalizojnë Muhamemdin (a.s.) Kështu që, misionari i fesë universale, të cilin e presin shumica e feve që të vijë në Kohën e Fundit, është Muhamedi (a.s.). Ai ka ardhur si udhëzues, si tregues i rrugës së vërtetë; ai e ka kryer misionin e tij dhe pas tij ka lënë islamit dhe Kur'anin.

Sipas fraksionit islam shiit, besimi në *mehdiun-mesihun* është kusht. Është prej parimeve të besimit. Kurse fraksioni islam sunnit, besimin dhe priten e imamit 12. *mehdi-i muntazar* (imami i pritur), të imamijve, e shohin si një koncept dhe një vlerësim politik. Transmetimet për këtë gjë në përmbledhjet e haditheve nuk i pranojnë si fjalë të Pejgamberit, por, si slogane të shpikura në emër të Pejgamberit dhe si transmetime të dobëta. Për shkak që në Kur'an nuk gjendet ndonjë ajet për këtë çështje, atë e pranojnë si një koncept kulturor dhe social që nuk ka aspak të bëjë me besimin.

5. Doktrina e udhëzimit/shpëtimit

Sipas islamit, themeli i udhëzimit të njeriut, gjegjësisht themeli i përfitimit të kënaqësisë së Zotit, bashkë me dhurimin e një besimi të drejtë atij individit nga ana e Allahut, fillon duke kërkuar të vërtetën me anë të të dëgjuarit të zërit të ndërjegjes dhe të arsyes dhe me pranimin e atij realiteti. Realizimi i lutjeve dhe i sjelljeve të porositura nga Kur'ani, qëndrimi larg ndalesave, sjelljeve të ndyta dhe jo të drejta, dhe zbatimi i urdhërave shtojnë fitimin shpirtëror. Ibadetet dhe sjelljet e mira, sikurse që ndihmojnë në përforcimin e besimit, ashtu ndihmojnë edhe në afrim më tepër Allahut dhe mundësojnë fitimin e kënaqësisë së tij. Sjelljet e mira dhe etike gjithmonë në rrugën e shpëtimit plotësojnë besimin e drejtë. Sikur që sjelljet e pavetëdijshe (punët pa fe) që nuk ndihmojnë për udhëzim ashtu edhe besimi që nuk shoqërohet me sjellje të mira nuk mund të garantojë shpëtimin. Vetëm se ligjëvënësi absolut është Allahu. Për vendimin e tij nuk është përgjegjës përpara askujt. Mëkatet mund t'i falë, por mund edhe të mos i falë. Ai politeistët dhe përgënjeshtuesit nuk i falë. Vendimi i fundit i takon Allahut të Gjithfuqishëm.

⁵¹¹ Kur'ani, *Ibrahim*, 48.

Islami, sipas këtyre pikëpamjeve, fetë të cilat mbrojnë besimin pa vepra nuk i pranon, kurse nuk i miraton edhe ato besime të cilat i japin përparësi punës pa besim. Islami vë theks të veçantë mbi tërësinë e punës dhe të besimit. Sistemet etike dhe sistemin karma të feve indiane, i sheh si të pamjaftueshëm për shpëtim. Gjithashtu edhe mendimet e disa të krishterëve dhe të disa fraksioneve budiste, se shpëtimi mund të arrihet edhe me besim pa vepra, nuk i pranon.

6. Feja dhe vullneti i lirë

Sipas islamit Allahu, i cili ka krijuar çdo gjë, njeriun e ka krijuar si krijesë më të përsosur. Ai dëshiron që njeriu me mendjen dhe logjikën që ia ka dhënë vetë Ai, ta njohë veten dhe t'i zbatojë rregullat etike për të cilat e ka udhëzuar. Vetëm se që kjo botë “për njerëzit” të jetë një provim, Ai njerëzit i ka lënë të lirë në sjelljet e tyre. Çdo njeri për besimin dhe për sjelljet e tij është përgjegjës. Edhe ata të cilët i udhëzojnë të tjerët në të mirë ose në të keqe do të shpërblehen apo do të dënohen. Do të jenë pjesëmarrës në të mirën dhe në të keqen, për të cilën kanë qenë shkaktarë.

Për këtë, detyrimi i njerëzve që të pranojnë një sistem ose një besim është i papranueshëm. Feja e pranuar me detyrim, e cila nuk është e pranuar me zemër, nuk është legjitime. Obligimi i muslimanëve me besim dhe të ditur është vetëm propagandimi i të mirës dhe i të drejtës. Ndaj të gjithë njerëzve, besojnë apo nuk besojnë ata, duhet të sillemi të drejtë dhe moralshëm. Duhet të jemi të respektueshëm ndaj besimeve të të tjerëve. Në rast nevojë duhet të shpjegohet e drejta dhe e vërteta. Islami, respektin dhe nderin që ua bën atyre, të njëjtën e kërkon edhe prej feve të tjera. Në të kundërtën, sipas kushteve kohore, me metoda të drejta dhe të ngjashme, lind e drejta dhe obligimi për mbrojtjen e vetvetes dhe të muslimanëve të tjerë. Për këtë, në të gjitha shtetet ku është përhapur dhe ku ka dominuar islami, e drejta fetare dhe e bindjes i ka qenë e njohur çdonjërit që i ka realizuar obligimet shtetërore, pa marrë parasysh se ai ka qenë monoteist, politeist apo nuk e ka njohur Zotin fare (ateist). Administrata shtetërore, krahas praktikimit të ligjit fetar dhe të sheriatit, ndaj njerëzve që kanë adhuruar qindra zotëra apo idhujtarëve, si për shembull anëtarëve dhe tempujve hindusë, nuk ka ushtruar ndonjë dhunë shpirtërore ose materiale. Kurse disa sjellje jashtë ligjit të disa administratorëve janë raste të rralla apo janë përgjigje sjelljeve të gabuara të shteteve fqinje.

7. Filozofia e natyrës

Allahu, sipas islamit, të gjitha krijesave që i ka krijuar, të gjalla apo jo të gjalla, që në krijimin e tyre ua ka dhënë obligimet themelore, gjithashtu ka thënë “ejani me dëshirë ose pa dëshirë” dhe si përgjigje kësaj, të gjitha krijesat janë përgjigjur se vijmë “me dëshirë”. Parimet e shkencës moderne natyrore që ajo i quan “*ligji i natyrës*”, janë urdhëra të Allahut, që shihen në krijesat e Tij, qofshin ato të gjalla apo jo të gjalla. Edhe veprimet e atyre që merren me natyrën dhe veprimet e shkencëtarëve që mundohen t'i kuptojnë, t'i hulumtojnë, t'i shpjegojnë ngjarjet natyrore, nuk janë gjë tjetër vetëm se janë veprime për të kuptuar dhe komentuar “argumentet (ajetet) konkrete” të Allahut që duken në natyrë. Teologët veprojnë në të kuptuarit teorik të argumenteve të Allahut, kurse ata që merren me shkencat natyrore veprojnë në të kuptuarit dhe të komentuarit e argumenteve faktike (praktike) dhe konkrete të Zotit. Vetëm se disa këtë e kryejnë të vetëdijshëm kurse disa të tjerë të pavetëdijshëm. Merituesit e lëvdatave janë ata që janë të vetëdijshëm në veprimet e tyre.

8. Adhurimet

Nënshtrimi urdhërave, realizimi i tyre dhe falenderimi për dhuntitë që i janë dhënë atij, për njeriun që është i vetëdijshëm për obligimet e tij ndaj Allahut, llogariten ibadete/adhurime. Sidomos këto janë respektimi dhe nënshtrimi ndaj rregullave juridike dhe etike të theksuara në Kur'an, si namazi, agjërimi, zekati, haxhi etj.

a. Namazi

Fjala namaz (*salat*) do të thotë “lutje”. Vetëm se këtu është për qëllim “lutja zyrtare”, gjegjësisht “lutja me formë”. Koha dhe parimet e kësaj lutjeje janë të theksuara në Kur'an, kurse praktikimi i saj besimtarëve iu është paraqitur dhe iu mësuar nga ana e Pejgamberit. Ky është një ibadet që njeriun e mbron prej sjelljeve të papërshtatshme dhe prej punëve të këqija. Ai ibadet është lutje, falënderim dhe madhërim Allahut. Është pendim dhe kërkim falje për mëkatet. Këtë ibadet çdo musliman mund ta realizojë edhe vetvetiu edhe në shoqëri. Besimtari, nëpërmjet namazit direkt del përpara Krijuesit të tij dhe me këtë llogaritet realizues i obligimit si rob i Zotit.

Ndërkaq lutjet jozyrtare, gjegjësisht lutjet e lira, krahas asaj që janë manifestim i shpirtërores në çdo vend ku ai gjendet, ato janë edhe kërkim prej Allahut dhe shprehje e çdo lloj dëshire ahireti dhe të kësaj bote në lutjen e tij përpara të Gjithmëshirshmit. Kjo lutje nuk ka vend të caktuar, kohë apo kushte të caktuara. Allahu, i cili i është njeriut më afër se edhe damari i qafës, në çdo moment dhe në çdo vend dëgjon lutjet me zë ose pa zë, të fshehta ose haptazi. Këto dy lloje ibadetes në Kur'an janë të theksuara, e para me shprehjen “*salat*” (namaz), kurse e dyta me shprehjen “*dua*” (lutje).

b. Agjërimi

Agjërim është qëndrimi i muslimanëve larg çdo nevoje fizike, si çdo lloj pije dhe ushqimi në muajin e Ramazanit, duke filluar prej mëngjesit ende pa lindur dielli, e deri në mbrëmje kur perëndon dielli, dhe është durim ndaj aspiratave të ndryshme. Qëllimi i këtij ibadeti është që njeriun ta mësojë që ai të kontrollojë dëshirat dhe ambiciet, aspiratat dhe ndjenjat e tij. Vetëm se ky ibadet iu është bërë farz (detyrim) atyre që janë në gjendje në aspektin e fuqisë fizike. Kurse ata që nuk janë në gjendje, si të sëmurët, udhëtarët, lehonat dhe gratë me menstruacion, kur të shërohen dhe të arrijnë në gjendje për të agjëruar, do të agjërojnë aq ditë sa nuk kanë patur mundësi t'i agjërojnë më herët.

Agjërimi, siç përmendet në Kur'an, ka qenë edhe në fetë e tjera para islamit. Edhe krahas disa dallimeve në imtësi, shembuj të këtillë në hebraizëm është Behor dhe Tesha-Beav, kurse në krishterim është agjerimi i Pashkëve.

c. Zeqati

Zeqati është ndarje e një pjese të caktuar të pasurisë, jashtë nevojës, njerëzve të cilët kanë nevojë, apo shtetit në të cilin ata jetojnë. Është një lloj ibadeti me pasuri. Tek fetë e mëparshme para islamit ka qenë në formë të ndihmës vullnetare. Kurse Kur'ani, që çdo njeri t'i ndihmojë të afërme dhe komshijve të varfër, çdonjërin e ka obliguar me dhënie të një pjese të pasurisë. Sasia e kësaj edhe pse nuk është theksuar në Kur'an, Pejgamberi (a.s.) e ka praktikuar duke marrë 1/40, ose 2.5 % e pasurisë. Dhe kështu, në këtë formë ka arritur deri tek ne. Po ashtu, në fund të muajit Ramazan, çdo kryetar i familjes në emër të vet dhe në emër të anëtarëve të tjerë të familjes, jep një ndihmë ekonomike të quajtur *sadaka-i fitër*. Mënyra dhe imtësitë e praktikimit të kësaj shpjegohen nëpër ilmihaletë ndryshme.

ç. Haxhi

Haxhi është një ibadet trupor, të cilin ata besimtarë të cilët kanë mundësi shëndetësore dhe ekonomike e kanë për obligim që një herë në jetë, duke e vizituar Qabenë brenda muajve haram dhe duke i praktikuar kushtet e tjera në lidhje me të, ta realizojnë. Muaj haram janë katër edhe atë Dhu'l-ka'de, Dhu'l-hixhxe, Muharrem dhe Rexheb. Pejgamberi (a.s.) ditën e haxhit e ka filluar me qëndrim në Arafat në ditën e 9 të Dhu'l-hixhxes. Vetëm se për realizimin e dëshirave të shtuara për shkaqe të ndryshme, si shtimi i popullatës në tërë botën dhe lehtësimin të udhëtimit deri atje, grumbullimi i të gjitha atyre miliona mysafirëve në Mekke për një kohë të caktuar shkon duke u vështirësuar ende më tepër. Kështu që duhet të bëhen përgatitje edhe më të organizuara.

Edhe tek fetë e tjera ka adhurime si vizita e vendeve të ndryshme të shënjeta. Vetëm se nuk janë farz dhe të domosdoshme sikur që është në islam.

Të gjitha ibadetet që i përmendëm më lart janë ibadete me kohë dhe vend të caktuar dhe që vazhdojnë për të gjithë besimtarët muslimanë. Përveç këtyre ka edhe sjellje dhe ibadete që nuk janë zyrtare, të cilat bëhen me nijet ibadeti.

9. Parimet etike dhe juridike

Islami, që besimtarët të arrijnë shpëtimin dhe të fitojnë kënaqësinë e Allahut, duhet t'i zbatojnë urdhërat dhe parimet etike dhe juridike që i përmend. Besojnë se ata për çdo të mirë dhe për çdo të keqe, gjegjësisht besojnë se do të shohin shpërblimin ose dënimin për sjelljet jashtë normave etike dhe juridike dhe se ditën e gjykimit do të gjykohen. Në sqarimet në lidhje me ligjet për dënim janë vendosur të gjitha limitet, janë vendosur bazat e drejtësisë universale. Për shembull të jesh shkaktar për vdekjen e dikujt, pa arsye ligjore, limiti më i lartë është dënimi me vdekje (*kisas*), kurse limiti më i ulët është falja (*aff*). Fusha e gjerë mes kisasit dhe faljes iu është lënë simpatizuesve dhe gjykatësve. Muslimanët janë të detyruar që këtyre t'iu nënshtrohen. Edhe nëse ata nuk kanë të meta në besimet e tyre, ata te Allahu (te rahmeti i Tij), do të arrijnë pas marrjes së shpërblimit për sjelljet e veta dhe, nëse ka, pas marrjes së dënimin. Sjelljet në lidhje me besimin llogariten plotësuese të imanit. Kur'ani këto i rezymon kështu:

“Thuaj: ‘Ejani t’ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata, të mos u afrohuni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytnjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë. Mos iu afrohuni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë, (mund t’i afroheni) vetëm në mënyrë më të mirë, zbatoni me drejtësi masën dhe peshojnë, Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij. Kur të flitni (të dëshmoni), dubet të jeni të drejtë edhe nëse është çështja për (kundër) të afërmit, dhe zotimin e dhënë Allahut plotësonie. Këto janë me çka Ai ju porositi kështu që të përkujtoni’. (En’am, 151-152).

10. Fraksionet (besimet) e ndara nga islami

Ka edhe rryma dhe fraksione, të cilat edhe pse kanë lindur dhe janë zhvilluar në kulturën islame, janë të ndara prej Kur'anit dhe shoqërisë islame. Këto rryma që nuk pranohen nga shoqëria islame, për të shfrytëzuar lirinë dhe të drejtën e njeriut të cilën ligji ndërkombëtar ua njuh feve, dhe për të shpëtuar nga shtypja psikologjike e anëtarëve të komunitetit, kanë theksuar se janë fe të reja dhe të pavarura.

a. Durzizmi

Është një rrymë fetare e themeluar nga kalifi el-Hakim b. Emril-lah (996-1021) dhe ministri i tij (veziri) Hamza b. Aliu, që janë nga dinastia fatimite me origjinë shiia-ismailije. Kurse emrin e merr nga

Anushtekin Durziu (v. 1019), që është njëri prej përhapësve të fraksionit.

Sipas besimit të fraksionit, el-Hakimi është zot në formë të njeriut. Zoti në të është trupëzuar. Ai është edhe shpirt edhe trup. Vdekja është një formalitet (dukje). Në të vërtetë ai nuk ka vdekur. Por, ai është fshehur për shkak të fitesë dhe të disfatës (turbullirave). Kur njerëzit do të pendohen për mëkatet e tyre dhe do t'u japin fund turbullirave, ai do të dalë në shesh përsëri.⁵¹² Hamza b. Aliu është krijesa e parë e lartë e Zotit. Universi është krijuar prej substancës së tij. Ai është logjika universale. Është i krijuar prej nurit të Zotit.⁵¹³ Ata nuk i pranojnë ibadetet tradicionale dhe besimin në ahiret, si xhennetin dhe xhehennemin. Të gjitha besimet dhe ibadetet e feve, përfshi këtu edhe islamin, i mohojnë. Tempujt e tyre të quajtura "halavat", i themelojnë në vende të pabanuara. Cigaren dhe pijet alkoolike i quajnë haram. Shumica e komunitetit është në Liban. Gjithashtu simpatizues kanë edhe në Siri, Jordan dhe në Izrael.

b. Kadianizmi

Themeluesi i *kadianizmit*, që njihet edhe si "*ahmedije*" dhe "*mirzaije*", është Mirza Gulam Ahmedi (1839-1908). Ky fraksion ka lindur në Kadian të Indisë në shek. XIX. Kadian është në rajonin Gurdaspur të krahinës Penxhab. Gulam Ahmedi, i cili në fillim me shkrimet e tij nëpër gazeta u bë i njohur si mbrojtësi i islamit, autoritetin e tij e përforcoi me librin e tij *Berabin-i Ahmedijje*. Aty bën fjalë për kerametet dhe për profecitë e tij. Ai thotë se shpallja nuk ka përfunduar, "njeriun e pa të meta që i nënshtrohet Muhamedit (a.s.) do ta furnizojë me të gjitha njohuritë ezoterike dhe ekzoterike. Po ashtu thotë se, njohuritë e bazuara në parandjenjë u përngajnë diturive të Pejgamberit. Gjithashtu bën të ditur se në këtë drejtim ka marrë shumë inspirim".⁵¹⁴ Xhihadin e komenton si një luftë që bëhet me mjete paqësore. Ai veten e shpalli reformator dhe, kështu, përreth tij u tubuan një grup njerëzish. Pas një kohe deklaroi se Isai (a.s.) nuk ka vdekur, kurse për të përhapur fenë ka ardhur në Kashmir dhe këtu në moshën 120 vjeçare vdes dhe varroset në Srinaga. Mesihu që duhet të vijë në kohën e fundit, nuk do të jetë Isai, por një njeri nga ummeti i Muhamedit (a.s.) që do t'i përngajë Isait. Gegjësisht Mesihu dhe Mehdiu nuk janë të ndryshëm por janë një njeri dhe ai është vetë Gulami.⁵¹⁵ Më pastaj deklaroi se ka marrë shpallje dhe se është resul (pejgamber me libër ose fletushkë të shpallur) dhe nebi (pejgamber pa libër ose fletushkë të shpallur), vetëm se nuk ka sjellur një fe dhe një shariat të ri.⁵¹⁶ Kështu që ai pejgamberllëkun e ndanë në dy mënyra, pejgamberllëk me shpallje dhe pa shpallje. Sipas tij, Muhamedi (a.s.) është pejgmaberi i fundit me shariat, kurse pejgmaberrllëku pa shariat vazhdon. Kështu që veten e tij e deklaroi si reinkarnacion i pjesërishëm i Muhamedit (a.s.).⁵¹⁷ Ai thotë se Xhibrili i ka sjellur shpallje prej Zotit. Gjithashtu ai me fjalët: "Ky i dobët (i varfër) u dërgua te ky ummet nga ana e Zotit si zëdhënës. Zëdhënës në çdo aspekt ka kuptimin pejgamber. Sado që nuk posedon pejgamberllëk të plotë, ai pjesërisht është pejgamber", u mundua që të forcojë pozitën e tij.⁵¹⁸ Edhe për indusët vetveten e deklaroi se është avatara (pamja trupore) e zotit *krishna*.

Pas vdekjes së tij më 1908, në komunitet në lidhje me çëshjten "nebij" lindi një mosmarrëveshje. Komuniteti u nda në dy krahë, në atë të Lahorit dhe të Kadianit. Krahu kadian për vete kryetar zgjodhi djalin e Gulam Ahmedit, Mirza Besiruddin Mahmud Ahmedin (1889-1965), i cili njihet si kalifi i dytë. Më 1947 qendrën e tyre e bartën në Rabva. Ata që nuk e pranuan pejgamberinë e Gulam Ahmedit, veprimtarinë e tyre e vazhduan duke organizuar organizatën e quajtur "*Ahmedije Enxhumen-i Ishaat-i Islam*", të cilën e udhëhiqte Mevlana Muhamed Ahmedi.

Kadianitët veprimtarinë e tyre me një aksion aktiv e vazhduan në vende të ndryshme të botës.

⁵¹² Turan, *Islam Mezhepleri Tarihi*, Samsun 1993, f. 79.

⁵¹³ Turan, f. 79.

⁵¹⁴ Kadiyanilik, *AnaBritanika*, XII, f. 374.

⁵¹⁵ Ebul A'la el-Mevdudi, *Kadiyanilik Nedir?*, (përkth. në turq. Ahsen Batur), İhya Yayınları, Stamboll 1975, f. 24.

⁵¹⁶ el-Mevdudi, f. 24.

⁵¹⁷ el-Mevdudi, f. 37-39.

⁵¹⁸ el-Mevdudi, f. 48.

Supozohet se numri i tërësishëm i tyre është afër 5-10 milionë.⁵¹⁹

c. Bahaizmi

Ka lindur ka fillimi i shek. XIX. Fazës së parë i thuhet “babizëm”. Sipas babizmit realiteti pejgamberik, sikur që ka qenë te pejgamberët e mëparshëm, ashtu është paraqitur edhe te Muhamedi (a.s.), në fisin e të cilit edhe ka vazhduar. Me fshehjen e imamit 12. pejgamberia 1000 vjet me radhë është fshehur dhe me ardhjen e kohës është paraqitur Ahmed el-Ahsai (v. 1826), pas tij Kazim Reshti (v. 1843) dhe pastaj e ka vazhduar Bab Mirza Ali Muhamedi. Mirza Aliu ka pretenduar se libri i tij me titullin “el-Bejan” bazohet në shpallje dhe gjithashtu ka pretenduar se ligjet në lidhje me ibadetet dhe drejtësinë (*muamela*) islame në këtë libër janë anuluar sipas nevojës së kohës. Për shkak të mendimeve të tij në kundërshtim me islamit në vitin 1850 është ekzekutuar.

Nxënësi i tij, Mirza Husein Aliu (1817-1892), i zhvilloi mendimet e mësuesit të vet dhe veten e titulloi “Bahauallah”. Ai shkroi fletushka dhe libra të ndryshëm. Nga më të njohurat janë *el-Ikan* dhe *Kitabu'l-akdes*. Besohet se ato janë të bazuara në shpallje. Leximi për çdo ditë i një pjese nga ky libër është vaxhib (obligim fetar). Mirza Husein Ali Bahai llogaritet themeluesi i fesë. Sipas bahaizmit krijuesi i universit, Zoti i Madh, është i fshehur, emri dhe cilësitë e tij njihen nëpërmjet të të dërguarve të tij. Zoti është manifestuar në Bahauallahun, kurse cilësitë hyjnore janë dukur në Bahauallahun. Ai është edhe *zot* edhe *pejgmaber*, i cili bartë shpalljen deri te njerëzit. Ai gjithashtu është edhe “*mehdi*” dhe “*mesih*”, të cilin e presin të krishterët.⁵²⁰ Ai ka ardhur për bashkimin e feve botërore. Ai ka predikuar një doktrinë univesale. Sipas kësaj doktrine:

Kur’ani dhe ligjet e drejtësisë janë anuluar me pejgamberllëkun e Mirza Ali Muhamedit. Ibadetet dhe urdhërat e tjerë vlejné për ata të moshës 15-20 vjeçare, kurse për të tjerët nuk vlejné.⁵²¹ Ibadeti është individual. Ibadet me xhemaat nuk ka. Kible është varri i Bahauallahut në Akka. Viti bahai ka 19 muaj, të cilët kanë nga 9 ditë. Ditët prej 2-21 mars janë ditë agjërimi. Viti i ri fillon më 21 mars me Nevruzin. Haxh është vizita e shtëpisë së Bab-it në Shiraz dhe e shtëpisë së Bahauallahut në Bagdad.⁵²² Ditë feste janë ditë të ndryshme përvjetori. Gjatë këtyre ditëve puna është haram. Numri i këtyre ditëve është 9. Kanë tempujt të quajtura “*Masharik-i Ezka*”. Me qëllim që të bashkohen me fetë e tjera ata nuk përtojnë që bashkë me simpatizuesit e feve të tjera në tempujt e tyre të bëjnë ibadet së bashku. Për bashkimin e botës çdo nxënës duhet të mësojë një gjuhë internacionale. Për këtë arsye e përkrahin gjuhën esperanto. Porosisin që të qëndrohet larg politikës. Vetëm me fjalët “politika është një shenjë e zotit”, japin shenjë për marrjen me politikë atëherë kur të ketë nevojë.⁵²³ Në administrimin e komunitetit dhe në komentimin e librave me autoritet më të lartë është organizata “*Shtëpia univesale e drejtësisë*”. Anëtarët e saj zgjidhen me zgjedhje. Vendi i saj është turbeja e Bahauallahut në Akka.⁵²⁴ Qendra e komunitetit të tyre në Turqi është në Stamboll me emrin “*Vend tubimi i klerikëve bahai të Turqisë*”.

⁵¹⁹ Kadiyanilik, *AnaBritanika*, XII, f. 374-375.

⁵²⁰ Muhsin Abdulhamid, *İslam'a Yönelen Yıkıcı Hareketler*, (përkth. M. Saim Yeprem, Hasan Güleç), Ankara 1973, f. 173, 176, 220.

⁵²¹ N. Özsuca, *Bahai Dini*, Ankara 1967, f. 20-40.

⁵²² Özsuca, f. 40-41.

⁵²³ Abdulhamid, f. 215-238.

⁵²⁴ Özsuca, f. 20.

BIBLIOGRAFIA

- Abdulhamid Muhsin, *İslam'a Yönelen Yıkıcı Hareketler*, (përkth. M. Saim Yeprem, Hasan Güleç), Ankara 1973.
- Abdulkadir İnan, *Eski Türk Dini Tarihi*, Stamboll 1976.
- Abdullah Aydemir, *İslami Kaynaklara Göre Peygamberler*, Ankara 1992.
- Abdurrahman Küçük, *Dönmeler ve Dönmelik Tarihi*, Stamboll 1979.
- Abdurrahman Küçük, *Ermeni Kilisesi ve Türkler*, Ocak Yayınları, Ankara 1997.
- Abdurrahman Küçük, Sihizm, *AUIFD*, v. 28, 1986.
- Adnan Aslan, Batı Perspektifinde Dini Çoğulculuk Meselesi, *İslami Araştırmalar Dergisi*, nr. 2, 1998.
- Adnan Aslan, Dinlerde Mutlak Hakikat Kavramı, *İslami Araştırmalar Dergisi*, nr. 1, 1997.
- Ahmet Çelebi, *Yahudilik*, Stamboll 1978.
- Ahmet Hikmet Eroğlu, *Belgeler Işığında Osmanlı Devletindeki Yahudilerin Dini ve Sosyal Durumu*, (temë doktrature e pabotuar), Ankara 1996.
- Ahmet Hikmet Eroğlu, *Osmanlı Devleti'nde Yahudiler (Dini ve Sosyal Durumları)*, Seba Yayınları, Ankara 1997.
- Ahmet Turan, *İslam Mezhepleri Tarihi*, Samsun 1993.
- Albert M. Bernard, Katolik Mezhebi, *Din Fenomeni*, ed. M. Aydın, Konja 1993.
- Alfred Adam, *Lerhbuch der Dogmengeschichte*, v. 1, Gutersloch 965.
- Ali Demirsoy, *Kalıtım ve Evrim*, Ankara 1984.
- Ali İhsan Yitik, Hinduizm'in Diğer Dinler'e Bakışı, *II. Türkiye Dinler Tarihi Sempozyumu*, 8-9 Nëntor 1996.
- Ali Sayı, *Hz. Musa*, Stamboll 1992.
- Amiran Kurtkan, *Sosyolojik Açıdan Tasavvuf ve Laiklik*, Kutsun Yayınları, Stamboll 1977.
- Apokrif Petrus İncili*, (Përkth. Ekrem Sarıçioğlu), 19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, nr. 7, Samsun 1993.
- Avesta*, Die Heiligen Bucher der Parsen, Übersetzt von Fritz Wolf, Strassburg 1910, Berlin 1960.
- Ayşe Başaran, *Tıbbi Biyoloji*, Botim 4., botoi Bilim Teknik, 1996.
- Aziz Günel, *Türkiye Süryaniler Tarihi*, 29;
- B. Spuler, *Die Morgenlandischen Kirchen*, Leiden 1964.
- Bahaeddin Ögel, *Türk Kültür Tarihi*, Ankara 1962.
- Bahaeddin Ögel, *Türk Mitolojisi*, Ankara 1971.
- Baki Adam, *Katolik Kilisesinin Kurtuluş Öğretisi Açısından Diğer Dinlere Bakışı*, (temë e pabotuar), Ankara 1997.
- Baki Adam, *Yahudi Kaynaklarına Göre Tevat*, Ankara 1997.
- Baki Adam, Yahudiliğin Dini Açıdan Hıristiyanlığa ve İslam'a Bakışı, *II. Türkiye Dinler Tarihi Sempozyumu*, 8-9 Nëntor 1996.
- Barnabas İncili*, (Ky ungjill është edhe në shqip).
- Bernard Heller, Lokman, *İslam Ansiklopedisi*, v.VII, Stamboll.
- Bertold Spuler, *Die Morgenlandischen Kirchen*, Leiden 1964.
- Bertold Spuler, *Gegenwartslage der Ostkirchen*, Frankfurt 1968.
- Carl Klemen, *Die Religionen der Erde*, v. 1, Munchen 1966.
- Cecie Starr-Ralph Taggar, *Biology, the Unity and Diversity of Life*, Botim 5, California 1989.
- Chung Hwan Kwak-Thomas Cromwell, Unification Prensiplerinin Özü, *Sun Myung Moon'un Öğretisinin Esasları*, pa vend dhe kohë, f.3.
- Curth Nuthmann, Die Religiöse Gesellschaft der Freunde, in: *Glieder an Einem Leib*, f. 264-271.
- D. Howard Smith, *Congucius*, England 1974.

- Daumas Francois, *La Civilisation de l'Egypte pharaonique*, Paris 1967.
- David Goodblatt, Sanhedrin, *The Encyclopedia of Religion*, New York 1987, v. XIII, f. 61.
- Dunand Francoise-Zivie, *Coche Christiane. Dieux et Hommes et Egypte*, Paris 1991.
- E. A. Wallis Budge, *The Book of the Dead*, Bell Publishing Com. New York 1960.
- E. A. Wallis Budge, *The Gods of the Egyptians*, v. 2, New York 1969.
- E. Conze, *Der Buddhismus*, f.66.
- E. S. Drower, *The Mandeans of Irak and Iran*, Oxford 1937.
- Ebul A'la el-Mevdudi, *Kadiyanilik Nedir?*, (përkth. në turq. Ahsen Batur), İhya Yayınları, Stamboll 1975, f. 24.
- Eduard Meyer, *Geschichte des Altertums*, v. 1-2, Stuttgart 1954.
- Eduard Schweizer, *Jesus Christus*, Munchen-Hamburg 1968, f. 12.
- Ekrem Sarıkçioğlu, *Dinlerde Mebdi Tasavvurları*, Samsun, 1997.
- Ekrem Sarıkçioğlu, Kur'an ve Arkeoloji Işığında Hz. Nuh ve Tufan Olayına Yeni Bir Yaklaşım, *İslami Araştırmalar Dergisi*, v. 9, numri 1-4, 1996.
- Ekrem Sarıkçioğlu, Kur'an'a Göre Müşrikler, *İslami Araştırmalar Dergisi*, Korrik 1986.
- Ekrem Sarıkçioğlu, *L. Ron Hubbard ve Sayentoloji*, 19 Mayıs Üniversitesi IFD, nr. 1-2.
- Erich Geldbach, *Freikirchen*, Gottingen 1989.
- Erik Hornung, *Les Dieux de l'Egypte*, Paris 1986.
- Erman Adolphe, *Des Pharaons*, Paris 1939.
- Ernst Benz, *Neue Religionen*, Stuttgart 1971.
- Ernst Sellin dhe Georg Fohrer, *Einleitung in das Alte Testament*, Botimi 10, Heidelberg, 1965.
- Ernst Zbinden, *Eski Ortadoğu ve İslam Ülkelerinde Cin İnancı*, Stamboll, 1996.
- Ernst Zbinden, *İslam'da ve Eski Doğu'da Cin ve Ruh İnançları*, Stamboll: Yeni Ufuk Neşriyat 1997.
- Esat Uras, *Tarihçe Ermeniler ve Ermeni Meselesi*, Stamboll 1987.
- Ezra Pound, *Konfüçyüs*, (përkth. Ahmet Yücel), Stamboll 1981.
- F. Heiller, *Die Religionen der Menschheit*, f. 632.
- F. S. Vidal, *Al-Hixhr*, E.I.IV, f. 365.
- Filip İncili*, (përkth. Ekrem Sarıkçioğlu), 19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, nr. 6, Samsun 1992, f. 1-20.
- Firuzan Kinal, *Eski Anadolu Tarihi*, Ankara 1962.
- Fridrich Heiler, *Die Religionen der Menschheit*, Stuttgart 1959.
- Friedrich W. Haack, *Die neuen Jugendreligionen*, v. 1-2, Munchen 1980.
- G. Filoramo, *A History of Gnosticism*, Oxford 1990.
- G. Quispel, *Gnostik Studies*, Stamboll 1974.
- Günay Tümer-Abdurrahman Küçük, *Dinler Tarihi*, botimi 2, Ankara 1993.
- Gunther Balders, *Der Bund Evangelisch-Freikirchlicher Gemeinden in Deutschland*, in: *Glieder an Einem Leib*, Hrsg.: Hans-Motel, Konstanz 1975.
- Gunther Lanckowski, *Heilige Schriften*, Stuttgart 1963.
- Gustav Mensching, *Die Religionen*, Munchen, pa datë.
- H. Jonas, *The Gnostic Religion*, Beacon Hill 1994.
- H. Jonas, *The Knowledge of Life*, Oxford 1994.
- H. Reller, *Handbuch Religiöse Gemeinschaften*, botim 2, Gutersloh 1979. .
- H. Schmokel, Sümer Dini, (përkth. Turhan Özdemir), IFD, v.19 dhe v.21.
- H. Viogot, *Die Evangelisch-Methodische Kirche*, in: *Glieder an Einem Leib*. Pa datë.
- Hanna Aksöz, *Şammasların Rütbeleri*, Mardin 1960.
- Hanna Dolaponu, *Tarihçe Mardin*, Stamboll 1972.
- Hans Beat-Motel, *Glieder an einem Leib*, Konstanz 1975.
- Hans Findeisen, *Schamanentum*, Stuttgart 1957.
- Hans Joachim Schoeps, *Das Judentum*, Bern 1964.
- Hans Joachim Schoeps, *Religionen*, Gutersloh 1961, 1964.
- Hans Joachim Schoeps, *Theologie und Geschichte des Judentum*, Tubingen 1949.
- Hans Küng-Joseph van Ess, *Christentum und Weltreligionen, Islam*, Munchen 1987.
- Hartmut Gese, *Die Religionen Altsyriens, Altarabiens und der Mandaer*, Stuttgart 1970.

- Helmer Ringgren, *Religions of the Ancient Near East*, London 1973.
- Helmut von Glasenapp, *Die Nichtchristlichen Religionen*, Frankfurt am Main 1963.
- Helmut von Glasenapp, *Die Religionen Indiens*, Tübingen 1943.
- Hikmet Tanyu, *Dinler Tarihi Araştırmaları*, Ankara 1973.
- Hikmet Tanyu, *Tarih Boyunca Yahudiler ve Türkler*, Stamboll 1977
- Hikmet Tanyu, *Türkiye'de Dinler Tarihinin Tarihçesi, İlahiyat Fakültesi Dergisi*, Ankara 1961.
- Hikmet Tanyu, *Yehova Şahitleri*, Ankara 1973.
- Hıristiyan İnanç*, (Türkiye Katolik Yayınları), Stamboll 1994.
- Hıristiyanlarda Çocukluk İncili*, I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu, Samsun 1992.
- Hofner, Gese dhe Rudolph, *Die vorislamische Religionen Arabiens: Die Religionen Altsyriens, Altarabiens und der Mandaer*, Stuttgart 1970.
- Horst Reller, *Handbuch religiöse Gemeinschaften*, Gutersloh 1979.
- Hüseyin Atay, *Kur'an'a Göre Araştırmalar*, v. I.-IV, Ankara 1993.
- Huzejfe Sayim, *Sib Dininin Kurucusu Guru Nanak'ın Hayatı ve Öğretileri*, (temë magjistrature e pabotuar), Kajseri 1986.
- İbn al-Kalbi, *Putlar Kitabı*, (përkth. Beyza Düşüngen), Ankara 1969.
- İbn Fadlan Seyahatnamesi*, (përkth. Ramazan Sesen), Stamboll 1969.
- İbrahim Kafesoğlu, *Eski Türk Dini*, Ankara 1980.
- İbrahim Özdemir, *Dinler Arası Diyalog*, *Zaman Gazetesi*, 24 Janar 1998.
- İbrani Din Bilgisi*, Türkiye Hahambaşlığı, Stamboll 1992.
- İbrani Tomas İncili*, XX.; I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu, Samsun 1992.
- İbraniler İncili*, (përkth. Ekrem Sarıçioğlu), I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu, Samsun 1994.
- İlhan Güngören, *Buda ve Öğretisi*, Stamboll 1981.
- Isidore Epstein, *Judaism*, G. B. 1979.
- İslam Ansiklopedisi*, Türkiye Diyanet Vakfı.
- J. P. Asmussen, *Manichaeen Literature*, New York 1975.
- J. Sagesses Leveque, *de l'Égypte ancienne*, Paris 1983.
- Jacq Christian, *Nefertiti et Akhenaton*, Paris 1990.
- Jak V. Kamhi, *500 Yil Vakfı (Raporu)*, Stamboll 1992.
- James Hewitt, *Yoga*, London 1970.
- James Mellaart, *Excavation at Hacilar*, v. 1-2, Edinburg 1970.
- Joachim Wach, *Vergleichende Religionsforschung*, Stuttgart 1961.
- Job Samuel Terrin, *The Encyclopedia of Religion*, VIII.
- Johannes Lahnamann, *Weltreligionen im Unterricht, Teil I, Fernostliche Religionen*, Gottingen 1986, f.165.
- John D. Davis, *The Westminster dictionary of the Bible*, Philedelphia 1944.
- Kadiyanilik*, AnaBritanika, XII, f. 374.
- Kamuran Birand, *İlk Çağ Felsefesi Tarihi*.
- Kemal Özbay, *Süryaniler, Kadim Süryaniler ve Türkler'deki Durumları*, Stamboll 1975.
- Kitab-ı Mukaddes*.
- Kolpaktchy Gregoire, *Le livre des Mort des anciens égyptiens*, Paris 1991.
- Kur'an-i Kerim*.
- Kurt Rudolf, *Die Mandaer*, Gottingen 1960-1961.
- Kurt Rudolf, *Gnosis, the Nature of History of an Ancient Religion*, Edinburgh 1983.
- Kurt Rudolf, *Theogonie, Kosmogonie und Anthropogonie in den Mandaischen Schriften*, Gottingen 1965.
- L. Cinillo-A. Roselli (ed.), *Codex Manichaicus Coloniensis*, Merra Editare Cosenna 1986.
- Lalouette Claire, *Textes sacres et textes profanes de l'ancienne Égypte*, Paris 1987.
- Lao Tzu, *Taoizm*, (përkth. në turq. Mukaddere N. Özerdim), botimi 2., Ankara 1963.
- Leyla Alberti, P. Xavier Jacob, P. Luigi Iannitto, Nilay Hıdıroğlu (ed.), *Hıristiyan İnanç*, Türkiye Katolik Kilisesi Yayınları, Stamboll 1994.
- M. E. Yamauchi, *Mandaic International Texts*, New Haven 1967.
- M. F. et Guy, *Dictionare dela civilisotion égyptienne*, Paris 1970.

- Mahmud Esad es-Seydişehir, *Tarib-i Edyan*, Stamboll 1912-1913.
- Manfred Korfmann, Demircihoyuk, *Türk Arkeoloji Der.*, XXV-1, Ankara 1981.
- Maria Hofner, von Harmut Gese, Maria Hofner, Kurt Rudolph, Die vorislamische Religionen Arabiens, *Die Religionen Altsuriens, Altarabiens und der Mandaer*, Stuttgart 1970.
- Martin Werner, *Die Entstehung des Christlichen Dogmas*, botim 2, Tubingan 1941.
- Maurice Borrmans, *Müslimanlar'la Hıristiyanlar Arasında Diyaloga Yönelişler*, Stamboll 1988.
- Maurice Bucaille, *Tevrat, Inciller ve Kur'an*, përkth. M. Ali Sonmez, Konja 1979.
- Mehmed Şemseddin, *Tarib-i Edyan*, Dersaadet 1338.
- Mehmet Aydın, *Din Fenomeni*, Konja 1993.
- Mehmet Çelik, *Süryani Kadim Taribi*, Stamboll 1987.
- Mehmet Taplamacıoğlu, *Din Sosyolojisi*, Botimi 2, Ankara 1975.
- Mehmet Taplamacıoğlu, *Karşılaştırmalı Dinler Taribi*, Ankara 1966.
- Mircea Eliade, *Die Religionen und das Heilige*, Salzburg, 1954.
- Mircea Eliade, *Schamanismus und archaische Ekstasetechnik*, Zurich und Stuttgart, pa datë.
- Mithat Sertoğlu, *Süryani Türklerin Siyasi ve İctimai Taribi*, Stamboll 1974.
- Montet Pierre, *L'Égypte éternelle*, Paris 1970.
- Moret Alexandre, *Le Nil et la civilisation égyptienne*, Paris 1929.
- Muhamed Ebu Zehra, *Hıristiyanlık Üzerine Konferanslar*, Stamboll 1978.
- Muhammed Esad, *Kur'an Mesajı*, Meal Tefsir, İşaret Yayınları, 1998.
- Muhammed Hamidullah, *Dinler Taribi Konferansları*, 3 Prill, Erzurum 1977.
- Muhammed Hamidullah, *İslam Peygamberi*, Stamboll, 1966.
- Muhsin Abdulhamid, *İslama Yönelen Yıkıcı Hareketler*, (përkth. M. Saim Yeprem, Hasan Güleç), Ankara 1973.
- Muslim*, Zuhd, kapitulli: 10
- Mustafa Erdem, *Hız Adem*, Ankara 1993.
- Mustafa Erdem, Kıpti Kilisesi Üzerine Bir Deneme, *AUIFD*, nr. 35.
- N. Özsuca, *Babai Dini*, Ankara 1967.
- Necla Başgün, *Türk-Ermeni Münasebetleri*, Stamboll, pa datë.
- Neşet Çağatay, *İslam Öncesi Arap Taribi ve Cahiliye Çağı*, Ankara 1971.
- Nisim Behar, *Ibrani Taribi*, Stamboll 1979.
- Nureddin Ali b. Abi Bekr el-Heysemi, *Mexhmu-ez-Zevaid ve Mendau'l-Fevaid*, v. 9, botim 2., Bejrut 1967.
- Olivier Clement, Ortodoks Mezhebi, *Din Fenomeni*, ed. M. Aydın, Konja 1993.
- Ömer Faruk Harman, Danyal, *İslam Ansiklopedisi*, VIII, f. 480-481.
- Ömer Hilmi (Budda), *Hint Dinleri*, Stamboll 1935.
- Ömer Rıza Doğrul, *Yeryüzündeki Dinler Taribi*, Stamboll 1963.
- P. Bargiut, *Les Textes des Sarcophages égyptiens du Moyen Empire*, Paris 1986.
- P. Oskar Simmel, R. Stablin, *Christliche Religio*, Frankfurt 1964.
- P. Xavier Jacob, *Hıristiyan Kiliseleri ve İbadet Yerleri*, Stamboll 1994.
- Paul Carus, *Buda'nın Öğretisi*, (përkth. Teoman Uçkun), Stamboll 1984.
- Peter Foth, Die Mennoniten, in: *Glieder an Einem Leib*, Krsg. H. Motel, Konstanz 1975.
- R. Cameron-A. J. Dewey, *The Cologne Mani Codex*, Scholars Press 1979.
- R. de Vaux, İsrail Oğullarının Mısır'a Yerleşmesi ve Yusuf Kıssası, *19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, V. 3, Samsun 1989.
- R. Faulkner, *The Ancient Egyptian Pyramid Texts*, v. 2, Oxfprd 1969.
- Ramazan Şeşen, *İbn Fadlan Seyahatnamesi*, Stamboll 1975.
- Ramyana*, (përkth. O. R. Doğrul), Stamboll 1975.
- Robert F. Weaver-Philip W. Hedrick, *Genetics*, Iowa 1989.
- Roland de Vaux, *İsrail Oğullarının Mısır'a Yerleşmesi ve Yusuf Kıssası*, (përkth. Siddik Yücel), 19 Mayıs Üniversitesi IFD, nr. 3, Samsun 1989.
- Roland de Vaux, *The Early History of Israel*, London 1971.
- Rudolf Wrede, *Worte des Konfuzius*, Munchen, pa datë.
- S. N. C. Lieu, *Manichaeism*, Manchester University Press 1985.

- Şaban Kuzgun, *Dinler Tarihi Dersleri*, v.1, Kajseri 1993.
- Şaban Kuzgun, *Dört İnciller Farklılıkları ve Çelişkileri*, Stamboll 1991.
- Şaban Kuzgun, *Hazır ve Karatay Türkleri*, Ankara 1985.
- Şaban Kuzgun, *Hz. İbrahim ve Haniflik*, Ankara 1985.
- Sadettin Buluç, Şaman, *İslam Ansiklopedisi*, v. 11.
- Sadi Koca, *Tarih Boyunca Ermeniler ve Türk-Ermeni İlişkileri*, Ankara 1967.
- Saliba Samun, *Antakya ve Doğu Sayın Patriki Kadesetli Mar İgnatios 3. Yakub'un Hindistan Süryani Kilisesine Resuli Ziyaretleri*, Stamboll 1965.
- Samuel Akdemir, *Dini Kurallarımız*, Stamboll 1972.
- Şankara, Tefrik Etme Hazinesi (përkth. Mehmet Ali Işın), Dergah, Stamboll 1976.
- Sedat Veyiş Örneç, *100 Soruda İlkelerde, Din, Buyu, Sanat, Efsane*, Stamboll 1971.
- Şinasi Gündüz, Kur'an'daki Sabiiler'in Kimliği Üzerine Bir Tahlil ve Değerlendirme, *I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu*, Samsun 1992.
- Şinasi Gündüz, *Son Gnostikler, Sabiiler, İnanç Esasları ve İbadetleri*, Ankara 1995.
- Sophy Hoare, *Yoga*, Stamboll 1978.
- Stephan Teplan, *Christen in der Turkei*, Weltbild (30 Janar 1998) Nr. 3.
- Suleyman Ateş, *Kur'an-i Kerim ve Yüce Meali*, Ankara.
- Suleyman Ateş, *Yüce Kur'an'ın Çağdas Tefsiri*, v. 5, Stamboll 1990.
- Suzan Alalu, Klara Arditi, Yahudilikte Kavram ve Değerler, *Gözlem Gazetecilik Basım ve Yayın (A.S.)*, Stamboll 1996.
- Tahsin Özgüç, *Die Bestattungsbrauche im vorgeschichtlichen Anatolien*, Ankara 1948.
- Tahsin Özgüç, Öntarihte Anadolu Ideollerinin Anlamı, *Dil ve Tarih Cografya Fakültesi Dergisi*, v. 2, Ankara 1943.
- Talat S. Halman, *Eski Mısır Şiiri*, Stamboll 1972.
- The Talmud*, trans. H. Polano, London, New York 1978.
- Thomas Cleary, *Konfüçyüs*, Stamboll, pa datë.
- Thomas Michel, *Hiristiyan Tanrı Bilimine Giriş*, Stamboll 1992.
- Traunecker Claude, *Les Dieux de l'Egypte*, Paris 1991.
- U. Bahadır Alkım, *Anatolien I.*, Genf 1968.
- Ünver Günay-Harun Güngör, *Başlangıçtan Günümüze Türklerin Dini Tarihi*, Stamboll 1997.
- Upaşıadlar, (ed., M. Ali Işın), Stamboll 1976.
- V. Gordon Childe, *Doğu'nun Prehistoryası*, përkth. Şevket A. Kansu, Botimi 2, Ankara 1971.
- W. F. Albright, *The Archaeology of Palestine*, London 1949.
- W. Foerster, *Gnosis, I. Patristic Evidence*, Paris 1972.
- W. Hinz, *Zarathustra*, Stuttgart 1971.
- W. Sibiryadan Radloff, (përkth. Ahmet Temir), V. 1, Libri 2, Stamboll 1975.
- Walter Krickeberg, *Die Religionen des Alten Amerika*, Stuttgart 1961.
- Wilhelm Kiefel, *Die Heilsarmee: Glieder an Einem Leib*.
- Wilhelm Wohrle-Heinz Adolf Ritter, *Der Bund Freier Evanelischer Gemeinden in Deutschland*.
- Wolfgang Meissner, *Der Christliche Gemeinschaftsverband*, in: *Glider an Einem Leib*, Konstanz 1975.
- Xavier Jacob, *Sorabilir miyiz?*, Stamboll 1992.
- Yakub İncili*, (përkth. Ekrem Sarıncıoğlu), *I. Türkiye Dinler Tarihi Araştırmaları Sempozyumu*, 24-25 Shtator 1992, Samsun 1992.
- Zefer ul-Islam Han, *Yahudilik'te Talmud'un Mevki ve Prensipieri*, (përkth. M. Aydın), Stamboll 1981.

TREGUESI I EMRAVE

A

Abdurrahman Küçük, 29, 42, 305, 381, 437, 439, 563
adoptianismi, 502
Adventistët, 586,-7, 590
Aforizmat e Sulejmanit, 418-9
Afrika, 436, 551, 595-6
Afrodita, 59, 110, 146, 155
Aftartodoketizmi, 560
ahireti, 444, 628, 638
Aja Sofia, 495
Akad, 60, 70
alkooli, 66, 577, 610
All-llahu, 43, 45-8, 68, 72, 86, 111-2, 116, 120-2, 124, 132-4, 136-8, 382, 385, 387-8, 390-1, 393-4, 396, 397, 402, 415, 445, 447, 457, 509, 513, 612, 615-8, 620-3, 625-32, 634-8, 640-1
Amerika, 291, 296, 412, 437, 574, 580, 589-90, 592-3, 599-600, 602, 605, 609
Anu, 58, 62, 67, 69
Antikrishti, 539
Antu, 58
apologjetika, 33
Apostoli, 557, 594
apostolike, 494, 585, 594
apostulli, 470-1, 477, 484, 489, 526
arianizmi, 591
Ariusi, 470, 497, 498
arkonë, 254, 255, 256
ashkenazimi, 383
asiriane, 6-1
ateizmi, 316
Athanasiusi, 499
Ati, 491, 497-9, 501-2, 504, 506-7, 509-10, 520, 531, 549
avataranë, 618
Azeri, 68

B

Baali, 107, 400
Babiloni, 56, 60-2, 66, 70-3, 198, 382, 399, 404-5, 407-8, 413-5, 418,

422, 427

Ballkani, 199, 557
banorët e shpellës, 493
baptistë, 577, 578
berzahu, 623
besimi, 49, 51, 81, 95, 99, 129, 141, 147, 159, 185-6, 196, 198, 201, 240, 252, 280, 329, 331, 343, 345, 361, 367, 377, 386, 389, 401, 412, 414, 424, 476, 490, 510, 515, 544, 602, 604, 606, 619, 635-6
Betlehemi, 424
Bhagavadgita, 270, 271
Bijat e Izraelit, 83, 126, 387, 389-90, 392, 395, 399, 402, 404, 408, 413, 418, 428
Biri, 460, 504, 506-7, 509, 531, 549
biri i njerëzisë, 505
Biruni, 229, 248-9
brahmanizmi, 267
bronzi, 52
Buda, 259, 299, 309-13, 315-8, 320, 323, 327-8, 332-3, 335-6, 338-41, 601, 603, 627
Burdur Hacılar, 53

C

Calvin, 546
Ciceroni, 27, 35, 155
credo, 531
Cyrill, 559

D

Dalajlama, 336-8
Danieli, 72-3, 404, 419
daru'l-funun, 38, 39, 40
Davidi, 394
demiurgu, 221, 238, 278, 491, 617
Dhiata e Vjetër, 71, 110, 127, 129, 173, 180, 375, 394, 396, 401-2, 407, 417-9, 431, 445, 455, 465, 477, 491, 511, 514, 588-9, 617
Dhiata e Re, 108, 465-6, 470-3, 488, 491-2, 498, 512, 514, 540, 578, 624
dbimmi, 228, 231
Dhu'l kijnl, 403
dialogu, 556, 587
diaspora, 405
Dielli, 45, 77, 109, 122, 131, 133, 171, 185, 255

Dingir, 58
diofizitizmi, 571
Dionisiusi, 497
Drashia d Jahja, 232
dualizmi, 167, 220, 221, 234, 416, 619
Dumuzi, 59, 63

E

E-an-na, 58
Ebionitët, 481
Ebu Mensur Bagdadit, 33
Ebu Nasr Mutahhir ebn Tahir el-Makdisit, 33
Edom, 54
Egjipti, 74, 76, 105, 136, 141, 156, 386-8, 395,
398, 427, 502, 568
Ehl el-kitab, 48, 626
Ekrem Sarkçioğlu, 21, 25, 30, 342, 424, 445, 447,
450, 473
el-Bagdadî, 229
el-Bakillani, 34
el-Fark bejne'l-Firak, 33
el-Milel ve'n-Nihal, 32, 34
Emile Durkheim, 36
Enki, 58, 62, 63
ensar, 614
Epifaniusi, 462, 480
Ernest Renan, 37
Esatir, 41
Esfarani, 34
eskatologjia, 240, 259, 405
essenitët, 218, 415, 444
Europë, 410, 432, 439, 530, 580, 585, 599-600,
602, 606, 609
Ezekieli, 71-72
ezel, 620
ezoterike, 25, 232, 356, 378, 607, 643
Ezra, 202, 351, 406-7, 419, 650

F

Faraoni, 384, 386, 397, 404
farizitët, 444
Fatih sulltan Mehmeti, 565
fe botërore-natyrore, 32
fe jo të vërteta, 32
fe kombëtare-nacionale, 31
fe që bazohen në shpallje, 32
fe të vërteta, 32
fe tradicionale, 31, 179
fe universale, 31
fenomenologjia fetare, 28, 37
Festa së Pashkëve, 453, 508, 523
Fetë babilonase, 60-1
fetë e vdekura, 23
fetë indiane, 34, 41, 310, 631

fetë romake, 35, 140
filozofia e fesë, 23, 32
fise primitive, 51
fraksione, 24, 33-4, 42, 165, 197, 218, 266, 272,
277, 285, 292, 314, 318, 331-2, 345, 415, 442,
460, 465, 543, 547, 557, 572-3, 576, 595-6, 599,
602, 604, 641
Franca, 578

G

Gautama, 311, 313
Gerardus van der Leeuwit, 37
gërmimet arkeologjike, 56, 62, 113, 181
getto, 436
Gilgamiş, 57
Ginza, 232, 234, 235
gnosis, 223, 224
gnosticizmi, 218, 223, 224
gnostike, 25, 217-21,
224-5, 245, 248, 251, 255, 258, 431, 479, 491-2
Gregori, 533, 537, 564
Günay Tümer, 42, 437

Gj

Gjon pagëzori, 446
Gjoni, 71, 219, 446, 449, 451, 458, 465, 468,
470-1, 473, 501-3, 517, 632-3

H

hallall, 429, 620
Hamurabi, 60-1, 63, 69, 422
Hanna, 447, 473, 558
haram, 123, 425, 429, 620, 640, 642, 646
Harani, 69
Haruni, 386, 388, 390, 626
Haruti, 66, 623
Hassidizmi, 433, 435
hatemu'l-enbija, 628
Havva, 45, 48, 239, 257, 511
hebraizmi, 112, 142, 179, 218, 382, 408, 412-3,
415, 430, 436-8, 440, 441, 455, 458, 476, 488,
493, 500, 604, 639
Hebrenjtë, 231, 399,
405-6, 411, 413, 426-7, 440, 443, 476, 482
hebreo-krishterët, 480, 482-5, 514
Hëna, 45, 122, 131, 133, 255
henoteizmi, 182, 276
Herodos, 231, 448
Herodoti, 35, 56, 181
Hezekijel, 64
Hidri, 391
hieroglif, 56, 75-6, 87
Hilmi Ömer, 41

Hira, 613
 historia e feve, 23, 25, 27-32, 35-8, 40-2, 170, 543
 hixhri, 33, 34, 614
 humanizmi, 540
 Hyjneshat Kryesore, 57
 hyjnesha, 53, 58, 62-3, 79, 81, 108, 144, 154, 159, 190
 hyjnitë, 35, 90, 95, 338, 345, 364
 Hz. Ademi, 45, 48, 54
 Hz. Ibrahimit, 63, 69, 70, 382
 Hz. Llokmani, 396
 Hz. Nuhi, 54, 67, 68, 134

I

Ibën Miskevejh, 47
 Ibën Mukaffa, 33
 Ibën Nedim, 229, 248
 Ibrahimit, 62, 68-9, 112, 114, 120-2, 124, 126, 136-7, 626
 idhujtarët, 142, 469, 476-9, 491, 536, 636
 Idrisi, 54, 111, 626
 Iljazi, 400
 Imran, 122, 138, 445-7, 449, 450, 456-7, 459, 473, 623
 Inanna, 58-9, 63
 induizëm, 267, 295, 332, 618, 633
 inkuizicioni, 537
 Inxhil, 34, 467, 514, 623-4
 Irem, 54, 113, 115, 119
 Isai, 230-1, 259, 366, 443-4, 448, 456, 458, 461, 624-6, 632, 633, 643
 Ishaja, 402, 617
Islam Ansiklopedisi, 39, 72, 116, 179, 396
 islami, 24, 48, 305, 397, 415, 441, 502, 506, 612, 620-2, 627, 629, 631, 635, 636, 640

J

Jahja, 230, 232, 444-5, 459
 Jahve, 142, 380, 409, 588
 Jakobi, 471, 476, 479, 481, 483, 529, 559
 Jang, 345, 377
 Jean Heringit, 37
 Jeremja, 402
 Jerusalem, 152, 230, 398, 402, 405, 407, 443, 448, 450, 482, 488, 495, 523, 529, 566, 585
 jevm, 45
 Jezusi, 374, 380, 443, 447, 449, 450-2, 454-8, 460, 462, 464-5, 467, 470, 472, 474, 477, 479, 484-6, 490-1, 495, 497-500, 502-6, 508, 511, 514-5, 518, 523, 526, 528-9, 543, 546, 548-50, 560, 562, 572, 574, 585-9, 592-5, 597
 Jezusi historik, 497
 Jin, 345, 377
 Joga, 268, 287, 293-7, 319
 jogizmi, 266
 Johannes Hus, 539
 Josefi, 448-50, 504
 Junusi, 404, 626
 Jusha b. Nuni, 393
 Justiniani, 495
 Jusufi, 75, 81-3, 626

K

Kabbala, 415, 431-2, 434-5
 kada, 631
 Kader, 631
 Kalki, 279, 633
 kalkolite, 53
Karai, 439
 Kargo, 379
 karma, 273, 275, 283, 295, 302-3, 318-9, 326, 600, 607, 635
 Karma, 274, 279, 283, 319, 373
 kast, 275
 katolicizmi, 460, 541, 547
 katolike, 372, 483, 491-2, 496, 501, 506, 511, 522, 530, 537, 539, 545, 547-9, 561, 566, 576, 585
 Ki, 58
 kiamet, 628
Kipur, 426
keisas, 616, 641
 Kisha, 411, 419, 455, 468, 504, 507-8, 524, 526, 528, 530, 536, 545, 548-9, 551-5, 557-8, 560, 562-4, 567-9, 588-90, 596, 597
 kisha katolike, 492
 Kisha ortodokse maqedone, 553
 Kisha ortodokse serbe, 553
 Kishat ortodokse kombëtare, 557
 Kisha ortodokse shqiptare, 554
klerikëve, 64-5, 233, 309, 550, 554, 620, 646
 Kolasta, 232
 Komuniteti Heindel Rosenkreuzer, 602
 koncili i Apostujve, 480
 koncili i Nikesë, 499, 617
 Konfuçi, 351, 353-7, 359, 362, 627
 Konstantini, 494, 532
 Konstantinopoja, 495
 Konya Çatal Hoyuk, 53
 Krishna, 270, 286, 289, 290
 Krisht-Hristos, 506
 krishterizmi, 34-5, 48, 180, 196, 199, 218, 411-2, 441-2, 454-5, 457, 459, 461, 476-8, 483, 487-8, 491, 494, 500, 502, 509, 514-6, 519, 546, 551,

553, 558, 563-4, 570, 585, 587, 599, 608, 618, 639
 kristotokos, 571
 Kryepeshkopata e Ohrit, 553
 Kryqëzatat, 538
 Kryqi, 512, 520, 526
 kulti, 59, 79-81, 91, 97, 101, 110, 131, 133, 135, 139, 140, 144-6, 150-1, 155, 159, 178, 185-6, 247, 276, 335, 346, 360, 366, 379
 kungimi, 515, 523, 548, 551, 563
 Kur'ani, 24, 33-4, 43, 45, 49, 54, 63, 84, 102, 114-6, 122, 124, 132, 136, 201, 339, 389-91, 393, 397, 407, 415, 417, 428, 444-6, 449, 456-8, 483, 500, 513-4, 615-7, 620, 623-6, 628-30, 633-4, 639, 641, 646
 kurban, 53, 85, 98, 109, 123, 134-5, 145, 150-2, 159, 165, 167, 173, 175, 186-7, 189-90, 204, 244, 277, 281-2, 288, 346, 359, 362, 366, 479, 490, 492, 511, 592

L

lajuhti, 556
 Lama, 175, 336-8
 lamaizmi, 197, 335
 Laotse, 346-51
 Letrat e apostujve, 471, 624
 Letrat e Palit, 492
 librat e shenjtë, 112, 230-1, 233-4, 246, 374, 492, 494, 514, 626
 Logosi, 603
 Lufta e Parë Botërore, 37
 Lun-Yü, 353-4, 357, 360
 Luteri, 541, 544-6

M

magji, 35, 52, 92, 204, 226, 232, 257, 334, 432, 536, 623
 Mahatma Gandhi, 271
 Maimonides, 441
 Mali Sina, 388
 Malka d Hshuka, 234-5, 242
Malka d Nbura, 233-5
mana, 35, 220
 manda, 223, 240
 Manda d Hiia, 236, 238, 240
 mandene, 219, 227, 233
 mandi, 247
 Mani, 198, 248-9, 251-2, 259, 261, 339
 maniheizmi, 264
 Maria, 113, 129, 249, 447, 449, 498-9, 503, 505, 509-10, 549-50, 557, 571-2
 Marsioni, 455, 491
 martesë, 115, 123, 239, 262, 336, 397, 429, 515, 548, 563

Martin Buber, 435
 Martin Luteri, 490
 Maruti, 66, 623
masiqta, 243
 Max Mullerin, 36
 Max Schelerit, 37
 mbishkrimet, 85, 102, 131, 162-4, 185, 193
 Medine, 614-5
 Mehdi, 41, 279, 342, 424
 Mehmet Aydın, 42, 381, 432, 436
 mëkati, 260, 358, 375, 400, 426, 479, 511, 518, 526, 550, 572
 Mekke, 121, 133, 615, 640
 melekët, 64, 66, 405, 409, 415, 434, 513, 617, 620-1, 623
 Menora, 430
 Merjem, 48, 54, 122, 249, 390, 445, 447, 449, 459, 473
 Mesia, 241, 380, 410, 423, 453, 458, 460, 464, 485, 595, 597
 mesianizmi, 486
 Mesihu, 423-4, 445-6, 451, 643
 Mesopotamia, 56, 67, 76, 80, 90, 103, 105, 107-8, 112, 130, 218, 248, 399, 404-5, 446, 559, 564, 570
 mezolite, 50, 102
 mirosja, 515-6, 563
 Mirza Husein Aliu, 645
 Mishna, 420-1, 435
 misteritë i priftërve, 515
 misticizmi, 270, 431-2, 435
 Mitologjia krahasuese, 36
 Mitra, 96, 204, 210, 255, 487
 Moisiu, 485
 monarshianizëm, 591
 monoteizmi, 24, 67-8, 81, 83, 111, 121, 142, 306, 318, 402, 441
 mu'xhize, 387
 muderris, 39
 Muhamedi, 292, 377, 612-4, 627-8, 632-4, 644-5
 Muller, 36
 Mürüvvet Kurhan, 25, 74
 Musai, 75, 384-90, 392, 407, 413, 617, 626

N

Nag Hammadi, 219, 473
 Nemrut, 69
 neolite, 50, 52-3, 103
 nestorianë, 572-3
 nestorianizmi, 199, 572
 Nike, 499
 Ninurta, 59, 64
 Nirvana, 317, 320, 325, 327, 331, 341, 631

- Njeriu i Parë, 254-5
 Nuhi, 112-5, 626
- O**
 ortodoksozmi, 547
- P**
 pagëzimi, 155, 226, 243, 446, 515-6, 527, 548, 563, 578
 paleolite, 53, 102
 Pali, 310, 315, 454, 457, 463, 475-8, 484, 486-8, 490, 497
 panteizmi, 276
 Papati, 495, 517, 528, 532, 534
 Papa, 495, 529, 533-4, 539, 542, 549, 565
 paralelizmi, 181, 204, 218, 372, 454, 473, 513
 parsizmi, 619
 Pashkë, 519, 557
 patrik, 552, 561, 564, 566, 573
 Pejgamberi, 49, 117, 348, 422, 614-5, 628, 639-40, 645
 pendimi, 263, 426, 446, 515, 548, 563
 Pentakost, 507-8, 522
 Perandoria Asiriane, 61
 Perandoria Romake, 80, 410, 493
Peshitta, 564
Phallus, 116, 145, 366
Philo, 434
 Pjetri, 495, 507, 529, 534, 549, 563
 Plutarch, 35
 politeiste, 55, 61, 65, 142, 267
 politeizmi, 67, 128, 485, 497, 618, 620-1
 pozitiviste, 23, 36-7
 Prashai Siva, 241
 profetët, 452-3, 514
 protestantizmi, 421, 460, 543, 547
 Psallmet, 396, 418
 Ptahili, 237-8, 242
 Ptartolatrizëm, 560
 Purna, 332, 333
- Q**
 Qabesë, 60, 137, 138, 614
 qytetërimi, 57
- R**
Rabbani, 439
 Ramajana, 270-1
 rasta, 246
 reinkarnacioni, 290, 306, 317, 319, 343
religio, 27
 religionet krahasimtare, 28
reliquine, 536
 Renesanca, 540
 rimishërimi, 258, 280, 413
 rish ama, 245
 Rocy Cross, 601
 Roma, 36, 59, 150-2, 154-5, 231, 416, 443, 447, 452, 458, 492, 495, 497, 528-32, 538, 540
 Rudolf Ottosë, 37
 Ruha, 235, 237
- S**
 Sabataj Sevi, 433
 sabii, 227-8, 242, 243, 246
 sabiizëm, 245
 saddukitët, 444
 Said Fejumi, 33
 sajentologji, 343
 sakramenti, 515
 samiritë, 399
 Sankya, 309
 sansara, 302, 319
 Sargoni I., 63, 70, 422
 satani, 513
 Saul, 394-5, 487
schisma, 530
 sefardin, 383
 Selaniku, 439
 Selman Farisiu, 482
 sihizmi, 305, 307
 Simon, 431, 444, 464, 471, 597-8
 Sin, 62-3, 96, 108
 sinagogat, 486
 skematik, 56
 skolastika, 34
 Solomoni, 397
Sophia perennis, 28
 Spiritizmi, 604, 606, 608
 spiritualizëm, 605, 607
 Stambolli, 27, 33, 39-41, 43, 48, 66, 74, 140, 166, 183, 192, 217, 266, 293, 297-8, 310, 351, 353, 378, 381, 387, 414, 426, 439-40, 469, 472-3, 504, 508, 554, 558, 562-3, 565-6, 592, 622, 643, 646-58
 Sulejmani, 395, 397, 626
 Suleyman Ateşit, 24
 Sumerët, 57
 Sun Myung Moon, 374, 648
 syrgjynosja, 413
- Sh**
 Shemsuddin Sami, 41
 shaman, 35, 181, 191
 Shamashi, 62-3
 ShBA, 287-8, 378, 382-3, 435, 554, 581, 605
 Shehristani, 32, 34

Shën Pjetri, 495, 536
 Shinasi Gündüzit, 25
 Shinto, 363, 367-8
 shintoizmi, 367, 369
 Shit, 49
 Shiva, 276, 278-80, 293
 Shkrimi me kunja, 55-6
 shpallje, 110, 249, 270-1, 297, 310, 354, 369, 373, 379, 417, 467, 472, 485, 500, 503, 583, 587, 589, 593, 597, 620, 624, 626, 628, 643, 645
 shpirti, 35, 47, 51, 135-6, 152, 154, 183-4, 186, 190, 192, 210, 214, 220, 222, 238, 301-2, 354, 409, 497, 513, 540, 572, 583, 604, 631, 642
 Shpirti i Jetës, 255
 Shpirti i Shenjtë, 249, 255, 450, 460, 467, 472-4, 496, 497, 501, 503, 507-9, 516, 520, 523, 527-8, 531, 549, 572, 583, 608, 621, 624, 633
 Shteti Osman, 38, 41, 439, 440, 566

T

tabu, 35
 Talmudi, 33, 49, 112, 421, 434-5
 Tao, 345, 347-8, 350, 355, 357, 359, 377
 taoizmi, 350
Tarib-i Edyan, 31, 33, 40, 41, 653, 654
Tarib-i Umumi ve Ilm-i Esatiri'l-Evvelin, 39
 tasavvuf, 33
 Taylor, 36
 tekstet sumere, 57, 65
 Tempulli, 152, 154, 402, 406, 413, 418, 425, 426, 431, 438, 447-8, 462, 469, 481
 Tengiri, 58
 teologjia e Palit, 491
 teozofike, 599, 601
 Tevrat, 34, 45-6, 48-9, 54, 61-2, 64, 67-70, 102, 111-4, 117, 122, 128, 137, 382, 391, 398, 408, 412, 414, 418, 421, 443
 Tiele, 36
 Tora, 34, 142, 182, 418, 443
totem, 35, 139
triniteti, 63, 65, 95, 130, 151, 154, 164, 509, 523, 591
 trupëzimi, 286, 503, 600
 Tsing-to, 339, 341
 Tufan, 57, 115, 649
 Turqi, 24, 32, 38, 40, 41, 42, 74, 89, 217, 440, 442, 561, 562, 574, 591, 611, 646

Th

Theophilusi, 509
theotocos, 572
theotokos, 571
 Thomas Aquinos, 534

U

ufologjia, 608
 ungjijtë, 449, 468-70, 514, 593-4
 Ungjilli, 34, 219, 448, 457, 467-70, 472-3, 504, 507, 518, 524, 544, 624, 633
 ungjilli hebraik, 472
 Ungjilli i Bernabës, 472-3, 625
 Ungjilli i ebionitëve, 472
 Ungjilli i Filipit, 473
 Ungjilli i Jakobit, 447
 Ungjilli i Pjetrit, 473
 Ungjilli i Tomasit, 473
 Ungjillin e Lukës, 492
 Ungjillin e Mateut, 455, 471, 479, 509, 529
 universi, 270, 272, 318, 607
 Upanishada, 270
 Ur, 57, 60, 62, 67-9, 109, 112, 114, 234
 Uruk, 57-8, 62, 103
 Utu, 59, 96

V

Vahji, 615
 vajimi i shenjtë, 515
 Veda, 204, 269-70, 277, 280
 Venus, 59, 63, 65, 118, 130, 133, 155
 Vishna, 270

Xh

xhajnizmi, 329
 Xhebraili, 415, 509, 621
 xhehennemi, 629, 631
 xhenneti, 242, 341, 415, 423, 629, 631
 xhinnë, 67, 171, 212, 237, 256, 346, 536, 622

Y

Ylli i Davudit, 430

Z

Zaratustra, 197, 201-2, 204-11, 213-5, 259, 601, 604, 628
 zaratustrizmi, 196, 198, 405, 563
 Zeburi, 396, 624
 Zekerija, 444-7, 473
 Zen, 297, 339-41, 369
 Zeusi, 50, 141-3, 146
 Zoti, 28, 45, 62, 77, 96-7, 115, 131, 136-7, 142, 148, 153, 158, 160, 167, 174, 177, 182-5, 193, 207-9, 211-2, 215, 234, 238, 251-2, 254-7, 270, 272-3, 290, 297, 316, 341, 365-6, 373, 377, 380, 384, 395-7, 409, 412-7, 422, 424-5, 432, 434, 444, 447, 454, 456-7, 460, 463, 472, 479, 481, 491, 497-9, 501-2, 504, 506, 510-3, 516-8, 544, 545, 572, 583, 589, 592, 601, 603, 611, 616, 618-9, 631-2, 641-2, 645

Zvicër, 546, 578
Zwingli, 545-6

W
Welt Spirale, 603

Wilhelm Wundt, 36

Ö
Ömer Rıza Doğrul, 42, 655